XHEMIL ZEQIRI

E VËRTETA BËN ARMIQ

SHARR, 2017

Botues:
Thesari

Redaktor:
Mr. Gëzim MEKULI

Recensentë:
Gjeneral Dilaver GOXHAJ
Andrim ZEQIRI

Lektor:
Prof. Xhelal ZEJNELI

Dizajni dhe faqosja:
Omi DESIGN

©Copyright Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për autorin e librit. Ndalohet kopjimi dhe shumëzimi i pjesshëm ose i tërësishëm i librit pa lejen e autorit.

Katalogimi në botim – **(CIP)**
Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

821.18-92

Zeqiri, Xhemil
E vërteta bën armiq / Xhemil Zeqiri. – Sharr : Thesari. – 400 f. ; 21 cm.

ISBN-978-9951-723-10-7

XHEMIL ZEQIRI

E VËRTETA BËN ARMIQ

SHARR, 2017

“Një pjesë e shqiptarëve duket se kanë një defekt në kompozimin e tyre gjenetik, që i bën ata të urrejnë, të përbuzin dhe t’i kenë zili bashkëkombasit e tyre.”

Peter Lucas

PASOJAT E TË KALUARËS SË GABUAR POLITIKE VAZHDOJNË TË RËNDOJNË ENDE PËR ZGJIDHJEN E ÇËSHTJES SHQIPTARE

Letër falënderimi z.Xhemil Zeqiri
nga Dilaver Goxhaj (Shpëtim Golemi)

Ju faleminderit për librat "*E vërteta bën armiq*" dhe atë "*Në mbrojtje (diplomatike) të çështjes shqiptare*", të cilët i lexova dhe janë me të vërtetë vepër e rëndësishme politike e historike së bashku, dhe për këtë ju falënderoj nga zemra. Dhe ajo që të lë mbresë në tërë materialet e pasqyruara, krahas së vërtetës reale është guximi intelektual i veprimtarisë suaj të vërtetë politike në kushtet e emigracionit ekonomik. Edhe nëse ka diçka që unë mund të kritikoja, është mbase vetëm që unë nuk kam qenë dëshmitar i ngjarjeve në Danimarkë, për të cilat ju flisni e shkruani.

Libri juaj "*E vërteta bën armiq*" përbëhet prej 11 intervistash në media të ndryshme në Kosovë, Maqedoni dhe Danimarkë; prej 8 reagimev të ndryshme për përgënjeshtimin e propagandave të ndryshm kundër Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, kundër Ushtrisë Kombëtare Çlirimtare si dhe kundër shkrimeve tuaj të ndryshme me këto tendenca për të denigruar veprimtarinë tuaj atdhetare të shëndoshë; 6 letra të ndryshme dërguar Qeverisë dhe Parlamentit të Danimarkës dhe shumë institucioneve të tjera ndërkombëtare e kombëtare si dhe personaliteteve të ndryshme politike e gazetareske, por edhe 13 shkrimeve tuaja të natyres politike e historike. Të gjitha këto shkruar në periudhën 2001-2016, dhe që kanë një lidhje logjoke sikur me qenë shkruar në një periudhë disa mujore.

Në të gjithë këtë publiçistikë tuajën është përshkruar me hollësi gjithë aktiviteti juaj politik në interes të çështjes sonë kombëtare sa të len përshtypjen se Ju jeni jo vetëm njohës i gjithë ngjarjeve politike që kanë ndodhur në gjithë periudhën tuaj politike 36 vjeçare 1981-2016 dhe protagonist i pothuaj të gjithë atyre

ngjarjeve me karakter kombëtar në Kosovë, Maqedoni, Shqipëri, Luguna e Preshevës, Mal i Zi dhe në diasporën shqiptare në vendet e Skandinavisë europiane, por njëkohësishtë Ju jeni një njohës i mirë i historisë dhe letërsisë sonë kombëtare.

Ju e pranoni që nuk keni diplomë universitare për histori a letërsi shqipe, por etja juaj autodidakte dhe përvoja e veprimtarisë politike u ka bërë që t'i njihni ato shumë më mirë se shumë nga historianët tanët, duke i lënë në bisht shumicën absolute të të gjithë politikanëve aktualë shqiptarë të të gjitha trevave të banuara prej tyre.

Në tërë këtë material që ju keni përmbledhur në këtë vëllim si dhe në librin e mëparshëm "*Në mbrojtje (diplomatike) të çështjes shqiptare*"[1], lexuesi mëson se emigracioni shqiptar në Danimarkë, ku mbi 10 mijë prej tyre janë prej viseve tona në Maqedoni, ka qenë emigracioni më i organizuar politikisht duke arritur të angazhoi edhe Parlamentin dhe Qeverinë Daneze, për çështjen e Kosovës e të Maqedonisë, si asnjë qeveri a parlament tjetër europian. Dhe kjo falë veprimtarisë Tuaj patriotike, e cila ka bërë, bën e do të bëjë ziliqarë shumë "patriotë" deklarativë, mashtrues e hipokritë, të cilët qëllim kryesor kanë pasur e kanë përfitimet materiale që vinin pas privatizimit të veprimtarive tuaja atdhetare, sikundër janë më tipikët: Abdilahim Kasami *"për të cilin, vjehrri i tij Ismail Sulejmani me të cilin punonim bashkë, shpesh më thoshte: "Ata të ambasadës kurrë nuk mbajnë mbledhje pa turkun tim, siç e quante ai"*, Ibrahim Xhemajli, Remzi Loku, Xhemal Duraku, Shenasi Rexhepi, Aki Bilalli, Eshref Eshrefi, Nehat Zymberi, Nevzat Ibishi, Muamer Seferi, si dhe nxirrni lakuriq fytyrën e vërtetë hipokrite të Musa Xhaferit, Bilal Sherifit, Ali Ahmetit, Arbër Xhaferrit (i cili, "kur ishte në opozitë ishte Arbën Xhaferi, e që më vonë, kur do të merrte pushtetin në koalicion, u bë Arbën Xhafersoni" dhe që "Edi

---

[1] Në atë vëllim autori ka përmbledhur 23 letra dërguar Parlamentit, qeverisë dhe ministrisë së jashtme të Danimarkës, Parlamentit e Këshillit të BE-së, Sekretarit të përgjithshëm të OKB letra dërguar Ministrisë së Jashtme, prej vitit 1991-2001, si dhe ka angazhuar 26 gazetarë dhe personalitete të larta Daneze që të prononcohen në favor të çlirimit të Kosovës.

Rama do të shprehej: "O Arbën Xhaferi, eja e bëju shtetas i Shqipërisë dhe do të të bëjmë president"!) etj.

Njëkohësishtë në këto intervista, shkrime dhe reagime ju, i dashur Xhemil, u bëni autopsinë politke dhe "atdhetare" Ibrahim Rugovës, Hashim Thaçit ("Një ish-i përndjekur nga Serbia, kryeministri Hashim Thaçi dhe qeveria e tij, i cytur nga Serbia dhe "miqtë" evropianë, e ndjek për ta burgosur Albin Kurtin!!!"), Ali Ahmetit, Sali Berishës, Veton Surroit, ambasadorit Sami Ibrahimi, Agim Zatriçit, Mendu Thaçit, "Po si të mos bëhesh or vëlla nervoz, kur e sheh në RTV tipin e Naim Malokut kundër Lëvizjes Vetëvendosje, apo kur e sheh Refet Elmazin duke e masakruar popullin shqiptar në malësinë e Sharrit!", Lulëzim Bashës, Pandeli Majkos, Azem Vllasit, Kaqusha Jashari, Fazli Veliut, Agim Çekut, Halil Matoshit, Migjen Kelmendit, Nexhmedin Spahiut, Havzi Sulejmanit, Xhavit Halitit, Baki Ymerit, Uran Butkës, Sabri Godos, Sabri Novosellës, FARK-ut të B. Bukoshit dhe të I. Rugovës, Ymer Ymerit, Atifete Jahjagës, Shenazi Alitit, Milazim Krasniqit, Bamir Topit, Mahmut Bakallit, Ibish Nezirit, Refet Elmazit, Llukman Feratit, Teuta Arifit, Njazi Nuredinit , dhe detyroheni të ndesheni edhe me ish-kryetarin e LPK-së, Bedri Islami, për përkrahjen që i është dhënë nga Ali Ahmeti intrigantit profesionist Abdilhalim Kasamit etj. "Si ua ka dalë, xhanëm, - thashë me vete kur po i rendisja gjatë leximit, - gjithë kësaj armate politikanësh në pushtet e të mbështetur fuqishëm nga ndërkombëtarët!"

E gjithë kjo publiçistikë është një tablo e plotë e veprimtarisë politike shqiptare në trevat shqiptare e diasporën europiane, protagonistët e së cilës udhëhiqen nga parimi: "*dallandyshe ktheje ndryshe*" sa herë u preken interesat personale e ato partiake edhe pse në dëm të interesave kombëtare. Shumë gjera që mua më bëjnë shumë përshtypje nga veprimtaria e këtyre personave, mund të duken krejt të natyrshme në Kosovë e Maqedoni.

Karakteret e këtyre personazheve politikë shqiptarë janë përshkruar, sipas mendimit tim, me një individualizëm të qartë e që është i zakonshëm për Ju; secili prej tyre është një tip, por

njëkohësishtë edhe një individ plotësisht i përcaktuar, një "ky", siç shpreheni ju, dhe kështu duhet të jetë.

Është e qartë se në tërë veprimtarinë tuaj politike e publicistike të botuar në këta dy libra, ju keni ndjerë nevojën t'i shpallni botërisht edhe në këtë libër veprimet dhe bindjet tuaja, t'ja tregoni ato gjithë opinionit shqiptar, e cila përbën një pjesë të historisë për çlirimin e viseve shqiptare në ish-Jugosllavi.

Unë nuk jam kurrsesi kundërshtar i një literature të tillë politike, por merita kryesore e veprimtarisë suaj të dokumentuar në këtë libër si dhe në librin e mëhershëm është se atje paraqitet një dramë shqiptare me tendenciozitet të lartë politik e atdhetar. Shumë prej autorëve të tjerë të kësaj gjinie publiçistike shqiptare janë tendenciozë të njëanshëm, duke mos qenë edhe vetë protagonistë të gjithçkaje që ata analizojnë. Ndërsa tendenca Juaj rrjedh vetiu nga ambjenti ku është kryer aktiviteti dhe nga veprimi Juaj, duke qenë ju protagonisti kryesor, edhe pse nuk e theksoni atë posaçërisht, duke synuar t'ia jepni lexuesit, apo dëgjuesit në radio e TV, të gatshme konfliktet shoqërore e politike që Ju paraqesni, ndryshe nga sa bëjnë romancierët e poetët.

Përveç kësaj, gjithë kjo veprimtari e Juaj u drejtohet si politikanëve por edhe lexuesve të të gjitha kategorive e moshave shqiptare, që do të thotë se kanë të bëjnë drejtpërdrejt me ne të gjithë shqiptarët; prandaj, mund të them se vepimtaria e juaj politike e publicistike, e pasqyruar në këtë libër, e kryen plotësisht, sipas mendimit tim, funksionin e vet, sepse i përshkruan me shumë vërtetësi reale marrëdhëniet tuaja me të gjithë këta persona që reshtova më lartë, të nxjerra nga materiali i këtij libri të dytë, duke zhdukur iluzionet lidhur me natyrën e këtyre marrëdhënieve; kjo tabllo shkallmon optimizmin e të papjekurve politikë dhe dyfytyrësinë e shumicës absolute të politiknëve shqiptarë të periudhës 36 vjeçare që përshkruhen në këtë libër, si dhe ngjall dyshime në lidhje me besnikërinë e tyre ndaj popullit shqiptar, – dhe në shumicën e rasteve Ju propozoni

drejtëpërdrejtë një zgjidhje të caktuar dhe ngandonjëherë duke këmbëngulur: kështu dhe vetëm kështu.

Realizmi juaj në këto matriale parakupton, përveç vërtetësisë së hollësive, një riprodhim me vërtetësi të karakterve tipikë në rrethana tipike, brenda caqeve në të cilat ata veprojnë. Dhe kjo falë faktit që ju e njihni shumë mirë si emigracionin ekonomik e atë politik shqiptar në Danimarkë e më gjerë, por edhe gjendjen politike dhe ekonomike të shqiptarëve në Kosovë e Maqedoni, ashtu edhe veprimtarinë politike të presidentëve Rugova, Berisha, Topi, Thaçi, Nishani, Atifete Jahjaga dhe të politikanëve veteranë Arbër Xhaferri, Ali Ahmeti, Fatos Nano, Edi Rama, Pandeli Majko, Musa Xhaferri etj, dhe dini t'i pasqyroni me një vërtetësi e freski të habitshm si njërën edhe tjetrën figurë politike, gjë që japin në këtë drejtim mundësi shumë të mëdha, të cilat provojnë se keni ditur si të silleni me korrektësi patriotike në çdo situatë që patriotët e rremë e mashtrus shqiptarë janë munduar t'u vënë para situatash të pandershme e të papritura, pa qenë nevoja të përdornit ironi apo sarkazëm të hollë, por duke i goditur drejtëprdrejtë me "sopatën e dardharit", gjë që dëshmon për idealizmin e papërkulshëm tuajin për çështjen shqiptare.

Në materalet e këtyre dy librave lexuesi sheh se si shëmbet dalëngadalë patriotizmi dhe idealizmi i shumë veprimtarëve dhe drejtuesve politikë shqiptarë në Kosovë, Maqedoni e diasporë nën presionin e mashtruesve e hipokritëve shqiptarë vulgarë, duke kaluar në tradhëti të idealeve të deklaruara në fillim të veprimtarisë së tyre politike. Rreth kësaj tabloje qëndrore Ju përqëndroni gjithë historinë e ngjarjeve 36 vjeçare shqiptare, prej së cilës unë dhe gjithkush që i ka lexuar e do t'i lexoi këta dy libra do të nësoi më shumë sesa nga gjithë monografitë e botuara deri tash për atë periudhë të diasporës sonë politike, të marra së bashku.

Veprmtaria politike e juaj e pasqyruar në këta dy librat Tuaj është një ELEGJI e pafund lidhur me vendimet e Rambujesë, Marrëveshjen e Konculit e atë të Ohrit dhe me pavarësinë e cunguar të Kosovës, të cilat çuan në çarmatosjen vetëm të ushtrive çlirimtare

shqiptare, ndërsa ushtrive pushtuese nuk iu hoqën as edhe një fishekë nga armatimi i tyre; simpatia juaj është për luftëtarët dhe popullin e thjeshtë e të vuajtur shqiptar. Të vetmit njerëz, për të cilët ju flisni kurdoherë me një admirim të hapët, janë: Adem Jashari, Adem Demaçi, Ukshin Hoti, Zaim Beqiri, Beqir Berisha, Albin Kurti, Taip Mustafaj, Ibrahim Kelmendi, Hydajet Hyseni, Ramush Haradinaj, Fadil Shyti, Bardhyl Mahmuti, Muhamed Kelmendi, Shqiptar Oseku, Koço Danaj, Bajram Bahtiri, Jashar Salihu, Shaqir Shaqiri, Mehmet Reshati, Gëzim Mekuli, Mehmet Gega, Rafi Halili, Shpëtim Pollozhani, Elmaz Ademi, Rahim Neziri, Remzi Hoxha e Ali Uka, Jusuf Gërvalla, Emrush Xhemajli, Erald Selca, Sejdi Veseli, Ramadan Pllana, Afrim Morina, Kastriot Haxhirexha, Enver Ademi, Xhevat Bislimin, Sheradin Berisha e shumë të tjerë që kanë vepruar në kuadër të LPK-së apo individualisht. Fakti që Ju jini të detyruar që këta atdhetarë të palëkundur deri sot, t‘i vini kundër politikanëve e veprimtarëve që përmenda më lartë, - unë e quaj si një nga fitoret më të mëdha të guximit tuaj intelektual e atdhetar dhe një nga tiparet më të vlefshme Tuajin.

Për t’Ju përligjur, duhet të pranoj se asgjëkundi në tërë veprimtarinë politike shqiptare në emigracionin në Evropë klasa politike shqiptare nuk mund të krahasohet me veprimtarinë Tuaj politike, ngaqë ju nuk i jeni nënshtruar në asnjë rast fatit, shpifjeve e ktitikave tendencioze të ziliqarëve dhe njerëzve me disa fytyra që u kanë rrethuar përherë, me tendencë për t’Ju penguar me çdo kusht, ku kampjonë kanë qenë “mjeshtri i pakrahasueshëm i hipokrizisë” Abdilahim Kasami, Ibrahim Xhemajli e Remzi Loku të mbështetur nga Ali Ahmeti, Musa Xhaferri, Arbër Xhaferri, Bilal Sherifi etj.

Leximi i këtyre dy librave me karakter kombëtar shqiptar nga të gjitha pikpamjet, - si nga tema, ashtu edhe nga trajtimi,- më preku aq fort, saqë m’u desh shpesh herë ta ndërprisja leximin përkohësishtë nga bgenga që ndjeja, aq më tepër që shija ime në këto kohë tradhëtishë të shumta të politikanëve shqiptarë është

topitur aq shumë, - këtë duhet ta pohoj, ndonse më vjen turp, - saqë nganjëherë edhe botime me vlerë të paktë atdhetare në leximin e parë më lënë njëfarë mbrese.

E di se për ju nuk do të jetë ndonjë kompliment i madh, në qoftë se do të vë në dukje, se asnjë prej politikanëve të sotëm zyrtarë në tërë trojet shqiptare, nuk ka guxuar kurrë t'i bënte një mbrojtje të tillë argumentuese veprës atdhetare të Enver Hoxhës, sikundër e bëni Ju, përmes krahasimeve të mbështetura edhe në shifra, në përgjigjet që u jepni telespktatorëve të *RTK–Radio, gjatë emisionit "MË AFËR",* më 19 korrik 2015, pa u përgatitur më herët, sikundër bëjnë politikanët tanë, falë erudicionit tuaj, të cilin dëshiroj ta pasqyroj të plotë: **"***Sa për Enver Hoxhën, do të doja që këtë çështje ta elaboroj në mënyrë pak më të gjerë. Prej viti 1992, qarqe të caktuara bëjnë çmos t'i bindin shqiptarët që ta hanë sapunin për djathë. Me shpifje të llojllojshme, të sajuara nga intelektualë të ndryshëm, si në Shqipëri, ashtu edhe në Kosovë,të cilët mundohen ta lansojnë tezën, se "Enver Hoxha ka qenë njeriu më famëkeq i kombit shqiptar". Por unë nuk u kam besuar këtyre përrallave që na i thojnë intelektualët dhe politikanët tanë.*

Po e elaboroj çështjen në disa pika të shkurtra: Që nga viti 1945, kur mbaroi Lufta e Dytë Botërore, e deri në vitin 1990 ka pasur tre milionë shqiptarë në ish-Jugosllavi dhe tre milionë shqiptarë në Shqipëri. Të bëjmë një krahasim të vogël: Sipas disa analizave të Komitetit të Helsinkit, me sa di unë dhe në mos gabohem, në Shqipëri për 50 vite janë dënuar me pushkatim 3.400 vetë, ndërsa 4.000 të tjerë janë dënuar me shumë vite burg. Pra, nëse e kam bërë mirë llogarinë matematikore, bëhet fjalë për gjithsej 7.400 vetë. Secili prej tyre ka pasur nga 5, ose ja, ta marrim mesatarisht nga 10 anëtarë të familjes, dhe këto bëjnë 74.000 vetë. Le ta marrim se kanë qenë rreth 100.000 njerëz, të cilët kanë qenë të internuar. Ky ka qenë "suksesi i diktatorit Enver Hoxha", siç e quajnë disa intelektualë dhe politikanë tanë.

Tani le të kalojmë te shqiptarët e ish-Jugosllavisë, te Titoja, dhe e bëjmë krahasimin midis Titos dhe Enver Hoxhës. Prej vitit

1945 deri në vitin 1990, me sa kam lexuar unë po nga këta intelektualë gazetash, në Jugosllavinë e Titos janë ekzekutuar 79.000 shqiptarë, ndërsa 350.000 shqiptarë janë shpërngulur me dhunë për në Turqi. Dihet mirëfilli se 1.500.000 shqiptarë janë shpërngulur "përkohësisht" në Perëndim, nga ku shumica nuk u kthyen kurrë më në vatrat e stërgjyshërve. Duhet shtuar se prej vitit 1991 deri më sot, në Shqipëri kemi 120-130 parti politike. Po kështu shumë parti politike kemi edhe në Kosovë, në Maqedoni, Mal të Zi… Pra, në trojet shqiptare në Ballkan kemi mbi 200 parti politike – të mëdha apo të vogla. Këto parti politike i kanë degët dhe nëndegët e veta. Çdo degë apo kryesi partiake ka së paku nga 10 anëtarë. Shumica prej tyre kanë të kryer fakultet. Megjithëkëtë, asnjëri prej tyre nuk doli të thotë një fjalë të vetme për ta zbardhur të vërtetën e hidhur për atë që bëri Titoja! Bëri ndaj shqiptarëve një ***genocid*** *të pashembullt në botë. Përkundrazi, të gjitha këto parti politike e akuzojnë Enver Hoxhën, birin më të shtrenjtë të kombit, se paskësh qenë diktator. E akuzojnë njeriun që e mbrojti kombin, që siguroi mirëqenie kombëtare, që e mbrojti popullin shqiptar nga shpërbërja, që me politikën e tij ekonomike për 40 vjet e rriti popullsinë në Shqipëri nga 800.000 në 3.500.000, ndërsa sot partitë e saj politika e kanë çuar numurin e popullsisë në 1.000.000. Rrjedhimisht, vetvetiu imponohet pyetja: "Përse partitë politike shqiptare, intelektualët dhe politikanët heshtin para krimeve të Titos ndaj shqiptarëve, e në anën tjetër dalin me teza denigruese ndaj personalitetit të Enverit"?! Unë i kuptoj miqtë tanë amerikanë, që e urrejnë Enver Hoxhën sepse kemi të bëjmë me dallime ideologjike, mirëpo udhëheqësit dhe politikanët shqiptarë duhet ta pranojnë se po të mos kishte qenë Enver Hoxha në Konferencën e Paqes në Paris, në vitin 1946, interesat e Shqipërisë në Ballkan do të rrezikoheshin rëndë, ndoshta dhe nuk do kishte Shqipëri. Partitë politike apo liderët shqiptarë të sotëm, sot e kësaj dite, nuk kanë as 5% kapacitet për ta thënë atë që e tha Enveri në Konferencën e lartpërmendur. Pastaj duhet të theksohet lufta e Enverit për mbrojtjen e pavarësisë së Shqipërisë, ndarja nga bashkimi sovjetik, nga Kina, nga jugosllavët, vetëm e vetëm për ta mbrojtur vendin.*

Në Shqipëri janë bërë përparime të mëdha nën udhëheqjen e Enverit. Unë nuk mund ta kuptoj se si një intelektual, një profesor si Sali Berisha merr guximin të flasë gjera të kota kundër Enver Hoxhës, kur ai vetë ka qenë në shërbim të sistemit dhe në shërbim të partisë së tij?!"

Moszgjidhja e çështjes shqiptare edhe në këto katër dekada të quajtura DEMOKRACI, vërteton se nuk ishte Enver Hoxha ai që "e shiti" Kosovën e trojet e tjera shqiptare, dhe as faktori i varfërisë sonë ekonomike, por në këtë zhvillim të luftës historike ndikojnë fuqishëm edhe shumë faktorë të ndryshëm të politikës së Shteteve të Mëdha Europiane, SHBA e Rusisë; ndikojnë format juridike dhe pasqyrimi i të gjitha këtyre betejave reale në trurin e politikanëve shqiptarë pjesmarrës në kontaktet ndërkombëtare; ndikojnë teoritë e tyre politike, juridike, filozofike, fetare dhe zhvillimi i tyre i mëtejshëm në përqasje me konjukturat ndërkombtare të cilat na kanë ardhur në takim shumë herë në këto katër dekada, por që politikanëve tanë u kanë munguar aftësitë e Enver Hoxhës që theksoni Ju më lartë. Këtu kemi të bëjmë me një veprim reciprok midis të gjithë këtyre faktorëve, zhvillimi i të cilëve bazohet në zhvillimin tonë ekonomik. Të gjithë këta faktorë ndikojnë mbi njëra-tjetrën si dhe mbi bazën ekonomike, por nuk është aspak e vëtetë se vetëm gjendja ekonomike është shkaku i vetëm aktiv dhe se të gjithë të tjerët janë vetëm një rrjedhim pasiv, sikundër duan të justifikohen politikanët shqiptarë të këtyre katër dekadave të fundit.

Si përfundim mund të them se Ju keni pasur fatin të njiheni me shumë personalitete të larta politike e publicistike europiane, e veçanërishtë ato daneze, falë guximit e këmbënguljes suaj intelektuale, duke pasur një sy më të mprehtë dhe një horizont më të gjerë se ata që u rrethonin në emigracionin shqiptar në Danimarkë. Dhe duke qenë i tillë, sikundër ndodh zakonisht kur rrethohesh nga hipokritë e ziliqarë, Ju nuk e gëzoni, sa kohë që të jini gjallë, famën që besoj se e meritoni. Jam më se i bindur se ju do të çmoheni nga brezat e ardhshëm. Historia në fund të fundit do ta vërë çdo gjë në vend, por deri atëherë Ju dhe të gjithë ata që e kanë pësuar si Ju, do

të kenë shkuar në atë botë dhe nuk do të marrin vesh asgjë, pasi koha që jetojmë ne është koha e maskarenjve, ku pas vdekjes vlerësohen njerëz më pak të rëndësishëm, si psh rasti i Arbër Xhaferit- Xhafersonit, të cilën e keni shtjelluar shumë saktë në librin tuaj në fjalë.

Tiranë, 28 gusht 2017

Pjesa e parë

INTERVISTA

DEVIJIMI I PDSH – SHKAK I SHPËRTHIMIT TË LUFTËS NË MAQEDONI

Intervistë TV 3, Danimarkë, 26-01-2001

Rasmus Rasmuseni: Disa ditë pasi ka shpërthyer lufta në Kalanë e Tetovës, në klubin shqiptar "Bashkimi" shkoi një eki i ynë, i programit të tretë - TV3, për të mësuar diçka më shumë në ambientin shqiptar. Pronari i klubit na adresoi te Ju, z.Xhemil Zeqiri. Z. Xhemil, ju jeni kryetar i Këshillit për liritë e njeriut - të Kosovës dhe jeni aktiv edhe për shqiptarët e Maqedonisë. Javën e fundit konflikti ka shpërthyer edhe në Ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe ju i jeni drejtuar me një letër të hapur qeverisë, nëpërmjet ministrit të Jashtëm, Mogens Lyketoftit.

Zeqiri: Po, edhe në Maqedoni shpërtheu konflikti i armatosur pasi shqiptarët atje nuk kishin rrugë tjetër. Edhe protestat filluan të bëhen monotone. Gati në të gjitha qytetet e banuara me shqiptarë janë bërë me dhjetëra demonstrata që të njihen të drejtat më elementare, siç është zhvillimi i gjuhës amtare, shkollimi në gjuhën amtare, që edhe shqiptarët të kenë shkollat në gjuhën shqipe dhe të drejta rë tjera të garantuare me të drejtën ndërkombëtare, sipas konventave ndërkombëtare. Ky konflikt që ka shpërthyer dhe do përhapet në të gjitha vendbanimet e banuara me shqiptarë, sepse urrejtja është e madhe ndaj padrejtësive që vite të tëra vazhdojnë të bëhen në kurriz të popullatës shqiptare. Këtë, pak kohë më parë e paralajmëroi edhe organizata e respektuar për të drejtat e njeriut, ËËËAVC.Mes tjerash, ajo në raportin e fundit thekson se nëse nuk përmirësohet pozita e shqiptarëve, konflikti është i pashmangshëm, kështu që parashikimet dolën të sakta. Ndërkohë thuhej se shteti të cilin e quanin Maqedoni, është shembull konkret sesi zgjidhen problemet ndërnacionale.

Rasmus Rasmuseni: A do të thotë kjo se është një organizim i mirëfilltë pas luftës në Kosovë dhe luftës tjetër në tri komunat në Serbi të banuara me shqiptarë dhe se plani vjen edhe në ketë Republikë?!

Zeqiri: Nuk është e planifikuar, se po të ishte ashtu, atëherë do të fillonte me kohë, kur filloi në Drenicë, sepse kishte një organizim. Ai organizim i UÇK-së në fakt Maqedoninë e ka pasur Zonë operative Nr. 3. Por si duket, politikanët shqiptarë dhe ndërkombëtarë u morën vesh që në Maqedoni të mos ketë luftë, por shqiptarët të jenë të barabartë dhe të behet edhe ndryshimi i kushtetutës. Bile për këtë dha garanci dhe partia shqiptare në koalicion, pra Partia Demokratike Shqiptare. Por asgjë pozitivisht nuk ndryshoi. Pastaj me hyrjen e trupave ushtarake ndërkombëtare, ata e shkatërruan çdo organizim ushtarak shqiptar, filluan burgosjet e luftëtarëve më të mirë, filluan edhe vrasjet. Edhe sot nuk dihet se kush po i vret ish-pjesëtarët më të mirë. Në Maqedoni nuk pati përmirësime të të drejtave të shqiptarëve, partia në pushtet harroi përse popullata ia pat dhanë votat, ndaj ky është një veprim spontan. Ka dalë me disa veprime Ushtria Çlirimtare Kombëtare e cila ka bërë disa aksione, i ka marrë përsipër ato aksione ushtarake. Ky ka qenë pretekst që filloi një valë e paparë terrori ndaj popullatës shqiptare. Pa dyshim se në këto sulme kanë qenë në qendër ata djem të cilët kanë marrë pjesë në luftën e Kosovës, por edhe ata që ishin shpërngulur nga Kosova gjatë bombardimeve të NATO-së, e që ishin strehuar në Maqedoni. Me fjalë tjera, sulmet policore ndaj familjeve shqiptare ishin një dhunë e paparë dhe nuk dallojnë nga sulmet serbe që i kemi parë nëpër tv-botërore, ku edhe fëmijët, gratë, e pleqtë janë rrahur e maltretuar.

Rasmus Rasmuseni: Por qeveria thotë se ata janë në kërkim të terroristëve dhe se në qeveri ka edhe shqiptarë. Edhe ata e thonë të njëjtën gjë!

Zeqiri: Unë e kam parasysh deklaratën e ambasadorit sllavo-maqedonas në Danimarkë, por ata janë shërbëtorë të maqedonasve

dhe për këtë ata marrin rroga, pra i mbrojnë interesat e atij shteti. Populli ynë ka një thënie të bukur "qeni ku ha, aty edhe lehë".

Ata njerëz që janë në koalicion tani , kur ishin në opozitë, me qindra demonstrata bënin vetëm e vetëm ta demaskonin shtypjen maqedonase ndaj popullatës shqiptare. Tani që hynë në qeveri, ata i kanë harruar edhe premtimet që ia dhanë elektoratit të tyre. Këtu vlen të përmendim se edhe faktori ndërkombëtar po bën trysni të madhe ndaj faktorit shqiptar në këtë Republikë, duke i premtuar se dalëngadalë do ta detyrojnë Maqedoninë të lëshojë pe. Ndonjëherë edhe i kërcënon, pra tallen me kërkesat shqiptare. Bashkësia ndërkombëtare thotë: "Ne nuk mund t'i lejojmë terroristët dhe ekstremistët të bëjnë aksione terroriste?

Po tani është shumë kontradiktore kjo thënie që pastaj po bëhet qëndrim. Pastaj nuk dihet për opinionin e jashtëm, kur është ekstremiste e kur çlirimtare. Për mendimin tim, nuk mund të jenë terroriste kërkesat që të jesh i barabartë me popullatën tjetër të Ballkanit dhe nuk mund të jetë terroriste ideja dhe vepra që të mbrosh të drejtën e popullit tënd, të drejtën që të takon, qoftë edhe me armë. Pra, këto definicione nuk janë të qarta për bashkësinë ndërkombëtare. Nëse ata mendojnë se padrejtësitë ndaj shqiptarëve duhet të vazhdojnë, është e kuptueshme se shqiptarët do të bëjnë përpjekje për t i kërkuar të drejtat e tyre. Duhet të kemi parasysh se lufta e armatosur nisi vetëm atëherë kur kërkesat paqësore nuk donin t i dëgjonin qeveritarët maqedonas e serbë.

Rasmus Rasmuseni: Të faleminderit për bisedën.

Zeqiri: Ju lutem, jeni të mirëseardhur edhe herë të tjera.

Fund

NUK SHOH ÇLIRIM KUR NJË E TRETA E TERRITORIT TË KOSOVËS ËSHTË NËN OKUPIM TË DHUNSHËM DHE ME ENKLAVA SERBE

Intervistë me gazetarin Musli Krasniqi, për gazetën "Epoka e Re", Prishtinë , 13 korrik 2001

Musli Krasniqi: Kosova dhe problemi shqiptar është kthyer në vitet '50, në një gjendje shumë katastrofike, në pikëpamje ekonomike, kulturore apo morale. Unë merrem qe 26 vjet më këtë çështje dhe që kam marrëdhënie mjaft të mira me diplomacinë daneze. Ata thonë se nuk ka pavarësi për Kosovën. Ata thonë se ka vetëm një autonomi dhe kësaj autonomie po i thonë pavarësi e kushtëzuar. Kështu thotë në një intervistë për "Epokën e re" veprimtari nga diaspora, Xhemil Zeqiri. I lindur në fshatin Zhelinë të Tetovës, që nga viti 1981 jeton në Danimarkë, ku edhe ka filluar aktivitetin ilegal në shërbim të çështjes kombëtare në radhët e Lëvizjes Popullore të Kosovës (LPK). I rënë në kontakt me shokët e tjerë të ilegales atje, veçmas në Kopenhagë, fillimisht u angazhua në shpërndarjen e literaturës dhe të kasetave që vinin nga Shqipëria. Me këtë mundoheshin t'i sqaronim masës se "nuk jemi jugosllavë". Tani ai "militon" në radhët e Lëvizjes VETËNVENDOSJE në Skandinavi. z..Zeqiri, vendi ku jetoni dhe veproni që nga ajo kohë është Danimarka. Cili ishte roli juaj në sensibilizimin e organeve daneze për kauzën shqiptare?

ZEQIRI: Nga viti 1985 erdhi një proces kur filloi një vetëdije te shqiptarët dhe ata filluan të interesohen më shumë. Dhe ne klub nuk kishim. Ishte një klub kur ishte përgjegjës Abdylhalim Kasami (kryetar i atëhershëm i LPK-së për Danimarkë) dhe që dënonte demonstratat e vitit 1981 në ambasadën jugosllave. Mua më dhembte në shpirt se si është e mundur që të manipulohet populli. Unë në atë kohë sakrifikova 120 mijë kruna daneze (sot përafërsisht

20 mijë euro), që të krijohet një klub shqiptar. Asnjëherë nuk kam qenë anëtar i kryesisë së saj. Deri në vitin 1985, kur u krijua shoqata, me shokët e tjerë filluam organizimet edhe në shtetet e tjera, Gjermani, Zvicër, Suedi etj. dhe filluan edhe demonstratat. Shoqata e punëtorëve shqiptarë "Besa" luajti një rol të madh në këtë kohë dhe të gjitha demonstratat u bënë nga kjo shoqatë. Në këtë kohë kishte edhe një klub tjetër, "jugoklub" që i dënonte kërkesat shqiptare në Kosovë.

Më vonë, unë pashë se në mjetet daneze lobi serb ishte shumë i aftë dhe përvetësonte gazetarët. Ne filluam të intervenojmë nëpërmjet gazetarëve, nëpërmjet shoqatave të ndryshme dhe organizatave për të drejta të njeriut, lidhjes së shkrimtarëve, Pen Klubit Danez, në partitë politike dhe te përfaqësuesit e tyre që kishin të bënin me politikën e jashtme, tek ata që ishin përgjegjës për Ballkanin. Filluam kontaktet, filluam t'i furnizojmë me materiale, blinim libra anglisht që kishin të bënin me çështjen shqiptare, ua shpërndaja, fotokopjonim materiale, sillnim gazeta të ndryshme, kaseta etj. E sollëm edhe një film në anglisht, ***"Kosova today",*** që e kishte bërë Shqipëria për demonstratat e marsit '89 në Kosovë, kur kushtetuta e Kosovës u shkel me dhunë nga Serbia. Ky film iu shpërnda të gjitha partive në parlamentin danez, organizatave të ndryshme, radio televizioneve etj. Me krijimin e partive politike shqiptare, u mundova t'i vë në kontakt me partitë daneze, organizatat, gazetarët dhe vumë kontakte të ngushta. Por, u pa qartë se partitë politike në trojet shqiptare nuk ishin të interesuara që procesin shqiptar ta çonin përpara, por ta stagnojnë.

EPOKA E RE: *Shtatë vjet pas çlirimit të Kosovës, gjashtë vjet pas përfundimit të luftës në Luginë të Preshevës dhe pesë vjet pas përfundimit të luftës në Maqedoni, sa ka ndryshuar qëndrimi perëndimor rreth çështjes shqiptare në Ballkan dhe në ç'kontekst mund të jetë ky ndryshim?*

ZEQIRI: Për fat të keq unë nuk mund ta quaj çlirim, sepse nuk shoh çlirim kur një e treta e territorit të Kosovës është nën okupim të dhunshëm dhe me enklava serbe, e për fatin e keq këtu ekziston

edhe UNMIK-u, dorë e zgjatur e Serbisë. Ne jemi dëshmitarë të kohës se me ligjet që Millosheviqi dhe bashkëpunëtorët e tij i aprovuan në kushtetutën e dhunshme të vitit 1989 kundër shqiptarëve, janë dënuar nëpër gjykata në Kosovë ish-ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Nuk mund të them çlirim kur mbi 300 mijë shqiptarë sot vuajnë për kafshatën e bukës, ndërsa përfaqësuesit e UNMIK-ut, si p.sh. Hans Hakerupi, i cili sipas informacioneve të mia e kishte rrogën jo më pak se 30 mijë euro në muaj si ministër i Mbrojtjes i Danimarkës, e la luksin atje dhe erdhi në Kosovë. Ma merr mendja se në Kosovë ka marrë dyfishin ose trefishin e rrogës. Dhe, të gjitha këto shpenzime i paguan populli i Kosovës. UNMIK-u është një organizatë antidemokratike që nuk i intereson të zgjidhë problemin e shqiptarëve, por i detyron një klikë politikanësh shqiptarë të futen në dialog pa asnjë perspektivë. Duke e parë këtë rrezik, i jam drejtuar disa herë Havier Solanës dhe qeverisë daneze, se dialog po, por para se të hyjmë në dialog me qeverinë fashiste serbe, e cila ka bërë shumë dëme, t'i kthejë të burgosurit që as sot nuk dihet nëse janë gjallë, nuk dihet fati i Ukshin Hotit dhe i shokëve të tjerë, për kufomat e të vrarëv, pasurinë e plaçkitur nga Kosova. Fundi i fundit, vetë komuniteti ndërkombëtar duhet ta detyrojë Serbinë të kërkojë falje për atë dhunë dhe terror që ka bërë mbi shqiptarët në njëqind vjetët e fundit. Përkundrazi, partitë politike në Kosovë ranë pre e UNMIK-ut dhe u futën në një dialog të tillë.

EPOKA E RE: *Dhe prapë, shtatë vjet pas çlirimit të Kosovës, gjashtë vjet pas përfundimit të luftës në Luginë të Preshevës dhe pesë vjet pas përfundimit të luftës në Maqedoni, sa është realizuar synimi i shqiptarëve?*

ZEQIRI: Po të ishte Fan Noli i madh do të thoshte "zero me xhufkë". S'kemi kurrfarë realizimi. Përkundrazi, Kosova dhe problemi shqiptar është kthyer në vitet '50, në një gjendje shumë katastrofike, në pikëpamje ekonomike, kulturore apo morale. Unë merrem qe 26 vjet më këtë çështje dhe që kam marrëdhënie mjaft të mira me diplomacinë daneze. Ata thonë se nuk ka pavarësi për

Kosovën. Thonë se ka vetëm një autonomi dhe kësaj autonomie po i thonë pavarësi e kushtëzuar. Atëherë pse e mashtrojmë popullin?

EPOKA E RE: *A shpresoni ju në një zgjidhje të drejtë të çështjes shqiptare?*

ZEQIRI: Tani për tani kemi Lëvizjen VETËVENDOSJE e cila mundohet të nxjerrë në pah gjendjen, të shpjegojë dhe është duke ia shpjeguar mirë masës. Shumë organizata në Danimarkë, Norvegji, Suedi e në vende të tjera, kanë filluar të shohin se çfarë tragjedie po i kanoset Kosovës nëpërmjet UNMIK-ut. Lëvizja VETËVENDOSJE nuk është aspak kundër OKB-së, por OKB-ja këtu po luan rol të dyfishtë dhe këtu duhet të koncentrohemi më tepër.

EPOKA E RE: *Kosova është afër përkufizimit të statusit politik të saj nëpërmjet një procesi negociator ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit, e të "sponsorizuar" nga OKB-ja. Cili është gjykimi juaj për rrjedhën e deritashme të këtij procesi?*

ZEQIRI: Statusi i Kosovës do të jetë i qartë, do të jetë vetëm ai që e kanë nënshkruar pehlivanët politikë në Rambuje. Kosova ende do të quhet territor i Serbisë derisa të mos ndryshojë Rezoluta 1244 në Kombet e Bashkuara. Të definohet qartë se Kosova është territor i vendësve. Pra, neve na duhet e drejta për vetëvendosje. Dhe ky është program. Kam dëgjuar disa herë të jetë thënë se Lëvizja VETËVENDOSJE nuk ka program. Programi për të cilin që njëqind vjet luftojnë shqiptarët është pikërisht ky: pika 1, e drejta për vetëvendosje. Dhe të gjithë shqiptarët duhet të sillen në këtë pikë. Përndryshe, nuk shoh ndonjë perspektivë tjetër, mund të ketë vetëm trazira. Tani bëjnë pazarllëqe, jo Mitrovica, jo decentralizimi. Unë decentralizimin edhe në shtypin danez e kam quajtur kancer për Kosovën që do të na e hajë shpirtin neve shqiptarëve.

EPOKA E RE: *z. Zeqiri, kthehemi edhe njëherë në Maqedoni. Atje u bë një luftë në vitin 2001 dhe patëm nënshkrimin e një marrëveshjeje në Ohër ndërmjet shqiptarëve dhe maqedonasve. Çka fituan shqiptarët nga ajo luftë dhe a e fituan atë që mund ta fitonin?*

ZEQIRI: Marrëveshjen e Ohrit në një rast unë e kam quajtur "marrëveshje e vorrit". Sepse më tepër ushtarë të ish-Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare janë vrarë pas asaj marrëveshjeje sesa gjatë luftës. E përmenda më herët Abdylhalim Kasamin. Abdylhalim Kasami përhapte ide se "tani NATO-ja do ta njohë Ushtrinë Çlirimtare Kombëtare si ushtri legjitime në Maqedoni dhe ka pak gjasa të njihet ushtria maqedonase". Do të thotë manipulonte me çdo kusht para njerëzve. Fundi i fundit, unë kam kërkuar edhe nga shtabi i tyre që ky njeri të dalë dhe të deklarojë se çka ka bërë si zëdhënës politik gjatë asaj kohe sa ishte në Skandinavi. "Zero me xhufkë" ishte rezultati i tij. Nuk ka dhënë asnjë intervistë. Sot e kësaj dite nuk është i gatshëm të japë intervistë. Dhe sot rezultati është i tillë: fitojnë BDI-ja dhe VMRO-DPMNE-ja që ishte në qeveri gjatë luftës. Tani BDI-ja mundohet me çdo kusht të mbrojë karrigen e vet. Do të thotë, atyre nuk iu intereson se si do të ecë procesi për shqiptarët. Kjo vlen edhe për PDSH-në. Për PDSH-në kam një fije shprese te Bardhyl Mahmuti, i cili është inkuadruar në këtë parti dhe mbetem me shpresë të madhe se ai do të bëjë disa ndryshime aty dhe kjo parti do të gjejë rrugën dhe do të definojë politikën e vet për popullin në ato troje.

EPOKA E RE: *Përmendët zgjedhjet e fundit në Maqedoni dhe fituesit e tyre. A ishte i pritshëm për ju ky rezultat?*

ZEQIRI: Para zgjedhjeve më pyesnin shokët se kush do të fitojë dhe unë u thosha se do të fitojnë maqedonasit. Pavarësisht se kush do të fitojë, shqiptarët janë vetëm shërbëtorë të institucioneve sllave. Nuk ka asgjë, Marrëveshja e Ohrit nuk është realizuar as 3 për qind. Nëse e marrim me përqindje, kërkesat reale të luftëtarëve të lirisë, me Marrëveshjen e Ohrit u realizuan në letër 25 për qind, ndërkaq më vonë, ish-presidenti maqedonas, Boris Trajkovski, bëri ndryshime. Pasi u çarmatos UÇK-ja, maqedonasit bënë një lloj referendumi se a pajtohet populli apo jo, u jep apo nuk au jep besimin politikanëve që e nënshkruan marrëveshjen e Ohrit. Dhe kur Trajkovski e gjysmoi këtë, shqiptarët dolën njëjtë sikur turqit, romët e bullgarët në Maqedoni. Do të thotë, shqiptarët me 30-40 për

qind, u barazuan me pakicat 2-3 për qind. Partitë politike shqiptare, BDI-ja dhe PDSH-ja e pranuan një lojë të tillë. Dhe sot as 3 për qind nuk është realizuar ajo marrëveshje, nuk ka asgjë, gjithçka ka ngelur. Burgjet në Maqedoni janë përplot me ushtarë çlirimtarë, unë për veten time u frikësova të shkoj në Maqedoni.

Kur folëm për të drejtat, shqiptarët atje kanë të drejtë vetëm të shahen dhe të vriten mes vete por jo të drejtohen kundër shovinizmit dhe nacionalizmit maqedonas. Kanë të drejtë vetëm mes vete të ngatërrohen. Ka pasur edhe gjakderdhje gjatë fushatës elektorale.

EPOKA E RE: *Ende po vazhdon lufta e partive shqiptare për pushtet atje. Secila parti, si BDI-ja ashtu edhe PDSH-ja duan të jenë pjesë e pushtetit, por jo të dyja së bashku. Cilën parti shqiptare e shihni në qeverinë e re të Maqedonisë?*

ZEQIRI: Ç'është e vërteta nuk e kam ndjekur procesin e këtyre zgjedhjeve, duke e parë se këto dy parti luftojnë vetëm për pushtet dhe nuk u intereson interesi i popullit. Partia Demokratike Shqiptare tani ka kuadër më të fortë, e them edhe njëherë, shpresoj te Bardhyl Mahmuti. I vetmi njeri që ka një sens politik dhe që ka mundësi të bëjë ndryshime në këtë parti. Se sa do të jetë Partia Demokratike Shqiptare parti demokratike shqiptare, e tregoi veten edhe gjatë luftës dhe kur ishte në pushtet. Unë e kam thënë, **kur ishte Arbën Xhaferi në opozitë ishte Arbën Xhaferi, e kur u fut në pozitë u bë Arbën Xhaferson**, filloi të shohë problemin shqiptar me syze angleze, syze perëndimore. Dhe mbes me shpresë te Bardhyl Mahmuti që të bëjë ndryshime në këtë parti dhe shpresa është që kjo parti të bëjë ndryshime. Ndërsa te BDI-ja nuk kam asnjëfarë shprese.

EPOKA E RE: *A mendoni se kjo lojë e koalicioneve ua ul shqiptarëve "pazarin" e pjesëmarrjes në pushtet?*

ZEQIRI: Natyrisht. Ja e patë, tani bashkësia ndërkombëtare tha se të dyja partitë shqiptare duhet të jenë në pozitë. Atëherë kush do të jetë opozitë për shqiptarët? Populli do të jetë në opozitë, ndërsa këto të dyja do të jenë në luftë kundër popullit.

EPOKA E RE: *z..Zeqiri, kalojmë te një vend yni fqinj, Mali i Zi. Ai me votat e shqiptarëveka fituar pavarësinë para pak muajsh. Cili është komenti juaj?*

ZEQIRI: Folëm për Maqedoninë, tani flasim edhe për Malin e Zi. Maqedonia është krijuar si republikë e dytë serbe në Ballkan. Edhe Mali i Zi është republikë serbe, de fakto. Janë aleatë shpirtërorë të nacional-shovinizmit serb ndaj shqiptarëve dhe në njëqind vitet e fundit Mali i Zi ka luajtur një rol shumë antishqiptar. Ne e dimë se gjatë atyre viteve të "mjaltit" të demokracisë në Mal të Zi, kur luftohej në Kroaci e në Bosnjë, malazezët i shpërngulën shqiptarët me dhunë. Sot Malësia e Madhe gati se është shpërngulur e tëra në Kanada. Dhe, lëre se është shpërngulur për fatin e keq, por ata vinin nga Kanadaja me mish e me shpirt të votonin për pavarësinë e Malit të Zi. Dhe kjo e dyfishon tragjedinë. E tragjedia dyfishohej edhe nga politikanët aktualë të Shqipërisë dhe të Kosovës kur thoshin se ndarja e Malit të Zi është fitore e madhe dhe se me Serbinë ne do t'i zgjidhim problemet më mirë. Serbia bëri një marrëveshje me bashkësinë evropiane: Mali i Zi le të ndahet, duke e ditur se Mali i Zi nuk mund të jetojë i pavarur prej Serbisë, në aspektin kulturor, ideologjik, fetar e të gjitha. Ata janë të lidhur shpirtërisht. Ajo ishte vetëm një pavarësi në thonjëza dhe shqiptarët nuk do të kenë kurrfarë të drejte në atë republikë. Do të humben edhe ato kërkesa të shqiptarëve, do t'u thuhet: *Ju i keni përfaqësuesit tuaj në pushtet.* Mirëpo, të drejtat e njeriut nuk respektohen. Kanë krijuar edhe këshilla që të ankohen kur shkelen të drejtat e njeriut. Por neve na mohohet me shekuj e drejta kombëtare.

Ishte pikërisht Sali Berisha që para asaj kryengritjes popullore në Shqipëri në vitet 1996-1997 e pranoi Maqedoninë pa kurrfarë kushtesh. Dhe prapë Sali Berishës i shkon piskama për "pavarësinë e Malit të Zi". Jo rastësisht Besnik Mustafaj deklaron: *"Pavarësisht statusit të Kosovës dhe marrëdhënieve me Kosovën, ne nuk i prishim marrëdhëniet me Serbinë, i kam premtuar homologut tim Drashkoviq".* Ç'janë këto deklarata tradhtie?! E njeh Maqedoninë pa asnjë kusht, e njeh Malin e Zi pa asnjë kusht. Sot në Shqipërinë e

jugut veprojnë më shumë se 100 organizata antishqiptare dhe në sy të Partisë Demokratike. Nuk ndërhyn. Zhvarrosen shqiptarët, duke i quajtur ushtarë grekë. Nacional-shovinizmi grek tallet me varrezat shqiptare. Dhe qeveria demokratike hesht, për të mos thënë i përkrah.

EPOKA E RE: *A mund të mburret shteti shqiptar me rolin e tij gjatë shekullit që lamë pas në shërbim dhe ndihmë të shqiptarëve të lënë dhunshëm jashtë kufijve të tij?*

ZEQIRI: Ajo Shqipëri me 28 mijë km^2 që u njoh në Jaltë, ndoqi një politikë shumë të drejtë ndaj problemit shqiptar jashtë atdheut. Ju e dini se në ato situata shumë delikate Shqipëria dërgoi disa qindra profesorë, libra, që të ngrihet vetëdija në Kosovë dhe në territoret e tjera të shtypura. **Ne na ka mbajtur gjallë Shqipëria e Enver Hoxhës**[2)]. Dolën më vonë partitë politike titiste dhe filluan të merren me prapahistori, duke akuzuar se Shqipëria dhe Enver Hoxha e kanë shitur Kosovën. Por si e shiti ore Enver Hoxha Kosovën kur në vitin 1913 ai kishte vetëm 5 vjet?! Ne mund ta diskutojmë se pse nuk e bashkoi, por tash po dalin dokumentacione se Enver Hoxha kishte punuar shumë, kur 850 mijë ushtarë në Shqipëri kanë qenë të gatshëm për intervenim ushtarak në territoret shqiptare, duke e ditur se serbët nuk do ta lëshonin Kosovën në mënyrë demokratike. Ata do të bënin treqind komplote të ndryshme, vetëm e vetëm ta mbajnë Kosovën territor të tyre.

Sot për sot Shqipëria luan një rol shumë antikosovar. Ja, patët ju Sali Berishën. Pa e pyetur popullin e Kosovës thotë se populli i Kosovës është për pavarësi, për Strasburgun. Prej ku këto deklarata të tij? Mos bëri referendum në popull ai? Mos pyeti ai se populli i Kosovës nuk qenka për bashkim me Shqipërinë, por për Strasburgun? Do të thotë, ne njëherë qenkemi për Stamboll, njëherë për Beograd, tash për Strasburg, por kurrë për Tiranë dhe për bashkim kombëtar.

Unë e pashë se gjatë vizitës së Sali Berishës, këtu doli vetëm elita politike titiste dhe i bëri nderime të mëdha. Unë pashë një

---

2 Shih pjesën e pestë të librit.

skenë këtu para Grandit, Bujar Muharremi, përfaqësues i zyrës këtu dhe Sali Berisha i bënë popullit me dorë dhe populli s'e ngre dorën. Do të thotë populli ka filluar të hetojë se kah është duke e çuar ky palaço politik çështjen shqiptare.

EPOKA E RE: *Disa herë gjatë kësaj bisede keni përmendur Lëvizjen VETËVENDOSJE!. A mund të na e bëni një koment më të gjerë rreth kësaj lëvizjeje?*

ZEQIRI: Unë kam krijuar Këshillin e Lëvizjes VETËVNDOSJE në Danimarkë dhe përfaqësoj lëvizjen atje. Jam munduar të shpjegoj se UNMIK-u është një organizatë antidemokratike. UNMIK-u ka organizuar disa palë zgjedhje në Kosovë dhe këto zgjedhje janë mbajtur me lista të mbyllura. Vetë danezët kanë filluar ta kuptojnë se këto janë procese antidemokratike. Hans Hakerupi ka qenë si një mbret në Kosovë. Ka bërë një libër të tij atje dhe thotë se shqiptarët nuk dinë ç'është demokracia. Jo more, dinë ç'është demokracia, neve na duhet liria. Ne s'kemi liri, pa liri s'ka demokraci, s'ka zhvillim ekonomik, s'ka perspektivë, as në aspektin kulturor, e as në asnjë lëmi tjetër. Albin Kurti dhe Lëvizja VETËVENDOSJE janë duke ia çjerrë maskat UNMIK-ut. Me këtë gjuhë u flas danezëve. Dalin serbët dhe zënë rrugën, SHPK-ja dhe TMK-ja nuk kanë të drejtë të intervenojnë. Del në kufi Lëvizja VETËVENDOSJE për ta ndalë Koshtunicën, një kriminel serb, SHPK-ja i sulmon dhe i hap rrugë Koshtunicës. Këta të SHPK-së ishin pjesëtarë të UÇK-së, janë pjesëtarë të këtij populli? Pse bën kështu? Fundi i fundit hedhe atë kapelë, hedhe atë uniformë.

Pastaj, një tjetër gjë që më mundon janë akuzat e disa partive politike se Lëvizja VETËNDESOJE nuk ka program. Shqiptarët bënë tri luftëra për të drejtën e vetëvendosjes dhe pikërisht ai është programi shqiptar. Nëse duan partitë politike, ne e kemi programin kombëtar, e kemi programin e Lidhjes së Prizrenit. Nëse nuk duam ***lëvizje për vetëvendosje*** atëherë e kapim programin e Lidhjes së Prizrenit. Ata vetëm qesin petulla në ujë. Mundohen të gjejnë vetëm një gabim të vogël të Lëvizjes dhe pastaj të rrahin daullet. Unë e përkrah Lëvizjen VETËVENDOSJE sepse vërtet është lëvizje

qytetare, lëvizje demokratike, lëvizje e cila lufton me argumente, lëvizje qe del me trupin e vet dhe nuk përdor dhunë. Për gjithë këtë tollovi përgjegjësinë e marrin partitë politike. Zëdhënës i popullit realisht është vetëm Lëvizja VETËVENDOSJE. Vetëm ajo e mbron interesin e popullit, sakrifikon trupin e vet në mënyrë që të bëjë diçka në të mirën e popullit.

Fund

NË DANIMARKËN DEMOKRATIKE KEMI PASUR MUNDËSI TË MËDHA, POR ATO NUK I SHFRYTËZUAM

Intervistë me gazetarin Luigj Shkodrani, 07 -12-2007

Luigj Shkodrani: Kush është Xhemil Zeqiri? Nga je, çfarë arsimimi ke dhe si autor librash që je, sa libra ke botuar?

Xhemil Zeqiri: Jam i lindur në katundin Zhelinë, nga rrethi i Tetovës. Kam mbaruar shkollën e mesme teknike në Gostivar, pastaj u regjistrova në Fakultetin Filozofik - Dega e historisë në Prishtinë në vitin 1980, por pas një viti, siç dihet, ndodhën demonstratat e pranverës së madhe të vitit 1981. Në katund, aty ku jetoja, kisha provokime nga policia maqedonase: thirrje në biseda informative, maltretime etj., nga një stacion policor në fshatin Grupçin, që në atë kohë ishte një stacion terrorizues për shqiptarët në anën e Dervenit. Prandaj u detyrova të emigroj së pari në Zvicër, pastaj në Gjermani. Që andej, disa muaj më vonë erdha në Danimarkë, ku u vendosa me punë. Prej atëherë, përkatësisht nga janari i vitit 1981, me përkushtim jam munduar të veproj për çështjen e pazgjidhur kombëtare. Tanimë po bëhen 27 vite, pra mbi gjysmën e jetës sime e kalova në Danimarkë.

Luigj Shkodrani: Me çfarë pune merreni në Danimarkë? Diçka për fillimet tua në emigracion? Çfarë mendimi keni për punën e shoqatave shqiptare në Danimarkë?

Xhemil Zeqiri: Po, si e mora leje-qëndrimin në Danimarkë, në fillim kam punuar lloj-lloj punësh fizike, sepse diploma ime nuk ishte edhe aq me vlerë këtu. Isha pa përvojë. Këtu në Perëndim më tepër u intereson puna praktike dhe jo ajo teorike. Pra, nuk isha i kualifikuar për këtu. Pastaj u bëra ngasës i autobusit urban dhe isha mirë, por më pengonte shumë për aktivitetet që pata filluar në

Danimarkë, sepse orari i punës nuk më përshtatej dot. Kur aktivitetet filluan të shtohen, i fillova edhe kontaktet me gazetarë, me partitë politike, me shoqatat që merreshin me çështjet ndërkombëtare, me deputetë etj. Prandaj u detyrova ta ndërpres këtë punë dhe fillova të punoj si taksist. Me këtë angazhim të ri, isha më i lirë dhe kisha njëfarë pavarësie në punë, i mbaja kontaktet më me rregull dhe prej atëherë vazhdoj punën si taksist.

Sa i përket pyetjes Suaj lidhur me shoqatat shqiptare, mund t'ju them, si vijon: Në fillim në Kopenhagë nuk kishte shoqatë shqiptare, por ishte një klub që quhej Jugo-Klub. Aty tuboheshin shqiptarët. Në të, kishte ndikim të madh ambasada serbo-jugosllave dhe me siguri shqiptarëve u kujtohet se nga ky klub u dënuan edhe demonstratat e mëdha të viti 1981 në Kosovë. Më vonë filluam të veprojmë disa shokë që të formohet një shoqatë shqiptare që do të zhvillonte veprimtari kulturore dhe që do t´i mbronte interesat shqiptare. Unë isha aktiv në këtë shoqatë, jo vetëm me praninë time, por pata dhënë 15.000 korona daneze. E dija se nuk ka mundësi të punohet për çështjen kombëtare, pa pasur mjete në dorë për të formuar një shoqatë. Dhe në fakt unë e dhurova atë shumë parash, vetëm e vetëm që të fillojmë një punë të mbarë.

Pastaj fillova të merrem edhe me shkrime, kryesisht me publicistikë. Organizoja debate, u drejtoja letra të hapura institucioneve daneze, institucioneve evropiane dhe atyre të OKB-së. Disa herë i kam dërguar artikuj edhe shtypit të vendit, për problemet politike që ishin aktuale për kohën. Natyrisht, unë doja që të mos dilja me emër. Disa nga mesi ynë, për të gjitha këto aktivitete thoshin: Ai na qenka "i madhi". Kur e pashë se kjo metodë ishte shumë e rrezikshme dhe do t´i kishte pasojat e veta si dhe dëshpërimin e disa shokëve që e dinin se kush vepron, atëherë dola me emër dhe mbiemër.

Më vonë ato shkrime dhe intervista do t'i botoj vetëm e vetëm sa të dinë, sepse kishte matrapazë të tillë që mundoheshin të më pengonin në aktivitetin tim. Por ata e panë se nuk kanë mundësi të më pengojnë, as donin të rreshtohen në radhët tona, aq më pak të

jenë në radhët e para. Për t'i sprapsur përpjekjet e tyre të errëta që kishin për qëllim të parandalojnë veprimtarinë time atdhetare, unë u detyrova të dal hapur me shkrime dhe me tre libra të botuar.

Librin e parë me titull *"Kosova jonë"*, Tiranë, 2000. Librin e dytë *"Në mbrojtje (diplomatike) të çështjes shqiptare",* Prishtinë, 2005. Librin e tretë *"Polemika, intervista, debate dhe letra",* Prishtinë, (?)

Natyrisht, ende vazhdoj të merrem me veprimtari atdhetare dhe tani së shpejti do të botojmë një libër të përbashkët me tre autorë: Unë, Mona Agrigoroaei nga Rumania dhe Fadil Shyti nga Suedia, me titull *"Drejt vetëvendosjes".*

Meqenëse Fadil Shyti dhe unë i kemi disa shkrime të përbashkëta në të cilat është shtjelluar çështja e pazgjidhur shqiptare, ca më vonë ato do t´i botojmë në një libër. Pastaj ka mundësi reale që ta botoj edhe një libër tjetër me ***intervista*** pasi materialet i kam gati. Për të, unë kam dhënë disa herë intervista në radion dhe televizionin shtetëror danez, por edhe në të gjitha gazetat daneze, për ngjarjet që zhvilloheshin këto 20 vitet e fundit në trojet shqiptare.

Luigj Shkodrani: Cili është mendimi Juaj për politikën e sotme në Kosovë?

Xhemil Zeqiri: Po si të them, mjerim. Politika shqiptare, prej kur doli në skenë LDK-ja ose më mirë të themi LKK-ja, pra Lidhja Komuniste e Kosovës, ndoqi një politikë reaksionare përballë kërkesave kombëtare. Me një mjeshtri të madhe e mashtruanpopullin që me dekada kishte rezistuar dhe pikërisht në momentin kur u dashtë të jepen rezultatet, dolën këta bashibozukë, ish-aktivistë të UDB-së dhe e krijuan këtë parti që ta kenë nën kontroll gjithë popullin. Nëse ju kujtohet, në fillim jepnin premtime të mëdha. Thoshin: Enver Hoxha krijoi armiq, kurse ne do ta bëjmë bashkimin kombëtar, pa luftë dhe pa gjakderdhje. Ky mashtrim dalëngadalë erdhi te prapakthimi i madh dhe sot e pranuan Pakon e Ahtisarit.

Dikush mund të thotë se Ibrahim Rugova ka qenë i mirë etj. Por kjo politikë që po udhëhiqet, është pikërisht ajo politikë reaksionare e Ibrahim Rugovës. Këtë politikë e ndjekin dhe një lojë të tillë e kanë pranuar, jo vetëm krahu pacifist, por për fat të keq edhe ata që dolën nga lufta!

Luigj Shkodrani: Deshëm të dinim diçka mbi mendimi Tuaj për pavarësinë e Kosovës. Ku është arsyeja, sipas mendimit Tuaj, që ky proces vetëm po zgjatet pak si pa kuptim?

Xhemil Zeqiri: Pas asaj rezistence të madhe nga bijtë dhe bijat më të mirë të Kosovës, të radhitur në famëmadhen Ushtri Çlirimtare të Kosovës (UÇK), komuniteti ndërkombëtar filloi me intrigat e veta, e pikërisht me Konferencën "paqësore" në Rambuje, që kishte për qëllim "stabilizimin" e Ballkanit. Këtu vlen të theksojmë se kjo ishte një konferencë tejet kundërshqiptare dhe shumë proserbe, edhe pse pala serbe nuk e nënshkroi. Siç dihet, komuniteti ndërkombëtar bëri presione të mëdha dhe në fund intervenoi ushtarakisht. Në atë kohë, unë ndoshta isha i vetmi që dola kundër intervenimit, sepse nuk dëshiroja që t´i shtohen tragjeditë popullit shqiptar dhe në fakt koha më dha të drejtë. Madje edhe sot, bashkësia ndërkombëtare, që tani quhet UNMIK, në Kosovën hallemadhe luan një rol tejet kundërshqiptar. Për këto çështje kam shkruar mjaft dhe i kam shtjelluar me kohë në analizat e mia, por tani dua të theksoj faktin se ishin politikanët servilë, ata që lëshonin pe para miqve të vërtetë të serbëve, e që ishin maskuar nën uniformën e UNMIK-ut. Kujtojmë Kornizën kushtetuese te njohja e një kolaboracionisti si kryetar të Kosovës - Ibrahim Rugovën. Pastaj këta e njohën lojën e ndyrë të Serbisë, gjegjësisht të UNMIK-ut, ngase konstatuan padrejtësisht se "në vitin 1999 nuk ka pasur luftë, por konflikt". Pastaj u bënë edhe shumë lëshime të tjera në emër të pavarësisë. Pra, këta politikanë dritëshkurtër që u rreshtuan në politikë pas viti 1999, menduan se tani u realizuan aspiratat e tyre dhe fjetën mbi dafine. Serbia ndërkaq, vepronte tinëz, por ishte tejet aktive edhe

haptazi. Deri më sot, asnjë dokument ndërkombëtar me peshë për të ardhmen tonë, nuk është në favor tonin.

Me një fjalë, Konferenca famëkeqe e Rambujesë-Parisit, Marrëveshja teknike ushtarake në Kumanovë në të cilën shqiptaret nuk morën pjesë, sepse politikisht u defaktorizuan, pastaj Rezoluta famëkeqe 1244 që e njeh Kosovën nën sovranitetin e Serbisë, po as pakoja e Marti Ahtisarit, nuk janë në favorin tonë. Janë politikanët e korruptuar, ata të cilët, për privilegje të caktuara, i miratuan ato. Por, pasojat do të jenë të mëdha në një të ardhme të afërt.

Lëvizja Vetëvendosje i ka përgënjeshtruar me kohë këto politika tejet reaksionare ndaj shqiptarëve. Këtu dua të theksoj se me daljen në skenë të kësaj ***lëvizjeje***, menjëherë i jam bashkëngjitur dhe jam anëtar aktiv i saj.

Nga viti 1981, kam qenë anëtar i Lëvizjes Popullore të Kosovës (LPK). Pastaj një kohë të gjatë kam qenë edhe anëtar i ***Këshillit për liritë dhe të drejtat*** në Kosovë.

Dua të theksoj këtu se Pakoja e Ahtisarit nuk e njeh pavarësinë që e meritojmë, por ky do jetë një status si ai i Grënlandës ose i Feurnit, që janë koloni daneze e që kanë nga 40.000 banorë. Edhe pse janë mbi 6000 km larg Danimarkës, megjithatë janë koloni të saj. I njëjti fat na pret edhe neve shqiptarëve me këtë politikë që po ndiqet nga ky grup negociatorësh, me ndërkombëtarë të tipit të Ahtisarit dhe të treshes. Serbia gjenocidale e ka futur Kosovën në kushtetutën e vet dhe kjo do ketë pasoja të mëdha në të ardhmen e afërt. Ashtu siç nuk ishin largpamës në Konferencën e Rambujesë dhe me Rezolutën famëkeqe 1244, po kështu do të kemi telashe të mëdha pas disa viteve, sepse krahu pansllavist çdo ditë po vjen duke u forcuar dhe duke u bërë faktor vendimmarrës në politikën ndërkombëtare.

Luigj Shkodrani: Çfarë mendimi keni për radiot shqipe që ato ta kryejnë më mirë funksionin e vet në ndihmë të bashkatdhetarëve që jetojnë dhe që punojnë në këtë vend skandinav?

Xhemil Zeqiri: Tani në Danimarkë ka shumë radio lokale dhe mjete të informimit, megjithëse nuk janë në nivel. Dikur ***"Radio Zëri i Kosovës"*** ishte e para radio në Skandinavi dhe me shumë programe të mrekullueshme. Më vonë ato e zbehën veprimtarinë e tyre. Në Danimarkën demokratike kemi pasur mundësi të mëdha, por ato nuk i shfrytëzuam dhe ende nuk jemi duke i shfrytëzuar mundësit që na i ofrojnë. Në fillim ishte vështirë kur e hapëm radion e parë në Skandinavi dhe në Evropë. Më vonë, programi Radio Zëri i Kosovës me të vërtetë u bë zëri i Kosovës. Para dhe gjatë luftës çlirimtare ka luajtur një rol shumë të madh informimi, jo vetëm te punëtorët shqiptarë, por edhe më gjerë. Të kujtojmë ngjarjen ose aferën e Ministrisë së Jashtme daneze për rastin Panteliç. Ishte një avokat serb, anëtar i partisë së Arkanit dhe ishte verifikues në Ministrinë e Jashtme daneze për ata që kërkonin strehim politik. Shumë intervista në atë kohë ai i ka keqinterpretuar. Radio "Zëri i Kosovës" ka një bagazh të madh informativ dhe sot e kësaj dite ka një zë të mirë, jo vetëm te shqiptarët e Shqipërisë etnike, por edhe më gjerë. Kudo në botë dëgjohet: Radio-Televizioni Zëri i Kosovës. Ka edhe disa radio të internetit.

Është një radio që quhet Projekti 21, e cila u hap në momentin kur filloi lufta në Maqedoni dhe luajti një rol tejet dezinformues aty. Dikur ishin enveristë e tani kinse në demokraci, janë bërë diçka saqë as vetë nuk e dinë çka janë. E kam dëgjuar disa herë një analist. Quhej Haxhi Eshref Eshrefi. Për fat të zi të tij, më vonë u zu me drogë, bile gazeta *Urban* e shkroi një artikull se u zu banda shqiptaro-serbe. Për habi të të gjithëve, këtë e patën zgjedhur si koordinator të Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare. Se ç´kombëtar ishte ai me shokë, e tregoi puna e tyre gjatë dhe pas luftës, ku rol kryesor ka pasur edhe Abdilhalim Kasami - turkoshak dhe agjent i ambasadës serbo-maqedonase. Nuk do të doja të flas më tepër për këta aktivistë që i bënë dëm të madh kauzës, duke iu imponuar Shtabit të Përgjithshëm, se këta kanë kontakte dhe lidhje të mëdha me politikanët danezë dhe evropianë. Vetëm dua të theksoj sesi mashtroheshin njerëzit gjithandej, e sidomos nëpër ODA, ata që kishin besim te ky turkoshak. Më thotë një bashkëpunëtor i tij se Kasami ka lidhje të

mëdha, bile mbrëmë na tha se "sipas informatave që paska ai, NATO-ja po biseduaka dhe se gjasat qenkan që UÇK-në ta njohë si ushtri legjitime në Maqedoni." Paramendoje se me çfarë mashtrimesh i mbante rreth vetes disa kokëshkretë!

I revoltuar, ai u shpreh me një fjalor vulgar dhe shtoi: "Ai nuk është budalla. Në Ohër janë duke e nënshkruar Marrëveshjen e Ohrit. Atje partitë politike PDSH dhe PPD i tradhtuan shqiptarët". Me këso pallavra i mashtronte ky turkoshak njerëzit naivë, siç e mashtroi edhe Shtabin e përgjithshëm të UÇK-së.

Atje Ali Ahmeti e ka pranuar këtë marrëveshje që do jetë tejet kundërshqiptare. Përse këto gjëra i di unë dhe nuk i di ish-zëdhënësi politik, të cilin e emëruan ata të shtabit! Për çudi, s'e kuptova fjalinë. Pra, duke parë qëndrimin tim, këta kishin bërë plane edhe të më vrisnin, bile si tradhtar. Për këto qëndrime të mia, këta "patriotë" më sulmuan edhe fizikisht në një lokal shqiptar, duke thënë se u tradhtua lufta, u shkel mbi gjakun e dëshmorëve etj. Më sulmuan fizikisht, saqë u sëmura dhe nuk munda të rri në këmbë për ditë të tëra, sepse isha bërë operacion.

Pra, ja se kush janë këta të radios "kombëtare dhe demokratike" Projekti 21. Vetëm doja të shtoja se tani mbarë opinioni e di se mua të gjitha radiot më kanë marrë intervista dhe i kanë lexuar shkrimet e mia, si ato shqiptare ashtu edhe këto daneze. Qëndrimet e mia politike janë të qarta dhe nuk kam përse të ndryshoj mendimin. Do të isha i lumtur që analizat e mia të mos dilnin të sakta. Përkundrazi, ata që shkuan atje të marrin poste në pushtet pa shtet, erdhën si mos më keq. Bile njëri erdhi, ai i madhi, t´ia heqë plumbat që ia dhanë si peshqesh në oborrin e vet. Flitet se e ka shitur, si të ketë qenë tregtar Anadolli, lojën e futbollit.

Luigj Shkodrani: Cili është mendimi Juaj për politikën e sotme në Shqipëri?

Xhemil Zeqiri: Si të them, mjerim politik, tragjedi! Tani Sali Berisha dhe partia e tij, pasi e "stabilizuan" shtetin dhe e sollën pak a shumë në binarë, bota demokratike me vota "demokratike" e pruri përsëri Sali Berishën në pushtet. Gjatë fushatës elektorale, ai pati

premtuar se do t´i përmirësojë gabimet e veta, por JO, JO. Ai mjeran po vazhdon me të njëjtin avaz, si dikur kur ishte në pushtet dhe tani e vuri edhe Prokurorinë nën kontroll të partizanëve të Partisë Demokratike. Prandaj mjerimi dhe tragjedia do të vazhdojnë përderisa ky njeri prapë do ta "udhëheqë" Shqipërinë.

Te Ibrahim Rugova dhe te Sali Berisha, fjala demokraci është kuptuar si kapitalizëm dhe se atyre aspak nuk u ka interesuar të zgjidhet çështja kombëtare. Këta dy "kryeheronj" të "demokracisë" më të çuditshme në botë nuk kanë zgjedhur mënyra dhe mjete sesi të pasurohen dhe të mbeten me çdo kusht në pushtet. Mirë, Shqipëria londineze, megjithatë e kishte shtetin, po Ibrahim Rugova ç´dreq pushteti pati, kur gjatë luftës shkoi në Beograd, ku, duke u zgërdhirë, e nënshkroi atë deklaratën e famshme për t'u ndalur bombardimet e NATO-së, sepse po vuajtka populli serb. Hajde të besojmë se u kidnapua nga Millosheviqi, po përse qeshte or vëlla. Po edhe shkuarja e tij në Itali dhe në Gjermani, ku kërkoi azil politik, e që nuk i dhanë… Pastaj përsëri kthimi në Itali. Kjo tregon se ai luajti një rol si të ketë qenë vërtet marionetë e të huajve. Apo më saktë veproi si me qenë ministër i jashtëm serb.

Kjo politikë u kritikua atëbotë nga shumë politikanë evro-atlantikë. Me futjen e UNMIKUT në Kosovë, me mbarimin e luftës, me vota "demokratike" dhe me presionin e ndërhyrjen e Hans Hekerupit, që me çdo kusht ai të jetë kryetar i Kosovës, përsëri u bë kryetar, sepse ashtu donin serbet. Ramush Haradinaj dhe Hashim Thaçi njëherë nuk pranuan **dhe ia përmendën se e ka nënshkruar atë marrëveshjen kundërshqiptare në Paris - Rambuje.**

Po ja tani edhe një politikë shumë e ashpër kundërshqiptare nga UNMIK-u, gjegjësisht nga Serbia. Paramendojeni se ç´taktikë kanë përdorur. Thoshin se Kosova nuk do jetë si para vitit 1999, Kosova nuk do të ndahet dhe nuk do të bashkohet me ndonjë shtet fqinj! Politikanët "tanë" kënaqeshin me këto premtime boshe. Pra kjo do të thotë se Kosova nuk do jetë ajo së cilës ia mori Serbia të gjitha të drejtat, por do të ketë një autonomi substanciale sipas Marrëveshjes së Rambujesë. Sot e kësaj dite politikanët "tanë" - Rugova, Thaçi,

Çeku e të tjerë, nuk distancohen nga ajo Marrëveshje e Rambujesë. Edhe në arritjen e Marrëveshjes tekniko-ushtarake në Kumanovë, këta "tanët nuk ishin të pranishëm, sepse u defaktorizuan në Rambuje. Shqiptarët nuk i pyeste kush më. Famëkeqe është edhe Rezoluta 1244 e OKB-së. Po Korniza kushtetuese, zgjedhjet me lista të mbyllura, po parlamenti kukull, siç e quan me të drejtë Demaçi ynë i madh, që e pranoi pa pikë rezistence se lufta në Kosovë nuk paska qenë luftë, por konflikt!

Skandali më i madh i të gjitha skandaleve politike është pranimi i Pakos së Ahtisarit që krijon me ligje e nene të zeza, të ashtuquajturin "komb kosovar". Sipas terminologjisë sllave, Kosovë do të thotë zog i zi. Me fjalë të tjera,u anashkalua emri i lashtë dhe i bukur Dardani. Po ndryshimi i flamurit, i himnit dhe i simboleve të tjera etj., a nuk paraqesin të gjitha këto kthim prapa në historinë tonë të re?!

Këtu nuk i demantuam të gjitha. Këto që i përmendëm më lartë, asnjë veprim pozitiv realist nuk patën. Ishte madhështore kur ish-veteranët e luftës të UÇK-së i mblodhën flamujt e ëndrrave të mbrapshta të Ibrahim Rugovës dhe i dogjën para hundës së atij satrapi dinak antikombëtar, i cili shkoi në botën e amshuar duke protestuar ndaj djegies së "flamurit" të tij me histori turpesh.

Luigj Shkodrani: Cili është mendimi Juaj për politikën e sotme në Shqipërinë zyrtare?

Xhemil Zeqiri: Mendoj se u përgjigja më lartë. Elif be, të gjithë një fe!

Dhe ajo "fe" është antikombëtarizmi i tyre! Pra, në territoret etnike shqiptare, pas shkatërrimit të sistemit socialist, erdhën në pushtet të gjitha grupet më reaksionare dhe më antikombëtare. Atyre në Shqipëri u ndihmuan tërthorazi serbët dhe titistët "shqiptarë" të Kosovës dhe qarqet reaksionare ndërkombëtare. Këtu vlen të theksojmë se për Sali Berishën kanë simpati të madhe miqtë e serbëve dhe armiqtë tanë, sepse ky, për ta stabilizuar Ballkanin, e

destabilizoi Shqipërinë dhe e dëmtoi rëndë çështjen kombëtare. Pra Kjo strategji errësire e tyre qe dhe mbeti plotësisht në kundërshtim me amanetin e Sulejman Vokshit dhe të Abdyl Frashrit, se pa zgjidhjen e drejtë të çështjes shqiptare nuk do ketë paqe dhe qetësi as Ballkani e as Evropa. Mu për këtë arsye ndërkombëtarët e përkrahin këtë politikë toptaniste të Sali Berishës dhe të bandave të tij. Nuk ka dyshim se kjo politikë është plotësisht në kundërshti me vullnetin politik të shqiptarëve në tërë Shqipërinë natyrale.

Luigj Shkodrani: Deshëm të dinim diçka mbi mendimi Tuaj për pavarësinë e Kosovës. Ku është arsyeja, sipas mendimit Tuaj, që ky proces po zgjatet pak si pa kuptim?

Xhemil Zeqiri: Realiteti është i hidhur, dialogu do të zgjatet pa kufi me këtë grup negociator, të gjitha vendimet në dokumentet ndërkombëtare janë në favorin e Serbisë, ndërsa politikanët "tanë" kanë pranuar një lojë të rrezikshme në disfavorin tonë,që nga Konferenca e Rambujesë deri te vendimet e tjera që i përmendëm më lart. Serbia duke i pasur të gjitha "tapitë" e Kosovës, si dokumentin e Rambujesë dhe Rezolutën famëkeqe 1244 të OKB-së, e të tjera, nuk e pranon dot pavarësinë e Kosovës. Mikja e saj - Rusia po ngre veto në Këshillin e Sigurimit të OKB-së. Për këtë grup negociator, Kuvendi i Kosovës votoi kundër që Kosova të hyjë në dialog për statusin e saj. Por, nëse na kujtohet, akademik Nexhat Daci dhe "rahmetliu" Ibrahim Rugova, nuk e përfillën as vullnetin e popullit, pra as vullnetin e institucionit, siç është Kuvendi. Ata shkuan në Vjenë dhe e faktorizuan Serbinë dhe Rusinë aq shumë saqë këta xhambazë politikë nuk duan ta pranojnë dhe vazhdojnë ta mashtrojnë popullin duke e pasur në shërbim TV-në, radiot, UNMIK-un që edhe më tej i shërben Serbisë, me ato qarqe ndërkombëtare "mike."

Por, të theksojmë faktin se të gjitha këto manipulime popullit ia bëri me dije Lëvizja Vetëvendosje duke e njohur shumë mirë rolin e toptanëve të shekullit 21, që e quajnë veten "Grupi i unitetit". Tani siç thotë populli: "lakrorit iu hoq peta". Në zgjedhjet e 17 nëntorit u pa qartë se sa legjitimë janë këta plëngprishës të atdheut. Këta u

dënuan me injorim, u dënuan me bojkotim. U dënuan keq, ashtu siç e meritojnë, këta politikanë të pandërgjegjshëm, të pamoralshëm dhe tejet të korruptuar. Kujtojmë vetëm një fakt: Sa milionë euro i ka harxhuar Hashim Thaçi për fushatën elektorale, ndërsa shokët e tij dhe fëmijët e dëshmorëve janë pa kulm mbi kokë dhe shpesh u mungon edhe kafshata e gojës. Këto ditë më njoftoi një shok i cili punon në një restorant në Berlin, se Sejdiu, Çeku dhe disa të tjerë kanë darkuar dhe kanë pirë me një kosto të lartë, hiç më pak se 1000 euro. Pra, kjo qeveri u pasurua tej mase, duke marrë honorarë për këto bisedime të poshtra me serbët. Natyrisht, të gjitha këto prapësi i paguan gjithmonë populli i varfër dhe kurrë jo ata të grupit të ahtisarëve. Shiko se ç´kapital marramendës kanë bërë, ndërsa akademik Rexhep Qosja nuk e merr dot një pension të mjaftueshëm. Bile të ketë mundësi të botojë një libër, e të mos flasim për simbolin e rezistencës sonë kombëtare, Adem Demaçin. Pensioni që ia jep kjo qeveri nuk i del madje një palë rroba të blejë apo një litër verë të pijë në muaj. Ky hero i gjallë, i cili tërë jetën veproi për çështjen kombëtare, tani po mohohet, po fyhet dhe dënohet nga ata që i marrin "votat demokratike", ndërsa shërbëtorët e Serbisë - të sojit të Veton Surroit e të tjerë si ai - po majmen paturpësisht me djersën e popullit.

Por si duket, kohët e fundit populli ka filluar të ndërgjegjësohet. Kjo natyrisht se jep shpresa për kënaqësi, kur e shohim se në zgjedhjet e fundit dolën vetëm 37%. Te kjo ka ndikuar fuqishëm edhe fakti se Lëvizja Vetëvendosje dhe forca të tjera politike si dhe shumë analistë përparimtarë, njerëz të dëshmuar, kanë bërë fushatë të mrekullueshme kundër daljes në ato zgjedhje mashtruese.

Mirëpo, edhe tani si herë të tjera, RTK-ja e Agim Zatriqit, titistit me damkë dhe e kompanisë së tij pro-serbe, bëri një fushatë të ethshme pro tyre, duke propaganduar se këto nuk janë zgjedhje, por janë referendum për pavarësinë e Kosovës e të tjera gjepura politik. Nga kjo mund të konstatojmë se populli vlerëson ngadalë, por sigurt! Populli nuk mashtrohet përjetësisht! Ky është haraçi i pritjes së "pavarësisë", ky është mashtrimi politik i pritjes

pambarim. Për më tepër, neve aspak nuk na duhet kjo pavarësi e kushtëzuar, e mbirë në Rambuje, ndërsa e korrur në Vjenë!

Kosovën me këtë lloj pavarësie do ta kemi pa sovranitet, kur në vendin tonë do të na sundojnë të huajt. Neve na duhet një pavarësi e plotë, ashtu siç e kanë vendet fqinje dhe për një pavarësi të tillë kemi luftuar. Kujtoj këtu një deklaratë të zëvendëssekretarit amerikan të Jashtëm, kur tha: "Ose ka pavarësi, ose nuk ka". Ndaj po e ritheksoj se neve nuk na duhet pavarësi me kushte, me bishta etj.

Luigj Shkodrani: Cili është mendimi Juaj për situatën në Maqedoni dhe si ndikojnë këto ngjarjet e fundit në zgjidhjen e statusit të Kosovës?

Xhemil Zeqiri: Situata që po kalojnë shqiptaret në Maqedoni është produkt i politikës që folëm më lartë. E them pa ndonjë rezervë se partitë "shqiptare" që lindën në territoret e ish-Jugosllavisë u krijuan nga strukturat sllave, siç ishte Lidhja e Komunistëve e Serbisë, e Kosovës, e Maqedonisë dhe e Malit të Zi. Këto parti u krijuan si aleate të partive reaksionare në Shqipëri. Këto parti, me përjashtim të Partisë për Bashkim Demokratik të udhëhequr nga Mr. Bardhyl Mahmuti, d.m.th. partitë e paraluftës, u krijuan nga ish-titistët dhe nga disa ballistë të mjerë që ishin ende gjallë. Ndërsa partitë e dala nga lufta u krijuan me ndihmën e Solanës dhe solanë-sulltanëve të tjerë proserbë. Dashtë zoti të mos jetë kështu, por fatkeqësisht kjo po vërtetohet në shumë dimensione jetësore.

Lufta e vitit 2001 në Maqedoni, siç dihet, u tradhtua nga Ali Ahmeti, nga Musa Xhaferi dhe nga drejtori politik, ekonomik dhe kadrovik, bashkëpunëtori i zellshëm i tyre - Abdilhalim Kasami, i cili pohonte me intriga se ka kontakte të caktuara me ndërkombëtarët dhe me politikanët danezë. Me fjalë të tjera, atje pas lufte filloi një diferencim i madh i tipit jugosllav, jo vetëm duke i larguar njerëzit nga puna, por edhe duke i vrarë aktivistët atdhetarë, të gjithë ata që nuk pajtoheshin me atë Marrëveshjen famëkeqe të Ohrit. Shumë ish-luftëtarë u izoluan, u burgosën etj.

Shumë pjesëtarë të ish Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare, qe 7 vjet jetojnë në ilegalitet dhe sipas shtypit, ata tani kanë dalë sheshit me rastin e luftimeve në Brodec. Kur u sulmuan, atje pati një rezistencë të madhe dhe pasojat janë shumë të mëdha. Sipas dëshmitarëve, thuhet se ka 10 policë të vrarë, 2 helikopterë të rrëzuar, 6 automjete lufte janë djegur. Më në fund, tërë këtë luftë më së shtrenjti e pagoi popullata civile. Shtëpitë e fshatarëve u granatuan në mënyrë mizore. Më pas pasuan arrestimet e banorëve të pafajshëm. Për këtë ka pasur një raport edhe Amnasti International, në të cilën dënohet dhuna ndaj banorëve të pafajshëm. Por edhe sikur të jenë kriminelë, siç deklarojnë qeveritarët maqedonas, si kanë mundur të bombardojnë me aq barbari, duke paguar edhe mercenarë ruso-serbë.

Pra, partitë shqiptare që ishin në koalicion gjatë luftës së 2001-shit – e sidomos PDSH-ja, dhe tani po hakmerret përsëri, kur të kemi parasysh se vetëm tre muaj para konfliktit të 2001-shit, nga ministria maqedonase u tha publikisht se Maqedonia është shembulli më i mirë i njohjes së të drejtave të minoriteteve. Përsëri para disa muajve ministri maqedonas pati deklaruar në një gazetë angleze se *"Maqedonia është shtet shembullor, model sesi zgjidhen problemet me minoritetin etj."* Por ja Brodeci e tregoi fytyrën e vërtetë të okupatorëve sllavë ndaj shqiptarëve. Kjo aspak nuk më habit. Më habit qëndrimi i PDSH-së dhe i deputetëve shqiptarë. Përse luftuan shqiptaret!? Për të vazhduar të jenë vetëm shërbëtorë të sllavëve apo...?!

Përse luftuan shqiptarët, më së miri dhe me një mal argumentesh, e ka elaboruar shumë mirë intelektuali i madh kombëtar - Beqir Berisha në veprën e tij të famshme: "Përse luftuan shqiptarët" si dhe në shkrimin e tij të ngritur mbi fakte, me titull "Letër e hapur ndërkombëtarëve".

Luigj Shkodrani: Çfarë mendimi keni ju për AKSH-në?

Xhemil Zeqiri: Tani po bëhet një kohë e gjatë që po lexojmë dhe shohim ushtarë me uniforma. Madje thuhet se komandant

"Drenica" - Xhavit Morina, paska qenë pjesëtar i AKSH-së. Ky luftëtar i lirisë u vra me pabesi nga veglat qorre të qeverisë maqedonase. Fare nuk ka rëndësi në ishin ekzekutuesit shqiptarë, maqedonas apo serbë. Është i tmerrshëm fakti se ai u vra me pabesi. Akoma nuk kam dëgjuar ndonjë prononcim publik për vrasjen e tij. Me tepër nuk di, por pritet të shohim se sa janë të vendosur këta djem e vasha ta mbrojnë popullin. Unë mendoj se as AKSH-ja dhe asnjë ushtri deri sot, nuk ka mundur dhe as që mund të bëjë diçka, pa përkrahjen e popullit.

Këto ditë dëgjova në televizion një deklaratë të një mësuesi në fshatin Shipkovicë, i cili bërtiste dhe kërkonte ndihmë prej AKSH-së, kurse gjoksin e vet e kishte të mbushur me ar! Të kujtojmë këtu fjalën e urtë popullore: *"Si të kruan dora jote, nuk të kruan dora e huaj"!* Tani e sa vite po jetojmë në situata tejet të ndërlikuara, prandaj si kurdoherë më parë, duhet çdo ditë e më tepër ta rrisim solidaritetin tonë, ashtu siç e kishim ne shqiptarët dikur.

Luigj Shkodrani: Kohët të fundit po flitet shumë për bashkim të trojeve shqiptare. Cili është mendimi Juaj në këtë drejtim?

Xhemil Zeqiri: Tani ekziston një thënie gjeniale nga populli shqiptar në jug që thotë: *"Nga e thëna në të bërë, është një det i tërë"*. Popullit nëse i jepet fjala, ai ashtë i plotfuqishëm dhe unë jam ithtar i një referendumi. Nuk jam militarist, por i kam përkrahur ushtritë çlirimtare, sepse vetëm ato e sollën çështjen e pazgjidhur shqiptare në tryezat e ndërkombëtarëve dhe jo LDK-ja e Ibrahim Rugovës, që shkeli mbi referendumin dhe shpalljen e pavarësisë dhe tani e 17 vjet po bëjnë dialog me Serbinë se sa të drejta do të na japë ajo!!

Pra, këta titistë dhe ballistë që dolën në skenë pas vitit 1989, shkelën pa mëshirë mbi Marrëveshjen e Bujanit legjendar. Bënë dhe punë të tjera të këqija - njohën Maqedoninë si shtet dhe Malin e Zi. Duke vepruar kësisoj, ata bënë tradhti kombëtare. Për t'i mbuluar tradhtitë, herë-herë ata hedhin si lecka në erë edhe teza kinse janë për bashkim kombëtar.

Tani pyes: Si do të bëhet bashkimi kombëtar me zëdhënësin e Grupit të unitetit që flet jerm, apo me Veton Surroin dhe kompaninë e tij titiste. Në fakt, këta ishin dhe janë pengesa kryesore e realizimit të ribashkimit kombëtar. Për këto pengesa që na i bëjnë e kishin dhe e kanë përkrahjen pa rezervë të Serbisë dhe të miqve të saj kudo nëpër botë.

***Luigj Shkodrani*:** A jeni human?

Xhemil Zeqiri: Po, gjatë tërë jetës sime. Që kur kam ardhur në Danimarkë, por edhe më parë, humanizmin e kam pasur në shpirt. Jam munduar me mish e me shpirt t'i ndihmoj në çdo aspekt njerëzit që ishin vënë në shërbim të çështjes kombëtare. Për këtë, nuk më takon mua të flas. Unë veproj pa pasur asnjë interes. Të gjitha aktivitetet që i kam bërë, i kam kryer me djersën time. I kam ndihmuar çdo individi apo organizate që ka pasur nevojë.

Luigj Shkodrani: Cila është dëshira Juaj të cilën nuk keni mundur ta realizoni?

Xhemil Zeqiri: Dëshira ime ka qenë dhe është që ta bëjmë Shqipërinë natyrore, ashtu siç na e ka dhuruar Zoti. Parullat: pavarësi me pako ahtisariane ose Shqipëria e madhe, janë parulla shumë reaksionare, tani kur nuk ekziston Jugosllavia që e krijuan fuqitë e mëdha.

Luigj Shkodrani: A bëheni nervoz shpesh dhe pse?

Xhemil Zeqiri: Bëhem, e si mos të bëhem, kur dalin Azem Vllasët në RTK dhe na mbajnë ligjërata politike për demokracinë! Apo kur Veton Surroi e bën këtë mishmash politik, kur të gjithë e dinë mirë se gjatë gjithë jetës, jatak e kishin Serbinë. Po si të mos bëhesh or vëlla nervoz, kur e sheh në RTV tipin e Naim Malokut kundër Lëvizjes Vetëvendosje, një ish-oficer i armatës sllave me ato pikat dhe kur i tha Visarit, djaloshit trim të LV: "mos llomotit". Ec e mos u bëj nervoz nga këto fëlliqësira titiste!

Po si të mos bëhesh nervoz, kur e sheh Refet Elmazin duke e masakruar popullin shqiptar në malësinë e Sharrit!

Po si mos bëhesh nervoz, kur e dëgjon ministrin e Punëve të Jashtëm të Shqipërisë, Lulzim Bashën, kur thotë: *Shqipëria do ta ketë Kosovën, një shtet të ri fqinjë!*

Bëhem nervoz dhe i pështyj në fytyrë këta maskarenj që tentojnë qëllimisht, për interesat e veta personale, ta ndajnë kombin shqiptar në dy kombe. Po ne jemi vëllezër ore i gjorë! Dhe si mos të bëhem nervoz kur ish-shefi i UNMIK-ut, Soren Jensen Pederseni, me dekret e ka firmosur që Adem Demaçi të izolohet nga veprimtaria politike. Paramendojeni çfarë tmerri! Në Prishtinë janë mbledhur nga populli disa qindra nënshkrime dërguar RTK-së, përse nuk e ftojnë Adem Demaçin që t´ia shpjegojë popullit?!

Ai farë pusi, Sulejman aga, u thotë se po ai, ka qenë drejtor i bordit Prandaj, ka vite që titistët nuk e ftojnë heroin tonë të gjallë, t´i shprehë qëndrimet e tij. Janë këta mjeranë që e okupuan këtë institucion të rëndësishëm.

Luigj Shkodrani: A do të kemi ndonjë botim të ri nga Ju?

Xhemil Zeqiri: E thashë dhe më sipër se së shpejti do të botojmë një libër të përbashkët: unë, një veprimtare nga Rumania e cila quhet Mona Aggrigoroaiei si dhe Fadil Shyti, veprimtar politik nga Kosova e Shqipërisë, i cili tani jeton në Suedi. Do t‘i botojmë ca shkrime publicistike me ide të përbashkëta, që t´ua bëjmë me dije këtyre politikanëve të sotëm se ende deri sot, nuk kanë mësuar gjë nga dështimet!

Po qe se duan të vazhdojnë të bëjnë politikë edhe me tej, ata duhet doemos të ulen e të lexojnë, pa harruar të theksoj se atyre u duhen shumë e dhe këshillat popullore. Ndryshe, populli do t´i detyrojë të largohen sa më parë, me demonstrata dhe me forma të tjera të protestave, sepse pafundësisht janë duke manipuluar me vullnetin e tij. E them me zemërim se populli ynë i shumëvuajtur shqiptar, më së paku e meriton këtë politikë të papërgjegjshme.

Kam edhe disa materiale shumë të rëndësishme, intervista dhënë gazetave në Kosovë dhe Radio Kosovës etj. Shpresoj të bëj një përmbledhje. Aty mendoj të publikoj edhe shumë këshilla që ju duhen për së tepërmi politikanëve tanë të ardhshëm.

Luigj Shkodrani: Çfarë do të shtonit diçka për fund?

Xhemil Zeqiri: Po, tani do të dëshiroja që populli ynë të vetëdijesohet, të jetë sa më solidar ndaj atyre që e vazhdojnë punën për të drejtat e legjitime të kombit tonë, të drejta këto që na i mohojnë miqtë e armiqve tanë. Me këtë rast do të dëshiroja t´ia uroj popullit tim kudo që jeton në trojet etnike shqiptare dhe në diasporë, festat e mëdha të nëntorit, dy datat shumë të rëndësishme: 28 dhe 29 Nëntorin.

28 Nëntori 1912, ditë e shpalljes së pavarësisë të asaj gjysmë Shqipërie dhe *29 Nëntori 1944*, ditë e çlirimit po të kësaj gjysmë Shqipërie nga fashizmi dhe nazizmi italiano-gjerman.

PROBLEMI KA ÇALUAR QË NGA KONFERENCA E RAMBUJESË, KUR DELEGACIONI I KOSOVËS E NËNSHKROI ATË MARRËVESHJE

Intervistë në Radio "Drenasi", 4 shtator 2005

Drenasi: Z. Zeqiri, kemi kënaqësinë që jeni këtu për 30 minuta, për të na folur për librin tuaj që e keni përuruar këto ditë, për temat çfarë keni shtjelluar në këtë libër. Pyetja e parë: përse një lexues duhet ta lexojë këtë libër?

ZEQIRI: Dëshiroj t´i përshëndes dëgjuesit e nderuar të Radio-Drenasit dhe stafin e radios dhe me këtë rast dua të shpreh kënaqësinë time ngase është privilegj për mua që pas kaq vitesh në mërgim, të gjendem në mesin tuaj.

Pas përfundimit të luftës çlirimtare, shumë veprimtarë tanë u futën nëpër parti politike dhe thonë se u zgjidh problemi ynë kombëtar, tani ne duhet pushuar, sepse sipas tyre, u lodhëm. Mirëpo unë shpejt e kuptova se pas vitit 1999, gjërat nuk do të shkojnë drejt realizimit të objektivave tona historike.

Duke pasur kontakte me diplomatë danezë, norvegjezë, suedezë dhe europianë e shihja se këtu po përgatitej një komplot shumë i rreptë dhe perfid në dëm të çështjes shqiptare në përgjithësi, e të Kosovës në veçanti. Dhe thënë kushtimisht, unë nuk doja të dorëzoja armën time, që do të thotë luftën propagandistike, informative në Danimarkë për këto rrjedhoja. Prandaj në këtë mënyrë vazhdoja të informoja opinionin danez, vazhdova të bëj polemika me ministrinë daneze dhe të sqaroja se punët nuk janë duke shkuar në vijën e duhur, nuk është duke shkuar atje ku vete kërkesa e popullit shqiptar në përgjithësi, por edhe e Kosovës - për liri, unitet, për t'u bërë e barabartë me popujt në Ballkan dhe Europë.

Neve na janë mohuar këto të drejta kombëtare, e për këtë arsye në trojet tona shpërthyen tri luftëra çlirimtare.

Drenasi: Shpjegimet, sigurisht do të gjenden te libri "Polemika, intervista, debate, letra", te ky libër shumë interesant, ku gjejmë shumë pyetje dhe përgjigje, shumë analiza të problemeve mbarëkombëtare të Shqipërisë etnike. Do të dëshiroja të shtroja pyetjen tjetër lidhur me decentralizmin, është bërë shumë zhurmë rreth kësaj çështjeje, është diskutuar dhe për sovranitetin e lirë që po i njihet Serbisë mbi popullin e Kosovën, duke bërë që kjo (decentralizimi) ndofta të bëhet një shkelje e mëtejshme e të drejtave tona shqiptare. Për këtë e ka ngritur zërin fuqishëm edhe Lëvizja Vetëvendosje. Do të flasim më vonë për këtë lëvizje, por do të na interesonte thjesht mendimi yt për bashkësinë ndërkombëtare në lidhje me Kosovën, kur e dimë që vetëm pak muaj më vonë do të fillojnë bisedimet për statusin e Kosovës. Prandaj, cili është mendimi i juaj ndaj bashkësisë ndërkombëtare për statusin e Kosovës?

ZEQIRI: Po, tani fillojmë me decentralizimin. Dihet, për decentralizimin është diskutuar shumë dhe janë bërë shumë analiza të mira. Sidomos, simboli i rezistencës sonë kombëtare, Adem Demaçi e ka shpjeguar fort mirë se ç´do të thotë decentralizimi, pastaj Albin Kurti e shumë të tjerë. Unë mendoj se decentralizimi është kancer i Kosovës. Nëpërmjet tij bashkësia ndërkombëtare dhe Serbia duan ta sëmurin Kosovën dhe ta mbajnë pezull. Me fjalë të tjera, bashkësia ndërkombëtare i hap rrugë Serbisë që kjo të manipulojë me popull, siç ka manipuluar, e pikërisht me ndihmën e UNMIK-ut dhe të KFOR-it. Pra dëshiron të manipulojë më tej që në një moment të përshtatshëm të futet me ushtri dhe polici në Kosovë.

Kështu që, ma merr mendja se Lëvizja Vetëvendosje është duke e shpjeguar mirë këtë fenomen të rrezikshëm që vjen direkt nga institucionet dhe elaboratet serbomëdha, por që, për fat të keq, ka përkrahje nga UNMIK-u, i cili është bërë shërbëtor i politikës serbomadhe, që tashmë po shihet haptazi.

Sa u përket situatave që po kalojmë; Serbia po mundohet ta vërë përsëri këmbën në Kosovë. Problemi ka çaluar që nga Konferenca e Rambujesë, kur delegacioni i Kosovës e nënshkroi atë marrëveshje. Fuqitë e mëdha, pra NATO-ja, SHBA-të, i bënë presion Serbisë dhe pikërisht Serbia qe ajo që e ndjeu veten pak si më të favorshme, duke thënë: "Unë s´kam pse ta nënshkruaj, kur pala kosovare nënshkroi se Kosova do të jetë pjesë integrale e Serbisë".

Pra, ata faktikisht nuk nënshkruan. Të gjitha presionet që iu bënë Serbisë ishte që ajo ta nënshkruante atë marrëveshje e cila ishte përgatitur nga Akademia e Shkencave e Francës, në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Serbisë.

Dhe pikërisht për këtë ndodhi intervenimi i NATO-s mbi caqet serbe, sepse bënin presion që të respektohet ajo marrëveshje prej atyre që u mbyllën në kështjellën e Rambujesë.

Prej asaj kohe të gjithë jemi dëshmitarë që gjatë luftës, pas 78 ditë bombardimesh, erdhi përfundimi që të kurorëzohet, jo fitorja por në fakt një gjysmëfitore, kur në Kumanovë u bë marrëveshja, kur Kombet e Bashkuara ishin kundër intervenimit ushtarak. Në këtë aspekt, Kombet e Bashkuara e zgjodhën një serbofil, Marti Ahtisarin finlandez, që ai të jetë i pranishëm në Mbledhjen e Kumanovës, me gjeneralët serbë. Aty s´kishte as përfaqësues të NATO-s, as përfaqësues të UÇK-së, që do ta përfaqësonin palën shqiptare.

Prej aty, prej asaj mbledhjeje, e pashë rrezikun që po na kanoset, se politika serbe është favorite përballë problemit shqiptar të Kosovës.

Tani për tani, ne kemi institucione fiktive që quhen qeveri dhe parlament, por ne e shohim se të gjitha vendimet që i marrin këto institucione, UNMIK-u i hedh poshtë.

Kjo do të thotë se ndonjë ligj që aprovohet nga parlamenti i Kosovës, në dobi të shqiptarëve, UNMIK-u e hedh poshtë. Pastaj, kemi Kornizën kushtetuese, kemi dhe dokumente të tjera censuruese që politikës shqiptare ia imponon UNMIK-u.

Unë dëshiroj të them një fakt më konkret. Atëherë kur diskutohej për intervenimin ushtarak të NATO-s, unë në një mbledhje e kundërshtova këtë. Bile ka pasur një artikull në "Rilindje" kundër meje, pse isha kundër intervenimit ushtrak të NATO-s. Është e vërtetë se unë e thashë këtë në atë mbledhje, për arsye se me këtë politikë, Solana, si zëdhënës i NATO-s, thoshte: "NOT INDINPENDENT"! "AUTONOMI FOR KOSOVO"! (Jo pavarësi! Autonomi për Kosovën!)

Në kohën kur gati 60% e territorit të Kosovës ishte nën kontrollin e UÇK-së, komuniteti ndërkombëtar, GK ia kishin bërë me dije Serbisë se nuk guxon të masakrojë civilë. Në këto situata, dolën forca pro-serbe, që nëpërmjet NATO-s të intervenonin që ta ndalonin pavarësinë e Kosovës. Dhe unë konstatova që ky intervenim do të jetë NDAL pavarësisë së Kosovës!

Dihej se 60% e territorit të Kosovës ishte në kontroll të UÇK-së, prandaj asaj duhej t´i jepej e drejta që ajo ta shpallë pavarësinë e vet dhe kësaj t´i ndihmohej në të gjitha aspektet ekonomike, politike, ushtarake etj., që gjendja të stabilizohet, popullata të kthehet në shtëpitë e veta. Serbisë t´i bëhej e qartë se ajo më s´ka çfarë të kërkojë në Kosovë.

Mirëpo, forcat ndërkombëtare pro-serbe intervenuan nëpërmjet NATO-s, që me këtë akt, më tepër ta pengojnë pavarësinë e Kosovës. Atëherë, unë dëshiroja të isha gabim, por fatkeqësisht ideja ime doli e qëlluar! Kjo vjen si rezultat i lansimit të idesë që tani thuhet: "Për Kosovën do të vendosë KS i OKB-së"!.

Pse Kofi Anani të vendosë për problemin e Kosovës?! Për ketë çështje madhore duhet të vendosë populli i Kosovës! Populli i cili e ka bërë referendumin dhe luftën për pavarësinë e Kosovës.

Është pastaj Kushtetuta e Kaçanikut, por në fakt, udhëheqja politike e Kosovës i ka shkelur me të dy këmbët vendimet e veta historike që i ka marrë t´i çojë përpara. Nga ky aspekt mendoj që me popullin tonë po manipulojnë vetë liderët shqiptarë.

Jo, nuk kam qenë i bindur kur thoshin: Ja u zgjidh problemi! Unë e kam parë se problemi s´po zgjidhet. Nga ky aspekt, kam bërë polemika me Solanën, Kofi Ananin, ministrin e Punëve të Jashtme të Danimarkës. Pra, u kam dërguar letra, kam replikuar me deputetë, me rryma politike pro-serbe të cilat veprojnë intensivisht. Por për fat të keq, ne shqiptarët në Perëndim jemi pasivizuar shumë, ndërsa forcat pro-serbe janë shumë aktive. Prandaj këtu e shoh rrezikun më të madh. Fatkeqësisht, po e përsëris: udhëheqja politike shqiptare nuk i aktivizon veprimtarët në Perëndim. Ajo merr ofensiva t´i ç´orientojë, t'i bëjë defensivë, t´i pengojë ata në veprimtarinë e tyre atdhetare.

Të them të drejtën, unë kisha dhe kam presione, jo vetëm nga të huajt, por edhe nga shqiptarët. Ata më thonë: "Kush je ti që flet në emër të shqiptarëve, kur populli i ka zgjedhur përfaqësuesit e vet"?!

Por, ata duhet ta kuptojnë se unë kam hyrë në këto punë ngase dua ta ndihmojë procesin politik, që vetëdija e popullit shqiptar të ngritet më lart, që populli të jetë më këmbëngulës, jo për pavarësi sepse konsideroj që pavarësisë i ka kaluar koha!

Pavarësia, republika na duheshin kur ishte federata jugosllave, por tani, pas këtyre ndryshimeve të mëdha, kur Serbia s´ka çfarë të kërkojë në Kosovë, kur tani trumbetohet për një pavarësi të kushtëzuar, pra që ne të jemi nën kontroll nga të huajt, kjo fare nuk na duhet.

Këtë diplomatët nuk e thonë kurrë. Prej kujt e kushtëzuar, nga OKB-ja, nga Këshilli i Europës apo nga Serbia?!

Pavarësi po, por pa të drejtë bashkimi! Nëse një popull ka të drejtë për pavarësi, ai popull duhet ta ketë edhe të drejtën **e vetëvendosjes!** Prandaj, shikuar nga kjo logjikë, rezulton se neve po na mohohet e drejta e vetëvendosjes! Kësisoj, populli vetë do të vendoste në mënyrë të pavarur se çfarë do të përcaktonte për ardhmërinë e vet.

Unë e kam potencuar dhe kam kërkuar disa herë në debate, letra etj., që ne ta kemi të drejtën për vetëvendosje. Dhe nëse populli shqiptar e sheh interesin e vet ekonomik, politik, kulturor, zhvillimin e vet në kuadër të federatës serbo-malazeze, pse jo – pranon. Por, atë ditë që kjo federatë shkel mbi të drejtat tona, ne ta kemi të drejtën e shkëputjes. Është e drejtë e popullit tonë që me udhëheqjen e vet e cila e definon interesin e popullit të Kosovës, të përcaktohet nga të shkojë.

Pse na duhet patjetër një ambasador i ardhur nga Kofi Anan, nga OKB-ja, siç është Kai Aide, i cili patjetër duhet të japë mendimin e fundit, se kur duhet të fillojnë bisedimet për statusin e Kosovës?! Mendoj, Kaide është një diplomat i mirë, Kofi Anani e ka zgjedhur një diplomat të fortë, por fatkeqësisht, Aide fort mirë e di se statusi i Kosovës ku është!

Rezoluta 1244 tregon se Kosova është pjesë integrale e Serbisë dhe standardet që ia ka vënë Kosovës KS i OKB-së, nuk është kurrsesi e mundur të plotësohen, sepse as Danimarka që është shtet me potencial të fortë ekonomik etj., ato nuk mund t´i plotësojë.

Aide, e di që kosovarët s´mund t´i plotësojnë standardet, sepse UNMIK-u qëndron si gur i nxehtë apo u rri shqiptarëve si saç mbi kokë.

Prandaj shqiptarët s´janë në gjendje kurrsesi t´i plotësojnë këto. Nëse liderët politikë shqiptarë thonë se do t´i plotësojnë standardet, ata vetëm e gënjejnë vetveten! Ky është një manipulim shumë i rrezikshëm.

Ne duhet të kemi një politikë të qartë, si para popullit tonë, ashtu edhe para armiqve tanë, por edhe para miqve tanë që në këtë mënyrë të ecet përpara. Me intriga e mashtrime nuk arrihet politika e vërtetë kombëtare!

Drenasi: Në këtë rast, politikanët si mund të ishin më të saktë, më të plotë, më të qartë, për mendimet e tyre për statusin e Kosovës?

ZEQIRI: Ata duhet të thonë para ndërkombëtarëve: “Ne nuk mund t´i bëjmë këto, ne e kemi të drejtën tonë për vetëvendosje”,

gjë që unë e kam theksuar në letrat e mia për Ministrinë e Jashtme daneze, se në Kosovë pushtetarët shqiptarë nuk mund të marrin asnjë vendim, ata s´mund të caktojnë as edhe një terminal të autobusëve lokalë, pa e pyetur UNMIK-un. Nëse UNMIKU-u thotë jo, kjo s´ka për t´u bërë! UNMIK-u e ka pushtetin absolut në Kosovë. Këto ministri të Kosovës janë vetëm dekorime, si kukulla. Me fjalë të tjera, çdo gjë është në dorë të UNMIK-ut. Dhe ketë e dinë të gjithë, prandaj këto janë veç manipulime. Unë nuk e kuptoj pse udhëheqësit politikë shqiptarë krenohen për çdo ditë me pavarësinë, kurse në anën tjetër thonë: "Bëjmë negociata me Serbinë për Kosovën"!

Drenasi: Çfarë negociatash?! Këto negociata çojnë në autonomi!

ZEQIRI: Të gjithë e dinë në Perëndim, ministritë, politikanët dhe këtë e thonë hapur se Kosova është pjesë e Serbisë. Atëherë, përse politikanët shqiptarë të Kosovës nuk thonë: "S´kemi çfarë të bisedojmë me Serbinë".

Me Serbinë ne mund të bisedojmë vetëm për çështje ekonomike, për turizëm, për qarkullime të ndryshme rrugore, d.m.th. për vajtje-ardhje, për këtë bën të flitet, por jo edhe për statusin e Kosovës!

Për statusin e Kosovës është përcaktuar populli, pra për pavarësi, të cilën tani e shohim se na mungon, sepse na mungon **vetëvendosja**! Pavarësi po, por vetëvendosje!

E tani është kjo Lëvizja Vetëvendosje që e fuqizon pavarësinë e Kosovës. Lëvizja Vetëvendosje do të çojë direkt në vetëvendosjen e Kosovës! Ne nuk mund të izolohemi nga Europa dhe bota, por as nga Serbia, sepse ne nuk mund t´i zgjedhim fqinjët. Këta janë fqinjë tanë dhe nuk mund t´i shpërngulim.

Sa u përket serbëve që janë këtu në Kosovë, unë e kam thënë shumë herë edhe në shkrimet dhe në debatet e mia jashtë, se minoriteti serb në Kosovë duhet të respektohet si është më mirë,

sepse vetë shqiptarët, duke i respektuar serbët, kanë të drejtë t'i kërkojnë të drejtat e shqiptarëve që jetojnë në Serbi.

Në Beograd para luftës kanë qenë 150.000 shqiptarë. Flitet se 600.000 shqiptarë janë në tërë Serbinë. Atëherë, për një klikë të vogël që dëshiron të ketë kontakte me Serbinë, për interesa biznesi etj., t´i harrojmë interesat madhorë të kombit dhe interesat e shqiptarëve që jetojnë në Serbi?!

Këtë e vlerësoj jashtëzakonisht, jashtëzakonisht gabim!Dhe këtu duhet gjërat të përmirësohen! Por si duket, në politikën shqiptare legale, nuk ka përmirësime. Kemi një demagogji politike dhe pikërisht kjo po e ngatërron popullin dhe nga kjo ngatërresë, nga ky demoralizim, nga ky depresion ndodhën demonstratat e marsit të vitit 2004, që në fakt ishin të drejta, demonstrata gjithëpopullore. Por u keqpërdorën nga disa keqbërës, duke gjuajtur me armë nga kishat serbe, pastaj duke i djegur disa shtëpi të serbëve etj.

Por ne s´duhet të harrojmë se ato kisha janë shqiptare. Kanë qenë dhe duhet të jenë shqiptare. Kanë ardhur këtu okupatorët serbë, i kanë ngjyrosur dhe i kanë ndërtuar sipas traditave dhe riteve të tyre fetare dhe tani thonë se janë kisha tyre!

Drenasi: A mendon se Lëvizja Vetëvendosje është diçka e re dhe për të mirën e Kosovës? Përse Lëvizja Vetëvendosje nuk është shumë e mirëpritur, kur dihet që nuk është sindrom i Rezolutës 1244?!Diçka më tepër rreth kësaj lëvizjeje. Si duket, jeni edhe ju veprimtar i saj, andej larg vendit e përkrahni?!

ZEQIRI: Unë si veprimtar i kam përkrahur të gjitha partitë dhe shoqatat që kanë dalë që nga viti 1982 në Kosovë, Akademinë e Shkencave, Lidhjen e Shkrimtarëve, Lëvizjen Popullore për Republikën e Kosovës (LPRK), pastaj partitë politike që dolën në vitet '90, LDK-ja, Prosperiteti. I kam kontaktuar me institucionet daneze, duke ua tërhequr vërejtjen që me këtë politikë, ju po e katandisni popullin shumë keq, prandaj të keni shumë kujdes.

Kam bërë polemika, bile në librin tim ka shumë gjëra ku ua kam tërhequr vërejtjen dhe për fatin e keq kisha të drejtë. Unë tani do të isha i kënaqur sikur të kisha qenë gabim, që sot punët të shkonin mbarë e mirë, por për fat të keq, e them edhe njëherë, vlerësimet e mia dolën të sakta, prandaj punët nuk po shkojnë mirë as në Kosovë, as në Maqedoni.

Me këtë rast ju informoj se duke u kthyer nga Tetova, policia maqedonase gati-gati më arrestoi, po të mos kishin intervenuar disa miq të cilët bënë presion tek ata të më lirojnë. Prandaj kalova këndej nga Kosova, përndryshe do të arrestohesha sot, sepse e përkrahi Lëvizjen Vetëvendosje.

Kjo është ajo pikë që sot sllavët më së shumti i preokupon! Vetëvendosjen nuk e kanë shpikur shqiptarët.Vetëvendosjen e kanë shpikur vetë Kombet e Bashkuara.

Prandaj është Rezoluta 1540 e cila thotë: "Çdo popull që është i kolonizuar, ka të drejtë të luftojë me të gjitha mjetet, për ta arritur vetëvendosjen, pavarësinë. Ka të drejtë të shkëputet prej shteteve të huaja".

Dhe kjo çon në përfundimin se ne këtë armë e kemi marrë nga Kofi Anani, prandaj Kofi Anani nuk ka sesi ta mohojë këtë!Ju thashë më herët se unë e kam ndihmuar L. V. në të gjitha aspektet: politike, ekonomike dhe morale.

Tani kjo lëvizje është njëra ndër lëvizjet më të shkëlqyera të popullit tonë, në periudhën e pasluftës - LPK-së dhe UÇK-së. Tani kjo e ka radhën që t´i ndihmojnë të gjithë shqiptarët. Kjo lëvizje, me këtë rini të shkëlqyeshme në ballë të popullit, nuk e meriton këtë status që e ka Kosova sot.Nuk e meriton injorimin që po na e bën Europa me aleatët e vet, që me çdo kusht Kosova të mbetet në kuadër të Serbisë.

Kur jemi këtu te kuadri i Serbisë, unë e them dhe një fakt tjetër:Ministri i Malit të Zi ishte për një vizitë në Danimarkë. Ministria daneze nuk donte ta pranonte sepse Mali i Zi nuk është i njohur si shtet i pavarur. Një mik yni gazetar, bën një intervistë me

ministrin, të cilit i thotë: “Pse nuk deshi t´ju pranojë Ministria e Jashtme (e cila pas disa presioneve e pranoi)”?!

Ai iu përgjigj: "Më 1995-1996 Këshilli i Europës na ka thënë se të gjitha ish-republikat jugosllave do të pranohen si të pavarura, por Mali i Zi nuk do të pranohet tani, derisa të qetësohet situata e Kosovës. Me fjalë të tjera, kur Kosova të futet në kuadrin e Unionit Serbi-Mali i Zi, pastaj Mali i Zi do të pavarësohet".

Mirëpo ministri malazez i thotë: "Në Kosovë është derdhur gjak dhe atje nuk ka shqiptar që e pranon këtë. Ndofta ndonjë lider për interesa shumë të ngushta mund ta pranojë një lojë të tillë, por popullata 99% se pranon dot”. Kështu tha në Radio Danimarkë se popullata shqiptare është kundër çdo unioni me Serbinë.

Kjo do të thotë se Perëndimi dhe OKB-ja mundohen me çdo kusht që neve të na fusin në kuadër të Serbisë, prandaj qesin bllokada, standarde, decentralizim etj. Pikërisht për këtë e përkrahi me shumë vullnet të madh Lëvizjen Vetëvendosje.Ajo ka përkrahje, jo vetëm në Danimarkë, por edhe më gjerë. Tani janë hapur qendrat e L. V. në Malmö, Stokholm, Oslo, ku sipas informacioneve janë kyçur intelektualë dhe përkthyes të mirë që janë duke bërë një punë të shkëlqyeshme, duke intervenuar në ministritë e shteteve ku veprojnë, duke u dhënë atyre të dhëna direkte. Me sa jam në dijeni, mbi 1500 letra elektronike (e-maile) janë dërguar vetëm në Norvegji. Është dërguar materiali komplet i gazetës **"Vetëvendosje",** i përkthyer në gjuhë të huaja. Është dërguar tek ata që ta kenë një material alternativ, sepse UNMIK-u është ai që informon dhe vendos për rrjedhat në Kosovë. Pra ne jemi bërë, do të thosha, si një opozitë informative.

Drenasi: Lëvizja Vetëvendosje (L.V.) mendoj të jetë sindrom, ideologe tjetër për Shqipërinë Etnike, siç e thonë edhe udhëheqësit e saj, Albin Kurti e të tjerë. Ndoshta mund të jetë kjo Lëvizje për Shqipërinë Etnike?

ZEQIRI: Unë nuk kam dëgjuar për këtë! Unë e di se L. V. mund të jetë në radhë të parë ajo që kërkon që ne të vendosim për fatin tonë.Unë përmenda më herët që, nëse për interesin e vet, populli i Kosovës dëshiron të bashkëpunojë më tepër me Shqipërinë londineze se me Serbinë apo anasjelltas, dëshiron të ribashkohet me Shqipërinë apo të krijojë një union me Serbinë - kjo është tjetër çështje.

Unë nuk kam parë ndonjëherë se Albain Kurti kërkon që Kosova të ribashkohet me Shqipërinë londineze.Ne jemi për atë që vetë Kosovës, me këta kufij, t´i njihet e drejta për vetëvendosje. Popullata - 95% e vendit - të vendosë vetë për fatin e vet! E jo të na e imponojë neve Kofi Anani me KS. Fundi i fundit, të pyetet populli shqiptar: A do apo nuk do që të jetojë nën dhunën dhe tmerrin serb.

Pengesa nuk është veç te Millosheviqi. Dihet, Millosheviqi tani është në Hagë, por tani kanë ardhur millosheviqër më të zi e më të egër se ai. Kanë qenë para Millosheviqit edhe mbretërit serbë të cilët u sollën keq ndaj popullit tonë. Kësisoj sillen edhe pasardhësit e tyre. Prandaj ne duhet ta kemi të drejtën për vetëvendosje. Kjo e drejtë na u mohua edhe gjatë Luftës së Dytë Botërore. Dihet që kjo e drejtë iu premtua shqiptarëve por pastaj u tradhtuan padrejtësisht.

O sot o kurrë! Të gjithë shqiptarët, kudo që janë, në vendin amë - Shqipëri dhe përreth, por edhe në Perëndim, duhet ta përkrahim këtë lëvizje. Të ndihmohet me të gjitha forcat që ta fitojmë këtë të drejtë.

Mua më kanë thënë në debate në Danimarkë se nëse kjo bëhet një forcë me potencial të fuqishëm, qendrat politike ndërkombëtare të vendosjes detyrohen t´ua njohin të drejtën për vetëvendosje.Por kështu si jemi, ata thonë: Ju i keni të zgjedhurit tuaj!

Sot e dëgjova Albin Kurtin kur tha se as 50% s´kanë votuar zgjedhësit në zgjedhjet e fundit. Kjo thuhet në raportet e OSBE-së. Por ajo i ka pranuar si zgjedhje legale sepse ata thonë se edhe 30% po të dalë popullsia në zgjedhje, ne i pranojmë. Përse? Për arsye se ata e kanë kastën politike e cila manipulon me këtë popull. Prandaj

populli duhet t´u bëjë presion politikanëve. Presion më i fuqishëm do të jetë që njerëzit të antarësohen dhe ta ndihmojnë L. V. në mënyrë që politikanët shqiptarë t´i nxjerrin para aktit të kryer! Atëherë ata do të detyrohen të mendojnë dhe ta kuptojnë se rruga e Lëvizjes Vetëvendosje qenka rruga më e mirë e zgjidhjes.

Drenasi: Gjatë leximit të librit "Polemika, intervista, debate dhe letra", kemi pasur rastin të njihemi me qëndrimet e pathyeshme, në lidhje me shumë atdhetarë që ju nuk keni rënë kurrë në kurthet e politikës ditore, ndofta ideologjike apo klanore dhe posaçërisht për ju ka qenë kryesore zgjidhja madhore e çështjes shqiptare, për të folur ndofta për ribashkimin e trojeve etnike shqiptare.Keni për të shtuar diçka për dëgjuesit për librin tuaj?Diçka më tepër për ribashkimin e Shqipërisë, e cila është një temë që ceket shumë në faqet e këtij libri?

ZEQIRI: Për ribashkimin e Shqipërisë është derdhur gjaku lum.Nuk ka shqiptar atdhetar që thotë: “Nuk e dua ribashkimin e shtetit shqiptar”.Këtë unë e kam potencuar edhe nëpërmjet letrave që ia kamdërguar Ministrisë së Jashtme të Danimarkës, se kjo duhet të arrihet me çdo kusht, se fundi i fundit shqiptarët janë për këtë.Por bashkësia ndërkombëtare, Europa, OKB-ja, NATO-ja e kanë mbërthyer shumë keq politikën shqiptare në Shqipërinë londineze, qoftë e udhëhequr kjo nga Fatos Nano, qoftë e udhëhequr nga Sali Berisha.Gjithashtu kjo vlen edhe për udhëheqësit shqiptarë në Kosovë, Maqedoni, Preshevë etj.Fuqitë e Mëdha e imponojnë dhe po e zbatojnë politikën e tyre me ndihmën e liderëve politikë shqiptarë.

Në fakt, kam dalë si opozitar kundër gjithë këtyre, që të bëhem një zëdhënës i popullit, sepse fundi i fundit, Kosova Republikë, qe aktuale kur ishim nën sundimin e ish-federatës jugosllave. Ne të gjithë e dimë se sikur të ishte Kosova republikë, do ta kishte të drejtën për vetëvendosje, që një ditë t´i ribashkohej nënës Shqipëri. Unë do t´ua them një shembull. Në vitin 1980 kur u burgos grupi i parë i atdhetarëve në Shkup, me atdhetarin e madh Zaim Beqirin, gjyqtari atyre u tha: "Juve nuk ju do Shqipëria, ju pse e doni

Shqipërinë"?! Ata, atdhetarët, i ngritën grushtet lart, sepse ashtu përshëndetnin në atë kohë në Shqipëri. Reaguan para kolegjit gjyqësor dhe thanë: "Nuk ka nënë që s'e do fëmijën e vet dhe nuk ka fëmijë që s'e do nënën e vet"!

Këtë ide madhështore sllavët atëbotë s´arritën dot ta mposhtnin! Lëvizja jonë çlirimtare u forcua dhe u rrit, por tani Europa, nëpërmjet udhëheqësve dritëshkurtër politikë shqiptarë, po e imponon politikën e përçarjes sonë kombëtare. E shihni si është gjendja në Maqedoni edhe pas luftës çlirimtare që e bëri UÇK-ja?Atje po manipulohet me popullin. Tani z. Ali Ahmeti mendon se gjaku u derdh për ta forcuar integritetin sllav në Maqedoni.Atje shqiptarët burgosen, vriten, injorohen. Ushtarët e UÇK-së hedhen burgjeve.

Në Shqipërinë londineze, intelektualët e ndershëm po bredhin rrugëve. Kam takuar akademikë, studiues të shkencave politike, inxhinierë të elektroteknikës që bredhin rrugëve, pa punë, sepse ata nuk janë të dëshirueshëm nga partitë në pushtet, nga pozita apo nga opozita, PD-ja apo PS-ja. Ata janë linçuar, kanë mbetur anash.

Ribashkimin kombëtar nuk e duan partitë politike. Këto janë në shërbim të të huajve. Secila parti tani e di kujt i shërben, por populli i thjeshtë mirë e di se ribashkimi kombëtar është i vetmi shpëtim yni. Por tani kjo nuk është në rend dite. Tani lufta jonë aktuale është për vetëvendosje.

Unë do t´i përkrah të gjitha ato lëvizje që çojnë kah ribashkimi kombëtar. Tash për tash jam përqendruar në Lëvizjen Vetëvendosje sepse populli ynë nuk i meriton këto keqpërdorime që po i bëhen.

Drenasi: Do të dëshironim të dinim për letrat tuaja drejtuar Mojsiut, Nanos, Majkos. Cili ka qenë qëllimi i tyre dhe si janë përgjigjur pushtetarët me këtë rast?

ZEQIRI: Fola më herët se atyre s´ju intereson çështja e popullit, por e manipulimit dhe e korruptimit. Ata kanë harruar apo s'e kanë marrë me mend se ekziston Xhemil Zeqiri dikund! Bile, as nuk e kanë parë të arsyeshme të më përgjigjen!

Ndërsa Solana, Ministria e Jashtme dhe kryeministri danez më janë përgjigjur në çdo letër, sepse ata e shohin kapacitetin tim politik dhe organizativ që kam atje, prandaj më janë përgjigjur.Unë u kam shkruar letër institucioneve shqiptare, kam reaguar për arrestimin e Gafur Adilit, Taip Mustafajt dhe Idajet Beqirit të cilët janë veprimtarë të FBKSH-së.

Akuzat që u ngritën kundër tyre ishin ngritur nga maqedonasit. Kinse këta veprimtarë shqiptarë kishin nxitur urrejtje ndërnacionale në Maqedoni. Prandaj unë e pashë të arsyeshme të reagoj. Kërkova që të ndërpriten këto akuza.Ndërsa Pandeli Majkos i jam drejtuar me një letër, kur ai refuzoi ta nënshkruante dokumentin, duke thënë se Enver Hoxhës, ish-udhëheqësit shqiptar, nuk i takon statusi i veteranit!

Gjithë bota e di se Enver Hoxha, qoftë për të mirë, qoftë për të keq, ka qenë udhëheqës shqiptar i luftës, po edhe i pasluftës, derisa vdiq. Ndërsa Pandeli Majko, ministër i Mbrojtjes, nuk e paska ditur se Enver Hoxha paska qenë veteran dhe udhëheqës i luftës çlirimtare!

Kjo është diçka qesharake. Në botën e jashtme bëhet qesharake. Kur danezëve u them se Ministri i Mbrojtjes nuk e pranon këtë, ata qeshin e thonë: "Ç´është ky budallallëk te ju shqiptarët. Në një anë e akuzoni Enver Hoxhën si diktator, se paska vrarë e paska prerë gjatë kohës kur ishte në pushtet, e në anën tjetër, po të mos kishte pasur forcë e të mos kishte qenë udhëheqës, nuk do t´i bënte ato ”krime”!Nëse mund të quhen krime, sepse unë nuk kam hasur diku se Enver Hoxha ka bërë krime.

Por, ata që i eliminoi regjimi i Enver Hoxhës, ishin disa agjentë serbo-greko-italianë që kishin hyrë në agjenturat e huaja, për interesa të vet dhe në dobi të shteteve armike.Por në fakt, Enver Hoxha ka bërë shumë për çështjen kombëtare.

Iniciativa e tij për njësimin e gjuhës shqipe, me Kongresin e Drejtshkrimit në Tiranë (1972), tregon qartë se ai ka punuar për bashkimin shpirtëror të shqiptarëve. Prandaj ky bashkim u arrit deri në vitin 1990, por pastaj, agjenturat e huaja, me partitë politike

"demokratike", të krijuara brenda e jashtë Shqipërisë, arritën ta prishin imazhin e bashkimit shqiptar.

Nëse bëhet sot një referendum, kam drojë se ky do të jetë në favor të ribashkimit kombëtar. Agjenturat e huaja e kanë bërë këtë hapje të madhe të hendekut brenda nesh. Unë nuk kam parë diçka që shteti shqiptar ka bërë në dëm të dikujt. Mund të ketë përjashtime, sepse populli ynë thotë: "Afër drurit të thatë, digjet dhe i njomi". Mua më vjen keq për ato raste.Ja, shiheni ku jemi katandisur.

Gjysma e popullit ka mbetur jashtë dhe po digjen edhe i thati, edhe i njomi nën dhunën sllave. Si mos më keq.

Drenasi: Tani dëshirojmë të flasim për botimin e librave tuaj. Këto ditë ju keni përuruar librin "Polemika, intervista, debate dhe letra", por ju nuk jeni vetëm me ketë libër por edhe me "Kosova jonë", Tiranë, 2000, pastaj "Në mbrojtje (diplomatike) të çështjes shqiptare", Prishtinë, 2003. Pra për librin që po diskutojmë është libri i tretë, pastaj e keni në dorëshkrim dhe një libër tjetër i cili patjetër do të gjejë mbështetje te lexuesit. Do të kisha një pyetje për autorin e librave që është në studio. Botimi i librave është rezultat i profesionit apo i vullnetit për të vënë një gur më tepër për lirinë e atdheut? Botimi i këtyre librave a është çështje thjesht profesoinale apo diçka tjetër që ju jeni kaq pranë lexuesit në të tilla debate?

ZEQIRI: Jo, unë s´jam profesionist në politikë. Jam punëtor i thjeshtë, ngasës taksie në Kopenhagë. Kam familje, kam dy fëmijë dhe gruan. Me djersën e ballit i bëj të gjitha. Aktivitetet dhe shpenzimet i bëj prej xhepit tim. Ndihmat nuk i marr prej askujt. Vetëm në disa raste ministria daneze më ka paguar disa udhëtime për konferenca ballkanike.

Drenasi: Tani kemi një telefonatë nga dëgjuesit.

ZEQIRI: Urdhëroni!

Drenasi: Një dëgjues nga Londra, pyet: Çka ka të bëjë AKSH-ja për faktorin shqiptar? Disa po e quajnë negative, disa pozitive. Çka mendoni ju konkretisht për këtë armatë? Pastaj, kam dëshirë ta kam adresën e postës elektronike, të e-mailit tënd.

ZEQIRI: Po, është e vërtetë që Fronti për Bashkim Kombëtar Shqiptar (FBKSH) e ka edhe krahun ushtarak, AKSH-ën. Kjo do të thotë se ata e duan një ribashkim kombëtar, kjo do të thotë se ata e kanë krijuar krahun e luftës, i cili, po qe se nuk arrihet fitorja me mjete paqësore diplomatike, do të çohet që këtë ta bëjë edhe me armë. Sa kanë të drejtë, këtë koha do ta vërtetojë. Për veten time, unë e shoh dhe mundohem që t´i ndihmoj Lëvizjes Vetëvendosje, sepse L.V. vepron të arrihet kjo, pa gjakderdhje dhe në mënyrë civilizuese - në zemër të Ballkanit dhe të Europës.

A e ka gabim - siç e shtroi pyetjen dëgjuesi. Unë nuk mendoj se këtu ka ndonjë gabim, por sigurisht, kur kris pushka bëhen edhe gabime. Ja p.sh. ushtarët tanë më të mirë tash po na i merr Haga. Po dënohen në Hagë për këto "arsye".Unë e përkrahi L. V. që të mos kemi gjakderdhje më, që të arrihet e drejta jonë për vetëvendosje.

Po ja edhe një fakt tjetër. Pse lindi FBKSH-ja dhe në gjirin e saj, AKSH-ja. Ata e shohin se nuk po shkon drejt zgjidhjes çështja e Kosovës dhe çështja shqiptare në përgjithësi. Prandaj unë mendoj se derisa nuk është zgjidhur drejt çështja jonë, do të lindin AKSH-ja dhe ushtri të tjera të cilat nuk e shohin zgjidhjen me mjete paqësore. Prandaj duhet të arrihet një zgjidhje, sepse gjaku i dëshmorëve, amaneti i tyre na fton që të arrihet qëllimi. Fundi i fundit, dihet se UÇK-ja e Ali Ahmetit e dha betimin për ribashkim kombëtar ndërsa ky zotëriu tani trumbeton, përpiqet me të gjitha mënyrat dhe mjetet për bashkim me sllavët. Kjo është një tragjedi që ai mundohet t´ia imponojë popullit, kinse s´kemi mundësi tjetër, siç arsyetohet ai dhe kompania e tij.

Bile, njëri prej ish-komandantëve të UÇK-re, më tha: “Nuk kishim mundësi, sepse patëm presione prej Batlerit, ambasadorit amerikan në Maqedoni”. Unë ia ktheva: “Mirë bre dost, ti luftove për Batlerin, e dhe betimin për Batlerin, apo e dhatë betimin për

popullin tonë”?!Kështu vijnë këto gjëra, derisa nuk është zgjidhur çështja jonë, siç thotë dramaturgu i madh gjerman, Brehti: **"Ku është revolucionari, është pakënaqësia"**. (Pastaj, Zeqiri ia jep adresën e vet dëgjuesit.)

Drenasi: Thjesht, është vullneti ai që ju bën të fortë të shkruani për lirinë e atdheut?

ZEQIRI: Natyrisht, pakënaqësia! Pakënaqësia e madhe për zhvillimet politike në hapësirën shqiptare më detyron që herë pas her të shkruaj letra, artikuj, peticione, të bëj debate dhe kundërshtime (polemika), të futem thellë në këto sepse e shoh të arsyeshme. Kur populli e ka këtë rini kaq të mrekullueshme, ne s´guxojmë të lejojmë të futemi në këto aventura të çfarëdo unioni me Serbinë dhe Malin e Zi. Kjo më detyron të reagoj, nuk mund të flej i qetë.

Në anën tjetër, puna e taksistit në Kopenhagë është mjaft e lodhshme. Shpesh mbetem pa gjumë dhe prapë mundohem që me djersën e ballit të ndihmoj diçka, të bëjë diçka të mirë në favor të çështjes kombëtare shqiptare.E kam parë të arsyeshme t´i botoj këta libra që ta shohin intelektualët që nuk jam gjuhëtar. Bile kam gabime edhe në shkrime. Kur e shkruaj një letër e dërgoj te 5-6 shokë, ta shikojnë mos kam ndonjë gabim këtu apo mos e lëndoj të djathtin apo të majtin danez, sepse problemi ynë nuk zgjidhet duke i përkrahur të djathtët apo të majtët.

Juve ju kujtohet që unë e pëlqej një punë të Ramiz Alisë, kur ai i rregulloi marrëdhëniet me BS. Ai e dinte se BS është në KS. Dihet se Rusia e ka një veto atje, me të cilën, kur të dojë e përdor kundër njohjes së Kosovës. Prandaj unë nuk jam as kundër Rusisë, as kundër Amerikës.

Unë jam edhe me Rusinë edhe me Amerikën, por kur çështja shqiptare kërkon zgjidhje, për këtë duhet të gjithë të jemi të një mendimi. Ne s´kemi pse të jemi as kundër Amerikës as kundër Rusisë.

Ne, Amerikës dhe Rusisë duhet t´ua bëjmë të qartë se ashtu siç kanë vdekur të parët tanë për çështjen kombëtare, edhe ne pasardhësit e tyre, jemi të gatshëm të vdesim për çështjen kombëtare.

Duke i botuar këta libra, ma merr mendja që intelektualët do të ndërgjegjësohen. Kur një taksist i thjeshtë me një shkollë të mesme teknike qenka në gjendje të polemizojë me diplomatë të huaj, po çfarë pune të madhe në këtë drejtim do të mund të bënin ata! Ku janë ata intelektualë, pse heshtin?

Pse hyjnë në shërbim të djallit e të birit të mallkuar, e jo në shërbim të popullit? Bile aq më keq, ngase ata marrin vota në emër të popullit.Kjo ka qenë edhe ajo revolta ime që e kam shprehur në librat e mia.

Drenasi: Veprimtaria juaj ka qenë e fokusuar që ta njoftoni opinionin atje në Danimarkë, ndofta kjo ka qenë qëllimi yt kryesor. Si është pritur kjo nga miqtë tuaj, apo nga përfaqësuesit e diplomacisë? Është pritur mirë mendimi juaj për çështjen kombëtare shqiptare?

ZEQIRI: Kjo është një pyetje e ndërlikuar që duhet patjetër ta shpjegoj më mirë.Unë nuk e kam lehtë atje, sepse në fillim jam unë ai që e kam pritur delegacionin 9-anëtarësh danez. Ata, me sugjerimin tim, më 1992 ishin në Kosovë. Atëbotë e kisha një veprimtari tejet të ngjeshur. Bisedoja me ata për t´i bindur që të vinin në Kosovë, pastaj ata erdhën këtu. U takuan me udhëheqësit politikë të Kosovës, që dolën në atë kohë legalë.

Pasi u kthyen, unë i prita me shoqen time dhe me fëmijët e mi me buqeta lulesh në Kopenhagë. Gjatë takimit, një udhëheqës i delegacionit të grupit parlamentar, më tha: “Tani do të kemi kontakte të drejtpërdrejta me kosovarët. Ata kanë qëndrime shumë të buta për zgjidhjen e çështjes shqiptare, e ju si duket, keni qëndrime shumë radikale. Ne do të kontaktojmë edhe me ju, por ata kanë qëndrime demokratike që nuk e provokojnë Serbinë, nuk e provokojnë gjakderdhjen, ndërsa ju këmbëngulni për pavarësi, për

vetëvendosje, prandaj nuk mund t´ju përkrahim”.Megjithatë, unë e vazhdova veprimtarinë time.

Kisha miq analistë që më përkrahnin, parlamentarë, bile në disa letra shkruhet kjo!Por, nga ky aspekt se kam lehtë, sepse jam në presione, më përgjohet telefoni, policia daneze më pyesin: çfarë bënë ti, a ke armë?

Unë shërbimin ushtarak s’e kam kryer. Kurrë në jetën time pushkë s´kam mbajtur, por ja, qëndrimi im ndaj çështjes shqiptare në përgjithësi dhe asaj kosovare në veçanti, e bën këtë që ministria daneze të më mbajë kështu si peng të situatës.

Unë e kam shprehur haptazi edhe në shtypin dhe televizionin danez se do të vazhdoj ta përkrahi çështjen shqiptare edhe me pushkë nëse ka nevojë, të luftoj për të drejtat tona që po na mohohen.Gjatë bisedave më kanë pyetur: “Çfarë interesi ke ti”?!

Unë ua kam kthyer: “Interesi im madhor, është që unë t´i shoh shqiptarët që si popujt e tjerë ta kenë të drejtën e vet për vetëvendosje.Paramendojeni zonjë e nderuar, këtu në redaksi, çfarë dëshire madhore është kjo, çfarë fuqie të madhe do të kishte një komb prej 7-8 milionë banorësh të bashkuar, me një ekonomi të zhvilluar.Ne jemi 2 milionë shqiptarë jashtë vendit. Sikur atë pasuri ta shfrytëzonim në territoret shqiptare, me siguri që Shqipëria do të bëhej lule në brigjet e Adriatikut dhe në mes të Ballkanit.Po, kështu siç jemi, ne s´përparojmë dot, s´jemi askund. Dilni e shihni në Perëndim. Atje shqiptarët, tani për tani janë të humbur.

Kjo politikë paqësore përçarëse i ka vënë në depresion të madh shqiptarët. Nuk ka ardhmëri, nuk shihet dalje nga kjo gjendje. Tani ka filluar një ringjallje me L. V., tani e shohim sërish se paska burra e vasha atdhetare që i dalin zot popullit, sikur që ishte Demaçi në vitet ‘50, i cili e filloi rezistencën kundër politikës serbomadhe, qëndroi burgjeve. Kjo pasqyrohet në librin **"Dosja Demaçi"**, Prishtinë 2004. Në të përshkruhen vuajtjet dhe gjyqet e tij dhe të shokëve të tij Një libër i përgatitur shumë mirë. Pastaj, i madhi atdhetar Adem Jashari. Sot të njëjtën punë po e bën djaloshi atdhetar Albin Kurti.

Rezulton sikur perëndia e ka shkruar fillimin e qëndresës sonë me **A**-Adem Demaci, **A**-Adem Jashari, **A**-Albin!Diçka këtu do të ketë në favorin e shqiptarëve. Prandaj, ju bëj thirrje edhe njëherë, vetëm përkrahje **Albin Kurtit**, sepse jemi në rrugë të mbarë.

Drenasi: Janë vërtet analiza interesante, me vlera të mëdha kombëtare, por s´ka si të ndodhë ndryshe, prandaj duam të dimë mendimin tuaj për qeverinë e re, për "Qeverinë Berisha"?

ZEQIRI: Do të dëshiroja të dalë gabim mendimi im, por mendoj se Berisha ka një orientim shumë pro-grek dhe pro-serb, nëpërmjet vjehrrës së vet. Por, qëllimin kryesor e dëshmoi haptas kur deklaroi: "Të gjithë shqiptarët duhet t'i kenë sytë nga Greqia".Sipas disa informacioneve që kam unë, forcat greke do të marshojnë, do ta bllokojnë ekonominë shqiptare dhe në këtë mënyrë grekët do ta gëlltisin ekonominë shqiptare. Nga kjo rezulton se kush e ka ekonominë në dorë, do të vendosë, do ta ketë tutelën edhe për çështjet politike.

Drenasi: Mendoni se "Qeveria Berisha" do të jetë më favorite se qeveria Nano?

ZEQIRI: Personalisht nuk pres shumë nga qeveria Berisha. Greqia është në Këshillin e Europës etj. Nano e kishte njëfarë politike si Fan Noli. Mbahej me Italinë, me Greqinë me Amerikën dhe me NATO-n, ndërsa Berisha është shumë kokëfortë dhe i paaftë politikisht. Është hakmarrës në shpirt dhe ai tani shkon në një drejtim. Ishte me arabët, me Lindjen e Mesme. Pikërisht këtu edhe dështoi në politikën e tij. E humbi përkrahjen nga amerikanët dhe tani shkon drejt Greqisë.

Atë garniturë qeveritare që e ka paraqitur tash siç janë ministrat e Mbrojtjes, të Punëve të Brendshme, kryetari i Parlamentit, apo ministri i Jashtëm, nuk e shoh se kanë sens politik për t´i çuar punët përpara dhe për t´i përparuar e bashkuar shqiptarët.Dhe, vërtet shumë

shpejt do të fillojë revanshizmi tek ata atje.Prandaj unë frikësohem mos të përsëritet 97-a.Duke e kujtuar këtë, s´ndihem i qetë.

Druaj, Berisha do ta gjakosë përsëri popullin. Do të dëshiroja shumë të jem gabim, por unë mendoj kështu. Për atë njeri kam bindje shumë të keqe.

Drenasi: Të nderuar dëgjues kemi folur për çështjen shqiptare.

ZEQIRI ndërhyn: Nuk është e thënë që ju t´i keni bindjet e mia. Duhet të kemi kujdes ndaj të gjithë udhëheqësve shqiptarë, jo vetëm ndaj Berishës. Nuk është mirë të krijojmë kulte dhe t´ju besojmë në mënyrë fanatike apo verbërisht. Ne duhet t´i shikojmë në radhë të parë si veprojnë ata, sa punojnë për qëllimet tona, për vizionet tona që çojnë drejt realizimit të objektivave tonë historikë. Në emër të demokracisë janë duke iu bërë padrejtësi të mëdha këtij populli.

Drenasi: Të falenderojmë që erdhe në studion tonë.

ZEQIRI: Gjithashtu edhe unë ju falënderoj.

Drenasi: I nderuar, si e vlerësoni situatën politike sot, fillimisht do të thoja të shqiptarëve në Maqedoni, për faktin se këto ditë ishit në vizitë andej nga Tetova, për "pushime"?

Zeqiri: Situata politike e shqiptarëve që jetojnë në trojet e veta në Maqedoni është shumë e rëndë dhe tejet e ndërlikuar. Në këtë republikë, siç duket qartë, faktorët ndërkombëtarë dhe pushtetarët maqedonas e shqiptarë po bëjnë eksperimente në kurriz të popullit të pambrojtur shqiptar.

Gjatë qëndrimit tim atje, pashë nga afër një gjendje tejet kaotike, një anarki që e rrezikon të sotmen dhe të ardhmen e shqiptarëve.

Shqiptarët kudo në Ballkan nuk po arrijnë të krijojnë një unitet, pavarësisht pluralizmit politik që ekziston. Në vend që të bashkoheshin kombëtarisht shqiptarët, po ndodhë e kundërta.

Tani gjendja në Maqedoni është e ndërlikuar, për faktin që tri partitë kryesore shqiptare, të përfaqësuara në parlamentin maqedonas, nuk po arrijnë dot të gjejnë një gjuhë të përbashkët, në veçanti për çështjet më madhore nacionale dhe sociale, por përkundrazi, secila e lufton njëra-tjetrën dhe garojnë se kush do të bëhet më servil ndaj politikës dinake maqedonase.

Drenasi: Pse ndodh kjo, a mund të kërkohen fajtorët për këtë politikë prapakthehu edhe jashtë trojeve etnike shqiptare?

Zeqiri: Populli ynë e thotë një fjalë të urtë: "Faji është jetim"!

Për fatkeqësinë tonë, që nga shpallja e pluralizmit politik në ato vise, në skenën politike erdhën njerëz të etur për pushtet, e jo për shtet shqiptar. Erdhën njerëz të regjur për pehlivanllëk dhe për gatishmëri të bashkëpunojnë me qarqe të huaja, që hiqen si mike, por në të vërtetë, nën rrogoz e bënë dhe po e bëjnë punën e qarqeve armike. Fjala vjen, kur nga qarqe të huaja "aleate" kërkohet ndonjë bashkëpunëtor "këshilltar" apo ndërmjetësues midis popullit dhe faktorit të huaj, aty nuk ka mundësi kurrsesi që të angazhohet ndonjë intelektual i mirëfilltë, atdhetar i dëshmuar, por dërgohen "njerëz" servilë, që as i kanë mbrojtur ndonjëherë të drejtat tona kombëtare, as e bëjnë sot këtë punë të rëndësishme. Por, çka e bën edhe më të rrezikshme çështjen, është fakti se edhe nga qarqet e diplomacisë ndërkombëtare, më tepër se një decenie, në trojet shqiptare po vijnë "bedelët" e Maxhar Pashës, e tipave të "Marrëveshjeve" të arkitektëve Ahtisari dhe Çernomerdin & Co, kudo në trojet shqiptare.

Politika toptaniste e udhëheqjes së Tiranës, Prishtinës, Shkupit, i ka lënë shqiptarët vetëm në mëshirë të fatit!

Si mund të arsyetohet fakti fjala vjen, që në debatin për emrin e Maqedonisë, për historinë dhe për kulturën tonë nuk dëgjohet zëri i udhëheqjes "shqiptare", por për të gjitha këto çështje aq vendimtare për popullin tonë, vendosin apriori vetëm politikanët maqedonas dhe "aleatët" tanë.

Të mbytur në një letargji të pafalshme, po veprojnë edhe akademitë e shkencave në Tiranë dhe në Prishtinë.

A ka më mjerim politik se fakti, që kryeministri Sali Berisha, në kor me Ali Ahmetin, vajtojnë ditë e natë pse Maqedonia nuk u pranua në aleancën veri-atlantike! Pikërisht për këtë, këto ditë Ali Ahmeti deklaroi se qeveria e Shqipërisë është lobuesja kryesore që Maqedonia të pranohet në strukturat euro-atlantike…

Drenasi:: Dihet fakti se ne jemi vende fqinje. Mos vallë i shkon përshtati kjo mirësjellje e politikanëve në Tiranë dhe në Prishtinë popullit shqiptar në Maqedoni e Kosovë?

Zeqiri: Aspak! Kjo më përkujtoi rastin kur Sali Berisha qe i pari i cili në vitin 1993 e njohu Maqedoninë si shtet, pa asnjë kusht, as garanci për të drejtat e shqiptarëve, kur dihet fakti që shqiptarët janë popull shumicë në Maqedoni, me afër 40% (zyrtarisht 25%). Pastaj, qe pikërisht Sali Berisha - njëshi i politikës toptaniste në Ballkan, i cili e theu embargon tregtare me naftë: Serbi-Mali i Zi; në atë kohë nuk pranonte se po e bënte këtë, por kur kjo vepër e kriminalitetit ekonomik doli sheshit, ai tani deklaroi pa pikë turpi se "këtë e kam bërë për të mirën Kosovës".

Dihet nga të gjithë se Sali Berisha ka deklaruar disa herë, madje dhe në shtypin e huaj se "jam kundër ribashkimit kombëtar" dhe këtë përpiqej ta argumentonte me "faktin" se forcat që janë për bashkim kombëtar, nuk arrijnë as 2%, kurse tani bën demagogji politike, duke thënë se: "angazhohem për

bashkim kombëtar, por pa e cenuar sovranitetin e dy shteteve shqiptare në Ballkan”!…

Drenasi: Shtrohet pyetja: Si po u cenuaka sovraniteti i Kosovës, kur kjo i ribashkohet Shqipërisë?! Apo, si i rrezikohet sovraniteti Shqipërisë, kur asaj i ribashkohet pjesa e vet - Kosova shqiptare?!

Xhemil Zeqiri: Ndërsa Salua harron se Kosova tani është pa sovranitet, sepse Serbia çdo ditë po e shkel rëndë sovranitetin e saj.

Drenasi: Kur i thua këto, a mund të na argumentosh me fakte konkrete përse mendon kështu?

Zeqiri: Natyrisht se po! Shqiptarët brenda dhe jashtë atdheut pandalshëm e financojnë Maqedoninë. Megjithëkëtë, shqiptarët nuk kanë vende të hapura pune, nuk kanë bujqësi as industri të zhvilluar, të rëndë as të lehtë. Sepse, nuk mund të konsiderohet industri e zhvilluar p.sh. një dyqan zejtari: tekstil, këpucar, argjendar etj., si nisma të ekonomisë së vogël, prej të cilave vetëm shteti ka përfitime të mëdha. Prandaj, konsideroj që nga aspekti ekonomik jemi shumë të diskriminuar. Megjithatë, kjo popullatë e financon shtetin maqedonas. Pastaj, ne tani i numërojmë mbi 150.000 shqiptarë që jetojnë në mërgim! Ata, tërë kohën i derdhin mjetet e tyre financiare në bankat e këtij shteti.

Si shpërblim nga ky shtet kundërdemokratik, diskriminohemi në të gjitha sferat e jetës. Ndaj shqiptarëve lejohet anarki dhe ushtrohet trysni - kudo dhe kurdoherë.

Ithtarët e flaktë, “fundamentalistët partiakë”, këtë anarki e shfrytëzojnë për interesat e tyre dhe e konsiderojnë si vlerë demokratike.

Drenasi: Pse mendon që Kosova nuk ka sovranitet?

Zeqiri: Përderisa Kosovën e administrojnë OKB-ja dhe BE-ja sipas Rezolutës famëkeqe 1244, Kosova me këtë lloj "pavarësie të kushtëzuar" ka mbetur si i thonë fjalës: "as mish, as peshk". Pra, ka mbetur pa ushtri, pa gjykata të mirëfillta të drejtuara nga shqiptarët, pa diplomaci të mirëfilltë të drejtuar nga shqiptarët, pa ulëse në OKB. Si duket edhe këtu, qarqet ndërkombëtare po duan të bëjnë eksperimente me shqiptarët, duke mos u dhënë të drejtë për të vendosur në dikasteret ku veprojnë, që pushtetarët: pozitë-opozitë të mos kenë asnjë qëndrim të tyre që mund të realizohet. Atyre u lejohen vetëm ato qëndrime që i marrin të huajt, por jo vetëm kaq. Për ruajtjen e "status-quos", paqes në rajon, atyre u lejohen si shpërblim korrupsioni, kriminaliteti etj, etj…

Faktikisht, në Kosovë nuk ka opozitë të mirëfilltë që proteston për të drejtat e popullit.Me këtë rast po theksoj se opozitë e vetme dhe serioze që proteston për këto të drejta është Lëvizja Vetëvendosje. Nuk ka dëshmi më të fortë se kjo Lëvizje, kur vetë miku i "partive demokratike" ish-ambasadori i OSBE, Ëilliam Ëalker, deklaroi: "E vetmja opozitë në Kosovë është Lëvizja Vetëvendosje".

Drenasi: Këto ditë u festua tetë vjetori i "Marrëveshjes së e Ohrit", ndërsa kryetari i PDSH-së, Menduh Thaçi doli me propozimin që të bëhet një "Marrëveshje e re" me Maqedoninë, sepse "Marrëveshja e Ohrit" dështoi. Si mendon për këtë çështje? A u realizua kjo "Marrëveshje" dhe a ka të drejtë M. Thaçi?!

Zeqiri: Po, M. Thaçi ka të drejtë kur konstaton se kjo "Marrëveshje" ka dështuar. Por harron M. Thaçi se partia e tij ishte një përkrahëse e madhe e kësaj maskarade. Brenda këtyre viteve shumë herë jam prononcuar se kjo marrëveshje është vetëm një hedhje hi syve popullit shqiptar dhe asgjë të mirë s´do

të kemi prej saj. Kur them kështu, kujtoj se më shumë janë vrarë ish-ushtarë të UÇK-së pas luftës, se gjatë luftimeve.

Pra, e them me bindje të plotë se M. Thaçi dhe PDSH-ja nuk janë të sinqertë në politikën kombëtare. Ishte pikërisht PDSH-ja ajo që ishte në koalicion në qeverinë maqedonase, kur shqiptarët bombardoheshin dhe vriteshin nga qeveria PDSH-VMRO.

Menduh Thaçi kur flet për "Marrëveshje të re", manipulon me elektoratin shqiptar. Me këtë rast e përforcoj mendimin tim se ky dhe ish-udhëheqësi i PDSH-së, Arbën Xhaferi, e kanë një mani politike të përsëritshme, që kur janë në pushtet i harrojnë premtimet ndaj elektoratit, bëhen sylesh përballë padrejtësive, ndërsa kur kalojnë në opozitë fillojnë farsat "patriotike" dhe kinse shpikin ide të reja në dobi të popullit shqiptar.

Nga kjo konstatoj përsëri se "Marrëveshja e Ohrit" ka vdekur njëherë e përgjithmonë, duke u bazuar në dhunën e pandalshme që po ushtrohet ndaj fshatrave shqiptare mbi popullin e pambrojtur. Kujtoj këtu Sopotin, Brodecin dhe në fund çka është më tragjike, kur në sytë e policëve maqedonas dhe opinionit botëror, "komitët" maqedonas, të përbërë nga një grup i madh huliganësh prej mbi 300 vetësh, i sulmuan qytetarët shqiptarë rrugëve të Shkupit dhe në shtëpitë e tyre.

Drenasi: Kur jemi këtu te kjo "ide novatore" e M. Thaçit, me sa më kujtohet, për herë të parë këtë nismë e ka kërkuar politologu Bardhyl Mahmuti?

Zeqiri: Po, ashtu është! Mirëpo, siç e ceka më lart "pehlivanët politikë" këtë mjeshtri e kanë, t´ia vjedhin idetë dikujt tjetër. Mirëpo, mendoj se edhe vetë Bardhyli do të ishte i kënaqur sikur PDSH-ja do të arrinte të bënte ndryshime pozitive në favor të kërkesave legjitime që shqiptarët të jenë të barabartë me maqedonasit. M. Thaçi dhe partia e tij nuk mund të bëjnë ndryshime pozitive politike në favor të kombit shqiptar, sepse

qerren e kanë lidhur gabimisht, me ata që "hesapet " i bëjnë pa hanxhiun, kur vetëm para pak ditësh, ky servil politik, përkrah Ramush Haradinajt e përshëndetën "fitoren" e vjedhje-zgjedhjeve nga Sali Berisha.

Drenasi: Po si mendoni kështu kur ai, me ose pa probleme, me ndihmën e Ilir Metës e fitoi të drejtën për ta keq-qeverisur Shqipërinë edhe katër vite të zeza?

Zeqiri: Po, ke plotësisht të drejt! Sepse Saloja që prej viteve '90, kur erdhi në pushtet mbolli, dhe kam frikë se ende do të mbjellë, vetëm tragjedi për kombin shqiptar. Kujtojmë njohjen e Maqedonisë okupatore pa kushte, kujtojmë furnizimin me naftë për Serbinë, kujtojmë piramidat " e famshme" që e sollën Shqipërinë në prag të shkatërrimit, kujtojmë Otranton dhe fatkeqësinë e madhe të tmerrshme që e neveriti opinionin botëror, si ajo e Gërdecit. Ndërsa në "shpikjen" e "kombit kosovar" mund të konstatoj lirisht se edhe ky politikan i prapë ka gisht!

Unë habitem pakufishëm, si ka mundësi që gjenerali i famshëm në luftën çlirimtare, Ramush Haradinaj, duke ia njohur të gjitha këto krime e turpe, që këtu as po kemi mundësi t´i numërojmë të gjitha, të bëjë gabim të tillë fatal dhe ta´ia urojë "fitoren" e pushtetit, atij që nuk e meriton.

Nuk pajtohem me mendimin që Sali Berisha nuk e njeh politikën. Si sot më kujtohet kur me rastin e nënshkrimit të Rambujesë, i bëri ftesë publike delegacionit shqiptar në atë konferencë që të mos e nënshkruajnë, sepse kjo është tradhti kombëtare. Ndërsa tani, pa pikë turpi e mohon një apel apo një deklaratë të tillë aq famoze! Madje, u kthye në një vasal të krejt botës në dëm të kauzës shqiptare. Sali Berisha, me të dyja këmbët po e shkel Kushtetutën e Shqipërisë.

Propozoj që ne shqiptarët, brenda dhe jashtë atdheut të ngrihemi dhe të protestojmë kundër kësaj qeverie që po i bën

shkelje flagrante kushtetutës në fuqi. Ky "politikan i prapë" nuk e respektoi kushtetutën socialiste të dalë nga pushkët partizane, kurse tani e shkel edhe këtë kushtetutë të dalë nga votat popullore demokratike.

Drenasi: I nderuar, u thelluam në çështje të mëdha të pazgjidhura kombëtare, ndaj harrova të të pyes se si kalove gjatë muajit korrik në atdhe?

Zeqiri: Eh, si të të them, në vendlindje kalova mirë, u çmalla me të afërmit, me miqtë, me shokët dhe me shumë të tjerë. Mirëpo, duke u kthyer nga Tetova për në Prishtinë, sepse e kisha biletën e aeroplanit nga Prishtina për në Kopenhagë, kur arrita në pikën kufitare të Jazhincës, pashë se ajo tani ishte bërë pika më rrezikshme për kalimin e atdhetarëve shqiptarë. Ua përkujtoj lexuesve se kjo pikë kufitare u krijua që me njohjen e Maqedonisë së pavarur. Pra, aty më ndaluan, siç më kanë ndaluar disa herë, pasi emri im është i regjistruar në kompjuterët e kufitarëve si preson i papërshtatshëm.

Aty më arrestuan, me ç´rast ma morën telefonin, pasaportën, dokumentacionin dhe prisnin urdhër nga Ministria e Brendshme e Shkupit, si të vepronin, në rastin tim. Policët kufitarë më thanë se duhet të pres derisa të vijnë inspektorët e sigurimit maqedonas, nga Shkupi. Pas një pritjeje katër pesë orëshe, erdhën dy punëtorë të sigurimit. Ata më morën në pyetje disa orë. Natyrisht se interesoheshin për veprimtarinë time dhe të disa shokëve të mi.

U thosha se disa prej tyre i njoh, mirëpo pluralizmi politik disi ka krijuar përçarje midis ideve partiake, shokët e mi natyrisht se kanë ide të ndryshme, aderojnë në parti të ndryshme, prandaj jo rrallëherë ka raste kur shokët edhe po grinden midis tyre për këto. Unë jam nga ata që nuk dua të konfrontohem me njerëzit, e në veçanti me shokët, për të tilla mospajtime. Pastaj, kur e kuptova

qëllimin e tyre se ata interesoheshin të pyesin për njerëzit, ua thashë prerë: Unë, nuk mbaj mend se çka flasin njerëzit dhe nuk dua të bëhem papagall i tyre dhe unë u përgjigjem vetëm pyetjeve për veprimtarinë time politike dhe humanitare.

Nuk dua ta fsheh para lexuesve. Ata nuk më keqtrajtuan fizikisht për faktin që pranova të bisedoj edhe pa praninë e avokatit tim. Mirëpo, reagova atëherë kur ata m´i morën numrat nga celulari im. Pastaj më pyetnin për njerëzit, numrat e të cilëve ishin aty. Më skandaloze dhe anticivilizuese qe fakti që ata m´i morën edhe numrat e qeveritarëve, të gazetarëve dhe të miqve danezë.

Unë u thash: Jam i pastër si loti! Them kështu, sepse jam luftëtar i paepur ndaj padrejtësive kudo që ndodhin nëpër botë, ndaj falsifikimeve, veprave kriminale ekonomike dhe abuzimeve nga keqbërësit, si shpërndarja e drogës, prostitucioni e të tjera dukuri negative që janë të ndaluara me ligje ndërkombëtare. Pas tetë orësh më liruan për të udhëtuar në Prishtinë.

T´u them të drejtën, tërë kohën aty brenda isha i qetë, ndërsa, kur dola dhe po udhëtoja në pikën kufitare me Kosovën u ndjeva shumë keq, i shqetësuar, sepse m´u kujtua se kështu si mua, po i ndalin veprimtarët e Lëvizjes Vetëvendosje, si Albin Kurtin me shokë. Gjithashtu, kujtoj këtu faktin se sa shumë u revoltova kur pashë që në kufirin e Maqedonisë, të njohur ndërkombëtarisht plotësisht shtet i pavarur, ishin ca baraka të vogla, ndërsa në pikën kufitare të Kosovës, ende josovrane, ishin ngritur barrikada të pakapërcyeshme, marramendëse. Ndërsa politikanët kokëshkretë të “kombit kosovar” dhe ata “shqiptarë”, bëjnë zhurmë nëpër oda gjatë festave, dasmave e “mevludeve”, kinse jemi për bashkim kombëtar.I nderuar, të falënderoj për intervistën, ishte kënaqësi që ishim bashkë!

Fund

MOSMIRËNJOHJA – VESI MË I ULËT NJERËZOR

Intervistë në RTK - Radio emisioni "MË AFËR" 19 korrik 2015

TEMA: "Kontributi i bashkatdhetarëve tanë në mbrojtjen diplomatike të çështjes shqiptare"

DEMIR RESHITI: Mund të na thoni diçka për fillimet tuaja në emigracion?

XH. ZEQIRI: Ju faleminderit shumë për pyetjen. Do të doja edhe unë të flisja për këtë çështje sepse ka shumë të tillë që mendojnë se ne këtu, të gjitha i kemi gjetur të gatshme. Kur mbërrita në Danimarkë hasa në një mjerim total. Në mars dhe në prill të vitit 1981 në Kosovë shpërthyen demonstratat masive.

Në fund të vitit 1981 erdhi një delegacion i kryesuar nga një person i cili sot ka një post të lartë në Kosovë, me një delegacion të Beogradit dhe ish-kryetari i LPK-së Abdylhalim Kasami, i cili ishte edhe zëdhënës i Ali Ahmetit. Pastaj u bë edhe drejtor ekonomik dhe politik, u bë njeri me famë atje në Maqedoni. Ata mbajtën një mbledhje me bashkatdhetarët. Formuan dhe një klub të cilin e quajtën **Jugoklub** dhe **i dënuan demonstratat e pranverës së madhe të vitit 1981.**

Unë shpejt e konstatova synimin antikombëtar të tyre. Qëllimi i tyre ishte t'i frikësonin atdhetarët që i përkrahnin demonstratat. Në fillim, numri i tyre nuk ishte i madh. Ata kishin frikë nga shqiptarët e dyshimtë. Ambasada jugosllave ndërkaq i mbante shqiptarët nën syrvejim të vazhdueshëm, duke ushtruar njëherazi edhe presion permanent. Unë jo se isha ndonjë farë trimi, por u përpoqa t'ua bëj me dije shqiptarëve të këtushëm se kjo që thuhet nga këta vizitorë, fare nuk është e vërtetë, se Jugosllavia është një shelg si ato që mbillen rreth lumit, me gjethe që bëjnë shumë gjelbërim, por me

trung brendie të thatë. Pra është në shkatërrim e sipër. Ne duhet të punojmë për interesat tonë, në mënyrë që kjo situatë të mos na zërë të papërgatitur. Në atë kohë, shtypi danez nuk kishte njohuri të sakta për problemin shqiptar, ndaj unë fillova të vendosi lidhje dhe kontakte me gazetarë eminentë.

Brenda viteve 1985-86 themeluam një shoqatë shqiptare, në të cilën kam dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm, edhe pse kurrë s'kam qenë as anëtar i kryesisë. Objektivi im ishte që përmes kësaj shoqate ta sensibilizojmë dhe ta organizojmë masën, t'i tubojmë shqiptarët dhe në mënyrë ilegale të dalim në protesta. Duhej të bënim diçka në mënyrë që shtypi danez të ndërronte pikëpamjet për shqiptarët, ndërsa politika dhe diplomacia daneze t'i ndërronin qëndrimet për ne.

Të tregoj një rast kur shkova në Lidhjen e Shkrimtarëve të Danimarkës. I pyeta me ironi dhe me zemërim: Si është e mundur që një fëmijë danez të dijë se kush është **Nelson Mandela**, kurse një intelektual danez që ka shkruar 20-30 libra, nuk di asgjë për **Adem Demaçin**?!

Ata më thanë se për çështjet ndërkombëtare është kompetente Pen-Qendra daneze, ndaj më udhëzuan të shkoj atje. Sakaq shkova atje. Me të filluar biseda, të njëjtën pyetje ua shtrova edhe këtyre. E elaborova në hollësi edhe politikën kolonialiste të sllavëve ndaj shqiptarëve, të bazuar në ideologjinë anakronike **garashaniniste**. Personi me të cilin kontaktova më tha: "Edhe neve na intereson problemi shqiptar në Jugosllavi. Në kuadër të interesimit tonë është edhe z. Demaçi, ndaj lidhur me këtë tri herë i jemi drejtuar Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës dhe ja se ç'na kanë thënë:"Adem Demaçi është i burgosur politik, ka dy fëmijë, është i ndarë nga gruaja…"

Ja pra çfarë shkruante në atë letër, të nënshkruar me pakujdesi, saqë nënshkrimi nuk mund të lexohej. Nuk e di dot se kush e kishte shkruar atë letër. Në vijim ai më pyeti në ka mundësi t'u siguroj material për Adem Demaçin. Pikërisht në atë kohë ne e patëm organizuar 25-vjetorin e burgosjes së Demaçit, me ç'rast kishim

mbajtur dhe një debat publik në Danimarkë. U thash se material kemi, por në gjuhen gjermane. M'u përgjigj se kjo s'prish punë fare, ngase e njihte gjermanishten, ndaj materialin do ta përkthente në gjuhën daneze vetë ai. Pa një pa dy, i telefonova në Gjermani **Ibrahim Kelmendit** nga i cili kërkova që të m'i dërgojë dokumentet. Me të mbërritur dokumentacioni, ia dorëzova danezit. Ishte e premte. Pas dy ditëve, d.m.th. mbrëmjen e së dielës më bëri një telefonatë ish-sekretari i Pen-Qendrës daneze dhe më njoftoi se **në Kongresin e Holandës, nga Danimarka, nga Norvegjia dhe nga Suedia Adem Demaçi është shpallur anëtar nderi i Pen Qendrën daneze**.

Është për t'u habitur se si disa kuazi-intelektualë çfarë intrigash bënin. Në vend që t'i dërgonin veprat e Demaçit, i fshehin të dhënat për të.

Çështja tjetër ka të bëjë me **Ukshin Hotin**. Këtë po e them për herë të parë publikisht. Në fund të vitit 2000 organizova një debat publik në Pallatin e Kulturës në Tetovë. Isha i sëmurë, i shtrirë në spital, ndaj nuk munda të shkoj. Në vend timin, e çova sekretarin e Pen-Qendrës daneze, i cili njëherazi ishte edhe anëtar i kryesisë. Ai e kishte marrë fjalën dhe **grosso modo** e kishte elaboruar problemin shqiptar në Jugosllavi. Këtë takim e organizova nëpërmjet Shoqatës së ish të burgosurve politikë në Maqedoni. Nga qeveria daneze arrita të siguroj një shumë prej 3000 eurosh, të cilën ia dërgova shoqatës së sipërthënë, për të organizuar aktivitetin lidhur me Ukshin Hotin. Për të folur për personalitetin e kolosit të kombit, politologun dhe udhëheqësin e vërtetë të popullit shqiptar – Ukshin Hotin, kanë qenë të ftuar **Moikom Zeqo** nga Tirana, e **motra** e atdhetarit të madh, **Hidajet Hyseni** etj. Kanë qenë të ftuar edhe shumë intelektualë të tjerë nga Tetova dhe nga vise tjera. Fatkeqësisht, për fatin e këtij biri të shtrenjtë të kombit, sot e kësaj dite nuk dimë gjë.

Pas kthimit në Danimarkë, sekretari i Pen Qendrës daneze botoi një artikull të mrekullueshëm për kulturën dhe për traditat shqiptare në përgjithësi, për popullin tonë që synon lirinë. Në

artikull, një vend të posaçëm i kushtohej Ukshin Hotit. Midis tjerash, në të thuhej se këtë intelektual të shquar, shqiptarët e kishin në zemër.

Telefonuesi: Në qershor të vitit 1999, Hashim Thaçi erdhi në Danimarkë. Kam dëshirë ta dëgjoj nga Ju personalisht se kush e ka ftuar atë dhe kush e organizoi në atë kohë takimin e tij me kryeministrin e Danimarkës, ngase ka edhe informata se tjetërkush e ka organizuar. Ndërsa pyetja e dytë ka të bëjë me Valon Muratin. Gjatë vizitës së tij në Danimarkë, është takuar m Ju, si një person që e ka dëshmuar veten në të kaluarën, apo e ka takuar tjetër kënd?

XH. ZEQIRI: Në Danimarkë ka qenë jo vetëm Valon Murati por edhe Ibrahim Makolli më herët, me të cilin njihemi edhe më mirë. As Makolli dhe as Murati nuk më kanë takuar. Në të vërtetë ata kontaktojnë me disa persona të cilët nuk dinë se si të veprojnë. Vetëm ua bëjnë qejfin ministrave shqiptarë këtu, kinse janë faktorë dhe gjoja po bëjnë diçka për mërgatën apo se i ndihmojnë popullit, por në fakt nuk ka ndonjë sukses.

Tani t'i përgjigjem pyetjes Suaj të parë. Gjatë bombardimeve të NATO-së, më thirrën të Partisë Socialdemokrate, të cilët zakonisht i shqyrtonin problemet që kishin të bënin me luftën. **Erik Bool**, sekretari i përgjithshëm i Partisë dhe këshilltari i parë i kryeministrit danez më pyeti se ç'mund të bënte për mua? Unë i kërkova dy gjëra: e para, se Ukshin Hoti është i sëmurë, ndaj ta ndihmojmë për ta sjellë në Danimarkë për mjekim. Ndërsa kërkesa tjetër imja ishte që qeveria daneze ta ftojë zyrtarisht kryeministrin e Kosovës - **Hashim Thaçin** për vizitë zyrtare në Danimarkë. Danezi Erik Bol më tha se është problem të ftohet zyrtarisht Hashim Thaçin në Danimarkë, për arsye se Kosova ndodhet në luftë dhe se nuk është subjekt i njohur ndërkombëtarisht. Pra, nuk mund të bëhet një gjë e tillë. Por ka një mundësi tjetër me të cilën ne mund t'i bëjmë një pritje zyrtare Kryeministrit të Kosovës. Ardhja e tij do të kishte një domethënie të madhe për Kosovën dhe për luftën çlirimtare të saj, por edhe për shqiptarët në përgjithësi. Po qe se ti ke kontakte, vetëm

na njofto një javë më herët. Mjafton të vijë një ditë dhe ne i bëjmë pritje zyrtare. Të gjitha do t'i kemi në nivel të lartë. E mora telefonin, i bëra një telefonatë Ibrahim Kelmendit dhe ia sqarova çështjen. Kelmendit i pëlqeu ideja dhe më tha: "Urdhëro dhe bisedo vetë me Thaçin" dhe ma dha lidhjen me Kryeministrin. Hashim Thaçi mendoi se bëhet fjalë vetëm për ndonjë intervistë ose për ndonjë takim jo aq të rëndësishëm. Por unë ia bëra me dije se do të ketë takim me kryeministrin danez, me ministra. Do të ketë dhe konferencë për shtyp me kryeministrin, takime publike me diplomacinë daneze. I thashë se do të ketë hapësirë edhe në televizionin danez. Me fjalë të tjera, të gjitha që ua kërkova danezëve, ishin të gatshëm ta realizojnë. Ma dha këshilltarin e vet, Bilall Sherifin dhe me të e caktuam një datë. Kur i zhvilluam këto biseda, ishte ditë e hënë, ndërsa vizitën e caktuam për të martën e ardhshme. I pyeta nëse ka mundësi që vizita të realizohet për nesër një javë. E vazhdova komunikimin me telefon dhe pasi e mbaruam bisedën me Thaçin dhe Sherifin, kryeministri danez i dërgon e-mail dhe i thotë se kërkesa është miratuar dhe se vizita mund të realizohet në ditën e propozuar, ndërsa mua më tha të rri i qetë dhe shtoi**: "Mjaft je munduar deri tani. Ne do ta marrim në dorë këtë punë. Nëse ke ndonjë kërkesë, na trego, ne do ta plotësojmë për ty".**

Bilall Sherifi më dha mua një numër telefoni që të jemi në kontakt. Kur më dha një përgjigje shumë pozitive këshilltari i kryeministrit danez, mua më kapën ca djersë të ftohta, duke e ditur se shqiptarët me të cilët kam pasur punë dhe kontakte të shumta, nuk janë seriozë në punë dhe mund të ndodhë të gjejnë arsyetime të tilla si: më iku treni ose aeroplani. Unë e mora në telefon t'i them se kryeministri danez e ka verifikuar këtë dhe mos bëni ndonjë gabim. Pra, duhet të jeni seriozë në këtë punë.

Brenda tri-katër ditëve, mund të them se i kam telefonuar disa qindra herë, por ai nuk u paraqit dot. Ndërkohë Bilall Sherifi, rreth orës tre të natës - nëse nuk gaboj – më lajmërohet dhe më thotë:

Unë ty nuk të njohë. Ne e kemi atje kryetarin e LPK-së, kurse ti nuk je ndonjë i rëndësishëm!

Më erdhi shumë keq në atë rast dhe u zura shumë ngushtë. Ta pezulloj takimin e planifikuar, në mënyrë që mos të kompromotohem me danezët, apo ta realizojmë takimin e parashikuar?! I bëj një telefonatë Shaqir Shaqirit, konsulli i Kosovës në Suedi në qeverisjen e Bukoshit dhe i them atij në ka mundësi të vijë në Kopenhagë, për arsye se e kemi ftuar kryeministrin e përkohshëm të Kosovës - Hashim Thaçin dhe delegacionin e UÇK-së që të bisedojmë për hallet dhe çështje të tjera, e kështu me radhë. Ai më pyeti në kishte mundësi t'i dërgonim një ftesë. Ne ia dërguam ftesën dhe ai erdhi. Dhe kjo ka qenë e gjitha.

Pas 10 viteve unë kurrë s'kam rrahur gjoks se unë e kam bërë këtë. Kuptohet, dy ose tre shokëve ua kam rrëfyer këtë. Pas dhjetë vitesh dalin fjalë se kryetari i LPK-së Ibrahim Xhemaili paskësh qenë meritori dhe disa provokime të tjera në opinion. Kjo ka ndikuar që njerëzit apo veprimtarët të jenë ftohur. Ata tanimë nuk janë në nivelin në të cilin kanë qenë para luftës çlirimtare dhe pas saj.

Kësisoj është zhvilluar çështja e organizimit të takimi, në pika të shkurtra. Me fjalë të tjera, vizitën e sipërthënë e kam organizuar unë bashkë me këshilltarin Erik Bol. Për këtë i kam ftuar edhe **Visar Ymerin** dhe **Albin Kurtin** dhe u kam thënë: Urdhëroni tregoni se si ka ndodhur rasti i takimit me kryeministrin danez! Mua më habit fakti se si është e mundur që as Ibrahim Kelmendi, as Bilall Sherifi dhe as Hashim Thaçi të mos i thonë kryetarit të PDK-së në Danimarkë, Ibrahim Xhemajlit: Ngadalë burrë! Nuk mjafton vetëm të ngjeshësh kollaren, të futesh në delegacion dhe të thuash se ti je ai meritori.

D. R: Një përshëndetje nga Suedia na vjen nga dëgjuesi ynë i rregullt Fadil Shyti i cili shkruan: Ju përshëndes shqiptarisht ty Demir dhe bashkëpunëtorin shumëvjeçar Xhemil Zeqirin. Fadili ka një pyetje: Pse po na vonohet liria e plotë në të gjitha trojet e Shqipërisë

natyrale? Pse po na vonohet ribashkimi territorial i shqiptarëve, sipas parimit të së drejtës së kombeve për vetëvendosje?

XH. ZEQIRI: Unë dua ta përshëndes posaçërisht Fadilin, i cili gjithmonë më është gjendur si krah i djathtë. Kemi qenë bashkëpunëtorë shumë të ngushtë. Fadili më ka ndihmuar jashtëzakonisht shumë. Çdo shkrimi tim që e kam shkruar, ai i ka hedhur një sy. Unë kam ca të meta në drejtshkrim, sepse e kam kryer shkollën e mesme teknike në Gostivar. Shumë lëndë atje, i kemi pasur në gjuhën maqedonase. Rrjedhimisht, në lëmin e drejtshkrimit kam pasur ca dobësi. Kurrë s'më ka shkuar mendja se do të përmirësohem ndonjëherë apo se do të merrem me shkrime dhe do të botoj libra. Të gjitha shkrimet e mia më kanë marrë shumë kohë. Një shkrim që ti e bën brenda pak orësh, mua më duhen tri apo katër ditë për ta përpiluar. Pastaj unë ia dërgoj shkrimin Fadilit i cili e lekturon, pa ia humbur dhe pa ia ndryshuar esencën. Por, më duhet të shtoj se gjithmonë jam përpjekur të gjej kohë për t'i lexuar krijimet letrare artistike të rilindësve tanë si dhe të krijuesve letrarë të periudhave të ndryshme të letërsisë shqiptare, përfshi edhe studimet mbi historinë e popullit tonë. Leximi permanent më ka ndihmuar që në fushën e shkrimit të gjuhës sonë të bëj përparime evidente.

Të njëjtin problem dikur e kam pasur edhe me gjuhën daneze, ngase as këtë nuk kam mundur ta shkruaj mirë. Por kam pasur dhe kam shumë miq danezë të cilët vazhdimisht më kanë ndihmuar në këtë pikëpamje.

Sa i përket të drejtës sonë për **vetëvendosje**, është e vërtetë se armiqtë tanë janë shumë të egër, kanë edhe shumë miq ndërkombëtarë. Përpos kësaj, kemi edhe ca ferra të këqija që na e kanë zënë rrugën! Këto ferra duhet të eliminohen. Por tani është koha e demokracisë, ndaj populli duhet të vetëdijesohet. Është mirë të shohë se kush punon, përkatësisht kush vepron për çështjen kombëtare. Duhet të mendohet mirë se kush ka qenë dhe kush vazhdon të jetë meritor dhe jo ta japë votën për dy minuta, që pastaj 5 vjet ta kruajë kokën - sikundër thotë një fjalë e urtë popullore.

Të drejtën për **vetëvendosje** nuk e kanë shpikur shqiptarët. Unë në vitin 1997 i kam shkruar ministrit të jashtëm danez se, për të drejtën për vetëvendosje, shqiptarët janë të gatshëm të rrokin dhe armët. Dhe faktikisht nisi lufta. Me një fjalë, u bënë tri luftëra për të drejtën tonë historike për vetëvendosje. Fatkeqësisht, bashkësia ndërkombëtare na e mohon këtë të drejtë, duke nxjerrë lloj-lloj çështjesh dhe arsyetimesh. Më e keqja është tani se duke e krijuar këtë gjykatë speciale, edhe luftën duan të na e mohojnë.

Miqtë tanë ndërkombëtarë duhet ta dinë se problemi i shqiptarëve duhet të zgjidhet në bazë të **parimit të vetëvendosjes**. Ne nuk e kemi shpikur këtë të drejtë, ne nuk kërkojmë diçka tepër. Kur gratë në Portugali kërkuan referendum për të drejtën e abortit, u mbajt referendumi dhe u votua që ato të kenë të drejtën e dështimit. Atëherë pse shqiptarëve nuk u njihet e drejta për të vendosur për fatin e vet, duan apo nuk duan liri?! Kjo ka qenë ajo pikënisja ime, kur jam kyçur nëpër aktivitete dhe dorën në zemër, më kanë përkrahur shumë intelektualë, politikanë por edhe redaksitë e mediumeve daneze. Këtë çështje e kam shtruar, e kam shtjelluar dhe e kam elaboruar gjithmonë nëpër tryeza, nëpër debate, në polemika apo në artikujt që kam botuar gjithandej. Me fjalë të tjera, gjithmonë kam qenë i prirë nga e drejta për vetëvendosje. Pikërisht për këtë u bë dhe lufta. Dhe jo vetëm një luftë. U bë luftë edhe në Preshevë, Bujanovc dhe Medvegjë. Luftë u bë edhe në Iliridë. Nuk e di sa është i kënaqur miku im me përgjigjen?

D. R: Shpresoj të jetë i kënaqur me përgjigjen. Sidoqoftë, një përgjigje shumë e sinqertë dhe shumë e thuktë. Jeni shumë modest. Kjo ju bën njeri të madh dhe ju bën të t'ju çmojnë, natyrisht ata që ua dinë vlerat dhe virtytet njerëzore. Do të doja të merrja mendimin Tuaj rreth kërkesave për azil.

XH. ZEQIRI: Një gjë duhet ta kuptojmë: azil nuk japin. Perëndimi azil nuk jep sepse konsideron se problemi shqiptar në Ballkan është zgjidhur dhe sipas tyre, Kosova është demokratizuar. Për ta mjafton që procesi zgjedhor të realizohet sipas parimeve

demokratike dhe kjo tregon se është zgjidhur gjithçka. Me fjalë të tjera, ata nuk japin më strehime. Në këtë periudhë krize të rëndë ekonomike që ekziston kudo dhe jo vetëm në Ballkan, njerëzit mundohen të gjenden disi. Mirëpo duhet të kuptohet se nuk do të jepen më strehime. Emigruesit vetëm do të maltretohen nëpër kampe të azileve.

Telefonuesi: Ç' mendoni për gjakmarrjen?

XH. ZEQIRI: Gjakmarrja në pushtetin popullor apo në pushtetin socialist u ndërpre. Nëse ligjet bëhen më rigoroze, atëherë edhe dukuria e tmerrshme e gjakmarrjes do të reduktohet. Unë mendoj se ligjet në Shqipëri duhet të ashpërsohen ndaj kriminelëve, ndaj vrasësve që kryejnë krime, sepse vetëm pushteti mund ta ndalë gjakmarrjen. Siç thotë Demaçi, nëse pushteti ngre gishtin e krimit, atëherë gjakmarrja nuk ndalet. Kjo është një plagë shumë e rëndë e shoqërisë shqiptare, posaçërisht në periudhën e tranzicionit të madh në vitin 1991. Është një tragjedi vërtet e madhe që kërkon një zgjidhje të shpejtë. Zgjidhja mund të vijë vetëm nga pushteti dhe jo, siç tha telefonuesi - nga barinjtë. Ndryshe është kur një çështje e merr në dorë dhe i merr frenat në dorë pushteti. Përndryshe do të kemi anarki, siç e ndodh në Shqipëri gjatë tranzicionit. Kur një vrasje kryhet për lekë, atëherë korruptohem gjyqtarët. Sistemi i gjyqësisë është katastrofik dhe për këtë ka pasur edhe shkrime në shtypin danez. Organet e gjyqësisë nuk marrin masa të duhura dhe kjo është një tragjedi për shqiptarët. Por, mendoj se Partia Socialiste me aleatët do të marrin masa përkatëse për t'i dhënë fund kësaj dukurie makabre që ndodh në 25 vitet e fundit.

D. R: Kemi një pyetje nga një dëgjues i cili na shkruan: Desha ta pyes veprimtarin e devotshëm se si e sheh zgjidhjen e çështjes shqiptare në Maqedoni, posaçërisht pas rastit të Kumanovës?

XH. ZEQIRI: Ajo që ndodhi në Kumanovë ishte një tragjedi e planifikuar. Çështjen e Kumanovës më së miri e ka shpjeguar

Glauk Konjufca në Klan Kosova. Atje ndodhi një tragjedi e madhe. Me çdo kusht deshën që Kumanovën ta pastrojnë nga shqiptarët. Partitë politike shqiptare nuk janë duke e mbrojtur popullin tonë në Maqedoni. Ato punojnë vetëm për interesat e tyre ekonomikë dhe për interesat meskinë të klaneve të ndryshme partiake, ndaj mund të themi se gjendja e shqiptarëve në Maqedoni është më keqe se e shqiptarëve në Mal të Zi.

Nuk shoh ndonjë perspektivë në Maqedoni. Edhe pse shqiptarët e kanë Komunën e Tetovës në dorë si dhe shumë komuna të thera, shkollat, spitalet, çerdhet janë në gjendje katastrofike. Me një fjalë, situata është për t'u vajtuar. E vetmja gjë që kanë bërë partitë politike është se Bajramin e kanë bërë festë shtetërore. Është mjerim, është tragjedi dhe kjo situatë e paqëndrueshme kurdo duhet të zgjidhet.

D.R. Kemi dy pyetje nga dëgjuesit që na nxjerrin pak a shumë nga tema jonë, por unë do t'i lexoj e ju vendosni nëse dëshironi të përgjigjeni ose jo: Pyetja e parë është: Çka mendoni për udhëheqësin e Shqipërisë socialiste Enver Hoxhën; dhe pyetja e dytë është: Çka mendoni për të ashtuquajturin flamur të Kosovës apo më saktë - dhuratën e imponuar të Ahtisarit?

XH. ZEQIRI: Te flamuri i Ahtisarit nuk shoh ndonjë vlerë kombëtare. Unë për vete e kam flamurin kombëtar të cilin do ta mbaj gjithmonë në zemër . Pra, flamuri i shqiptarëve është ai i Gjergj Kastriotit. Simbol tjetër shqiptarët nuk njohin. Nuk na kanë mposhtur as turqit, as sllavët, ndaj nuk do të mund ta bëjë këtë as Evropa - të na imponojë flamuj të ndryshëm me ngjyra sllave apo joshqiptare. Për mua vlen vetëm flamuri kombëtar. Për të është derdhur gjaku, me të janë betuar ushtarët e UÇK- së të cilët nuk kthehen më në jetë dhe ky do të jetë flamuri ynë, sot e mot.

Sa për Enver Hoxhën, do të doja që këtë çështje ta elaboroj në mënyrë pak më të gjerë. Prej viti 1992, qarqe të caktuara bëjnë çmos t'i bindin shqiptarët që "ta hanë sapunin për djathë". Me shpifje të llojllojshme të sajuara nga intelektualë të ndryshëm, si në

Shqipëri, ashtu edhe në Kosovë, mundohen ta lansojnë tezën se Enver Hoxha ka qenë njeriu më famëkeq i kombit shqiptar. Por unë nuk u kam besuar këtyre përrallave që na i thonin intelektualët dhe politikanët. Ta elaboroj çështjen në disa pika të shkurtra: Që nga viti 1945 kur mbaroi Lufta e Dytë Botërore e deri në vitin 1990, ka pasur tre milionë shqiptarë në ish-Jugosllavi dhe tre milionë shqiptarë në Shqipëri. Të bëjmë një krahasim të vogël: Sipas disa analizave të **Komitetit të Helsinkit**, me sa di unë dhe në mos gabohem, në Shqipëri për 50 vite janë dënuar me pushkatim 3.400 vetë, ndërsa 4.000 të tjerë janë dënuar me shumë vite burg. Pra, nëse e kam bërë mirë llogarinë matematikore, bëhet fjalë për gjithsej 7.400 vetë. Secili prej tyre ka pasur nga 5 ose 10 anëtarë të familjes. Ta marrim mesatarisht nga 10 anëtarë të familjes dhe këto bëjnë 74.000 vetë. Le të kenë qenë rreth 100.000 njerëz të cilët kanë qenë të internuar. Ky ka qenë sukses i "diktatorit" Enver Hoxha, siç e quajnë disa intelektualë dhe politikanë.

Tani të kalojmë te shqiptarët e ish-Jugosllavisë, te Titoja dhe e bëjmë krahasimin midis Titos dhe Enver Hoxhës. Prej vitit 1945 deri në vitin 1990, me sa kam lexuar unë, në Jugosllavinë e Titos janë ekzekutuar 79.000 shqiptarë, ndërsa 350.000 shqiptarë janë shpërngulur me dhunë për në Turqi. Dihet mirëfilli se 1.500.000 shqiptarë janë shpërngulur "përkohësisht" në Perëndim, nga ku shumica nuk u kthyen kurrë më në vatrat e stërgjyshërve. Duhet shtuar se prej vitit 1991 deri më sot, Shqipëri kemi 20-30 parti politike. Po aq parti politike kemi edhe në Kosovë, në Maqedoni, Mal të Zi… Pra, në trojet shqiptare në Ballkan kemi mbi 50 parti politike – të mëdha apo të vogla. Këto parti politikë i kanë degët dhe nëndegët e veta. Çdo degë apo kryesi partiake ka së paku nga 10 anëtarë. Shumica prej tyre kanë të kryer fakultet. Megjithëkëtë, asnjëri prej tyre nuk doli të thotë një fjalë të vetme për ta zbardhur të vërtetën e hidhur për atë që bëri Titoja! Bëri ndaj shqiptarëve një **gjenocid** të pashembullt në botë. Përkundrazi, të gjitha këto parti politike e akuzojnë Enver Hoxhën, birin më të shtrenjtë të kombit, se paskësh qenë diktator. E akuzojnë njeriun që e mbrojti kombin, që siguroi mirëqenie kombëtare, që e mbrojti popullin shqiptar nga

shpërbërja. Rrjedhimisht, vetvetiu imponohet pyetja: ”Përse partitë politike shqiptare, intelektualët dhe politikanët heshtin para krimeve të Titos ndaj shqiptarëve, e në anën tjetër dalin me teza denigruese ndaj personalitetit të Enverit”?!

Unë i kuptoj miqtë tanë amerikan që e urrejnë Enver Hoxhën sepse kemi të bëjmë me dallime ideologjike, mirëpo udhëheqësit dhe politikanët shqiptarë duhet ta pranojnë se po të mos kishte qenë Enver Hoxha në **Konferencën e Paqes në Paris** në vitin 1946, interesat e Shqipërisë në Ballkan do të rrezikoheshin rëndë. Është i botuar fjalimi i Enver Hoxhës. Partitë politike apo liderët shqiptarë të sotëm, sot e kësaj dite, nuk kanë as 5 për qind kapacitet për ta thënë atë që e tha Enveri në konferencën e lartpërmendur. Pastaj duhet të theksohet lufta e Enverit **për mbrojtjen e pavarësisë së Shqipërisë, ndarja nga bashkimi sovjetik, nga Kina, nga jugosllavët, vetëm e vetëm për ta mbrojtur vendin**. Në Shqipëri janë bërë përparime të mëdha. Unë nuk mund ta kuptoj se si një intelektual, një profesor apo Sali Berisha merr guximin të flasë gjera të kota kundër Enver Hoxhës, kur ai vetë ka qenë në shërbim të sistemit dhe në shërbim të partisë.

D.R: Një nga librat që Ju keni botuar titullohet ‘Në mbrojtje diplomatike të çështjes shqiptare’. Ky titull pikërisht përputhet me temën të cilën po e trajtojmë sonte. Jam kureshtar të di, besoj edhe dëgjuesit dëshirojnë të dinë se çfarë keni shtjelluar në atë libër.

XH. ZEQIRI: Në atë libër kryesisht janë shtjelluar intervistat, debatet, letrat të cilat ia kam dërguar ministrit të jashtëm danez, kryeministrit danez, OKB-së, këshillit danez, Bashkësisë Evropiane… Ta marrim një shembull se si manipulojnë shqiptarët të cilët janë në shërbim të serbëve apo të maqedonasve nëpër ambasada. Në ambasadën maqedonase në Danimarkë gjithmonë na dërgojnë shqiptarë dhe masës i thonë se ky është shqiptar dhe duhet të përkrahet. Unë dal dhe them se Mr. Sami Ibrahimi ka qenë ambasador në Danimarkë. Gjatë luftës së 2001-shit në Maqedoni mbahej një samit i **Bashkimit Evropian** në Gëteborg. Samitine

udhëhiqtekryeministri i Suedisë **Goran Person**. Unë shkrova një letër dhe ia dërgova këtij. Në të flisja për situatën e shqiptarëve në Maqedoni si dhe për arsyet e shpërthimit të luftës atje. Atë letër ua dërgova edhe gazetave daneze që ta botojnë. Gazeta Politika çështjen shqiptare e kishte në fokus të interesimit të vet. Njëri prej drejtuesve të saj më tha se do ta botojnë letrën, por do të kishte qenë akoma më interesante sikur në gazetë të dilte edhe mendimi apo qëndrimi maqedonas. Më pyeti në kam mundësi ta gjej një maqedonas, i cili do të dilte me qëndrimet e veta. Unë u angazhova lidhur me këtë, por disa persona me të cilët njihesha më thanë: "Nuk mund të dalim publikisht, ngase do të biem në konfrontim me shtetin. Pastaj do të na ndjekin edhe neve, ashtu si të ndjekin ty". Pra, nuk guxonin. I tregoj kryeredaktorit të gazetës se nuk mund të gjej një të tillë, duke i shtuar: "E keni të lehtë. Merreni ambasadën maqedonase dhe bisedoni!" Ia tregova dhe numrin.Gazetari e merr në lidhje Sami Ibrahimin, ndërsa ky i thotë që t'i dërgojnë ftesë, e pastaj do t'u përgjigjet pyetjeve si përfaqësues i Maqedonisë. Gazetari nuk i tregon se letrën e kam shkruar unë, por i thotë se na ka ardhur një letër në redaksi. Do të ishte mirë që edhe ju të dilni dhe të mbroni tezën tuaj se përse luftohet në Maqedoni. Por ambasadori nuk guxon të dalë. Ai e kërkon letrën, në mënyrë që t'i përgjigjet asaj, por personalisht nuk guxon të dalë dhe të tregojë se përse bëhet lufta.

Unë kurrë nuk e kam ndarë Maqedoninë, Kosovën, Shqipërinë. Për mua gjithmonë kanë qenë një, të bashkuar. Kufijtë na i kanë imponuar të tjerët. Më 1991, partitë politike shqiptare, në vend që të imponohen me platformat kombëtare për ripërkufizimin e kufijve në gadishull, ato lejuan që të krijohen kufij të ri. Lëre se krijuan kufij të ri, por tani me këtë demarkacionin, duke u falur troje shqiptare pak Maqedonisë, pak Malit të Zi dhe pak Serbisë, janë duke rrudhur territorin e Kosovës. Edhe kjo që ka mbetur, duan akoma më shumë ta ngushtojnë.

Unë me të vërtetë nuk e kam të qartë se për çka flasin në emër të popullit këta. Lexoj disa artikuj ku thuhet se pozita dhe opozita

nuk po pajtohen për kufijtë me Malin e Zi. Përveç kësaj, duhet theksuar se një pjesë e madhe e shqiptarëve atje janë duke u asimiluar. Mali i Zi nuk u pavarësua pa votën e shqiptarëve, megjithëkëtë qeveria malazeze i përdor ata si mish për top, ndërkohë që qeveria e Shqipërisë dhe ajo e Kosovës nuk bëjnë asgjë për përmirësimin e pozitës së shqiptarëve në Mal të Zi. Këto gjera i kam diskutuar nëpër mediumet daneze dhe mund të them se nuk ka asnjë medium, gazetë, radio ose televizion që nuk ka bërë intervistë. Lidhur me problemin në fjalë, mediumet daneze i kanë botuar shkrimet e mia. Shesh ka ndodhur edhe të më kenë cituar.

Gjatë luftës në Kosovë kur doli UÇK-ja, filloi një fushatë e madhe kundër tyre. I quanin kriminelë dhe narkomanë, njerëz që merren me prostitucion, etj. Unë dola hapur, reagova ndaj një gazete të djathtë daneze dhe u them se unë me gruan time japim çdo muaj nga 2.000 euro. Ka pasur një debat të madh edhe ndër shqiptarë. Fondi **Vendlindja Thërret** brenda dy orëve ia doli të tubojë rreth 1.000 shqiptarë, me ç‘rast u mblodhën rreth 1.000.000 krona. Por për fat të keq, udhëheqësit e fondit Vendlindja Thërret i morën ato lekë dhe ia dërguan Qeverisë së Bukoshit. Shiko çfarë demagogjie! I lexojnë deklaratat e UÇK-së dhe aty për aty lind një fraksion tjetër. Nehat Zymberi dhe Muamer Seferi i Strugës, i marrin dokumentet dhe paratë nga Ibrahim Xhemajli dhe ia çojnë Qeverisë së Bukoshit. Sot e kësaj dite nuk kanë dhënë përgjegjësi se ku janë ato lekë, pse shkuan atje.

Në një mbledhje tjetër, gruaja ime i nxjerr dukatet që kishte në duar, në veshë, paratë e fundit që kishte në çantë, e merr mikrofonin dhe u thotë se a nuk është turp që njerëzit të cilët bredhin rrugëve me qibrita dhe sillen si mic-sokola, të thonë: “Ç’janë këto veprime?! Ne kemi qeveri, kemi president. Kush janë këta që duan të bëjnë luftë, që duan të na e prishin harmoninë...?!”

Gruaja u thotë: “Si nuk u vjen turp?! Atje bëhet luftë e ju paratë i çoni në Gjermani”. Pas dy apo tri ore vjen Ibrahim Xhemajli dhe na e kthen dukatin prapë. Ibrahim - i thash – ne nuk luajmë dot, gruaja i dha këto përfundimisht. Po ç’bëmë ne! Të

nesërmen, sapo u çel tregtiza e arit, vajtëm aty dhe e pyetëm se sa kushtojnë këto dukate. E dhamë arin, i morëm lekët dhe i dërguam atje.

Në Kosovë, por edhe këtu në diasporë, disa persona të UÇK-së kishin menduar se do krisnin ca armë, e pastaj do të vijë NATO-ja dhe do t'i zgjidhë problemet. Problemet nuk zgjidhen kështu. Problemet tona në të gjitha sferat e jetës, duhet t'i zgjidhim vetë, e jo t'i presim të tjerët.

D. R: Kemi një përshëndetje dhe një pyetje nga një dëgjues i cili pyet: Në cilin shtet në diasporë bashkatdhetarët kanë bërë më së shumti për çështjen e Kosovës?

XH. ZEQIRI: Nëse merret në aspektin diplomatik, në Danimarkë është bërë më së tepërmi. Në Zvicër kanë qenë më të organizuar, kanë pasur më shumë intelektualë. Në Gjermani gjithashtu. Por herë-herë, disa prej shokëve të **Lëvizjes**, shumë shpejt dështuan. Nuk e di pse ndodhi kjo.

Unë dëshiroj ta përshëndes **Prof. Dr. Muhamet Kelmendin** i cili qëndroi besnik, nuk u thye, nuk u përkul para stuhive dhe furtunave. Është i vetmi njeri që më ka dhënë përkrahje. Ka qenë disa herë nëpër debate publike. Ka qenë në **Këshillin për Politikë të Jashtme të Parlamentit danez**, ka mbajtur ligjërata, ka qenë nëpër intervista në studio televizive dhe në radio dhe kauzën tonë kombëtare e ka shpjeguar shumë mirë. Nuk di gjithaq se si janë zhvilluar proceset dhe veprimtaritë nëpër vendet e tjera, por në Danimarkë kësisoj janë zhvilluar. Ta përmendi një rast kur kam qenë bashkë me danezët, në kohën kur administrator i parë i Kosovës ishte francezi Benard Kushner, i cili pastaj dha dorëheqje. Ndërkohë nuk kishim administrator. Duke pirë kafe me sekretarin e Partisë Socialdemokrate e cila ishte në pushtet, e pyes se ç'do të bëhet me këtë? Ai qeshet dhe ma kthen: "A e di se kush do të jetë administrator i ardhshëm"? Jo – i them. Ai më thotë: "Do të të tregoj në besë, por mos e përhap. Do të jetë Hakerup". Ai ishte ministër danez i Mbrojtjes. Me të kam pasur një polemikë të ashpër,

me ç‘rast Hakerupi më quajti serb, duke shtuar se nuk qenkam shqiptar. Unë iu ktheva atij dhe i thash: “Më fal, por nuk jam serb, jam shqiptar, por nuk kam asgjë kundër serbëve. Jam kundër politikës serbe ndaj shqiptarëve, sepse ata në fakt janë duke bërë një gjenocid ndaj shqiptarëve.

Ishte fjala te intervenimi i NATO-s. Unë kërkova nga ministri danez i Mbrojtjes të na sqarojë se sa do të zgjatë ndërhyrja e NATO-s dhe si do të zhvillohen ngjarjet pas ndërhyrjes?! A do të na njihet e drejta të vendosim për fatin tonë, apo pas luftës do të na thoni që të ulemi dhe të bisedojmë me serbët se sa të drejta do të na japin ata?!

Unë në asnjë mënyrë nuk isha kundër. Edhe unë e kërkoja ndihmën e tyre, por jo të shtohet tragjedia mbi shqiptarët, sepse me planin që kishte përgatitur NATO-ja, mund të ndodhte t’u shtoheshin problemet shqiptarëve dhe zgjidhje nuk do të kishte. Hakerupi nuk e priste këtë nga unë, sikur u nxi në fytyrë. Unë i thash se fëmijët e mi e kishin bukën në mbrëmje, por 300.000 shqiptarë do të prisnin ndihmë nga NATO-ja dhe po qe se ndodh që tragjedia të thellohet, unë nuk do të mund të pajtohesha me këtë. Qëllimi im ishte që **kauza shqiptare** të zgjidhej njëherë e përgjithmonë, qoftë edhe në luftën çlirimtare të isha vrarë dhe unë.

Dhe tani shihet se unë kam pasur të drejtë. Tani këta të NATO-s mundohen ta shtyjnë Parlamentin e Kosovës që ta votojë gjykatën speciale. Kjo gjykatë, jam miliona për qind i sigurt, është një vetëvrasje për shqiptarët dhe nuk duhet assesi të pranohet. Miqve tanë amerikanë duhet t’u shpjegohet se ne i kemi miq, por miratimi i gjykatës speciale është katastrofike për ne, ndaj nuk mund të aprovohet një gjë e tillë. Nuk mund t’i themi çdo miku: po, po, po. Duhet të kemi një qëndrim. Pa qëndrim nuk shkohet përpara. E këta që udhëheqin sot, nuk kanë qëndrim. Këta dinë vetëm për PO dhe AMIN, e kjo nuk është në rregull.

D. R: Interesante kjo puna me Hakerupin sepse ishte njëri nga administratorët e dështuar!

XH. ZEQIRI: Kur më tha për Hakerupin unë i kërkova ta bëj një komunikatë për media. Ai nuk u pajtua, duke shtuar se **Kofi Anani** kishte vendosur qysh para dy muajve për Hakerupin, por Serbia nuk po e pranonte ngase kërkonte të arrihej një marrëveshje Hakerup-Çoviq, nëse ju kujtohet. Rrjedhimisht, u arrit një marrëveshje pas së cilës u hoqën nga lista e deputetëve **Rexhep Qosja**, **Ibrahim Kelmendi**, **Emrush Xhemajli** si dhe e disa figura të tjerë, të cilët ishin këmbëngulës që të ec përpara Kosova. Unë e theva besën me danezin dhe i bëra një telefonatë Nuri Bexhetit, i cili ishte këshilltar i Thaçit. I them: **"Mos e përhapni, por Kofi Anani ka vendosur për Hans Hakerupin si administrator të ardhshëm të Kosovës, të keni kujdes".** Por Nuriu menjëherë më thotë se mirë është, se ai ka qenë për intervenimin e NATO-s etj. Ai gruan e kishte ruse, ndaj nuk mund të jetë i mirë për shqiptarët.

Kur erdhi në Danimarkë, e botoi një libër dhe në promovimin ku ishin të pranishëm 300 vetë, gazetarë dhe intelektualë, thotë: "Shqiptarët në Kosovë nuk dinë se ç'është demokracia"! U çova unë dhe i thash**: "Ne nuk luftuam për demokraci, ne luftuam për çlirim kombëtar. Pa u çliruar nuk mund të demokratizohemi, nën okupim s'ka demokraci. Ne nuk jemi kundër Perëndimit, kërkojmë të na ndihmoni dhe të na udhëzoni se si të ecim barabar me ju, por jo të na pengoni".**

Në NATO janë shumë shtete dhe nëse e bëjmë një analizë, NATO-ja më shumë ka vrarë shqiptarë sesa ushtarë serbë. Unë nuk jam ekspert i luftës, por mund të them se intervenimi ushtarak i NATO-s më shumë i ka konvenuar Serbisë se Kosovës. Para bombardimeve të para, rusët dhe serbët nuk i kishin punët mirë. Rusët nuk e donin Milosheviqin, por kur ra bomba e parë e NATO-s, rusët u bashkuan. Në këtë moment dua të theksoj se televizioni danez tha se veprimtari Xhemil Zeqiri është kundër intervenimit ushtarak të NATO-s dhe kur erdhi puna që bombardimet të ndalen, erdhën e më thanë se tani bombardimet duhet të ndalen. Unë **thash jo, bombardimet duhet të vazhdojnë derisa Serbia ta ngrejë flamurin e bardhë, sepse problemi mbetet as mish as peshk. Më**

thanë - ti ishe kundër, tani je për?!Unë thashë se **kam qenë për,por jo si intervenim humanitar,sepse jo vetëm Milosheviqi, por politika serbe në 100 vitet e fundit i ka shkelur të gjitha të drejtat e shqiptarëve dhe kjo duhet të ndërpritet.**

Nëpërmjet **Komitetit të Kosovës** unë këmbëngula që të bëhet një **libër i bardhë** me dokumentet e Kosovës dhe t'u shpërndahet të gjithë diplomatëve, ambasadave dhe deputeteve të ndryshëm dhe këto i kam financuar të gjitha vetë. Pastaj u bë një libër tjetër "**Kosova, një konflikt i vjetër"**, pra jo konflikt nga viti 1989 kur u zhbë autonomia. Kosova ka qenë konflikt i vjetër, që nga viti 1913.

Në **Konferencën e Londrës**, delegacioni serb del në mënyrë demonstrative nga konferenca ngase nuk arriti ta marrë tërë Shqipërinë. Nëpërmjet shkrimeve dhe librave, unë jam i kënaqur se intelektualët danezë më respektojnë. Ka pasur shkrime për mua rreth problemeve sociale. Në një artikull theksohet se nuk jam vetëm një shofer, por jam një njëri tjetër me vlera dhe virtyte, i cili ka kontribuar jo vetëm për demokratizimin e shoqërisë shqiptare, por edhe të mbarë Ballkanit. Kam organizuar disa debate publike dhe dy konferenca ballkanike me danezët. Dhe kur UÇK-në e quajtën terroriste, e kështu me radhë, unë me disa organizata joqeveritare jam angazhuar dhe kam organizuar që në kuvendin danez të thirret **Nasim Haradinaj** si përfaqësues i UÇK-së. Në emër të **Unionit të Studentëve** erdhi **Driton Lajçi**. Dritoni mbajti fjalim dhe e përkrahu UÇK-në, ndërsa Nasimi nuk arriti të vinte në atë debat.

Sot e kësaj dite përmendet se si për herë të parë në kuvendin danez është mbrojtur guerilja për të cilën ende nuk është dhënë dritë e gjelbër si organizatë. Unë arrita që në kuvendin danez të debatohet dhe të legjitimohet UÇK-ja. Kur filloi lufta vinin shumë danezë që të **rekrutohen**. Unë e zgjodha njërin ishte (magjistër i drejtësisë) Juristi **Nis Herik Hogo** (vullnetar i UÇK-së). Ishte një magjistër. Mua më interesonte dimensioni politik i problemit. Më interesonte që një danez të kishte informata të sakta dhe të drejta për ne, në mënyrë që problemin tonë ta shpjegonte mirë në

Perëndim. Atë e dërgova nëpër intervista. Televizioni danez bëri një dokumentar për shkuarjen e tij në luftë në Kosovë, e kështu me radhë. Ndërsa sot dalin do individë dhe rrahin gjoks, duke thënë se si anëtarë të **LPK**-së kanë bërë këtë apo atë. Unë kam qenë anëtar i LPK-së dhe deri në vitin 1991, kur jam kyçur në **Këshillin për liritë dhe të drejtat e njeriut**, gjithmonë kam punuar në emër të **Lëvizjes** dhe jo timin.

PËR ÇËSHTJEN KOMBËTARE TË GJITHË DUHET TË PUNOJNË

Mysafir në studio të RADIO-KOSOVËS, Prishtinë, 14.06.2006

Gazetari Mentor MRIPA: Sonte nuk do të jemi vetëm, në studion tonë kemi mysafir. Jeta po i degdis shqiptarët gjithkund nëpër botë dhe ne shqiptarët gjatë jetës sonë patëm vështirësi, patëm trauma, gjithçka përjetuam dhe për arsye të ndryshme, mjaft prej nesh kanë shkuar jashtë atdheut, por ata vijnë na vizitojnë, faleminderit prej tyre dhe njërin prej tyre kam në studio, pavarësisht punës që kryen atje … Sonte nuk do të jemi vetëm, në studion tonë kemi mysafir.

Pavarësisht punës që kryen atje, ky merret edhe me punë kreative dhe shkruan vazhdimisht, është aktiv dhe sonte do të bisedojmë me të, kështu në këtë mënyrë do ta prezantojmë mysafirin tonë, do të flasim për punën e tij, por edhe për gjërat që na preokupojnë edhe për gjërat që ndodhin në vendin ku ai jeton. Tash do të thotë dikush, hajde më, tregona kush është se na i nxore veshët!

Dëgjues të dashur, mysafir në studion tonë është atdhetari Xhemil Zeqiri, i cili është nga Ilirida, nga katundi Zhelinë, rrethi i Tetovës.

Këtë burrë, jeta e largoi jo pak kohë larg vendlindjes, jeton në Danimarkë, konkretisht në Kopenhagë.

RADIO KOSOVA: Xhemil, mirëserdhët në studio!

ZEQIRI: Mirëmbrëma, mirë se ju gjej në studio të Radio Kosovës!

RADIO KOSOVA: Do t'ju them kështu, nuk do të fillojmë me zotëri e të tjera, do të mundohemi të jemi sa ma të lirë, ashtu siç

keni dëshirë ju dhe siç kanë dëshirë edhe dëgjuesit e Radio Kosovës, apo jo Xhemil?!

ZEQIRI: Natyrisht, më mirë është të bisedojmë lirisht.

RADIO KOSOVA: Ndjeheni mirë në studion tonë?

Zeqiri: Po, si në shtëpinë tonë.

RADIO KOSOVA: S´është hera e parë që vjen këtu, apo Zeqiri?

ZEQIRI: Jo, është hera e dytë. Kam qenë edhe më parë, kam biseduar me Sabit Ballabanin.

RADIO KOSOVA: Edhe atëherë keni kaluar mirë me Sabit Ballabanin dhe ne e përshëndesim Sabitin!Thashë diçka që u ndërlidh me këtë hyrje të emisionit. E dëgjuat me vëmendje ç'bëra? Të pëlqeu nga sfera gazetareske, ç`mendoni, t`u duk pak e gjatë hyrja?

ZEQIRI: Po tani ky është profesioni juaj, shumë mirë!

RADIO KOSOVA: Unë theksova se Xhemil Zeqiri, pavarësisht punës që ai po bën atje në Danimarkë - Kopenhagë, megjithatë kjo nuk ju pengon që të shkruani vazhdimisht dhe keni tre libra të botuar, apo jo?

ZEQIRI: Po, ashtu është.

RADIO KOSOVA: Kush është Xhemil Zeqiri, do të na flisni pak për ju?

ZEQIRI: Me origjinë jam nga Tetova, siç paralajmërove, nga një katund, quhet Zhelinë, nga rrethi i Tetovës, që tani është bërë edhe komunë më vete, jetoj në Danimarkë që nga viti 1981, në Kopenhagë, me punë jam marrë si punëtor, çka s´kam punuar atje,

punë fizike e të tjera?! Kam mbaruar shkollën e mesme teknike në Gostivar, jam marrë shumë me lexime, më ka interesuar më tepër çështja jonë kombëtare, politike, historike etj.

RADIO KOSOVA: Decentralizimin e keni realizuar mirë, apo si mendoni?

ZEQIRI: Po, decentralizimi është realizuar mirë edhe atje, në dëm të shqiptarëve, si çdo herë, me një fjalë është bërë komunë më vete.

RADIO KOSOVA: Observimet tua kanë qenë gjithmonë politike?

ZEQIRI: Po, politika neve na u është imponuar dhe si zakonisht, sipas mendimit tim, është më mirë të merremi ne me të, sesa ajo të merret me ne.Dhe është e pamundur që të mos të merremi me të, të futemi në analiza dhe studime të ndryshme e kështu me radhë.

RADIO KOSOVA: Dikush thotë se politika merret me ne, për shembull e di që është thënëkjo?

ZEQIRI: Deri në vitet 1985 merresha më tepër, kryesisht duke shpërndarë literaturë përparimtare, shpërndaja artikuj të gazetave të Shqipërisë, asaj kohe që kishin të bënin me çështjen kombëtare. Pastaj video kaseta.Merresha me komente, analiza, reagime etj., shpërndaja edhe këngë patriotike sepse mendoja se kështu po kontribuoj për ngritjen e vetëdijes sonë kombëtare, atje ku isha.

Pastaj i koordinoja veprimet edhe me shokët në Skandinavi. Vepronim, punonim për çështjen që na preokuponte.Më vonë i krijuam edhe degët e këshillave të LPK-së.Ky ka qenë edhe fillimi i aktivitetit tim në Danimarkë.Pastaj me shokët e lëvizjes ilegale filluan edhe punët të ecin më mirë.

Kam qenë veprimtar i Lëvizjes Popullore të Kosovës, deri në vitet ’90, por kur dolën në skenën politike edhe partitë politike, në Prishtinë u krijua edhe Këshilli për liritë dhe të drejtat e njeriut. Me dëshirë veprova edhe në aktivitetin e Këshillit derisa më ngarkuan edhe kryetar të këtij këshilli, dega Danimarkë.

Jam munduar të veproj ndershmërisht dhe shpresoj se ka pasur shumë suksese në Danimarkë, sepse në fakt të gjitha gazetat daneze kanë shkruar ose kanë i cituar burimet e Këshillit në Prishtinë, kanë bërë shumë intervista, si p.sh. radiot shtetërore dhe lokale dhe studiot televiziveetj. Po ashtu u kam ndihmuar edhe partive politik që u krijuan në territoret shqiptare,pavarësisht se ku vepronin, në tërë Shqipërinë etnike.

RADIO KOSOVA: Ju e quani kështu pra, Shqipëria Etnike, apo jo?

ZEQIRI: Po natyrisht, ashtu quhet. Edhe danezët e quajnë në shtypin e tyre Shqipëri Etnike. Pastaj kur atje shkruajnë për ne, shkruajnë: shqiptarët etnikë etj. Termin Shqipëria e madhe nuk e pëlqejnë.

RADIO KOSOVA: Por, ne jemi të ndarë!

ZEQIRI: Po, në aspektin territorial të ndarë jemi, por zemrat tona nuk guxojnë të ndahen, kemi një gjuhë, një flamur, një traditë, një kulturë dhe kjo është shumë mirë, këtë duhet ta zhvillojmë,të mos ua bëjmë armiqve qejfin, se ja shqiptarët e Shqipërisë kanë tjetër gjuhë, tjetër flamur dhe tjetër kulturë, kurse ata të Kosovës me visete tjera shqiptare, i kanë të tjerakëto pasuri të identitetit tonë kombëtar.

Ky ka qenë qëllimi i Serbisë dhe i shteteve të tjera armike, të na ndajnë e të na copëtojnë sipas planeve të vjetra serbe e të tjera.Pranuk duhet të biem në kurthet që po i shpikin për çdo ditë nacionalë-shovinistët serbë, kur trumbetojnë se ne nuk kemi asgjë të përbashkët me shqiptarët e Shqipërisë dhe ata të Iliridës etj. Këto qëllime armiqësore i dëmtojnë proceset integruese brendashqiptare

dhe kjo tendencë e rrezikshme duhet të luftohet me çdo kusht.Ne jemi një komb. Me një gjuhë, një flamur, një histori, një kulturë, një traditë etj.

RADIO KOSOVA: Mirë, deri në vitin 1981 ku ishit dhe ç'bënit ju?

ZEQIRI: Po, demonstratat e pranverës së madhe të vitit 1981 më gjetën në Danimarkë.Edhe unë, si të gjithë shqiptarët që ndodheshin të shpërndarë nëpër botë, i dëgjonim lajmet, por informatat ishin shumë të kufizuara,të njëanshme dhe të pasakta. Natyrisht,ne ishim të shqetësuar për atë qëndodhte dhe kërkonim informacione të sakta.

Pastaj, ishte ambasada jugosllave që me ndihmën e disa shqiptarëve "të ndershëm" po manipulonte me masën e mërguar. Këta shqiptarë "të ndershëm që ishin të shpallur dhe vepronin për interesat sllave, i kishin ca privilegje: nuk i ftonin në ushtri, në armatën jugosllave, nuk pagunin disa taksa, i ftonin në dreka e darka ku bëheshin ahengje.Jugosllavët organizonin disa mbrëmje gazmore, kështu që ata ishin kryekëput në shërbim të ambasadës sllave.

Kjo, natyrisht krijonte edhe urrejtje para masave të mërgatës sonë, por urrejtja shtohej kur këta u bashkoheshin disa personave apo delegacioneve nga Kosova, të ardhur së bashku me disa persona shqipfolës. I bashkoheshin korit të ambasadës jugosllave dhe mbanin disa mbledhje "informative" me mërgimtarët dhe përhapnin lloj-lloj dezinformatash kundër demonstratave heroike, i dënonin demonstratat duke thënë se ato nuk janë të organizuara nga populli i Kosovës etj. Këta natyrisht që ishin shërbëtorë besnikë të sllavëve, anëtarë të LKK-së ose të LKJ-së famëkeqe dhe kur takoheshin me shqiptarët,thoshin: "Ndaj demonstratave të keni kujdes, rezerva, sepse këtu ka dorë Serbia dhe UDB-ja".

RADIO KOSOVA: Mirë, dua të bëj një digresion këtu, sigurisht që ke lexuar edhe ti se edhe sot dikush thotë se

demonstratat e viti 1981 nuk i kanë organizuar shqiptarët, e të tjera e të tjera?!

ZEQIRI: Unë mendoj se është gabim të thuhet ashtu, sepse çdo përpjekje, çdo lëvizje që ka ndodhur dhe që ndodh kudo, që ka karakter të lëvizjes popullore, në radhët e saj mundtë futen edhe njerëz të padëshiruar, njerëz të shërbimeve të huaja, pse jo këtu edhe ato të shërbimit sekret serb, kur dihet se ato kanë qenë edhe vitet e mjaltit për ata shqipfolësit që ishin në shërbim të sllavëve. Dhe ata së bashku kanë mundur të hedhin ndonjë parullë, me tendenca që ta pengonin organizimin e demonstratave, këtu nuk ka dyshim. Por, të thuhet se janë serbët dhe UDB-ja që i organizuan demonstratat, kjo sipas bindjes sime është gabim,sepse si ka mundësi që UDB-ja të kërkojë që Kosova të fitojë statusin e republikës nga ajo që kishte autonomi.

Po, kam lexuar dhe kam dëgjuar,dhe më herët tregova sesi vinin titistët në Perëndim dhe e dizenformonin mërgatën tonë atje. Nëpër aktivitete ku marrin pjesë shumë njerëz, futen lloj-lloj agjenturash serbe e të tjera, që pastaj të kenë “argumente” që t´i luftojnë kërkesat mbarëpopullore.

Ne e kemi historinë jo të largët të luftës së UÇK-së, kur edhe nëpër konferenca shtypi, qyqarët politikë thoshin se djemtë tonë çlirimtarë janë dorë e zgjatur e Serbisë, thoshin që serbët po bëjnë provokime me njerëz të frustruar, e të tjera gjepura si këto.

Këto ishin intrigat që titistët i kishin mësuar në kurset famëkëqija të Kumrovcit dhe në këtë mënyrë ata i manipulonin masat e gjëra popullore. Pastaj dihet se ka pasur pasoja dhe do ketë, derisa populli ynë i shumëvuajtur të vetëdijesohet.

RADIO KOSOVA: Pse shkuat në Danimarkë, mos ishte diçka e veçantë atje?

ZEQIRI: Jo, shkurt unë u largova nga maltretimet e policisë maqedonase, sepse nuk është mirë të thuhet se nuk më kanë rrahur, sepse titistët, pra ata shqiptarët "e ndershëm" menjëherë fillojnë me

shpifjet e tyre dhe thonë: ”Ja, ky apo ai atdhetar, vetë ka deklaruar se nuk e kanë rrahur” e të tjera.Por, mua më izoluan, m´u ndalua të bisedoj me njerëz, me bashkëkatundarët e mi në rrugë. Pra, s´kisha të drejtën e komunikimit me askënd. Ashtu i izoluar nga njerëzit e dashur, pa dëshirën time, nuk munda të qëndroj, prandaj u detyrova të emigroj. Kur jemi këtu, do doja të them edhe diçka sesi po manipulojnë titistët me një deklaratë të simbolit të rezistencës, Adem Demaçit se paska deklaruar që ”për 28-29 vite nuk e paska rrahur policia jugosllave”. Këto janë intriga për manipulime, të atyre mjeranëve që vetëm presin ndonjë deklaratë të tillë dhe pastaj të fillojnë sulmet. Unëmendoj se e vërtetë është kjo: Adem Demaçi nuk pendohet se ka qenë nëpër burgje, me ca ndërprerje, plot 29 vjet. Përkundrazi, ai mbahet dhe ka të drejt të mbahet krenar, se ka kryer një mision historik, kombëtar dhe patriotik. Nga ky prizëm del qëndrimi i heroit tonë.

Adem Demaçi nuk dëshiron të tregojë për vuajtjet e tij, sepse nuk dëshiron të krijojë frikë e panik te disa, por do që popullit t´i japë guxim, rinisë heroike po ashtu, që ta vazhdojë më tej rezistencën deri në realizimin e të drejtave tona. Dua të kujtoj këtu që, me sa kam dëgjuar,Adem Demaçi gjatë atyre 29 vjetëve që hoqi burgjeve, ka qenë 5-6 vjet në izolim. Ishte ajo kohë kur titistët shqipfolës i kanë përjetuar muajt e mjaltit, në ato kohë ferri të vërtetë për ne shqiptarët.

Por unë nuk jam Adem Demaç, jam si jam. Njeri punëtor, flas ashtu siç e shoh dhe si e ndiej problemin.

RADIO KOSOVA: Po para se të shkonit në Danimarkë, a vepruat diçka në Tetovë?

ZEQIRI: Po, unë në fakt pata qenë dëshmitar në një gjykatë në Shkup dhe dëshmova për një rrahje masive në fshat. Kjo mjaftonte që policia të më quante me lloj-lloj epitetesh dhe të më ndiqte këmba-këmbës. Për mua u bë një jetë e padurueshme. Për këtë arsye u detyrova të largohem nga vendlindja, por me një qëllim dhe vetëdije se do t`i hakmerrem asaj politike antishqiptare që ndiqej në

Maqedoni. Për këto që ata bënë me mua, duke vepruar në këtë mënyrë.Të them të drejtën, prej kohës që kam shkuar në Danimarkë, kam qenë çdoherë i gatshëm për veprime dhe aktivitete në dobi të çështjes dhe tërë kohën jam munduar të bëj diçka. Në mbrëmje i parashtroja vetes pyetje: "A bëra sot diçka të mirë për atdheun dhe ç´duhet të bëj nesër". Pra i jepja vetes detyra të reja.

RADIO KOSOVA: Ishe me familje atje në Danimarkë?

ZEQIRI: Jo, kam qenë vetëm, më vonë krijova familje, u martova në vitin 1987.

RADIO KOSOVA: Pastaj e ndale veprimtarinë, apo jo?

ZEQIRI: Jo, përkundrazi. Do të ishte mirë që t`i bëni një pyetje gruas sime e cila shpesh po ankohet, sepse po na kushton çdo lloj aktiviteti, sepse ne jemi në kurbet të mbledhim ca lekë e t´i kursejmë, kurse ti vetëm po harxhon në aktivitet tua etj.

RADIO KOSOVA: Me fjalë të tjera, gruaja po të thotë se ti merresh vetëm me probleme politike. Zakonisht, shumë gra mundohen t'i pengojnë burrat e tyre.

ZEQIRI: Po, ashtu është. Ajo më thotë: "Vetëm ty të ka mbetur politika,vetëm ti merresh me këtë". Për çështjen kombëtare të gjithë duhet të punojnë. Jemi çliruar e ti nuk po pushon. Të gjithë kanë rregulluar shtëpi, e ti asnjëherë nuk pushove me fëmijët e tu, se vetëm për ty nuk janë punët mirë. Të tjerët u kënaqen, ataqë hynë në politikë, u bënë deputetë, ministra, drejtorë. I lan edhe kurbetet dhe janë bërë milionerë,ndërsa ne do të merremi tërë jetën me çështjen kombëtare. Po kur nuk u intereson atyre që marrin para e rroga, pse mua të më interesoj, e të tjera, të ngjashme, si gratë.

RADIO KOSOVA: Dalim te rënia e komunizmit. Të flasim pak për atë dhe si u bëre që të merresh edhe me të drejtat e njeriut në Prishtinë. Si u inkuadruat ju?

ZEQIRI: Po tani rënia e komunizmit... Nuk do të doja të flas për këtëngase nuk ka pasur komunizëm si sistem. Prej asaj kohe që u bëra aktiv edhe nëKëshill, unë kërkoja të bashkëpunoj me të gjitha organizatat dhe partitë politike, me Lidhjen e shkrimtarëve etj. Por Këshilli ishte më i interesuar për bashkëpunim me partitë ngase ato përgatisnin raporte të ndryshme, e kjo më interesonte edhe mua për të punuar me Këshillin. Në ato kohë ishte vala e aktiviteteve në Kosovë dhe u dashtë të koordinohen disa aktivitete,duhej dalë edhe legalisht, aq më tepër kur burimet na vinin nga Prishtina. Para saj kishim krijuar edhe një miqësi të ngushtë me danezët dhe krijuam edhe Komitetin ”Miqtë e Kosovës”. Si anëtar i Lëvizjes Popullore kisha bashkëpunim me qendrën e LPK-së. Komiteti luajti një rol të madh, duke bërë edhe demonstrata, debate publike, së bashku me PEN qendrën daneze dhe me organizata të tjera. Patëm organizuar edhe një mbrëmje kushtuar simbolit të rezistencës sonë kombëtare, Adem Demnaçit. PEN-ni e patsensibilizuar çështjen e shkrimtarit tonë – Demaçit edhe nëpër instancat evropiane.Më vonë Adem Demaçi shpallet dhe anëtar nderi i PEN qendrave skandinave dhe evropiane. Më vonë do t’i jepej edhe një mirënjohje ose **Çmimi Saharov**nga Këshilli i Evropës. Pastaj bënim peticione,u dërgonim letra të hapura politikanëve dhe institucioneve daneze dhe evropiane. Po ashtu, patëm botuar një përmbledhje dokumentesh për Kosovën që e quajtëm **Dokumentet e bardha të Kosovës**. Pastaj një libër me rreth 180 faqe **”Kosova një konflikt i vjetër”**, e të tjera. Pra, vitet 1988-89 ishin vala e aktiviteteve si në Kosovë, ashtu edhe nëpër botë.

Kryetare e Komitetit ishte akademikja Mina Skafte Jensen. Ajo e njeh mirë problemin shqiptar. Ka qenë disa herë edhe si eksperte në Universitetin e Tiranës, pastaj në Athinë, Beograd.

Është një njohëse e mirë e problemit të Ballkanit në përgjithësi dhe atij shqiptar në veçanti. Pastaj kemi edhe një gazetare daneze e cila e ka studiuar edhe gjuhen shqipe ne Tiranë në vitet 1981-82. Të

gjitha shkrimet kjo i ka përkthyer, pa asnjë lek ose ndonjë interes tjetër.Kjo mikee shqiptarëve -**Lotte Rudof Madsen** kërkoi nga Komiteti që Adem Demaçit t´i jepet emri **Mandela i Kosovës**. Posaçërisht, veprimtari i njohur danez, mik i shqiptarëve, **Jorn Pederseni,** së bashku me gruan e tij **Marianën**, vepronin pa pushim për t'i ndihmuar popullit shqiptar në Kosovë.

RADIO KOSOVA: Po viti 1989 nuk ishte konflikt, por ishte luftë, apo jo?

ZEQIRI: Natyrisht, ajo ishte një kryengritje popullore, derisa ka gjakderdhje, ka protesta masive popullore e të tjera. Atëherë u mor kushtetuta me tanke. Me të drejtë u quajt nga**"Zëri i Popullit"**- kushtetutë e tankeve. U vranë më shumë se 23 vetë, qindra u plagosën dhe qindra e mijëra u arrestuan. Pra ishte një kryengritje popullore, i tërë populli ishte çuar në këmbë dhe kërkonte të drejtën e vet që i takonte.

Në fakt, organizata e Lëvizjes Popullore u dashtë të luaj një rol më të fuqishëm konstruktiv, për t`i dalë popullit në ballë dhe ta udhëhiqte në mbrojtjen dhe në organizimin e masave popullore. Por,ata e lanë popullin, të them, ashtu në stihi. Prandaj populli pa kontroll, i thërriste ata që nuk do të duhej të thirreshin: Azem, Kaqusha. U thirrën ata të cilët e mbronin autonominë e vitit 1974 dhe në fakt ishin kundër Republikës së Kosovës. Kështu u bë një prapakthehu në ecjen tonë drejt lirisë. Në vend që ne të kalonim fuqishëm në kërkesën për **republikë**, ne e mbronim autonominë, meqë i mbronim zëdhënësit e saj.

RADIO KOSOVA: Ta ndërpresim bisedën këtu. Do të dëshiroja ta dëgjojmë një këngë, sepse folëm pak si shumë dhe do jetë mirë ndoshta për dëgjuesit tanë mos t'i lëmë vetëm me fjalë. Mysafiri ynë Xhemil Zeqiri e ka zgjedhur këngën. Kjo do të thotë se nëse ka akuza, pra nuk ju pëlqen kënga, atëherë akuzojeni mysafirin e jo mua… Pra kënga "Jam shqiptar i Shqipërisë së

vjetër" e këndduar nga këngëtarja tropojane Dava Gjergji. Është kënga e parë. Pra këtë këngë e ke zgjedhur, apo jo Xhemil?

ZEQIRI: Ashtu pra. Edhe unë, i Shqipërisë së vjetër jam. Ilirida është e Shqipërisë së vjetër, apo jo?

RADIO KOSOVA: Mbetëm te vitet ´89 -´90. Ju iu përveshët punës!?

ZEQIRI: Po! Gjithnjë në veprimtari kombëtare! Me shoqatat, Lidhjen e Shkrimtarëve. Kërkoja materiale për shkeljen e të drejtave të njeriut. Kjo pati ndikim pozitiv sepse shumë shoqata e parti në Danimarkë kanë marrë intervista dhe materiale prej meje. U kam ofruar materiale me shumë argumente edhe parlamentarëve danezë të cilët merren me politikën e jashtme, konkretisht me Ballkanin. Ata i kanë ato dokumentacione dhe shumë prej tyre më janë falënderuar për veprimtarinë e Këshillit të të drejtave dhe lirive të njeriut (KDLNJ) në Danimarkë.

Më vonë krijuam lidhje edhe me Sindikatën e Pavarur të Kosovës (SPK). Unë isha i interesuar shumë që edhe partitë politike simotra në Danimarkë, të kontaktojnë me partitë tona në Kosovë. Por, për habi, partive politike në Kosovë nuk u interesonte fort kjo. Ato preferonin më shumë të merreshin me gjëra të kota atje. Kujtoj këtu faktin...

RADIO KOSOVA: Pse partitë nuk donin kontakte? Pse thua merreshin me gjëra të kota?! Kështu nuk mund të thuhet sepse ne kemi qenë në okupim total apo jo?

ZEQIRI: Po, në okupim total klasik kolonial. Të gjitha qëndrojnë. Por, unë do t´ua them vetëm një shembull. Unë kisha kontakte shumë të frytshme, por kur erdhi Partia e Prosperitetit Demokratik (PPD) të formojë nëndegë në Danimarkë, atyre nuk u interesonte të kontaktojnë me masat popullore. Atyre u interesonte t´i krijojnë këshillat e Partisë, degët e saj dhe pastaj të mblidhnin të holla. Roli i tyre qe rol i gjykatësve. Ata merreshin me të kaluarën,

me të vdekurit, kurse të gjallët i lënin në mëshirën e sllavëve. Ata atëherë, pa pikë turpi thoshin: **"Kosova nuk është e okupuar, Shqipëria është e okupuar".**Ata bënin thirrje: "Ta çlirojmë Shqipërinë, pastaj i rregullojmë punët, i qesim në rend, në terezi", etj, etj.

Unë, me kohë jam distancuar me ato parti, bile kam pas edhe polemika, atyre u thosha: "ju po merreni me të vdekurit, e të gjallët po ua lëni sllavëve t´i torturojnë e t´i masakrojnë!

Kur e kisha përballë meje gjithë atë shumicë, ndofta ndonjëherë mendoja se po bëja gabim por, më vonë u pa se aspak s´kisha gabuar; sepse ata vërtetë ishin të tillë, atyre nuk u interesonte që proceset të ecnin përpara!

RADIO KOSOVA: A mendoni që në botë, ne shqiptarët (që nuk jemi aq shumë), pavarësisht dëshirave tona,a mendoni pra se kanë qenë e domosdoshme të formohen degët e partive, pavarësisht të cilës pjesë të viseve shqiptare? A do të ishte më mirë të quhej p.sh "Liga shqiptare e të mërguarve" apo ndonjë tjetër emërtim i ngjashëm?

ZEQIRI: "Qendra Informative", do të mjaftonte apo Këshillat për të drejtat e njeriut, pastaj nëpërmjet tyre të depërtonim, por politikanëve nuk u interesonte që të ecim përpara, atyre u interesonte mbi të gjitha që të shtypen ata të cilët mundoheshin të merrnin kontakte me gazetarët e politikanët e huaj, pra të mbytej mendimi i lirë. Do të them një rast konkret. Pas një kohe kur u formua PPD-ja në Danimarkë, ata kishin të holla, por pastaj i morën edhe të hollat që kohë më parë i kishin mbledhur mërgimtarët për veprimtari atdhetare.

RADIO KOSOVA: Nëse nuk gaboj në zgjedhjet e para në Maqedoni e ka fituar pushtetin PPD-ja?

ZEQIRI: Po! Bile erdhën mërgimtarët me aeroplanë specialë, me makina, në grupe të ndryshme që t´ia jepnin votën PPD-së.

Mirëpo, u bë një dredhi e madhe ndaj kësaj partie, ndaj popullit i cili atëbotë s´ishte në gjendje ta kuptojë. Paramendojeni, dolën atje 23 deputetë, kur për Xheladin Muratinduhej të votonin 22.000 votues,ndërsa për 1 deputet maqedonasnevojiteshin disa herë më pak votues.Kësaj i thonë barazi?!Edhe pse populli vinte prej Danimarkedhe vendeve të tjera për të votuar, kjo nuk kishte sukses, sepse ata e kishin përcaktuar numrin sesa deputetë të hynin në parlamentin maqedonas. Këta ishin ata "shqiptarët e ndershëm" që nuk ua prishnin aspak planet maqedonasve, se fundi i fundit unë, duke pasur shumë kontakte me partitë politike, e kam fituar bindjen, pra kam ardhur në përfundimin se partitë politike të krijuara para luftës çlirimtare, ishin të krijuara me bekimin e politikës dhe të policisë serbe, maqedonasedhe malazeze. Kam përshtypjen se ato ishin nën kontroll të plotë. Ajo parti legale që nuk ka qenë nën kontroll para luftës, ka qenë Uniteti Kombëtar (UNIKOMBI). Atëherë u zgjodh kryetar i madhi **Ukshin Hoti.** Me sa më kujtohet ai e pranoi detyrën në ora 12, ndërsa pasi përfundon mbledhja në ora 07, e arreston policia dhe sot e kësaj dite nuk dihet ku është, ku mbahet i izoluar. Kemi shpresa se jeton diku! Unë i kam shkruar për këtë atdhetar të madh, Karla De Pontes, i kam mbledhur 300 nënshkrime, ndër ta edhe shumë intelektualë danezë, grupe parlamentare etj.

Pastaj kemi shkruar një peticion që Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës të interesohet më tepër, por në politikë nuk paska mëshirë! Në politikë ka vetëm interesa! Gjatë veprimtarisë sime jam duke mësuar dhe duke kuptuar çdo ditë e më shumë se nuk duhet t´u besojmë shumë fjalëve, por vetëm veprave.

RADIO KOSOVA: Sa ishte faktor dhe sa mund të luante rol Danimarka në shpejtimin e këtyre proceseve të përgjithshme?

ZEQIRI: Danimarka zakonisht ka luajtur një rol të madh. Dua të kujtoj se kur ishim në Komitetin "Miqtë e Kosovës", ne në atë kohë shkuam nëpërmjet institucioneve daneze dhe kërkuam nga forcat politike në parlament që ata ta ftojnë zyrtarisht në vizitë

simbolin e rezistencës sonë, Adem Demaçin. Baci Adem erdhi me ftesëne Komitetit "Miqtë e Kosovës". Ai në Danimarkë e mbajti një fjalim historik, bëri debate me të gjitha forcat politike në parlament , me ekspertë të politikës etj. Me sa di, ka qenë viti ´93. Baci Adem i shpjegoi realisht problemet dhe kërkoi nga danezët që të ndihmohet Shqipëria në atë kohë, të ndihmohet Kosova, që atje të vijnë grupe politike, të shohin se në çfarë shtypjeje dhe mjerimi jeton populli shqiptar, i okupuar dhe i kolonizuar egërsisht nga politika serbe.

Një dëgjues: Jam Hysen Durmishi nga katundi Mushtisht i Therandës. E përshëndes mikun tim Xhemil Zeqirin! Urime! Falënderime! Suksese!

ZEQIRI:E kemi obligim kombëtar o vëlla! Pra, Adem Demaçi kërkoi që grupe parlamentare daneze të shkojnë në Kosovë dhe ata pranuan. Unë, pa humbur kohë, u dërgoj një letër dhe i pyes: Hë, çka u bë me ju?

Ndërhyn një dëgjues! Mentor Mexhuani këtu! Përshëndetje! Ju njoh përmes tre librave që keni shkruar dhe përmes shumë shkrimeve që po i shkruani.

RADIO KOSOVA: S´kemi ardhur ende te librat!

Pyetja e dëgjuesit Mexhuani: Çka mendon mysafiri, a është duke u tallur bashkësia ndërkombëtare me ne? Kur e them këtë, po i paraqes këtu këto argumente. Nga 50 shtete të botës që ishin pas Luftës së Dytë Botërore, tash janë 190 shtete, rreth 70 shtete janë më të vogla se Kosova dhe janë të pavarura.

1. Kosova, gati më së paku në botë është multietnike. Kosova veriore, Albaniku, Zveçani e Zubin Potoku, 63,2% kanë qenë të banuara me shqiptarë, deri në luftën e fundit çlirimtare.

2. Pse Letonia me 56% letonë, nuk quhet multietnike dhe asnjë shtet në botë nuk quhet multietnik, përpos Kosovës?

3. Pak na copëtoi bashkësia ndërkombëtare në favorin e Serbisë, Malit të Zi dhe Greqisë më 1878-1912dhe ende kjo po nxiton të na copëtojë me decentralizime, prona kishtare dhe kompromise të tjera. Logjikuar nga këto pyetje që i parashtrova, kam edhe një pyetje:

4. A kanë moral kombëtar udhëheqësit tanë t´i thonë vetes udhëheqës të Kosovës, pozitë opozitë, kur mysafiri që e keni ju sonte aty e ka një shkrim me titull: *"Kosova dhe problemi shqiptar është kthyer në vitet '50"?!*

ZEQIRI: Këto ishin pyetje shumë të qëlluara, të përgatitura. Do të jem i lumtur sikur të gjithë shqiptarët e Kosovës të kenë një vetëdije që e ka Baca Merxhan.

Është e vërtetë se bashkësia ndërkombëtare po bën një tallje të madhe cinike me ne shqiptarët, si para luftës,ashtu edhe pas luftës çlirimtare. Prandaj, unë kam pasur debate nëpër gazeta me këta politikanë, me ç´rast u kam thënë hapur: Sipas jush dhe sipas politikës evropiane, Serbia që e ka bërë terrorin që nga viti 1913, e paska bërë me ndihmën tuaj! Ata reagonin: Jo s´është e vërtetë!

Ata kërkojnë nga ne që të jemi popull i qëndrueshëm, të durojmë, të besojmë në demokracidhe kinse pastaj nuk do ta lejojnë Serbinë të veprojë si ka vepruar! Sipas tyre, sistemi pluralist do të jetë një mrekulli e Zotit, e ku di unë çfarë.Ne shqiptarët do të jemi të pranishëm në Kosovë, Serbia nuk do t´i shkelë më të drejtat tona – thonë ata! Këto vetëm kanë qenë dhe janë ca tallje, por për fatin e keq, këto broçkulla dikush i kapërdin - siç ka thënë edhe Baca.

RADIO KOSOVA: *A kanë qenë politikanët tanë para aktit të kryer?*

ZEQIRI: Edhe kanë qenë! Sepse, siç theksova më herët, ato partitë politike kanë qenë të përgatitura mirë, kur potencova se ato nuk mund të krijonin parti të shëndosha, sepse anëtarët e tyre ishin dikur ish LKJ-istë. Pastaj dolën në ballë duke përfshirë këtu edhe

disa ish-të burgosur politikë, apo ish-udhëheqës të demonstratave të vitit 1981 e më tutje. Ata e kanë pasur detyrë para liderëve të tyre të distancohen nga e kaluara "e hidhur revolucionare" apo nacionaliste, siçe quajnë ata.

Unë kam informata se, për t´u futur në këto parti, ata (çlirimtarët) është dashur të flasin keq e më keq për regjimin komunist të Shqipërisë, për Enver Hoxhën, edhe pas vdekjes së tij fizike. Unë dëshiroj që ne të merremi me njerëz të gjallë por, nuk e dija kush dhe çka i detyronte këta, të distancohen nga politika shqiptare e saja kohe, e cila për mendimin tim, ka pasur një politikë të qartë për zgjidhjen e problemit shqiptar në trojet tona.

RADIO KOSOVA: Këtu ka shumë dilema edhe për këtë.

ZEQIRI: Natyrisht, argumentet flasin për bindjen time. Shkopi ka dy anë, nga ta marrësh për t´u shërbyer, thjesht, plus minus. Megjithatë, unë mendoj se nga politika reale që është udhëhequr deri sot, më të mirë se ajo nuk ka pasur. Pavarësisht se ai ka qenë një shtet i izoluar nga Perëndimi.

RADIO KOSOVA: *Shtet komunist, shtet ideologjik, shtet ateist etj etj.*

ZEQIRI: Po, megjithatë s´ka qenë i vetëm, sepse blloqet në Jaltë u ndanë në dy sfera të interesit. Dihet që Shqipëria u pozicionua në anën e shteteve socialiste. Unë kujtoj një rast interesant që i ka ngjarë Ukshin Hotit,kur ishte në studime në Amerikë. Ai kishte kontakte të mëdha me politikanë, udhëheqës etj etj. Ai shkruan se atyre u ka thënë se gjithçka do të jetë në rregull. Bile u thotë që Enverin ma lëni mua, unë merrem vesh me të, veç ta bëjmë Shqipërinë të ribashkuar. Ne do të kalojmë në sferën e interesave kapitaliste. Mirëpo, thekson Hoti, amerikanët nuk kanë dashur. Nga kjo kuptojmë se amerikanët kanë dashur vetëm të bëjnë eksperimente me ne në atë kohë.Bile sot e kësaj dite ata vazhdojnë t´i bëjnë ato eksperimente me shqiptarët në Ballkan.

RADIO KOSOVA: *A jemi edhe ne fajtorë?*

ZEQIRI: Po, natyrisht jemi, sepse ne shqiptarët shumë u besojmë fjalëve të mira. Ne duhet t´u besojmë veprave.

RADIO KOSVA: *Për shtete më të vogla se Kosova që e kanë marrë pavarësinë, a do ta komentosh këtë, Mali i Zi, p.sh.?*

ZEQIRI: Jo vetëm shtete që kanë marrë shtetësinë, pavarësinë etj. Unë kam shkruar edhe në librat e mi, kam kërkuar nga politika ndërkombëtare që shqiptarëve t´u lejohet e drejta për ***vetëvendosje***. Kam kërkuar nga ata të na përgjigjen pse na ndalohet neve kjo e drejtë?! Unë vetë nuk mund ta përcaktojnëse do populli i Kosovës pavarësi apo. Unë jam për vetëvendosje.Pastaj, të shihen situatat në Evropë dhe në botë si na leverdisin neve, si lëvizin.Sot për sot, nuk është interes i Evropës që të krijohen dy shtete shqiptare në Ballkan. Këto dy shtete shqiptare i kushtojnë shumë, edhe Shqipërisë edhe Kosovës, por edhe bashkësisë ndërkombëtare, botës.

RADIO KOSOVA: *Ne po pretendojmë se jemi për pavarësi.*

ZEQIRI: Pikërisht, këtu është ai lloj i pavarësisë, me kokën nën Serbi, pra siç thotë bashkësia ndërkombëtare, pavarësi e kushtëzuar.

Agroni 1: *Në lidhje telefonike paraqitet një dëgjues, quhet Agroni: Thërras nga Gjermania, jam ithtar i madh i politikës kritike, i kritikës sipas masës. 1. A mendon bashkëbiseduesi juaj se kjo rezistencë e tillë i ka edhe mangësitë e mëdha?*

ZEQIRI: Mangësi ka shumë, i nderuar! Sot, politikanët shqiptarë janë bërë shërbëtorë të mjerë në institucionet sllave, kudo në trojet shqiptare, edhe atje, në atë Shqipërinë e shkretë që u shkatërrua nga politikanët kokëfortë, të cilët mendojnë vetëm si të korruptohen, si të përfitojnë poste për ta mbajtur popullin zvarrë. Kjo politikë e tyre është plotësisht antikombëtare.

Agroni: 2. *Çështja tjetër që kam vërejtje, është se shpeshherë shqiptarët marrin detyra që s´mund t´i çojnë deri në fund. Kjo është karakteristikë jona antropologjike. Kjo, jo vetëm në kuadër të partive politike, por edhe në kuadër të lëvizjeve popullore.*

ZEQIRI: Ke plotësisht të drejt. Pajtohem me mendimet tua, sepse unë për veten time jam veprimtar politik dhe nuk mund të jem kritik i mirë, as historian i mirë. Nëse kam shkruar për histori, kam pasur debate me disa profesorë e historianë shqiptarë. Megjithatë, nuk mund të quhem kritik as historian. Pastaj nuk mund të quhem as ndonjë farë lideri politik, sepse as që më ka interesuar ndonjëherë politika. Politika, neve na është imponuar.

Agroni:3. *Shumë anëtarë të LPK-së nuk i qëndruan besnikë vijës së përcaktuar fillimisht në programin e kësaj lëvizjeje. Çka mendoni ju?*

ZEQIRI: Pajtohem me ty, sepse ata në momentin më kritik, do të thosha vendimtar, e lanë çështjen politike në mes të rrugës. Konkretisht e kemi rastin në Maqedoni. Partia e BDI-së, ku janë udhëheqës ish-anëtarë të LPK-së, de facto dështuan. E kemi njërin nga veprimtarët e kësaj lëvizjeje, Fazli Veliun, "Abaz Xhukën", alias Ali Ahmetin, Musa Xhaferin, të cilët, jo vetëm se e shkelën programin e LPK-së, por ata e tradhtuan edhe gjakun e dëshmorëve të cilët ranë në luftën çlirimtare në Maqedoni.

AGRONI: Unë mendoj kështu për këta ish-pjesëtarë të lëvizjes së rezistencës. Unë e shoh këtë problem në rrafshin praktik. Një pjesë e tyre kanë qenë të përndjekur nga regjimi jugosllav për veprimtari politike, por siç po shihet, dëshira e tyre paska qenë t´i realizojnë dëshirat dhe nevojat e tyre dhe të familjeve të tyre sociale etj. Prandaj, ata mendojnë se çështja kombëtare është rregulluar. Ne shqiptarët nuk kemi nacionalizëm përmbajtësor. Nuk mundtë kemi, pa pasur fabrika, pa pasur prodhim, pa pasur intelektualë të mirëfilltë. Ne s´mund të jemi nacionalistë siç po mendojmë. Ne veç mund ta luajmë rolin e nacionalistit, se në realitet nacionalizmi duhet të jetë përmbajtësor, për t'u shprehur në ekonomi, në politikë, në kulturë, në sport. Ne s´jemi të përfaqësuar askund në botë, vetëm

po i tregojmë përralla vetes. Kjo është politika jonë: Themi, ky kështu, ai ashtu, ky është patriot, ai është tradhtar, ky është më i zoti, se ai tjetri etj. Ky e ka kryer këtë shkollë apo atë. Mirëpo, kur krahasohemi me të tjerët, përpara jemi krahasuar brenda ish-Jugosllavisë, kurse tani krahasohemi me krejt Evropën. Pasi ti jeton në Danimarkë, e di shumë mirë se në çfarë niveli është Danimarka, çfarë intelektualësh dhe kuadrosh, sportistësh ka në përgjithësi. Mendoj se ne duhet të rrezatojmë, të mendojmë sinqerisht, të mos bëjmë lojëra të kota, sepse edhe luftën e kemi humbur – mendoj. Ne shqiptarët, luftën nuk e kemi fituar. Luftën e fitoi NATO-ja. Aty duhet të jemi të sinqertë, në fakt kanë shkuar shumë viktima por...

ZEQIRI: Edhe NATO-ja, bashkë me ne e humbi luftën.

AGRONI:*Aty kanë luftuar shumë njerëz, është për të ardhur keq, ka pasur shumë viktima mirëpo ne jemi treguar të paaftë sidomos në organizimin politik aq të paaftë sa me të vërtetë... unë habitem sesi disa gjejnë mundësi dhe vend për t´u krenuar para kamerave në media.*

ZEQIRI: Ju faleminderit për këto mendime të mira

AGRONI:*Nëse jemi kritikë dhe të sinqertë me vetveten do t´i kemi punët shumë më mirë.*

RADIO PRISHTINA: Ju thoni e kemi humbur luftën. Nuk dotë pajtohesha me këtë, sepse megjithatë forcat serbe nuk janë këtu.

ZEQIRI: Këtë mund ta kuptojmë ose ta interpretojmë si të duam vetë, por de fakto NATO-ja dhe UÇK-ja e humbën luftën, sepse këtu i kemi forcat e OKB-së, sepse OKB-ja ishte kundër intervenimit të NATO-s dhe pasi ata erdhën në Kumanovë, pra në marrëveshjen e Kumanovës nuk ishin të pranishëm me gjeneralët çetnikë serbë, as gjeneralët e UÇK-së, as gjeneralët e NATO-s, por ishte vetëm OKB-ja e cila ishte kundër UÇK-së dhe kundër NATO.

RADIO KOSOVA: *Në Kumanovë nuk ishte askush nga NATO?!*

ZEQIRI: Jo, askush! Aty ka qenë, me sa më kujtohet, Rusia, pra përfaqësuesi i Rusisë Çernomerdini dhe përfaqësuesi i OKB-së Ahtisari. Në Kumanovë u bë një marrëveshje në dëm të shqiptarëve.

RADIO KOSOVA:*Me sa dimë ne, në Kumanovë ka pasur përfaqësues të NATO-s.*

ZEQIRI: Jo, në Kumanovë nuk ishin përfaqësuesit e NATO-s, as të UÇK-së.

RADIO KOSOVA:*Ju jetoni në Danimarkë që nga viti 1981, ndërsa si për koincidencë, dy kryeadministratorë i kemi pasur nga Danimarka, Hakerupin dhe Peterssenin.*

ZEQIRI: Po e filloj me Peterssenin, i cili ka qenë më gjatë si kryeadministrator i Kosovës. Petersseni nuk ka qenë i njohur në politikën daneze. Ai, me sa di unë, ka jetuar në Suedi, Amerikë, Zvicër etj. Pastaj ishte në Maqedoni me misionarët e Kryqit të Kuq etj., por më interesant ishte Hans Hakerupi, i cili ishte njëri ndër aleatët më të mëdhenj të Serbisë, i cili bënte piskamë të madhe për intervenimin e NATO-s mbi caqet serbe dhe në atë kohë debatoja andej-këndej dhe më ftuan në Radio-Danimarkë. Isha mysafir në studio në orën 8.05 të mëngjesit. Është një emision që quhet*Mysafirët në studio*. Aty trajtohen ngjarjet më të rëndësishme që ndodhin. Kisha vetëm 3 deri 5 minuta në dispozicion.

Ndërhyn një dëgjues: Jam Shemsiu nga Hamburgu – thotë, pastaj shtron pyetje: A kemi ne shqiptarët diplomatë, se politikanë kemi sa të hanë qentë. Por nuk e di a kemi ndonjë diplomat që do të na përfaqësonte denjësisht në botën e jashtme?

ZEQIRI: Faleminderit! Diplomatë kemi, por ata faktikisht nuk janë në rrjedhat politike. Diplomatë i përgatitur ka qenë i madhi ***Ukshin Hoti,*** por ja ku është! Heroi ynë i pazëvendësueshëm, ***Adem Demaçi, Albin Kurti,*** pastaj njëri ndër diplomatët e shkëlqyer

Bardhyl Mahmuti i cili tani është angazhuar në PDSH, në Maqedoni. Kam shpresë shumë të madhe se ai do ta ndryshojë kursin e kësaj partie në favor të shqiptarëve. Diplomatë të tjerë manipulatorë, që mundohen ta mashtrojnë popullin ditë e natë kemi sa të duash, siç theksove edhe ti përpara. Megjithatë, diplomatë që mundohen t´ia imponojnë Perëndimit dhe qarqeve ndërkombëtare politikën shqiptare ka, por mjerisht janë fleksibilë.

RADIO KOSOVA: *E po, diplomacia e ka ndjenjën e kompromisit, fleksibilitetit.*

ZEQIRI: Po, kompromisi e ka edhe diplomacinë, por këta duhet të dinë sesi të kërkojnë. Duhet të godasësh pa mëshirë. Pa ndërprerje, të pamundurën ta fitosh, pra ta bësh të mundur. Ndërsa kur thua apokur "diplomatët" tanë thonë: *"Zgjidhja më e mirë është pavarësia e Kosovës"*, ata në fakt po i japin shenjë diplomacisë ndërkombëtare se janë të gatshëm të bëjnë edhe kompromise dhe t'i shesin interesat kombëtarë. Natyrisht, këta pastaj do të kenë përkrahje edhe nga diplomacia ndërkombëtare.

Ndërhyn një dëgjues: Quhem Ismet Hasani, flas nga Suedia. Jemi me një grup shokësh, ju përshëndesim! Megjithëse për momentin edhe ne në Perëndim kemi plagë të rënda, emisionet tuaja po na i shërojnë plagët.Po e përfundoj këtë përshëndetje me një fjalë të urtë popullore: *"Rrezet e diellit bien edhe në pleh por, ato prapë mbesin të pastra"*. Pastaj do të shtoja: *"Ai njeri që në robëri më shumë e do jetën e ëmbël dhe pasurinë sesa lirinë, mbetet përherë rob i mjerë që për asgjë s´ka siguri"!*

Ndërhyn një dëgjues: Quhem Skënderi, pastaj thotë: Me sa po dëgjojmë, vetëm zi paska te ne shqiptarët.Kam një pyetje për mysafirin: Sikur të ishte në pozita të Ali Ahmetit, të gjeneral Çekut dhe të Fatmir Sejdiut, a do t´i kishte folur këto fjalë, vetëm zi?! A ka diçka të mirë te ne shqiptarët. A është e mundur që ne vetëm po hamë bar dhe s´po dimë kujtt'ia japim votën?! Nuk pajtohem me konstatimin tuaj se UÇK-ja dhe NATO e kanë humbur luftën dhe si mund të jemi të sinqertë me vetveten, kur vetëm zi po shohim?!

ZEQIRI: Unë nuk mund të jem në pozitë derisa jemi në këto situata, por Ali Ahmeti ka qenë qe sa kohë.

RADIO KOSOVA: *Çka do të bënit ju?*

ZEQIRI: Unë nuk do të bëja asgjë. Këta e kanë sjellë apo e kanë pranuar një situatë të paperspektivë. Kanë hyrë në një parlament me do zgjedhje dhe po i dirigjon UNMIK-u si një organizatë antidemokratike. Krejtësisht e ka nën kontroll politikën e tyre.

RADIO KOSOVA: *Atëherë në Maqedoni, pasi vini nga Maqedonia? Po të ishit atje, a do të bëheshit shërbëtor i politikës sllave?*

ZEQIRI: Në radhë të parë po ia bëj me dije mikut që më pyeti se fundi i fundit, unë nuk jam i sigurt të hyj në Maqedoni, sepse Maqedonia dhe BDI-ja kanë ngritur një farë aktakuze kundër meje më 25 maj 2005. Ata gati sa më arrestuan më 9 shtator 2005, vetëm e vetëm se unë nuk e pranoj këtë status që u është imponuar shqiptarëve në Maqedoni.

RADIO KOSOVA: *D.m.th, ju keni qenë kundër Marrëveshjes së Ohrit?*

ZEQIRI: Natyrisht! Kjo marrëveshje nuk i plotësoi as 20% të kërkesave të luftëtarëve të lirisë.

RADIO KOSOVA: *A jemi të mirë ne shqiptarët?*

ZEQIRI: Po, jemi të mirë. Ne e pranuam pavarësinë e Maqedonisë, pa asnjë kusht për shqiptarët. Pastaj, politikanët tanë që ne ua kemi dhënë vetë votën- siç tha dëgjuesi - e pranuan pavarësinë e Malit të Zi, po ashtu pa kurrfarë kushtesh për shqiptarët atje, kur *de fakto* dhe *de jure* Mali Zi është krijuar si republikë e dytë serbe në ish-federatën jugosllave, kur kjo tjetra – Maqedonia - u themelua më 1943. Sot këto republika u ndanë prej

Serbisë pa luftë, pra me referendum. Tani shtrohet pyetja: Si i lejoi Serbia që ato të ndahen pa luftë? Si është e mundur kjo? Cila republikë ish-jugosllave u nda pa luftë prej Serbisë?!

Mos u nda Bosnja, Kroacia apo Sllovenia? Por, është e sigurt se Maqedonia dhe Mali i Zi ishin dhe janë aleate të sigurta të Serbisë dhe ne shqiptarët do t'ua shohim "hajrin" këtyre pavarësive që po i përkrahin këta politikanët, të cilëve vetë ua dhamë votat.

Natyrisht, votat ata po i marrin me ato listat e mbyllura, por kur kam filluar t´u shpjegoj në Danimarkë për listat e mbyllura politikanëve, gazetarëve, shkrimtarëve etj., ata habiten dhe thonë: *"Ky është akt i shëmtuar antidemokratik. Këtë ua imponon administrata e UNMIK-ut, pra forcat e UNMIK-ut, të cilët luajnë rol të dyfishtë kundër shqiptarëve"!* Ndodh kështu sepse fundi i fundit ato raporte dalin para opinionit ndërkombëtar. Pra, raportet që i marrin në Danimarkë thonë: *"Çdo gjë në Kosovë është OK"*. Vetëm se atje është një problem i pazgjidhur. Ky problem qenka i pakicës serbe, e cila po ka presione prej shqiptarëve! Kjo është pika kryesore shqetësuese që trajtohet në qarqet ndërkombëtare. Pra, si t´i sundojmë, t´i bëjmë zapt shqiptarët, që po i mundojnë serbët që jetojnë në Kosovë. De fakto, është e kundërta. Serbët ishin të privilegjuar para luftës nga pushteti serb, ndërsa pas luftës janë të privilegjuar nga administrata e UNMIK-ut. Ne kemi argumente të shumta, të qarta se politikanët tanë heshtin, i mbyllin sytë para këtyre fakteve dhe nuk e bëjnë asnjë deklaratë. Fjala vjen, kur serbët dalin dhe i bllokojnë rrugët e Kosovës, UNMIK-u dhe KFOR-i heshtin. Ata me pasivitet tejet të madh e shohin këtë situatë.

Ndërsa, kur Lëvizja Vetëvendosje (L.V.) del proteston kundër një krimineli si Koshtunica, i cili me kallashnikov në dorë erdhi për të vrarë shqiptarë në Kosovë, atëherë policia e SHPK-së, intervenon dhe e maltreton fort atë rini. Është skenë e tmerrshme kur sheh sesi polici shqiptar, ish-ushtar i UÇK-së, tani me rroba polici, e shkel në fyt një vajzë heroinë që ka dalë të protestojë kundër vizitës së Koshtunicës. Në anën tjetër, presidenti i Kosovës Fatmir Sejdiu, shkon në Tiranë, e merr çmimin *"Honoris causa"*

dhe nuk e jep asnjë deklaratë kundër kësaj vizite antinjerëzore. Kjo është tepër imituese, apo jo!

RADIO KOSOVA:*Po partitë politike kanë thënë se janë kundër kësaj vizitetë Koshtunicës.*

ZEQIRI: Po, *"Nga e thëna në të bërë, është një det i tërë"*-thotë populli ynë.Ata duhet të bëjnë diçka!

RADIO KOSOVA: *Megjithatë, është thënë diçka!*

ZEQIRI: Është thënë, si është thënë!

QAZIMI: Nuk pajtohem me bashkëbiseduesin, se NATO-ja dhe UÇK-ja e humbën luftën në Kosovë!

ZEQIRI: Do të dëshiroja ta elaboroj më tej mendimin e Qazimit,i cili thotë se ne e kemi fituar luftën, tani duhet ta fitojmë paqën.

Pyetje tjetër: Pse qëndron ky konfuzion kaq i madh në mes liderëve shqiptarë në Shqipëri, Maqedoni dhe Kosovë?! Ne po e përcjellim parlamentin e Kosovës, po i shohim divergjencat që kanë! Kur jemi te liderët shqiptarë, a vlen thënia e Fishtës i cili thotë se *më lehtë është t´i bësh bashkë një grusht pleshta se dy shqiptarë"?*A vjen në kundërshtim Ali Ahmeti me Arbën Xhaferin, Sali Berisha me Nanon etj etj?! Po ashtu, parlamenti i Shqipërisë është bërë për t´u brengosur për të! Agim Çeku nuk prodhon rrymë! Agim Çeku nuk mund t'i ruajë pyjet, ai e ka punën e tij!

ZEQIRI: Rrymën e ka nën kontroll UNMIK-u, or Bacë!

QAZIMI: Ne duhet të jemi unik prej Presheve deri në Çamëri!Të gjithë shqiptarët duhet të jemi një, s´ka divergjenca! Luftën e kemi fituar! Ne se kemi aeroportin pikë të nxehtë, por e kemi Mitrovicën, Albanikun, Leposaviqin, e jo t´i ndalohet Naim Malokut të dalë në veri. Ai është oficer dhe është anëtar i

Parlamentit të Kosovës dhe s'guxon të shkojë në Mitrovicë, askush prej tanëve atje.

(sa mjerim! ra në kundërshtim me fjalët e veta, kur thoshte: luftën e kemi fituar)!

...dhe dëgjuesi vijon: "Sanda Vançoviq vjen atje dhe i thotë 1000 të zeza..."

ZEQIRI: Këto janë fakte se luftën e kemi humbur, por duhet ta fitojmë!

QAZIMI: Ndërsa, policia jonë i shkelin Albin Kurtin, Emrush Xhemailin...Kjo s´po më pëlqen!Ne dje i shkrimë me çka patëm në luftë, e sot s´po na përmend askush!Ju falënderojmë për këtë emision që po na përkrahni.

ZEQIRI: Mendimi im se luftën e kemi humbur, po rrahet nga shumë dëgjues. Po ta kishim fituar ne luftën dhe NATO-ja, në Kosovë sot do të kontrollonte UÇK-ja.Ajo nuk do të çarmatosej, nuk do të bëhej forcë civile - TMK dhe nuk do të bëhej SHPKqë po e shkel në fyt rininë tonëqë protestonkundër gjithçkaje që është në dëm të shqiptarëve dhe në dëm të interesave të Kosovës. Në anën tjetër, dua të argumentojë mendimin tim se kam qenë i vetmi shqiptar në Perëndim që kam qenë kundër intervenimit të NATO-s, kësisoj siç u argumentua ndërhyrja.

RADIO KOSOVA: *Si? Dëgjuam mirë apo jo?*

ZEQIRI: Po, po! Kam qenë dhe kam deklaruar në Radio-Danimarkë, sepse në atë kohë ishte një platformë e përcaktuar e Havier Solanës, që thoshte: "**Notindependet! Autonomi for Kosovo**! Prandaj, Radio-Danimarkës i deklarova: ***"Shqiptarët luftojnë për pavarësi…"***

Fund

DUHET TË PËRKRAHET PLATFORMA PËR SHQIPËRINË NATYRALE

Intervistë dhënë nismëtarëve të librit "Golgota shqiptare", pjesa e katërt (1970-1980) dhe e pestë (1980-1990), Kopenhagë, më 27 maj 2009

Go.Shq: Ju jeni kryetari i Komitetit për të drejtat dhe liritë e njeriut, dega e Skandinavisë. Ligji për lustrim duhet të zbatohet. Ju lutem komenti juaj: ku mbeten shqiptarët me këtë ligj, përkatësisht çfarë fitojmë e çfarë humbim?

Zeqiri: Dëgjoni, kjo pyetje është shumë e qëlluar. Kujtoj se tani nuk është momenti të merremi me këtë ligj që na kthen prapa në historinë tonë të djeshme.

Këtë e them për faktinse tani në Kosovë dhe në viset e tjera shqiptare të pushtuara nga ish-Jugosllavia titiste, të gjitha dosjet i kanë në duar pikërisht ata që ia shkaktuan të gjitha ato vuajtje popullit shqiptar. Prandaj, ne nuk jemi aq të marrë që të kujtojmë se ja tani qenka bërë Kosova "demokratike", Tetova "demokratike", Presheva, "demokratike", Malësia e Madhe, "demokratike". Ish-udbashët shqipfolës, tani do të thonë: Ja ku i keni bëmat tona të liga. Ja, ne do t´i nënshtrohemi drejtësisë së kombit shqiptar në trojet e veta dhe po dalim e po kërkojmë falje për krimet dhe turpet që kemi bërë, në bashkëpunim me UDB-ën, KOS-in, e të tjera agjentura jugosllave. Prandaj kërkojmë sinqerisht t´i përgjigjemi drejtësisë etj. etj.. Për më tepër, kur dihet se pjesën më të madhe të pushtetit të sotëm, pa shtet të ribashkuar shqiptar, e kanë po ata që deri dje i sollën aq vuajtje këtij kombi fatkeq.

Ndërsa sa i përket Ligjit të lustracionit në Shqipërinë administrative, po ashtu e kam të njëjtin qëndrim.Duhet të ndalen këto gjurmime shtrigash të "krimeve të komunizmit", për faktinse këto asgjë të mirë nuk i sjellin Shqipërisë dhe kombit shqiptar.

Ne duhet të bashkohemi si një trup i vetëm që t´i realizojmë aspiratat tona shekullore, me ndihmën e shtetit shqiptar. Ky është aspekti i unitetit të kombit, ndërsa nga ana tekniko-administrative, po flitet dhe është shkruar jo rrallë, se shumë dokumentacione arkivore janë zhdukur gjatë këtyre viteve të tranzicionit, trazirave dhe ndryshimeve të pushteteve në Shqipëri. Pra, nuk duhet të kemi iluzione se këto parti janë të sinqerta që t´i detyrojnë organet e shtetit të dalin hapur, ta paraqesin krejt atëqë ka ndodhur gjatë atyre viteve, që datojnë pothuajse një gjysmë shekulli. Kujtoj se paraqitja e këtyre dosjeve, sipas përmasave jo të barabarta dhe jorealiste, do t´i shkaktonte vetëm përçarje të reja kombit shqiptar.

Go.Shq: Mendoni se Komiteti juaj ende duhet të funksionojë. Fjalën e kam për të drejtat dhe liritë e shqiptarëve?

Zeqiri: Mendoj se Këshilli për liritë e të drejtat e njeriut ekziston dhe duhet të ekzistoj, derisa nuk ka zgjedhje të drejtë. Bile duhet të aktivizohet dhe më shumë. Këshilli po bën punë të shkëlqyer nën drejtimin e z. Bexhet Shala, po bën një sensibilizim të shkëlqyer. Mjafton Këshilli të funksionojë fuqishëm, që shtetet e huaja të kenë të tjera qëndrime ndaj nesh. Por ish-shërbëtorët e Serbisë i krijuan partitë, gjegjësisht degët e tyre, vetëm për ta përçarë mërgatën e lodhur dhe të degdisur, por edhe të harruar. Kjo tregon se vetëm pas formimit të atyre degëve dhe të nëndegëve të partive, filloi një konfrontim mes shqiptarëve. Për fat të keq, ka pasur zënka dhe rrahje në mesin e shqiptarëve. Vallë, a mos këto parti i krijuan rastësisht?! Jo,sepse vetëm në këtë mënyrë serbët dhe aleatët e tyre ia arritën qëllimit. Pra, si u krijuan këto parti brenda trojeve shqiptare dhe në Europën perëndimore,problemi thelbësor i zgjidhjes së çështjes kombëtare, realisht u harrua. Shqiptarët merreshin me vetveten dhe filluan konfliktet brendashqiptare dhe brenda partiake. Vetëm për një çast, kërkoj që t´i analizojmë biografitë e njerëzve që i formuan këto parti politike nën maskën kinse “demokratike” në ish-Jugosllavi. Përgjigjja është e qartë kur dihet se mbi 95% e tyre

kanë qenë anëtarë besnikë të LKJ-së. Natyrisht që rezultati përfundimtar i tyre, tani pas kaq vitesh, po shihet.

Go.Shq: Cilat ishin motivet që ju të largoheni nga vendlindja?

Zeqiri: Motivet i thash me lart. M´u bë jeta monotone kur ma ndaluan të dilja në rrugë, të bisedoja me ndonjë shok, të shkoja në kafene. M´u dha vetëm e drejta që të shkoja të blija diçka në shitoren e fshatit dhe të mos flas me askënd, bile as me shitësin i cili më pyeste shpesh si jam dhe më thoshte: "Xhemil, ki kujdes se agjentët e sigurimit maqedonas, keq të kanë kap në sy". Unë e shikoja dhe bisedoja me të, sepse e nderoja shumë, por sa vinte dikush, ai e ndërpriste bisedën dhe thoshte: "E kam hallin për ty, se mua nuk kanë çfarë të më bëjnë" dhe kështu vazhdonte krejt kjo. Shkaku kryesor qe një tragjedi që ndodhi te xhamia."Unë dhe ti e rrezikuam jetën. Dolëm të dëshmojmë në emër të zotit dhe të drejtësisë. Beso Xhemil, më dhimbsesh si djali im, sepse je i drejtë dhe guximtar".

Unë isha pa punë, isha pa lek dhe ai më jepte cigare dhe lekët nuk m´i merrte. Dhe përsëriste: "Mua nuk kanë ç'më bëjnë dhe jam i gatshëm të kacafytem me këto veglat e Komitetit. Ne jemi pak, por zoti na ndihmon dhe katundarët tanë na nderojnë. Njerëzit për ty flasin shumë mirë, të duan shumë se je trim dhe i drejtë. Vazhdo se ky është nder edhe për tërë familjen tënde"!

Mua më mbusheshin sytë me lot, sepse gjendjen e kishim shumë të rëndë ne shqiptarët, kurse puthadorët, shqipfolësit e Komitetit, na bënin presione dhe kërkonin nga ne që të silleshim si dele, pra të mos ia prishnim qejfin pushtuesve, por të vepronim si të na thoshin spiunët dhe Komitet. Ne të bënim vetëm amin.

Kjo ishte në pika të shkurta gjendja e asaj kohe.

Prandaj analizoja tërë natën, si të gjeja shtegdalje, pija duhan në dhomë, i vetmuar duke parë RTSH-në. Atëbotë, në ato çaste, më bëhej zemra mal, sepse meditoja: "Çka të bëhet, le të bëhet, ne shqiptarët e kemi një shtet që lulëzon dhe nuk i përulet askujt".

Prej atëherë fillova të kuptoj më thellësisht qëllimin e pushtuesve sllavë dhe metodat e tyre djallëzore që donin të na mbajnë të ndarë e të përçarë, vetëm e vetëm që të na sundojnë më lehtë dhe pa vështirësi.

Go.Shq: Cilat janë arsyet që ju shtynë të merreni me veprimtari ilegale-kombëtare?

Zeqiri: Arsyet, thjesht, ishin dy nga më kryesoret: çlirimi dhe ribashkimi i trojeve shqiptare me shtetin amë, Shqipërinë dhe hakmarrja ndaj pushtetit të huaj armiqësor që veproi në fshat në atë mënyrë. Mirëpo, duke u thelluar në mendime dhe duke ndjekur lajmet e TV-shqiptar, posaçërisht fjalimet e udhëheqësve të atëhershëm të Shqipërisë, m'u dha mundësia të kuptoj hallin e madh të kombit tonë të pushtuar dhe të rraskapitur nga dhuna politike dhe psikike që ushtronin pushtuesit. Pra, këto ishin qëllimet dhe arsyet që unë doja të hakmerrem dhe të punoj për zgjidhjen drejt të çështjes sonë kombëtare. Në këtë mënyrë, vendosa të dal në Zvicër. Atje kisha disa kontakte në Sangalle me disa djem, pak më të moshuar se unë, por që punonin në ilegalitet, pra ishin anonim. Për t´ua ruajtur konspiracionin, nuk doja t'i mbaja mendemrat.

Go.Shq: Si u njoftuat me shokët e grupit ilegal?

Zeqiri: Po. Kur shkova në Danimarkë, në janar të vitit 1981, atje nuk njihja shumë shqiptarë. Dalëngadalë fillova të njihem, por ishte shumë keq, pasi ambasada jugosllave kishte kontroll absolut mbi shqiptarët, më keq se kur isha në katundin tim në Zhelinë. Mundohesha të bisedoja me njerëz dhe më interesonte t'i di gjërat, të takoja ndonjë veprimtar. Fillova të njoftohem me danezët dhe këtu pata rastin të njihem me Jonin dhe gruan e tij Mariana Pederssen, me Lotën Madsen, e cila kishte studiuar në Shqipëri gjuhën shqipe dhe shqipen ë fliste për mrekulli. Ata ishin organizuar në Shoqatën shqiptaro-daneze dhe prej tyre, për herë të

parë, mora libra dhe filma shqip, kaseta dhe këngë popullore folklorike. Ato i shumëzoja dhe i shpërndaja.

E lusja Lotën që të m´i përkthente artikujt në gjuhën daneze dhe pastaj ua dërgoja. Mirëpo në atë kohë, shokët danezë nuk më lejonin të dilja hapur me emrin tim. Më këshillonin të veproja anonim. Pastaj vendosa të dal me pseudonimin ”JIMI”.

Pas disa viteve u takova me veprimtarë të LPK–së, si me Ibrahim Kelmendin, Gafur Elshanin, Muhamed Kelmendin, e shumë të tjerë. Kur erdhën shokët e LPK-së në Danimarkë, në njëfarë mënyre terrenin e gjetën të parapërgatitur në opinionin danez. Me shokët danezë e krijuam edhe **Komitetin “Miqtë e Kosovës”**. Menjëherë krijuam lidhje me LPK-në dhe në këtë mënyrë filloi aktiviteti. Ndërsa në anën tjetër, pra me shqiptarët, nuk mundja të depërtoja lehtë, edhe pse i përkrahja të gjitha nismat që bënin për bashkim ose aktivitet, si në sport (futboll), grup muzikor etj. U jepja përkrahje morale dhe ekonomike, u jepja lek, vetëm që t´i nxis për të bërë diçka.

Më vonë u bëmë një grup dhe krijuam **shoqatën “Besa”,** për të cilën u dhashë 128.000 korona daneze (sot afër 16.000 euro). Me këto mjete e morëm lokalin e shoqatës dhe aktiviteti filloi. Njerëzit tuboheshin, etj. Por, agjentët e ambasadës nuk rrinin të qetë. Ata punonin të na përçajnë. Për mua thoshin: “Të keni kujdes nga Xhemili se ai është i rrezikshëm”, etj. Dhe shokët filluan të dinë se lekët ishin të miat. Spiunët në fakt, u demaskuan keq. Pastaj përhapnin thashetheme se “BESA” është financuar me paratë e Enver Hoxhës, etj. etj.

Go.Shq: Roli dhe aktiviteti juaj në Danimarkë?

Zeqiri: Roli im ka qenë vetë nisma.Me fjalë të tjera, i dhashë detyrë vetes, meqë mora një përgatitje më të mirë shkencore dhe njohuri të mjaftueshme për çështjen shqiptare në përgjithësi dhe për çështjen e Kosovës në veçanti, ku edhe bëheshin përpjekjet çlirimtare. Për çdo ditë i thosha vetes sime: Ç’kam bërë sot për

çështjen shqiptare dhe sa i demaskova para botës gjithë ato tortura që po u bëhen shqiptarëve atdhetarë në burgjet e Serbisë fashiste? Dhe bëja plane se ç´do të bëj nesër. Ndoshta dikujt i duket e tepërt kjo, por kjo është e vërtetë.

Jam i sigurt se nuk kishte ditë që nuk kam bërë diçka, qoftë edhe ndonjë bisedë telefonike me ndonjë gazetar ose intelektual danez, për t'ua shpjeguar për ndodhitë. Poashtu, i lusja shokët që të më siguronin materiale në gjuhë të tjera, si p.sh. gjermanisht, anglisht, frëngjisht etj.I bëja fotokopje dhe ua shpërndaja partive politike, parlamentarëve, organizatave për të drejtat e njeriut, **Amnisti Internacional,**Lidhjes së shkrimtarëve, Pen-qendrës daneze, etj.

Gjithashtu mund të them se vetëm për kopje materialesh të tilla, me vlera faktesh, harxhoja shumë lek. E kam përmendur me një rast, por e përsëris edhe njëherë, se i bezdisja këto institucione. Organizuam një manifestimi me rastin e 25-vjetorit të burgosjes së Adem Demaçit, i cili bënte rezistencë ndaj Jugosllavisë, duke sakrifikuar veten për interesat shqiptare. Në atë manifestim na erdhën disa shkrimtarë dhe publicistë danezë. Pastaj me ato materiale që na erdhën nga Gjermania, kërkova një takim me kryetarin e PEN-it danez, me sekretarin e tij- Johanes Riis. Gjatë bisedës, i them:"Jeni intelektual dhe fare pak dinipër Adem Demaçin,ndërsa për Nilson Mandelënështë në gjendje të dijëedhe një fëmijë 7-8 vjeç. Si është e mundur kjo"?!

Kërkoj të di prej Jush, pse po e mbani të heshtur dhe të izoluar këtë rast?!Përse po i besoni aq shumë Jugosllavisë dhe Titos, kur ai ashte një fashist i pastër, i cili na ka shkaktuar aq shumë shkatërrime dhe dëme neve shqiptarëve, saqë politikanët e Perëndimit ia kanë lënë duart e lira të veprojë si të dojë ndaj shqiptarëve. Menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore, ky xhelat i ka pushkatuar me mijëra shqiptarë, gjysmën e Shqipërisë ia aneksuar Jugosllavisë. Pastaj trojet shqiptare i kanë ndarë në disa shtete: në Serbi, Mali të Zi, Maqedoni dhe Greqi. Tani Kosovën e shfrytëzon Serbia egërsisht, gjithnjë nën maskën e "vëllazërim-bashkimit", të

politikës tejet perfide dhe dinake të shtetit jugosllav. Kosova nuk është larg Kopenhagës, vetëm 2 orë me aeroplan. Urdhëroni dhe shkoni e shihni sesi e përjetojnë shqiptarët dhunën dhe terrorin shtetëror serb. Ne kemi një histori tejet tragjike në Ballkan. Si pasojë e dhunës politike dhe e shtypjes ekonomike, mbi 300,000 shqiptarë janë shpërngulur në Turqi.

Mbi 500 mijë emigrantë ekonomikë tani degdisen rrugëve të Perëndimit, po treten në heshtje dhe Serbia po i zbaton planet e nobelistit fashistit, Ivo Andriq dhe të Çubrilloviqit. Ja, urdhëroni dhe lexojeni platformën që e kanë botuar për shpërnguljen e shqiptarëve nga trojet e tyre. Ndërsa në anën tjetër, e keni izoluar Shqipërinë dhe asaj i bëhen bllokada nga të gjitha drejtimet e jetës politike, ekonomike, ushtarake.

Z. Johanes Riisi më dëgjoi me vëmendje dhe kur e mbarova bisedën më tha: "Prit pak" - Pastaj e thirri sekretaren e vet, ia kërkoi dosjen dhe më tregoi se tri herë i ka shkruar Lidhjes së Shkrimtarëve të Jugosllavisë dhe të Kosovës për Adem Demaçin, por nuk ka marrë përgjigje. Pastaj më tregoi një faks që i kishte ardhur nga Lidhja e Shkrimtarëve të Kosovës, ku shkruante për ditëlindjen e Adem Demaçit. Aty tregohej se i ka dy fëmijë, se ishte i dënuar me 15 vjet burg, se është me shëndet mirë dhe se gjendet në burgun e Stara Gradishkës në Kroaci. Ja pra z. Riiss, shihet edhe mënyra sesi e paraqesin Adem Demaçin. Atij nuk i lejohet të merret me shkrime. Në dhomën e tij ka edhe kriminelë dhe kjoparaqet një torturë shpirtërore për shkrimtarit tonë të madh, kurse Lidhja e Shkrimtarëve të Kosovës është vegël e Serbisë dhe mos pritni diçka më shumë, sepse disa prej tyre janë përgjegjës dhe janë fajtorë direkt për burgosjen e tij.

Ai pastaj ma ktheu: "Ne nuk mund të bëjmë asgjë në Kongresin e PEN-it që do të mbahet javën e ardhshme në Holandë, por a mund të na e sigurosh ti biografinë e Adem Demaçit? Po, i thash. E kam, por në gjuhën gjermane.

Nuk ka problem, më tha ai, sepse ne danezët, jemi në udhëheqësi të Kongresit botëror dhe unë personalisht do ta shtroj

këtë çështje në Kongres. Faleminderit! - i thashë. Kjo duhet të bëhet nga ju, o sot, o kurrë!

Ndodhi ashtu siç më pat premtuar. Kur prej Holande më telefonoi dhe më njoftoi se ishte i kënaqur që Adem Demaçi është pranuar si anëtar nderi në PEN-in skandinav, pa asnjë kundërshtim. Pra, ky ishte një sukses i madh dhe më jepte shpresa që të vazhdoj punën. Poashtu, ka pasur rastekur më kanë përzënë, duke u shprehur: "Ju jeni mirë me Titon, kurse në Shqipëri janë keq nën regjimin e Enver Hoxhës". Në disa raste mundohesha t´i merrja me të mirë, mirëpo kishte raste kur e humbja durimin dhe grindesha me ata, duke ua thënë troç: "Qëllimi juaj është që ta shkatërroni shtetin shqiptar, që të mos ketë kush për të na mbrojtur nga jugosllavët dhe nga armiqtë e tjerë. Por kot e keni. Kurrë nuk do ta arrini qëllimin djallëzor që Shqipëria të veprojë kundër nesh, si në kohën e mbretit Ahmet Zog. Ky xhelat atëbotë bashkëpunonte me Serbinë dhe me shtetet e tjera ballkanike, kundër interesave gjithëkombëtare, vetëm e vetëm për ta rrëmbyer pushtetin".

Pastaj, kur ishte dikush i interesuar të dijë më tepër, caktoja takime dhe i ftoja shokët të vijnë. Në këto takime u thosha:"Pajtohem, nuk ka problem, ne merremi me të tjera çështje, por vetëm duam që t´i argumentojmë gjërat, sepse kjo na duhet". Jam i vetëdijshëm se nuk është mirëqë njeriu të flasë për veprimtarinë e tij, sepse nga të tjerët kjo mund të keqkuptohetdhe të merret si krekosje. Për veprimtarinë time dhe tonat është mirë tani të flasin zotërinjtë - Adem Demaçi, Ibrahim e Muhamed Kelmendi, Hajdin Abazi, Xhavit Haliti, Bujar Bukoshi Xhafer Shatri, Shaqir Shaqiri, Hajrullah Gorani, Dritëro Agolli, Skënder Gjinushi, Arbën Xhaferi, Abdurrahman Haliti, Nevzat Halili, Sami Ibrahimi, Mevlan Shanaj, ish-atasheu i ambasadës shqiptare në Stokholm, Fadil Shyti, Hashim Thaçi, Shqiptar Oseku e shumë të tjerë. Që të gjithë i kam ftuar në Danimarkë për aktivitete atdhetare dhe kanë marrë pjesë në takime shumë të rëndësishme me njerëz të politikës, të artit dhe të kulturës, pra këtu në Danimarkë.

Më duket e tepërt t´jua them juve emrat e gjithë këtyre veprimtarëve. Asnjë lek nuk u ka kushtuar. Përkundrazi, unë ua siguroja udhëtimin dhe shpenzimet e tjera që i kërkonin institucionet daneze. Mirëpo, jam i shtrënguar ta theksoj këtë fakt vetëm për arsye se për Shqipërinë, për ribashkimin dhe lirinë e saj, kurrë nuk duhet askush nga ne që të kursejë djersën dhe gjakun.

Pastaj, në vitin 1992, në Kosovë e dërgova një grup miqsh danezë, përfaqësues të universitetit, parlamentarë dhe gazetarë. Për tri ditë i përcollëm me lule në aeroport dhe i pritëm në mënyrë shumë të organizuar. Unë dhe bashkëshortja ime,bashkë me 6 fëmijë të miqve tanë përgatitëm 6 buqeta me lule për ata që ktheheshin nga Kosova. Pastaj, sa gazetarë dhe organizata i kam ftuar ta çojmë çështjen tonë përpara. Pra e kam përgatitur terreninnë të gjitha trojet shqiptare: në Kosovë e në Maqedoni, ashtu edhe përtej kufijve administrativë, në Shqipëri. Për këto veprimtari do të duhej të shkruhej një libër, por ja që as kohë s´po kam për ta bërë këtë.

Po ashtu, mund t´ju them shkurtimisht se në Danimarkë nuk ka ndonjë stacion TV ose gazetë apo radio që nuk ka bërë intervistë me mua, dy a mëshumë herë. Bile disa prej këtyre intervistave dhe shkrimeve i kam botuar në librat e mi - "Kosova jonë", "Në mbrojtje diplomatike të çështjes shqiptare" dhe në " Intervista, debate, letra dhe polemika".

Unë u përqendrova më shumë për të informuar për represaliet që përjetonte populli ynë në trojet e veta.

Go.Shq: Mburreni apo jeni penduar për vuajtjen jashtë atdheut në emër të çështjes sonë kombëtare?

Zeqiri: Si të them, si jashtë ashtu dhe brenda atdheut, vuajtjet për shqiptarët nuk kanë të ndalur.Nuk jam penduar kurrë që kam vepruar. Bile më duket pak kam vepruar. Kemi arritur diçka me këto veprimtari, por në njëfarë doze jam penduar, ngase kujtoj se, sikur t'i kisha vazhduar studimet dhe të mbroja ndonjë titull

shkencor. ndoshta do të isha më i pranishëm në debate, në qarqe të larta shkencore për çështjen shqiptare. Disa politikanë shqiptarë do të bindeshin për veprimet politike që i kam bërë, pa kurrfarë interesi. Nuk kemi arritur gati asgjë dhe mund të themi se edhe ato që i arritëm me mund dhe sakrifica në vitet 1968-1981, i humbëm. Tani, pas tri luftërave çlirimtare, konsiderojse nuk kemi arritur gati asgjë. Prandaj, nuk kam, as kemi përse të mburremi.

Personalisht, kam vepruar pa kurrfarë interesi personal. Në fakt, interesimi im ka qenë që edhe ne shqiptarët të bashkohemi dhe të krijojmë një shtet shqiptarpër të konkurruar me vendet e tjera të Ballkanit dhe në Evropë, sepse i kemi të gjitha mundësitë dhe vlerat reale kombëtare dhe demokratike.

Go.Shq: Me shembjen e sistemit të RSFJ-së, a e morën shqiptarët atë që u takonte?

Zeqiri: Jo! Nuk e morën atë që u takonte, por për fatin e keq,edhe ato që i sanksiononte Kushtetuta e vitit 1974, i humbëm. Edhe ato të drejta që i patëm fituar me gjakundhe sakrificate luftëtarëve partizanë në Luftën e Dytë Botërore dhe pas luftës, i humbëm. Kosova kishte disa të drejta, përafërsisht sa një republikë, por edhe ato na i mori Serbia. Serbia gjakatare pati bërë disa plane. Nga fundi i viteve '80 gazeta "Mladina" i bëri publike disa plane serbe kundër shqiptarëve. Ky plan synonte që shqiptarët t´i përçajë shumë keq, duke krijuar parti politike me besnikët titistë, si Rugova & Co.

Në Shqipërinë administrative, serbët dhe grekët e kanë marrë nën kontroll pothuajse tërë ekonominë shqiptare. Bile jam shumë i merakosurme këto zhvillime "demokratike" që po ndodhin në Shqipërinë administrative.Lobi grek dhe fazlliqët serbë, miq të Sali Berishës, e kanë në dorë gati tërë ekonominë shqiptare.

Go.Shq: Ju dhe shokët tuaj u dënuat se kërkuat që pjesa e Maqedonisë Veri-Perëndimore t'i bashkohet Kosovës dhe një ditë

këto troje shqiptare të ribashkohen me shtetin amë.Fort mirë e dimë se më 1912 këto troje i takonin Shqipërisë (shpallja e pavarësisë), ndërsa më 1913 mbetëm padrejtësisht nën sundimin e sllavëve pushtues. Cili është komenti juaj?

Zeqiri: Po, është e vërtetë se i takojnë Shqipërisë, por kush i thotë këto, unë dhe ti dhe disa idealistë. Ja që ndërkombëtarët nuk na pyesin neve aspak, por i pyesin ata "të zgjedhurit" e popullit. Ç´platformë kanë paraqitur ata, asgjë s´presim nga miqtë e serbëve, të tipi Marti Ahtisari, që ka qenë dhe do jetë për jetë e mot, mik i Serbisë. Këtë e them pa fije dyshimi dhe jam në gjendje, kur të duan,t´ua argumentoj. Ishin titistët ata që shpikën termin "kosovar" dhe tani na duhet që pas asaj lufte të lavdishme te UÇK-së, të pranojmë sa për sy e faqe një lloj "pavarësie" të Kosovës. Natyrisht, unë jam për pavarësi kombëtare, por jo për këtë që po na e ofrojnë serbët dhe miqtë e tyre të sojit Ahtisari. Jo të krijojmë komb "kosovar". Kjo do të thotë se Serbia ia arriti plotësisht qëllimit të vet duke i ndarë shqiptaret me këtë farë kombi "kosovar", me këtë flamur dhe himn për memecë, pa zë.

Go.Shq: Cilat janë arsyet që ju të merreni me aktivitete ilegale - kombëtare?

Zeqiri: Arsyet thjesht, ishin hakmarrja ndaj pushtetit që veproi në fshat, në atë mënyrë! Duke u thelluar në mendime dhe duke ndjekur lajmet TV-shqiptar, posaçërisht fjalimet e zyrtarëve të atëhershëm të Shqipërisë, m'u dha mundësia të kuptoj hallin e madh të popullit tonë të pushtuar dhe të rraskapitur nga dhuna politike e psikike që ushtronin pushtuesit.

Serbia tërë potencialin e vet e ka orientuar që shqiptarët të mos bashkohen. Kjo "pavarësi" e kushtëzuar nuk e tremb Serbinë, bile ajo është e interesuar dhe punon shumë me miqtë e saj për t i përçarë shqiptarët, duke krijuar "mini-shtet" brenda Kosovës. Kjo është tragjedi! Unë jam për bashkim, jo për shtet dhe komb të fals e të ricopëtuar. "Shteti dhe kombi" i Halil Matoshit dhe i Migjen

Kelmendit, sipas "kandarit" të idesë së huazuar serbe, kinse na qenka ide "kosovare". Asgjë nuk u duhet shqiptarëve.

Unë dhe shokët e mi nuk kemi bërë përpjekje për këtë shtet që u krijon barriera të reja shqiptarëve, por kemi bërë përpjekje t´i heqim këta kufij shqiptaro-shqiptarë që po na i presin e qepin armiqtë tanë. Prandaj jam i bindur thellësisht se as dëshmorët që pushojnë të shqetësuar në atdheun tonë të natyrshëm, nuk do të pajtohen në varre me këtë lloj "pavarësie". Ata që ranë në altarin e lirisë, e dinin përse sakrifikuan gjithçka dhe më në fund e dhanë edhe jetën. Komandanti legjendar Adem Jashari, nuk sakrifikoi për Kosovën e "pavarur" me kushte ku të qeveriset nga miqtë e Serbisë dhe me lloj-lloj rezolutash, si ajo famëkeqja 1244. Në këtë politikë reaksionare ç´nuk po ndodh. Dalin tani "ish-shokët e komandantit" dhe thonë se Adem Jashari ra për këtë Kosovë të "pavarur". Bile, para disa ditësh dëgjuam në një akademi për të madhin Ukshin Hoti, ku Zv./kryeministri Hajredin Kuqi i mashtroi shqiptarët duke thënë: "Qeveria e Kosovës bën përpjekje dhe në tryezë e ka platformën e Ukshin Hotit". Ndërsa ata që e njohin mirë Ukën, e dinë se ai kurrë nuk do ta pranonte këtë status, as nuk do t'i pranonte këto përpjekje për krijimin e kombit kosovar. Po ç´të bëjmë, kur çdo ditë po shihet qartë se në politikën e sotme shqiptare nuk ka realizëm dhe as moral. Pikërisht kjo na ka sjellë deri në këto situata që nuk po kemi as mundësinë më të vogël t´i dalim zot vendit tonë, kurse kufijtë na i"i ruajnë" dhe na i "hartojnë" miqtë e Serbisë, që janë instaluar, si UNMIK-u dhe EULEX-i. Ata vetëm vulat dhe uniformat po i ndërrojnë, por në esencë janë antishqiptarë. Pra, janë po këta evropianë të vitit 1913 të cilët tani po veprojnë në mënyrat më perfide që i njeh historia e botës.

Ma merr mendja se duhet të përkrahet Platforma për Shqipërinë natyrale, ashtu siç e ka bërë i madhi **Koço Danaj**. Mendoj se në planin kombëtar janë dy gjëra, në mos më shumë, që janë arritur me shumë sakrifica:

1. Njësimi i gjuhës shqipe, dhe 2. Miratimi i Kushtetutës në vitin 1997-98, që të gjitha qeveritë shqiptare i obligon të punojnë për ribashkimin e kombit shqiptar në një shtet.

Pikërisht këto dy arritje e përparojnë dhe e mbrojnë gjuhën tonë dhe i obligojnë pushtetarët që të bëjnë përpjekje dhe të arrijnë ribashkimin kombëtar. Tani, si kërpudhat pas shiut, po dalin "gjuhëtarë" trutharë dhe "analistë" qyqarë e tinëzarë si Halil Matoshi &Co, si Migjen Kelmendi, Nexhmedin Spahiu dhe japin alarme tek ndërkombëtarët duke theksuar se gjuha dhe kushtetuta shqiptare duhet të ndryshohen, sepse sipas tyre, na qenkan burime përçarjesh brendashqiptare dhe burime konfliktesh në Ballkan! Dhe pa fije turpi, zyrtarët e Shqipërisë administrative, me nismën e kryeparlamentares Jozefina Topalli, marrin nismën "famoze" për ndryshimin e kësaj pike shumë të drejtë dhe më të fuqishme kombëtare në Kushtetutën e Shqipërisë, e cila fatmirësisht nuk u aprovua.

Go.Shq: A shkoi në vend amaneti i të parëve tanë dhe i juaji bashkë me shokë për një Shqipëri siç e ka falur Zoti?

Zeqiri: Jo! Nuk është plotësuar amaneti i të parëve. Bile as në gjysmë të rrugës drejt lirisë nuk kemi arritur. Prandaj na presin punë të mëdha e të rënda deri në realizimin e këtij amaneti ndër brezni.Për fatin tonë të keq, në politikën shqiptare, në udhëheqjen e shtetit shqiptar, janë shërbëtorët e huaj. Merreni me mend, ish-ministri i Mbrojtjes, Fatmir Mediu, vendos kurora lulesh te varret e ushtarëve fashistë, ndërsa po prishen bustet e heronjve. Fazlliqët dhe viqër të tjerë, sot i kanë marrë frenat e ekonomisë shqiptare. Pastaj ç'mund të thuash kur kryeministri shqiptar Sali Ramë Berisha, vjen në Kosovë dhe përlotet duke thënë: "Shtëpia e ime ka qenë shtab i UÇK". Të gjithë e dimë se Sali Berisha,ky mashtrues i pacipë ishte kundër UÇK-së dhe gjatë luftës e përkrahu "FARK-un". Ishte vetë Sali Berisha ai që, kur ishte në pushtet, i burgosi dhe i torturoi burgjeve Adem Jasharin, Ilaz Kodrën, Luan Haradinajn, Fehmi Lladrovcin, Zahir Pajazitin, e të tjerë, që tani janë heronj të lavdishëm dhe emblematë nderit dhe të qëndresës të shqiptarisë.

Prandaj kjo politikë, sa më parë duhet të marrë fund, sepse na mori lumi si komb.

Go.Shq: Porosia juaj drejtuar opinionit në cilësinë e mërgimtarit politik?

Zeqiri: Porosia ime është të punojmë pandalshëm, të jemi afër popullit dhe t´ia shpjegojmë mirë masave të gjëra popullore se kjo politikë është e dështuar dhe antikombëtare. Duhet t´u shpjegojmë dhe të kërkojmë pandërprerë, deri në fitore, se duhet ta përkrahim të gjithë, pa dallim ideje, feje dhe krahine, platformën e Koço Danajt, sepse si duket, ky Koço yni i madh e bëri një platformë "motër", me atë platformën madhështore të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Pastaj, duhet të veprohet me forca të mirëfillta demokratike nëpër botë, të krijojmë miq dhe shokë të sinqertë, që të na ndihmojnë për realizimin e aspiratave tona.

Pra, të veprojmë me këto forca. Unë personalisht kam bërë dy Konferenca Ballkanike dhe disa debate publike në Danimarkë dhe asnjë lek nuk u ka kushtuar shqiptarëve. Gjithashtu, nëpërmjet fondeve të qeverisë daneze janë bërë disa debate, ku kanë marrë pjesë Adem Demaçi, Hajrullah Gorani, Dritëro Agolli, Skënder Gjinushi, Shaqir Shaqiri, Arbën Xhaferi etj. Kjo është detyra jonë që të mbajmë kontakte me intelektualët ku jetojmë dhe në momente të caktuara t'i ftojmë njerëzit që kanë dhënë prova vetëmohimi, se vërtet janë për zgjidhjen e drejtë të çështjes sonë kombëtare.

Të mos i kursejmë lekët për ato forca që me përpjekjet e tyre janë të gatshme të sakrifikojnë për çështjen kombëtare, për përparimindhe për demokratizimin e jetës dhe për të bërë një shtet të ribashkuar shqiptar në Ballkan.

Fund

SALI BERISHA DHËNDËR SERB, ARBËN XHAFERI FILOZOF "RADIKAL"

Intervistë dhënë "DAILY NEËS", 22 gusht 2013
Intervistoi: Destan JONUZI, kryeredaktor i DAILY NEËS-it

DAILY NEWS: Kush është Xhemil Zeqiri? Nga është, çfarë arsimimi ka të kryer dhe autori i sa librave është?

XHEMIL ZEQIRI: Jam i lindur në katundin Zhelinë, nga rrethi i Tetovës. Kam mbaruar shkollën e mesme teknike në Gostivar, pastaj u regjistrova në fakultetin e historisë në Prishtinë në vitin 1980, por pas një viti, siç dihet, ndodhën demonstratat e pranverës së madhe të vitit 1981.

Në katund, aty ku jetoja, kisha provokime nga policia maqedonase: thirrje informative, maltretime etj, gjegjësisht nga një stacionin policor në katundin Grupçin, i cili në atë kohë ishte një stacion terrorizues për shqiptaret në anën e Dervenit; prandaj u detyrova të emigroj së pari në Zvicër, pastaj në Gjermani, prej nga, disa muaj më vonë erdha në Danimarkë, ku u vendosa me punë dhe prej atëherë, pra që nga janari i vitit 1981, me një përkushtim të madh, jam munduar të veproj pandalshëm, për çështjen e pazgjidhur kombëtare.

Dhe tani po bëhen afër 30 vite, pra mbi gjysmën e jetës sime e kalova në Danimarkë. Ashtu si jeta e të madhit tonë, simbolit të rezistencës shqiptare - Adem Demaçit, i cili i kaloi 30 vite kazamateve jugosllave, duke e mbrojtur çështjen shqiptare, ndërsa unë, po rropatem rrugëve të Perëndimit duke i përkrahur mendimet e ndritura të këtij kolosi të madh të shqiptarizmit.

Pastaj, pasi e mora leje-qëndrimin në Danimarkë, në fillim kam punuar lloj-lloj punësh fizike, sepse diploma ime nuk ishte edhe aq me vlerë në Danimarkë, isha pa përvojë dhe këtu në Perëndim u intereson më tepër puna praktike dhe jo teorike. Pra, nuk isha i kualifikuar, për këtu. Pastaj u bëra vozitës i autobusit urban dhe isha

mirë, por koha më pengonte shumë për aktivitetet që i pata filluar në Danimarkë, sepse orari i punës nuk më përshtatej dot. Kur aktivitetet filluan të shtohen, i fillova edhe kontaktet me gazetarët, me partitë politike, me shoqatat që merreshin për çështjet ndërkombëtare, me deputetë etj. Prandaj u detyrova të ndërpres këtë punë dhe fillova të punoja taksist. Nga kjo punë isha më i lirë dhe kisha njëfarë pavarësie në punë, i mbaja kontaktet më me rregull dhe kështu, prej atëherë vazhdoj punën si taksist.

Pastaj fillova të merrem me shkrime, kryesisht me publicistikë: me debate, u drejtoja letra të hapura institucioneve daneze, evropiane dhe atyre të OKB-së. Herë-herë i dërgoja edhe artikuj shtypit të vendit, për problemet politike që ishin aktuale për kohën. Natyrisht, unë doja që të mos dilja me emër. Disa nga mesi ynë, për të gjitha këto aktivitete thoshin: Ai na qenka "i madhi". Kur e pashë se kjo metodë ishte shumë e rrezikshme dhe do t´i kishte pasojat e veta dhe dëshpërimin e disa shokëve që dinin se kush vepron, ndërsa ky po i merrte si individuale, sepse ky më mësonte se si duhet të veproj etj.etj, atëherë dola me emër dhe mbiemër. Më vonë ato shkrime dhe intervista do t'i botoj, vetëm e vetëm sa të dinë, sepse kishte matrapazë të tillë që mundoheshin të më pengonin në aktivitetin tim, por kur shihnin se nuk kanë mundësi, së paku të rreshtohen dhe mundësisht të jenë të parët, për këtë arsye u detyrova të dalë hapur me shkrime dhe me katër libra të botuara: "Kosova jonë", Tiranë, 2000, "Në mbrojtje (diplomatike) të çështjes shqiptare", Prishtinë, 2003, "Polemika, intervista, debate dhe letra", Prishtinë, 2005, "Drejt Vetëvendosjes ", Prishtinë, 2008. E kemi botuar këtë libër tre autorësh: unë, Mona Agrigoroaei nga Rumania dhe Fadil Shyti, nga rrethi i Vushtrrisë. Meqenëse unë dhe Fadil Shyti i kemi dhe disa shkrime të përbashkëta të cilat i janë kushtuar çështjes së pazgjidhur shqiptare, do t´i botojmë në një libër ca më vonë. Pastaj, ka mundësi reale që do të botoj edhe një libër tjetër me intervista, pasi materialet i kam të gatshme.

Gjithashtu, kam dhënë shumë intervista, disa herë në disa radio-TV dhe në gazetat shtetërore daneze për situatat që zhvilloheshin këto 20 vitet e fundit në trojet shqiptare.

DAILY NEWS: Na flisni për fillim çfarë mendoni për politikën shqiptare në Luginën e Vardarit?

XHEMIL ZEQIRI: Jam shumë i shqetësuar sepse kaluan kaq shumë vite që u formuan partitë politike dhe asgjë pozitive nuk po lëviz nga vendi në favor të popullit shqiptar. Jemi dëshmitarë se këto parti politike të krijuara pas shpërbërjes së federatës jugosllave po luftojnë vetëm për interesat e veta klanore e mafioze. Populli, duke e parë se këta matrapazë politikë që ishin shkolluar dhe edukuar në kurset e Kumrovcit, talleshin me zhvillimet politike që i përjetonte populli ynë pas vitit 1990, u irritua shumë. Këto parti kishin si dirigjent një antishqiptar, më të madhin toptanist, Ibrahim Rugovën, dhe ky "politikan"e mbajti një vijë politike që sot jemi duke e paguar shumë shtrenjtë, sepse edhe pas tri luftërave nuk ndryshoi situata në favor të shqiptarëve, pasi ky Ibrahim Rugova, një besnik i rrugës titiste, e formoi një parti të ashtuquajtur LDK, kurse në Tiranën zyrtare ishte formuar dhe PD-ja e udhëhequr nga një dhëndër serb, i quajtur Sali Berisha dhe këta "largpamës" të udhëhequr nga miqtë serbë, e mbanin zap edhe politikën shqiptare në Luginën e Vardarit. Besoj, ju kujtohet kur populli shqiptar në Luginën e Vardarit, duke e parë se partitë, PPD-ja dhe Partia Popullore Shqiptare nuk bënin asgjë për përmirësimin dhe ndaljen e terrorit shtetëror ndaj shqiptarëve, derisa filloi një lëvizje radikale, në atë moment na doli në skenë një "filozof" i dalë nga kurset titiste që, siç thotë populli: " ...fjalët si Demushi, e punët si askushi." Ky ishte "filozofi" titist, i quajtur Arbën Xhaferi, që më vonë, kur do të merrte pushtetin në koalicion, do të bëhej dhe "Xhaferson", sepse shpejt e pati harruar dhunën dhe terrorin shtetëror që përjetonin shqiptarët. Pasi që Arbeni e kishte "mjaltë e sheqer" me Rugovën dhe Saluan, natyrisht edhe ai u bë i tillë.

Unë mendoj se më tepër e kanë mbrojtur popullin "komunistët" shqiptarë se këto parti politike që janë bërë shërbëtore të pushtetit antishqiptar, maqedonas. Por, befasia më e madhe qëndron aty se pas luftës së Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare, përfaqësuesit e saj që e formuan BDI-në, ranë bashkë me partinë ,nën ndikimin e politikës rugoviste dhe prej tyre nuk pritet më asgjë e mirë!

Në Luginën e Vardarit ka disa parti minore, por unë as që u besoj!

Përjashtoj këtu partinë e z. Bardhyl Mahmutit i cili është njëri ndër kuadrot politike me të shquar që kemi në hapësirën e Luginës së Vardarit dhe patriot që rrjedh nga një familje atdhetare të persekutuar dhetë përgjakur nga sistemi sllav. Pra, ky udhëheqës dhe partia e tij e meriton përkrahjen e shqiptarëve për të bërë ndryshimet e duhura në këtë hapësirë shqiptare.

DAILY NEWS: A mendoni se politikanët shqiptarë të Luginës së Vardarit duhet të jenë më unikë?

XHEMIL ZEQIRI: Po, natyrisht se do të duhej të jenë më unikë, por kjo tani më nuk varet nga këta politikanë, sepse këta tani i dirigjon pushteti dhe në vend që të jenë unikë, këta bëjnë gara ndërmjet njëri-tjetrit se kush do jetë më servil ndaj padronit sllavo-maqedonas.

Ja shembulli më konkret: PDSH-ja e Arbën "trimit" thoshte se "VMRON e kemi partner strategjik", por në politikë nuk ka vëllazëri, nuk ka mëshirë, aty ka vetëm interesa dhe pikërisht VMRO-ja e hodhi në rrugë si limonin e shtrydhur dhe i mori në koalicion "luftëtarët e lirisë" që u betuan në uniformën e ushtrisë shqiptare, për bashkim kombëtar dhe më në fund u bënë partnerë dhe se ajo farë "Marrëveshje e Ohrit" as që ishte në favorin tonë, por këta e pranuan dhe ajo pastaj u ndryshua. Nëse ju kujtohet kur ish-presidenti maqedonas Trajkovski bëri ndryshime në atë "Marrëveshje", pikërisht njëri ndër komandantët e Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare, Rafis Haliti deklaronte: "...nëse vetëm një presje i hiqet "Marrëveshjes së Ohrit, do të pëlcet pushka ..."!

Aty u bënë “marrëveshje të mëdha”- deklaronte ai. Dhe ky farë komandanti tani hesht, është qorruar nga korrupsioni dhe “kolltuku”, prandaj i mbyll sytë....

DAILY NEWS: Si e komentoni pranimin e Republikës së Kosovës dhe të pasaportave të saj nga Maqedonia?

XHEMIL ZEQIRI: Maqedonia ka probleme të mëdha me të gjithë: me Bullgarinë, me Serbinë dhe me Greqinë. Tani më dolën hapur, sheshit për emrin dhe në vend që të flasin shqiptarët, sepse emri Maqedoni është emër ilir, ata heshtin. Mirëpo presidenti Topi dhe pionieri i Titos Fatmir Sejdiu, i kanë futur veshët në lesh dhe nuk duan të dëgjojnë për këtë fakt, ata po heshtin!

Bullgaria e njeh shtetin e Maqedonisë, por jo edhe kombin, pra maqedonasit i konsideron si popull bullgar, ndërsa Maqedoninë si territor të saj. Serbia nuk ua njeh fenë as gjuhën. Gjithashtu edhe kjo e konsideron Maqedoninë si territor të saj, prandaj e ka njohur si shtet duke shpresuar se herët a vonë ajo do t´i bashkohet asaj, sepse është e lidhur me të që prej kohësh.

Dhe në fakt, ky shtet është formuar pas luftës nga xhelati Tito, edhe për t´i ndarë shqiptarët, si një republikë e dytë serbe.

Për më keq, si diçka që shkon në disfavor tonin është fakti që e vetmja Shqipëria, e udhëhequr nga Sali Berisha, e ka pranuar bile pa asnjë kusht, pa çarë kokën aspak për të drejtat e shqiptarëve që jetojnë në trojet e veta, brenda këtij shteti dhe përbëjnë një popullsi prej gati një milion.

Duke e shfrytëzuar këtë neglizhencë të shtetit amë, qeveritë e Maqedonisë, secila që vjen në pushtet, pa ndërprerë po bëjnë terror të paparë mbi shqiptarët. Dhe si për ironi të fatit, tani as “politikanët” e Kosovës, por as ata të Shqipërisë administrative (të udhëhequr prapë nga S.Berisha), kurrë nuk japin madje asnjë deklaratë kundër këtij terrori të okupatorëve sllavë.

Konsideroj që njohja e “pavarësisë “ së Kosovës nga Maqedonia sipas kutit të “pavarësisë” së Ahtisarit ka qenë edhe

presion ndërkombëtar dhe maqedonasit po e shohin qartë se kjo "pavarësi " e mbyllur në Pakon e Ahtisarit nuk është aspak në dëm të okupatorëve sllavë, por u jep atyre mundësi më të mëdha sesa kishin para luftës, për të qenë faktor i rëndësishëm në Ballkan.

DAILY NEWS: Me ligjin e ri për zgjedhje në Maqedoni do të kenë mundësi që edhe mërgimtarët të votojnë dhe më këtë të fitojnë edhe një deputet. A mendoni se ky propozim është i mirë për diasporën shqiptare?

XHEMIL ZEQIRI: Nuk e kam lexuar atë ligj, por mendoj se nuk mund të jetë aq shumë në favorin tonë, sepse po të ishte i mirë për ne shqiptarët, maqedonasit nuk do ta pranonin dot, por edhe nëse e pranojnë, çka mund të ndihmojë apo të ndikojë në politikën shtetërore një deputet dhe me siguri që ai deputet do të jetë ndonjë servil që e pranon këtë politikë të ndyrë antishqiptare.

DAILY NEWS: A mendon se ky deputet do të luftojë më shumë për të drejtat e më.) rgatës shqiptare ? (arsimimin e gjeneratave të reja të mërgimtarëve në gjuhën amtare etj

XHEMIL ZEQIRI: Mërgatën e kanë shfrytëzuar partitë politike shqiptare dhe në fund e kanë lënë në harresë dhe si mos më keq të përçarë dhe me shumë halle, sepse sa herë që shkojnë bashkatdhetarët tanë në vendlindje, kurdoherë ankohen për maltretimet që u bëhen nga Sllovenia, Kroacia, Serbia dhe në fund nga Maqedonia dhe kjo ka një prapavijë të qëllimshme që t´i lodhin dhe t´i thyejnë shqiptarët, që ata të heqin dorë nga vatrat e tyre ku kanë lindur dhe t´i adaptohen Perëndimit, pra të asimilohen përfundimisht në ato shtete ku jetojnë"përkohësisht".

DAILY NEWS: A jeni human?

XHEMIL ZEQIRI: Po, jam dhe kjo më ndihmon që shpirtërisht të jem i qetë. Humanizmi me flenë në shpirtin. U bënë gati 30 vjet dhe kurrë nuk i kam kursyer lekët për çështjen

kombëtare dhe atje ku e kam parë se ka njerëz në nevojë, u kam ndihmuar atyre, me aq mundësi që kam pasur dhe këtë e bëjë kurdoherë, deri sot dhe do ta bëjë edhe ne

DAILY NEWS: Dëshira juaj e parealizuar?

XHEMIL ZEQIRI: Po, dëshira ime ka qenë dhe është që shqiptarët të kenë të drejta kombëtare dhe sociale, këto që deri tani na mohohen jo vetëm nga sllavët e jugut, por edhe nga bashkësia ndërkombëtare.

Pluralizmi shumëpartiak në Shqipërinë natyrale, u keqpërdor tej mase për faktin që po mungon një unitet i duhur GJITHËKOMBËTAR. Merreni me mend, sa marrëzi politike kjo që sot ekzistojnë mbi 100 parti, që betohen ditë e natë në parimet demokratike, kurse territoret shqiptare ende mezi po gjallërojnë të copëtuara, madje akoma më zi, janë bërë dhe po bëhen ricopëtime të reja që dikur nuk i kishim ashtu, para tri luftërave të fundit që i bëmë ne shqiptarët.

Këto parti që dolën si "kërpudhat pas shiut", nuk janë të interesuara për t´i fituar ne shqiptarët të drejtat kombëtare dhe barazinë si kombet e tjera në Ballkan e më gjerë, por ngatërrohen kot së koti për të ardhur në pushtet pa një shtet shqiptar të përparuar dhe të ribashkuar në rajon.

Këto, pastaj i kanë ngritur shigjetat kundër njëra-tjetrës për çështje ideologjike, fetare e të tjera gjëra që janë të rendit të dytë apo të tretë.

Pra, dëshira ime është të jemi të bashkuar, të sinqertë ndaj njëri-tjetrit, ideologjia jonë mbi të gjitha, duhet të jetë shqiptaria . Duhet vepruar me këmbëngulje dhe me çdo çmim për të arritur të drejtën tonë si komb, për VETËVENDOSJE, e drejtë kjo, e cila po na mohohet nga okupatorët sllavë dhe nga miqtë e tyre kudo nëpër botë!

DAILY NEWS: A bëhesh nervoz?

XHEMIL ZEQIRI: Po si të mos bëhem nervoz. T´ua them të drejtën, festat fetare, as nuk i shikoj në TV-studiot shqiptare. Kujtoj faktin këtu që politikanët shqiptarë deri dje deklaroheshin se ishin ateistë, të pafe, kurse tani shihen duke u gajasur në mes të priftërinjve dhe hoxhallarëve para kamerave. Përse e bëjnë këtë, mund ta di edhe një njeri më naiv, pa u thelluar gjatë. Këtë e bëjnë vetëm për të mashtruar popullin që kinse " janë në udhë të Zotit", që pastaj, ky popull i gjorë, i varfër dhe i shtypur, t´i votojë këta manipulues. Pastaj, janë po këta kameleonë të mjerë, që deri dje bërtisnin deri në kupë të qiellit: RROFTË KOMUNIZMI!

Janë gjithashtu po këta shkretanë që deri dje ishin në ballë të luftës ideologjike kundër fashizmit, kurse tani thonë pa pikë turpi se fashizmi paska qenë më i mirë se komunizmi,e gjepura të tjera.

Madje shkohet aq larg në marrëzira, sa që njëfarë "bukuroshi", Fatmir Mediu, ish-ministër i Mbrojtjes i Shqipërisë, ky palo "bukurosh" republikani e monarkisti, shkon vajton dhe vendos kurora me lule tek ish-ushtarët fashistë gjermanë të rënë gjatë LDB-së, shkon atje për t´u hequr "më papë se papa" duke harruar se ata erdhën të vrasin dhe i vranë 28 mijë shqiptarë liridashës, në trojet e veta stërgjyshore. Duke harruar gi cili gjithashtu që këtë "nderim" nuk e bëjnë dot, as ministrat e mbrojtjes të vendeve më të zhvilluara demokratike?!

Pra, ky farë zotëria i maskuar si demokrat , por në fakt rehabilitues cinik dhe i mjerë i fashizmit, e tregoi qartë pafytyrësinë e tij prej matrapazi në rastin e Gërdeci, ku si duket është involvuar në tregtinë e armëve. Për këtë "së shpejti" pritet ta thotë fjalën e vet gjykata e Tiranës.

Përderisa "fatmirët" i nderojnë në pikë të ditës ish-ushtarët e fashizmit, njëkohësisht po prishen dhe po fyhen monumentet e komandantëve dhe të partizanëve çlirimtarë, të atyre që e dhanë jetën për lirinë e Shqipërisë. Po si të mos bëhesh nervoz kur në

ekranet televizive e shohim Ismail Kadarenë, i cili gjatë sistemit socialist ishte nënkryetar i Frontit Demokratik dhe njëri ndër shkrimtarët më të privilegjuar në Shqipërinë socialiste, kurse tani çirret si papagall i çmendur duke shpifur dhe sharë sistemin socialist dhe ish-udhëheqësit e tij. Shpif dhe trillon gjëra të paqena, fantazi si në romanet kriminalistike, ndaj atyre që deri dje u thuri himne, e në veçanti ndaj Enver Hoxhës.

I përbuz tani ata që popullin e drejtuan afër 50 vjet , hedh gur ndaj atyre që popullit i dhanë bukë, drita dhe shkolla, të cilat tani, edhe pas kaq vitesh, po i mungojnë në këtë të ashtuquajtur sistem "demokratik".

I mohon ata të cilët për më tepër se 30 vjet e ndalën vëllavrasjen, e cila tani u rikthye si hienë famëkeqe dhe po ua humb jetën qindra shqiptarëve, po ua humb ardhmërinë e ndritur breznive të tëra. Natyrisht se bëhem nervoz kur Kadareja nuk e thotë asnjë fjalë kundër kësaj politike të ndyrë antishqiptare që po ndjekin ballistët dhe zogistët në Shqipëri, por për fatkeqësinë e karakterit dhe moralit të tij, jo rrallë edhe solidarizohet me ta. Kujtoj këtu deklaratën e tij të pacipë: "dy armiq e kanë dëmtuar rëndë Shqipërinë: perandoria otomane dhe komunizmi"!!!

Po si mund të komentohet kjo deklaratë e dhënë në TV-Alsat, veçse si një matufllëk i tijpolitik anakronik.

Në Shqipërinë administrative gjërat kanë shkuar aq për së prapthi sa që në Burrel po kërkohet të hiqet busti i Skënderbeut dhe në vend të tij të vendoset busti i satrapit, Amet Zogu! Kjo është e turpshme, kjo është e tmerrshme! Po nisma për heqjen e emrit të ndritur të Ismail Qemalit nga universiteti i Vlorës?! Pse nuk u dënua kjo nismë e errët nga shkrimtari Ismail Kadare?!

Ky shkrimtar i njohur nuk po reagon as kritikon si i ka hije, sepse koka i ka marrë erë, duke shpresuar që me përkrahjen e politikës shtetërore "demokratike" të Shqipërisë do ta marrë çmimin "Nobel". Prandaj jo rastësisht, i bëhen atij pritje madhështore nga pushtetarët. Madje përpjekja shkoi deri aty, pa menduar se po bëhen edhe qesharakë para botës, kur presidenti

Topi kërkoi që këtij shkrimtari me nam, t´i jepet ky çmim! Mbase marrëzirat e tilla askush nga politikanët e botës nuk i bën dot. Jo ore zotërinj, nuk jepet çmimi "Nobel" sipas "rendit" të lutjeve tuaja partiake dhe klanore!

Ismail Kadare kurrë nuk e kritikon klasën politike të sotme në trojet shqiptare dhe as komunitetin ndërkombëtar, për padrejtësitë që po na bëhen ne shqiptarëve, sepse ky plak matuf që prej viteve '90, është bërë leckë e Perëndimit, vetëm për të arritur majën e "meritave" letrare, pra me marrjen e çmimit "Nobel". Këto ditë e lexova në shtyp një reagim të fortë ndaj Ismail Kadaresë, i shkruar një poet yni në mërgim, i cili midis tjerash thotë: "mbase nuk i dihet, ndoshta edhe e merr ... por nëse nuk ta japin, dije se Perëndimi e ka kuptuar dhe vërtetuar, se ke qenë me bindje të thella, enverist"! Ndërsa unë tani do t´i thosha Ismail Kadaresë : "mbase nuk i dihet...por nëse nuk ta japin Nobelin, dije se kjo mund të jetë për shkak se tani ke evoluar së prapthi, me bindje të thella, si fashist". Them kështu sepse në vendet me demokraci të mëdha popullore, e urrejnë fashizmin e vjetër dhe të ri dhe e luftojnë atë me mjetet që ato i shohin të arsyeshme dhe të domosdoshme.

DAILY NEWS: Edhe pse të shtyrë ca në moshë, shumica nga ju veprimtarët e lirisë, vlerësoni se keni vullnet rinor. A mplaket "Baca" Xhemë?

XHEMIL ZEQIRI: Jo, nuk mplakem sepse nuk kam kohë as me u mplakur dhe ne të gjithë atdhetarët nuk kemi kohë për këtë, sepse konsiderojmë që ia kemi borxh atdheut të punojmë dhe veprojmë sa më gjatë dhe sa më shumë. Përndryshe do të na mallkojnë dëshmorët nëse amanetet e tyre nuk realizohen!

DAILY NEWS: Në fund të shtoni diç për lexuesit dhe abonentët e "Daily Neës Agency?

XHEMIL ZEQIRI: Lexuesve të Daily Neës ju dëshiroj një vit të mbarë! Konsideroj që kërkohet nga të gjithë që t´i ndjekin situatat

me vëmendje, sepse, situatat në Ballkan janë shumë të brishta, pastaj kriza ekonomike që i ka mbërthyer shtetet e Perëndimit gjatë vitit 2008 dhe kjo gjendje pritet të eskalojë më tej edhe viteve të tjera. Pra viti 2009 për shtetet kapitaliste do të jetë vit i vështirësive, prandaj duhet të jemi më të bashkuar, afër njëri- tjetrit dhe t´í ndihmojmë popullit me mundësitë që i kemi.

DIÇKA ËSHTË DUKE ZIER NË MAQEDONI

Intervistë nga Thomas Hjortsø, për të perditshmen daneze "Informacion", 24 shkurt 2001

Th.H: Disa episode të njëpasnjëshme në Maqedoni kanë rritur dyshimin se vendi ka fituar një ushtri kryengritëse të shqiptarëve.

Zeqiri: Në këto javët e fundit kemi marrë raporte të shumta ne lidhje me kontakte dhe episode tjera të ndryshme me kryengritësit shqiptarë ne Maqedoni. Sa del një informatë për një episod te kësaj natyre, po aq shpejt reagojnë zyrtaret maqedonas duke e refuzuar se, grupe te armatosura qëndrojnë pas.

Me gjasë, duket se kemi shtesë në aktivitetet e shqiptarëve të armatosur. Popullata shqiptare përbën së paku 25% nga numri i përgjithshëm i popullatës në Maqedoni. Shumë shqiptarë shprehen se ata diskriminohen nga shumica e popullatës sllave atje.

Në Ballkan dhe në Perëndim po ashtu, kanë frike se shqiptarët duan të shkëputen nga Maqedonia dhe në këtë mënyre të krijojnë një tjetër vatër zjarri në Ballkan.

Këto shqetësime bënë që këtë javë trupat e NATO-s në Kosovë t'i shtojnë patrullimet në kufirin mes Kosovës dhe Maqedonisë. Kjo ndodh pasi që disa grupe të kryengritësve janë parë duke lëvizur në kufi. Para ca javësh ka pasur kontakte me kryengritësit brenda në Maqedoni. Në muajin e kaluar u vra një polic maqedonas nga një sulmi që u bë ndaj një stacioni të policisë.

"Jemi shumë të shqetësuar", ofshan një diplomat perëndimor në Kosovë, për gjendjen në Maqedoni. Në Kosovë, tanimë kemi konflikte mes serbëve dhe shqiptarëve dhe brenda në kufi të Serbisë luftojnë shqiptarët me ndihma nga Kosova, kundër forcave të sigurisë të Serbisë. Kjo ndodh në luginën e Preshevës që gjendet në Serbi, ku takohen kufijtë e Maqedonisë dhe të Kosovës.

UÇK marshon përsëri!

Kur UÇK - Ushtria Çlirimtare e Kosovës u krijushta në vitet e 90-ta, ishin shumë persona që thoshin se nuk ekziston një gjë e tillë. Në Maqedoni duket se po ashtu po i mbyllin sytë nga një grup i ngjashëm lokal.

Pas sulmit ndaj stacionit të policisë dhe një treni, grupi që thirret në UÇK e ka marrë përsipër këtë aksion. Edhe më herët kanë lëshuar komunikata, sa herë që kanë bërë ndonjë aktivitet.

UÇK e Kosovës në shqip do të thotë Ushtria Çlirimtare e Kosovës (danisht Kosovos Befrielseshær), e cila formalisht është zhdukur. Tani është UÇK e Maqedonisë. K-ja do të thotë "kombëtare", d.m.th. nacionale, apo Ushtria Çlirimtare Kombëtare. Kjo ka bërë të mendohet se UÇK e vjetër është e përzier këtu. Ekzistojnë lidhje të afërta mes shqiptarëve të Kosovës dhe atyre të Maqedonisë.

"Ne shohim një shtim të aktiviteteve nga shqiptarët e armatosur", thotë Brenda Pearson, e cila në Maqedoni është si analist politik për grupin **Inernational Crisis Group**.

"Por unë nuk mendoj se është një lëvizje e koordinuar. Bëhet fjalë për njerëz në grupe nga 20 -30, të organizuar rreth një udhëheqësi të tyre. Shpeshherë bëjnë kontrabandë ose jetojnë nga një formë tjetër kriminale. Mund edhe të fusin ndonjë përmbajte politike", thotë ajo, duke nënvizuar se nuk i njohin këto grupe apo prapavijat e tyre.

"Ata jetojnë nga trazirat që ekzistojnë përreth Maqedonisë. Ata mundohen ta destabilizojnë shtetin për t'i arritur qëllimet e veta. Lufta politike e tyre ka të bëjë me krijimin e sa më shumë të mirave për shqiptarët në Maqedoni. Një grup shumë i vogël mundohet për ta krijuar Shqipërinë e Madhe" - thotë ajo.

Autoritet maqedonase kanë refuzuar se prapa tyre qëndrojnë grupe të organizuara.

Edhe vjet bënë të njëjtën gjë, kur disa stacione policore u sulmuan me bomba.

Atëherë ishin shumë vetë që mendonin se ekstremistët shqiptarë qëndronin prapa tyre, por qeveria e Maqedonisë u frikësua për ta pranuar këtë, pasi që kjo shkaktonte ndarje në koalicionin qeveritar shqiptaro-maqedonas.

Edhe sot, mendon Brenda Pearson, nuk duhet t´ua varim veshin kur qeveria maqedonase nuk pranon se grupe të organizuara shqiptare rrinë prapa këtyre aktiviteteve. ”Autoritetet mundohen ta qetësojnë popullatën. Zyrtarët duhet dhe patjetër e kanë t’i refuzojnë mendimet, kur kryengritja e organizuar kërcënon” - mendon Brenda Pearson.

”Qeveria është nën presion nga opozita e cila thotë se sulmet e armatosura tregojnë se shteti është në rrezik”.

Shqiptarët janë të hidhëruar.

Arsyeja e sulmeve të armatosura duhet ndofta të shikohet nga pakënaqësia në rritje e shqiptarëve, me gjendjen e tyre në Maqedoni. Shqiptarët po ashtu ndihen të tradhtuar nga partia shqiptare që është pjesë e koalicionit qeveritar.

”Populli shqiptar është si vullkan. Shqiptarët janë të inatosur që ende janë qytetarë të rendit të dytë në Maqedoni“ - thotë Xhemil Zeqiri, i cili vjen nga pjesa shqiptare e Maqedonisë, por tani jeton në Danimarkë. Ai e përcjell me vëmendje situatën atje.

”Është bërë një radikalizim i shqiptarëve atje, që nga vera e kaluar, kur vendosën të krijojnë një universitet shqiptar” - shton më tej Xhemil Zeqiri.

Shumë shqiptarë janë kundër universitetit privat shqiptar, pasi që ai është më i shtrenjtë se universiteti shqiptar, i cili tani duhet të zhduket. Në disa drejtime bile kërkohet që të flitet edhe gjuha shqipe.

” Unë kam takuar shqiptarë të cilët duan t´i zgjidhin problemet në mënyrë paqësore, por nëse kjo s´bëhet, atëherë ata janë të gatshëm t´i rrokin armët”, thotë me bindje të plotë Xhemil Zeqiri.

Brenda Pearson mendon të kundërtën. Sipas saj, kanë ndodhur përparime për popullatën shqiptare, në këtë qeveri dyvjeçare.

”Është një koalicion i fortë qeveritar që ka zgjidhur shumë probleme”. Ajo pastaj mendon se mund të bëhet një radikalizim i shqiptarëve. ”Çështja shqiptare në Maqedonie është një çështje me rëndësi në Ballkan. Kjo çështje nuk mund të zhduket përnjëherë” - thotë ajo.

Fund

UNË DUHET TË BËJ PËR SHQIPËRINË DHE JO SHQIPËRIA TË BËJË PËR MUA!

Intervistë me gazetarin Fadil Shyti, Kopenhagë, më 17 korrik 2010

Fadil SHYTI: Kohëve të fundit në të gjitha hapësirat shqiptare, po zhvillohen ca ngjarje "të reja", sa je në rrjedhat e këtyre situatave?

Xhemil Zeqiri: Po, ke të drejtë, kohëve të fundit po zhvillohen ngjarje "të reja", për faktin se politika shqiptare është në defensivë. Në radhë të parë andej nga Tirana, po ndodhin ngjarje tejet të pakëndshme për çdo shqiptar. Fjala vjen rreth atyre zgjedhjeve të para një viti, po bëhet aq problem hapja e atyre kutive, sikur opozita të kërkonte të hapej toka!

Në fillim qarqet ndërkombëtare nuk e morën shumë seriozisht këtë kërkesë, mirëpo vendosmëria e opozitës me protesta e greva, bëri që kjo çështje të internacionalizohet tej mase. Pastaj filloi ndërhyrja e ndërkombëtarëve që të stabilizohej situata. Kjo u bë si mbulesë për përkrahjen që ia dhanë ata S. Berishës, pra të mos kompromet ohen edhe ato qarqe evropiane. E faktoj këtë me një shembull: E keni parë disa herë në ekranet televizioneve se, sa herë që rrymat e djathta, pro-serbe në Evropë depërtojnë t´u japin përkrahje forcave të tyre në Tiranë, opozitën menjëherë e viziton ambasadori amerikan. Mbase kjo do të thotë se amerikanët po i shohin si lojëra të rrezikshme të këtyre forcave në Evropë, që po zhvillohen në Shqipërinë Londineze. Dhe, më tej, nga kjo konstatoj se, fatkeqësisht, fuqitë e mëdha po tallen me politikanët shqiptarë.

Sali Berisha dhe qeveria e tij si duket janë të interesuar vetëm t´i përçajnë shqiptarët dhe ta destabilizojnë Shqipërinë, për ta stabilizuar Ballkanin. Sipas "lojërave" politike: Sa më keq dhe më e destabilizuar që të jetë gjendja në Shqipëri, aq më shumë kjo u shkon

përshtati armiqve që na rrethojnë. Bile, për këtë shërbim ndaj tyre, shumë forca antishqiptare e financojnë këtë qeveri antidemokratike.

Ngjarjet tragjike në Kosovë, në Iliridë e gjetiu në trojet tona etnike, aspak nuk po e tundin ”fronin” e pushtetit berishian. Përkundrazi, në sferën ndërkombëtare vetëm sa po e forcojnë më tej. Sa irritues është fakti kur ministri i Punëve të Jashtme, Ilir Meta, pa menduar gjatë, shkoi në Beograd, për t´ua nderë dorën serbëve. Dhe për më keq, atje pranoi në heshtje absurdin se kinse në Shqipëri paska një minoritet serb!

Nga kjo kujtoj me keqardhje se, vërtet me këtë vizitë të tij atje, çështja shqiptare u dëmtua rëndë. Si mund të shpjegohet fakti që policia maqedonase pa gjyqe po i vret shqiptarët, siç qe rasti i komandant Harun Aliut me shokë, ndërsa Tirana zyrtare të mos ketë madje as edhe një reagim për ato vrasje mizore?! Ndërsa krejt ndryshe po vepron qeveria e Beogradit.

Fadil SHYTI: Si i komentoni rrethanat e krijuara për shqiptarët në trojet e pushtuara kudo në Shqipërinë Etnike?

Xhemil Zeqiri: Çfarë të them ore?! Jam i detyruar të pohoj se vërtet mjerim politik! Po filloj me ngjarjet tejet tragjikomike lidhur me gjyqin e të madhit atdhetar, Albin Kurti. Gjithë ajo furtunë për të mbuluar tragjedinë e shkaktuar nga policia rumune e UNMIK-ut. Dhe në fund, si i thonë fjalës: “U trand mali, polli mi”. ”Fajtori” u gjet dhe u dënua me 9 muaj!! Qëllimi i ndërkombëtarëve dhe i politikanëve servilë ndaj tyre qe, vetëm të ndalohet hovi i protestave dhe i demonstratave që kishin suksese në terren, i Lëvizjes Vetëvendosje dhe i politikës së saj të drejtë, me orientime për zhvillime të reja, vërtet në dobi të kombit shqiptar.

Pastaj, ende pa u tharë gjaku i katër atdhetarëve të UÇK-.së, të vrarë nga policia maqedonase, këto ditë e dëgjova në lajme një takim të stilit të ”vëllazërim-bashkimit” titist. Atje në malet e Sharrit, po mbahej një takim me ftesë të presidentit të Kosovës, Fatmir Sejdiut, me kryetarin e Maqedonisë dhe atë Malit të Zi. Bile

aty u derdhën lot krokodilësh të "kombit jugosllav", pse nuk ishte në mesin e tyre edhe kryetari i Serbisë "paqësore". U bë kjo mbledhje kinse për të ashtuquajturin "mini-shengen" ballkanik.

Sa shumë po i hidhet hi syve - popullit shqiptar dhe popujve të tjerë në këto hapësira! Bëhet zhurmë, kinse shtetet e Ballkanit po e presin orën e madhe të bashkimit në Bruksel! Pastaj, atje gjithçka do të zgjidhet drejt dhe gjithçka do të rrjedhë si vaj ulliri!

Duke bërë zhurmë kinse për integrime evropiane, po mbulohen qëllimisht problemet tejet të pazgjidhura të kombit shqiptar, po injorohet me cinizëm integrimi i shqiptarëve. Mos të harrojmë se shqiptarët i bënë tri luftëra për t´u ribashkuar në mes tyre, e jo për t´u ribashkuar me Evropën, sepse në Evropë ishim dhe jemi.

Pastaj, hiç më e mirë gjendja nuk është në Maqedoni. Atje politikanët shqiptarë, me në krye Ali Ahmetin, po tallen me çështjen shqiptare. Tani shtroj pyetjen: Pse politikanët shqiptarë nuk e zgjidhin problemin e çështjes shqiptare?! Bile as e shtrojnë këtë problem për zgjidhje, ndërsa Greqia, përkundër problemeve të brendshme, si kriza ekonomike që e turbullon për më tepër se një vit, nuk lejon dot që pa u zgjidhur drejt problemi i emrit të Maqedonisë, të ecën kjo përpara në BE.

Fadil SHYTI: Ku i shihni përparësitë e diplomacisë shqiptare dhe prapakthimet e kësaj politike?

Xhemil Zeqiri: Po ç´përparësi ore vëlla ka politika shqiptare?! Kjo politikë prapakthimi, në fakt ka vetëm një "përparësi". E ka servilizmin e tejskajshëm ndaj ndërkombëtarëve të të gjitha ngjyrave. Po, sa po mund të kuptoj, fakti qëndron aty se që kur e mori pushtetin me mashtrime, hajni e dhunë S. Berisha dhe bandat e tij, Shqipërinë e mjerë e dogjën dhe e shkatërruan, popullin e në veçanti rininë - e varfëruan, e lanë rrugëve, e "çliruan" të ikën, të përjashtuar nëpër Evropë e gjetiu. Kujto vitin 1997 kur popullit i erdhi zullumi në majë të hundës nga kjo qeverisje servile serbo-greke. Gjendja shkoi deri aty, sa u detyrua të rebelohej për hajninë

që e bëri me piramidat. Njerëzit humbën shumë pasuri dhe pastaj, me pushkë në dorë e rrëzuan nga pushteti Sali Ramë Berishën.

Pas asaj lufte qytetare, apo si ta quajmë, forca të vërteta demokratike shqiptare mezi e qetësuan popullin, duke e detyruar për të dhënë dorëheqje nga pushteti që e ktheu në anarki, me marrëzitë e tij vetë S. Berisha. Pastaj u zhvilluan zgjedhjet. Dihet se në ato zgjedhje fitoi PS-ja dhe me të gjitha hallet që kishte Shqipëria dhe kombi shqiptar, përsëri dinte ta drejtonte timonin nga ardhmëria. Jo se PS-ja ishte aq shumë e angazhuar që të plotësonte amanetin e heronjve të gjakosur dhe të burgosur për 100 vitet e fundit, por vërtet bëri aq sa diti e mundi. Edhe në ato kushte tepër të rënda që ishin krijuar.

Unë mendoj se njëra ndër arritjet më të mëdha në fushën e politikës shqiptare gjatë asaj kohe, ka qenë dhe do të mbetet aprovimi i Kushtetutës shqiptare. Sot Shqipëria e ka një Kushtetutë, vërtet demokratike. Mirëpo, këtë fitore armiqtë tanë si zagarët e nuhatën dhe i ranë në gjurmë. Pastaj kanë bërë çdo gjë që miqtë e tyre serbë, si Damir Fazlliqi e viçër të tjerë sllavë të vijnë në pushtet, bashkë me forcat e djathta, me Berishën "në krye", sepse vetëm në këtë mënyrë do të kishin terren nga përkrahja e tij që të rriten interesat serbo-greke në Ballkan. Dhe ja argumenti: Në zgjedhjet e parafundit politika e S. Berishës e pranoi statusin e pavarësisë së kushtëzuar, nëpërmjet ministrit të tij të Jashtëm B. Mustafaj, që do të thotë se tani e më tej, nëse realizohet kjo pavarësi e gjymtuar, atëherë Kosova do të jetë e varur në shumë aspekte (si tregtia, kontrabanda, enklavat etj) nga Serbia dhe më tej e pavarur nga Shqipëria.

Më shtrove pyetjen për përparësitë! Po çfarë përparësish ore? Sot e kësaj dite shqiptarët janë të izoluar edhe pas gjithë kësaj zhurme të madhe, kur po trumbetojnë se jemi në Evropën politike, se do t´i heqim vizat. Mirëpo kur jemi këtu, kujtoj se neve shqiptarëve vizat nuk na i heqin lehtë, por edhe nëse na i heqin, Evropa kurvë do t´i formojë disa rregulla, me kushte speciale për Shqipërinë. Mos mendoni se ata e futën Shqipërinë nën ombrellën e

NATO-s se iu dogjën zemrat dhe për të mirën tonë. Ata duan që shqiptarët vetëm të jenë shërbëtorë të huaj, ndërsa Shqipërinë nuk janë në gjendje ta mbrojnë nga askush. Fatkeqësia e madhe qëndron aty se në të ardhmen ushtria shqiptare do të përdoret "mish për top", duke shkuar në vende të huaja për t´i zgjidhur çështjet e pazgjidhura për botën, ndërsa ende çështja shqiptare ka mbetur tejet e pasigurt!

Ja, në këtë farfuri që e ka futur Shqipërinë dhe në këto borxhe që e ka zhytur Shqipërinë në bankat e huaja, NATO-ja e detyron që atje ku ata e kanë humbur luftën, ta paguajnë popujt e varfër! Tani Shqipëria duhet të rregullojë 5 shkolla dhe 200 studentë i shkolloi në Tiranë dhe shumë obligime të tjera, me gjakun dhe me shpenzimet e shqiptarëve, ndërsa qe besa, kjo nuk ndodhi në kohën e socializmit. Kujtoj këtu faktin që asnjë metelik BRSS-ja nuk e shfrytëzoi nga Shqipëria. Përkundrazi, Shqipërinë komunistët shqiptarë e bënë një kala të pamposhtur!

Fadil SHYTI: Por, megjithatë, mos nga ky anëtarësim a do të kemi ca përfitime?

Xhemil Zeqiri: Lëri dhe injoroi tani matrapazët dhe servilët se çfarë deklarojnë! Mendoj se këto deklarata që janë "për t´i mëshiruar" politikanët e sotëm, i bëjnë nën trysninë e ambasadave të huaja që tani janë bërë "zonja" shtëpie në Tiranë. Gjithashtu S. Berisha, për t´i humbur gjurmët e tradhtisë së vet, tani ka ngritur "në rend dite", tragjedinë e Tivarit dhe natyrisht që po e harron tragjedinë e Gërdecit e të gërdecave të tjerë si Otranto dhe për më tepër e harron tragjedinë e shqiptarëve gjatë tri luftërave shqiptare. Por është një ide gjeniale kur thuhet: "Sulmi është mbrojta më e mirë"!

Fadil SHYTI: Çka ju ka nxitur më shumë në veprimtarinë tënde dhe çka ju step në këtë rrugë, të shtruar jo kurdoherë me "dafina"?

Xhemil Zeqiri: Ke të drejtë, nuk ka qenë e shtruar me dafina, sepse çdo lëvizje, takim e të tjera, në radhë të parë përmbante

rreziqe, sepse jo më kot thotë populli se "politika, shpesh është shpatë me dy tehe". Prandaj, të lëvrosh në hullitë e saj, nuk duhet vetëm trimëri por kërkohet më shumë se gjithçka, shumë mençuri! Dihet fakti se, duke përfituar nga gjendja jonë e rëndë, qarqe të ndryshme ndërkombëtare, qoftë edhe ato përparimtare, nuk bëjnë dot ndonjë hap përpara, pa i nxitur ndonjë individ apo faktorët tanë politikë, me takime, darka etj. Natyrisht se të gjitha këto kërkojnë shpenzime materiale dhe për t´i arritur objektivat tonë, pothuaj tërë kohën është dashur që këto shpenzime t´i kem bërë me djersën time, pra me lekët e mia.

Paramendoje faktin kur në Këshillin për Politikë të Jashtme, me ne në Parlamentin danez ka qenë nënkryetari i përgjithshëm LPK-së, Muhamet Kelmendi dhe pas shumë aktiviteteve të tjera, intervistave e të tjera, u detyrova t´i them Muhametit se po kam probleme me këta "pehlivanët politikanë" shqiptarë këtu në mërgim, për faktin se po më sabotojnë dhe tani e tutje nuk do të mund t´ i njoftoj për veprimtarinë siç qe kjo e sotmja. Natyrisht, Muhameti ishte shumë i kënaqur për ato takime dhe me tha: "Ti vazhdo punën, ndërsa ata le të bëjnë çfarë të duan"!

Po kështu dhe me po ashtu! Unë gjithnjë kam dashur t´u imponohem institucioneve daneze. Dhe nëpërmjet meje kanë qenë në Danimarkë, për punë politike dhe shtetërore, Bujar Bukoshi, pastaj më vonë përfaqësuesi i Zyrës së Qeverisë së Kosovës në Stokholm, që e përfshinte edhe Danimarkën. Është ftuar zyrtarisht Dr. Shaqir Shaqiri. Pasi e bëri vizitën e pa se ç´mundësi kishte në Danimarkë. Atëbotë Sh. Shaqiri e dha një vlerësim për punën time aty të cilin vlerësim e kam të botuar në librin tim: "Në mbrojtje diplomatike të çështjes shqiptare".

Gjithashtu, kam organizuar disa konferenca ballkanike dhe debate publike. Paramendojeni faktin që në atë kohë në Parlamentin danez organizova një debat publik për situatën politike. Pasi doli në skenë e lavdishmja UÇK, përfaqësuesit politikë u ftuan të vijnë dhe të debatojnë në atë debat. Aty pati ligjërues edhe nga Unioni i studentëve të Prishtinës, ishin të ftuar dhe disa të tjerë që, mjerisht

nuk erdhën. Pati në debat edhe politikanë të pozitës edhe të opozitës , gazetarë edhe analistë dhe të tjerë që merrnin pjesë. Shumë organizata e përcillnin debatin, mirëpo përfaqësuesi i UÇK-së nuk erdhi, sepse s´pati kohë.

Do të dëshiroja të theksoj faktin se gjatë luftës sonë çlirimtare dhe bombardimeve të NATO-s, në Kosovë u krijua Qeveria e përkohshme nga delegacioni që përfaqësuan në Rambuje. Kryeministër e bënë H. Thaçin. Në një takim të Partisë Social Demokrate daneze me të cilën kisha një bashkëpunim të shkëlqyeshëm, kërkova prej tyre dy gjera:

1. Të bëjnë përpjekje të dihet ku është Ukshin Hoti dhe të lirohet menjëherë.

2. Të organizohet një vizitë këtu në Danimarkë, për kryeministrin H. Thaçi.

Sekretari gjeneral, Erik Bool që ka qenë dhe në Shkup, Tetovë, Prishtinë, Tiranë etj., më tha: "Për z. Ukshin, ne nuk e kemi më ambasadën tonë në Jugosllavi, mirëpo do të interesohemi të dimë si është gjendja dhe do të bëjmë të gjitha përpjekjet që ta shpëtojmë nga burgu dhe pastaj do ta sjellim për shërim këtu, në spitalet daneze. Ndërsa për kryeministrin tuaj, nuk e kemi lehtë ta sjellim këtu, sepse Kosova nuk është subjekt-shtet i njohur ndërkombëtarisht, por ka ndonjë mundësi tjetër që do bëjmë. E kuptoj se është shumë mirë dhe një hap shumë i fort diplomatik. Ti bisedo me të dhe atje të caktojnë një datë kur do ai të vizitojë Danimarkën. Ne ia bëjmë atij një pritje zyrtare dhe një takim zyrtar edhe me kryeministrin tonë që është kryetar i Partisë - Paul N. Rasmusen-in. Pastaj do ketë takim edhe me ministrin e Jashtëm danez dhe me atë të Drejtësisë. Do të ketë takime me gazetarë. Këto të gjitha unë i marr në përgjegjësinë time".

Unë dëshiroja që kjo vizitë të ketë sukses, nuk e humba kohën, por menjëherë i telefonova Ibrahim Kelmendit dhe i tregova se këtu është kjo mundësi. Ai menjëherë e pranoi idenë dhe tha se kjo është shumë punë e mirë! Atë e pyeta: "A ke mundësi që Ti ta sigurosh

me Thaçin, sa më shpejt që të jetë e mundur. Dëshiroj të jetë kjo vizitë, bile pas shtatë ditësh".

Ibrahim Kelmendi si kurdoherë, si një veprimtar i palodhur për çështjen kombëtare, aty për aty ma ktheu: "Ja ku e ke, bisedo vetë"! Bisedova me H. Thaçin. Atëbotë, unë kujtoja se ai është në luftë, por në fakt ai ishte në Bochum të Gjermanisë, atë ditë.

Ia shpjegova rastin për takimin me aq rëndësi të madhe dhe natyrisht që pranoi. Mirëpo më tha: "Ja ku e ke këshilltarin tim, Bilall Sherifin. Merruni vesh me të, për datën e të tjera".

Bisedova me Bilallin, i shpjegova fort mirë. Bilalli më tha: 'Mirë pra, e lëmë të vijmë nesër një javë'. Duke folur, e ndërpreva bisedën dhe i them Erikut: 'A bën nesër një javë'? Ai bëri me shenjë se bën dhe e vazhdova bisedën duke ia shpjeguar takimet që do t'i organizojë Bilalli. Më dha edhe një numër telefoni ku do t'i mbajmë kontaktet. Sa e mbylla telefonin, Eriku më tha: 'U bë mirë dhe ja edhe e-maili i Paul Nyrup Rasmussenit'. Erdhi dhe më tha: 'Xhemil, ti ri i qetë, mos u shqetëso fare. Unë do të bëj që ky takim të ketë sukses të madh'. Të faleminderit - i thash.

Sa dola jashtë dhe më hipën ca djersë të ftohta. Mendoja: Po sikur të mos vijnë e të më komprometojnë, edhe mua, edhe Partinë Socialdemokrate edhe Kryeministrin danez, etj. Për tri ditë rresht e kam thirrur në telefon, bile njëqind herë, po se po! Pas tri ditësh, aty nga ora 001 pas mesnate e hapi telefonin Bilalli. E thirra: "O, ku jeni bre burra, se jam mbytur duke telefonuar"?!

Pse - tha Bilalli?!!

Po dua të merremi vesh o vëlla, se ç´do të bëjmë, do vini vërtet, apo... Mos më komprometoni me danezët, sepse është shumë nivel i lartë takimi, prandaj dua të jem i sigurt.

Bilalli më tha: Të treguam datën dhe më nuk ka nevojë të bësh telefon, sepse atje e kemi kryetarin e LPK-së, Ibrahim Xhemajlin.

Obobo - sa u dëshpërova! Pastaj atij i tregova: 'Ai nuk di për këto punë more, sa nga kujdesi prej UDB-ës, aq edhe për faktin që ai nuk merr vesh në rrjetin politik e diplomatik të Danimarkës'.

Aty për aty, për një çast mendova t´i them: "Unë do ta ndërpres këtë punë"! Mendova kështu edhe për faktin se unë atëbotë qëndroja shumë ftohtë me I. Xhemajlin, për shkak të një interviste prej meje që bëri "bujë politike", kur një gazetar danez e lëshoi një lapsus krejt kot, kur shkroi se unë paskam deklaruar: "Shqiptarët po mbledhin lekë për UÇK-n dhe po përgatiten për luftë"! etj.

Për këtë lëshim, "gabim të madh diplomatik", ndaj meje disa herë e pat ngritur tonin lart, më bërtiste pa lidhje, ashtu si të isha fëmija i tij. Mirëpo, as unë nuk ia varja shumë veshin, pasi e dija se ai nuk merr vesh shumë në ato punë. E dija se gjuajtjet e mia me shigjeta në diplomaci në marrëdhëniet me miqtë danezë, vrisnin dhe vrasin larg, e këtë ai nuk e kuptonte. Por, njëkohësisht më vinte keq për të, sepse e dija që kishte vuajtur shumë në burgjet serbe.

Pasi ishin bombardimet, doja që lufta të ketë sukses dhe të mohohet ajo marrëveshja diplomatike. Shpresoja që takimin e H. Thaçit ta shfrytëzojmë në diplomacinë daneze kundër marrëveshjes së turpit të Rambujesë. Duke menduar dhe duke u kujtuar, menjëherë i telefonova Shaqir Shaqirit në Stokholm. E njoftova për këtë aktivitet të radhës. Ai burrë, si njeri intelektual dhe patriot që është, e kuptoi drejt qëllimin tim. Pastaj e ftova që të vinte dhe ta shoqëronte delegacionin e H. Thaçit. Unë do ta pres biletën, i thash.

Jo - tha ai! - Në Danimarkë vij me lekë të mia, sepse jam i bindur se vërtet ke shumë miq nëpër institucionet daneze.

Bile me një rast u tha që këtu ta ndërpresin këtë fushatë ndaj meje, sepse "Politika" ka shkruar ashtu, për ndihmë UÇK-së. Ç´është e vërteta, gazetari i "Politikës", Jens Hltsø , më pyeti: 'A mblidhni lekë për UÇK-n'?

Po - ia ktheva! - Para pak ditësh, mërgimtarët këtu, vullnetarisht i dhanë mbi 1 milion korona daneze për UÇK-n.

Pyetja tjetër ishte: 'A blini armë'?

Jo, jo, sepse keni vendosur embargo ndaj nesh, ndërsa serbët po prodhojnë armë dhe po blejnë sa po munden.

Por ne i kemi dhënë përkrahje morale, politike dhe ekonomike UÇK-së. Kështu vepruam edhe në demonstratat e vitit 1981, ashtu kemi vepruar për ndihma minatorëve, me partitë politike, kur u krijuan më 1990 dhe tani e ka radhën UÇK-ja. Këtu për lexuesit po e paraqes letrën me të cilën Shaqir Shaqiri ka njoftuar për vizitën e H. Thaçit gjatë asaj kohe në Danimarkë: "Më 15 qershor të vitit 1999, falë angazhimit të veprimtarëve kosovarë në Danimarkë (mes të cilëve edhe veprimtarit shumëvjeçar, Xhemil Zeqiri), u realizua vizita e kryeministrit të parë të njohur ndërkombëtarisht të Kosovës, zt. Hashim Thaci, në Danimarkë. Kjo vizitë u realizua me ftesën e kryeministrit danez, Poul Nyrup Rasmussen me të cilin zt. Thaçi zhvilloi një bisedë të gjatë e të përzemërt.

Kryeministrin Thaçi e shoqëroi Përfaqësuesi Diplomatik i Kosovës në Suedi, dr. Shaqir Shaqiri, kurse kryeministrin Rasmussen një pjesë e madhe e ministrave të qeverisë së tij.

Përveç takimit me kryeministrin danez, zt. Thaçi mbajti edhe një ligjëratë në Institutin e Shkencave Politike dhe dha një intervistë për Televizionin qendror danez.

Ditën e dytë të vizitës së kryeministrit Thaçi në Kopenhagë, kryeministri danez Rasmussen shtroi drekë për delegacionin kosovar. Në këtë drekë pune morën pjesë edhe gjashtë ministrat kyç të qeverisë Rasmussen.

Përfaqësuesi diplomatik i Kosovës në Suedi, zt. Shaqir Shaqiri e përgëzoi zt. Xhemil Zeqiri për angazhimin e tij rreth kësaj vizite dhe për punën e tij të palodhshme shumëvjeçare për çështjen e Kosovës.

Jam i vetëdijshëm që e zgjata ca më shumë se që kujtoja këtë ngjarje, mirëpo rëndësi ka fakti të dihet që atëbotë vizita e H. Thaçit në Danimarkë, pati jehonë të madhe në sferën e politikës shqiptare dhe në qarqe të ndryshme ndërkombëtare.

Është tejet i habitshëm fakti që, as sot e mot, kryesia e LPK-së nuk e di që atë takim e kam organizuar unë, veprimtar i LPK-së, Xhemil Zeqiri!

Pata një bisede ca të "nxehtë" me Ibrahim Xhemajlin. Më tha: Ai "shoku" që "më këshilloi" dhe më tërhoqi vërejtjen për disa gjëra, më tha edhe një "njoftim", kinse dikur Kryesia e fondit "Atdheu në rrezik - Vendlindja thërret" paska dashur të më shpallë si njeri të dyshimtë! Tani këtë e "vërteton" në atë letrën, por njëkohësisht në atë letër që e ka shkruar "shoku" ynë, më jep këshilla që të mos shkruaj për emra, e të tjera. Prandaj, me atë rast i thashë Ibrahimit: Çfarë janë këto akuza pa bazë dhe pse nuk më keni treguar?!

Ibrahim Xhemajli rrudhi krahët dhe më thotë: Nuk më kujtohet!

Si mund të akuzohem unë ashtu, kur jam i pari që e kam ndihmuar dhe përkrahur luftën çlirimtare me të gjitha mundësitë, politikisht, moralisht dhe ekonomikisht, si njëri ndër veprimtarët më të hershëm këtu në Danimarkë. Këto që i them këtu, shumë lehtë mund t´i argumentoj jo vetëm unë, por mund të argumentohen nga të gjithë ata me të cilët kam vepruar. Pastaj, dihet fakti që unë kisha lidhje direkt me kryetarin e fondit "Vendlindja thërret", të ndjerin Jashar Saliun. Me të kisha së paku 3-4 biseda telefonike çdo ditë dhe si të injorohet tani aq lehtë fakti që atëbotë gazetarët danezë, me ndërmjetësimin tim bënin intervista me të. Ka dëshmi të forta se atëbotë kisha lidhje edhe me z. Bardhyl Mahmutin, ish-zëdhënës i UÇK-së për mërgatën që vepronte në Zvicër dhe më gjerë. Ky më së miri e njeh, si në dritën e diellit, veprimtarinë time dhe për këtë paraqitje të çoroditur nga kjo Kryesi e fondit, nuk di asgjë. Nga kjo kujtoj se ky Ibrahim Xhemajli, sikur pajtohet!

Dua të theksojë këtu faktin që unë as sot nuk e ndali dot, por edhe më tutje e vijoj veprimtarinë time me L.V. Ua përkujtoj këtu lexuesve rastin e vizitës së Albin Kurtit, vitin e kaluar në Danimarkë, kur ky djalë trim u prit nga parlamentarë, qeveritarë dhe gazetarë danezë. Pas kësaj vizite të tij, pas disa muajsh, një delegacion danez e vizitoi Prishtinën, me ç`rast u njoftua për gjendjen aspak të mirë që po mbretëron atje, përderisa popullit tonë po i mohohet e drejta e VETËVENDOSJES. Ata u njoftuan gjithashtu nga L.V. për

padrejtësitë e mëdha që po i bëhen kombit tonë nga qarqe të caktuara antishqiptare, për persekutimet ndaj Albinit dhe veprimtarëve të tjerë të L.V. dhe për servilizmin e pushtetarëve të Prishtinës ndaj UNMIK-ut dhe EULEX-it. Këta politikanë dritëshkurtër e bënë lesh arapi Kosovën duke e ricopëtuar përsëri, si në kohën e satrapit Tito, kur titistët e ndanë Kosovën Lindore nga gjiri i Kosovës etnike me decentralizimin e tyre "famoz".

Por, njëkohësisht tani e shtroj pyetjen: Po këta zotërinj që po më pengonin mua dhe po më këshillonin, çfarë janë duke bërë?

Këtyre zotërinjve u mungojnë veprimtaritë në shërbim të kombit, por jo, nuk iu mungojnë për asnjë çast, rrahagjokset e kota. Unë nuk e harroj faktin kur këta "dai" nga njëra anë rrihnin gjokset me veprimtarinë time, ndërsa në anën tjetër më thoshin: Mos u deklaro ti se po i bën këto veprimtari, por kinse po i bën Këshilli i LPK-së në Danimarkë.

Mirëpo, me pak fjalë dua t'ua bëj me dije lexuesve se këtij Ibrahim Xhemajlit që aq shumë iu gjeta pranë në kohë të vështira për shqiptarinë, tani si nuk i vjen turp kur indirekt nuk do që ta pranojë faktin se unë e solla H.Thaçin në Danimarkë. Por, kur ia argumentova këtë atij dhe jo vetëm atij, për një çast u zgërdhi dhe u tregua shumë i pacipë kur tha: "Ti e solle, po kush e ka kthyer"?!!

Unë ia ktheva: "O djalë i mirë, kryeministrin H. Thaçi e ka ftuar Shaqir Shaqiri. Unë i pata shkruar letër dhe i kërkova që ky, Shaqiri, në cilësinë e diplomatit të Zyrës së Kosovës në Stokholm, t´i shkruante kryeministrit danez që të vinte H. Thaçi në vizitë.

"Pallavra janë këto"! – tha i revoltuar I. Xhemajli.

Janë gjallë Ibrahim Kelmendi, Bilall Sherifi, Shaqir Shaqiri. Ky i fundit e ka argumentuar me një letër këto ditë dhe të tjerët mund ta argumentojnë nëse duan dhe nëse nuk kanë harruar! Thonë se "faji mbetet jetim", por kjo "harresë" nuk mund të mohohet dot. Them kështu sepse, nëse zotërinjtë kanë harruar, unë lirisht mund të shkoj dhe t´i hapi arkivat e Partisë Socialdemokrate, e marr një kopje, e botoj dhe pastaj do të binden ata që nuk duan të dinë se ky

takim aq i rëndësishëm, ka qenë pikërisht i iniciuar prej meje, ndërsa ju o bukëshkalë po më luftoni dhe më akuzoni pa asnjë arsye as fakt konkret se unë paskam vepruar në dëm të çështjes shqiptare, konkretisht në dëm të "Vendlindja thërret"!

Nuk dua të harroj faktin që t´i njoftoj lexuesit, përse mua dhe shumë bashkëveprimtarëve të mi, kaq shumë u drejtohen sulme dhe kritika qyqare nga disa prototipa ish-udhëheqës apo anëtarë të LPK-së sonë të lavdishme. Pa dyshim, për asgjë tjetër, por vetëm e vetëm për "mëkatet" e tyre, që as sot nuk po pajtohen dot me prapakthimet që politikanët e sotëm ia bënë Shqipërisë Etnike.

Fadil SHYTI: Cila parti, Lëvizje apo Organizatë që vepron sot në trojet shqiptare, konsideroni që po vepron sipas motos "nga fjalët në vepra", me cilën prej tyre jeni i angazhuar pa rezerva?

Xhemil Zeqiri: Pa dyshim, të gjithë aktivitetin tim e kam zhvilluar në emër të LPK-së. E tani është LVV (Lëvizja Vetëvendosje). Është një ndër Lëvizjet më të ndritura, me një strategji të qartë, me një platformë shumë të kuptueshme për popullin shqiptar dhe një sfidë e fortë për armiqtë e popullit tanë. Është Lëvizje që e ka arsyetuar dhe argumentuar publikisht dhe botërisht idenë për ribashkim kombëtar. Personalisht, këtu në këtë Lëvizje e kam gjetur veten (bashkë me Ty, i nderuar vëlla ideali, Fadil), që prej fillimit të veprimtarisë së saj.

Sa për ilustrim, për lexuesit po e jap një fakt: më datë 24 shkurt 1997 me një letër të hapur i drejtohem ministrit të Punëve të Jashtme të Danimarkës, Niels Helveg Petersen, me pyetjen: Përse popullit shqiptar nuk i lejohet e drejta e vetëvendosjes?!

Ajo letër u botua nga disa gazeta të përditshme këtu në Danimarkë. Këtë letër e kam botuar edhe në librin tim: "Në mbrojtje të diplomacisë shqiptare", Prishtinë, 1985, faqe 185.

Pra, këtë kërkesë tonë tejet të ligjshme e kam shprehur kurdoherë në intervistat e mia si dhe në shkrimet për shtypin danez.

Këtë ide e kam theksuar shpesh dhe natyrisht që shumë kishte dhe ka përkrahje, mirëpo ky zë, sado i fuqishëm, por "i vetmuar" në mërgim, sikur ngrihet kot, përderisa politikanët tanë atje në Shqipërinë tonë, nuk e ngrenë fuqishëm këtë kërkesë para faktorëve me peshë në qendrat e vendosjes. Përkundrazi, ata pafundësisht ende janë duke bërë politikë të marrë.

Fadil SHYTI: A jeni krenar apo jeni i zhgënjyer ndaj kësaj veprimtarie rreth 30 vjeçare?

Xhemil Zeqiri: Po, si të të them, kurrë nuk pendohem, por edhe krenar, jo se jo! Them kështu sepse nuk e arritëm atë fitore që e dëshironim, Ribashkimin e kombit ende nuk e arritëm, as të drejtën e popullit shqiptar të vendosë për fatin e vet. Pra që me referendum t´i jepet e drejta apo të pyetet populli se a do që të ribashkohet apo të ngelë kështu i ndarë dhe i përçarë si mos më keq.

Sa për dëshpërim, natyrisht se jemi të dëshpëruar, jo nga armiqtë, sepse ata po luftojnë për interesat e vet, por dëshpërohem kur kujtohem: Po ne, çfarë jemi duke bërë?!

Personalisht kam vepruar në kuadër të LPK-së, dega në Danimarkë dhe në fillim, si të themi të legalizimit, pati shumë të interesuar që të anëtarësohen, bile patëm mjaft anëtarë dhe ishin mjaft të interesuar të jenë aktivë. Aty u formua edhe një këshill që do merrej edhe me organizatat daneze, me gazetarët, e të tjera. Në atë kohë nuk pranonin të bëhet kryetar ai që kishte më shumë vota dhe vullnetarisht pranoi A. Kasami, ndërsa Ibrahim Xhemajli nuk pranoi ta merrte postin e kryetarit.

Unë dëshiroja të kryhen punët që kishin të bënim me informimin e opinionit danez. Në Këshillin që u krijua, menjëherë filloi aktiviteti dhe natyrisht që pati suksese. Por siç e kam theksuar dhe më parë në shkrimet e mia, për çudi udhëheqja e LPK-së i sabotonte aktivitet dhe në një mbledhje kërkova që t´i kemi vulat e degës së LPK-së, në Danimarkë. Por, në atë kohë Abdilhalim Kasami i sabotoi dhe ato u blenë me lekët e mia, ndërsa ai më tha:

”Si duket, ti nuk e kupton rolin, sepse i ke ngatërruar postet. Unë jam kryetar ”

Kam dëshmi të mjaftueshme se jam përpjekur që t´i ndihmoj, por këto ishin të kota. Çdo përpjekje ishte e kotë. Bile kam përshtypjen se edhe Ibrahim Xhemajli sikur frikësohej, apo ngase kurdoherë e merrte me inate me mua. Bile shpeshherë i ndërpritja marrëdhëniet me të, mirëpo kur dëgjoja se do të lëvizin me ndonjë aktivitet, gëzohesha dhe u ndihmoja.

Kujtoj se do ishte mirë të kemi një debat të hapur, por si duket këta zotërinj, as që kanë kurajën për këtë mundësi. Në fakt, unë jam i gatshëm ta bëj këtë me secilin prej këtyre që dëshiron, sepse kam mjaft dokumente, bile shumë argumente që ende s´janë të botuara.

Fadil SHYTI: A konsideroni se keni bërë mjaft për çështjen kombëtare?

Xhemil Zeqiri: Jo, kurrë nuk jam i kënaqur se kam bërë, për aq sa kam dëshiruar dhe sa do të dëshiroja! Personalisht jam përpjekur t´u qëndroja besnik dy parimeve:

a. Motoja ime ishte dhe ka mbetur e patundur se unë duhet të bëj për Shqipërinë dhe jo Shqipëria të bëjë për mua!

b. Pastaj, me këtë rast të kujtojmë të madhin atdhetar, Sulejman Vokshin i cili ka thënë para gjyqit: “Edhe tri jetë t´i kisha, të tria do t´i jepja duke luftuar për Shqipërinë, në luftë kundër pushtuesve turq” !

Tërë kohën, që nga viti 1981 që jam në Danimarkë, jam përpjekur që, jo vetëm njerëzit, por edhe gurët, t´i vë në lëvizje për çështjen kombëtare. Sa e sa herë kam bërë përpjekje të bashkëpunoj me shqiptarët, mirëpo mjerisht, në Danimarkë shumë herë më kanë penguar dhe më kanë nervozuar. Madje kjo më ka kushtuar shumë edhe ekonomikisht. I bënin ato pengesa me qëllim që të më dëshpëronin, apo ishin të nxitur nga armiqtë që tentuan dhe tentojnë edhe sot, ta bllokojnë veprimtarinë time në fushën diplomatike. Nuk e kuptoj as sot e kësaj dite.

Fadil SHYTI: Mos ishin dhe janë të nxitur nga të tjerët

Xhemil Zeqiri: Thua, i nderuar: Mos ishin dhe janë të nxitur nga të tjerët?! Lëri ore, të tjerët! Për këtë, ata e dinë më së miri nga kush! Por, për fatin e keq edhe vetë udhëheqësit e këshillit të LPK-së në Danimarkë, bile më kanë kërcënuar në një mbledhje, siç ndodhi në prezencën e Ibrahim Kelmendit kur me atë rast Ibrahim Kelmendi e ndërpreu Këshillin duke u thënë se në Danimarkë nuk ka Këshill të LPK-së. As atëherë, e as deri tani Ibrahim Xhemajli nuk është distancuar nga ato kërcënime që u drejtuan kundër meje!

Unë e kuptoj qëllimin tinëzar të tij. Ky zotëri "i qetë", e babaxhan, nuk dëshiron të prishet në shoqëri me askënd, nuk do që të ketë pasoja të çfarëdo natyre. I vjen më mirë të pasivizohet, siç ka qenë pasiv dhe pastaj të rrahë gjoks se sa punë ka bërë në Danimarkë.

Unë personalisht i kuptoj fort mirë edhe aktivistët që kanë qenë të përkushtuar, sepse injorimi dhe përbuzja e aktivistëve është një akt absurd. Këta të dytët janë dëshpëruar dhe janë izoluar. Pra e them përsëri se i kuptoj se vështirë e kanë.

Por, prototipat si Ibrahim Xhemajli nuk marrin së paku një nismë dhe si të tillë natyrisht që nuk kanë pse të gabojnë. Pra sipas motos: "Ky e ka pasur mirë. Ky e ka pasur mirë, këtij "notuesi" në ujëra të qeta po i shkon fort mirë "noti" edhe me LPK-në edhe me LDK-në edhe me S. Berishën edhe me I. Metën. Këta vërtet ngjasojnë me një tip kameleoni.

Fadil SHYTI: Po, përkrah jush a keni bashkëmendimtarë, më shumë në mërgim, apo lidhjet i mbanë më shumë me veprimtarët në atdhe?

Xhemil Zeqiri: Natyrisht, kam shumë bashkëmendimtarë. Kjo më jep forca për të mos u ndalur deri në fitoren përfundimtare. Jo vetëm në Shqipërinë Londineze, por edhe në Kosovën heroike, në Iliridë të tjerë kam dhe mbaj kontakte të rregullta me intelektualë

dhe organizata të ndryshme. Por edhe në Evropë dhe më tej nëpër botë, kontaktet nuk mungojnë. Do të dëshiroja të përkujtoja këtu një aktivitet, fort me rëndësi: Këtej nga Danimarka, atje në Tetovë organizova një **tryezë debatuese** për të madhin politologun tonë, Ukshin Hoti. Hiç më pak se 15.000 korona daneze ia dërgova Shoqatës së të burgosurve politikë, që këta ta mbajnë këtë tryezë dhe aty ishte dhe një përfaqësues i "PEN-it", ishte shkrimtar danez - internacional dhe mbajti fjalim. Pastaj pati një shkrim shumë të fortë në gazetën daneze në "Fri Aktuelt".

Pra, jo vetëm në Danimarkë, por edhe në atdhe jam përpjekur të veproj me lekët e organizatave qeveritare daneze. Pastaj kam financuar disa revista që kanë kushtuar rreth 15.000 korona daneze, etj.

Fadil Shyti: I nderuar, atdhetar! Ishte vërtetë kënaqësi biseda me Ty, uroj që ta arrijmë fitoren e madhe, Ribashkimin kombëtar për të cilin kemi bërë dhe po bëjmë përpjekje!

Xhemil Zeqiri: Gjithashtu! Nderimi qoftë mbi veprimtarët e lirisë dhe të ribashkimit, e në veçanti nderim dëshmorëve të atdheut!

Fund

Pjesa e dytë

REAGIME

UNË QUHEM XHEMIL ZEQIRI, E JO PETRIT VOKA APO XHEMIL ZHELINKA

Ju mendoni se unë jam Petrit Voka, i cili ka dalë me një shkrim kundër jush. Bile ai i paska cituar ca ide nga libri im. Duke menduar kështu gaboheni shumë, sepse unë s'kam pse të fshihem pas pseudonimeve në letra, prandaj vendosa të dal hapur me këtë reagim ndaj shkrimit të Remzi Lokut, botuar në rubrikën "Forum", në "Liria Kombëtare" dhe në ëeb-faqen e internetit të rtvzik-ut, me titull: *"Bastard ke lindur, i tillë je rritur, kështu edhe do përfundosh."*

As që dëshiroja të reagoj ndaj këtij shkrimi të mbarsur me shpifje dhe rrena të kulluara, por për hir të së vërtetës për lexuesit do t`i komentoj disa pika të artikullshkruesit i cili më akuzon pa argumente.

Natyrisht, unë e kuptoj revoltën e tij dhe të klikës së tij sepse nga demaskimi im ata e humbën autoritetin të fituar pa merita, në dëm të mërgatës shqiptare që jeton në Danimarkë.

Ti dhe klika jote, që në emër të luftës së zhvilluar në pranverën e 2001-shit, Musa Xhaferi ju emëroi si zëdhënës politikë (ty - artikullshkruesin e mjerë dhe Abdilhalim Kasamin).

Që atëherë unë i kam shprehur qëndrimet e mia dhe e kam demaskuar hapur veprimtarinë tuaj destruktive në Danimarkë dhe të gjitha këto i dinë dhe i vërtetojnë edhe shqiptarët që punojnë dhe veprojnë në këtë vend skandinav.

Për të mos u zgjatur më tepër se ç´thekson: *"të nderuar lexues nuk mund të heshti, por e shoh të arsyeshme që edhe unë të infiltrohem pak me disa fjalë në lidhje me artikullin e Xhemil Zhelinkës (Petrit Voka)...*

Se, si thotë një proverb popullor, nëse gjithmonë të mençurit duhet të lëshojnë pe, atëherë mbetet që qeveritë e shteteve të udhëhiqen nga budallenjtë".

Unë, as që kam ambicie për pushtet.Populli ynë ka disa shprehje të shkëlqyera si për shembull: "Mos e vet se të tregon vet";

"Shtëpisë që duket, nuk i duhet kallauz "; pastaj "Nëse pitja është ngrënë, tepsia ka mbetur." Këto gjëra mund të argumentohen dhe argumentet janë të pamohueshme, si për ty ashtu edhe për mua.

"Jo vetëm bashkatdhetarët në Danimarkë por edhe më gjerë, të njohin se sa vlen dhe peshon. S´të vjen turp. Mundohesh ta kallaisësh veten në këto kohëra të tranzicionit kur u është dhënë hapësirë dhe mundësi shkruesve të hurit e të litarit, pra çdokujt, e veçmas një llumi sikur ti, të paguajë ndonjë gazetar ose krijues letrar të ngratë, të të botojnë ndonjë libër, e që pastaj të na shitesh edhe si poet e shkrimtar."

Duke qenë se ty o Remzi Loku dhe klikës tënde po u penguaka veprimtaria ime dhe arritjet e mia, që po përpiqeni t´i mohoni, pa dëshirën time më detyroni t´ua them ca gjëra, që janë vetëm disa që duhen thënë, si për shembull:

Prej kur kam mërguar në Danimarkë, me një përkushtim të madh i jam qasur sensibilizimit të çështjes shqiptare në përgjithësi dhe asaj të Kosovës në veçanti.

Për interesat kombëtarë, kam bashkëpunuar me shumë personalitete, me shqiptarë dhe me organizata daneze, deri te parlamenti dhe kryeministria e vendit. Këtë e dinë të gjithë, sepse për veprimtarinë time ka shkruar shtypi shqiptar dhe ai danez.

Dihet mirëfilli se: Kam organizuar dy konferenca ballkanike. Kam organizuar edhe disa debate publike. Kam organizuar takime të politikanëve shqiptarë me ata danezë në nivel institucionesh. Janë aq shumë, saqë nuk mund t´i përmendi, sepse bëhet e tepërt. Këto veprimtari, në dobi të çështjes mbarëkombëtare i kam paraqitur në 3 libra:

1. *"Kosova jonë"* , Tiranë, 2000;

2. *"Në mbrojtje (diplomatike) të çështjes shqiptare"*, Prishtinë, 2003;

3. *"Polemika, intervista, debate dhe letra",* Prishtinë, 2005.

Këta dy të fundit të përuruar (të promovuar) edhe në Prishtinë, në lokalin "Pojata" dhe në Institutin Albanologjik, ku kanë qenë të

pranishëm mjaft intelektualë. Me këtë rast, është diskutuar për veprimtarinë time dhe për librat e mi që janë vlerësuar shumë pozitivisht nga personalitete politike dhe shkencore si ***Adem Demaçi***, historiani ***Hakif Bajrami***, publicisti ***Beqir Berisha***, ***Prof. Dr. Sadri Fetiu*** etj, etj. Librat e mi kanë gjetur vlerësime edhe në shtypin tonë.

Ju paralajmëroj me kënaqësi se edhe dy libra i kam në dorëshkrim. Shpresoj se edhe këta, së shpejti do t´i botoj. Kjo e tregon më së miri përkushtimin tim ndaj çështjes sonë të pazgjidhur kombëtare edhe pas tri luftërave çlirimtare, të cilat në fakt i fituam në frontet e betejave, por i humbëm në frontet e betejave politike.

Kur thua se nuk jam shkrimtar as poet, e thua një të vërtetë, sepse sa i përket kësaj gjinie letrare, vërtet as që kam provuar ndonjëherë të shkruaj ndonjë poezi, ndonjë tregim, apo ndonjë lloj tjetër letrar që i përket letërsisë. Por, këtu ti e tregon vërtet logjikën tënde të cekët, kur e ngatërron publicistikën me artin letrar. Dihet se këto janë dy lëmenj krejtësisht të ndryshëm.

Publicistika është një fushëbetejë e analizës së situatave dhe të veprimtarive politike. Këtu njeriu nuk shkruan diçka artistike. Këtu ai e paraqet dhe e shkruan realitetin që kalon një komb, një vend dhe më gjerë.

Por ti e ke humbur logjikën sepse ke shkruar me mllefe të ulëta, i nxitur nga inatet personale se: "*vetëm pesë minuta u more në bisedë informative në UDB-në e Tetovës, me dorën tënde more i mjerë, një nga një i shkrove emrat e shokëve, duke na thënë se ata na njihnin të gjithëve; atëherë ta falëm, duke u bazuar në intelektin tënd të ulët.E si u bë që dikush u rrah e u maltretua me vite të tëra, e ti mbete i paprekur si virgjër, kur kihet parasysh ajo që thamë më lart"?!...*

Kjo nuk është aspak e vërtetë, sepse është dosja në gjykatën e Tetovës dhe për të e di mirë opinioni. Për atë rast e pata informuar "Flakën", "Radio Shkupin" e shumë të tjera mediume - elektronike dhe të shkruara.

Raportin e përgatita dhe ia dërgova Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian, kryesuesit të saj në Shkup, Richard Bech.

Gjithashtu, avokati im Mamut Jusufi e ka dosjen si të papërfunduar, që e pat dhënë në gjykatë veprimtarinë kriminale të policisë së Tetovës në atë kohë.

"*Ah, po! Sepse, ti je mjeshtër i imzave (nënshkrimeve), por ti nuk je i vetëm. Po na e përmend edhe Malik Kastratin, me nder me thënë, me tri klasë shkollë, emrin e vërtetë të të cilit e dinë të gjithë, i cili një fjali komplet se thotë dot sagllam me gojë, e lëre më t´i shkruajë dy rreshta, i cili për një pasaportë të vajzës së tij që iu desh, lidhi miqësi dhe krushqi me inspektorin e policisë Metodija Sekullovskin, kurse ti, me shkaun mysliman – Zijaun, së bashku shtruat darkën në Kodër të Diellit (Popova Shapkë) dhe përsëri nga ju, këtu ra viktimë njeriu të cilit ju ia hanit bukën dhe si përherë ia shkelët sofrën".*

Tani më detyron të ta them troç se këto janë vetëm shpifje.

Unë, nuk e njoh fare Malik Kastratin dhe kurrë nuk kam ngrënë darkë në Kodrën e Diellit, ndaj rrenat e tilla t´ i ka shitur fare lirë, shoku yt të cilin e emëruat Koordinator politik të UÇK-ve për Skandinavi, por si kriminel dhe trafikant i paskrupullt që është, e zuri policia, në bashkëpunim me serbët, me 10 kg heroinë dhe që është dënuar me 10 vite burg. Ai tërë kohën, nëpër vende publike, më sulmonte me këtë fjalorin tënd, si antikombëtar etj, sepse unë kurrë nuk kam dashur të kem ngatërresa me shqiptarë, e këto sherre i donit ju, e posaçërisht ti Remzi Loku dhe e konsideroje veten "tepaç". Bile këta terma sllavësh shpesh i përmendje nëpër mbledhje, nëpër kafene. Kur unë mundohesha të bashkëpunoj edhe me ju, ti më thoshe:

"Nek se jebe ko se jebe, ti çuvaj sebe." "He, he, budalla qenke ti. Çështja kombëtare nuk është zgjidhur qe 500 vjet, e dëshiron ta

zgjidhësh ti, o Xhemil Zhelina". “He, he, Menduh Thaçi është bërë milioner, e ti merru me çështjen kombëtare." Dhe vazhdoje: "He, unë me dashtë, bëhem deputet në Republikën e Maqedonisë dhe në dyqan do të punojë te shtëpia".

A të kujtohen, or "patriot", këto deklarata, kur m’i thoshe para shokëve?! Pastaj, ti o bukëshkalë i përdalë ke shkruar: *“Tamam puna, Zhelinka të mos merret me këto punë të mëdha. Madje tokat tona do të jenë të mjera pa peshën e trupit të një " poeti" e "shkrimtari" kokëshkretë. Atëherë UDB-ja e Maqedonisë do të jetë e gjymtë dhe nuk do të funksionojë si duhet pa urdhrat e "poetit" dhe do të fundoset përfundimisht në llumin e devijimeve fatale, pa mençuritë e "poetit" xhevahir.”*

Këto s’janë gjë tjetër, veç broçkulla që i pjell truri yt i sëmurë!Jo zotëri,unë nuk jam poet as shkrimtar, por siç e ceka më lart, jam një veprimtar politik i cili dështimet tua dhe të shtabit tuaj dështak në Danimarkë i kam demaskuar me kohë, sepse unë nuk kam ambicie për poste në hierarkinë e pushtetit në shtetin e huaj. Ato ambicie i keni ju që shkuat atje ta "ndihmoni" popullin, ti duke u krekosur dhe duke shitur mend se kinse ke studiuar pushtetin lokal, ndërsa ai "intelektuali" tjetër, A. Kasami, kinse paska punuar në Ministrinë e Arsimit në Danimarkë!!!

Po, të nderuar lexues, është e vërtetë se A. Kasami e ka marrë rrogën e turpit nga kjo ministri, por si mësues i serbëve dhe i romëve në Helsingor dhe ti e di mirë këtë, siç e dinë të gjithë shqiptarët.

Në vazhdën e këtyre shpifjeve dhe të trillimeve na paraqitet edhe një "gazetar” analfabet, Havzi Sulejmani, i cili trillon: *"Në një mbledhje të mbajtur nga nëndega e LPK-së në Danimarkë në vitet ‘95-‘96, në lokalet e radios København Kanalen (Radio Zëri i Kosovës) do të merrej vendim për përjashtimin e Xhemil Zeqirit, si anëtar i padisiplinuar dhe me dyshime të krijuara…!?Në atë kohë, përjashtimin e tij nga radhët tona, më së shumti e kam kundërshtuar unë dhe me këmbëngulje kërkoja nga kryesia dhe nga anëtarët që të bëhen lëshime edhe për një kohë ndaj tij, me pretekst se gjithnjë ka*

hapësirë për bashkëpunim (nëse gaboj, le të më korrigjojë ndonjë nga anëtarët e pranishëm në këtë mbledhje), sepse kam konsideruar se veprimet e tij nuk janë të dëmshme për këshillin tonë dhe se në të shumtën e rasteve, i ka bërë pa vetëdije".

Detyrohem të ta them hapur:

Jo, or mjeran! Veprimtaria ime politike është e njohur si në Danimarkë, në Skandinavi, në Europë ashtu edhe në trojet shqiptare.Unë, deri në fund i kam qëndruar besnik LPK-së, bile ende vazhdoj t´i përmbahem parimit dhe platformës së saj.Ndaj e them hapur, me përgjegjësi morale dhe penale sekurrë dhe askush nuk më ka përjashtuar nga radhët e LPK-së. Për këtë kanë dëshmi dhe mund të flasin vetëm ata që kanë qenë në Organizatë si dhe kryetari i asaj dege - Ibrahim Xhemaili.

Përkundrazi, e vërteta qëndron krejt ndryshe!Në atë mbledhje ti nuk ishe, sepse disa herë jepje dorëheqje me shkrim. Por aty ishin ai dhëndri yt, A. Kasami dhe ai "boksieri", R. Loku. Dhe u pa qartë se në atë mbledhje ishte organizuar një komplot kundër meje, mirëpo Ibrahim Kelmendi e ndërpreu mbledhjen duke thënë se ***i vetmi Xhemil Zeqiri e ka parapaguar anëtarësinë, ka paguar për organin e saj "Zërin e Kosovës" dhe ka dhënë ndihma për aktivitete të tjera të organizatës...!***

Në atë mbledhje ishit përgatitur madje edhe të më boksoni, kurse gjatë luftës në trojet tona në Maqedoni, ju keni komplotuar edhe më keq kundër meje: Ju keni bërë plane me atë shtabin tuaj, të më vrisni, vetëm për faktin sepse nuk u përulesha këshillave tuaja, që, siç pretendonit ju, duke më dhënë dreka e darka, të më mashtronit që ta tradhtoja idealin kombëtar.

Ju paskëshit menduar gabim, ngase keni pandehur se duke ma mbushur barkun, do të mundni të ma shpëlani apo më mirë të themi,

të ma njollosni dhe trurin!!!Kam ngrënë dhe keni ngrënë bukë tek unë.Kjo paska qenë e përcaktuar si një aksident jetësor!

Dihet fort mirë se ai dhëndri yt, me darka e dreka i korruptoi disa shokë të LPK-së, si: Xh.H., Xh.D. Dhe për çudi nuk e përmendi se edhe kryesia e BDI-së ka ngrënë bukë tek A. Kasami, por së shpejti do ta dëgjojmë edhe atë "mrekulli".

Kur ju i përmendni drekat e darkat, konsideroj që vërtet turpet tuaja s´kanë fund!Kurrë nuk do të dëshiroja të hyj në këto grindje letrash. E kuptoj se nuk është as koha dhe as momenti, sepse e kemi situatën shumë kritike në trojet etnike. Por s´munda dot t´i lejoj këto shpifje tepër të ulëta.Shpifje këto, për të cilat populli thotë: *As qentë s´ua hanë*!

Unë jam i gatshëm, sot dhe nesër, të dal me argumente të pathyeshme se çfarë pune athdetare kam bërë deri sot në Danimarkë.Por ju të shtabit taksamledhës, ishit sabotues, krekoseshit se po punonit për popull, ndërsa pikërisht ti Havzi Sulejmani dhe dhëndri yt A. Kasami, nuk e keni dhënë asnjë qindarkë apo asnjë lekë për UÇK-në e Iliridës dhe për asnjë aktivitet atdhetar, ndërsa për t'i vjedhur lekët, besa kishit qenë të aftë!

Dhe, pikërisht se kanë dalë të palarat tuaja atje në kryesinë e BDI-së, pikërisht tani ka shpërthyer zemërimi juaj dhe më akuzoni mua pa asnjë argument!Unë kurrë s´kam punuar dhe as kam luftuar për karrierë dhe për poste. Ju, keni punuar dhe keni luftuar për to. Tani keni dështime tepër të hidhura, ndaj jeni vërsulur si çakej kundër meje, sepse A.Kasami abortoi, nuk u bë dot ministër për Transport dhe Lidhje, as kryetar komune. Ai shoku yt - R. Loku. nuk u bë dot kryeshef i policisë të Tetovës, apo drejtor në aeroport ose në doganat maqedonase.

Dhe tani do të ishte krejt e natyrshme që BDI-ja të kërkojë përgjegjësi se ç´keni bërë ju o "sokola" në Danimarkë, gjatë luftës çlirimtare.

E keni informuar apo e keni dezinformuar opinionin e huaj në Danimarkë dhe në Europë, në emër të luftës dhe këto duhet t´i argumentoni!!!

Por, pasi nuk ka kush t´i kërkojë këto përgjegjësi, ju akuzoni dhe shpifni sa të mundni, se interesimi do të rritet dhe se njerëzit do të dinë më shumë për veprimtarinë time.Por, duhet të dini se kjo do t´ju kthehet si bumerang!

Sa i përket figurës sime, unë jam i pastër si loti nga të gjitha aspektet:kombëtar, politik dhe moral. E vetmja "dobësi" që edhe unë e di se e kam është se kam marrë guximin t´i demaskoj pamëshirë, pandërprerë dhe pa frikë, matrapazët politikë, qoftë në Tiranë, qoftë në Prishtinë, qoftë në Shkup dhe këtu ku jetoj në Danimarkë.

Sa i përket çështjes morale dhe tradicionale shqiptare, dua t´ju them edhe diçka:Nuk është traditë imja personale t´i përmend vendet dhe njerëzit që kanë ngrënë bukë tek unë dhe anasjelltas. Dhe mendoj se kur ha njeriu diku bukë, nuk do të thotë se duhet të bëhet i tillë siç është ai që i dha bukë.

Natyrisht, ka shumë miq që kanë ngrënë bukë tek unë. Edhe unë kam ngrënë bukë tek ata me të cilët kam pasur lidhje miqësore, shoqërore. Pra, njerëz të merituar dhe të tillë pa merita etj. Por, kjo nuk do të thotë që unë ta tradhtoj idealin tim, për një, dy ose njëqind darka.

Ndërsa kur ti i përmend ato, vërtet e tregon kulturën tënde tejet të cekët!Nuk dëshiroj të merrem më me këso gjepurash të politikës së klaneve ditore, sepse mërgata shqiptare e di fort mirë kush jam unë.

Opinioni këtu, e di mirë se jam i vetmi shqiptar që jam futur në institucionet daneze, jo për t´i begatuar interesat e mia personale. Atje kam hyrë krenarisht për ta sensibilizuar opinionin danez dhe më gjerë, në mënyrë që ata ta njohin realitetin e hidhur të okupimit të trojeve etnike shqiptare nga sllavët okupatorë, gjakpirësit e shqiptarëve.

Edhe ju e dini fort mirë këtë, por nga xhelozia si dhe nga vuajtja për pushtetin e humbur apo të parealizuar, tani më sulmoni në mënyrë të paskrupullt!Bile si pushtetarë që ishit, më 7 maj 2005 më keni ngritur aktpadi si njeri i padëshiruar, pra i rrezikshëm për pushtetin sllavo-maqedonas.

Gjatë vizitës në vjeshtën e vitit 2005 në hapësirën shqiptare në vendlindje, më 07. 09. 2005, në pikën kufitare Jazhincë-Glloboçicë, policia maqedonase deshi të më arrestonte. Midis tyre, edhe ata që dikur kishin qenë pjesëtarë të UÇK-së, por shpëtova me ndihmën e disa miqve të mi dhe tani jam i vetëdijshëm se gjithçka e turpshme, monstruoze, hakmarrëse pritet prej jush!

Do të dëshiroja me gjithë mendje e zemër që pas këtyre shpifjeve tuaja banale, shqiptarët në Danimarkë dhe lexuesit e letrave tona, të interesohen dhe lirisht ta verifikojnë veprimtarinë time.

Për fund të kësaj polemike, unë ju zotohem lexuesve se këtyre dështakëve nuk do t´u përgjigjem më, sepse nuk kam kohë për të humbur me xhuxhë të përrallave për fëmijë.Megjithatë, të keqen s´ua dëshiroj, madje përkundrazi, ua shtoftë zoti jetën se më duheni. Për sa kohë që e vërej se puna ime i bezdis, do ta di se jam në rrugë të mbarë.

Kopenhagë, më 22.12.2005

ZOTËRI XHAFER LECI NA TREGOI SE VËRTET QENKA NAIV ME BRIRË TË NDYRË!

Reagim ndaj shkrimit të Xhafer Lecit, alias Leckës së LDK-së, lidhur me një shkrim të Fadil Shytit, botuar në faqen e internetit "lajme com" më datë 16 maj 2005.

Shkrimit tënd o mjeran politik do të përpiqem t´i përgjigjem shkurt, sepse ti nuk e meriton të ta kushtoj këtë kohë, kur kemi kaq shumë punë të tjera për të bërë në shërbim të popullit tonë të shumëvuajtur.

Ti e paske lidhur qerren pas mjeranëve të historisë më të zezë të Kosovës, me ata që "sunduan" me ardhjen e tyre, që krijuan "pushtetin paralel" në vitet e errëta 1989-1997 të regjimit të S. Millosheviqit, ata që ia ruajtën aq shumë shpinën këtij regjimi kriminal me politkën paqësore të durim-turpit!

Nuk ka deklaratë dinake e dhënë prej I. Rugovës, që ia lanë krimet dhe turpet politike të tij. Sepse, ai është lider tejet përçarës satanik në politikë, kurrë s'e ka dashur as e dëshiron ribashkimin kombëtar. Këtë e ka dëshmuar me shumë vepra antikombëtare. Ndërsa Bajram Kosumin mos e fut në një pozitë të barabartë kombëtarisht me të. Këta, pavarësisht se e përfaqësojnë pushtetin në Kosovë nën tutelën e UNMIK-ut, dallojnë nga njëri-tjetri si nata me ditën, për përpjekjet e tyre për lirinë e Kosovës. Bajrami qe bir i vuajtjeve, sokol djalë i burgut dhe i malit. Ndërsa, Ibroja qe dhe mbeti "njeri" i lukseve të pushtetit të pa shtet dhe korb i kapitalit.

Kjo dihet nga të gjithë njerëzit me mend në kokë!

Ti o shkretan provincial e ke sulmuar atdhetarin Fadil Shyti me epitete ofenduese, duke menduar se marrëzia jote shkon sipas idesë qëllimkeqe të ldk-istëve se prej një mijë rrenave diçka mendohet si e vërtetë!

Shkrimi yt nuk mund të quhet reagim por një akuzë, trillim që mëvonë sigurimi juaj kriminal t´i ekzekutojë njerëzit.

O pelivan i historisë suaj të mjerë, reagimi nuk bëhet kështu me sharje, akuza të paqena, në këtë mënyrë tejet banale.

Ti në shkrimin tënd me asnjë aspekt nuk u je qasur dy shkrimeve të Fadil Shytit.

Në shkatërrimin tënd ndaj Fadil Shytit shihet qartë se ke një urrejtje patologjike ndaj autorit dhe si i tillë ke pasqyruar edhe foshnjërinë tënde politike.

Unë të di kush je, sepse sipas "logjikës" së atij shkrimi çoroditës e kuptova drejt se ti je askushi.

Por, duke bërë këtë gaboshesh rëndë!

Ti ore Xha-Ferr,
qenke i mjerë,
qenke i pacipë,
të paska marrë koka erë!

Ti, pa pikë turpi gënjen kur shkruan, kinse "sipas një shoku, Fadil Shyti qenka një mësues katundi, pa çka se ai e quan veten profesor" !!!

Jo mor zotëri, xheloz i mjerë provincial, kjo nuk qëndron sepse vërtet që Fadil Shyti nga viti 1983-1991 ka punuar në një katund të Shalës (Vllahi), ku ka bërë një jetë migjeniane, por kjo s´do të thotë se nuk ishte i kualifikuar me titullin Profesor i letërsisë shqiptare. Këtë mund ta verifikoni kur të dëshironi, ti dhe të pabesët e tjerë inatçorë. Sa për ilustrim po ta jap një fakt: Veprimtari atdhetar, Fadil Shyti, ka diplomuar në vitin 1982, në degën Letërsi dhe gjuhë shqipe në UP. Ai punoi në Vllahi për faktin që ishte i burgosur në vjeshtën e vitit 1981, për "fajin" se e paska vizituar Shqipërinë e përtej Drinit, kur ishte student. Pra në vitin 1979, atij, nga "sigurimcat" e LKJ-së, me kompani, nuk i lejohej të punojë në

qytet, nën akuzat se ishte irredentist, nga lehja e shpifjeve të sojit tuaj se është i rrezikshëm etj...

Nuk mund të duroj! Ti me rrejtë e unë me flejtë, kur thua se Fadil Shyti ka vetëm një përmbledhje poetike. Jo mor sylesh, vëllai ynë atdhetar i ka, jo një përmbledhje poetike, ***"Në kërkim drite",*** Tiranë (1996), por edhe një vepër të dytë publicistike të botuar me titull ***"Në rrugën e lirisë",*** Prishtinë (2004) dhe ka dorëshkrime të tjera që së shpejti do ta shohin dritën.

Pavarësisht se ju jeni të egërsuar nga sëmurja partiake, kot e keni, ngase nuk mund ta mohoni dot veprimtarinë e tij atdhetare.

Ke shkruar se kinse biografia e I. Rugovës përputhet me "vija e vjaska" me atë të Shaban Palluzhës dhe të gjyshit të Fadil Shytit. Kinse duke e "përgojuar" I. Rugovën, analisti Fadil Shyti "shkon ndesh gjyshit të vet".

Po a ka më mjerim se kjo logjikë: Përcaktimi i I. Rugovës për politikë paqësore tejet pasive, shkon ndesh politikës së Shaban Palluzhës dhe Hajzer Tafës, gjyshit të Fadil Shytit, të cilët luftuan me armë në dorë për liri dhe ribashkim kombëtar.

Kujdes zotëri! Mos i shqtësoni edhe heronjtë nën varre!.

Pastaj, veprimtaria politike qyqare e "heroit" tuaj nuk barazohet me asgjë me qëndresën e tyre heroike. Ata luftuan e u vranë me serbët okupatorë. Ata kurrë nuk ngritën dolli duke u gajasur në Beograd në kohë të rënda lufte.

Opinioni shqiptar dhe i huaj e ka të qartë kur ky lideri juaj, i sëmurë nga gangrena LDK-iste, nuk zbriste nga aeroplani në Tiranë, përkundër gjithë atyre përpjekjeve të institucioneve të shtetit shqiptar. Ai dëshironte të shkonte në Kosovë se atje e kishte të siguruar mbrojtjen nga policia famëkeqe e S. Millosheviqit.Opinioni e di fort mirë atë deklaratën famëkeqe të I. Rugovës të cilën e transmetuan BBS-a dhe CNN-i, kur dy "burrecat", Millosheviq-Rugova, kërkuan të ndërpriten bombardimet e NATO-s.

Ke vjellë vrer pa pikë turpi se Fadil Shyti, vetëpërgënjeshtrohet në arenën kombëtare dhe ndërkombëtare, për titullin: "Një shkëndijë drite po përhapet në Kosovën shqiptare". Sipas teje "po potencuaka atë që nuk është normale, tendencën e spastrimeve etnike, tamam sikur politika serbe ..."!

O, ngadalë e mos u ngut dhe mos u tut o mjeran, se nuk të mbetet Kosova veç me shqiptarë! Do të kesh ti dhe pinjollët e sëmurë të LKJ-së, aq serbë sa t´i ftoni në kafe të pista dhe në gosti kumbarie.

Kisha fashiste serbe dhe UNMIK-u dhe miqtë tuaj ndërkombëtarë po përgatiten të sjellin sërish kolonë të ri serbo-sllavë në Kosovën tonë shqiptare , ata duan ta bëjnë Kosovën multietnike aq sa dëshiron ti dhe ata që gëzohen si ti.

Nuk bëhen spastrime etnike me një titull shkrimi! Por ti mor zotëri, dhembjen e ke gjetiu, tani juve institucionalistëve pacifistë u ka hyrë lepuri në bark, duke e shikuar veprimtarinë atdhetare të ***Albin Kurtit***, ka filluar t´ju dridhet "kurora e mbretit".

Lumenjtë fillojnë ngadalë të vërshojnë, por s´ kalon shumë kohë kur ata i rrëmbejnë të gjitha mbeturinat që u dalin përpara!

Mbase ju e keni përjetuar këtë më 1 tetorin e vitit 1997, tani i druani fort zgjimit të sërishëm të uraganit popull!

Ju çmendeni nga frika e prishjes së rehatisë dhe e kumbarisë shumëvjeçare me "pobratimat", vëllamët tuaj serbë.

Nuk dua të ndalem për kontributet "madhore" të LDK-së, dhënë LÇ-së. Në veçanti ka "shkëlqyer qeveria juaj e drejtuar nga ish-kryeministri B. Bukoshi, me ata 200.000 ushtarët dhe me gjeneralët e tij institucionalë, pinjollë të akademisë së Beogradit. Por, pa harruar të ta kujtoj se ishte LPK-ja ajo bërthama e parë opozitare ilegale, e cila ia lëkundi themelet ish-Jugosllavisë, në vitin e lavdishëm 1981. Ishte ajo që pastaj e ndihmoi me djersë e gjak luftën heroike të UÇK-së. Pajtohem me mendimin që anëtarët e thjeshtë të LDK-së, e kanë ndihmuar këtë luftë, por jo edhe udhëheqja snobe, servile me në krye teknokratin cinik I. Rugovën,

të cilët ikën nga sytë këmbët në relacionin, Bllacë-Beograd-Cetinë-Tiranë...

Tendenca jote për ta përshkruar politikën e I. Rugovës, si "politikë të hollë", është fund e krye fataliste, sepse e mbron haptas tradhtinë!

Historia e popullit shqiptar, fatkeqësisht i njeh dy liderë tinëzarë e qyqarë të cilët kanë ikur nga fronti në kohët më të rënda kur po rrezikohej Shqipëria:

1. Ahmet Zogun dhe

2. Ibrahim Rugovën.

As balli as bishti, gjegjësisht, as i pari, as i dyti, nuk e kishin as aftësinë as trimërinë ta krijonin dhe ta zhvillonin një ushtri çlirimtare, ashtu siç bëri komandanti legjendar, ***Enver Hoxha.***

Pastaj, ta krijojnë dhe ta zhvillojnë një ushtri ashtu siç bënë "bijtë e bijat e tij"- siç do të dëshiroje t´u thoshe ti dhe kori yt pacifist, djemve të UÇK-së, se kinse këta paskan krijuar dhe formuar ushtri ideologjike! Marrëzi më e madhe politike se kjo s´ka ku shkon! Ti o mjeran, paturpësisht i ke fyer shumë nga udhëheqësit e UÇK-së dhe komandantët e saj. Kjo s´ na habit aspak, sepse kompania jote mbahet nga këto gjepura, nga këto gjellë bajate dhe të pakripë, me atë të "famshmen" "Bota Sot". Me sulmet ndaj çlirimtarëve ju ia kaloni edhe politikës serbe. Hiqeni kinse i njihni situatat nga kanalet e kalasë nga brenda. Pastaj këto i transmetoni me servilizëm e besnikëri labirinteve të udbashëve dhe kos-it. E pastaj, ata i dërgojnë këto dosje deri në Hagë. Por, kot e keni, sepse "anijet që lundrojnë drejt Beogradit, ne i kemi djegur", deklaroi ***Xhavit Haliti***, ***veprimtar politik i*** LPK-së, për më tepër se 20 vjet. Eh, i nderuari Halit, ka harruar ai, se tani drejt Beogradit liderët e LDK-së dhe puthadorët e tyre, ikin me aeroplanë e trena, sa herë ndihen tërmete në trojet etnike shqiptare.

I dehuri Xha Ferr tenton të na e mbushë mendjen se Klintoni, Ollbrajti, Ëokeri e paskan prishur gjumin për hatër të I. Rugovës.

K*am përshtypjen se këto e përkrahën luftën tonë vetëm sepse e panë realitetin se ekzistonte UÇK-ja.*

Por u zhgënjyen kur e panë se ky popull nuk di t´i vlerësojë heronjtë e vet dhe se është i papjekur politikisht, për faktin se dy herë zgjedhjet e fundit në Kosovë ishin një manipulim. Vetëm shqiptarët e hanë këtë gjellë pa kripë, të dalin në zgjedhje me lista të mbyllyra. Pastaj ata na lanë në baltë. Kjo është ajo pasoja katastrofike që tani këta ushtarët e huaj po tallen me identitetin tonë kombëtar dhe na rekomandojnë standarde. Medoemos t´ua rregullojmë kishat politike serbëve me përqindje nga pagat e vogla të punëtorve kosovarë.

Ju i dënuat protestat popullore, në marsin e 2004-shit, dhe kështu keni hyrë në vallen "shiri kollo" të djajve sllavë.

Ata i erdhën në ndihmë Kosovës vetëm atëherë kur jehuan pushkët partizane maleve të Kosovës, e jo kur gjëmuan vajet katundeve e qyteteve të saj! I ke shtruar pyetjen shokut Fadil Shyti: Si do të dukej sot Kosova pa intervenimin e NATO-s kundër Serbisë? Por unë paraprakisht kam një pyetje për ty: Si do të dukej Kosova, sikur të mos ngriheshin në luftë djemtë e UÇK-së, që pastaj e sollën intervenimin e NATO-s në Kosovë?

Po të "sundonte" pambarimklika vajtuese e LDK-së, me siguri edhe sot Kosovën do ta shkretonte kapica serbomadhe dhe çetnikët, me në krye kriminelët si: Millosheviqi, Arkani, Shesheli dhe do të organizonte tubime festive si ajo e Gazimestanit, peshkopi shovinist Artemije.

Tani, ju o bukëshkalë, hidhni shqelma kundër vëllezërve tuaj çlirimtarë, kafshoni e pastaj si kuajt e majmë që s´duan të dinë për të zotin e tyre...

Bile, për këtë harlisje e keni edhe bekimin e çetnikëve dhe të vasalëve të tyre nëpër botë. Me gjuhën e nepërkës, në stilin e një agjenti të mjerë, e ke pyetur sikur në hetuesi, ***veprimtarin*** Fadil Shyti: Më intereson reagimi yt dhe reagimet e rrethit tënd, në rastet

e shpeshta të atentateve? Ja po ta them si mendoj unë dhe besoj plotësisht se edhe shoku ynë i nderuar, Fadil Shyti mendon kështu.

Këto atentate janë ato që e tregojnë fytyrën tuaj të vërtetë. Klane të ndryshme për interesa të ndryshëm, andej nga "mëhalla juaj e madhe" e LDK-së, po ia hani kokën njëri-tjetrit!

Ndërsa për qëndrimin ndaj armiqve dhe puthadorëve të tyre, ne e kemi devizën tonë që e kemi treguar gjatë luftës, por po ta kujtoj këtu një amanet të dëshmorit të kombit tonë, Bajram Bahtiri, i cili thoshte: **"Armiqtë dhe tradhtarët, me plumba kresë duhet t´i qëllojmë"!** Tani e kam një pyetje për lexuesit e nderuar:

Kush është më shkja se shkau, e tregoi koha luftë. Janë ata që u bënë dje dhe po bëhen sot vasalë me të. Ata që ngritën dolli para dhe pas luftës, apo ata që ndërruan vetëm plumba, barut e zinxhirë me serbët pushtues?

E sa për hallin e Marrëveshjes së Rambujesë - mendoj unë dhe besoj se këtë mendim e ka katërcipërisht edhe shoku ynë Fadil Shyti se atje u shkel parimi i VETËVENDOSJES, atje u thellua hendeku i mosrealizimit të pavarësisë së Kosovës. *Me fjalë tjra, kur Ibroja juaj u tha diplomatëve Robin Kuk dhe M.Olbrajtit në Shkup, ende pa e lexuar dokumentin e Rambujesë, se ne do të vijmë atje dhe natyrisht, ky ishte akt i kryer si parti më e madhe që kishte fituar. Në këtë mënyrë i fiton zgjedhjet në Kosovë sa herë që të votoni, sepse votat janë të mbikëqyrura nga serbët, e tani nga UNMIK-u, pra nga miqtë e serbëve.*

Pra zgjedhjet dhe Rambujeja janë dy pika më delikate në politikën shqiptare dhe këtë e ka shpjeguar fort mirë simboli i rezistencës shqiptare, që ti e quan ish-simbol. Po ta them hapur që ti dhe rrethi juaj nuk e dini se cili popull e ka në botë një njeri si Adem Demaçi, me atë kapital aq të madh politik.Lexoje librin "Dosja Demaçi", aty do të gjesh shumë gjëra o mjeran. Kur Demaçi e mbronte të drejtën e shqiptarëve gjyqeve serbe, Ibra dhe zotërinjtë tuaj bënin shkolla dhe kurse politike në Kumrovc, Francë, Itali, Irak e Libi, pra te Sadami dhe te Gadafi, sepse ata ishin miqtë të Titos, të cilin ju e quanit pejgamber.

Pastaj atje u bë një marrëveshje për një qeveri të cilën e shkeli me të dy këmbët, me inicimin (këshillimin) e qeverisë italiane, "mbreti" ikanak I. Rugova. Kjo pati për pasojë këtë gjendje që e kemi deri sot, pra kemi mbetur "as mish, as peshk" - siç thotë populli ynë. Si dinak që na qenke, i sojit më të keq, je përpjekur që dërgimin e Ramushit në Hagë ta barazosh me "kidnapimin" e I. Rugovës nga serbët. Mos deshe të thuash që Ramushi u "kidnapua" nga ndërkombëtarët, aleatët tanë, shpëtimtarët tanë, siç thërrisni ju me zë të ngjirur, e për të mos na futur në luftë me botën, u dorëzua pa rezistencë. Po "kryeplqenari" yt, për hir të cilës paqe u vetëdorëzua në Beograd?

Ja po ta them unë këtë. Jo mor zotëri, mos kij dert fare për vuajtjet e "Titanikut" rugovas. Jo mor jo, nuk është kidnapua fare, lideri me "një mijë okë mend", por sipas të gjitha rrethanave, që opinioni fort mirë i mori vesh pastaj - kjo kishte qenë fund e krye marrëveshje midis kumbarëve politikë, në relacionin Prishtinë-Beograd. Këtë sot e di edhe naivi më i madh i sojit tënd. Por tjetër është fakti që këtë ju s´keni guxim ta pranoni.

Ti mor qerrata politik, je përpjekur kinse ta mbrosh turpin e Donika Gërvallës për sulmin e saj të pacipë kundër Ramush Haradinajt, duke i dhënë asaj të drejtë se është e bija e hero Jusufit, e tani u dashka t´i lejohet të llomotisë turpe nëpër botë kundër heroit tonë të gjallë, Ramush Haradinajt. Kjo marrëzi nuk shkon! Këtë marrëzi s'e duan as pionierët e shkollave fillore. Ju krekoseni me ata 36000 anëtarët e LDK-së në Gjermani. Kjo s´na habit aspak, megjithë respektin për anëtarët e padjallëzuar, sepse në radhët e tyre ka njerëz të ndershëm e atdhetarë. Por dijeni mirë, ti dhe sorta jote se as ***veprimtarin*** Fadil Shyti, as neve, kjo s´na bën për asnjë çast të ndalemi në rrugën tonë të ndritur për ta arritur fitoren e madhe të ***ribashkimit kombëtar***, që e kemi pikësynim kryesor. Kësisoj do ta realizojmë ëndrrën shekullore të të parëve tanë.

Nëse ke kurajë, lexoi më me kujdes shkrimet tona dhe atëherë do ta kuptosh se përpjekjet tona këtë objektiv madhor synojnë. Fatbardhësisht, në këtë rrugë sot i kemi përkrah qindra e mijëra, por

nesër do të na bashkohen edhe miliona shqiptarë, ashtu siç dinë atdhetarët t´i ribashkohen qëllimit të shtrenjtë.

Je shprehur me cinizmin e mykur titisto-ldk-ist se UÇK-ja s´na paska qenë ilegale për faktin se e paska pasur selinë e saj në Prishtinë. **E more trutharë,** po ndalu njëherë e mendoje këtë me gjakftohtësi. Kur dhe pse e hapi këtë seli SHP i UÇK-së?! Pastaj, kush u bë zëdhënësi i saj? U bë krejt natyrshëm ai Anteu shqiptar i betejave të mëdha politike, Adem Demaçi të cilin ju ldk-istët dhe të gjithë pacifistët shkretanë e keni fyer dhe denigruar aq shumë, e që sipas teje **"vetëm një herë qenka bërë burrë"!** Ani, kur se? Atëherë kur e paska treguar një "stisje" dinakëri politike të I. Rugovës. Por ne fort mirë e dimë se për simbolin e rezistencës sonë kombëtare, I. Rugova është njeriu më i pamerituar në historinë e re të Kosovës, për arsyet që opinioni i brendshëm dhe i jashtëm fort mirë i ka të njohura.

Kur ke tentuar të futësh dhenjëza thonjsh midis viganit Albin Kurti dhe "joviganit" Adem Demaçi, ke dalë shumë mjeran si vetë klasa jote politike. Kurse siç shprehesh ti i o pacipë, A. Jashari, A. Demaçi, A. Kurti, kinse paskan qenë shokë – këngëtarë, duke kënduar potpuri labe. Je treguar shumë i ulët jo veç kombëtarisht por edhe njerëzisht. Për krahasimin që e ka bërë veprimtari atdhetar, Fadil Shyti, ka pasur plotësisht të drejtë, sepse këta tre viganë të historisë së Kosovës, sikur e plotësojnë njëri-tjetrin. Atë çka bëri Adem Jashari dje me armë, këta burra intelektualë që i shpëtuan terrorit serbomadh, po e bëjnë me penat e tyre të ndritura.

Po e përfundoj këtë reagim me një poezi të Fan S. Nolit që ia kushtoi shokut të tij të vrarë, Luigj Guarakuqit, nga dora gjakatare e Ahmet Zogut. Është ajo elegjia e famshme

"Syrgjyn vdekur", prej së cilës lexuesve po ua kujtoj veç ca vargje:

Nëno moj mbaj zi për vëllanë,
Me tre plumba na i ranë,
Na e vranë e na e shanë,
Na i thanë tradhëtor!

Sikur po na përsëritet historia, sepse sërish atdhetarët po na i vrasin, po na i burgosin dhe po na i shajnë, larot e krisur dhe të pashpirt. Por kot e kanë!

Kopenhagë, 24 qershor 2005

SQARIM RRETH REAGIMIT TË IBRAHIM XHEMAJLIT, LIDHUR ME INTERVISTËN TIME DHËNË SHOKUT TIM, FADIL SHYTIT!

Pleqtë tanë të urtë, kur kuvendonin dikur në odat tona thoshin se kur shenjëtarët gjuajnë shënjestrën, duhet pasur kujdes të mos dilet në ballë te poligoni, sepse mund të të mërrë ndonjë plumb.

Në reagimin e tij më 7 shtator 2010, botuar në faqen rtvzik.com, z. Ibrahim Xhemajli, që në fillim të reagimit paraqitet tendencioz dhe me keqardhje mund të konstatoj edhe disi cinik. Them kështu, sepse vetë titulli i reagimit me baza tejet jorealiste e pasqyron këtë përpjekje disfatiste për faktin që reaguesi në vend se të reagonte duke iu referuar fakteve të paraqitura si kundërshtuese ndaj meje, ai deklarohet se unë Xhemil Zeqiri i paskam dhënë intervistë shokut tim, Fadil Shyti. Sipas "kandarit" dritëshkurtër "të mëhallës" del kinse mua nuk më paska intervistuar kurrë askush tjetër përveç shokut tim. Për këtë s´kam çfarë të shtoj më tepër, përpos që të them se Fadil Shyti nuk më ka intervistuar mua në cilësinë e shokut të tij, por më ka intervistuar në bazë të meritave që ai ka menduar se i kam. Në përpjekjet tona për të bërë diçka të mirë për Shqipërinë duke i demaskuar elementët reaksionarë, në radhët e të cilëve nuk je Ti, o i tremburi "prej hijes" tënde, o I. Xhemalji. Por kujdes, se me këtë revan që e ke marrë ti dhe suita jote e PDK-së, me apo pa qëllime, me apo pa njohuri të duhura politike, "strategjia" juaj po në atë hulli të zezë e të qullët shpie!

Nuk kam dashur të merrem me ty për faktin se nuk ishe në shënjestër të kritikave tona për veprimtarinë tënde diversive, përkundrazi, kisha respekt për veprimtarinë tënde në atdhe dhe si ish-i burgosur politik, të kam respektuar dhe të kam ndihmuar më tepër sesa e paske merituar. Kështu po mendoj, sepse ti me të arritur këtu në Danimarkë, nga shokët e LPK-së mësova se ke qenë një nga kuadrot e LPK-së në Zvicër. Pa ngurruar dhe i bindur se po bëja një punë të mirë duke e afruar pranë shokëve tanë

danezë një veprimtar, pastaj duke të emëruar si redaktor të radios "Zëri i Kosovës", vendosa të organizoj Komitetin "Miqtë e Kosovës". Në fakt, miqtë tanë ngurronin sepse nuk të njihnin, mirëpo unë i sigurova ata për ty, bile kjo u bë në praninë tënde. Është e logjikshme që në këto raste kur kemi ca keqkuptime, më mirë se të vjellim vrer kot së koti, konsideroj që më e ndershme do të jetë të dalim me fakte konkrete, duke iu qasur mospajtimeve. Kur e kemi fjalën te ndihmat dhe pengesat që ishin dikur në mesin tonë, vërtet jam i kënaqur që nga ana ime mbisundojnë vetëm elementet pozitive, ndërsa mua edhe pse për shumë vite i kam mbajtur në heshtje, tani më kujtohen fort mirë dhe tani më duhet doemos të ta them se ti ishe jo rrallëherë sabotues i heshtur. Kujtoj këtu në veçanti se, duke qenë në Konferencën Ballkanike, kur bëre aq shumë zhurmë për asgjë, me rastin e përfaqësimit të Ibrahim Kelmendit në atë Konference, e pastaj të dështimit të vizitës së Muhamet Kelmendit në Danimarkë. Më tej, ishte tejet e pakuptimtë dhe qëllimkeqe sjellja jote kur ti atëbotë, si një pionier i llastuar hidhëroheshe kot së koti me mua, ndërsa kur unë i organizoja konferencat etj., ti ishe aty, e shihje aktivitetin tim dhe, o sa keq të paska munduar xhelozia dhe më ke injoruar për aq sa ke mundur e ditur!

Ti, z. Ibrahim Xhemajli ke shkruar: Duke kërkuar ndjesë për mos modesti po e filloj këtë reagim duke cituar një pasus të një letre të veprimtarit Xhemil Idrizit dërguar personalisht Xhemil Zeqirit: "Ti si çdo herë ke zili ndaj të tjerëve, andaj dhe nuk ke dëshirë ta pranosh një realitet, siç e ke edhe zakon të tregohesh si njeri "supermen" që ka aftësi ta organizojë komunitetin. Kur ti e paske këtë aftësi për të bërë organizime të tilla, atëherë pse ti kurrë nuk ke qenë bartës i këtyre organizimeve ose më mirë me thënë, pse kjo popullatë kurrë nuk të ka zgjedhur ty ose nuk ta ka dhënë legjitimitetin? Ti, a ia ke bërë ndonjëherë këtë pyetje vetes? I vetmi person që mund të mburret për çdo herë se ka bërë organizime kombëtare është vetëm një njeri dhe ai është Ibrahim Xhemajli. PorIbrahimi kurrë nuk është mburrur dhe nuk ka dalë të thotë se si ai i ka bërë të gjitha, por çdo herë ka thënë se bashkë me shokët i

kemi bërë organizimet. Një njeri i kalibrit të Ibrahim Xhemajlit mund ta organizojë dhe mos ta përçajë këtë komunitet"!!!

Lidhur me këtë "iso" që ty t´u paska gjetur si ushtë mbrojtëse nga pikëpamjet personale të Xh. Idrizit, për këtë "zbulim" epokal, po të përgjigjem me sa vijon: Në krye të herës, dua t´i njoftoj lexuesit e nderuar se letrën e dërguar prej Xh. Idrizit, fillimisht e kam marrë unë. Atë letër ta kam dërguar ty, pastaj jemi marrë vesh që të mos e publikojmë për faktin që Idrizi më akuzonte padrejtësisht si spiun, bile-bile sikur Fondi "Vendlindja Thërret" paska dashur të më dënonte si njeri i dyshimtë. Natyrisht, kjo më revoltoi dhe dëshiroja të dija për burimet e pista të asaj maskarade se nga i ka rrjedhimet. Për më tepër, kur atëbotë po veproja në vrullin më të madh se kurrë, në dobi të UÇK-së, përkrah Ibrahim Kelmendit, Bardhyl Mahmutit, Jashar Salihut.

Pra, duke dashur të dija burimin e atyre akuzave – gënjeshtare, t´u drejtova ty. Pasi e mora sigurinë prej teje se nuk do ta publikoje kurrë, ashtu në besë ta dërgova letrën. Por, ja që edhe kjo"besë" jotja ra përtokë!

Pa dijeninë time ke botuar pjesë nga letra, ku ai të lëvdon ty dhe më akuzon mua se "populli s´më paska zgjedhur". I botove, pa çka se e shkele besën. Kjo sipas teje, nuk paska fare rëndësi.

Po tani, po të shtroj një pyetje, pavarësisht se e di që nuk e ke forcën as kurajën të më përgjigjesh lehtë: A e di ti z. Xhemajli se kurdoherë që ne shqiptarët ndërmerrnim veprimtari si demonstrata, konferenca,e të tjera në dobi të atdheut, kurdoherë aty kanë qenë të pranishëm njerëz të politikës, të artit dhe të kulturës, pa harruar të ta përkujtoj se të gjithë ata danezë kanë qenë të ftuar nga unë?

Me këtë rast gjithashtu dua të të përkujtoj atë që edhe ti fort mirë e dije, se të gjithë udhëheqësit politikë të Shqipërisë etnike që vërtetbënin përpjekje për liri, madje edhe disa të tjerë që këtë respekt nuk e meritonin, sepse ato përpjekje nuk i kishin me seriozitet (pacifistët), pra të gjithë i kam ndihmuar dhe njëkohësisht i kam kundërshtuar, kur e shihja se punët tona po shkonin keq dhe ashtu kuturu, në rrugë pakrye!

Ndihmat e mia ndaj tyre i kam fokusuar në veçanti nga dy aspekte:

- nga aspekti më i domosdoshëm, për të krijuar lidhjet me qarqet politike, kulturore dhe shkencore këtu dhe,

- nga aspekti aq shumë i domosdoshëm, ai financiar.

Këtë të fundit e kam bërë herë-herë me ndihmat e miqve danezë, por edhe duke u angazhuar personalisht. Unë kurdoherë kam pasur tendenca të theksuara për ta bashkuar komunitetin shqiptar.

Veprimtarii madh i çështjes shqiptare si Adem Demaçi, erdhi për herë të parë në Danimarkëdhe e bëri debatin e famshëm në parlamentin danez. Kjo ka ndodhur në fillim të viteve ’90 dheka qenë nismë imja në bashkëpunim me miqtë danezë. Por, juve ju ftova që të bashkoheshim e jo të ekspozohesha i vetmuar si pusi i pafund.

Pastaj, po kështu kam vepruar kur erdhën këtu Hajrulla Gorani (atëherë Kryetar i Sindikatave të Kosovës), Arbën Xhaferi, Driton Lajçi – në emër të Unionit të Pavarur të Studentëve të Prishtinës, Xhafer Shatri e të tjerë.

Nuk e di apo nuk doqë ta kujtosh se nuk ka gazetë në Danimarkë që nuk ka bërë intervista apo nuk i ka botuar reagimet e mia ndaj sojit të sllavëve që bënin politikë antishqiptare në shtypin danez. Në shumë artikuj të tyre jam cituar sipas qëndrimeve të mia që tani publikisht po dihen, mbase për këtë kam botuar tre libra politikë.

Kujtoj këtu rastin më të errët dhe njëkohësisht më të ndritur për mua, kur shtypi djathtist, konkretisht gazeta ”BT”, shkroi se ”UÇK-ja është organizatë ushtarake terroriste dhe narkomane”. Atëherë pa ngurruar, dola me mbrojtjen se ”UÇK-ja nuk është ushtri terroriste, por është ushtri çlirimtare, që përbëhet nga djem e vajza të kombit shqiptar,e sa i përket financimit, vetëm unë këto ditë i kam dhënë 20.000 korona daneze për një muaj, sepse duam që të çlirohemi njëherë e përgjithmonë nga okupatorët”.

Kur shkrova më lartë se jam injoruar nga Këshilli i LPK-së, mund t´i ketë shkuar mendja dikujt se po shprehem kot së koti, por ja vetëm një fakt ndër ato shumë fakte të tjera që dëshmojnë për veprimet që i keni bërë ju të Këshillit: Kur një delegacion danez ishte në Kosovë në fillim të viteve ‘90, me sa më kujtohet ishte delegacioni i parë parlamentar, studiues të universitetit dhe ca gazetarë, të udhëhequr nga kryetari i grupit parlamentar të partisë konservatore daneze Vigo Fisher, që atëbotë e kishin pushtetin,unë me familjen time i nderova me përcjellje. Pastaj kur u kthyen i prita me lule në aeroport me vetëm pesë pionierë të cilët mezi i binda të dalin atje, sepse nuk kishte fëmijë shqiptarë që prindërit e tyre i lejonin lehtë të vinin atje.

Mirëpo, me atë rast ngjau një befasi që nga lexuesit mund të kuptohet hiç më pak si komedi politike: Këshilli nuk e dinte se delegacioni kishte shkuar dhe kthyer nga Kosova. Pasi i mora materialet, intervistat etj. për ato që kishte bërë delegacioni, po ato ditë Këshilli i ”famshëm” i LPK-së organizoi një darkë për delegacionin në fjalë. I mblodhën lekët për darkën, i caktuan pjesëmarrësit kush do të ishin të pranishëm, mirëpo për ”habi”, unë nuk u ftova. Komedia alla politike qëndronte si shtyllë turpi aty se ata nuk e dinin kush kishte qenë në delegacion dhe më kërkuan mua që t´i ftoja miqtë danezë. Por pastaj, në vetëdijen time ia bëra pyetjen vetes: Si të shkoja e t´i ftoja ata, kur unë nuk isha i ftuar në darkë, as nuk do të isha i pranishëm pastaj?!!! Fort i habitur nga kjo marrëzi e tyre ”koprracie” u fola atyre ”shokëve bujarë”, se si mund t´i ftoja miqtë danezë, kur aty nuk jam i pranishëm dhe për më tepër, si mund t´i prisni ju ata, kur asnjërin prej tyre nuk e njihni?! Dheu thashë me ironi: Do t´ju them danezëve, ejani e hani darkën me njerëz të panjohur!!! Pastaj u kthjelluan dhe u detyruan të më ftojnë në darkë!

Z. Ibrahim Xhemajli, si duket ti paske kujtuar të mbrohesh si Don Kishoti nga armiqtë e paqenë! Konkretisht, nga asnjë sulm imi ndaj teje, apo ke kujtuar se e shpëton ”nderin” e humbur, sikur i

mbyturi që mbahet pas një fije kashte, kur me kënaqësi e paske cituar letrën e Xh. Idrizit.

Jo, ore zotërinj! Vlerësimi i Xhemil Idrizit aspak nuk më shqetëson kur të gjithë shqiptarët e dinë se çfarë peshe ka veprimtaria e atij burri që e paska marrë mundimin të më vlerësoj mua. Njëkohësisht, për mua e dinë jo vetëm shqiptarët, por edhe danezët se çfarë përpjekjesh kam bërë për Shqipërinë tonë të dashur.

Për ”avokatin” tënd të tanishëm, po të kujtoj vetëm rastin se po ky Idrizi dikur ishte sulmuesi-prokurori yt. Shpresoj, nuk të ka humbur kujtesa për kërcënimin e Xh. Idrizit: ”Do t´ju djeg me 10 litra benzinë juve stafin dhe redaksinë tuaj", i cili u revoltua për ”gafin” tuaj që për 50 korona daneze ju mashtroi një turkoman i quajtur “Haxhi” Shabani, duke e porositur një këngë turke në radion në të cilin ti ishe redaktor, pastaj ju u përçatë.

Kur shkrova në fillim të shkrimit se ke shprehur një cinizëm, faktet i kam edhe për këto tendenca krejt të pakuptimta, kinse mua më paskan lënë pa legjitimet, elementë si ti, Idrizi e të tjerë si ju.

Jo, ore zotërinj! Mos kujtoni se më bëni të mërzitem për gjepura të tilla si këto sepse legjitimitetin për të qenë ”në ballë dhe te këmbët e këtij populli” -siç do të thoshte i madhi Jusuf Gërvalla, në radhë të parë ma ka dhënë puna ime shumëvjeçare, përkushtimi i pandërprerë për të arritur në cakun ku jemi nisur si një armatë e madhe e liridashësve të vërtetë. E këtë pastaj e vërtetojnë me shkrimet dhe deklaratat e tyre, të cilat edhe mua më kanë inkurajuar: i madhi atdhetar, Adem Demaçi, Hulusi Hako, Dritëro Agolli, Hysni Milloshi, Beqir Berisha, Zaim Beqiri, Hajrulla Gorani, Hakif Bajrami, Ramadan Pllana, Shaqir Shaqiri, Shqiptar Oseku dhe krejt natyrshëm ka respekt të veçantë - siç e thekson edhe ti o shkretan -edhe ”shoku Fadil Shyti”!!!

Prandaj, do të ishte naivitet i paskajshëm që mua dhe shokëve të mi të na e njihnin legjitimitetin ata që për vite të tëra, herë hapur e herë maskuar, me të gjitha format, pa i zgjedhur mjetet na kanë

penguar me apo pa vetëdije, në rrugën e lirisë dhe të ribashkimit kombëtar.

Duke vijuar më tej në jermin e tij propagandistik kundër meje, midis tjerash z. I. Xhemajli shkruan: ”Në intervistën e datës 22.07. 2010 Xhemil Zeqiri pretendon se e ka organizuar vizitën e kryeministrit Thaçi në Danimarkë. Kjo edhe pse nuk është e vërtetë, nuk është shkaku i reagimit tim, por shpifjet, trillimi dhe shtrembërimi i fakteve, me qëllim të ofendimit të personalitetit tim”!!!

Pastaj ke shkruar me pompozitet: ”Jo vetëm gënjeshtër por maskarallëk i llojit të vet është shpjegimi i tij, duke shtrembëruar faktet në lidhje me idenë e realizimit të vizitës së Thaçit në Danimarkë, kinse ai i paska telefonuar Dr Shaqir Shaqirit etj etj”…

Sa i përket organizimit të vizitës së H. Thaçit në Danimarkë, mbetem sërish i patundur në qëndrimet e mia se isha nismëtar që kjo vizitë të bëhej me sukses. E pranoj faktin se kur kam shkruar për telefonatën time me Ibrahim Kelmendin, me Hashim Thaçin dhe Bilall Sherifin për këtë vizitë kam folur me telefon të Ibrahim Kelmendit. Kam mundur të bëja një ”lapsus” do të thosha, sepse Ibrahim Kelmendi me shokë (ka mundësi të ishte në Tiranë, Zvicër apo në Austri, kur po bisedoja në celularin e tij), kurse unë kam menduar se po flas me të nga Kopenhaga në Bochum të Gjermanisë.

Në kisha apo jo ndikim tek organet daneze, më së miri e sqaron letra e Shaqir Shaqirit (lexoje letrën me kujdes se çfarë shkruan ish-përgjegjësi i Zyrës së Republikës së Kosovës, me seli në Stokholm). Mirëpo, pikërisht kur thua për hir të së vërtetës, pikërisht atëherë ti i ikë asaj.

Ndërsa kur ke shkruar: Për hir të së vërtetës, sqaroj se: ”Meqë kryeministri Thaçi (pas marrëveshjes së Rambujes) ishte në një turne vizitash të suksesshme në vendet perëndimore dhe duke vërejtur reflektimin pozitiv të këtyre takimeve i telefonova përfaqësuesit të qeverisë së Kosovës në Skandinavi Dr Shaqir Shaqirit. Ne biseduam se nëse kërkesën do ta bënte Dr.Shaqir

Shaqiri, gjasat për një përgjigje pozitivenga qeveria daneze do të ishin reale. Dr Shaqiri reagoi menjëherë dhe shumë shpejt mori përgjigje pozitive. Kështuqë kryeministri Thaçi erdhi në Danimarkë dhe u takua me kryeministrin danez, Poul Nyrup Rasmussen, ministrin e Punëve të Jashtme, Niels Helveg Petersen dhe ministrin e Punëve të Brendshme, Thorkild Simonsen"!!!.

Kjo nuk qëndron hiç e vërtetë! Sepse nuk është aspak e ndershme të pretendosh t´i bindësh lexuesit kinse Hashim Thaçi paska zhvilluar disa vizita në vendet perëndimore. E vërteta është se Hashim Thaçi ka qenë atëbotë vetëm në Danimarkë, kurse gjatë kthimit e vizitoi Bullgarinë dhe Maqedoninë.

Kujtoj se veç Danimarka figuron gjeografikisht në Skandinavi, gjegjësisht në perëndim, ndërsa Bullgaria dhe e bija e saj, Maqedonia i përkasin Ballkanit, apo jo?! Kur shtron pyetjen krejt pa kuptim se me çka u kthye Hashim Thaçi në Kosovë, përgjigjen po ta jap krejt thjesht: "As më ka interesuar me çka kthehet Hashimi në Kosovë. Mua më ka interesuar të respektohet institucioni i Kosovës, e jo Hashim Thaçit si person.

Më tutje ore zotëri, je ankuar se unë të paskam akuzuar "padrejtësisht", se ti je herë me LDK-në, herë me Ilir Metën e partinë e tij, me Sali Berishën, Bamir Topin, Ibrahim Rugovën etj. Kështu fshihesh pas intervistave të cekura të poshtëshënuara dhe shkruan tejet me paturpësi: "Çka do të thotë se logjika e tij është e nivelit aq të ultë" sa që takimet e mia për qëllim interviste me Bamir Topin, Ibrahim Rugovën (gjatë vizitave të tyre të fundit në Kopenhagë) dhe me Ilir Metën më 28.05.2010 po ashtu në Kopenhagë i konsideron si përcaktime dhe anime të mia partiake. Qesharake!!!

Jo, asgjë këtu nuk ka qesharake, përveç kameleonizmit tënd të pacipë! Me elementë të tillë si ti, që "i ndërrojnë gëzofët sipas motit", mund të ngarkohen jo makinat, por trenat e zi të Perëndimit. Krejt në fund të kësaj përgjigjeje po të theksoj dy kërkesa:

- E para, kur të duash bëjmë debat publik për gjithçka që ty dhe si-vëllamët e tu, ju mundon. Aspak nuk ua kam frikën se do të fitoni me forcën e argumenteve; dhe

- E dyta, kurrë mos e merr mundimin e kotë të mësosh apo të këshillosh të tjerët ”se kanë përgjegjësi”, kë dhe si të më marrin intervista mua dhe të tjerë, që po ua prishim rehatinë ”demo(n)kratike”, pra shokëtemi si Fadil Shyti dhe ”Shyta të tjerë” të cilët Serbia, Maqedonia dhe Mali i Zi, i kanë në listat e tyre të zeza si elementë destruktivë dhe të padëshirueshëm.

ÇFARË KULTURE PREJ RRUGAÇI QË KENI, O BAKI YMERI (!!!)

Reagim, duke lexuar reagimin tendecioz tejet emocionues dhe
të pa bazuar në fakte të Baki Ymerit, te "Zemra Shqiptare":
„Çapaçulja e Puçalenit, apo: Kur gënjeshtrës i bien brekët!!!"

E Shtunë, 03-10-2009

Në këtë kohë të pakohë është bërë zakon dhe sikur një lloj sëmurjeje narciste nga disa elementë që kujtojnë se i kanë kapur ato "yjet" e flamurit të BE, duke u bërë kinse të njohur si "demokratë", vetëm për faktin se zotërinjt paskan arritur që të dinë ndonjë gjuhë të huaj dhe tani me letrat e tyre "me vlerë" s´ po lënë gur pa lëvizur që të shkatërrojnë çdo gjë të bukur e të shenjtë shqiptare.

Mbase, kjo u dëshmua jo rrallëherë nga disa "poetë provincialë" që faktikisht nuk i njohin as lagjet e tyre. Këtë bindje e forcova më tej duke e lexuar reagimin tejet emocionues dhe aspak të bazuar në fakte të Baki Ymerit. Ky, "atdhetar" i dëshmuar orvatet që me shpifje dhe fyerje të pista; ndaj atdhetarit, Zaim Beqiri, t´ua mbushë mendjen lexuesve për kinse pastërtinë e tij morale dhe kombëtare.

Jam nga ata shqiptarë mërgimtarë që tërë jetën time jam përpjekur dhe përpiqem për të bërë jo vetëm të mundurën por, edhe të pamundurën që Shqipëria jonë Etnike të ecën përpara në të gjitha fushat e jetës dhe një ideal madhor i breznive të shkuara e të sotme dhe atyre që po vinë të realizohet: *Ribashkimi i kombit tonë, sipas parimit, një komb një shtet.* Isha dhe jam i vetëdjshëm se, nuk mjafton vetëm dëshira për realizimin e këtij ideali por, duhen përpjekje, mund dhe sakrifica!

Duke e kuptuar këtë; jam pozicionuar kurdoherë në anën e forcave më përparimtare gjatë rrahjeve të valëve të historisë; e kisha dhe e kam për nderë t´u çasem me të gjitha format dhe mjetet në

dnihmë –atyre, që e meritojnë aq shumë, atyre që kanë bërë veprimtari të pandërprerë e po bëjnë aq shumë për Shqipërinë Etnike.

Padyshim, në këtë armatë të madhe të pishtarëve të lirisë që shtriheshin si krahët e shqiponjës nga Çamëria, Kosova , Tetova , Ulqini e Presheva; u rreshtuan dhe Zaim Beqiri me vëllëzërit e tij.

Kur mora vesh nga shokët se, Zaim Beqiri e paska përgaditur për botim një libër me kujtime; duke e njohur prej kohës veprimtarinë e tij ilegale dhe duke e ditur se, ishte njëri ndër më të persekutuarit nga shteti okupator maqedonas dhe ishte njëri ndër ata që përkundër gjihtë atyre torturave tejet çnjerëzore fizike e psiqike; nuk u thye kurrë; kur dihet fakti që edhe pas daljes nga burgu regjimi titist e damkosi dhe u përpoq ta izoloi dhe nga rrethi i tij më i ngushtë , por Ay qëndroi si i ka hije një shqiptari çlirimtar, qëndronte ballëlart dhe ecte në rrugën që i kishte shtruar vetes për detyrë; kishte dhe ka respekt të madh në popull; jo vetëm Ay, por edhe e tërë familja e tij . Pra, duke i kujtuar të gjitha këto, pa dijeninë e autorit të librit; kam vendosur që ta japë kontributin tim modest, për financimin e librit.

Madje, për këtë nuk jam i penduar aspak! Them kështu për faktin që, kur lexuesit do ta lexojnë librin ”Kujtime” do të mësojnë më shumë për veprimtarinë e lëvizjes ilegale e në veçanti do të mësojnë për formimin e njërës ndër të parat parti që e kishte në program ribashkimin kombëtar. Lexuesit aty mësojnë gjithashtu, për organizimin, veprimtarinë dhe qëndresën brenda radhëve të saj, mësojnë fatkeqësisht edhe për dështimin e ikjen nga fronti nga disa anëtarë të asaj partie- e njëri nga ata të tillë, sipas autorit pjesëmarrës dhe organizator kryesor i asaj forca politike, për më keq, i cilësuar prej tij si spiun -ishe ti o Baki Ymeri.

-Aty, je i cilësuar si spiun jo nga ndonjë mëri personale, që mund të kishte Zaim Beqiri ndaj teje; sepse, aty fort mirë lexuesi e kupton, se ishte pikërisht vet Zaim Beqiri që të kishte ofruar bashkëpunim ty, o shkretan, por, që pastaj, ti nuk pate

as forcë as guxim por as kurajon të qëndroje në ballë të atyre përpjekjeve…

Tani, me këtë rast do të shtroja dy pyetje retorike: **Cili organizator do të dëshironte që pas rënies apo daljes nga burgu t´i dështonin shokët e tij?! Kush do të dëshironte që të konfrontohej edhe fizikisht me ish-shokun e tij, kur do ta kuptonte se po i shkonte pas si hije nate, për ta përgjuar ku po shkonte e çka po vepronte?!**

Jam i bindur se lexuesit duke e lexuar librin do të kuptojnë me fakte që ti ore zotëri ishe nisur për së mbari në rrugën e përpjekjeve për liri, por, që pastaj ke devijuar dhe fatkeqësisht nuk je i vetmi - sepse, populli thotë: ”që, për të hyrë në rrugë të vështira të luftës për liri; i hyhet lehtë (”lumit”), por pastaj, zor është të dilet me faqe të bardhë!

Ti, o Baki Ymeri në reagimin tënd ke shkruar një mori të pavërtetash, shpifjesh dhe sharjesh të adresuara ndaj Zaim Beqirit; siç shihet ty të paska djegur fort ”miza nën kësulë”, për faktin se ky atdhetar i devotshëm të ka demaskaur botërisht ty dhe jo vetëm ty por edhe tërë soj sorollopin si ju të cilët keni shkalluar në rrugë të pakrye kudo që jeni –e, kudo që s´jeni!

Ty, or kokëshkretë që e hymnizon ”politikën largpamëse” pacifiste alla rugoviste-titiste dhe berishiste-zogolliste pro-fashiste, gjatë tërë reagimit tuaj nuk të ka vajtur mendja asnjëherë me asnjë fakt real të demaskosh Zaimin apo më saktë t´ia demantosh pretendimet e tij të paraqitura në librin e tij.

Të paktën për një çast më shumë do të të besonte dikush që s´të njeh apo së paku për çast, do të fitoje admirimin ndaj lexuesve nëse do të tregoheshe më i matur dhe më i kursyer ndaj shpifjeve dhe sharjeve që i ke vjellë kundër Zaimit, Ademit dhe Qosjes.

Ke shkruar**: ”***Në bazë të shkrimeve tona prezente edhe në google.com mund të verifikohet e vërteta se “Zaim Beqiri e qindra atdhetarët të tjerë dënohen me burg të rëndë nga autoritetet pansllaviste të Shkupit për ngritjen e flamurit kombëtar në Tetovë.”*

Këtë e kemi thënë dikurë, por koha nxjerr në pah anën tjetër të medaljes se më kot ka ndenjur në burg derisa i bie të mirës me shqelm, derisa gënjen dhe rend si një qen pas djersës së mërgimtarëve tanë për t'ia sponsorizuar "Kujtimet" e krisura me një varg gënjeshtrash alla/zaimiste për alimentimin e pulave të Puçalenit. E dinë fare mirë marksist/leninistët se shqiptari digjet për komb dhe atdhe, se shqiptari derdh djersën e ballit dhe shkrin pasurinë për t'ia ngritur shtëpinë me bazen bacit Zaim, bacit Rexhep dhe bacit Adem".

Nga këto keqinterpretime, shpifje e fyerje shihet qartë se ti ke dashur ta minimozosh veprimtarinë atdhetare të kolosëve të mëdhenj të shqiptarisë Adem Demaçit, Zaim Beqirit, por edhe të mendimtarit e flozofit të madh, Rexhep Qosjes. Fillimisht, dua të të sqaroj ty, sepse, lexuesit e dinë që as Adem Demaçi, as Zaim Beqiri, nuk qëndruan burgjeve me decenie të tëra vetëm për një vepër kundërvajtëse, se e paskan ngritur në një apo disa demonstrata në Prishtinë o në Tetovë, flamurin kuqezi; sepse, ore zotëri, që ty të paska lënë kujtesa: flamuri kuqezi pas gjithë atyre demosntratave në trojet shqiptare shovenistët jugosllavë me në krye xhelatin Tito, u detyruan ta lejojnë në fillim të viteve 70-ta.

Pra, ajo FITORE u arrit me sukses, e përse do të duhej pastaj të vuanin njerëzit burgjeve?!!!

Mirëpo, siç dihet historikisht´dhe siç e ceka më lart, dishepujt e shqiptarisë i kishin shtruar vetes objektiva tjera të mëdha për realizimin e tyre; t´i eliminonin ato, padrejtësi që iu kishin bërë kombit shqiptar në përgjithësi nga Evropa (që deri sot në këtë pikë nuk ka ndryshuar aspak) qëndrimi i saj.

Pra, ata intelektualë përparimtarë e prijës popullorë, ishin të angazhuar për ribashkimin tonë kombëtar.

Ty dhe të tjerëve si ti, ua përkujtoj edhe njëherë se: nuk kishte organizatë apo parti atdhetare-ilegale; -e, kohëve të fundit edhe legale që u krijua me mund e saktrifica nga atdhetarët shqiptarë; që, ata të mos e kenë në gjirin e tyre si njërin nga udhëheqësit më të nderuar edhe Zaim Beqirin, pas daljes nga burgu, ai nuk ia shtroj

rehatisë për njëqind palë qejfe, përtej brigjeve të Adriatikut, por tërë jetën e tij e shkriu në shërbim të çështjes shqiptare. Bacin, Adem Demaçi, s´ke përse as ta lëvdrosh as ta kritikosh, bile, ti që e ke fyer aq shumë shokun e tij të pandashëm të burgjeve dhe të veprimtarisë deri sot.

Por, dije mirë se nuk është aspak e ndershme (po, ku dini ju nderë se...) për ty që t´i akuzosh këta pishtarë lirie se, paskan ndërtuar **"shtëpi me bazene"** –sikur të shkruaje bile, "shtëpi me pishina" –**sepse, fjala bazen, është fjalë serbe**; por, si duket ti si një intelektual reaksionar, me rrënjë të gjuhës së nënës; rumune më për qejfi po të levërdiska të futësh "fjalë-ferra" sllave në kopshtin e bukur të gjuhës shqipe.

Por, kujdes! Mos harro se, prej Naim Frashërit të madh e deri tani, ka njerëz që i kositin ato ferra që ty dhe sojit si ti; iu të kanë mbetur në kokat tuaja.

Ke shkruar: "...*Por, kurrë nuk mund të përmirësohen lehjet e çapaçules kundër Sali Berishës apo autorit të këtij shkrimi".* Ju, që po e merrni mundimin t´i mbroni Ibrahim Rugovën dhe Sali Berishën, e bëni këtë për disa arsye, por dy janë më kryesoret:

1. Ju, doni t´i fshehni krimet tuaja,

2. Ju doni t´i fshihni turpet tuaja.

Le të mbetet ty zotëri dhe secilit prej jush detyrë "njerëzore" që të meditoni me veten tuaj dhe ta gjeni saktë veten se, në cilin taborr të përgjakur apo të pistë jeni!

E, sa për ilustrim se kush ishte I.Rugova po ju paraqes midis tjerash që dihen disa fakte të hidhura: - I.Rugova, për t´i mbetur besnik, LKJ-së, kur e bëri "Marrëveshjen" e turpshme të Shën Exhidios, e nënshkroi atë, me shkronja sllave.

-Pastaj, gjatë luftës kur shkoi në Beograd (kinse, i kidnapuar) atje në takimin zyrtar që zgërdhihej, me shefin e tij S. Millosheviqin; e nënshkroi një komunikatë për ndalimin e bombardimeve të NATO-s, sepse, po pësojnë civilët serbë..., poashtu, këtë e bëri edhe kur iku në Itali, kur deklarohej pa

dorashka: kundër bombardimeve, ashtu e zhvillonte një veprimtari anti-kombëtare, në rolin e ministrit të jashtëm të Serbisë- për faktin se në atë kohë ishte e ndaluar të vepronte ministria e jashtme e Serbisë.

-Pas kthimit të tij në Prishtinë, filluan për Kosvën të rrënohen themelet e saj për bërjen e shtetit.

-Me udhëzimet e qeverisë franceze, I. Rugova e kërkoi i pari, para S. Millosheviqit, dialogun –thuajse, kombi shqiptar ishte fajtor për krimet serbe që ndodhnin në 100 vj. e fundit.

Pas kërkesave për dialog nga pacifistët pro-serbë dhe devijatorët nga udhëheqja e UÇK-së; erdhën në valët e historisë së re të atdheut - si dallgë shkatërruese Konferencat famëkëqia si ajo e Rambujesë , e Parisit, e Vjenës të cilat ngjajnë si pika uji të turbullta në një gotë, me Konferencat e errëta të Londrës së vjetër dhe asaj Londërs 2 (1992) .

Të gjitha këto fatkeqësi që kombi shqiptar po i përjetion sot dhe do t´i përjetoj edhe nesër, burimin e kanë tek politika anti-shqiptare e Ibrahim Rugovës.

-Politika e tij e solli Paketën famëkeqe të Ahtisarit e cila fillimisht, e ndau Kosovën në enklava, tash sipas decentralizimit, po e realizon edhe de jure, uroj, që kjo nismë famëkeqe kurrë të mos bëhet de fakto!

- Politika famëkeqe e I. Rugovës, e krijo “kombin kosovar” , “duke e deklaruar e po përiqen ta bëjnë; Kosovën “multietnike” dhe si kryevepër më të poshtër -se vet poshtërsiapolitike qe, mohimi i flamurit kombëtar dhe zv. i tij me një flamur shumëngjyrësh që i gjason flamurit serb.

- Dihet nga gjithë se, këtë politikë prapaktheu të I. Rugovës, gjithmonë pa rezerva e përkrahu S. Berisha.

- Frytet e politikës “kombëtare” të S. Berishës, janë të njohura që nga koha kur erdhi në pushtet, por do t´i theskoja disa më të “dobishmet” prej tyre:

1. Kujtoni piramidat e vj, 1997, pastaj, tregtinë me naftë dhe armë për Serbinë (në kohën kur bota e bllokonte këtë shtet agresore fashiste), pastaj, Gërdeci dhe Gërdecër të tjerë që dihen e nuk dihen se kanë ngjarë...

Kjo, politikë anti-çlirimtare u ndoq kur qeveria I-rë e Sali Berishës i persekutoi burgjeve luftëtarët e UÇK-së: Adem Jasharin, Zair Pajazitin, Luan Haradinajn, Femi Lladrovcin dhe më së keqi e pësoi atdhetari Remzi Hoxha, i cili u vra gjatë marrjes në pyetje nga SHIK-asit e besnikut të Berishës, Gazidedes, prej torturave, me urdhër të vet Berishës, dhe pastaj përfundoi me zhdukjen e trupit të tij, të cilit ende varri nuk i dihet, - ngjashëm si trupat e shumë shqiptarëve që i vrau regjimi i Sllobodan Millosheviçit. Pse i ngjau kjo Remzi Hoxhës, tani po dihet: i ngjau sepse ky qe ai burrë që i zbuloi rrënjët e tradhtisë rugoviste-berishiste, bashkëpunimin dhe takimin e fshehtë në Ohër të S. Berishës me S. Millioshevicin dhe Kiro Gligorovit.

Tani, ku po i shkruaj këto radhë, më kujtohen dhe dy kryevepra tradhtie të S: Berishës: falje detare në kufirin me Greqinë; miqësia e trashur me serbët Fazlliqin-Tadiqin e viqër e hiqër të tjerë!

Prandaj, çdo shqiptar me mendje të kthjelluara në kokë i jep të drejtë atdhetarit, Zaim Beqiri kur në gazetën "Zëri i Kosovës" deklaron*: "Peshku qelbet nga koka e jo nga bishti, çoroditja jonë kombëtare gjatë këtyre viteve, pikërish zanafillen e ka në kokë, një prej shumë prognozave të gabuara të politikanëve aktualë si të Tiranës ashtu edhe të Prishtinës. Gabim katastrofal dhe i pafalshëm. Askush nuk ka të drejtë për të viktimizuar një mijlon banorë në tokën shqiptare qoftë, Sali Berisha apo Ibrahim Rugova"*

Ndërsa, tani klikat reaksionare, Rugova, Thaçi dhe Berisha po i viktimizojnë disa miljona shqiptarë!

Po e përfundoj këtë reagim me një konstatim, dhe që ti ore zotëri kot e ke që mundoshesh të hedhësh baltë mbi fytyrën e ndritur të Zaim Beqirit, sepse, populli e njeh Zaimin të pastër kombëtarisht; Ay, që kurrë nuk e lakmoi paranë as pushtetin por u përpoq dhe po përpiqet për ta bërë shtetin shqiptar të Ribashkuar

dhe të përparuar, - mbase, për këtë pikërisht, në librin e tij "Kujtime", ai i sfidon jo rrallëherë e përciptazi, por thellësisht dhe pamëshirë pushtetarët e sotëm servilë të maqedonasve, si: Ali Ahmetin, Fazli Veliun, Menduh Thaçin e Co, për gabimet gjatë veprimtarisë së tyre anti-kombëtare, politike dhe ushtarake , sepse janë nënshkruesit e "Marrëveshjes së Ohrit" e plot të tjera..., sipas lojërave të turpshme Berishiste...

Lexojeni zotëri shkrimin e atij libri: "Atdheu pikë e pesë, nuk është fjala ime e fundit" !

Shpresoj, që pastaj do të reflektoni sadopak dhe do të pendoheni për ato shkarravina nervash që i ke shkruar në reagimin tuaj i shprehur vetëm në emocione dhe jo në argumente as jetësore as shkencore.

Kopenhagë, 28.12.200

RTK-ja NË SHËRBIM TË KOLABORACIONISTËVE PROFASHISTË!

REAGIM i radhës ndaj RTK-së

Kësaj radhe reagimi im ka të bëjë lidhur me një intervistë që ia dha RTK-së Uran Butka.

Uran Butka është i biri i Safet Butkës, i cili luftoi përkrah nazifashistëve, derisa u vra duke u shërbyer armiqve të huaj.

Ai ia dha intervistën gazetarit ”xhentëlmen”, Smajl Smakës, më datë 10. 11. 2008, Prishtinë.

Në atë intervistë, ”rishkruesi” i historisë sipas qejfeve të tij dhe politikës ditore, na njofton se paska përuruar një libër dhe pohon se e paska analizuar ”drejt” Mbledhjen e Mukjes në cilësinë e një ”historiani”.

Reagimi im i drejtohet rreptë RTK-së, për arsye se në këtë medium, kinse për “art dhe kulturë”, po ftohen mbi 90%, ish-udbashë, ish- LKJ-istë, ballistë e zogistë, me të vetmin qëllim që të dezinformohet si mos më keq, populli ynë i shumëvuajtur shqiptar.

Populli ynë e di fort mirë se dezinformimet, trillimet, shpifjet dhe censurimet në këtë shtëpi informative nuk po kanë të ndalur.

Retorikën e poshtër, të pakursyer nga fjalët e ulëta që nuk e meriton t’i dëgjojë ky popull, më së miri e ka përshkruar dhe e ka analizuar saktë veprimtari atdhetar, analisti dhe eksperti i retorikës, Mr. Gëzim Mekuli, i cili në ëeb-faqen www.mekuli.com , midis tjerash konstaton se RTK-ja i shërben shpëlarjes së trurit të shqiptarëve. Pastaj përfundon me lutjen: “O zot, ruana nga dezinformatat e RTK-së”!

Unë prej vitesh jetoj në Kopenhagë. Pas punës së gjatë dhe të mundimshme, mezi pres të shkojë në banesë dhe t´i ndjekë zhvillimet e ngjarjeve në atdhe dhe të shikoj ndonjë program

shkencor, kulturor, ekonomik apo politik. Me një fjalë, jam dëgjues i rregullt i RTK-së.

Është e habitshme që RTK-ja e paska ftuar Uran Butkën të evokojë kujtime për babanë e vet, Safetin, me ç´rast nuk i kurseu lëvdatat. Mbase për të, kjo është e natyrshme. Por është tepër e habitshme sesi ky "mendjendritur" e paska harruar axhën e tij antifashist. Pra, nuk e tha asnjë fjalë për atdhetarin antifashist, Muharem Butkën, për të cilin i madhi Enver Hoxha kishte konsiderata të larta. Ai, gjatë vizitës në familjen e Butkajve do ta përkëdhelte Uranin e ri dhe do t´i uronte me gojë, ndërsa urimin do ta firmoste me shkrim: "Të bëhet trim si mixha i tij, Muharem Butka, e jo si krimineli Safet Butka"!

Dhe atë letër do ta ruante gjatë, "trimi" Uran Butka.

Irriton fakti që kur gazetari Smaka e pyeti se ç´mendon për rolin e Haki Stërmillit, U. Butka iu përgjigj negativisht duke thënë: "Ai për fat të keq, e përqafoi një politikë antikombëtare, pra antifashiste"! Haki Stërmilli paska përqafuar politikë antikombëtare sepse paska luftuar me armë në dorë kundër fashizmit, kurse Safet Butka, babai i Uranit, Muharem Bajraktari dhe vëllezërit Kryeziu, të cilët i vajtonte "qyqja" neofashiste, kinse paskan përqafuar politikë atdhetare!!! Po "harron" apo nuk e di pinjolli i Safet Butkës, i cili u vra nën uniformën fashiste, se Muharem Bajraktari dhe Kryezinjtë ishin kokë e këmbë të shitur tek krajlët serbë, se ishte pikërisht Ceno Beg Kryeziu ai xhelat, i cili në bashkëpunim me Muharem Bajraktarin, e organizuan dhe e realizuan vrasjen e atdhetarit me famë kombëtare - Bajram Currit.

Uran Butka ngre lart Ballin dhe veglat qorre të nazi-fashizmit. Ai e quan akt patriotik veprimin e kryeballistit - Mit´hat Frashërit i cili urdhëroi që pushtuesi i Shqipërisë, Perandori Viktor Emanueli III, më 21 maj 1939 të stoliset me Kurorën e Skënderbeut, duke e shpallur mbret të Shqipërisë!!!

Nuk do të harroj t´ia përkujtoj "historianit" se po me këtë kurorë e stolisi edhe Gjergj Fishta, i cili nuk hezitoi t´i këndonte edhe himne.

Urani i Safet Butkës vajton pse pas luftës nuk u instalua në Shqipëri sistemi shumëpartiak. Pra, të lejoheshin të merrnin pjesë në zgjedhje edhe ato parti që kishin kolaboruar me fashistët!!!

Jo mor zotëri, kjo logjikë nuk shkon, sepse që nga Mbledhja e Mukjes të cilën ju e ngrehi aq lart, Balli Kombëtar, Legaliteti dhe parti të tjera, "opozitë" e PKSH-së, nuk iu bashkuan kryengritjes popullore, por i goditën partizanët prapa shpine. Si paskan menduar të parët tuaj: Të bien para gjunjëve të armikut, t´i godasin prapa krahëve partizanët, e pastaj të ulen këmbëkryq në parlamentin shqiptar, të dalë nga gryka e pushkës!!!

Mbledhja e Mukjes alibi e kotë!

Për këtë Mbledhje, fjalën e vet e ka thënë dhe do ta thotë edhe më tej, historia. Devijimi nga rruga, i çlirimtarëve të rinj tani, pra aleancat për "pushtet", madje edhe pa shtet, me pacifistët dhe me kolaboracionistët titistë, më së miri dëshmojnë se në për çfarë faze kalon sot Shqipëria natyrale.

Këtë nuk e lejoi kurrë i madhi Enver Hoxha. Mbase dhe për këtë, ne shqiptarët patëm fat, sepse u ruajt ajo gjysmë Shqipëri, pa u bërë republikë e shtatë e Jugosllavisë.Lexuesve këtu po ua jap vetëm një fakt: Oficeri i Shërbimit të fshehtë anglez, Reginald Hibbert , në librin e tij "Fitorja e hidhur - Lufta Nacionalçlirimtare e Shqipërisë" (në kujtimet e tij për Luftën e Dytë Botërore) shkruan: "Ne ishim të interesuar ta ndihmonim luftën në Shqipëri. Ne e dinim se atje ekzistonin forcat komuniste dhe nacionaliste - siç i quan ai. Të dy palëve u jepnim armë, ushqime etj. Ballistët e të tjerë nacionalistë, i merrnin armët por nuk luftonin me fashistët, ndërsa partizanët e udhëhequr prej komunistëve të Enver Hoxhës, luftonin flakë për flakë".

Ballistët nuk luftonin sepse midis tyre dhe qeverisë fashiste italiane ishte bërë një marrëveshje që ata të mos i goditnin forcat fashiste.

Pastaj shton: “Ne e dinim se kjo do të na kushtonte në të ardhmen për vendosjen e sistemit në Shqipëri, por ne duhej të ishim aleatë me ata që e bënin luftën antifashiste”.

Po plaku djathtist , Sabri Godo, përse hyri në këtë mes gjatë atij emisioni?! Harron z. Smakaj se ishte Sabri Godo ai që e zgjodhi pasardhësin e tij, Fatmir Mediun, i cili pa kurrfarë logjike shkoi atje ku nuk duhej, kinse për t´ú bërë më papë se papa. Para ca kohësh shkoi dhe bëri homazhe te ish-ushtarët e fashizmit, të rënë në Shqipëri! Pas asaj broçkulle politike, ngjau hataja. Nuk kaloi as viti dhe ky “demo(n)krat) i kulluar, tani po përballet me gjyqet e zvarritura “berishiste” për tragjedinë e Gërdecit.

Nga ky emision fund e krye u dëgjua zëri i reaksionit, u pa qartë se ishte përgatitur enkas të mohohet lufta çlirimtare, të mohohen vlerat e larta kombëtare dhe historike të kombit shqiptar.

Emisione të tilla asnjëherë nuk do t´i duhen popullit shqiptar, kudo që jeton në trojet e veta etnike, sepse jeta politike aktuale është shumë e vështirë. Ustallarët e RTK-së bëjnë “lukse” të tilla përçarëse brendakombëtare. Ata mendojnë se, sipas strategjisë të tyre “vepro në mjegull”, tani është koha më e përshtatshme që ta rehabilitojnë veten, duke prodhuar trillime me të tilla emisione...

Natyrisht, qëllimi i tyre është ta çorientojnë kombin tonë nga rruga e drejtë e lirisë. Është tepër trishtues fakti që sot organizohen përurime të librave të tillë ku ngrihen pa asnjë meritë profashistët dhe mohohen ngjarjet historike antifashiste, madje në një kohë kur Evropa demokratike i mohon profashistët dhe i nderon antifashistët.

Për ne shqiptarët ishte fat i madh historik që PKSH-ja na bashkoi me aleancën antifashiste botërore. Ndryshe, sot e mot do të ishim të humbur dhe të turpëruar para botës së vërtetë liridashëse.

Shpifjeve balliste, tepër të pakuptimta dhe bajate, sipas stilit politik titist, se serbët e paskan udhëhequr luftën dhe ndërtimin e socializmit në Shqipëri, tani nuk i beson njeri me mend në kokë. Mbase këto vajtime shkojnë vetëm tek ithtarët besnikë të verbuar të

Ibrahim Rugovës dhe të Sali Berishës. Krerëve të tyre, siç po shihet, çdo ditë po u dalin sheshit gjurmët e mishëruara me politikën serbe.

Shqiptarët sot, kudo që jetojnë, e dinë fort mirë se në kohën e Enver Hoxhës ishin krenarë, jetonin të lirë dhe me nderë në trojet e tyre. Ata nuk i frikësoheshin kurrë dhe askujt, që të deklarohen se janë shqiptarë!

Ndërsa tani po shihet qartë se ku e solli "politika" alla Salo-Rugova, Shqipërinë natyrale dhe shqiptarët.

Dikur Enver Hoxha vizitonte qytete e fshatra shqiptare, për festa e gëzime, kurse tani Saloja po i viziton vetëm për vota, apo për më keq, në raste fatkeqësish dhe tragjedish të paparashikuara që po u ndodhin njerëzve të pafajshëm!

Kosovën ndërkaq, e ka mbërthyer kolonializmi dhe politika e nënshtrimit sipas amaneteve dhe aleancave politike partiake me LDK-në e I. Rugovës. Shqiptarët s´ janë të lirë as të jetojnë në shtëpitë e tyre në veri të Kosovës "së lirë dhe sovrane"!

Dikur na torturonte policia e Serbisë, tani po na torturon policia e Evropës, me firmën kolonialiste "UNMIK".

Kopenhagë, më 12 nëntor 200

DISKUTIME

gjatë promovimit të librit "Në mbrojtje të çështjes shqiptare", me autor z.Xhemil Zeqiri.

Prishtinë, 03.09.2005

ADEM DEMAÇI

Fjala e hapjes

Ju falënderoj për ardhjen tuaj. Këtu po shoh alamet veprimtarësh tanë, të brendshëm e të jashtëm, kushtimisht thënë. E kemi këtu edhe Shaqir Gashin nga Amerika, i cili shprehu dëshirën ta hijeshojë këtë takim tonin.

Po shoh këtu profesorë, akademikë. Me fjalë të tjera, kemi gazetarë, poetë, shkrimtarë dhe veprimtarë. Ju falënderoj të gjithëve. Mirëpo unë besoj se ky është një respekt që i bëhet një veprimtari tonë që e kemi të palodhshëm. Jeton tash, 30-40 vjet në Danimarkë. Kur ka shokë, punon me shokë, kur s'ka shokë – punon vetëm, e s'ndalet.

Çdo njeri që takon në Danimarkë, më së pari ia çel çështjet e Kosovës. Kështu që ka krijuar miq e dashamirës, si të majtë, si të djathtë, si të qendrës, si intelektualë, si sindikalistë. Ka qasje nëpër të gjitha gazetat e televizionet. Me fjalë të tjera, është një punëtor i cili meriton që ta përkrahim sepse vazhdimisht është në vijën kombëtare. Mund të pajtohemi ngandonjëherë, mund të mos pajtohemi ngandonjëherë, por ky është ai që nuk e lëshon rrugën kombëtare. Çdokush që e lëshon rrugën kombëtare, ky e gjuan. Pavarësisht a është Hasan, a Hysen. Si të vijë në rrugën kombëtare, përsëri pajtohet me të edhe ec përpara.

Me fjalë të tjera, ky është ai motori ynë popullor i cili nuk kursehet që të veprojë për popullin e vet. Ky është diku nga Tetova,

mirëpo ky nuk njeh kurrfarë kufijsh, kurrfarë barrierash e ndarjesh. Ky i din vetëm shqiptarët… prandaj edhe vlera e tij është shumë e madhe dhe prandaj edhe respekti i tij është shumë i madh, edhe këtu te ne, por edhe në hapësirën e Danimarkës, edhe në hapësirën e mëtutjeshme, jo Suedi, jo Norvegji etj. etj.

Iu shkruante kryeministrave, ministrave: *pse kështu, pse s'po bëni kështu, marre për ju kështu?!* Me fjalë të tjera, nuk rri rahat dhe çështjen tonë vazhdimisht e shkruan dhe e aktualizon, në të gjitha kohërat, në të gjitha situatat.

Ky është Xhemil Zeqiri. Sigurisht se ka edhe bashkëpunëtorë të mirë, e ka Beqir Berishën një bashkëpunëtor të mirë, i cili edhe ky nuk kursehet që ta japë kontributin e vet, si intelektual i lartë, si analist i madh, si njeri i letrave.

Unë po them edhe njëherë, ju falënderoj shumë që keni ardhur dhe që po merrni pjesë këtu bashkë me ne, ta gëzojmë edhe Xhemilin, të gëzohemi edhe ne që jemi këtu.

Po fillojmë. Beqir Berisha ka një vështrim të vetin lidhur me këtë libër që e keni të gjithë. Edhe vlerësimi i Beçës është që ky është një libër i mirëfilltë politik sepse prek çështje politike aktuale edhe në mënyrë të nxehtë. Jo në mënyrë vetëm për t'u përshkruar, por është aktiv dhe nuk e fsheh interesimin e vet dhe përcaktimin e vet për të drejtat e popullit tonë, për bashkimin e popullit tonë.

Me fjalë të tjera, ky është një nga ata maksimalistët nacionalë që gjatë historisë sonë kemi pasur shumë, por që edhe prania e Xhemilit tregon se ata edhe në ditët e sotme, nuk na mungojnë. Zoti Beqiri ju lutem ta merrni fjalën!

LIBRI I XHEMIL ZEQIRIT DALLOHET NGA SHUMË LIBRA TË TJERË TË KËSAJ NATYRE NË LOGJIKËN SPECIFIKE AUTENTIKE

Diskutim

Shkrimtar e Publicist **Beqir Berisha**

Të nderuar të pranishëm! Së pari ju falënderoj për respektin që keni treguar me ardhjen në promovimin e këtij libri. Para se ta lexoj këtë që kam shkruar për librin, më nxiti zoti Adem Demaçi që edhe unë të them disa fjalë rreth autorit të librit.

Ju e shihni se titulli i librit *Polemika, intervista, debate dhe letra* flet në mënyrë shumë të qartë çështjen shumë të qartë se autori nuk është vetcensuruar. Se autori nuk është vagë që të orientohet sipas politikës empirike, në trajtimin e problemeve politike që na ngarkojnë sot. Ky ka polemizuar, ka debatuar dhe ka shkruar letra në mënyrën të pa rezervë, duke mbrojtur në mënyrë.

Sipas titullit, sipas shkrimeve që janë në të, del se autori i librit është në opozitë gati me të gjithë ata që kanë gabuar ose që nuk i kanë trajtuar realisht dhe mirë çështjet më të mprehta politike. Por edhe politika që nga zanafilla e vet gjithmonë ka qenë… kemi pasur dy forca politike që gjithmonë kanë qenë, njëra në opozitë, tjetra në pozitë. Dhe libri shpreh atë opozitën e autorit që është ndaj pozitës.

Çështja tjetër që duhet ta them para se të filloj leximin. Dua të theksoj se mendimi politik, megjithëse flitet për mendim të lirë, për shkrim të lirë, për fjalë të lirë, mendimi politik gjithmonë ka qenë peng i vetë politikës: i politikës empirike, apo i politikës së ditës siç thuhet, ose ka qenë peng i konfrontimeve politike të forcave opozitare.

Që nga antika, pas Aristotelit i cili nuk ka pasur autocenzurë e më vonë, gjithmonë veprat politike dhe shkrimet politike, ose janë censuruar ose autorët janë vetcensuruar.

Për të mos hyrë në çështje më të thella, vetëm të them se gjatë historisë ka pasur raste kur autori i librave, autorët e veprave të mendimit politik nuk janë vetcensuruar.

Kemi për shembull iluministët francezë të shekullit XVIII që kanë kritikuar sistemin aktual. Dihet se vepra e Didërosë, një nga veprat më të shquara të shek. XVIII *Nipi i Rameut* është djegur në sheshin Roterdam të Parisit. Mandej kemi veprat e Marksit dhe të Engelsit që nuk janë vetcensuruar. Kemi veprat e mendimit politik të disa sociologëve dhe filozofëve francezë në gjysmën e dytë të shekullit XX , bile edhe tash para disa muajve, një vepër e një filozofi francez Mishell Debre ka pësuar 120 mijë ekzemplarë. Rreth këtij libri në Francë zhvillohet një debat i madh politik, se ai në realitet shkruan se në Evropë po kthehet mesjeta. Se religjioni ka marrë përmasa të mëdha.

Edhe ne në Kosovë kemi pasur sfida të tilla. Kur për shembull, shumë autorë, shumë shkrimtarë i kanë thurur lavde titizmit, zoti Adem Demaçi del me veprën e tij *Gjarpinjtë e gjakut*. Unë e konsideroj edhe veprën e Xhemil Zeqirit të cilën e kam analizuar këtu, si një sfidë të problemeve politike, të gabimeve që bëhen e që janë bërë gjatë këtyre 15 viteve rreth çështjes.

Unë librin e kam vlerësuar, si e kam vlerësuar unë. Por në politikë nuk ka vlerësime reale. Politika është art. Edhe pse flitet "shkencë politike", po politika nuk është shkencë, politika është art. Siç thotë Veberi, sociologu i madh gjerman, i cili jep një definicionin lapidar në sociologji "Art i të mundshmes, shkencë e negatives". Kur theksoj "shkencë e negatives" theksoj se këtë libër unë e vlerësoj mirë, ndoshta edhe shumica nga ju këtu mund ta vlerësojnë si libër i mirë. Por dikush që është në opozitë, thotë ky është një pamflet politik.

Do me thënë, libri politik nuk vlerësohet si vlerësohen librat e tjerë shkencorë, por vlerësohet nga pozicioni që i takon individi, në cilin grup, në cilin pozicion është, ashtu edhe e vlerëson librin. Tash unë mund të marr pak kohë me leximin:

Një libër me vlera të mirëfillta politike. Xhemil Zeqiri, librin e të cilit po e promovojmë sot është një veprimtar nga Tetova jo aq i dalluar, por me një veprimtari shumë të madhe, të fuqishme.

I ndjekur nga shërbimi policor jugosllav në vitin 1981, detyrohet të emigrojë në Kopenhagë. Në vitin 1988 formon komitetin ***"Miqtë e Kosovës"***. Si anëtar i dalluar me veprimtari të dendur politike, në kuadër të ***Lëvizjes Popullore të Kosovës***, më 1990 zgjedhet kryetar i Forumit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive të Njeriut, dega Danimarkë.

Ky është libri i dytë i autorit. Libri fillon dhe mbaron me polemika, debate, letra dhe intervista rreth çështjes sonë të pazgjidhur, statusit të shqiptarëve në hapësirën ballkanike, përkatësisht për shqiptarët e ndarë e të përçarë në hapësirën ballkanike.

Autorin nuk e brengos vetëm çështja e rëndë e Kosovës apo diskriminimi i shqiptarëve në Maqedoni, prej nga e ka edhe vetë origjinën, por çdo problem dhe çdo situatë që krijohet në tërë hapësirën, siç e quan ai, ***hapësirën etnike shqiptare***, të aneksuar nga shovinistët fqinj.

Autori nuk ka as diplomë fakulteti, as tituj të tjerë shkencorë, nuk ka as poste politike, as ambicie për karrierë. Por ka një gatishmëri për të sakrifikuar çdo gjë për Shqipërinë, siç shprehet ai.

Objekt komentimi dhe analize është çështja shqiptare. Nga të gjitha debatet e paraqitura, dominon fryma etnike, pa luhatëse e pa kompromise, duke përfshirë këtu edhe personalitete në pozita më të larta politike. Problemet që trajtohen në këtë libër janë të ndryshme, por mënyra e qasjes është unike.

Libri i Xhemil Zeqirit dallohet nga shumë libra të tjerë të kësaj natyre në logjikën specifike autentike, me një mori problemesh që i trajton në të, me të cilat ballafaqohen shqiptarët. Atë e brengos problemi i statusit të luftëtarëve të Kosovës, statusi i padefinuar, diskriminimi i shqiptarëve në Maqedoni, lojërat politike të cilat nuk i kuptojnë shqiptarët, nënshtrimi i udhëheqësve shqiptarë para

komploteve diplomatike, qëndrimi joparimor dhe konformist i ca individëve të angazhuar në sferën politike. Në debatet dhe në letrat e tij, hasim në vërejtje të arsyeshme dhe të argumentuara në mbrojtje të kauzës sonë para diplomatëve të vendeve e misioneve të ndryshme të diplomacisë ndërkombëtare dhe politikës shqiptare.

Autori, me vendosmëri dhe duke u mbështetur në parimin e pakontestueshëm të mendimit të lirë, merr guximin t'i aktualizojë problemet më të rënda politike që fare pak i hasim në shtypin tonë. Mënyra e qasjes mbi problemin, guximi mbi trajtimin e tyre, analiza që u bën problemeve, është një dëshmi e konsekuencës së tij. ***Ai, për dallim nga shumë publicistë të tjerë, nuk u adaptohet konjukturave antishqiptare dhe nuk u thur lavde atyre, por u kundërvihet me një vendosmëri të madhe që i jep librit një ton dhe vlerë të veçantë.***

Është për t'u theksuar se që nga artikulli i parë i librit e deri te ai i fundit, autori mban një qëndrim të pathyeshëm, të padyshuar, përdor një fjalor, shpreh të njëjtat pikëpamje, argumenton me fakte të pakontestueshme dhe pasqyron një pozicionim të palëkundur politik, sikur të jetë i ngarkuar me hekur e beton. Ky pozicionim, bën që shkrimet e tij të dallohen nga shumë shkrime të tjera që i hasim nëpër gazeta e që ndryshojnë nga raste e raste dhe nga situata në situatë.

Xhemil Zeqiri në librin e vet problemet politike i trajton pa paragjykime, pa inate, pa iluzione, pa kompromise në dëm të shqiptarëve. Autori dëshmon me veprën e tij se ka dërguar një numër të madh letrash, madje edhe ka korresponduar me një numër të madh politikanësh e publicistësh të rangjeve dhe profileve të ndryshme ndërkombëtare. Nga këto debate, nuk është vështirë që lexuesi të bindet se Xhemil Zeqiri ka një sens të theksuar politik, i kupton mirë problemet, i vlerëson realisht e pa rezerva.

Xhemil Zeqiri në shumë letra kërkon pavarësinë e Kosovës edhe pse nuk shpreson në mënyrë naive se kjo pavarësi do të fitohet si me maqinë. Autori njëkohësisht shpreh edhe rezervat e shumë diplomatëve ndërkombëtarë të cilët nuk rezervohen për të bërë

dallim ndërmjet luftës çlirimtare të një populli të shtypur dhe luftës së atyre që duan ta ruajnë sistemin kolonial në Evropë. Autori dyshon se çështja jonë do të zgjidhet lehtë në një kohë kur aspiratat tona janë plotësisht të papajtueshme jo vetëm me politikën serbe ndaj Kosovës, por edhe me disa akte ndërkombëtare ku definohet pandryshueshmëria e kufijve.

Nga ky këndvështrim, Xhemil Zeqiri apelon që shqiptarët të mos mashtrohen të bien nën ndikimin e agjenturave antishqiptare, qoftë me kërcënime, me mesazhe, me lëvdata apo projekte. Autori i librit polemizon me të gjithë ata që synojnë t'i mashtrojnë shqiptarët, t'i frikësojnë apo edhe t'i detyrojnë që të pranojnë opsione tashmë të njohura në dëm të shqiptarëve.

Autori me vendosmëri u kundërvihet edhe zyrtarëve të Tiranës përkitazi me burgosjen e disa shqiptarëve me akuza qesharake se gjoja po nxisin urrejtje në Maqedoni. Në letrat polemizuese drejtuar qeveritarëve të Tiranës, i qorton ata se si kanë rënë nën ndikimin e huaj dhe apelon që të bëhen më të kujdesshëm. Autorin e librit e provokon edhe gjykimi i shqiptarëve në Gjykatën e OKB-së në Hagë. Ai kritikon këtë organizatë për jokonsekuencë në zbatim të kartës së vet në të drejtën e popujve për vetëvendosje. OKB-ja në vend që t'u ndihmojë popujve që luftojnë për çlirim kombëtar, ajo de fakto mbështet kolonializmin dhe i gjykon në Hagë luftëtarët që luftojnë për çlirim kombëtar.

Xhemil Zeqiri veçohet edhe nga një dimension shumë i rëndësishëm. Xhemil Zeqiri nuk i ngatërron vlerat kombëtare, në një kohë kur neve, nga shërbimet e ndryshme antishqiptare na servohen ide që vlerat t'i shndërrojnë në jovlera dhe jovlerat t'i bëjmë vlera. Autori u kundërvihet tendencave të tilla, polemizon me predikuesit e bartësve të tendencave të tilla me argumente të forta.

Në përgjithësi, libri ka vlera të padiskutueshme aktuale. Padyshim, këto vlera do të bëhen edhe më të fuqishme sa më shumë që zvarritet zgjidhja e çështjes sonë. Qasjen e vet, autori e mbështet në parimin e kërkimit të së pamundshmes për ta realizuar të

mundshmen, siç thuhet në teori, edhe pse kërkesat tona janë legjitime dhe plotësisht të mundshme.

Nga kjo optikë, Xhemil Zeqiri pandërprerë, në librin e vet aludon në bashkimin kombëtar, në dekolonizimin e tokave shqiptare dhe në vetëvendosje. Aktualisht, një kërkesë e tillë duhet, e cila mbështetet në politikën agresive të fqinjëve, në politikën globale si dhe në qëndrimin antishqiptar të disa qarqeve diplomatike.

Megjithatë, të godasësh të pamundshmen është esenca e një politike rezultative. Autori i kritikon të gjithë ata publicistë dhe politikanë që në mënyrë sipërfaqësore i trajtojnë çështjet më të ndjeshme politike. Polemizon me publicistë që në mënyrë euforike shërbehen me data, me afate të caktuara përkitazi me zgjidhjen e çështjes më esenciale. Autori polemizon me predikues të tillë që manipulojnë me masën. Çështja jonë nuk ka të bëjë as me data, as me afate, as me angazhime individuale e partikulare. ***Xhemil Zeqiri në librin e vet kërkon vetëdijesimin e popullit për pozitën reale që kemi dhe ngritjen e tij në një shkallë më të lartë politike***. Ky është thelbi i librit që po e promovojmë.

Ju falëmnderit!

UNË DO TA KISHA TITULLUAR LIBRIN, DËSHMI PËR KOHËN TONË

Diskutim

Prof. Dr. Sadri Fetiu

Zonja dhe zotërinj, kam kënaqësi t'ju përshëndes të gjithëve që jeni pjesë e përurimit të këtij libri. Në mënyrë të veçantë do ta përgëzoj autorin e librit që ka dhënë një vepër të vlefshme. Unë librin e kam lexuar pardje. Do t'i them disa përshtypje. Nuk kam mundur t'i sintetizoj përshtypjet me shkrim, do t'i them kështu, në mënyrë të lirë.

Së pari, do të them diçka edhe për librin, edhe për autorin. Libri, edhe pse e ka titullin *Polemika, intervista, debate, letra,* ky është një libër unik. Unë do ta kisha titulluar *Dëshmi, Dëshmi për kohën tonë.* Ky libër është një dokument, është një dëshmi që flet për shqiptarët, por jo vetëm për shqiptarët, por edhe për kohën tonë në tërësi, në këto 10 vitet e fundit. Por, këto dëshmi, kuptohet, jepen nëpërmjet këndit të një individi i cili i sheh rrjedhat edhe i vlerëson në mënyrën më të sinqertë, drejtpërdrejtë, pa asnjë politikë, pa asnjë konsideratë për atë se çka mendojnë të tjerët.

Kjo është veçoria karakteristike sipas meje, e këtij libri, sepse në këtë libër, ai dëshmon për kohën e vet, edhe nëpërmjet polemikave, edhe nëpërmjet intervistave, edhe nëpërmjet debateve, edhe nëpërmjet letrave.

Dëshmon për politikën, për pozitën në të cilën gjenden shqiptarët, edhe në Shqipëri, edhe në Kosovë, edhe në Maqedoni, në përgjithësi, në Ballkan. Po është një dëshmi edhe për sjelljen e ndërkombëtarëve ndaj shqiptarëve në këtë kohë. Pra, këndi i vështrimit e paraqet realisht edhe pozitën e ndërkombëtarëve ndaj shqiptarëve. *Brenda e këtij vështrimi shprehet edhe revolta*

individuale e njeriut i cili është angazhuar shpirtërisht që të punojë për çështjen kombëtare.

Libri i Xhemil Zeqirit pra dëshmon edhe për vetë autorin. Është një dëshmi në të vërtetë për sjelljet dhe qëndrimet e tij. Njerëz si Xhemili, në traditën shqiptare ka pasur gjatë gjithë kohës, sa veprojnë rrymat, njerëzit, partitë, grupet politike për zgjidhjen e çështjes kombëtare.

Xhemilin do ta krahasoja me qindra veprimtarë që kanë vepruar në shekullin XIX nëpër kolonitë shqiptare: në Sofje, në Bukuresht, në Kajro, në Selanik. Do ta krahasoja ndoshta me një ekzemplar që është dalluar në atë kohë siç është Nikolla Naço, d.m.th. një entuziast që ka vepruar në Rumani edhe i ka shty i ka nxit… Në bazë të këtij libri, ky është një Nikolla Naço që ka vepruar në Danimarkë, që është përpjekur t'i nxisë të gjithë ato forca politike në Evropë që janë interesuar për çështjen shqiptare dhe t'iu plasojë dokumentacione dhe dëshmi, qoftë nga Këshilli për të Drejtat e Njeriut, qoftë nga partitë politike, qoftë duke i ftuar dhe duke i angazhuar veprimtarët nga Kosova, nga viset tjera shqiptare, që të vijnë e të flasin dhe ta popullarizojnë çështjen shqiptare. Kështu kanë vepruar në shekullin e kaluar, kështu kanë vepruar edhe në këtë shekull.

Xhemili ka vepruar në Kopenhagë, vëllezërit Gërvalla dihet që kanë vepruar edhe më herët në Gjermani, mandej Enver Hadri me Reshat Sahitajn me grupin në Belgjikë, Shaqir Gashi, Ramadan Çeta, me qindra veprimtarë të tjerë që janë angazhuar dhe kanë vepruar në këtë mënyrë për ta popullarizuar çështjen shqiptare. Pra, ky është rrëfimi i Xhemil Zeqirit që është autor i kësaj vepre.

Unë do të jap edhe një vlerësim, po i jap vetes liri, për qëndrimin… më ka befasuar, jo vetëm qëndrimi i tij patriotik, por edhe qëndrimi shumë i drejtë për zgjidhjen e çështjes kombëtare. *Ai e sheh zgjidhjen e plotë në të drejtën për vetëvendosje të popullit shqiptar, d.m.th. të drejtën për bashkim kombëtar*. Nuk mund të integrohet askush në struktura të huaja, pa u integruar në strukturën

e vet. Pa integrimin brenda kombit, s'mund të bëhesh ti pjesë e Evropës, pa qenë pjesë e vetvetes. Kjo ide e përshkon fund e krye librin e Xhemilit, prandaj edhe shprehet revolta, prandaj bën polemika, prandaj i kundërshton partitë politike e ata që kanë koncepcione pak më të ngushta se ky brenda librit. Kjo është një karakteristikë.

Karakteristikë tjetër është qëndrimi shumë i drejtë historik i Xhemilit me dy-tri polemika që i bën me historianë. Qëndrimi shumë i drejtë për historinë, sidomos për historinë e Luftës së Dytë Botërore. Pa marrë parasysh... ne kemi pasur një invazion në këtë kohën e ndryshimeve që janë bërë, tranzicionit që ka ndodhur, kemi pasur njëfarë invazioni, përpjekje për t'i rehabilituar, për t'i nxjerrë në sipërfaqe disa tendenca antihistorike, ahistorike. Ne nuk do ta mohojmë rolin e figurave të ndryshme, por duhet të themi se ata kanë vepruar kundër interesave tona kombëtare, por nuk kanë pasur sukses, për atë edhe kanë dështuar historikisht. *Xhemili, si një veprimtar, ngjarjet historike i ka vërejtur dhe i ka parë historikisht shumë drejtë.*

Unë do të kisha folur edhe më gjatë, por po e përfundoj me kaq. Autorit i uroj sukses, edhe ju propozoj që librin ta lexoni edhe ju me kënaqësi se është një libër që lexohet lehtë, bile këtu gjen edhe një shprehje shumë të bukur letrare. Një shprehje që përmban një frazeologji të veçantë që nuk më ka rënë... kam lexuar mjaft frazeologji, por nuk më ka rënë në sy më parë. Për një rast kur flet për një veprimtari politike, për një veprimtar të Perëndimit, i cili në atë kohë ka qenë si antikomunist dhe shokët e kanë korrigjuar, e kanë kritikuar Xhelilin pse po flet, se ky është antikomunist. Ky thotë: "Nuk dua t'i drejtoj brirët e dashit". Pra kjo është një frazeologji "T'i drejtoj brirët e dashit". Dashi, do të thotë, e ka formën ashtu siç e ka dhe s'mund prej dashit të bëjmë diçka tjetër. Pra ka edhe kësi frazeologjish. Libri mund të lexohet thjeshtë edhe si vepër letrare, ka pjesë të bukura që mund të lexohen.

Ju falëmnderit që më dëgjuat.

Ndërhyrje

Pasi z.Sami Dermaku foli kundër Shqipërisë dhe udhëheqjes socialiste, e veçanërishtë kundër Enver Hoxhës, u bë nje debat, ku nga pjesëmarrësit u ngrit z.Ragip Merxhuani tha se: Milladin Popuviçi ka qenë bashkpunëtor i Enver Hoxhes, por jo sikundër ka qenë Koçi Xoxe agjenti i Titos dhe tradhëtar kundra shtetit shqiptar etj. Por unë, vijoi ai, dëshrioj që ketë temë të na e trajtoi para nesh, ai që është competent, dhe konkretisht Pr.Dr. Hakif Bajrami, pasi ai ashtë kompetent për Historinë.

ENVER HOXHA
MERITON NJË PËRMENDORE 500 METRA

Diskutim

Prof. Dr. Hakif Bajrami

Kisha me ju lut si vëllai juaj, si një punëtor shkencor që në kësi rastesh kur hapen këto polemika, ky libër nuk është i asaj natyre që do të vendosë për fatin se ku e kishte vendin Enver Hoxha. Ju lutem, unë nuk do të guxoja kurrë të hy në shkencën e matematikës pasi nuk jam kompetent.

Sikur disa politikanë sot ta lexonin korrespondencën Enver Hoxha – Kim Philby, do të pësonin infarkt menjëherë se janë në pozita katastrofale të paditurisë.

Ju lutem! Kur për kombin shqiptar... unë nuk jam enverist, unë Enver Hoxhën e vlerësoj se ka punuar në rrethana të kohës dhe i ka pasur katër palë gërshërë: përpara, prapa, djathtas, majtas, besa edhe lartë e poshtë.

Prandaj, edhe sikur të vinin ballistët, unë më shumë personalisht si patriot i dua ballistët sesa komunistët, por edhe sikur të vinin ballistët, po ju them si profesionalist, vështirë se në Luftën e Ftohtë do të bënin më tepër për Shqipërinë etnike.

Ju lutem! Kush po na ndalë sot që të votojmë për Ballin Kombëtar?! Kush po na pengon?! Kjo pyetje duhet të shtrohet i nderuari Demaçi para vetvetes. Kur them Demaçi mendoj në krejt shqiptarët. A janë 15 milionë a 25, unë nuk e di. Sa vota përfiton Balli Kombëtar sot? Përfiton 1% të votave. Asnjë,jo.

Prandaj mos të hyjmë ne, t'i shndërrojmë këto manifestime në probleme shumë… e them me modesti, nuk e them për t'u promovuar. Se unë kam dalë kam folur mjaft. Qëllimin e kam tjetër. Enver Hoxha, pavarësisht çka ofendojmë ne, a do ta ketë

vendin pozitiv a negativ, nuk do të varet edhe nga gjenerata jonë, ta dini këtë.

Njëri m'u drejtua aty për Xhafer Devën. Unë nuk kam shkruar për Xhafer Devën fort pozitivisht për të. Por Xhafer Deva, duhet ta pranoj, përkulem para emrit të tij. Ai është i pari shqiptar që ka vendosur kontakt me Xhon Kenedi. A po e shihni?!

Duhet t'i objektivizojmë çështjet.

Unë mendoj se ky libër ka shkaktuar kësi lloj polemikash dhe është libër me fuqi pozitive, me fuqi dobiprurëse që të vetëdijesohemi, të lexojmë, të lexojmë, të lexojmë, por në fund, unë të flas si historian, por jo të jem padron i historisë, jo. Ka të drejtë edhe ai tjetri, që ndoshta për 57:57 sek ai ta thotë mendimin e vet, sepse ai e ka pa me sytë e vet. Njëri nga aspekti psikologjik, tjetri nga aspekti social, tjetri nga aspekti ekonomik, tjetri nga aspekti i përgjithshëm, por dija kurrë nuk ka fund. Të mos marrin edhe t'i vëmë barriera kombit tonë, sepse është një fuqi vepruese që po integrohet, d.m.th. edhe e ka pasur më mirë, ky e ka pasur më mirë, kur të gjithë e kemi pasur keq, me përjashtim të disave që kanë pa më larg, e ata janë individë. Do të thotë, grupacioni, entiteti, nuk ka qene në atë rrugën që…

Unë kam pasur rast (ta përfundoj) ta lexoj korrespondencën Enver Hoxha – Kim Philby. Nuk është në Shqipëri ajo, nuk është në Beograd dhe as në Bruksel. Unë ndonjëherë i bëj pyetje vetes zoti Berisha! Kush më ka lejuar ta lexoj atë? Kush më ka lejuar?! Më ka lejuar besimi i disa gjeneralëve të NATO-s më 1998. Ju lutem, Enver Hoxha meriton një përmendore 500 metra aty afër. Po meriton edhe 500 nderime tjera. Këtë konstelacion të problemeve ta shohim.

Kanë pësuar njerëzit, ju që nuk e doni, mirëpo edhe kombi ka pasur një ndikim, një fitim, një dobi, një element sepse është mbështetur në një fuqi që ishte... nuk i kemi thënë Bashkimit Sovjetik "imperialiste", por ishte fuqi atomike. Ju lutem, deri në vitin 1962, Bashkimi Sovjetik ishte shumë më larg me bomba atomike sesa Amerika. Këto duhet t'i dimë ne. Dhe çdo agjenturë, në thonjëza,

unë i them asaj, sepse shumicën e tyre unë i kam takuar në Gjermani, në Zvicër, në Amerikë, në Austri, kanë qenë patriotë të vërtetë, por në politikë nuk varet çfarë kravate mban, çfarë flokësh ke, çfarë diturie ke, por sa të pranon koha. Këtu është problemi.

Ju lutem, merreni shembullin e Jugosllavisë. Ishte rreth 20 vjet përpara llagerit socialist. Ku është sot? Vendi më i përbuzur, më i prapambetur dhe më kriminal në Evropë. A po e shihni ku të çon fukarallëku (1:00:38) edhe shikimi i mbrapshtë, edhe i kompanisë së ushtrisë jugosllave, edhe i kompanisë së Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë, edhe i kompanisë së politikanëve, edhe i atyre që e përjetonin, edhe i atyre që nuk do t'i përjetojnë. Prandaj të bëhemi bashkë, të mendojmë dhe të rezonojmë siç duhet e të flasim, gazetari si gazetar, historiani si historian, ekonomisti si ekonomist. Mund të shtiremi boll sot, po veç e marrim në qafë popullin.

Pjesa e tretë

SHKRIME TË NDRYSHME

A DO TË BËHEN PËRMIRËSIME NË POLITIKËN SHQIPTARE APO DO TË VAZHDOJË E NJËJTA DEMAGOGJI POLITIKE?!

Situata e krijuar pas vdekjes së I. Rugovës është e tmerrshme, kaotike nga fakti sepse edhe në këtë rast institucionet fiktive të Kosovës -qeveria, parlamenti dhe partitë e përfshira në parlament, nuk kanë kompetenca në zbatimin e ligjeve që vetë i nxjerrin dhe të gjitha këto institucione janë në shërbimin më servil të UNMIK-ut.

Ceremonia mortore e I. Rugovës ishte eufori politike, fushatë e pastër politike nga ndërkombëtarët që të legjitimohen negociatat me Serbinë gjakatare, që t'i imponohet popullit të mjerë shqiptar ideja famëkeqe e nënshtrimit, se vetëm kjo politikë e pa perspektivë rugoviste do t´i shpie përpara proceset tona historike. Prandaj,shikuar nga ky objektiv i tyre, këto ditë kemi dëgjuar lloj-lloj xhevahiresh dhe fjalë superlative për kryetarin e ndjerë, por assesi dhe asnjëherë nuk u përmendën dobësitë e tij që i bëri për aq vite, me politikën e tij disfatiste.

Gjatë sundimit të tij I. Rugova nuk e pati vullnetin as kurajën, bile njëherë t´i vizitonte ish- të burgosurit politikë, dëshmorët e UÇK-së dhe familjet e tyre.

T´i vizitonte zonat apo rrethet e rrënuara nga lufta në Kosovë dhe të ishte transparent me popullin, por pushtetin e tij absolut e përmbylli vetëm para gazetarëve dhe kamerave televizive. Kokulur i përsëriste afërsisht 20 fjali çdo javë.

Kryetari narcis nuk pati guxim ta kundërshtonte asnjë raport të grupeve dhe të organizatave ndërkombëtare që projektonin dinakërisht kundër pavarësisë së Kosovës, në veçanti dhe shqiptarëve, në përgjithësi.

Madje, nëse kujtojmë rastin kur delegacioni i Rugovës u kthye nga vizita në SHBA, në aeroportin e Prishtinës gazetarëve u

deklaroi: "Ishim në Evropë dhe Amerikë, patëm takime të shumta, ndër të tjera edhe me Kofi Ananin. Ata i kuptojnë mirë kërkesat tona dhe kemi përkrahje të madhe …." Dhe si për ironi, nuk kaluan as dhjetë ditë, filluan demonstratat madhështore heroike të marsit të vitit 2004, ku në fakt u kompromettua komplet politika destruktive e subjekteve të institucioneve kukulla të UNMIKUT. Por, duke i pasur në dorë mjetet e informimit siç është RTK-ja e Agim Zatriqëve titistë, medium ky që vepron nën kontrollin më rigoroztë UNMIK-ut, filluan akuzat dhe shpifjet ndaj demonstruesve dhe zërit të fuqishëm të demonstratave.

Edhe një argument tjetër dëshiroj t´ua përkujtoj lexuesve: Në shkurt të vitit 1996 në Kopenhagë, I. Rugova u ftua nga një organizatë proserbe borgjeze dhe iu dhe një shpërblim prej 100.000 kr.daneze (që bëjnë afërsisht 14000 euro), por kur të kemi parasysh se delegacioni qëndroi disa ditë në Danimarkë, duke përfshirë shumë persona si dhe disa "aktivistë mërgimtarë dhe ca danezë", shpenzimet e tejkalonin atë shumë, kinse "dhuratë", por mashtrimet politike ishin të mëdha. P.sh. gjatë dorëzimit të "dekoratës", kryetari i Parlamentit, Erling Olsen i tha: "Këtë shpërblim e meriton zoti Rugova, sepse ai, problemin e Kosovës e sheh si zgjidhje të të drejtave njerëzore në Jugosllavinë e cunguar".

Por, si kurdoherë që ngjante dhe po ngjan me gazetarët puthadorë të pacifistit dhe të pacifizmit, edhe kësaj radhe, ne që ishim pjesëmarrës aty në mbrëmje, u habitëm kur na ra të dëgjojmë raportuesin Kelmendi që fliste direkt nga Kopenhaga në ditarin e RTSH-së ku e dezinformonte tërë opinionin për atë ceremoni "pelegrinazhi" duke thënë: "Kryetari Rugova u nderua kështu e ashtu...;...kryetari i parlamentit Erlin Olsen u shpreh se çështja e njohjes së Kosovës së pavarur është çështje kohe dhe muajsh… "(ky fotokopjim do jetë i mirë për atë "ngjarje" të asaj kohe. Gazetari i ditarit të Radio Stokholmit Milaim Zeka, në një moment të përshtatshëm, pa vonesë të bëjë publike, që do të jetë me shumë interes për publikun, që ta kuptojë të vërtetën lakuriqe).

Se deri ku ka shkuar kjo politikë pakrye, do ta shohim edhe më mirë në të ardhmen e afërt. Për popullin shqiptar, kryetari Rugova ka lënë "amanete" tepër të dëmshme dhe përçarje të mëdha, siç janë: gjatë rezistencës së armatosur zhvilloi zgjedhjet e "lira", kurse në Drenicën legjendare derdhej gjaku lum. Iku në Beograd dhe shkruante komunikata e bënte thirrje me Millosheviqin, Shainoviqin e viçër të tjerë serbë që sa më parë të ndërpriten bombardimet e NATO-s, sepse ashtu po e pësojnë civilët serbë. Po pse s´u kujtua "kryetari" paqësor për civilët shqiptarë që masakroheshin me të madhe nga xhelatët serbë?!

Pas luftës, bëri gjithashtu gabime të pafalshme gjatë punës së tij presidenciale: Kurrë nuk i vizitoi varret e dëshmorëve, të pishtarëve të parë të lirisë në Prekaz. Madje në zyrën e tij "sulltanore", nuk pranoi t´ia sjellin as fotografinë madhështore të legjendarit Adem Jashari. Dhe nga shërbëtor i Serbisë që ishte, së shpejti i "ndërroi" zotërinjtë. Pas lufte, si servil i mjerë kaloi në shërbim të UNMIK-ut dhe ky i fundit i ndihmuar dhe nga diplomacia ndërkombëtare, duke i dhënë shumë atribute të paqena personalitetit të tij, e ngriti sërish nga "varri politik" duke e bërë kryetar.

Ai bëri përçarje të mëdha me "flamurin" privat, himnin e simbolet e tjera.

Kurrë nuk deshi ta vizitonte Shqipërinë, derisa ata i ranë ndër këmbë dhe i dhanë titullin "Honoris Kauza" nga Universiteti i Tiranës.

Po ashtu, si "politikan i hollë" që ishte, kurrë nuk e mohoi Mbledhjen famëkeqe të Rambujesë, Rezolutën 1244, as Kornizën Kushtetuese e të tjera dokumente, që na kthyen e po na kthejnë çdo ditë ne shqiptarët në prapakthehu në historinë tonë të re, për ardhmërinë e breznive të reja që do vijnë!

Nga këto dokumente që e bënë dhe rrezikohemi edhe më tej ta bëjnë jetën tonë zezonë, në fakt "po pjellin" edhe bisedimet për statusin e Kosovës. Ato do të zhvillohen në bazë të këtyre tre dokumenteve antishqiptare.

Ndërsa manipulimet e titistëve me mjetet e informimit e kanë shpallur njeri të pagabueshëm. Pikërisht këtu qëndron frika se në vend që të përmirësohet politika shqiptare pas vdekjes së tij, Kosovës edhe më tejpo i servohet apo imponohet nga qarqe reaksionare titiste që të vazhdohet politika famëkeqe antikombëtare, destruktive e I. Rugovës!!!

Prandaj kërkohet vigjilencë, kërkohet kthjelltësi mendimesh! Shqiptarët, t´i heqin nga koka iluzionet se me këtë politikë do ta kenë të siguruar lirinë dhe ardhmërinë e ndritur gjithëkombëtare.

Xhemil ZEQIRI

Aktivist i Lëvizjes Vetëvendosje

Kopenhagë, 31.01.2006

PËRPJEKËJET PËR TA SHPIKUR NJË KOMB KOSOVAR-IDEOLOGJI THELLËSISHT ANTIKOMBËTARE

Mjerisht, që nga viti famëkeq 1990, për shqiptarët në Ballkan filluan mbrapshtitë politike, ekonomike, sociale etj. Ky vit, qe vit i krizave të mëdha që përjetoi populli dhe shteti shqiptar, Shqipëria socialiste. Bllokadat dhe represionet e shteteve imperialiste ishin prej kohësh të pamëshirshme ndaj shtetit shqiptar, pasi që shteti socialist kishte mbrojtur me një fanatizëm të pakompromis identitetin dhe sovranitetin kombëtar. Shqipëria u ballafaqua jo vetëm me sanksione ekonomike, por edhe me ndërhyrje të pamëshirshme nga fuqitë e mëdha dhe agjenturat antishqiptare, siç ishte CIA, UDB-ja etj.

Faktikisht, presionet ekonomike nuk iu hoqën kurrë shtetit shqiptar, bazuar në një artikull të një publicisti shqiptar Anton Kote, që i referohet një gjenerali të CIA-s (tani s´më kujtohet emri i atij gjenerali), i cili ishte ndër më të suksesshmit e kësaj agjenture më të fortë në botë. Ky ishte vendosur në Frankfurt të Gjermanisë me 300 oficerë që kishin pasur objektiv të bëjnë ndërhyrjen në ish-shtetet socialiste. Pra, i nderuari Anton Kote i përshkruan fort mirë ndërhyrjet e tyre, mirëpo unë këtu do të potencoj vetëm disa fjalë nga ky artikull. Ai e citon gjeneralin amerikan që në fakt kishte qenë një bir shqiptari. Midis tjerash ai thekson: "Në Shqipëri nuk kemi dalë ashtu siç kemi paramenduar. Ne kemi dërguar 380 grupe. Ne nuk kishim mundësi të kuptonim si kanë rrjedhur aksionet, pasi ata kishin një politikë diktatoriale dhe nuk tregonin se grupet tona janë kapur ose kanë kryer ndonjë aksion e kjo na bënte tepër nervoz, pra nuk lajmëronin nëpërmjet mjeteve të informimit, por hiqeshin sikurse nuk na ka ndodhur gjë".

Artikulli i plotë është botuar në gazetën "Zëri i Kosovës" që botohej në Zvicër. Pyetjes së Anton Kotes se cila agjenturë u ndihmonte më shumë dhe nga ishin rekrutuar diversantët?

Gjenerali përgjigjet: "Ndihmën më të madhe e kemi pasur nga UDB-ja jugosllave, ndërsa kemi pasur shumë veprimtarë nga Kosova që janë hedhur në aksione”.

Ndërsa kryeministri anglez Tonny Blair, deklaron: ”Vetëm në Shqipërinë e Enver Hoxhës, kanë dështuar ndërhyrjet anglo-amerikane".

Kjo flet mjaft për luftën heroike të popullit shqiptar për ta mbrojtur Shqipërinë socialiste nga agjenturat e huaja kriminale. Këto fakte që theksuam janë të vërteta dhe jo trillime. Gjithashtu janë shumë të hidhura. Pikërisht për këtë, liderët "demokratë" është dashur të reflektojnë realisht dhe të mendojnë kthjellët.

Tani shtrohet pyetja: Përse vepruan kështu, pa kurrfarë kriteri, as kushtëzimi politik dhe kombëtar, në raport me të huajt?! Por ata kësaj pyetjeje nuk i përgjigjen dot. Ata nuk e thonë kurrë të vërtetën sepse kanë hyrë verbërisht në batak të ndyrë antikombëtar. Fatkeqësisht turpet dhe krimet e tyre: ekonomike, politike, sociale etj. koha po ua nxjerr në shesh çdo ditë. Nga udhëheqja e tyre e çoroditur, populli shqiptar jo vetëm që u varfërua tmerrshëm, por edhe u përgjak dhimbshëm në vitin e hidhur 1997. Ende plagë të hapura qëndrojnë mbi trupin e Shqipërisë Etnike.

Politika plotësisht antikombëtare dhe disfatiste e I. Rugovës dhe e S. Berishës i kanë sjellë aq shumë dëme kombit shqiptar, saqë sikur ta drejtonin Shqipërinë Etnike edhe çetnikët më të egër të Beogradit, nuk do të mund ta dëmtonin aq shumë.

Prandaj, në Shqipërinë londineze, politikën fashiste të S. Berishës populli e rrëzoi në vitin 1997, me pushkë në dorë dhe me humbje të mëdha njerëzore e materiale. Pas atij revolucioni të madh që matrapazët politikë e marrin me hipokrizi dhe me tallje.

Ishte Partia Socialiste ajo që e qetësoi situatën dhe e riktheu zhvillimin normal të jetës shtetërore të shqiptarëve, të shkatërruar në themel nga S. Berisha me kompani dhe të tradhtuar nga Perëndimi.

Kjo fatkeqësi, nën maskën "demokratike", me politikën nihiliste të I. Rugovës e "gëlltiti" popullin shqiptar në Kosovë dhe në viset e tjera shqiptare të okupuara nga shovinistët sllavë.

Trojet shqiptare të udhëhequra nga titistët Rugova, Xhaferi, Halimi u shkelën egërsisht nga armiqtë sllavë pa kurrfarë rezistence, as pacifiste as radikale. Popullin shqiptar e mbështetën me shpatulla për muri me durim-turpin e proklamuar prej tyre. Prandaj populli, duke e parë se kjo po e shpie drejt humnerave të mëdha historike, u detyrua të rreshtohet pas djemve dhe vashave që i rrokën armët dhe luftuan për liri dhe dinjitet kombëtar – nën udhëheqjen e UÇK-së.

Pas këtij zgjimi kombëtar, komuniteti ndërkombëtar i erdhi në ndihmë UÇK-së dhe popullit shqiptar. Duke e bërë këtë akt human, sikur u hapën shpresat për perspektiva të ndritura për ne shqiptarët e Kosovës dhe të viseve të tjera.

Por, diplomacia e evropiane dhe botërore në planet e tyre afatgjate strategjike nuk kishte ndryshuar. Në kokat e tyre kishte mbetur si një myk i keq ideja antishqiptare edhe pas gjithë atyre premtimeve nga "demokratët modernë" se pas shkatërrimit të sistemit socialist të Enver Hoxhës, do të arrihet edhe ribashkimi kombëtar. Shqipëria do të ndihmohej me "çeqe të bardha" nga Amerika, ekonomia e saj do të lulëzonte etj., etj.

Këto ishin lojëra të rrezikshme, ishin premtime boshe që mund t´i hanin si bonbone vetëm "kalamajtë politikë" të tipit Berisha-Rugova dhe kompanitë e tyre servile.

Dhe tani, "shkencëtarë" të dalë nga brumi i tyre, të dhënë pas interesave personalë, po dalin me xhevahire "të reja" dhe me paçavure shkrimesh publicistike orvaten ta bindin popullin e shumëvuajtur shqiptar, se shqiptarëve të pjesës tjetër të Shqipërisë, pra shqiptarëve të Kosovës, u duhet komb dhe identitet i veçantë, pra kombi kosovar, sipas identitetit kosovar!

Këta kalemxhinj shkojnë më tej me atavizmat e tyre dhe duan që gjuhën shqipe ta ndajnë, pra të thellojnë ndarjen e saj. Këta

shkrimtarë "me famë", këta gazetarë bulevardesh, brenda e jashtë atdheut, shkruajnë dhe flasin vetëm në gegërishte, ndërsa e urrejnë dialektin toskë, sikur ky dialekt të mos ishte fare yni!

Ndarja që po tentohet të bëhet në aspektin gjuhësor dhe në aspektin e identitetit çon ujë vetëm në mullirin e armiqve tanë të përbetuar sllavë.

Nëse vlerësojmë nga aspekti gjuhësor, këtu del fakti se emri Kosovë është term i huaj. Një toponim që ka tërhequr që moti vëmendjen tonë është emër vendi i fshatit Trudë, i cili me sa duket, ka qenë bazë motivuese e kalkimit në gjuhët sllave të toponimit Kosovë. Të gjitha këto rrënjë latine dhe neolatine na shtyjnë të përfundojmë se toponimi Kosovë është në të vërtetë një kalk i toponimeve të shumta të krijuara me apelativa latinë dhe neolatinë.

Në traditën toponime shqiptare ekziston edhe emër vendi Zogaj, që sipas mendimit tim duhet të ketë dalë nga togfjalëshi Zog i Zi 'turdus merula' (khs. anglisht blackbird 'zog i zi, turdus merula'") (*A. Konushevci*).

Ndërsa në aspektin politik, dihet mirëfilli se në "pushtetin paralel" nga Markagjoni i Mirditës, qe shpallur si një pykë e zezë e ashtuquajtura Republika e Mirditës, e cila jo pak favore u krijoi trupave serbe gjatë tërheqjes së tyre. Bile këto ditë, politikani serb Vuk Drashkoviq e bëri një falënderim për mikun e tyre Esat Pashën, me fjalët: "Serbët i harrojnë shpejt armiqësitë, por jo miqësitë".

Siç po shihet qartazi, politika e favoreve politike dhe ushtarake ndaj Serbisë, i bashkon si dy pika uji bajraktarin Markagjoni dhe kryeparin Rugova. Prandaj, fare nuk është për t'u habitur nëse në një të ardhme të afërt del një kryeministër serb dhe e falënderon Rugovën për shërbimet e tij ndaj Serbisë, që ia bëri me vite e vite.

Unë dua të paraqes këtu pikëpamjen time se një Republikë e tillë e Kosovës, e ndarë nga trungu amë, me gjuhë, identitet etj., do të ishte fillimi i një përçarjeje të madhe brendakombëtare, që zor se do t´i shihej fundi.

Nëse shqiptarët bënë kompromise politike dje, duke pranuar një Republikë të pavarur të Kosovës, me gjuhë, me identitet dhe me flamurin shqiptar që valoi ndër shekuj në trojet tona, kjo nuk i jep aspak të drejt askujt të vërë dorë mbi këto elemente të shenjta që s´na ndajnë por na bashkojnë në aspektin kombëtar. Pra as I. Rugovës, as tellallëve të tij politikë.

Duke qenë se realitetet politike kanë ndryshuar në Ballkan dhe në Evropë, ne shqiptarët tani, kompromiseve të pas viteve '80, duhet t´u japim fund. Tani është koha për VETËVENDOSJEN e kombit shqiptar në Ballkan.

Bazuar në shumë fakte, vij në përfundim se përpjekjet e tyre janë fund e krye, një shërbim i mjerë për pacifistët dhe për fashistët e huaj, të të gjitha ngjyrave.

Pra, ata kanë si synim që popullit t´i hedhin hi syve. Këta faktikisht janë vënë në shërbim të politikës antishqiptare titiste, të zhvilluar para viteve '90.

Vlen të theksohet se tani s´ka ndërhyrje nga jashtë që imperialistët të fusin banda kriminale në trojet shqiptare, që do të na çonin në vëllavrasje midis nesh. Por tani zënkat e shqiptarëve nga pluralizmi politik i frymës përçarëse Berisha-Rugova po na sjellin përçarje kaq të mëdha brendakombëtare.

Sot bota demokratike jeton me pluralizëm, por jo me grindje aq të egra ndërpartiake, siç jetojmë ne shqiptarët. Serbia rrinte e qetë kur Shqipëria Etnike ishte nën udhëheqjen e Berishës dhe të Rugovës, derisa UÇK-ja i mori armët.

Derisa profashisti Berisha dhe "gandisti mbret" Rugova, rrinin të qetë në Tiranë dhe në Prishtinë, po aq i qetë ishte edhe S. Millosheviqi, i cili me qeverinë fashiste të vet vepronte lirshëm në Kosovë, bashkë me bandat paramilitare të Sheshelit dhe të Arkanit gjakatar.

Janë këta politikanë "largpamës" që i ndoqën, i dënuan me burg dhe i fyen heronjtë kombëtarë - Adem Jasharin, Zahir Pajazitin, Luan Haradinajn etj. Është regjimi i S. Berishës ai që i vrau me

tradhti ideologët e parë të UÇK-së, Remzi Hoxhën dhe Ali Ukën. Për më keq, as sot e kësaj dite kriminelët që i vranë këta pishtarë të lirisë, kurrë nuk u zbuluan, e as u dënuan.

Këta "intelektualë puthadorë", në shkrimet e tyre trumbetojnë se në Kosovë ka zgjedhje të lira! Këto zgjedhje deri tani bëhen me lista të mbyllura, që faktikisht është antidemokratike dhe nuk janë zgjedhje të drejta shqiptare, por të dirigjuara. Pra janë zgjedhje të UNMIKISTANIT.

Nuk besoj se këta "analistë", të lyer me vaj e uthull të huaj, nuk i kuptojnë intrigat e rrezikshme. E kemi parë këtë se edhe gjatë kohës së "pushtetit paralel" të I. Rugovës, nën drejtimin e regjimit të S. Millosheviqit, kishte "zgjedhje të lira", pra me lista të mbyllura.

Dihet nga të gjithë se edhe kur krisnin armët e lirisë në malet e Kosovës, I. Rugova mbante "zgjedhje të lira". Pastaj edhe kur digjej Fieri në flakë (1997), Sali Berisha me parlamentin e tij njëpartiak, vetëzgjidhej kryetar!

Po tani shtrohet pyetja: Çka fitoi populli nga këto zgjedhje? Për këtë, le të reflektojë çdo shqiptar vetë. Këta puthadorë mjeranë, këta "analistë e gjuhëtarë" me prejardhje të dyshimta, sot po e dezinformojnë popullin. Këta janë bërë zëdhënës të së keqes shqiptare, duke e përkrahur politikën pacifiste, të nxitur nga Beogradi, indirekt përmes Grupit të Kontaktit, që sot mundohet t´ua imponojë sërish dominimin e politikës serbomadhe mbi shqiptarët, atë politikë gjenocidale që na kushtoi një lum gjaku ndër shekuj.

Tani Serbia trumbeton parullën e saj dinake: "Më shumë autonomi, e më pak pavarësi". Regjimi serb, natyrisht pajtohet me institucionet e Kosovës, të cilat dinakërisht e kanë pranuar një status të tillë qe shtatë vjet. Shikuar sipas parametrave të sotëm politikë, zor se do të ketë ndryshime.

Beogradi pajtohet me politikanët "demokratë" të Prishtinës. Kërkon dialog çdo ditë, sepse janë këta që e kanë pranuar Marrëveshjen e Rambujesë, e cila sipas rezolutës famëkeqe 1244,

haptas ia njeh Serbisë sovranitetin mbi Kosovën. Bile, si për ironi të fatit, asnjëherë deri më sot, nuk kemi dëgjuar të mohohet nga politikanët pacifistë.

Pra shkurt, Kosova dhe trojet shqiptare janë duke u udhëhequr nga politikanët e marrëveshjeve antishqiptare, që nga Parisi dhe Ohri, deri në Konçul.

Dhe nëse hyjmë të analizojmë në aspektin kombëtar, do të shohim se që nga ajo Konferencë famëkeqe e Rambujesë, çështja shqiptare ka marrë tatëpjetën.

Politika shqiptare është vënë në shërbim të qarqeve ndërkombëtare, ose shkurt e shqip, në shërbim të borgjezisë reaksionare, e cila ndër shekuj ka qenë dhe ka mbetur deri më sot, thellësisht antishqiptare.

Tani politikanët shqiptarë s'janë në gjendje t'i mbrojnë për asnjë moment interesat kombëtarë. Duke vepruar kështu, janë bërë "kukulla" në duar të huaja.

Pa çka se politikanët "modernë" i fitojnë zgjedhjet me ndihmën e "miqve", kur nënat shqiptare sot, janë veshur në të zeza, nga politika e tyre konfliktuoze dhe antihistorike. Këta janë të pangopur për pasuri e pushtet. Këta se kanë fare hallin për shtet.

Këta nuk duan që kombi shqiptar të dalë me VETËVENDOSJE, sepse kështu ngjarjet do të merrnin kahun e duhur, kombi ynë do të shkonte drejt fitoreve të reja, drejt ribashkimit kombëtar dhe përparimit.

Kopenhagë, më 23 korrik 2005

HISTORIA SI MËSUESE LIRIE PËR KOSOVEN

Information, 21 korrik 2005

Edhe pak kohë, çështja e statusit të Kosovës do të diskutohet në Këshillin e Sigurimit të OKB, pasi që për momentin Danimarka është anëtare e Këshillit të Sigurimit. Unë si shqiptar dhe me banim në këtë vend, dua ta drejtoj vëmendjen e qeverisë sonë në rritjen e pakënaqësisë dhe frustrimit te popullata shqiptare, për shkak të moszgjidhjes së statusit dhe të ardhmërisë së Kosovës.

OKB-ja me rezolutën 1244 ka përcaktuar kushte, kritere d.m.th. standarde për statusin, që duhet t'i plotësojnë shqiptarët e Kosovës, në veçanti disa të drejta ndaj pakicës serbe atje.

Ky plan është kryekëput absurd, pasi që një zgjidhje e drejtë dhe e qëndrueshme për Kosovën do të shtyhet më tutje, deri në pafundësi.

Është UNMIK-u dhe përfaqësuesit e OKB-së dhe jo popullata shqiptare, ajo e cila e ka fuqinë vendimmarrëse për zhvillimet ekonomike dhe politike në Kosovë në mbarë rajonin.

Atëherë, si mundet që këto kushte t'i vendosen popullatës shqiptare, kur dihet mirëfilli se edhe atyre sot u janë marrë të drejtat më elementare në Kosovë?

Një kryesi komunale sot, pa miratimin e UNMIK-ut, nuk ka të drejtë të hapë madje një terminal autobusësh..

Të mësojm nga historia

Natyrisht, nuk është vetëm Këshilli i Sigurimit i OKB-së, ajo e cila ka të drejtë të vendosë kushte lidhur me zhvillimin e rajonit, duke u bazuar në disa parakushte.

Popullata shqiptare e Kosovës kërkon gjithashtu që vendimet e OKB-së të bazohen në të drejtën e shqiptarëve për vetëvendosje. Kjo çështje është thelbi i problemit. Shqiptarët në ish Jugosllavi

ishin grupi i tretë për nga madhësia, por prapë se prapë iu mohua kjo e drejtë e vetëvendosjes, që popujve u sigurohej me kushtetutën e Jugosllavisë.

Kur Jugosllavia u shkatërrua, popullata shqiptare u la në mëshirën e fatit dhe nën shtypjen brutale të Serbisë. Përkundër alarmeve te shumta për një gjenocid të mundshëm në Kosovë, ajo megjithatë u la nën çizmen e Millosheviqit, i cili realizoi edhe një turn të gjenocidit brutal, duke përfshirë edhe pastrimet etnike.

E gjithë kjo që them është histori dhe nuk mund të zhbëhet, por detyra jonë është të mësojmë nga historia në mënyrë që mos të përsëriten gabimet.

Edhe më herët janë bërë padrejtësi historike ndaj popullit shqiptar. Ata janë penguar që vetë të vendosin për fatin e tyre, ngase fuqitë e mëdha e kanë ndarë një pjesë shumë të madhe të tokave shqiptare, në të cilat shqiptarët kanë jetuar me mijëra vite, në mes fqinjëve të tyre.

Kërkesat shqiptare

Është me rëndësi të theksohet fakti se kur shteti i ri shqiptar u krijua në vitet 1912-13, nën vete kishte një pakicë të vogël të shqiptarëve, në krahasim me pjesën më të madhe të shqiptarëve dhe të territoreve që mbetën jashtë kufijve të saj.

Udhëheqja serbe tani flet për një autonomi që duhet t'i jepet Kosovës dhe me pak pavarësi. E gjithë kjo, në themelet e saj është një lojë taktike për t'i ikur asaj kryesores që shqiptarët vetë të vendosin për të ardhmen e tyre.

Kroacia, Sllovenia, Maqedonia dhe Bosnja e Hercegovina u shkëputën nga Jugosllavia me zgjedhje të lira. Kufiri tokësor mes Gjermanisë dhe Danimarkës në Jyllandin jugor është përcaktuar me zgjedhje të lira.

Ndërkaq, referendumi i shqiptarëve të Kosovës u injorua. Pse vazhdimisht neve shqiptareve na mohohet kjo e drejtë, në krahasim me popujt e tjerë të Ballkanit?

Shqiptarët duan të jetojnë në paqe me të gjithë qytetaret në Kosovë. Ne nuk duam që t'i shtypim apo t'i dëbojmë serbët nga Kosova, por duam të ndërtojmë një Kosovë të lirë dhe demokratike, pa asnjë shtypje etnike, gjë që asnjëherë s'ka ndodhur me herët nga ana jonë.

Shqiptarët kërkojnë:

- Të drejtën e vetëvendosjes,

- Shqiptarët që u rrëmbyen nga njësitë ushtarake, policore dhe paramilitare serbe, para se t'i tërhiqnin trupat e veta ushtarake, të lirohen menjëherë,

- Kufomat apo mbetjet mortore të shqiptarëve të vrarë të sillen në Kosovë menjëherë, në mënyrë që ato të rivarrosen nga familjarët e tyre, sipas traditave shqiptare.

- Qeveria e Beogradit të detyrohet t'i kthejë të gjitha paratë që u vodhën nga Kosova, si p.sh. Fondi pensional si dhe vlerat e tjera që do të vlerësohen nga një komision i pavarur apo diçka e ngjashme, dhe

- Serbia duhet t'ia paguajë Kosovës dëmshpërblimin e luftës për dëmet që u janë shkaktuar shqiptarëve atje.

JA PSE DUHET TË KEMI NDRYSHIME RRËNJËSORE NË KOSOVË

Veshët tanë po shurdhohen nga zhurmat të cilat jo rrallë, po na shkaktojnë dhimbje nga politikanët servilë të Kosovës, të cilëve iu çirren zërat duke deklaruar: "Kosovën e çliruam me miqtë tanë ndërkombëtarë"!!!

Po nëse bëjmë një anketë me ushtarët e huaj që kanë marrë pjesë në bombardimet e NATO-s në vitin 1999 në Kosovë, me siguri as 15% e ushtarëve nuk dinë, nëse Kosova ka shqiptarë dhe pse kanë luftuar.

Mediet e mëdha me propagandë shumë të fuqishme kurdoherë kanë arritur dhe po arrijnë të shpëlajnë trurin e njeriut.

Dihet, shumë herë gjatë historisë, sikur tani, ua kanë shpërlarë trurin disa shqiptarëve. Kujtojmë kohën e errët të Titos, kur trojet shqiptare ranë nën robërinë sllavo-okupatore; edhe pas gjithë asaj rezistence me armë në dorë, titistët jugosllavë, përkrahë sahanlëpirësve të tyre shqipfolës, arritën që me propagandë dinake, të mashtrojnë një numër të madh të shqiptarëve, arritën madje gjer atje sa Tito gjakatarin ta quajnë “pejgamber” të paqes?!!! E të mos flasim për servilizma të tjerë, për interesa personalë, të kësaj natyre monstruoze...

UÇK-ja famëmadhe nuk luftoi që Kosova të hyjë nën protektorat ndërkombëtar. Sikur shqiptarët vërtet do ta dëshironin vetëm këtë “fitore”, nuk do të kishte nevojë për luftë çlirimtare.

Kjo buron nga koha e politikë-bërjes së zvarranikëve, kur titistët me Ibrahim Rugovën “në krye”, në konferenca shtypi dhe në çdo takim me ndërkombëtarët deklaronin: “Kosova, duhet të administrohet nga ndërkombëtarët"?!!!

Prej kohës kur u detyrua të tërhiqet nga Zyra e zëdhënësit politik të UÇK-së, simboli i rezistencës shqiptare, Adem Demaçi dhe në Shqipërinë londineze nga politika aktive detyrohet të

tërhiqet Fatos Nano, ndërkombëtarët vendosën dy kalamajtë politikë, me “vizione largpamëse”, Pandeli Majkon dhe Hashim Thaçin, çështja shqiptare, mori tatëpjetën e madhe, prandaj jemi këtu ku jemi!

Kosova, në sytë e mi, është KOLONI e të gjithëve që "harxhuan"municion ushtarak, përfshi këtu edhe Serbinë, kur edhe ajo me negociata me BE-në, po kërkon të marrë hisen më të pasur të Kosovës.

Të gjithë jemi dëshmitarë të fakteve që si pasojë e lëshimeve (kompromiseve) të kësaj kaste politike shqipfolëse, duke u paraqitur me “arsyetime” të pafundme, këtë hise, ajo përditë e më tepër është duke e marrë dhe legjitimuar.

Zhurma e madhe e retorikës që po bëhet nga politikanët aktualë se, Marrëveshjen midis Thaçit e Daçiqit e përkrahin miqtë tanë, nuk ka sesi të kuptohet ndryshe, përpos si mashtrim , për interesat e tyre, pra nga ana e miqve të rremë, sepse, nëse janë miq të vërtetë, do të duhej t´i thoshin, “Gjelit të detit”, kryeministrit të Kosovës, kurrsesi të mos i pranonte të tillat qullnaja - gjellë helmuese, politike që po përgatiten në Beograd dhe në Moskë, për t´u zier në Bruksel që t´i hajë Prishtina, vetëm që të plotësohen kërkesat dhe apetitet shoviniste serbomadhe.

Po, këta miq ndërkombëtarë pse janë kundër të drejtës për VETËVENDOSJE?!!!

Lind pyetja tjetër: Pse të quhen palaço djemtë dhe cucat më të mira të kombit, të VV dhe njëkohësisht të lavdërohen të korruptuarit , mafiozët që, vetë djajtë do të çuditeshin me prapësitë e tyre, këta që janë kthyer në shërbim të birit e të djallit?!...

Shqiptarët, sot kanë nevojë për miq të sinqertë, por jo për të tillë si ambasadori amerikanë dhe ai francez, të cilët e përkrahin pa rezerva Hashim Thaçin.

Po e përkrahin vetëm për faktin ngase e dinë se është duke ndjekur një politikë plotësisht antishqiptare dhe tejet të dëmshme, kundër-historike.

Mbesim me shpresë që me rënien e kësaj qeverie reaksionare, anti-shqiptare në Shqipërinë londineze, do fillojnë gjerat për së mbari...

Mbesim me shpresë që edhe në zgjedhjet e ardhme të kësaj vjeshte, në Kosovë të bie kjo qeveri e prapakthimeve të mëdha historike, kombi të marrë ecjen përpara me hapa të sigurt drejt fitoreve të reja.

Publikuar më 22 gusht 2013

PSE PO NDODH KËSHTU?!

Më kujtohet se dikur, udbashët e Tito-Rankoviqit thoshin: "Politika është kurvë". Këtë nuk e besoja, as dua ta besoj.

Kujtoj, politika është shkencë që merret me zgjidhjen e problemeve njerëzore, mirëpo ka mendimtarë që politikën e konsiderojnë me të drejtë edhe si art.

Mendoj gjithashtu se të gjithë ata që e imponojnë me dhunë e mashtrime politikën e tyre, janë me moral të dyfishtë, janë mashtrues, thurin intriga prapa perdeve kundër popujve të shtypur.

Unë, gjatë veprimtarisë sime ilegale në atdhe dhe gjysmë ilegale nëpër Evropë i kam njohur Ibrahim Kelmendin, Muhamet Kelmendin, Bardhyl Mamutin, Hydajet Hysenin, Fazli Veliun, Xhevat Bislimin, Sheradin Berishën e shumë të tjerë që kanë vepruar në kuadër të LPK-së, edhe si kryetar i shoqatave atdhetare shqiptare nëpër Evropë.

Por më habit fakti sesi prej gjithë kësaj plejade veprimtarësh të devotshëm të çështjes shqiptare, sot askush prej tyre nuk ka ndonjë pozitë në qeveri. Prej këtyre që i ceka më lart, kam lexuar shkrime, artikuj, komente, intervista, libra etj. etj. Madje, me këta jam takuar në protesta e demonstrata.

Kohëve të fundit, jam shumë i shqetësuar. Si ka mundësi të vijnë në pushtet, pra në hierarkinë më të lartë shtetërore të Kosovës, sikur pikën prej qiellit, Hashim Thaçi, Agim Çeku, Behexhet Pacolli, Atifete Jahjaga e të tjerë, të cilët kurrë nuk i kam takuar në veprimtarinë atdhetare për më tepër se 20 vjet. Madje, jo vetëm në veprimtari, por as nuk kam lexuar ndonjë shkrim, intervistë apo diçka të ngjashme. Prandaj shtroj pyetjen: Si u bë e mundur këta dhe kjo Jahjaga, të arrijnë të kapin majat e pushtetit në Kosovë?!

Që prej kur u shpall pavarësia e Kosovës, diçka po më mundon. Këta njerëz të ardhur si "politikanë parashutistë" aspak nuk janë seriozë dhe nuk kanë merita, mirëpo "veprimtaria e tyre atdhetare" po përkrahet e po lavdërohet nga të huajt, sepse janë

kthyer në marionetë të tyre. Këtu po e ceku një shembull konkret. Me numrin e telefonit të Ibrahim Kelmendit, dikur pata kontaktuar Hashim Thaçin, ish-Kryeministër i Përkohshëm i Kosovës. Unë pandërprerë kërkoja nga kryeministri danez Paul N. Rasmussen, që ai ta ftonte në takim zyrtar kryeministrin e Kosovës.

Takimi u bë, por si për ironi të fatit, më vonë lëvdatat apo si të themi, pikët politike i shkuan Ibrahim Xhemajlit. I shkuan atij që as e kishte idenë se do të vinte një delegacion i Kosovës në kryeministrinë daneze. Unë, si veprimtar politik i LPK-së, jam në gjendje t'i argumentoj disa nga aktivitet e mia, të cilat fatkeqësisht, Këshilli i LPK-së m'i ka penguar gjithmonë. Megjithatë, ia kam dalë të njoftoj kënaqshëm e besa edhe bujshëm për gjendjen tonë, opinionin danez. Për këto që po i shkruaj në këtë përsiatje evokuese, jam përpjekur dhe pjesërisht i kam paraqitur në 3 librat e mia: "Kosova jonë", "Në mbrojtje diplomatike të çështjes shqiptare" dhe në librin "Intervista, debate dhe letra".

Librat janë pritur mirë nga lexuesit, prandaj 2 librat e fundit janë përuruar në Prishtinë nga simboli i rezistencës sonë, Adem Demaçi dhe e treta në Universitetin e Tetovës, nga grupi i Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare. Shumë i habitshëm dhe cinik është fakti se nga Hashim Thaçi dhe nga fondi "Vendlindja Thërret", këtu në Danimarkë, shumë njerëz kanë marrë letra falënderuese, ndërsa ata që kanë kontribuar shumë vite dhe pa kursyer as shëndetin e tyre, që janë përpjekur deri në pikën e fundit me djersën e tyre, janë lënë padrejtësisht në harresë.

Më 13 qershor 2013

MARSI I KRENARISË KOMBËTARE SHQIPTARE!

Muaji mars, gjatë këtyre dy dekadave të fundit, shkëlqen si muaj i krenarisë dhe i rezistencës sonë kombëtare: Më 11 mars të vitit 1981, filluan demonstratat studentore në Prishtinë. Kjo qe fillimi i rrënimit të themeleve të një shteti armik, siç ishte ish-Jugosllavia e Titos dhe ajo pas-titiste.

Në mars të vitit 1998, krisi pushka e komandantit legjendar - Adem Jasharit. Pastaj, kjo pushkë jehoi në të gjitha territoret shqiptare dhe ia bëri me dije botës se durimi i turpshëm përballë armiqve sllavo-pushtues ka marrë fund; se shqiptarët më nuk do ta presin lirinë deri në amshim. Ata nuk do të shpresojnë më se lirinë do t´ua sjellin të tjerët në pjatë - siç thoshte, i madhi, Adem Demaçi. Pra, pushka e komandantit legjendar i bashkoi shqiptarët në Ballkan dhe në diasporë me një betim të madh për ribashkim kombëtar, e bëri sensibilizimin e çështjes së pazgjidhur kombëtare, e luftës në Kosovë dhe në trojet tjera etnike shqiptare. Ky betim i luftëtarëve të lirisë do të ndalohej në Rambuje dhe prej aty do të fillonte shkelja famëkeqe e atij betimi të madh të trimave dhe të ideal-realistëve të lirisë.

Gjithashtu, marsi i qëndresës dhe i besës shqiptare u përsërit me guxim edhe në Kosovën Lindore. Atje ushtarët trima e hapën frontin në luftë kundër Serbisë pushtuese dhe në këtë mënyrë do të sensibilizohet çështja shqiptare. U arrit ai objektiv përballë opinionit botëror, që shumë parti nuk e kishin bërë as me një përqindje të përafërt, sado të vogël për çështjen shqiptare në ato anë.

Gjithashtu, më 14 mars të vitit 2001 krisi pushka çlirimtare në Kalanë e malit Sharr mbi qytetin shqiptar, Tetovë. Aty, disa ditë pati rezistencë të madhe nga një grup ushtarësh trima, shokë të idealit të Adem Jasharit, të cilët i thanë JO robërisë, u thanë mjaft më mashtrimeve dhe shtypjes ndaj shqiptarëve në këto treva të

banuara me shqiptarë, përjetësisht të lidhur si gjaku me zemrën në trojet e veta. Ashtu pra, u bë sensibilizimi i çështjes shqiptare të pazgjidhur, të cilën e kishin koklavitur me synime të caktuara titistët dhe shërbëtorët e mjerë të sllavëve pushtues, që herë në emër të partisë e herë në mbi ndonjë emër tjetër, i mashtronim shqiptarët pa mëshirë.

Pas tri luftërave të fituara në beteja, por të humbura në diplomaci (në tavolina, me dialogë) me armiqtë, tepër e natyrshme është kur lind pyetja: Përse luftuan shqiptarët?!

Përkujtojmë këtu me respekt faktin se kësaj pyetjeje, më së miri dhe me një mal faktesh të pathyeshme i ka dhënë përgjigje shumë të saktë pedagogu, veterani dhe intelektuali i madh i kombit shqiptar, tetovari Prof. Beqir Berisha, në letrën e hapur drejtuar diplomacisë ndërkombëtare, me titull: "Përse luftuan shqiptarët"?!

Në këtë letër të botuar përafërsisht me 100 faqe, autori në mënyrë shkencore argumenton para opinionit të brendshëm dhe atij të jashtëm, përse luftuan shqiptarët. Por ne do ta argumentonim në veçanti këtë: Tri lufta që u zhvilluan në territoret shqiptare, nuk u bënë që sot dikush të rrahë gjoks e të mashtrojë popullin me një retorikë shumë primitive se ja, ne shqiptarët ia arritëm qëllimit!

Qëllimi ynë nuk ka qenë të integrohemi në Evropë para se të integrohemi brenda trojeve tona etnike shqiptare, në një shtet. Dhe pikërisht për këtë u bë betimi i madh. Pra, as komandant Shpendi, as komandant Roki, apo komandant Tahir Sinani e të tjerë, nuk u përleshën me armiqtë dhe nuk e dhanë jetën që Maqedonia të integrohet në BE dhe në NATO, ashtu siç po mashtron tani Ali Ahmeti me atë retorikë cinike dhe të mjerë, kur deklaron: "UÇK-ja e arriti qëllimin dhe se Maqedonia përfundimisht do të bëhet anëtare e BE-së dhe e NATO-s"!!!

Ndërsa tani, dihet mirëfilli se shqiptarët, edhe pas tri luftërave, po trajtohen si të huaj në tokën e vet. Bile këta "miqtë" tanë, tani po ua ndalojnë madje dhe shqiptarëve të Kosovës që në Projektkushtetutën e tyre, të ashtuquajtur demokratike, të quhen shqiptarë!!!

Këtyre ekspertëve "modernistë" duhet t´u thuhet: Mjaft! Përndryshe, ndërgjegjja shqiptare na e thotë se një ***ditë marsi*** të lavdishme do të çohen heronjtë nga varret dhe do kërkojnë llogari nga ne të gjallët, përse po lejojmë kaq lehtë të tradhtohen idealet kombëtare, nga këta renegatë bukëshkalë.

Do të shtoja vetëm dhe faktin se: pavarësisht, që Serbia hiqet se është e revoltuar nga "pavarësia" e Kosovës, ajo nëndheshëm e di fort mirë se: serbët kolonë në Kosovë kanë fituar si kurrë më parë të drejta me këtë lloj "pavarësie ahtisariane", prandaj zhurmat e tyre, janë sa për t´i bërë "kërcënime" perëndimit me dorën e zezë shoviniste ruse, kinse për "shtypjen" e serbëve në Kosovë, që po u ngjanë atyre, kinse prej shqiptarëve.

Danimarkë, më 26.02.2008

SI ARRITËM TA PRANOJMË ADEM DEMAÇIN ANËTAR NDERI NË PEN-in DANEZ DHE NË ATË SKANDINAV

Milazim Krasniqi "politikani largpamës", ishte dhe mbeti si personazhi "Tregtar flamujsh", "heroi" i feudal demon-kracisëtë 100 flamujve, te tregimi i famshëm.Tregtari në bodrumin e tij të shtëpisë i kishte ruajtur 100 flamuj të huaj, po dihet, të mykur, për të vetmin qëllim qëçdo pushtuesi që do të vinte në Shqipëri, ai do t´idilte përpara si mercenar, me flamurin e huaj, duke iu përulur gjer në servilizmin më të poshtër të mundshëm. I tillë njihet dhe ky "Ximi" i LKJ-së, apo më vonë i partisë simotër të saj,të regjistruar në Beograd, LDK-së. Po, po,njihet fort mirë nga populli si puthador i dëshmuar "kombëtar" dhe fetar.

Aty kahviti 1985 (nëse nuk gaboj) LPK-ja nëpër Europë bënte tubime protestuese, me rastin e 25-vjetorit të burgosjes sësimbolit kombëtar Adem Demaçit.Atëbotë, pata marrë një aksion: Kërkoja nga shoqatat dhe forumet e intelektualëve danezë të ngrenë zërin për heroin tonë, Adem Demaçin.

Lidhja e Shkrimtarëve Danezë më njoftuan që ishin të interesuar, por nuk kemiinformacione- më thanë. Prandaj, mëkërkuan të kontaktoja me PEN-in. Ai vendosi të bëjë ca lëvizje përkrahjeje me shkrimtarët internacionalistë.

Në takim me mikun tim Johanes Riss, sekretar i PEN-it, gjatëbisedës i them:"Po,a nuk është turp që fëmijëtdanezë në moshën 10 vjeç dinë për Nelson Mandelën, që po vuan burgjeve në Afrikën e largët, ndërsa asgjë nuk dinë për Adem Demaçin në Kosovën e afërt, bile jo vetëm fëmijët 11 vjeç, por as intelektualet danezë"!

Johanes Rissi më dëgjoi me vëmendje dhe thirri një sekretare me ç´rast i tha, ma sill dosjen e Jugosllavisë. Po aty m´u drejtua mua dhe më tha: "Ne, tri herë kemi kërkuar njoftime – dosjeje për

Adem Demaçin nga Lidhja Shkrimtarëve të Kosovës dhe ja çfarë përgjigje kemi”?!

Aty shkruante: “Adem Demaçi është shkrimtar, është i martuardhe ka 2 fëmijë,është i burgosur nëburgun e Stara Gradishkës”.Njoftimi përfundonte me kaq, përafërsisht kështu?! Dhe nëfund të njoftimit (përgjigjes mjerane), ishte një nënshkrim pështjellues që askush nuk dinte se kush e kishte nënshkruar. A ishte Rugova si kryetar i Shoqatës të Shkrimtarëve të Kosovës,apo ishte ky farë “shkrimtar pusi”, Milazimi, nuk e dija, por, një fakt e dija që, të dykëta shkretanë, ishin puthadorë të sistemit titist jugosllav dhe ishin anëtarë të LKJ-së.

Me atë rast, Rissit i thashë: “Këta të dy palo-shkrimtarë,po t´i shtrydhësh,jam i sigurt që prej tyre dalin nja 5 serbo-çetnikë”. Rissi qeshi dhe më tha: “A ke mundësi tëmë sigurish biografinë e Adem Demaçit, ndërsa ne danezët e udhëheqim Kongresin e PEN-it, të Internacionales në Holandë. Pastaj unë po e marr përsipër që Adem Demaçin dhe çështjen e tij ta trajtojmë në Kongres”.

Po, i thashë,e kemi në gjuhën gjermane .

Mirë, ma sill para ditës së premtes, do ta përkthej vetë në gjuhën angleze.

Menjëherë u konsultova me Ibrahim Kelmendin, i cili në atë kohë ishte në Bohum të Gjermanisë dhe ia shpjegova nismën tonë. Ibrahimi më përgëzoi dhe më tha:“Po, biografinë ta dërgoj menjëherë”. Ibrahimi e mbajti fjalën. Unë, të premten ia dërgova Johanes Rissit, ndërsatë dielën më erdhi lajmi me faks se Adem Demaçi është pranuar ***anëtar nder***i në PEN-in danez dhe në atë skandinav.

Po kështu vepruamme disa delegacione të tjera, me ç´rast filloi fushata jonë për të sensibilizuar çështjen kombëtare nëpërmjet simbolit të rezistencës sonë kombëtare, Adem Demaçit.

Me vonë e formova dhe Komitetin ”Miqtë e Kosovës” që përfaqësohej kryesisht, ngaintelektualë dhe politologë danezë.

Atëbotë në rrethin tonë Adem Demaçin e pagëzuam për respektin që i takonte dhe i takon - "Mandela i Kosovës".

Të nderuar lexues, më falni që këtë rrëfim jetësor të përpjekjeve tona atdhetare e zgjata ca tepër, por dua t´jua kujtoj që në atë kohë, të pakohë kishte shumë "intelektualë" që rrugëve të Perëndimit e pengonin me të gjitha format dhe mjetet veprimtarinë e LPK-së. Ata bukëshkalë, si të ndyrë që ishin në veprimtarinë e tyre antikombëtare, duke u vënë në shërbime të poshtra, ishin zhytur, kokë e këmbë, në agjentë të UDB-së famëkeqe. Tashmë kjo po shihet qartë në vazhdimësinë e tyre "të këngës së vjetër" me qëndrimet e ndyra të këtyre "intelektualëve" të sojit të Milazim Krasniqit, alias hiçit, një pinjoll titisto-rugovist, të cilit, shkollat e para për prapësitë e tij antikombëtare, i datojnë që prej shkollës së Kumrovcit, "prej kohërave të kolerës", të atyrekohërave të "vëllazërim-bashkimit" titisto-jugosllav.

Po e përfundoj këtë shkrim-kujtimesh, me mallkimin e përjetshëm që Naim Frashëri ynë i madh ka shkruar:***"Buk´e mëmëdheut i zëntë, tradhtarët e pabesë"***

Kopenhagë, 6 dhjetor 2016

KOSOVA - ZGJEDHJET TË LIRA NË SERBI PËR TË ARDHMEN E KOSOVËS!

Në Serbi u mbajtën zgjedhje të lira më 28 tetor, për një Kushtetutë të re.Votuesve serbë iu shtrua pyetja me ç'rastata duhej të vendosnin:*A duhet Kosova vazhdimisht të jetë një provincë serbe*.

Para zgjedhjeve, kryeministri serb Voisllav Koshtunica para shtypit pat thënë: "Unë ju lutem të gjithëve që ta votoni këtë kushtetutë të re dhe në këtë mënyrë të shprehemi njëzëri për një Serbi të bashkuar që askush të mos i vjedhë territoret tona dhe ta ndajë Serbinë".

Koshtunica më herët ka qenë në Kosovë dhe ka marrë pjesë në luftë në anën e serbëve, ndaj qëndrimi i tij nuk na habit.

Ndryshimi i Kushtetutës, që u miratua njëzëri nga parlamenti serb dhe që tani doli në votime kombëtare, kritikohet po ashtu për faktin se është një gjunjëzim ndaj nacionalisteve të skajshëm në Partinë Radikale Serbe, të cilët janë të përlyer me krime lufte.

Edhe pse pati propagandë nga të gjitha anët, në zgjedhje dolën vetëm rreth gjysma e atyre që kishin të drejtë vote.Edhe përkundër klithmës politike se "Kosova është djepi i Serbisë", politikanët nuk mundta nxirrninpopullsinë në votime.

Pavarësisht rezultatit të këtyre zgjedhjeve, lufta për pavarësinë e Kosovës vazhdon. Një fuqi e rëndësishme ka dalë në skenën politike të Kosovës. Kjo quhet "Lëvizje për Vetëvendosje",me të cilët STS Internacional Solidarity ka kontakte të mira. Dy përfaqësues të Lëvizjes - gazetarët Ismet Sopi dhe Elsa Muja kanë qenë të ftuar nga STS International Solidarity, për një vizitë këtu në Skandinavi, në janar 2006. Vetëvendosje, nëpërmjet internetit lëshon lajme në gjuhën angleze, për çdo javë. Këto lajme mund të gjenden në këtë adresë interneti ëëë.vetevendosje.org në "Newsletter". Ajo edhe mund të rezervohet edhe ne këtë adresë: selvdetermination@gmail.com

EU, NATO dhe OKB nuk duan vetëvendosje reale për Kosovën, një e drejtë kjo që iu njoh popujvetë tjerë në ish-Jugosllavinë. Edhe pse ata e kanë shtyrë vendimin pas zgjedhjeve parlamentare në Serbi, punohet në drejtim të të ashtuquajturit Plani i Ahtisarit, i cili e ka marrë emrin nga ish-kryetari i Finlandës Marti Ahtisari, dhe për momentin është ndërmjetësues.

Sipas këtij plani Kosova duhet të ndahet në disa komuna, që realisht janë një lloj kantonesh, sikur federata kroate-myslimane në Bosnjë, e cila gjithashtu nuk ka qenë e suksesshme.

Ne citojmë nga Vetëvendosja Nr. 16: Diplomacia mashtruese. Duket se sovraniteti i Kosovës i jepet çdokujt përpos atyre njerëzve që jetojnë aty, të cilët faktikisht kanë të drejtë për të, d.m.th. qytetarëve të Kosovës.

Në ato pjesë të planit të Ahtisarit, të cilët u paraqitën në mediume këtë javë, është lënë për t'u nënkuptuar se një rezolutë tjetër e OKB-së do t´ia japë sovranitetin e Kosovës EU-së dhe nëkëtë mënyrë, jashtë nga Serbia.

Fjala "pavarësi" nuk duket askund në atë dokument. Asgjë në atë dokument nuk jep shenja për një pushtet të pavarur dhe sovran. Kjo është si rezultat i mungesës së dëshirës për të shkëputur lidhjet mes Kosovës e Serbisë. Kosova nuk do të ketë një karrige ne OKB.

Si shpërblim për këtë, Kosovës do t'i jepet e drejta për të lidhur marrëveshje me vendet e tjera dhe të marrë pjesë në organizatat ndërkombëtare, gjë të cilën ajo vetëm po e praktikon nëpërmjet marrëveshjeve për tregti të lirë.

Kosova nuk do të ketë një ushtri, por do të ketë një të ashtuquajtur „forca sigurimi" me 2500 anëtarë aktivë dhe 800 rezervistë, të armatosur lehtë. Një forcë e tillë do të „mund të sigurojë" një sulm serb në Kosovë, por nuk do të mund të sigurojë popullatën kosovare.

Shaka e fundit është se e ashtuquajtura Ministri e Mbrojtjes do të quhet Udhëheqja e Organizatës Civile. Një ofertë e sigurt që mund të bëhet nga një shtet është të mbrojë qytetarët e vet nga shtet

e tjera. Për këtë arsye, shtetet kanë Ministri të Mbrojtjes. Çka bën apo çka do të thotë Udhëheqja e Organizatës Civile? Më në fund Kosova do të fitojë një autonomi etnike brenda kufijve të vet, të krijuar nëpërmjet decentralizimit. Plani vërteton po ashtu se do të krijohen 5+1 (komuna!), territore të reja me shumicë serbe. Kjo është diplomacia e mashtrimit dhe e gabimit. Populli i Kosovës ka të drejtë që vetë të vendosë se si ata duan të drejtohen (qeverisen).

Ata nuk duhet të jenë të detyruar për të pritur rezultatet, pasi që Serbia, Rusia dhe Kina t´i kenë mbaruar këshillat (opsionet), se sa liri vendi duhet të fitojë.

Kosova duhet të ketë të drejtën për vetëvendosje!Çka do të thotë Kosova sovrane?!

1. Forca të armatosura,

2. Një karrige në OKB,

3. Ministri të jashtme,

4. Asnjë territor autonom bazuar në baza etnike, brenda kufijve të vendit.

Problemet e mëdha që shqiptarët e Kosovës i kanë hasur për vetëvendosje, kanë të bëjnë pa dyshim me atë që Kosova është një territor i pasur me resurse natyrore. Vetëm minierat dhe vendet e përpunimit të mineraleve, të cilat gjenden në pjesën serbe të Mitrovicës, krijonin bazamentin për 40 % të prodhimit industrial në ish-Jugosllavi.

Me gjithë këtë pasuri minerale, popullata e thjeshtë shqiptare, vazhdon të ngelë një nga popujt me të varfër në Ballkan.Papunësia po ashtu është jashtëzakonisht e lartë.

Kopenhagë, 22.11.06

SHPALLJA E "PAVARËSISË" Më 17.02.2008 DHE PROTESTAT SERBE

Më 17.02.2008, në parlamentin "saksi" të Kosovës, u bë shpallja e "pavarësisë" së Kosovës. Shpallja u bë nga deputetët që fituan në zgjedhjet e fundit në Kosovë. Shikuar realisht ato zgjedhje ishin jo legjitime, sepse shumica e popullit nuk doli në zgjedhje që janë të bazuara dhe të kontrolluara nga Rezoluta famëkeqe 1244 dhe UNMIK-u.

"Dyerët e Londrës 1913" e shkëputën Kosovën nga Shqipëria amë.

Morten Messasmitështë pjesëtar i një partie djathtiste që njihet në opinionin danez si parti shumë ekstremiste ndaj të huajve. Si përfaqësues i partisë djathtiste, ai e shprehu edhe njëherë qëndrimin e tyre partiak para demonstruesve pro-serbe, të shtunën e kaluar dhe para kamerave televizive dhe tha: "Ne jemi kundër pavarësisë së Kosovës, sepse Kosova është tokë serbe, shqiptarët myslimanë janë të ardhur nga Shqipëria dhe tani jetojnë mbi 80% në Kosovë, ata e shpallën pavarësinë në territorin serb". Kjo ngjan - tha ia, "sikur myslimanët në NOREBRON (periferi të Kopenhagës) të shpallin pavarësi"! Dhe vijoi: "Ne nuk mundtë pranojmë një shtet mysliman në Evropë! Kështu konstatoi Morten Messasmiti dhe partia e tij që janë ndihmëse të qeverisë daneze.

Këto qëndrime dhe shpifje ndaj shqiptarëve në Ballkan janë nxitje dhe gënjeshtra të kulluara nga ana e Serbisë dhe e Rusisë, por nuk duhet harruar faktin se në njëfarë mënyre edhe demokratët pacifistë, të dalë si kërpudhat pas shiut pas vitit 1990, në deklarimet me të huajt kanë lënë përshtypje të gabuara te të huajt, se kinse Kosova është truall serb. Por ne jemi shumicë dhe jemi të detyruar nga dhuna serbe që të pavarësohemi sepse nuk mund të jetojmë me Serbinë, pasi ajo e mori autonominë e vitit 1974.

Këto ide reaksionare i kanë shprehur jo rrallë, titistë e përbetuar, pinjollët e satrapit Tito dhe as sot e mot, nuk po ndalen së

ecuri në rrugën e tij, duke bërë përpjekje të reja për ndarjen e Kosovës nga Nëna Shqipëri. Këtë e dëshmon më së miri përpjekja e tyre kinse për të shpikur një "komb kosovar", me një "gjuhë kosovare" duke e vulosur më tej tradhtinë e tyre me një "flamur kosovar".

Si përfundim, do të shtoja vetëm dhe faktin se, pavarësisht që Serbia hiqet se është e revoltuar nga "pavarësia" e Kosovës, ajo nëndheshëm e di fort mirë se serbët kolonë në Kosovë, kanë fituar si kurrë më parë, të drejta, me këtë lloj "pavarësie ahtisariane". Prandaj zhurmat e tyre janë sa për t´i bërë "kërcënime" Perëndimit me dorën e zezë shoviniste ruse, kinse për "shtypjen" e serbëve në Kosovë, që po u ngjan atyre, kinse prej shqiptarëve.

Danimarkë, 26.02.2008

KUSH ËSHTË ANDERS FOGH RASSMUSENI, TANI SEKRETAR GJENERAL I NATO-s?!

Anders Fogh Rasmussen, tani i zgjedhuri Sekretar gjeneral i NATO-s, u lind më 26 janar 1953, në Ginnerup të Danimarkës. Ka diplomuar dhe ka doktoruar për ekonomi. Me politikë merret që në shkollë të mesme si anëtar i rinisë në Partinë Liberale daneze, e cila quhet "Venstre" ("E majtë"), por në fakt është më e djathtë se të gjitha partitë e tjera në Danimarkë. Rasmuseni ka pasur disa poste në qeverinë lokale prej kur ishte 20 vjeçar, në komunën e Viborgit.

Më 1 qershor 1972 zgjidhet anëtar i parlamentit, ndërsa më vonë fiton dhe postin si kryetar i Partisë Liberale.

Në shtator 1982, Paul Schluta si kryetar i Partisë Konservatore Popullore, bëri koalicionin me liberalët danezë. A.F. Rasmuseni emërohet ministër i Tatimit dhe nga borgjezia daneze përfolet se ka qenë shumë i suksesshëm, ndërsa nga opozita është kritikuar dhe është demaskuar se ka bërë edhe skandale!

Më 18 prill 1998, zgjidhet kryetar i partisë, me ç´rast e zëvendëson ish-ministrin e Jashtëm, Uffe Ellemann Jensin, i cili dha dorëheqje nga kreu i partisë.Më 20 nëntor 2001, i fiton zgjedhjet parlamentare në koalicionin e djathtë, me Partinë Konservatore daneze dhe me Partin Popullore daneze. Kjo e dyta shquhet për një program “të pastër”, racist ndaj të huajve në përgjithësi dhe ndaj arabëve myslimanë, në veçanti.

Pra, prej 27 nëntorit të vitit 2001 A. F.Rasmusseni e udhëheq qeverinë daneze në koalicion me të djathtët.Natyrisht, nga koalicioni ka lëvdata të shumta, ndërsa nga opozita dhe nga intelektualët, njihet si një reformator i rrezikshëm që e zhyti Danimarkën në një kaos social, ngase gjatë qeverisjes së tij janë shtuar të varfrit. Bëri ”reforma” në aspektin social, arsimor dhe në administratë bëri një kaos të vërtetë. Prandaj, si i fitoi zgjedhjet e dyta, kjo ishte një çudi e madhe, kur as në debate nuk kishte aftësi t´i përballonte argumentet përballë socialdemokratëve. Por, si doli

hapur me qëndrimin e tij racist ndaj arabëve dhe myslimanëve dhe fakti se qe njëri ndër përkrahësit me të mëdhenj të luftës në Irak dhe në Afganistan, kjo ia mundësoi atij të fitojë edhe në mandatin e dytë. A. F. Rasmuseni do të mbetet në histori si provokator i madh që i bëri disa afera tepër të rrezikshme, fjala vjen:

1. Një provokim ndaj Autonomeve, duke ua prishur ndërtesën historike, ku të majtët gjatë shekujve të kaluar kanë mbajtur shumë mbledhje dhe aty kanë marrë vendime të rëndësishme që njihen si "Jagtvai nr. 69". Bile në këtë ndërtesë është marrë vendimi nga gratë përparimtare daneze të manifestohet "8 Marsi", si ditë ndërkombëtare e grave. Pastaj, këtu janë mbajtur dhe shumë mbledhje antifashiste, mirëpo gjatë "një dite", në orë të errëta të historisë "moderne", kjo ndërtesë u shkatërrua deri ne themel. Dihet pastaj se disa javë ka pasur demonstrata dhe përleshje me policinë.

2. Qeveria e A. F. Rasmussenit njihet si provokatore edhe ndaj komunitetit mysliman, duke e pikturuar në mënyrë shumë ofenduese profetin Muhamed, që komunitetin arab në Danimarkë e revoltoi. Madje atëbotë pati edhe protesta të dhunshme në Danimarkë, ashtu si në shtetet arabe. Mirëpo, këtë provokim drastik kryeministri e argumentoi duke thënë: "Kjo është shprehje e mendimit të lirë"!

3. Kryeministri danez A.F.Rasmusen, gjithashtu shquhej së tepërmi për një urrejtje (të themi, si gjithëpopullore), duke krijuar "fantazmën" e luftës së "Shoqatës së rokerëve", kinse këta janë në luftë me të, punëtorët e huaj". Në fakt kishte ndodhur një vrasje. Një iranian e vrau një turk dhe prej atëherë filluan mediumet të nxisin edhe dhunë kriminale. Në të shumtën e rasteve janë vrarë kriminelët në konfrontim ndër vete, e kurrsesi të huajt me danezët. Por, shihej qartë se mediumet dhe qeveria po e nxitnin konfliktin me të huajt.

Pra, kujtoj që nga lexuesit është me interes të dihet se kush është A. F.Rasmunsseni, i cili në fillim të prillit dha dorëheqje nga posti i kryeministrit danez dhe e pranoi postin e Sekretarit gjeneral të Aleancës Veri-Atlantikut, të NATO-s.Personalisht e them troç se

jam njëri nga ata që e kam ndjekur me vëmendje politikën e tij raciste dhe aspak konstruktive në Danimarkë.

Prandaj kam dyshime të bazuara në fakte të shprehura më lart se ky politikan “i denjë” për një vend të tillë udhëheqës do t´i shtojë më tej tragjeditë dhe luftërat. Kur e shtoj këtu faktin që ky personalitet i tillë tani mund ta krijojë dhe klikën e tij “paqësore”, duke e bindur botën "demokratike” me argumentet e tij, për përpjekjet e tyre “paqësore”.

Vetëm dy ditë para se të largohej nga posti si kryeministër, “shkëlqesia e tij”, e priti kryetarin e shtetit shqiptar Bamir Topin , të cilit nuk i bëri aspak publicitet për vizitën,ngase kjo vizitëu mbajt larg nga mediumet. Por, për habi, nga mediumet shqiptare është propaganduar si vizitë shumë e suksesshme!Duke e bërë këtë mediumet e politikës ditore, si kurdoherë më parë, po vazhdojnë ta mashtrojnë popullin shqiptar.

Kopenhagë, 15 prill 2009

VIZITË SKANDALOZE E PRESIDENTIT TOPI NË DANIMARKË!

Nëpërmjet një komunikate për shtyp, lëshuar nga kryeministria daneze, bëhet e ditur se kryeministri danez, Anders Fogh Rasmussen, e paska anuluar takimin e tij në selinë e NATO-s, sepse e paska në agjendë pritjeje presidentin e Shqipërisë, z. Bamir Topin, më datë 01 prill 2009. Pra, vetëm kaq ishte njoftimi për mediumet.

Si veprimtar politik në Danimarkë që veproj gati qe 30 vite në rrafshin e politikës daneze, kjo praktikë nuk ka ndodhur me asnjë kryetar ose delegacion nga cilido vend qoftë ai, po qoftë i ardhur dhe nga ndonjë shtet i Afrikës,madje që është shumë më i vogël se Shqipëria.

Në Danimarkë, kryetarët dhe delegacionet e larta të shteteve priten jashtëzakonisht mirë, njoftojnë dhe asistojnë zakonishtmbi 50 gazeta të përditshme, dhjetëra stacione televizive. Kjo shoqërohet me ngritjen e flamurit danez nëpër institucione, e pastaj në shenjë respekti, të gjithë autobusët urbanë, tërë ditën i mbajnë flamujt lart duke valuar, etj.

Po ç'ndodhi më datë 30 mars, kur në vizitë kishte mbërritur një delegacion me 70 vetë, i kryesuar nga presidenti i Shqipërisë, Bamir Topi. Kjo vizitë ishte tejet e palogjikshme dhe nga disa intelektualë danezë u vlerësua si skandaloze.

Të pritet në vizitë kryetari i kombit shqiptar dhe të mos i bëhet një pritje zyrtare, kjo për mua është vërtetë e pakuptueshme. Nuk mund takuptoi faktin, sesi pranojnë politikanët shqiptarë të bëhen lodra në duar të të huajve, apo "mish për top" për interesat e huaja!

Nëse presidenti Topi nuk i di rregullat, a mos politikanët e Tiranës, i kanë larguar të gjithë këshilltarët e ish-kryetarëve të mëparshëm që t´i japin këshilla, sepse kështu, me këtë mënyrë sjelljeje, vetëm po e komprometon si s´ka më keq, imazhin e Shqipërisë dhe çështjen shqiptare. Pastaj, aspak nuk habit fakti që nesër të dalin haptas shpifjet e fashistëve serbë të sojit më të keq si

Dobrica Qosiqi, i cilideklaron se "shqiptarët janë mbeturinat e Ballkanit"!

Dhe kjo sjellje servile e ul vlerën ndaj shqiptarëve si komb se ”populli shqiptar nuk po trajtohet si duhet nga faktorët e jashtëm", etj. etj.

Pra, nuk ka dyshim se kjo vizitë e presidentit Topi nuk e arsyeton me asgjë faktin që ishte me 70 vetë dhe të ndjekin ndeshjen Danimarkë-Shqipëri. Vetëm një sekondë e paraqiti TV shtetëror i Danimarkës Bamir Topin dhe kryeministrin danez, A. F.Rasmussenin, i cili tani ka fituar edhe postin e Sekretarit gjeneral të NATO-s.

Nuk ka pikë dyshimi se kryeministri danez nuk do ta fitonte kurrë postin e ardhshëm, pa qëndrimin e tij për diskriminimine theksuar të të huajve dhe posaçërisht të komunitetit mysliman në Danimarkë. Natyrisht, nga miqtë e vet këtij iu dha shansi që të largohet nga politika daneze, gjë që e pranoi me plot dëshirë!

A do të vazhdojë po me atë politikë raciste dhe luftënxitëse ndaj shteteve myslimane, apo do t´ia ndalin turrin, kjo pritet të shihet në të ardhmen?!

Kopenhagë, 07 prill 2009

PUSHTUESIT KURDOHERË MBETEN PUSHTUES, PAVARËSISHT GJUHËVE DHE FLAMUJVE QË I KANË!

Kauza shqiptare në gjysmë-Shqipërinë e okupuar që nga 1912/13 e gjer më tani ka qenë dhe është e pazgjidhur. Është e ngulfatur dhe është e pushtuar nga dhuna dhe mashtrimet. Kjo nuk do shumë mend për ta kuptuar dhe për ta vërtetuar. Përkundër faktit se kjo tragjedi zgjati ndër shekuj, shqiptarët liridashës kurrë nuk e pranuan as njërën dhe as tjetrën. Kurdoherë qëndruan dhe luftuan kundër pushtuesve dhe veglave të tyre qorre.

Brezni të tëra luftëtarësh që ishin dhe që janë të vendosur të luftojnë me pushkë e penë për mëmëdheun, nuk u mashtruan nga fundërrinat e kombit, si Abdullah Dreni, satrapi Ahmet Zogu, Rexhep Mitrovica, Ali Shukriu, Azem Vllasi, e më vonë as nga "elita" e famshme e pionierëve të Titos, me në krye Ibrahim Rugovën i cili vetëm përkohësisht e gjunjëzoi Kosovën me të "famshmen" paqe nën Serbi, nën flamujt e mashtrimeve evropiane. Atëbotë kur Millosheviqi bënte kërdi, si ujku në vath, qeveritarët e tij, ia kishin mbathur nga sytë këmbët.

Janë ende të freskëta rrethanat e rënda që ngjajnë si pika uji në gotë, ndaj mund të bëjmë paralele. Instrumenti i Titos - Fadil Hoxha, i nxitur nga ai, e burgosi Adem Demaçin. Edhe i përkëdheluri i Titos - Mahmut Bakalli, e burgosi. Pionieri i Titos - Azem Vllasi e burgosi Hydajet Hysenin. Qeveria e Ibrahim Rugovës, në bashkëpunim me atë të Millosheviqit, përsëri e burgosi Ukshin Hotin. Qeveria e Rrahman Morinës tentoi të burgosë Hashim Thaçin dhe Adem Jasharin. Qeveria e Sali Berishës burgosi Adem Jasharin, Zair Pajazitin, Luan Haradinajn - tani dëshmorë si dhe shokët e tyre. Ndërsa tani, çfarë absurditeti! Një ish-i përndjekur nga Serbia, kryeministri Hashim Thaçi dhe qeveria e tij, i cytur nga Serbia dhe "miqtë" evropianë, e ndjek për ta burgosur Albin Kurtin!!!

Edhe pas luftës së UÇK-së, kjo, fatkeqësi mjerisht ende po na përcjell, por tani në forma të tjera, kinse nën udhëheqjen e republikës "sovrane" të Kosovës, me në krye "binomin", Sejdiu – Thaçi. Po shihet qartë se hyrja e trupave të huaja në Kosovë nuk rezultoi me çlirim të plotë, por me një ripushtim nga ustallarët mashtrues evropianë, miq të përbetuar të Serbisë. Kufirin shqiptaro-shqiptar e theu me gjak UÇK-ja heroike, e përbërë nga djem dhe vasha të të gjitha viseve shqiptare. Ata ishin betuar për ribashkim me Nënën Shqipëri. Sot kemi një "zgjidhje" krejt tjetër. Kreu i shtabit të UÇK-së, duke bashkëpunuar me pacifistët, i shiti interesat kombëtare në Rambuje, duke bërë përsëri barrikada për shqiptarët si dhe bllokada ndarjeje midis tyre.

Prej asaj konferenca famëkeqe të shkurtit të zi 1999, "politikanët dhe diplomatët" shqiptarë u bënë shërbëtorë të një pushtimi të "ri" perfid botëror. Me fjalë të tjera, tani jo vetëm Serbia, por çdokush mund të vijë në Kosovë të sundojë, të plaçkitë t´i ofendojë shqiptarët në shtëpi të vet, në atë gjysmë Shqipëri ku u derdh gjaku shqiptar i të gjitha trojeve ilirike.

Se çfarë shtypjeje, diskriminimi dhe idiotizmi pushtues po bëhet në Kosovën shqiptare, këtë e treguan më së miri demonstratat e Lëvizjes Vetëvendosje të 10 shkurtit, kur policia e UNMIKUT qëlloi mbi djemtë shqiptarë me armë zjarri. Më skandaloze ishte kur mbeti në fuqi gjykimi i Albin Kurtit nga UNMIKU që në fakt abortoi. Por me ardhjen e EULEX-it ne Kosovë u riaktivizua gjykimi i Albinit, i cili tanimë është bërë simbol i ribashkimit kombëtar. Vetë qëndrimi i Albinit tregon se çfarë luftëtari i paepur është për përparim dhe ribashkim kombëtar. Pikërisht për këtë ngrenë akuza farse dhe absurde ndaj Albinit. Si duket tanimë kjo çështje u ndërkombëtarizua ngase në séancën e 6-të në Prishtinë merr pjesë edhe delegacioni nga Danimarka i përbërë nga Vagn Rasmmusen, nga eurodeputeti danez Søren Søndergaard si dhe nga eurodeputeti holandez Erik Majer, i cili këto ditë e njoftoi me telefon Vogne Rasmussenin duke i thënë: ***"Ky gjykim është vetëm***

një farsë dhe me prapavijë politike dhe Albini ka plotësisht të drejtë".

Tani kur ish i burgosuri politik, i dënuar edhe si i mitur, kërkon nga institucionet e Kosovës që të distancohen nga e kaluara kriminale e atyre që vepruan përkrah regjimeve kriminale të Serbisë, e që këta tradhtarë me damka të dënohen "për së gjalli" por edhe ***post mortem***, kjo kërkesë e tij e drejtë, u mohua. E tmerrshme!!!

Sot Albini arrestohet nga po ata ish-shokët e tij që dikur i kishte përkrah, në betejat e luftës heroike, si themelues i UÇK-së.

Me këtë veprim të turpshëm, ata e vërtetojnë katërcipërisht cinizmin dhe frikën e tyre për humbjen e pushtetit pa shtet. Sa shpejt i kanë harruar zotërinjtë qeveritarë të Kosovës së "pavarur" dhe "opozitarët" me të cilët janë në aleancë, kohët e tyre të rënda të robërisë. Tani atë peshë pa hezitim duan ta hedhin mbi supet e njoma të rinisë shqiptare në përgjithësi, e në veçanti mbi Albinin sypatrembur i cili për vetëvendosjen e trojeve shqitare po e sfidon botën antishqiptare.

Fatkeqësisht, për vite të tëra, po e njëjta gjë ndodh edhe me Albinin tonë të madh dhe të pathyeshëm. Përse t'i dorëzohet një gjyqi që nuk ka legjitimitet popullor. Të gjitha veprimet, si të UNMIK-ut ashtu edhe të EULEX-it, i kanë treguar dhe po i tregojnë për çdo ditë, fytyrat errëta se janë kundër interesave shqiptare dhe se janë pushtues "me dafinë" në dorë, ndërsa zjarrin mbi ne, e hedhin prapa shpinës.

Nga njëra anë, ditë e natë bëjnë zhurmë për integrime, por nga ana tjetër caktojnë kufij të zi në mes kombit shqiptar.

Duke u bazuar në sa më sipër si dhe në një mal faktesh të tjera, shihet qartë se ata nuk erdhën në Kosovë t´i përmirësojnë gabimet e Evropës, pra gabimet e veta, që ua kanë bërë shqiptarëve gjatë historisë. Përkundrazi, erdhën, i gjetën dhe i shtruan politikanët si dele të buta, që pranojnë çdo lloj "gjelle" si ajo Rezoluta famëkeqe

1244 apo Pakoja e antishqiptarit më të përbetuar evropian - finlandezit Ahtisari, pasardhës i Greit.

Vetëm Lëvizja Vetëvendosje, e ka paraqitur, e ka sqaruar dhe e ka kuptuar me kohë misionin se ne shqiptarët nuk jemi kundër institucioneve ndërkombëtare. Këtë e ka deklaruar shumë herë kjo organizatë rinore, e cila gëzon një mbështetje të fuqishme popullore.

Po këtë e ka theksuar shumë herë edhe simboli i shqiptarizmit, Adem Demaçi, i cili thotë: ***"Kërkojmë nga miqtë tanë çlirim dhe jo mëshirë. Shqiptarët nuk kanë nevojë për demokraci të rrejshme, por për liri të vërtetë, sepse pa liri të vërtetë nuk ka as demokraci të mirëfilltë. Nëse ndokush, kudo qoftë dhe kushdo qoftë, përpiqet që të vërtetën e hidhur ta mbulojë me demagogji, nuk është veçse demagog. Kjo demokraci e rrejshme do të dështojë, ashtu siç ka dështuar në shumë vende të Ballkanit të sotëm "demokratik" - në Serbi, në Maqedoni, në Greqi por edhe në Shqipëri".***

Ne duhet të këmbëngulim, të tregojmë një vendosmëri të madhe dhe të mos lejojmë të na mohohen të drejtat nacionale dhe sociale.

Ne nuk duhet të lejojmë gjithashtu as përçarjet fetare, sipas feve dhe sekteve të ndryshme, për arsye se këto mosmarrëveshje, në dukje të vogla, ka rrezik që më vonë të bëhen hendeqe të pakapërcyeshme. Dëshmi për këto rrugë pakrye janë vringëllimat e armëve në vende të ndryshme, atje ku FEJA është futur si "mollë sherri" në mes popujve apo në gjirin e një populli. Kujtojmë Irakun, Somalinë, Pakistanin etj., pa asnjë arsye.

Kurrë, për asnjë çast të mos e harrojmë amanetin e madh të ideologut tonë kombëtar, Pashko Vasës, i cili në poemën madhështore atdhetare *"O, moj Shqypni"* thotë:

"Mos të shikojmë kisha e xhamia,

Feja e shqiptarit është shqiptaria"!

Danimarkë, më 20. 04.2010

ARBËN XHAFERI, ASHTU SI E NJOHA UNË

Kopenhagë, 28. 09. 2014

"Më e mirë është një humbje heroike sesa një kompromis i turpshëm." Nikolla Makiavel

Kjo thënie gjeniale u shkon më së miri politikanëve shqiptarë të frymëzuar nga ideologjia titiste. Vitet e fundit (Arbën Xhaferi ishte gjallë), në Shqipërinë londineze mbizotëronte një gjendje e palakmueshme. Edi Rama do të shprehej: "O Arbën Xhaferi, eja e bëju shtetas i Shqipërisë dhe do të të bëjmë president"! Ndërkaq, pas vdekjes së tij, po e lartësojnë edhe më lartë, saqë duke i parë e dëgjuar këto marrëzira politike, jam i shtrënguar të dal hapur me një qëndrim të pastër. Me fjalë të tjera, dua t'i njoftoj lexuesit se kush ishte në të vërtetë, i ndjeri Arbën Xhaferi.

S'po shkruaj dot biografi për të, por grosso modo (në vija të shkurtra) do të paraqes ca elemente të biografisë së tij. E shoh të nevojshme për ta bërë një gjë të tillë, për arsye se në këto mjegullnaja të amullisë politike "demokratike", titistët, përkatësisht antishqiptarët po rehabilitohen me të madhe, ndërsa në anën tjetër, po bëhen përpjekje që të lihen në harresë atdhetarët e mirëfilltë të popullit, duke e shpërfillur dhe duke e injoruar plotësisht veprimtarinë patriotike shumëvjeçare të tyre.

Në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë ka pasur burra (të tillë ka dhe sot) të cilët kanë dhënë çdo gjë për çështjen kombëtare. Janë ata që vërtet i kanë dhënë grushte të forta Jugosllavisë titiste, në përgjithësi, e në veçanti - Maqedonisë pushtuese.

Atdhetarët e mëdhenj të historisë sonë të lavdishme, të cilët, për breznitë e reja e trasuan rrugën e qëndresës përballë shovinistëve titistë dhe pas-titistë ishin heronjtë si: *Mehmet Gega dhe Zaim Beqiri, tanimë të ndjerë.*

Mediumet dhe analistët primitivë dhe servilë të klaneve titiste, gjer në ditët tona, qëllimisht dhe me tendenca të theksuara, por tejet perfide, po i harrojnë edhe heronjtë e gjallë siç janë: ***Rafi Halili, Shpëtim Pollozhani, Elmaz Ademi, Beqir Berisha***, analisti, pedagogu dhe veterani i arsimit dhe i publicistikës sonë, e shumë të tjerë.

Harrohen mbi të gjitha për faktin se, nga këta analistë titistë shkretanë, heronjtë e gjallë dhe të vdekur, quhen enveristë, duke e mbuluar njëherazi të vërtetën se këta dishepuj të shqiptarisë, politikën diskriminuese titiste, e kanë kundërshtuar me guxim.

Sipas logjikës verbuese të pseudoanalistëve të lartpërmendur, këta atdhetarë të popullit shqiptar duhet me çdo kusht të anatemohen, sepse rezistenca dhe veprimtaria e tyre është ndërmarrë në një kohë kur këta "analistë të hollë" kanë qenë në shërbim të politikës antishqiptare të Jugosllavisë titiste. Kuazi opinionbërësve të sotëm, as që u ka shkuar ndërmend atëbotë për ta parashikuar fundin e tmerrshëm dhe të turpshëm të ish-shtetit shumë të dashur të tyre.

Qëndresa heroike dhe veprimtaria patriotike e pakursyer e bijve më të shtrenjtë të këtij populli kundër pushtuesve serbosllavë dhe sllavo-maqedonas, kanë lënë gjurmë të pashlyera në historinë e kombit shqiptar, ndërkaq sakrifica dhe martirizimi i tyre jetojnë të gjalla në kujtesën e këtij populli.

Në anën tjetër, titistin me damkë, Arbën Xhaferin, për ta popullarizuar, nuk lënë gur pa lëvizur. Përse vallë?! Për arsye se atë e kishin dhe e kanë mësues të "edukatës fizike" alias politike. Me një fjalë, ai ishte idoli i tyre. Çfarë ironie?! Shih, duke u orvatur që prej kundërheroit, të krijojnë si me magji "heroin e sakrificave të mëdha" për kombin shqiptar!

Edhe pas vdekjes së tij, për të po shkruajnë libra, po emërtohen emra rrugësh si ajo e autostradës Prishtinë-Shkup. Kjo bëhet me qëllime të caktuara, d.m.th. me një gur të vrasin dy zogj: "Të rehabilitohen elementët titistë, (duke e rehabilituar njërin nga më kryesorët) dhe populli të ketë frikë, po nga titistët..." Ne fort mirë i

njohim veprimtarët e kauzës kombëtare. Po kaq mirë e dimë se kush ishte Arbën Xhaferri.

Në demonstratat e vitit 1968 në Maqedoni, policia titiste jugosllave, UDB-ja dhe bashkëpunëtorët e saj, arrestuan grupin ilegal shqiptar të përbërë prej 17 vetëve, në krye me Mehmet Gegën. Të gjithë u dënuan, përpos vëllezërve Arbën dhe Agim Xhaferi, të cilët shpëtuan pa u dënuar! Si është e mundur?!

Arbni iku nga Tetova dhe vajti në Prishtinë. Atje hyri në ”ilegalitet” si drejtor i TV-Prishtinës dhe si aktivist i LKJ-së. Si i besueshmi i kësaj partie titiste, ai themeloi edhe Këshillin famëkeq për diferencime politike. Ata që kanë qenë në këtë institucion informativ dhe kulturor, e dinë mirë veprimtarinë kundër-shqiptare të Arbën Xhaferit. E dinë shumë mirë se ai ka qenë shërbëtor i huaj, pra në shërbim të huaj.

Kur Serbia e suprimoi Kushtetutën e vitit 1989, e zaptoi midis tjerash edhe TV-Prishtinën. Shumë shqiptarë në këtë kohë, mbetën pa punë. Njëri nga ata qe edhe Arbni. Ky ishte një filozof i padiplomuar, por në fakt ishte një mjeshtër dinak i penës. Si i tillë, filloi të merrej me shkrime. Dorën në zemër, kishte shkrime të fuqishme dhe ato i botonte në gazetat e ish-titistëve. Mirëpo, populli ynë thotë: ”Nga e thëna në të bërë, në mes është një det i tërë”. Atëbotë, shumë shqiptarë mendonin se Arbni ka ndërruar qëndrim, pasi amalgama jugosllave kishte dhënë shpirt, ndërkaq titizmi dhe agjenturat e Beogradit perënduan bashkë me utopinë AVNOJ-iste. Por tani shtrohet pyetja: A u varrosën me të vërtetë titistët?! Arbni iku nga Prishtina dhe u kthye sërish në Tetovë. Hiqej si ”shpëtimtar i kombit”. Fitoi përkrahje sepse përdorte një diskurs dhe një fjalor nacionalist. Kishte shumë që thonin: “Ja, tash na erdhi njeriu i duhur, në momentin e duhur”! Titistët e themeluan Partinë për Prosperitet Demokratik (PPD). Kjo parti, LDK-ja e Ibrahim Rugovës dhe ajo e Shqipërisë londineze - e ashtuquajtura PD e Sali Berishës, e njohën Maqedoninë si shtet, pa kurrfarë kushtesh për shqiptarët. E njohën pra këtë republikë armike jugosllave, të krijuar më 1943 nga titistët antishqiptarë, si një republikë eksperimentale,

nga ku, zbatuesit e Elaboratit të Vaso Çubrilloviqit i deportimin shqiptarët për në Turqi, në bazë të një marrëveshjeje ndërmjet Beogradit dhe Ankarasë, të nënshkruar pas Luftës së Parë Botërore.

Kur PDSH-ja e Arbnit ishte në opozitë, udhëheqësit e kësaj partie ishin "shqiptarë të mëdhenj", luftonin për Universitetin e Tetovës... Por, sapo u futën në qeveri, problemin shqiptar filluan ta shohin me syze franceze dhe angleze (z. Xhaferi, papritur u bë një z. Xhaferson). Po kështu, duke shkuar pas prijësit të tyre, u konvertuan edhe xhafer-sonët, sejmenët dhe besnikët e tij shqipfolës.

Arbër Xhaferrsoni & Co, e harruan Universitetin e Tetovës. Kokulur dhe në mënyrë djallëzore, e pranuan shkollën private - "Kolegjin e Shtulit". Si opozitë, këta zotërinj ishin të varfër, madje nuk kishin mundësi t'i paguanin as zyrat dhe telefonat e zyrave. Mirëpo, sa u futën në qeveri, me votën dhe me djersën e popullit u pasuruan dhe shumë shpejt e harruan problemin shqiptar, e harruan programin e partisë, i harruan të gjitha ato "mrekullira" që patën premtuar para elektoratit. Lufta në Kosovë e viti 1999, këta zotërinj, brenda natës i bëri milionerë. Populli shqiptar i shtypur në Maqedoni, luftën në Kosovë e shihte si një dritë lirie dhe pikërisht për këtë, në ato troje u mobilizua fort për të mbledhur ndihma.

Veprimtari Zaim Beqiri tregonte sesi, bashkë me përfaqësuesin e Shoqatës së të burgosurve dhe të të përndjekurve politikë - Xhevat Ademin i kishin kërkuar Xhaferit që, duke qenë lider i partisë në pushtet, të merrte përsipër dhe të dilte haptas në ndihmë të luftës në Kosovë.

Zaimi i njoftonte shokët e Shtabit UÇK-së: "Unë me gruan dhe familjen time jemi në gatishmëri të plotë, jemi në shërbim të luftës, por për të pasur sukses aksioni ynë në popull, duhet që qeveritarët të marrin përsipër detyrimet që i imponon çasti historik"!

Me një fjalë, i kërkuan kreut të PDSH-së të bënte një gjë të tillë dhe kjo ishte e mirëseardhur për ta. Kreu i kësaj partie, këtë punë e kreu, por a u dërguan të gjitha ndihmat që i dha populli për çlirimin e Kosovës, kjo mbetet një çështje e diskutueshme?! Është për t'u

habitur sesi deri më sot nuk kemi parë as dëgjuar për ndonjë raport lidhur me mjetet e grumbulluara?!

Akoma më tragjik është fakti me Stankovecin famëkeq. Sa përfituan Arbni & Co. nga tragjedia e kufirit, që herë mbyllej dhe herë hapej, me ç'rast refugjatët e stërlodhur jepnin mijëra euro për të shpëtuar anëtarët e familjeve të tyre nga ferri i policisë maqedonase në Stankovec dhe Bllacë. Ndërsa ata që nuk kishin euro e dollarë vuanin të zitë e ullirit. Dihet botërisht se policia maqedonase në atë kohë, si përbuzje ndaj shqiptarëve, hynte në kampet e sipërthëna të përqendrimit me maska në gojë e hundë. Ishin skena të tmerrshme. Qëndrimet politike të qeverisë maqedonase dhe të PDSH-së si partnere e koalicionit - ndaj luftës në Kosovë, ishin më se të qarta. Me Arbnin, personalisht, kam pasur disa mospajtime dhe këtë ia kam thënë troç. Këtu do të përmend tre raste:

1. Arbnin dhe Shaip Emërllahun i ftova personalisht në Danimarkë dhe i mundësova këtij të parit, që si kryetar i PDSH-së, veprimtarinë e vet politike ta prezantojë dhe ta afirmojë në mjetet daneze të informimit. Në një takim tonin të mbyllur ishte prezent edhe një gjeneral danez, i veshur me rroba civile. Ai, pasi dëgjoi ligjëratën dhe pikëpamjet politike të Arbnit, ia ktheu: "...po ç`prisni atëherë, pas kësaj situate kaq të rëndë që shpjeguat...."?!

Kur dolëm jashtë, Arbni më tha: "Këta preferojnë luftë"! Ndërkaq unë ia ktheva: "Ju jeni atje. Jeni edhe përfaqësues i popullit - në opozitë, ndaj punët i dini më mirë. Por, nuk duhet harruar se, kur pushtuesit nuk e kuptojnë gjuhën e demokracisë, atëherë lufta imponohet si imperativ i çastit historik. Pra, mirë e kishte gjenerali"! Në mbrëmje u tubua një numër i madh shqiptarësh. Pas debateve të shumta, iu drejtova Arbnit: "Arbën, në një dasmë kam pasur rastin ta takoj Mehmet Reshatin nga fshati Gllogjë. Më la përshtypje të mirë, ngase ishte njohës i shquar i zhvillimeve politike. Ishte dhe ekonomist i mirë, ndaj do të ishte mirë që personat e tillë të mos i lëni rrugëve, por t'i angazhoni për të mirën e kauzës sonë të përbashkët".

Pasi më dëgjoi, e tundi kokën dhe ma ktheu: "Xhemil Zeqiri, partia jonë nuk merr kuadro që kanë qenë në ish-sistemin e Titos". "Më vjen keq - i thashë - por këtyre pikëpamjeve nuk u vjen erë e mirë. Mos harro se edhe ti ke qenë pjesë e sistemit titist. Bile ke qenë edhe kryetar i Këshillit për diferencime ideopolitike. Ke bërë diferencime. Njerëzit që ti i ke përjashtuar nga puna, nga LKJ, apo edhe nga banesa - i dimë me emra dhe mbiemra. Mehmet Reshati është një kuadër i fortë politik. Është dhe ekonomist i mirë. Po qe se nuk e angazhojnë shqiptarët, atëherë ai do të inkuadrohej në ndonjë ndërmarrje private maqedonase". Kuptohet, jam kundër asaj që personat të cilët kanë qenë në shërbim të atij sistemi okupues, tani, me flamuj në duar, të dalin në vijë të parë. Por, nuk është mirë të lihen në rrugë, sepse ne shqiptarët, për nga numri, nuk jemi një popull i madh. Tani, sërish po i rikthehem rrëfimit tim lidhur me mospajtimet e mia me Arbën Xhaferin.

2. Herën e fundit, me Arbën Xhaferin jam takuar në selinë e PDSH-së në Tetovë, bashkë me të ndjerin, poetin Murtezan Arifi. Pasi debatuam rreth disa temave politike me karakter kombëtar dhe ndërkombëtar, poeti m´u drejtua me fjalët: "Përpos Arbnit, politikan dhe intelektual tjetër në Maqedoni nuk kemi. I ka disa analiza që rrallëkush i ka bërë"! "S'pajtohem dot me konstatimin tënd! - ia ktheva...! Arbni është shumë i rrezikshëm dhe prej tij priten vetëm të këqija për këtë popull. S'ka dyshim se shkrimet i ka të forta, por këto i bën vetëm sa për t´u kamufluar dhe për t'u imponuar. Për çështjen tonë kombëtare, ai duhet të ndërmarrë veprime politike të mirëfillta. Ndryshe, çdo gjë tjetër do të mbetet demagogji. Të mos harrojmë se para gazetarëve, edhe I. Rugova flet me patriotizëm. Madje duke shfaqur ide "tullumbace", ia doli të mashtrojë jo pak intelektualë dhe një pjesë të popullit. Por, duhet ditur se Rugova dhe Arbni, dritë të gjelbër për të krijuar parti politike kanë marrë prej padronëve sllavë të tyre, e në veçanti prej serbomëdhenjve. Këtyre dyve u lejohet të bëjnë një kritikë të sipërfaqshme të regjimeve të tyre antishqiptare dhe pushtuese, por jo edhe të veprojnë politikisht kundër tyre. Të mos harrojmë se në çastin kur të fillojnë veprimet

politike të njëmendta, pra kur të troket ora e historisë, pikëpamjet e tyre do të ndryshojnë.

Dhe pikërisht tani do t´i shohim këta ”Mic Sokola”!

Kur hymë në zyrë, pamë se brenda ndodheshin katër vetë. Arbni rrinte krejt inferior. I pajisur me syze, ishte duke shkruar diçka. Menduh Thaçi luante letra në kompjuter, ndërsa Alajdin Demiri përkthente një intervistë të babaxhanit Pjetër Arbnori, dhënë një gazete maqedonase. U ndjeva i provokuar kur më përshëndeti me mbiemër: “O mirë se ke ardhur z. Zeqiri”!

“Xhemil e kam emrin“ - i thashë si me të qeshur! Pasi u përshëndetëm dhe biseduam pak, më pyeti se ç’thonë bashkatdhetarët në Danimarkë dhe a kemi filluar të vetëdijesohemi ne, atje në Evropë?

“Të kujtohet kur ishe në Kopenhagë” - ia preva unë. “Na tregove një barcoletë që na bëri të qeshim me të madhe. Bëhej fjalë për një burrë të fortë, i cili kishte dashur të provonte se sa herë mund të bënte dashuri me gruan e vet. Për të parë se kush ishte më i fortë: burri apo gruaja, një natë i kishin hyrë punës. Dhe sa herë që e bënin, shënonin nga një vizë. Pas një kohe të caktuar, gruaja i tha se kishin bërë 17 herë, ndërsa burri e kundërshtoi, duke i thënë se nuk janë aq, por 16. Meqë nuk mund të merreshin vesh rreth herëve të bëra, burri i thotë: Po mirë, i fshijmë të gjitha dhe ia fillojmë nga e para. Nuk di nëse të kujtohet? Ndodheshim në dhomën e Sabejdin Eshtrefit. Ishim mbi njëzet vetë. Pra, edhe ne veprimtarët shqiptarë të Evropës i fshimë këto 17 parti politike sa jeni. Tani e tutje, do t´i ndihmojmë dhe do t’i mbështesim ata të grykëhollës”. Ishte duke më dëgjuar. Syzet i kishte në maje të hundës. U nxi i tëri dhe tha: ”Ju atje duhet të keni shumë kujdes, ata janë vegla serbe, ju nuk guxoni t´i përkrahni ata...”!

E shikova Murtezanin, qesha me ironi, u ktheva në të majtë dhe i thashë: ”E ke gabim. Ata që janë radhitur në UÇK, janë bijtë më të mirë të kombit shqiptar. Ne kemi vendosur që të çlirohemi nga sundimi sllav, e nëse nuk do t’ia dalim, do t´ia vëmë flakën gjithë Ballkanit. Për këtë jam më se i sigurt”!

I revoltuar dhe i zemëruar, i rashë tavolinës me grusht. “Ikim“ - i thashë Murtezanit. Kur dolëm në rrugë, iu drejtova poetit: ”A u binde se kush është Arbën Xhaferi”?! Dola jashtë i shqetësuar tej mase. Rastin e përjetuar ia tregova pikë e për pe Bacës Beqir, por edhe shumë të tjerëve. Beqir Berisha qeshi me ironi dhe ma ktheu: “Nuk ka gjë prej tyre, ata janë bashkëpunëtorë të sllavëve...”!

3. Nëse nuk gaboj, ishte muaji korrik i vitit 1996. Pas pak vitesh, UÇK-ja përparonte në terren me aksione guerile. Zhvillimet morën një hov të madh me betejën e Prekazit, ku në krye të detyrës në mbrojtje të atdheut, ra për të mbetur i pavdekshëm komandanti legjendar, Adem Jashari me shumë familjarë të tjerë. Pas kësaj beteje historike, për masakrën në Prekaz pasuan prononcimet e udhëheqësve politikë.

Isha duke i dëgjuar lajmet në TVSH, kur ja po na paraqitet Arbën Xhaferi, i cili me këtë rast deklaroi përafërsisht kështu: “Adem Jashari është komandant legjendar”!!!

“Uuufff, i ndyri”! - bërtita me zë ngase e humba kontrollin, kur m´u kujtua biseda që pata me të në selinë PDSH-së.

“Uuufff, udbashin e dreqit”! E prisha fjalorin. Pranë tavolinës ishim disa shokë - Bekimi, Besimi, Bashkimi dhe do të tjerë. Ata më thanë: “Ç´ke ore, mirë po flet Arbën Xhaferi”!

“Po, po, mirë po flet”! Në vijim ua rrëfeva rastin kur ai, pjesëtarët e UÇK-së i quante vegla serbe dhe vazhdova: “Këta të farës së keqe sllave duan që atdhetarët shqiptarë t’i shohin të vrarë, që pastaj të krekosen dhe t’u thurin elozhe me demagogjinë e sofistikuar, të mësuar në shkollat dhe në kuzhinat bizantine. Po këto shkolla i kanë kryer madje edhe partitë e tyre, të krijuara me bekimin e UDB-së.”

Po qe se analistët, gazetarët apo krijuesit letrarë dhe artistikë duan të kenë njerëz dhe emra të ndritur, do të mundohem t´u ndihmoj.

Në këtë shkrim po përmend disa prej tyre që ende janë gjallë - në Tetovë dhe Strugë, në Shkup e Kumanovë, si dhe në rajone të tjera.

Ata janë simbole të qëndresës, ngase për çështjen shqiptare dhe për bashkim kombëtar kanë dhënë prova më se njëmij herë. Këta flakadanë të lirisë janë të burgosurit politikë - Rafi Halili, Rahim Neziri, Shpëtim Pollozhani, analisti politik dhe publicisti i njohur Beqir Berisha, Elmaz Ademi dhe shumë veprimtarë të tjerë. Janë ata burra që e lanë Zvicrën si Elmazi, i cili kurrë nuk pushoi së vepruari nëpër fshatra e qytete, duke e ndihmuar luftën. Por, a ka ironi më të madhe dhe diçka më tragjike kur fatet e kësaj lufte dhe politikën e Shtabit të UÇK-së në Tetovë i shtiu në dorë Arbën Xhaferi?!

* * *

Lexuesve dua t´ua përkujtoj edhe një fakt: Arbën Xhafersoni kur erdhi nga Kosova në Tetovë, ishte i papunë. Pas një kohe të caktuar, me t'u angazhuar me devotshmëri si politikan besnik i shtetit maqedonas, u shpërblye nga punëdhënësit antishqiptarë dhe për një kohë të shkurtër u bë milioner.

Ishin Arbën Xhaferi, Ymer Ymeri i PPD-së dhe të tjerë si këta, që e bënë Marrëveshjen e Ohrit. Punë skandaloze që ia panë sherrin të gjithë shqiptarët. Sot e kësaj dite Ali Ahmeti, me papërgjegjësi të plotë deklaron me këmbëngulje se "Marrëveshja e Ohrit" po realizohet. Nga kjo rezulton se ai, pa pikë turpi as përgjegjësie politike dhe ushtarake, tanimë e ka pranuar kapitullimin. Ali Ahmeti ishte komandant vetëm si figurë, si një dekor i mjerë, në dramën e historisë sonë tragjike, pas takimit famëkeq në Prizren, kur ndërmjetësues ishte Fatos Nano, nëpërmjet Koço Danajt.

Dhe për fundi, qofsha i gabuar për këtë shkrim, në të cilin dëshmova me sinqeritet dhe vërtetësi.

SI U FESTUA 25 VJETORI I THEMELIMIT TË RADIOS 'ZËRI I KOSOVËS' NË KOPENHAGË

Më 30.11.2014 në Balerup (në periferi të Kopenhagës) u mbajt një manifestim kushtuar 25-vjetorit të themelimit të radios së pavarur shqipe. E patëm emëruar ”Radio Zëri i Kosovës”. Në këtë manifestim u kryen - siç thotë një fjalë e urtë popullore - Një udhë e dy punë”, u festua edhe “28 Nëntori” - Dita e Flamurit, por për habi e turp, jo edhe “29 Nëntori“ - dita e çlirimit të shtetit amë nga nazi-fashizmi. Pra, 70-vjetori i çlirimit të Shqipërisë, u anashkalua. Ky anashkalim ndodhi përkundër faktit se organizatori ka qenë një ish i burgosur politik, ish-kryetar, e më vonë edhe sekretar i LPK-së, një ish marksist-leninist i veprimtarisë ilegale në Kosovë, ish-veprimtar i UÇK-së famëmadhe, ish-aktivist dhe anëtar i Kryesisë ”Atdheu në rrezik“. I njëjti tani, nga “Vendlindja thërret”, është konvertuar në një fanatik radikal të Partisë Demokratike të Kosovës, e cila qe disa vite është në pushtet.

Në këtë përvjetor ishin ftuar një numër i konsiderueshëm mysafirësh. Manifestimi ishte begatuar edhe me një program të pasur kulturor-artistik të një grupi prej Suedie dhe të Shoqërisë “Zejnel Hasani” nga Balerupi.

Ishin ftuar shumë mysafirë nga Kosova. Midis tyre edhe simboli i qëndresës sonë kombëtare - Adem Demaçi, ministri i Integrimeve Ibrahim Makolli, zëvendësministri i Kulturës Hajdin Abazi, ekipi i Radio-Televizionit të Kosovës me Nuhi Bytyqin dhe Shaban Arifajn, këngëtari dhe veprimtari Ismet Bexheti nga Shkupi, Memet Latifi nga Struga si dhe gazetarë nga Stokholmi dhe Goteborgu etj. Ka pasur edhe të ftuar të tjerë, por nuk mund t´i përmendi të gjithë.

Pamje nga tubimi: Adem Demaçi, Ibish Neziri, Hajdin Abazi…

Për fat të keq, organizatori kryesor - zoti Ibrahim Xhemali, kishte "harruar" t'i ftonte personat kryesorë të cilët e kishin themeluar, përkatësisht e kishin hapur radion e sipërthënë - Xhemil Zeqirin dhe Jorgen Pedersenin. A thua vallë përse?! Mbase pse nuk i përkasin Partisë Demokratike! Zoti Pedersen është kryetar i Partisë Komuniste Daneze, ndërsa Xhemil Zeqiri është veprimtar i Lëvizjes Vetëvendosje në Danimarkë.

Duhet shtuar se mua më bëri një ftesë kryetari i Shoqatës së miqësisë Danimarkë-Shqipëri. Edhe një mik imi personal disa herë më pati bërë thirrje me telefon, por unë iu përgjigja se nuk dua të vij pa thirrje zyrtare nga organizatorët.

"Ftesë të dërgoj unë, pra shkojmë bashkë... Vjen edhe Demaçi" - më tha miku Tue Magnussen.

"E di se vjen edhe ai. Para ca ditësh fola me Bacën Adem dhe më tregoi se do të vinte në Kopenhagë, ngase e kishte thirrur Ibrahim Xhemali për përvjetorin e themelimit të Radios dhe shtoi se do të shihemi këtu. Edhe këtij miku i thashë se pa thirrjen e tyre nuk dua të vij. Madje as me shëndet nuk ndjehem mirë" - ia ktheva unë.

Tri ditë më herët më telefonoi një gazetar i së përditshmes "Politiken" - Henrik Kaufoltz. Më tha se shpresonte të shiheshim atje.

Henrikut, këtij miku të shqiptarëve që e ka sensibilizuar opinionin me shkrimet e veta lidhur me situatën e shqiptarëve në

Ballkan, që ka mbajtur kurdoherë një qëndrim tejet parimor dhe bindjet e të cilit përputhen me të miat, pra këtij miku të sinqertë të popullit tonë, nuk munda t´ia prishi. “Po, po. Shihemi...” - i thashë.

Unë e paramendoja krejt ndryshe atë mbrëmje, pasi që ardhjen e tyre e kishin konfirmuar më parë, disa figura daneze - prominente dhe shumë të njohura. Pandehja të kishte një rend dhe agjendë ngase danezët ishin të interesuar të bisedonin me Bacën Adem. Tek e fundit ata, si shumë shqiptarë të tjerë, vinin pikërisht për të. Por, u dëshpërova dhe u zhgënjeva. Një organizim kaq të dobët, kurrë s’kisha parë në Perëndim.

Kur shkova, u përshëndeta me Henrikun. Ai më tha: “Ja tek qenka Demaçi ...”. U ngritëm nga vendet ku ishim ulur dhe iu afruam për ta përshëndetur. Rreth e rrotull tij ishin ca “mic sokola”. As që lëvritën pak për t’i bërë një vend mikut tonë Erikut.

Erikun e njihnin mirë, pasi ai, në vitin 1992, në banesën time kishte biseduar me redaktorin e Agjencisë Telegrafike Daneze, Kim Ammloj. U ndjeva ngushtë për gazetarin, jo për veten, ngase e dija se me ç´njerëz kam të bëj. U ulëm në tavolinën ku ishin Nuhi Bytyqi, Mehmet Latifi, Shaban Arifaj dhe një veprimtar i radios, i cili, në një kohë kur ishte tepër e rrezikshme, i përpunonte lajmet kryesore në gjuhën daneze dhe i lexonte në Radio. Bedri M. shkonte edhe në vendlindje, pikërisht në periudhat kur veprimtarëve të kauzës sonë u kanosej rreziku më i madh. Disa herë e ka ndaluar policia maqedonase, duke i bërë lloj-lloj presionesh.

Pas disa pikave të programit që kishin përgatitur, iu dha fjala - radhazi - edhe mysafirëve. Ibish Neziri i ardhur nga Zvicra e bëri një retrospektivë të veprimtarisë së Radios, pasi për disa vite ka qenë dhe korrespodent i saj. Ai përmendi shumë persona që kishin kontribuar për themelimin e Radios si dhe për mbarëvajtjen e punës së saj. Nuk më kujtohen saktë të gjitha që i tha. Ceku se Radioja u hap me ndihmën e ***“Komitetit Miqtë e Kosovës”*** dhe të Mina S. Jensen. Në këtë eveniment qe e pranishme edhe Mina. Meqë e kupton gjuhën shqipe, mbeti disi e habitur dhe i erdhi interesant kur iu përmend emri. Filloi të qeshë sepse nuk dinte se kush në fakt e

kishte hapur Radion. Edhe kjo, njësoj si Henriku, ishte mjaft e interesuar të bisedonte me Demaçin.

Veprimtari Ibish Neziri, flet për themelimin dhe rolin e radios "Zëri i Kosovës", në ndërkombëtarizimin e çështjes sonë kombëtare

Paramendoni! Unë themeluesi, që ende jam gjallë - nuk përmendem fare, anashkalohem dhe injorohem, ngase dikush i shtrembëron faktet e së kaluarës dhe e falsifikon historinë. Po ç'të themi për një ngjarje historike që ka ndodhur para 70 vjetësh, me të cilën sot, në emër të demokracisë, lugetërit falsifikues po tallen në mënyrë të paskrupullt!

Fillova te nervozohem, por nuk mund të flisja, sepse në tavolinë ishte miku ynë, Henriku. Megjithëkëtë, herë-herë lëshoja ndonjë kritikë në adresë të organizatorëve. Para se të fillonte manifestimi, disa herë ishin bërë ushtrime dhe prova për ekzekutimin himnit. Papritmas, Shaban Arifaj më tha, nëse ka mundësi t´u them atyre të mos tallen me himnin kombëtar.

"Jo - i thash - këtu përurohen antivlerat dhe do shohim sesi do të kalojmë deri në fund. Ky zotëria - I. Xhemaili, që prej vitit 1990 e këndej, nja 100 herë ka thënë se nuk do të merret më me aktivitete, por ja, përsëri ka dëshirë të jetë në qendër të vëmendjes! Unë nuk kam ardhur për këta, por për mikun tonë danez, Henrik Kaufoltz-in, i cili dukej si i katandisur në një ambient grotesk ku mbizotëronte një atmosferë bizare. As pije nuk kishte për festë. Një birrë apo ndonjë gotë me alkool. Në një tavolinë kishin vendosur një arkë me lëngje në shishe plastike, kafenë ndërkaq, të pranishmit duhej të shkonin ta paguanin vetë. Natyrisht, ai nuk ndenji gjatë. Tha se është i zënë, se i ka do punë. U përshëndet dhe iku.

Derisa mysafirët flisnin në tribunë, asnjërit prej organizatorëve nuk i shkoi ndërmend të më përmend mua, përkatësisht kontributin tim shumëvjeçar!! Vetëm Hajdin Abazi e përmendi emrin tim, duke më thënë më vonë: "Nuk mundja pa të përmendur". Qesha dhe fillova t'i them se ky është një turp i madh, një padrejtësi, veprim

jokorrekt, akt i panjerëzishëm dhe shtrembërim faktesh. Këta s'dinë dot gjë për Radion, por është Jorni... "E di, e di - ma ktheu - por..."

Në rregull, në rregull, e përmendën edhe Nis Herik Hogon, vullnetarin dhe luftëtarin e UÇK-së. Herë-herë kishte edhe duartrokitje, por për ushtarin me tepër. Shaban Arifajt dhe Nuhi Bytyqit u them se ky ushtar është rekrutuar tek unë. Unë e mora në shtëpi, u përgatit dhe pas disa ditësh, duke i dhënë edhe informata të nevojshme, e dërgova edhe në TV-2. Realizuan një emision për të shpjeguar përse ushtari Nisi dëshironte të shkojë vullnetar në luftë në Kosovë. Pati një intervistë edhe në Radio, por edhe në një gazetë. Unë dëshiroja që UÇK-ja të ketë edhe ushtarë danezë, në mënyrë që lufta kundër armiqve serbë të ndërkombëtarizohej sa më shumë. Por edhe për qëllime propagandistike në mediumet e tyre, duke përfshirë edhe qarqet diplomatike. Ia pagova edhe rrugën për në Tiranë.

I habitur, Shaban Arifaj më pyeti, për ç'arsye nuk më përmendin fare?! Përse e injorojnë veprimtarinë time të pakursyer?!

"Eh, nuk jam në PDK që të më përmendin. Nuk më përmendin ngase kam një bagazh të madh me aktivitete, jo vetëm në Danimarkë, por në mbarë Evropën. Kam zhvilluar aktivitete, si në mediume, ashtu edhe në qarqet diplomatike". Kam organizuar 2 konferenca ballkanike dhe disa debate publike. Baca Adem, derisa ishte në burg, qendra daneze PEN e shpalli anëtar nderi. Pastaj, kjo mikja jonë që u përmend më lart, ka qenë kryetare e Komitetit. Ajo nuk di gjë për Radion që e kam hapur unë dhe sekretari i Partisë Komuniste Daneze Jorgen Pederseni. Gruaja e tij Mariane Perderseni ka qenë kryetare e Miqësisë Danimarkë-Shqipëri. Lotte Rdof Madseni është një albanologe e cila të gjitha materialet i ka përkthyer pa lekë. Këta janë miq të përbetuar të kombit shqiptar. Por sot anashkalohen dhe shpërfillen vetëm për faktin se janë komunistë.

Si kanë rrjedhur punët, e di edhe Ibrahim Kelmendi. Disa herë i pata thënë atij të gjejmë ndonjë person që është i profilit të gazetarisë, në mënyrë që të hapim një Radio. Mundësitë i kishim. Ibra disa herë më ka premtuar. Pas ca vitesh na e dërguan Ibrahimin dhe Eminen. Vepruam shpejt, nuk u vonuam shumë. Brenda një

muaji projekti u realizua, sepse në fillim ata ishin nën arrest. Menjëherë nisa ta sendërtoj premtimin. Fillova ta realizoj punën.

I them Jonit: *"Tani kemi një kuadër gazetarësh dhe duhet sa më shpejt ta themelojmë Radion, ta përhapim propagandën e Komitetit dhe të LPK-së".* Ai ma ktheu: *"Eh shumë mirë. Kemi një seminar jashtë qytetit të Odenses. Të vini atje, do t'ua japim fjalën që të jemi më të lirë si dhe të sigurojmë përkrahje për Radion edhe nga persona të tjerë".*Po si nuk i shkon mendja ndonjërit prej tyre?! Si u bë që ky farë burri, sa erdhi u bë edhe redaktor?

Përkundër faktit që disa spurdhjakë shqipfolës në Danimarkë, po përpiqen ta nënvlerësojnë punën atdhetare mbi 30-vjeçare të Xhemil Zeqirit, miqtë e vërtetë danezë janë ata të cilët, pa komplekse të natyrave të ndryshme ideologjike, partiake e të tjera, e nxjerrin në dritë veprimtarinë e tij. Ja se ç'ka shkruar këto ditë gazeta daneze "Politika", e datës 26 tetor 2014.

Henrik Kaufoltz është një gazetar me autoritet në Danimarkë. Në një artikull të gjatë të cilën e boton lidhur me padrejtësitë që i bëhen veprimtarit Xhemil Zeqiri nga komuna e Kopenhagës, ndërmjet tjerash nënvizon edhe këtë:

"Përfaqesues i shqiptarëve në Danimarkë. Në pamje të parë duket si një histori e zakonshme e një refugjati nga Ballkani që përfundon si shofer taksie. Por e kaluara e Xhemil Zeqirit është epazakonshme. Për vite me radhë, e veçanërisht në vitet ´90, ai ishte personi kryesor i asaj që mund të quhej një fushatë shqiptare. Ai ka agjituar në mënyrë të palodhur për pavarësinë e Kosovës, për të drejtat e etnitetit shqiptar në Maqedoni dhe për ta bërë Shqipërinë pjesë të Evropës, pas përfundimit të atij izolimi të gjatë të vendit në një lloj të veçantë diktature.

Me ndërmjetësinë e tij, gazetarë, zyrtarë, studiues të shoqërisë dhe politikanë danezë kanë pasur mundësinë t'i takojnë aktorët kryesorë të ngjarjeve në të gjitha territoret shqiptare në Ballkan dhe ai ka ndihmuar me përkthyes edhe takimet kur danezët kanë kërkuar të orientohen në vendin ku ndodheshin, pa marrë parasysh nëse ishte fjala për Tiranën, Tetovën apo Prishtinën."

LËVIZJA VETEVENDOSJE PO I DEMASKON FUQISHËM PLANET E SERBISË DHE TË TITSTËVE SHQIPFOLËS

Krijesa artificiale me emrin Federata Jugosllave u shkatërrua dalëngadalë prej vitit 1990 dhe këtu nuk ka dyshim se shqiptaret në këtë federatë antishqiptare luajtën një rol vendimtar.

Federata ka qenë një ferr për popullin shqiptar. Pas krimit, territoret shqiptare u sakatuan shumë keq. Të kujtojmë krijimin e Republikës së Maqedonisë që në fakt u krijua si republikë serbe me mbi gjysmën e territoreve shqiptare. Mali i Zi me disa komuna dhe Malësinë e Madhe, edhe kjo një republikë serbe. Diku nga mesi i viteve '50, Serbia i copëtoi edhe njëherë trojet shqiptare duke marrë edhe Luginën e Preshevës, Medvegjën e vise të tjera. Dhe këto copëtime i bëri herë me "dialog" e herë me dhunë, pra duke shtypur popullin shqiptar me hekur e barot. Këto padrejtësi tani dihen si nga opinioni kombëtar po ashtu edhe nga ai ndërkombëtar. Republika e Maqedonisë luajti një rol tejet antishqiptar, jo vetëm për popullin autokton në territorin e republikës së krijuar Maqedoni, por edhe ndaj shqiptarëve të Kosovës që hoqën të zinjtë e ullirit nga shtypja dhe terrori serbo-sllav. E vetmja rrugëdalje ishte që nëpërmjet Maqedonisë, shqiptarët prej Kosove dhe viseve të tjera, të shpërngulen duke i rregulluar dokumentet për në Turqi, duke pranuar të ndërrojnë identitetin dhe emrat, prej shqiptarë në turq dhe të kalojnë në Turqi. Kështu kishin rënë dakord dhe kishin bërë marrëveshje qeveria serbe, gjegjësisht jugosllave me qeverinë turke. Po ashtu, nga shovinistët grekë dhuna u shtri edhe mbi shqiptarët e Çamërisë. Pas Luftës së Dytë Botërore, duke i akuzuar shqiptarët autoktonë në Çamëri se ishin bashkëpunëtorë të fashizmit dhe nazizmit, bënin spastrime të mëdha.

Shqipëria, e dalë pas lufte e shkatërruar dhe e lodhur, për më keq, deri në vitet '60 u përball me grupe diversantësh, të prirë nga sëmurje bajraktariste, të etur për rikthimin e pushtetit profashist, të

nxitur nga fqinjët armiq: Serbia, Greqia, Italia dhe nga qarqe të tjera antishqiptare të cilat nuk dëshironin që Shqipëria të forcohej dhe të përparonte në rrugën e lirisë. Në anën tjetër, kishte presione të mëdha nga ish-aleatët anglo-amerikanë, e vonë edhe nga rusët dhe kinezët, që Shqipëria të futet në Federatën që në atë kohë ishte ferr për shqiptarët dhe të mbyllte gojën e të mos e mbronte popullin e ndarë padrejtësisht nga fuqitë e mëdha, qysh në vitin famëkeq 1913. Edhe në konferencat ndërkombëtare gjatë Luftës së Dytë Botërore, ishin marrë vesh se kufijtë nuk do të ndryshojnë, përpos në rast të marrëveshjeve!? Këtu grupet reaksionare zogiste e balliste e manipulonin për një kohë të gjatë popullin. Dorën ne zemër, propagandën e gatshme e kishin nga Serbia që të luftonin shtetin shqiptar, se ja Shqipëria nuk do bashkim kombëtar e gënjeshtra zoriste, e të tjera, që lexuesit i kanë dëgjuar me mijëra herë. Shqipëria e ndodhur në shumë zjarre dhe rreziqe nga brenda dhe nga jashtë, nuk pati rrugë tjetër vetëm t`i përvishet punës dhe luftës ndaj armiqve të brendshëm dhe të jashtëm, duke e forcuar shtetin dhe ushtrinë, që në momentin e përshtatshëm t`i merrte me luftë çlirimtare trojet shqiptare. Momenti i përshtatshëm erdhi në vitin 1989-90. Por atëherë nuk ishte më në ballë të popullit dhe të ushtrisë shqiptare strategu i luftës dhe i paqes, i madhi Enver Hoxha. Komandën e shtetit dhe të ushtrisë e mori Ramiz Alia. Në atë kohë ndodhën edhe ndryshimet e mëdha në bllokun socialist. Ekonomia shqiptare kishte tregti të madhe me këto shtete. Natyrisht, çdo shtet bën marrëveshje reciproke, pasi shtetet e Perëndimit, nën udhëheqjen amerikane, e izolonin Shqipërinë me qëllim që të futet në federatë, nën tutelën e ish-Jugosllavisë. Pikërisht kjo ishte ajo që Shqipërinë e izoluan dhe pastaj thoshin: Shqipëria me politikën e saj, u vetizolua. Duhet rikujtuar se në vitin 1989 Ibrahim Rugova me grupin titist që ishin vegla pro-serbe, e projektuan një politikë "paqësore" pro-serbe. Kjo politikë u forcua edhe me ndikimin e dhëndrit serb Lorenc Igëlberger, ish-ambasadori amerikan në Beograd. Më vonë u bë edhe ministër i Jashtëm amerikan.

Këta krijuan grupin apo partinë e parë "demokratike". Si alternativë, frerët e kësaj partie ia dhanë në duar një dhëndri sllav me emrin Sali Ramë Berisha që kishte qenë sekretar i parë i shëndetësisë në Shqipëri, gjatë viteve të socializmit. Për çudi, si mundi t'i bashkojë të gjithë ata "demokratë" me atë propagandë të rrezikshme, sa që Shqipërinë ta shkatërrojnë nga themelet, duke trumbetuar kinse Enver Hoxha ka krijuar armiq. Ndërkaq ne, Shqipërinë do ta bëjmë si Zvicra, e të tjera gjepura politike. Kjo parti e shkatërroi çështjen shqiptare, si në aspektin ekonomik dhe politik, ashtu edhe në atë moral etj. Kjo parti bëri përçarje të mëdha në organizimin gjithëkombëtar, sa që një përçarje të tillë s'kishin arritur të bënin ndër shqiptarë të gjithë armiqtë e shqiptarëve.

Berisha dhe Rugova me këto grupe titiste dhe ballisto-zogiste, Shqipërinë e përmbysën. Sipas tyre, vetëm përmbysja e Shqipërisë do të sjellë stabilitet ne Ballkan. Kësisoj ata e realizonin ëndrrën e madhe të armiqve tanë. Pra, ishte e qartë se lobi serb në Evropë dhe në Amerikë dhe politika nacional-shoviniste serbe i përkrahën dy partitë më të "mëdha" në Shqipëri e Kosovë: PD-në dhe LDK-në, gjegjësisht Sali Ramë Berishën dhe Ibrahim Ukë Rugovën. Pikërisht këta vegla serbe kanë përkrahje të madhe nga qarqet antishqiptare në Evropë dhe në botë, sepse ishin dhe janë ata që po ndjekin një politikë antishqiptare. Kjo është parë qartë dhe po shihet për çdo ditë, si me proceset e demokracisë në përgjithësi, ashtu edhe me procesin e bisedimeve me xhelatët serbë, që në fakt nuk kanë sjellë kurrfarë ndryshimesh. Qysh para luftës ata ndiqnin një politikë antishqiptare. Këto bisedime e kanë ulur shumë "pazarin" e çështjes shqiptare, sepse janë krijuar kufij të ri, janë bërë dhe po bëhen copëtime të reja në emër të decentralizimit në territoret etnike shqiptare.

Grupi i "elefantëve" dhe i minjve në Kosovë, me zëdhënësin e "elefantëve", Lutfi Hazirin dhe kompaninë, janë duke e shkatërruar çështjen shqiptare si mos më keq. Grupi i "elefantëve" titistë, d.m.th. rugovistët, janë duke e treguar mirë fytyrën e vet edhe në debatet, që thuajse fare nuk ekzistojnë. Pra titistët vazhdojnë vallen e dreqit duke e sakatuar çështjen shqiptare. Shqetëson fakti se edhe

ish-luftëtaret që formuan parti, tani janë bërë satelitë të LDK-së. Me apo pa vetëdije, apo thjesht për interesat e tyre meskine, u bënë shërbëtorë të titistëve dhe në fakt po e vallëzojnë vallen serbe, me imponim dhe nëpërmjet lobit serb në Evropë dhe Amerikë.

Është tejet befasuese dhe njëkohësisht tepër tragjike kur para pak kohësh Hashim Thaçi në përkujtimin e përvjetorit të rënies së komandant Ismet Jasharit - "Kumanovës", para masës deklaron se ne, d.m.th. UÇK-ja, e bëmë luftën, e bëmë marrëveshjen e Rambujesë dhe Rezolutën 1244 etj., duke deklaruar me pompozitet: "Jam krenar që e kam nënshkruar marrëveshjen e Rambujesë - Parisit, me ndihmën e komunitetit ndërkombëtar dhe e çliruam Kosovën". Mirëpo ai duhet ta dijë se komuniteti ndërkombëtar ishte nën ndikimin e lobit serb.

Ndërsa njërit prej komandantëve të luftës që ishte më këmbëngulësi që Kosova të shpallet e pavarur nga të deleguarit legjitimë të Kuvendit të Kosovës, siç mendonte ish-komandant "Çeliku" - Fatmir Limaj, agjenturat serbe dhe titiste i ngritën akuzë në gjykatën e Hagës. Fatmiri qëndroi heroikisht para gjykatës së Hagës (lobit serb) por, që kur është nënkryetar i Partisë, edhe ky deklaron në mënyrë shumë demagogjike: "Ne shqiptarët e bëmë luftën. Ne që nuk kishim të drejta para lufte, i fituam. Dhe tani jemi bërë faktor dhe tani prej nesh serbët kërkojnë të drejta". Kjo deklaratë foshnjore politike njerëzve të mençur u shkakton të qeshura!

Sa tingëllon kjo retorikë qesharake, kur njerëzit e dëgjojnë këtë demagogji politike. Nuk i ka hije komandant Çelikut kjo demagogji dhe nuk dua të besoj se ai nuk e kupton pozitën e mjerë që kanë shqiptarët, jo vetëm në Kosovë por në Ballkan në përgjithësi. Atje në Shqipërinë e mjerë, Sali Berisha me kompaninë balliste-zogiste po bën kërdi, duke i kënaqur orekset shoviniste serbe dhe lojën titiste të LDK-së. Gati se Shqipëria është duke mbetur "një shprehje gjeografike" siç ka deklaruar dikur Bizmarku gjerman. Shqipëria po e humb çdo ditë edhe atë pavarësi që u fitua me aq mund e sakrifica gjatë shumë dekadash.

Po ashtu e kemi edhe rastin e Ramush Haradinajt. Edhe ky, njësoj si Fatmir Limaj, u lirua me kusht nga burgu i gjykatës së Hagës, ose më saktë nga lobi serb dhe kjo vërteton se në gjykatën e Hagës nuk dënohen krimet dhe kriminelët, por pavarësia reale e Kosovës.

Pasqyrimin më të mirë mund ta shohim në parapëlqimin e organeve kukulla të lobit serb në Kosovë, SH.P.K. e cila po reagon aq ashpër ndaj atyre që kërkojnë pavarësi të plotë, reale ose të drejtën për vetëvendosje, ***Lëvizjen për vetëvendosje*** të udhëhequr nga kreshniku i Kosovës, shqiptari Albin Kurti.

Kjo që thashë më lart është një e vërtetë e hidhur sesi titistët pro-serbë, në njërën anë dhe presioni i lobit serb, që ne e kuptojmë si politikë të komunitetit ndërkombëtar, në anën tjetër, kanë hasur në rezistencë të vendosur popullore dhe kjo rezistencë dita-ditës do rritet më tej.

Tani ka filluar një etapë e re e demaskimit të planeve armike në bashkëpunim me hienat e tradhtisë! Prandaj populli nuk duhet të mashtrohet nga të ashtuquajturit "elefantë" të cilët në fakt janë kthyer në minj që po përpiqen ta brejnë ardhmërinë e trojeve etnike shqiptare. Ata përpiqen t´i hedhin hi syve të popullit dhe ta riburgosin me atë pavarësi të kushtëzuar, që nuk është asgjë tjetër përveç se autonomi substanciale, që e kanë nënshkruar pehlivanët politikë në Rambuje dhe në Paris.

Xhemil Zeqiri

Kopenhagë, 05.09.2006

JA PSE U VRA LUFTËTARI I LIRISË ENVER ADEMI!

Ç´po po ndodh tani me luftëtarët e lirisë?!

Pak ditë pas vrasjes së Xhavit Morinës, të njohur me nofkën "Komandant Drenica" në fshatin Odri të Tetovës, filloi sulmi në fshatin Brodec të malësisë së këtij qyteti.

Me atë rast u vranë 6 persona dhe mbi 13 u arrestuan. Pas kësaj lufte titanike, zëvendësministri i Punëve të Brendshme të Maqedonisë - Refet Elmazi, e cilësoi operacionin ushtarako-policor si të suksesshëm.

Për çfarë suksesi mund të flitet vallë në këtë aksion mizor të forcave militare të një shteti, në të cilin për shqiptarët nuk vlejnë as ligjet ndërkombëtare?!

Si ka mundësi që zëvendësministri Refet Elmazi të deklarojë se operacioni është i suksesshëm, kur dihet se në Maqedoni është qetë, ndaj nuk ka arsye të ekzekutohen njerëzit e pafajshëm, qofshin këta edhe kriminelë. Për fajësinë vendos gjykata dhe jo forcat e armatosura.

Tragjedia në Brodec është një histori në vete pasi atje disa ish-ushtarë të UÇK-së nuk pranuan t'i dorëzohen policisë maqedonase që të masakrohen siç ndodhi pak kohë më parë me Xhavit Morinën në fshatin Odri të Tetovës. Madje atje pati edhe rezistencë dhe si pasojë, u vranë 4 ushtarë dhe dy civilë, ndërsa 16 banorë të fshatit Brodec u arrestuan. Të arrestuarit u torturuan dhe u trajtuan si robër lufte, bile dhe më zi. Me një fjalë, kjo ishte një luftë e vërtetë.

Duhet shtuar se javën e kaluar u dëgjua se në malet e Ferizajt është gjetur një kufomë e masakruar aq barbarisht saqë askush nuk ka mundur ta njohë. Kufoma e gjetur ishte e Enver Ademit, një burrë mbi 60 vjeç nga fshati Sllatinë i Tetovës, i cili kishte punuar shumë vite punëtor në Leverkuzen të Gjermanisë.

Enver Ademi paska qenë i pranishëm kur është vrarë dhe është masakruar Xhavit Morina. Duke qenë se ishin shokë dhe bashkëluftëtarë, ka mundësi që Enver Ademi t'i ketë ditur rrethanat e vrasjes së Xhavit Morinës.

Enver Ademi ka punuar mbi 40 vjet në Gjermani dhe si aktivist i Lëvizjes Popullore të Kosovës, ka qenë pjesëmarrës i rregullt në demonstratat që organizoheshin në Evropë për sensibilizimin e çështjes shqiptare. E ka ndihmuar luftën me të gjitha mënyrat, po ashtu dhe me mjete financiare. Ai mori pjesë personalisht në luftën e vitit 2001 në Maqedoni.

Enver Ademi, ky veteran i luftës për liri, nuk u pajtua kurrë me Marrëveshjen e Ohrit dhe nuk pranoi të çarmatoset.

Pas disa vitesh, duke ardhur nga Gjermania, në Glloboçicë ku ndodhet kufiri midis Kosovës dhe Maqedonisë, policia e arreston. Shpejt u mobilizuan shokët e luftës, i bllokojnë rrugët dhe sakaq lirohet. Por javën e kaluar Enver Ademin nuk kishte kush ta mbronte. Ai masakrohet mizorisht, saqë kufomën e tij të ndritur prej luftëtari të pathyeshëm, mezi e njohën familjarët e tij.

Ka shumë pyetje enigmatike që na bëjnë të dyshojmë si dhe përse u vra Enver Ademi? Mos vallë u vra se ai i ka ditur rrethanat e vrasjes së Xhavit Morinës dhe për t´i humbur gjurmët, vrasësit e vranë edhe shokun e tij?!

Mos vallë ai u vra nga përkrahësit e "pavarësisë së kushtëzuar", prej atyre që duan të mos prishet plani famëkeq i kësaj "pavarësie" mashtruese!

Xhemil Zeqiri

Kopenhagë më Datë 16-12-2007

SPEKULANTËT FETARË PO MANIPULOJNË ME ÇËSHTJEN SHQIPTARE!

Komuniteti shqiptar në Danimarkë, shumica të ardhur nga fshatrat e Tetovës, përbëjnë shumicën absolute në Danimarkë. Si shqiptarë atdhetarë, kanë kontribuar shumë në sensibilizimin e çështjes shqiptare, të kauzës së Kosovës si dhe në të gjitha viset shqiptare të okupuara nga ish-Jugosllavia. Pra kërkesave të drejta që shqiptarët të jenë të barabartë në federatën ose në konfederatën jugosllave, që shqiptarët të kenë të drejtë për vetëvendosje.

Ajo ishte tepër aktive dhe e bashkuar deri në vitet ’90 të shekullit XX, kur erdhën në skenën politike partitë dhe partizat të ndihmuara nga institucionet sllave, d.m.th. kur u formuan partitë politike dhe shërbëtorë të shumtë dolën haptas dhe filluan të punojnë në emër të partisë. Në këtë mënyrë filluan ta çorientojnë popullin dhe kërkesat popullore që ishin të ngulitura te bashkatdhetarët tanë, kudo nëpër botë.

Danimarka dhe protestat myslimane

Që kur shkrimtari indian Selman Ruzhdi doli me librin e tij kundër profetit Muhamed, intelektualët danezë dhe shtëpitë botuese, ndër më të parët në botë, atij i dhanë një përkrahje të madhe morale dhe politike.

Më vonë një piktor danez në gazetën qeveritare daneze “JylandPosten” i paraqiti ca piktura fyese ndaj profetit Muhamed. Me këtë rast, komuniteti arab dhe myslimanët në përgjithësi filluan protesta të mëdha, jo vetëm në Danimarkë por edhe në të gjitha shtetet arabe. Shqiptarët, të njohur në botë si një komb me tri fe nuk i përkrahën demonstratat e tyre fundamentaliste dhe kjo ishte edhe një shenjë shumë pozitive në favor të përkrahjes së mëtejshme të kauzës sonë kombëtare.

Mjerisht, kohët e fundit ky imazh pozitiv për ne, me keqardhje duhet të themi të vërtetën, rrezikohet të prishet. Një grup shqiptarësh, të prirë nga një ish-profesor i shkollës së tekstilit në Tetovë, njëfarë Llukman Ferati nga fshati Odri i Tetovës, i cili qe disa vite punon dhe banon në Kopenhagë të Danimarkës, ka filluar një aksion me hapa shumë të rrezikshëm kundër çështjes shqiptare. Duke vepruar kësisoj, me apo pa vetëdije, u japin rast fashistëve serbë dhe miqve të tyre, të ngrenë akuza të tilla, siç ishin disa debate në mediumet daneze kur parlamentari i Partisë Popullore Daneze doli kundër pavarësisë së Kosovës, duke i quajtur shqiptarët myslimanë dhe duke shtuar se Evropa nuk duhet të lejojë një shtet mysliman në Evropë.

Kësaj propagande kundër-shqiptare po i ndihmon tanimë edhe profesori i lartpërmendur i cili ka filluar të shpërndajnë çeqe për ndërtimin e një "xhamie qendrore të shqiptarëve në Danimarkë." Disa ditë më parë u mundova t'ia sqaroj atij dhe ithtarëve të tij pasojat e këtij veprimi. U përpoqa të ndikoj që të paktën të mos përmendet sintagma "xhami shqiptare", sepse kjo po e dëmton fort çështjen tonë kudo në trojet shqiptare, sepse tani po kalojmë nëpër një situatë tepër të rëndë dhe shumë delikate. Me një fjalë, fare nuk kemi arsye t'i dalim zjarrit përpara. Le të shpërndahen ato çeqe nga një shoqatë kulturore dhe ato 9 milionë korona daneze do të mund të mblidheshin duke mos e penguar fare çështjen kombëtare.

Pasi kjo farë pavarësie e kushtëzuar e Kosovës nuk është ajo që ka synuar kombi shqiptar. Kemi edhe çështje të tjera të pazgjidhura, ndaj kur është çështja jonë në pyetje, bota i mban sytë nga ne, për të mësuar se kush jemi, ç'bëjmë dhe kë përkrahim.

- Jo! - M´u përgjigj ai! - E quajmë xhami shqiptare, sepse duhet të dihet se është xhami shqiptare!

Dhe vijoi: Çështjen kombëtare e shkatërruan politikanët e tipave Ali Ahmeti dhe Menduh Thaçi. Tani së paku ta mbajmë fenë e të mos e humbim. Na morën në qafë edhe personat e tipit të Abdilhalim Kasamit, e të tjerë. Ky i fundit ishte i zhytur në borxhe dhe pasi u emërua zëdhënës politik, ne i ndihmuam UÇK-së dhe jo

atij që sot i ka keqpërdorur paratë tona, sepse me paratë tona që i vodhi, ai ka blerë një shtëpi luksoze në Kopenhagë, e cila i ka kushtuar hiç më pak se 5 milionë korona daneze! Pra, xhamia na duhet në Danimarkë!

Pastaj këta danezët - shtoi ai – i kanë nënshkruar edhe konventat ndërkombëtare ku thuhet se duhet të respektohen fetë!

Mos mor zotëri kështu! – ia ktheva unë. - As arabët, as turqit dhe askush tjetër nuk e kanë emëruar objektin e tyre si xhami, por i cilësojnë si qendra kulturore fetare dhe aty zhvillohen të gjitha ceremonitë fetare që i takojnë një xhamie.

Ju duhet të kuptoni se ç'luftë është duke u bërë ndaj fanatizmit mysliman. Ka rrezik që t'ju thonë se e merrni në mbrojtje fanatizmin! Dijeni mirë se ai farë kryetari Llukman Ferati po e dëmton çështjen në përgjithësi dhe duhet të dini se mban përgjegjësi!

Pra Llukman Ferati e ka manipuluar një grup të vogël të mërgimtarëve tanë përtej mase dhe është shumë vështirë të paramendohen pasojat në të ardhmen. As vetë arabët nuk i kanë emërtuar xhamitë, por kanë institucion kulturor në Danimarkë ku zhvillohen edhe ceremonitë fetare, siç janë ato mortore e të tjera.

Kopenhagë, më 17 mars 2008

MAQEDONIA SHTYPUR PAKICËN SHQIPTARE

Historikisht, në Maqedoni, në shekuj kanë jetuar shumë kombësive brenda kufijve të tanishëm të saj dhe historikisht Ballkanit ka qenë quajtur "fuçi baruti", sepse e gjithë zona është një mozaik kombësish. Kufijtë janë përcaktuar nga fuqitë e mëdha, me një sundimtar, i cili ka krijuar pakica të mëdha kombëtare në shumë vende.

Shpesh në histori ka qenë fatale për popujt në Ballkan, kur fuqitë e huaja kanë rritur nacionalizmin për të promovuar interesat e tyre.

Në thelb, ky është mendimi im, të gjithë popujt e Ballkanit kanë një interes të përbashkët në të jetuarit në bashkëjetesë paqësore, me respekt për të gjithë nacionalitetet. Por koha dhe përsëri u kthye me "sigurues ndërkombëtarë" dhe konfliktet shpërthejnë në flakë.

Në Maqedoni ekziston një konflikt historik në mes të sundimtarëve dhe pakicës së madhe shqiptare në vend, të cilët janë të privuar nga të drejtat elementare. Konflikti historik në Maqedoni është në shumë mënyra të krahasueshme me Kosovën, por ajo ka qenë e vështirë të trajtohen në media daneze.

Kjo është një kohë të gjatë që ka pasur një regjistrim në Maqedoni, por një vlerësim realist është se të paktën 40 për qind e popullsisë së Maqedonisë janë shqiptarë. Deri në vitin 1980, ka jetuar disa shqiptarë në kryeqytetin maqedonas të Shkupit, se sa që jetojnë në kryeqytetin e Shqipërisë, Tiranë.

Prandaj, ka vetëm një zgjidhje për konfliktin kombëtar në Maqedoni, ku pika e fillimit është për të siguruar të drejta të barabarta dhe respekt për të gjithë banorët e vendit. Por ai është larg nga rasti.

Pak kohë më parë u hodhën përsëri benzinë në zjarr, kur akademia historike në Maqedoni publikoi një enciklopedi.

Ai deklaroi se shqiptarët në Maqedoni erdhi në vend në shekullin e nëntëmbëdhjetë - dhe thirrje direkt se shqiptarët ishin të detyruar nga Maqedonia. Kjo është një kurs i rrezikshëm, të gjitha

ndërsa Maqedonia e para u bë një republikë në kuadër të Jugosllavisë, e cila u shfaq në rrënojat Luftës së Dytë Botërore.

Nuk janë thjesht një Maqedoni historike, apo për atë çështje një historik i Maqedonisë njerëzit, kulturë dhe kështu me radhë. Historikisht, nuk ka për shekuj ka jetuar shumë kombësive brenda kufijve të tanishëm të Maqedonisë.

Kjo është edhe arsyeja pse Greqia, Serbia dhe Bullgaria me arsyetimin e tyre nuk pranon të njohë emrin Maqedoni.

Shqiptarët janë shumicë e popullatës në Maqedoni, por të drejtat tona po shkelet. Shqiptarët ulet sot në burgjet e Maqedonisë për shkak se ata kanë marrë masa në mënyrë paqësore për të drejtat e tyre kombëtare dhe sociale.

Si jorezident shqipe kam për shumë vite ka qenë një aktivist i të drejtave të njeriut. Ajo ka shumë herë më dha probleme të mëdha. Në verë kam përjetuar në trupin tim me pasojat e politikave të aparteidit që ekzistojnë në Maqedoni ndaj popullatës shqiptare në vend.

Unë po vjen në shtëpi për të vizituar familjen time. Në kufi unë u ndal dhe arrestuar për tetë orë. I është nënshtruar një pyetje orë të gjatë. Telefoni im është marrë nga unë, si dhe numrat e telefonit në listën time të kontaktit në telefon është kopjuar pa ndonjë qëllim, dhe kundër vullnetit tim.

I është kërkuar përgjigje në lidhje me aktivitetet e mia politike në Danimarkë dhe lidhjen time me ato. Në vizitat e mëparshme unë kam qenë i torturuar dhe ngacmuar.

Keni harruar

Ajo është e mendimit tim të fortë se bashkësia ndërkombëtare i ka harruar shqiptarët në Maqedoni.

Unë do të inkurajojë qeverinë daneze për të hetuar dhe për të dënuar shkeljet e të drejtave të njeriut në Maqedoni dhe kërkesën parimore që të gjithë qytetarët e saj - pavarësisht nga kombësia - ka të njëjtat të drejta kombëtare dhe sociale.

Kopenhagë, e Premte, 16 tetor 2009

VAZHDON APARTEIDI NDAJ SHQIPTARËVE NË MAQEDONI PJESËMARRËS SI KURDOHERË EDHE SHQIPFOLËSIT!

Tani, kohët të fundit politika maqedonase ka marrë përmasa tejet të forta antishqiptare. Kjo ofensivë e pandalshme tanimë po kuptohet fort qartë, përditë e më tepër jo vetëm nga analistët politikë përparimtarë - të brendshëm dhe të jashtëm, por dhe nga të gjithë njerëzit përparimtarë, e besa edhe jo shumë përparimtarë, të cilët janë mësuar që, kur ua do interesi, të dalin në skenë të historisë së ”rezistencës kombëtare”, gjithnjë në ballë të kombit, kinse si baballarët e tij, shumë të përvuajtur.

Sulmet e Maqedonisë kundër shqiptarëve

Ende nuk ka kaluar një vit që opinioni i brendshëm dhe i jashtëm e kuptoi se Akademia e Shkencave të Maqedonisë e nxori një **Enciklopedi** ku tentoi ta fshijë nga harta vendin e origjinës së vërtetë të shqiptarëve autoktonë në trojet e veta, duke i quajtur padrejtësisht ata “ardhacakë” nga viset e Shqipërisë administrative, si rrjedhojë e fitoreve të luftërave të otomanëve, pra, i konsideroi dyndje shqiptare.

Pasi, disi u qetësuan gjakrat dhe “u tërhoqën” nga sulmi i parë, shovinistët maqedonas u vërsulën me po atë eufori “kulturore”. Vendosën që nxënësit shqiptarë, **që nga klasa e parë të detyrohen të mësojnë gjuhën maqedonase.** Po ashtu, Ministria e Kulturës dhe e Arsimit hasën në mospajtimin e shqiptarëve. Përsëri “u tërhoqën” por nuk harruan të sulmojnë përsëri.

Sulmi tjetër flagrant u bë kur ardhacakët sllavë **e projektuan ndërtimin e Shkupit 2014** me të cilin do të vinte **“e vërteta”** në vend, sipas logjikës së tyre okupuese, se Shkupi paska qenë, është dhe do të jetë, tërësisht me brendi dhe pamje maqedonase, me ngjyrosje të pështirë fetare. Kinse Shkupi qenka bastion i

ortodoksizmit sllav "i kulturuar", ndërsa shqiptarët kinse ishin, janë dhe do të jenë "të pakulturuarit" e Ballkanit, dhe të trajtohen (të paraqiten) vetëm si "halldupët" e Turqisë, të zbritur në troje të huaja.

Duke i parë të gjitha këto sulme të cilat në këtë shkrim nuk është e mundur të përshkruhen të gjitha, kujtojmë të mjaftohemi me pyetjen: Sa dhe si po qëndrojnë përballë këtij aparteidi partitë e ashtuquajtura shqiptare?!

Sipas koalicionit të BDI-së së Ali Ahmetit, problemi më i madh nuk qenka lufta ndaj këtij aparteidi, por qenka zgjidhja e emrit të Maqedonisë, gjithnjë sipas "ndrikullave" sllave, pra si të duan ata ta pagëzojnë Maqedoninë, këtë krijesë artificiale titiste. Habit fakti që Ali Ahmeti merr nismën **"e mbarë"** që t´i kërkojë presidentit të Shqipërisë, Bamir Topit që, si burrë **"me peshë"** në politikën ballkanike të lobojë apo më mirë të thuhet **të zezojë** që Greqia t´ia njehë Maqedonisë emrin sipas orekseve maqedonase!

Harrohet të theksohet këtu nga politikanët "tanë të ndritur", lidhur me këtë çështje se shqiptarët nuk paskan të drejtën as të deklarohen, as të qesin kushte, pra të përcaktohen për dëshirën e tyre, për emrin e shtetit në të cilin tani përbëjnë hiç më pak se komb i dytë për nga shumë faktorë, si popullsia, territori etj.

Idealet e luftës çlirimtare u nëpërkëmbën dhe as për së afërmi shqiptarët nuk i arritën objektivat e tyre, përse luftuan.

Atdhetarët kishin njohuri për antikombëtarizmin e turkofilizmin e A. Kasamit. Ky atëbotë thuhej se e shiti një ndeshje futbolli të "Shkëndijës" shqiptare, në favor të ekipit "Gjorçe Petrov", **,** që Maqedonia të mos përfaqësohej në turneun evropian me një ekip shqiptar, por me një ekip maqedonas. "Shkëndija" ishte përpara me rezultat 2 : 1 dhe vetëm në dhjetë minutat e fundit, me ndërhyrjen e A. Kasamit, e humbi lojën me rezultatin 4 : 2 në favor të "Gjorçe Petreovit". Nga shumë tifozë të "Shkëndijës" thuhet se ky përfaqësues politik i BDI-së i ka marrë 300 mijë euro për atë "nderë" që në finalen evropiane të shkonte një përfaqësuese maqedonas e jo shqiptare.

Por, jo vetëm kaq. Si duket bëhet fjalë për shumë afera korruptive dhe lakmi për pushtet etj.

Ai ka qenë i ngatërruar në shumë afera të pista si: tradhti kombëtare, i zhytur kokë e këmbë në UDB-n serbo-sllave, si koordinator politik, ekonomik dhe kadrovik. Pastaj në BDI-n e Aliut ka bërë korrupsion të madh. Me siguri ky rast do ishte shumë interesant dhe tejet i qëlluar të merrej në prokurori, sepse ka përgjegjësi të madhe edhe për tragjedinë e katundarëve të pafajshëm të Brodecit. Nëpërmjet një mekaniku, i quajtur Njazi Nuredini nga katundi Pollaticë, i përçau ushtarët. A. Kasami është përgjegjës për shumë gjëra, që për fat të keq tani po shpërblehet nga partia e tij që po e drejton.

E ritheksojmë faktin që, fatkeqësisht ne shqiptarët ende nuk kemi arritur të kemi një gjyqësi me prokurori të pavarur, prandaj dhe nuk ka përgjegjësi akuzash për elementë të tillë antikombëtarë.

Ky mashtrues ende po mban peng të këqija të njohura dhe të panjohura dhe për më keq ende shumë njerëz kanë hamendje për të. Ata ende nuk i kuptojnë veprat e tij antikombëtare dhe antinjerëzore.

Shkurt e shqip ky matrapaz i pangopur ka përgjegjësi për një shumë marramendëse që i ka grabitur nga fondi i Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare "Liria Kombëtare". Për të gjitha këto punë të pista, këtij "trimi" iu bë një atentat në shtëpinë e tij. Mirëpo, për faktin që kjo ende nuk u verifikua nga "drejtësia maqedonase", nuk duam të pretendojmë se nga i pati ardhur sulmi.

Mirëpo, këtu duam të theksojmë se A. Kasami si pehlivan i regjur politik, me ndihmën e miqve sllavë e fitoi përsëri "davanë", duke e marrë në dorë ambasadën maqedonase në Kopenhagë. E bëri dhëndrin e tij, Adem Asafin ambasador. Mu për këtë, ceremonia e fillimit të punës së këtij "dylberi" u bë në një sallë si xhami, kur "imami" i katundit të Kopenhagës, Hafiz Abdyrrahim Kurtishi, ende pa u bë falja e namazit (***he zoti i vraftë***) mu në ditën e bajramit, e prezantoi ambasadorin sllav.

Pastaj, për një kohë të gjatë, përafërsisht pesë vjet, këtë "atdhetar të rrezikuar" nga armiqtë maqedonas e ndoqën nga BDI-ja. Pas kësaj mungese "për arsye shëndetësore", A. Kasami zgjidhet përsëri anëtar i KP të BDI-së, bile pa dëshirën e Ali Ahmetit, madje duke pretenduar të merrte, **"për merita të larta",** postin e Sekretarit të përgjithshëm të këtij ***sekti të prapë*** politikë. Hyri përsëri në këtë parti, për arsye se më së miri aty e gjen veten me të gjitha prapësitë e tij që i bëri dhe po i bën kundër lëvizjes çlirimtare shqiptare. Nga kjo akuzë jona, natyrisht që lexuesit duan fakte dhe shpresojmë se nuk do t´u mbetemi borxh për këto, as atyre, as "politikanit" titist A. Kasamit.

As që kisha ndërmend të shkruajmë për A. Kasamin, por tani përsëri po detyrohemi të paraqesim veprimtarinë e tij antikombëtare për faktin se ky "politikan pehlivan" edhe tani është duke i shkaktuar dëme të pallogaritshme dhe tepër të rrezikshme politikës shqiptare në Maqedoni dhe lëvizjes çlirimtare në përgjithësi.

Unë, për herë të parë kur e kam takuar A. Kasamin, kam qenë i punësuar në një fabrikë të ngjyrave. Kur hyra në punë, punëtorët shqiptarë më thanë për të se aty është një spiun i cili paska mbajtur një mbledhje me një përfaqësues i LKJ-së nga Kosova. Me sa me kujtohet, ka qenë Isa Mustafa, tani kryetar i komunës së Prishtinës. Pra, në atë delegacion të ardhur nga ish-Jugosllavia ishte bashkuar edhe ky A. Kasami. Atëbotë e patën mbajtur një mbledhje me bashkatdhetarët, sipas stilit: në një dorë karotën e në tjetrën shkopin, që t´i mashtrojnë dhe t´i frikësojnë duke i njoftuar se kinse "armiku nacionalist shqiptar" është thyer në kokë dhe është shkatërruar, siç thoshte një qen serb me emrin Sinan Hasani, për demonstruesit e pranverës së madhe të vitit 1981.

Është shumë interesant se si ky menjëherë e rregulloi lejeqëndrimin në Danimarkë, kur atëbotë bashkatdhetarët tanë kujdeseshin prej tij, sepse dokumentet ia kishte lëshuar edhe ambasada jugosllave. Bile, mund të shtojmë dhe këtë fakt: Sa herë kishin mbledhje në ambasadë, jugosllavët vinin e merrnin në punë besnikun e tyre, A. Kasamin. Lidhur me këtë "krenari" pro-

jugosllave, vjehrri i tij Ismail Sulejmani me të cilin punonim bashkë, shpesh më thoshte: "Ata të ambasadës kurrë nuk mbajnë mbledhje pa "turkun tim", siç e quante ai, A. Kasamin.

Unë nuk i flisja këtij "turku", për faktin se kisha mjaft informata nga njerëzit atdhetarë të cilët e dinin fort mirë se kush ishte ky "atdhetar" i viteve të ardhshme të luftës për liri të kombit shqiptar. Kujtimet për të që i shkrova më lart datojnë nga vitet 1982-1983.

Tani për lexuesit do të sqaroj më tej dhe saktësisht faktin si ky komplotist titist e kishte bërë skenarin, natyrisht me ndihmën e ithtarëve të vëllazërim-bashkimit, të agjenturave titiste, për të depërtuar në lëvizjen antijugosllave.

Lëvizja Popullore e Kosovës ishte e konsoliduar kënaqshëm në Suedi e në veçanti në qytetin e Malmes. Ky "pehlivan politik" e merr vesh se në Malme do të zhvillohej një demonstratë, në përkrahje të rinisë studentore në Kosovë e gjetiu. Jam i bindur fort se i dirigjuar nga dirigjentët e tij jugosllavë, në atë demonstratë shkon dhe ky "trimi me fletë". Atje, pa ngurrim depërton në gjirin e demonstruesve dhe pa vonesë kërkon të njihet me udhëheqësit e kësaj lëvizjeje antijugosllave. Aty i takon Xhemal Durakun dhe Sherif Gjonbalën, me të cilët pastaj mban kontakte dhe u thotë: "Duhet të bashkëpunojmë"! Prandaj, pa humbur kohë, po aty i shkëmbejnë adresat.

Më kujtohet se aty kah viti 1984-1985, erdhi në Danimarkë njëri nga udhëheqësit e LPK-së në Gjermani, veprimtari i njohur Ibrahim Kelmendi, me ç´rast u takua me shqiptarët në Kopenhagë në një klub privat. Pronar ishte Osman Lika. Aty, për herë të parë e kam takuar Ibrahim Kelmendin dhe u morëm vesh që në mbrëmje të tubohemi gjetkë dhe të bisedojmë më hapur dhe më shtruar për çështjen tonë kombëtare, që na preokuponte të gjithëve. Ata që ishin të pranishëm i thirrën të afërmit dhe shokët. Dua të përkujtoj lexuesit se i pranishëm isha edhe unë. Mirëpo, fort mirë më kujtohet fakti i hidhur se, kur të pranishmit e panë se po vinte A. Kasami, të gjithë u shqetësuan, besa u habitën dhe u revoltuan si mos më keq.

Dhe në atë gjendje dëshpërimi ishin gati që demonstrativisht të largohen. Mirëpo kur e vërejti këtë Ibrahim Kelmendi, me vendosmëri na tha: "Mos u shqetësoni, sepse unë kam shumë fjalë të mira për të, prej shokëve që veprojnë në Suedi".

Ne e dinim që Ibrahimi kishte shoqëri fort të mirë me Xhemal Durakun dhe Sherif Gjonbalajn. E dinim pastaj që ishin ata që garantonin. "Ky nuk do të kishte mundësi të bënte ndonjë spiunim. Përndryshe, edhe ne nuk jemi të interesuar të kemi pengesa" etj.

Më vonë edhe ne në Kopenhagë e hapëm një shoqatë shqiptare, me ç´rast unë i pagova 160.000 kr daneze dhe ua dhashë këtyre. Për fat të keq, po ky A. Kasami do të korruptohej dhe do t´i përvetësonte disa nga këto mjete duke i mashtruar bashkatdhetarët se kinse ato i ka marrë kredi në bankë dhe se dëshiron të kontribuojë për shoqërinë shqiptare në Kopenhagë.

Pastaj, për më keq, për t´i mbuluar turpet e veta, ky i pacipë filloi të shpifë kundër meje, kinse unë qenkam i dyshimtë e të tjera marrëzira. U krijua një gjendje që dukej situatë pa krye. Disa të painformuar mirë, anëtarë të Kryesisë së shoqatës, flisnin zi e më zi për mua, ndërsa Kasami qeshej me ironi dhe krekosej se ia kishte arritur qëllimit. Ky e shfrytëzoi rastin për faktin se lekët i dhashë pa autorizimin tim, pra fshehtas, sepse mund të kisha pasoja nga regjimi maqedonas.

Të shkruash deri në fund për bëmat e këtij njeriu të prapë, patjetër që duhen dhe jo vetëm mua, libra të tëra, për të pasqyruar veprimtarinë e tij antikombëtare. E ceka më lart se aspak nuk do të dëshiroja të merresha me të sikur të mos kishim ende pasoja nga veprimtaria e tij! Ato konsistojnë edhe në këto fakte tepër të hidhura, shumë të vërteta: Pasi u krijua shoqata shqiptare, bëja presion që shoqata te emërohej edhe si shoqatë shqiptare, e pastaj le të quhej, nga Jugosllavia. Atëbotë zhvillohej një luftë e ashpër me ambasadën jugosllave dhe me shqipfolësit që i mbronin interesat sllave dhe çirreshin e i "nduknin mustaqet" se "do na i marrin pasaportat", se "ne jemi jugosllavë". Bile kishte prej tyre që nxirrnin edhe pasaporta sllave dhe zhurmonin para masës dhe

ambasadës serbo-sllave, duke thënë: “Ja, unë jam qytetar i Jugosllavisë e jo i Albanisë” e të tjera budallallëqe.

A. Kasami, atëbotë i luante për mrekulli dy role politike. Kur ishte me shqiptarët bëhej “patriot i klasit të parë”, por kur vinin ata të ambasadës heshtte si mumie dhe nuk bënte fjalë. Shoqata në kuadër të kryesisë formoi edhe një delegacion që do t’i përfaqësonte shqiptarët në ambasadën jugosllave. Në atë delegacion doli i pari vullnetar, A. Kasami, mirëpo masa e zgjodhi edhe prof. Aki Bilallin që ishte edhe si njohës i mirë i situatave politike. Akiu ishte këmbëngulës që nuk prish asgjë të emërohet si “Shoqatë Shqiptare nga Jugosllavia” por ambasada nuk donte fare që të figuronte emri shqiptar, ishte kategorike dhe thoshte: ”Svi smo jugosllaveni”!

Një ditë (data nuk më kujtohet), ishte viti 1986 kur A. Kasami më mori në bisedë dhe më tha se ambasada jugosllave na ka ftuar të bisedojmë për Shoqatën dhe patjetër duhet të shkojmë, por hallin e kam si mund ta gjemë prof. Akiun. Meqë unë e dija ku punon dhe ku banon Akiu, shkuam ta kërkojmë, por as në punë dhe as në shtëpi nuk e gjetëm dot. U bë ora afër 16, koha e caktuar për takim. A. Kasami m´u drejtua mua me kërkesën: “Eja ti me mua”, por unë refuzoja sepse nuk dëshiroja të shkoja. Mirëpo, më luti shumë dhe tha: “Shkojmë për interes të shoqatës, ti po deshe mos fol asgjë, etj.” Më në fund, e hëngra “karremin”, u mashtrova dhe shkova me A. Kasamin në ambasadë. Aty na priti një djalë rreth dyzetvjeçar, shtatlartë. Si duket, ishte malazias, e kishte mbiemrin Peroviq. Ne u futëm brenda nga një derë speciale nga prapa, nuk e dija përse, por andej u futëm dhe t´ua them të drejtën, unë isha “në sy të tyre” dhe u shqetësova ca se çfarë do t´më ndodhte. Sapo u ulëm në tavolinë, para nesh ishte një revistë “NIN”. Në faqen e parë të saj ishte një fotografi e xhelatit të popujve, Sllobodan Millosheviqit që shihej në mitingun e Fushë Kosovës. Filloi biseda. Ai pyeti për mua, kush jam. A. Kasami foli dhe i tha se jam një aktivist i shoqatës dhe ia tregoi emrin tim. Filloi biseda. Më kujtohet si sot kur Peroviqi e pyeti me këto fjalë: ”Halime, shta mislish za druga Millosheviqa”?

Halim e quanin sejmenët sllavë, A. Kasamin. Pra, administratori e pyeti: "Halim, ç´mendim ke për Millosheviqin?

A. Kasami u përgjigj: "Po, shoku Millosheviq është një figurë e madhe, komunist i zgjuar, njeri që ka qenë edhe në Amerikë, ka qenë guvernator i bankës, njeri që di të flasë dhe të shkruajë disa gjuhë të huaja, njeri që di se çka është politika" etj, etj. "Në krahasim me Ivan Stamboliqin - i përmendi edhe disa viçër të tjerë që mua tani nuk më kujtohen, sepse kanë kaluar shumë vite - tani ata janë luftëtarë, janë komunistë të mirë, por me Millosheviqin, asnjë nuk krahasohet".

Biseda "konstruktive" dhe tepër miqësore midis tyre, vazhdoi afër dyzet minuta. Mua më vinte gjaku të më shpërthejë nga inati. Përse ky e lavdëron aq shumë Millosheviqin dhe për çudi të kohës, aty në atë takim nuk folëm asnjë fjalë për Shoqatën, për punën e së cilës patëm shkuar!

Prej asaj strofkulle të armikut, dola pa asnjë koment. Mendoja me veten time: Ç´të bëj?! T´i shkruaj një letër Lëvizjes Popullore, degës në Zvicër, ngase patjetër do të duhej t´u tregoja shokëve. Mirëpo druaja. Ata nuk do të më besonin sepse Xhemal Duraku e mbronte këtë farë palo burri. Ashtu i dëshpëruar nga ato bisedat e tyre, shkova e mora taksin dhe ashtu me vonesë, as nuk kisha nerva të punoja, u futa në Shoqatë të takoja ndonjë shok e të bisedonim që të lirohesha sadopak nga ai vrer i akumuluar në atë pikë të zezë antishqiptare. Kur hyra brenda, pashë në tavolinë disa bashkatdhetarë që ishin tubuar rreth A. Kasamit. Ai u mbante ligjërata. U ofrova ngadalë, e mora një karrige, u ula dhe po i dëgjoja. Isha i dëshpëruar tej mase. Ja se ç´ u thoshte A. Kasami: "He, ishim tani në ambasadën jugosllave dhe u grindëm me ata. Atje thoshin se Kosova po kërkon të bashkohet me Shqipërinë". E ky kinse u ka thënë: "Jo, kjo nuk është aspak e vërtetë. Shqiptarët e Kosovës nuk kanë kërkuar bashkim me Shqipërinë, por kanë kërkuar të drejta të barabarta si të gjitha republikat e tjera, për shembull si Mali Zi që i ka vetëm gjysmë milioni dhe një pjesë e tyre janë shqiptarë e megjithëkëtë kanë republikë. Maqedonia është

më e vogël me banorë se Kosova dhe ka statusin republikë, pastaj edhe Sllovenia" e të tjera. I shkuan sytë nga unë dhe tha: "Ja, pyeteni Xhemilin". Ofofof! Mjerë unë. Si të them tani se ky i pacipë po rren, po i mashtron këta anëtarë të Shoqatës, kur e dija që nuk i foli asnjë nga ato biseda atje, por foli për Millosheviqin e viçër të tjerë. Për besë, m´u bë se më ra ajo ndërtesë. Kurrë më keq nuk e kam ndier veten dhe aty e kam bërë gabimin më të madh në historinë e jetës sime, sepse e gëlltita një të pavërtetë, nuk fola, por vetëm e lëviza kokën.

Arsyeja pse nuk fola ishte se atëbotë shumë kundërshtarë të LPRK-së e akuzonin këtë lëvizje çlirimtare si organizatë proserbe, kinse në radhët e saj ka vetëm spiunë të Serbisë etj. Prandaj, sikur ta demaskoja unë A. Kasamin, shumë nga kundërshtarët e LPRK-së do të kënaqeshin dhe kjo sipas tyre, do të vërtetohej plotësisht. Që prej kohës që isha në këtë shpellë moderne të banditëve sllavë me A. Kasamin, pa hezitim shokëve u kam thënë se ky i pacipë rrenë dhe i përshtat bisedat sipas interesave të tij personale, pra nuk thotë asgjë të vërtetë. Natyrisht se këto fjalë ua kam thënë edhe Xhemal Durakut, Ibrahim Kelmendit, Muhamet Kelmendit, Xhavit Halitit e të tjerëve. Këto tani i them me përgjegjësi të plotë morale dhe penale. Me këtë rast dua të përkujtoj faktin se Xhemal D. dhe Xhaviti H. kishin rënë komplet pre e mashtrimeve, nën thundrat mashtruese të A. Kasamit .

Gjithashtu, e kam bindjen e bazuar në fakte se dhe Ibrahim Kelmendi e kishte të njëjtën bindje. Më kujtohet sesi në muajin mars të vitit 1990, në prani të mbi njëzet aktivistëve, Ibrahim Kelmendi ia dha një kritikë të rreptë A. Kasamit dhe kunatit të tij, apo më saktë, sejmenit të A. Kasamit, Avzi Sulejmanit. Kritika qe e rreptë për faktin se para vitit 1990 A. Kasami dhe A. Sulejmani kërkonin që Lëvizja ta bënte veprimtarinë e saj në mënyrë legale. Kjo kërkesë e tyre mua nuk më bënte përshtypje sepse e dija që këto i kanë vetëm fjalë. E dija që atyre as u interesonte, as e kishin hallin për legalizimin Lëvizjes, por me këtë krekoseshin, kinse janë aktivistë të dëshmuar të saj. Kur ishte Ibrahim Kelmendi në Danimarkë tha:

"Tani janë krijuar kushtet që Lëvizja t´i koordinojë veprimet gjysmë ilegale në Perëndim, pasi janë krijuar edhe partitë politike në Kosovë. Mirëpo, Kasami ishte kategorik se ne duhet të futemi në ilegalitet. Pra, para disa viteve kërkonte të dalim legalë, ndërsa tani kërkonte përsëri të hyjmë në ilegalitet. Këtu janë dëshmitarët të cilët lirisht mund të dëshmojnë se si e qortoi I. Kelmendi A. Kasamin, saqë vërtet u habitëm të gjithë. Bile, unë kujtoja se Ibrahimi nuk i prish fjalët me A. Kasamin, pasi që tërë kohën ai rrinte tek A. Kasami. T´ua them të drejtën, po të ma kishte bërë një qortim të tillë mua para gjithë atij publiku bashkatdhetarësh, ose do të ikja i turpëruar dhe nuk do të paraqitesha më kurrë para atyre shqiptarëve, ose druaj se do të bëja vetëvrasje.

Kur dolëm jashtë, i thashë I. Kelmendit: "Hajde tek unë në banesë"! "Jo -tha Ibrahimi - unë do të shkojë te Halimi, sepse me të jemi përsëri shokë, çështja kombëtare dhe politika janë të tjera, ndërsa shoqëria është tjetër, ne përsëri ne jemi shokë. Nga kjo sjellje e tij u befasova. Duke e ditur faktin se Ibrahim Kelmendi është një ndër të përkushtuarit e çështjes shqiptare, mendoj se tani ka përgjegjësi të madhe dhe kërkoj prej tij që të dalë dhe të deklarohet hapur se kush ishte deri sot dhe kush është A. Kasami. Sepse I. Kelmendi është i vetmi njeri veprimtar nga më të vendosurit dhe që kishte dhe ka qëndrime të drejta për gjithë ata shokë e shoqe që dikur i takonim Lëvizjes Popullore për Republikën e Kosovës.

Unë si veprimtar politik, në vitin 1989, isha në një grup intelektualësh që vepronin në kuadër të Komitetit "Miqtë e Kosovës". Ata më propozuan që unë të kandidoja në zgjedhjet komunale për komunën e Kopenhagës, të cilën e quajtëm "Listën Kopenhagës". Ishin pikërisht këta dy dhe një mik imi që vinte në shtëpinë time dhe bisedonim haptas. Ata me këmbëngulje thoshin: "Nëse hetohemi nga ambasada jugosllave të gjithë do të arrestohemi dhe do të burgosemi". Ata e përhapën një lloj frike edhe në familjen time. Shkurt, ata mundoheshin të bënin një lloj shantazhi, të ndikonin keq në marrëdhëniet e mia me gruan time, por këtë nuk e arritën kurrë.

Ata përgjunjeshin pranë meje të tërhiqesha nga kandidatura dhe thoshin: "Të lutemi Xhemil, tërhiqu, sepse nëse kandidohesh ti në zgjedhje, neve do të na arrestojnë në Maqedoni, ngase sllavo-maqedonasit do ta kuptojnë se kush është shok me Xhemilin" e të tjera, e të tjera komplote. Në momentin e fundit, unë, për të ruajtur familjen time, u detyrova ta tërhiqja kandidaturën time.

Me atë rast u detyruam t´i djegim 20.000 ekzemplarë të revistës, ku e pata dhënë një deklaratë përse pranoj të kandidohem për komunën e Kopenhagës. Për këtë mund të dëshmojnë kur të duan Isni Mustafa dhe Ibrahim Xhemaili, sepse ishin pikërisht këta që më luteshin që të tërhiqem e të mos i marrim shokët në qafë. Unë nuk dija si të argumentoja ndryshe, veçse kjo s´kishte të bënte me politikën jugosllave.

Kur ishte Ibrahim Kelmendi në Danimarkë tha se tani janë krijuar kushtet që Lëvizja t´i koordinojë veprimet gjysmë ilegale në Perëndim, pasi janë krijuar parti politike në Kosovë Është fakt që Ibrahim Kelmendi ka qenë koordinator i aktiviteteve dhe disa herë ka marrë pjesë në bisedat e Këshillit të LPRK-së, në degën e saj në Danimarkë. Me një rast, kur Ibrahim Xhemaili ishte kryetar i LPRK-së, ende pa e mbaruar afatin, Ibrahim Kelmendi kërkoi që Këshilli në Danimarkë të ndalë aktivitetin për shkak të shpifjeve të A. Kasamit dhe të R. Lokut. Ky i dyti ishte i gatshëm që në mbledhje të më godasë me grushte sepse shpesh ia prishte mendjen A. Kasami. Ndërkohë, anëtarët e Kryesisë aty e kuptuan qartë se unë isha i vetmi që e kisha paguar anëtarësinë e organizatës dhe kisha dhënë shumë ndihma për parapagimin e "Zërit të Kosovës". Ndërsa A. Kasami nuk e kishte dhënë asnjë metelik, bile nuk ka dhënë kurrë gjatë gjithë aktivitetit të luftërave që u zhvilluan në territoret tona. Ky bukëshkalë tërë kohën ka abuzuar me çështjen kombëtare, vetëm duke u paraqitur si bajraktar i mjerë, për të qenë kurdoherë në skenën politike shqiptare, ani pse nuk e meritonte aspak këtë nder. Habit fakti që edhe sot e gëzon respektin prej disa udhëheqësve politikë dhe ushtarakë që janë luajalë ndaj shtetit maqedonas. Në një rast tjetër, në mbledhje të LPRK-së ndodhej

edhe I. Kelmendi. Zakonisht në mbledhje A. Kasami e bënte lojën "fluturoi, fluturoi huti" dhe me dinakëri u shmangej bisedave reale, por përherë thoshte se çka i thashë këtu këtij e atje atij, "filanit e fistekut", këtij politikani apo shqiptari ose ndonjërit nga anëtarët e degëve të LPRK-së, të Gjermanisë apo të Zvicrës. Natyrisht, unë kurrë nuk i besoja dhe shpesh ia prishja. Ia kujtova se jemi në mbledhje ilegale, se ato biseda mund t´i bëjmë në klub etj. etj. Me atë rast filloi t´i nxehej gjaku. Halimi, dy nga shokët, Shenasi Rexhepin dhe Remzi Lokun i mbante si badigardë. Ata dilnin me qëndrime të ndryshme: Kur donin, thoshin se nuk jemi anëtarë të LPRK-së dhe kur donin, formonin degë tjetër dhe të gjitha këto manipulime i di fort mirë ish-kryetari, Ibrahim Xhemaili dhe sekretari, Aki Bilalli.

Pasi këta dhe të tjerë pjesëmarrës të kohës dhe të ngjarjeve nuk i pyet askush ngase i mbrojnë interesat e tyre, nuk po prononcohen për këtë "njeri" as deri sot. Po jap dhe shembuj tjerë: Si manipulonte A. Kasami me shokët e LPRK-së në vitin 1989/99. "Komiteti Miqtë e Kosovës" bëri jehonë të madhe për internacionalizimin e çështjes së Kosovës. Në atë Komitet isha i vetmi shqiptar dhe pothuajse gjithë aktivitetin e financoja vetë, derisa shqiptarët e kuptuan se çfarë qëllimi kishte Komiteti. Patëm disa demonstrata dhe shpërndanim komunikata ku tregonim realisht se ç´ po ndodh me shqiptarët në Kosovë. Pra, Komiteti ishte një zëdhënës i fuqishëm i popullit shqiptar dhe këtë e kemi faktuar disa herë.

Në një rast, planifikonim të bëjmë një debat për grevën e minatorëve. Ibrahim Kelmendi propozoi që prej LPRK-së të vinte Xhavit Haliti. Atij ia kishin dhënë detyrën që më tepër të merrej me Skandinavinë. Ishte caktuar data e mbajtjes së debatit, salla, paneli. Për debatin dhe për të interesuarit ishin shpërndarë njoftime për gazetarët dhe pritej vetëm dita kur të zhvillohej debati. Data u caktua, i telefonova disa herë Xhemal Durakut, i thashë se duhet pasur kujdes që mos të na dështojë ky debat, sepse ka shumë rëndësi ngase shpresojmë që për debatin të botojmë një libër etj. Ju lutem, mos e vononi punën me Xhavitin sepse zakonisht "nga

patriotizmi i madh" që kishin atëherë, disa aktivistë i harronin madje edhe tubimet, kur nga A. Kasami kishin ndonjë ftesë "të papritur" për dreka e darka të begatshme. Ia tërhoqa vërejtjen në veçanti. Mos u vononi! I tregova se A. Kasami nuk di asgjë për këtë debat sepse, si zakonisht, ai po i saboton këto aktivitete dhe po tallet me ata shokët danezë që po na përkrahin. Ia thashë troç se ju e doni atë, por dijeni se ai është spiun!

Kështu u kam thënë disa herë. Pastaj takimin e lamë në shoqatën "Besa". Erdhi dita dhe koha e caktuar. Ata nuk vinin. U telefonuam në Malme, na thanë se kanë dalë herët. Një mik imi i cili quhet Isni Mustafi, e priste "Zekën", atëbotë pseudonim i Xhavit Halitit. Iu afrova dhe i them: Ç´të bëjmë tani?! Ai më tha se A. Kasami po dëshiron t´i bien ndër këmbë dhe ta lusim, sepse konsideron se vetëm ai është këtu "më i madhi", siç shprehej. Për të tjerët atij nuk i intereson fare.

A. Kasami u thotë se Xhaviti nuk është këtu dhe se "ata të mëdhenjtë" e kryesisë së LPRK-së, kanë shumë besim tek ai.

Eu, eu, eu! Bela, o punë! Ngela i vetmuar, mbeta pa tekst! Pa pritur, pranë meje e pashë mikun tim, të cilit i them: "Po ti e ke vërejtur sa shumë herë ai po mundohet t´i sabotojë aktivitetet tona dhe kur nuk ia arrin, "bën dredhi me bisht" si bushtër, kinse afrohet. Së paku dëshiron të jetë aty midis nesh, atje në demonstrata. A të kujtohet si vraponte së bashku me Havzi Sulejmanin që të dukej se është i pari, me ata "të mëdhenjtë" e LPRK-së, sesi ia siguronin makinën, sesi afrohej në mesin e tyre pranë mikrofonave etj, etj.?

Isha i vendosur të mbahej ai debat dhe nuk tërhiqesha. Përsëri e binda mikun tim, që për hir të çështjes, t´i kërkonte dhe t´u tregonte ku gjendej salla, se për besë, ju nuk e kuptoni se kush është ky agjent sllav. Miku im shkoi i mori dhe debati u mbajt ashtu siç qe parashikuar.

Kështu i dështoi plani këtij injoranti dhe sabotatori, i cili, siç i fola edhe mikut, vetëm me tallje, e herë-herë me disa "batuta", ku ziejnë edhe kërcënimet, përpiqet t´i frikësojë shokët që të mos jenë aktivë. Pastaj, ti je duke e parë se ç´bën. Unë jam duke bërë të

pamundurën, si për shoqatën, si për Komitetin dhe për LPRK-në, ndërsa ky po tallet dhe gjatë mbledhjeve ilegale i frikëson shokët, i demoralizon, u thotë se "jeni jeshil" (të papjekur). Unë ua pata thënë të gjitha këto gjëra shokëve të LPRK-së. Bile as këtu në LPRK nuk kam për ta lënë, sepse ky dilenxhi po luan "majtap" tërë kohën me Xhemal Durakun dhe Xhavit Halitin, por ata kurrsesi nuk po duan ta kuptojnë.

Kur jemi këtu, të përkujtojmë se sistemi i ilegales ka qenë i domosdoshëm. Ishte i mirë por herë-herë jo i përshtatshëm, sepse ky dhe të tjerë prototipa "tarafë" si ky, e kanë shfrytëzuar "perden e hekurt" të ilegales për të hyrë në radhët e LPRK-së, e pastaj për ta sabotuar e minuar nga brenda veprimtarinë e saj.

Nga kjo konstatojmë se pikërisht për këtë shkak, për vite të tëra ka punuar UDB-ja që ta dëmtojë sa më shumë lëvizjen ilegale në tërësi.

Ky dhe disa të tjerë rreth tij, që vepronin si ky, ishin spiunë të ambasadave jugosllave dhe njëkohësisht ishin në mesin tonë. Fort lehtë pastaj, UDB-ja informohej për shumëçka nga aktivitet e ilegales. Pikërisht këtë "pikë të dobët" herë-herë ua përmendja Xhemal Durakut, Xhavit Halitit, ndërsa këta besa thoshin dhe dyshonin se "ky mund të jetë spiun". Bile, më kujtohet se Ibrahimi e hetonte dhe pastaj e deshifronte që të zbulonte ca gjëra nga ky spiun i ambasadës jugosllave. Mirëpo, si dukej, kishin idenë dhe thoshin shpesh se këtë "kavalier" e kemi nën kontroll. Mirëpo fatkeqësisht, siç po shihet tani, në të vërtetë ai i paska pasur këta nën kontroll.

Me rastin këtij aktiviteti dhe në shumë raste të tjera, ai ka vepruar kështu. Bile në një rast u qortua shumë me akademik H. Goranin. Ka bërë aq shumë skandale ky "njeri", sa zor se mund t´i përshkruajmë. Ka bërë shamatë e skandale me Xhafer Shatrin, Shaqir Shaqirin, Adem Demaçin. Me manipulime dhe gënjeshtra të paskrupullta, e ka penguar vizitën e akademik Rexhep Qosjes në Danimarkë etj. Ky "njeri", me disa anëtarë të LPK-së, siç ishin Xhemal Duraku, Xhavit Haliti, Musa Xhaferi e të tjerë, tërë kohën

është tallur. Për të gjitha aktivitetet e mia bënte telefonata nëpër Evropë dhe thoshte: "ja, ne jemi dërzhavë". Intervistat, letrat e hapura dhe artikujt që i botoja, kërkonte t´i përvetësonte si merita për vete. Shokëve iu thoshte: "Xhemili është jeshil (i papjekur), ai nuk di asgjë, mirëpo unë ia mësoj të tëra"!

Kur vinin ndonjëherë delegacione diplomatike të Shqipërisë administrative për të na takuar, ky mashtrues injorant, pa pikë turpi tallej me ta. Më kujtohet kur me një rast Dr. Abaz Dojaka dhe Nuri Çaushi ishin në Danimarkë në një panair për kulturën shqiptare. Biseduan gjatë me ne, ndërsa A. Kasami u grind me Nuriun, duke e lavdëruar Ahmet Zogun dhe Titon. Të nesërmen Nuriu më pat thënë: *"Ky qenka një spiun i rrezikshëm sepse shumë po m´i lavdëronte mbretin Zog dhe Titon dhe kurrsesi nuk donte t´i dëgjonte argumentet e mia, sipas fakteve historike se Zogolli, ai xhelat, vërtetë ka qenë bashkëpunëtor i Serbisë së Pashiqit, kurse Titoja, një armik i përbetuar i shqiptarëve"!*

Ndërsa A. Kasami neve na thoshte: "Po ua lavdëroja Zogun dhe Titon, sepse, dua të di sa janë këta diplomatë të pjekur politikisht".

Pra, asnjëherë nuk ishte serioz, por ishte si një "presë me dy teha". Me këto makinacione arrinte që t´i mashtronte shokët tanë të LPK-së në Evropë. Por, tek unë kjo "çorbë" nuk i shkonte, sepse e dija se ata ishin politologë dhe kishin tituj doktorë shkencash politike. Pikërisht se ishte dhe ka mbetur i tillë, ka arritur që të fitojë pozita madje deri në hierarkinë më të lartë të BDI-së së Ali Ahmetit.

Si arriti A. Kasami të pozicionohet aq lartë në hierarkinë e UÇK-së?!

Lufta e Kosovës administrative nuk kishte mbaruar. Shqiptarët ishin të mobilizuar dhe e ndihmuan atë sepse objektiv kryesor e kishin platformën për ribashkim kombëtar. Kjo bëri që të kishte një mobilizim të masave të gjëra popullore edhe në mërgatë, pavarësisht se kjo mërgatë qe përçarë si mos më keq nga partitë politike pacifiste, kudo që vepronin në trojet shqiptare. Prandaj,

mërgata mori pjesë aktive dhe i ndihmoi fort faktorët ushtarakë. Në Danimarkë u krijua fondi ”Atdheu në rrezik - vendlindja thërret”. Kryetar qe zgjedhur Dr. Musa Krasniqi, një djalë shumë i ndershëm dhe i urtë që të bënte për vete dhe të ndihmonte. Pikërisht këtu, Kasami u hidhërua me sondistët, por edhe me anëtarët aktivë të LPRK-së së degës, sepse nuk e zgjodhën në Këshillin organizativ. Do jetë mirë që këtë dhe të gjitha, t’ia thonë ata që kanë procesverbale. Por unë vetëm dëshiroj t´i njoftoj lexuesit se kush është A. Kasaimi dhe kush janë ata të njëjtit si ky, që e zgjodhën, e që pastaj populli ua pa sherrin këtyre demagogëve dhe bashkëpunëtorëve sllavë.

Pastaj filloi lufta në Kosovën Lindore (Preshevë, Medvegjë dhe Bujanoc). Për fat të keq nuk pati një organizim të mirëfilltë në Danimarkë për faktin se pas luftës së Kosovës filloi një përçarje e madhe sepse demagogët dhe devijuesit e kësaj lufte filluan t´i marrin frerët e politikës “kombëtare”. Prandaj synimet tona të vërteta kombëtare dhe të atyre që luftuan, mbetën në mes rrugës. Pasi u ktheva nga atdheu, përpjekjet i fillova sërish në Danimarkë. Menjëherë me disa shokë filluam të organizohemi dhe të propagandojmë se atje ka vullnet të bëhen sakrifica për të dalë nga kjo amulli në të cilën na kanë futur PDSH-ja dhe koalicioni me maqedonasit.

Kur mërgimtarët e panë se ne u organizuam dhe bënim një punë të mbarë, njerëzit përparimtarë filluan të ndihmojnë, por kishin frikë se mos keqpërdoren mjetet etj. Gjatë një mbrëmjeje kishin shkuar në klub Abrashi, A. Kasami dhe Remzi Loku. Kishin filluar të bisedojnë edhe për ndihmat e ushtarëve. A. Kasami dhe kompania e tyre kishin deklaruar paraprakisht: “Nëse Xhemili nuk merr pjesë këtu, ne do t´i ndihmojmë shumë këta ushtarë, por nëse ai merr pjesë, nuk do ketë kurrfarë suksesi”.

Disa shokë erdhën dhe më komunikuan: “Mbrëmë kemi biseduar për këtë çështje dhe nëse ua do të mirën ti atyre shokëve tanë që duan të luftojnë për shqiptarizëm, mos u deklaro (prononco), sepse haptas po bëjnë propagandë kundër teje. Mirëpo,

nëse je ti aty, ata nuk do ta ndihmojnë fondin...” Në fakt, isha në dijeni për një konflikt në mes A. Kasamit dhe Fazli Veliut. Për këtë më pat folur F. Veliu gjatë Konferencës së Pestë të LPRK-së që u mbajt në Prishtinë. Në atë Konferencë të përgjithshme isha edhe unë, si përfaqësues për Skandinavinë, siç më thanë, dhe Zaim Beqiri, si përfaqësues i Shoqatës së të burgosurve politikë shqiptarë të Maqedonisë. Patëm biseduar gjerë e gjatë edhe me Ali Ahmetin e të tjerë. Natyrisht, biseduam dhe për tradhtinë e A. Kasamit që ka bërë dhe vazhdon më tej të bëjë. Pastaj, disa herë kemi mbajtur kontakte përmes telefonit me F. Veliun i cili më thoshte që ta marrë drejtimin si ***përgjegjës*** për tërë Skandinavinë e më tej. Unë u thosha se jam për t´u ndihmuar, por për këtë pozitë nuk kam mundësi njëherë, pasi deri tani kam punuar për shqiptarët, por pa shqiptarët, pasi këta farë burra të Këshillit që kanë qenë, tërë kohën më kanë penguar në aktivitete. Po ashtu, F. Veliut i tregoja se me Shoqatën e të burgosurve politikë kam kontakte të mira, e posaçërisht me atdhetarin Zaim Beqiri. Bile prej këtu kam organizuar një debat për të madhin tonë Ukshin Hotin. Atyre nga Danimarka u kam dërguar 15.000 kr. dhe se këta lekë janë vjelë prej fondeve të qeverisë daneze dhe nga Lidhja e shkrimtarëve danezë, e cila më ka ndihmuar shumë për këtë debat për Ukshin Hotin. Bile kërkova që një përfaqësues danez të shkojë. Debati u mbajt dhe kaluan shumë mirë. Me këtë rast dua të theksoj se Xhevat Ademin e kam shok, por thënë të drejtën, as ai qe besa, nuk është shumë “për mashalla”, sepse e kthen gëzofin kah fryn era. Dua të theksoj këtu se Zaimi, Shpëtim Pollozhani, Kastriot Haxhirexha janë burra që nuk i ndryshojnë mendimet. F. Veliu më pat thënë se duhet vepruar ashtu si Xhevati, përndryshe të burgosin maqedonasit. Në mendjen time si vetëtimë më erdhi mendimi: Oh sa keq – thashë - çfarë dëgjova nga Fazli Veliu?!

Koha po kalonte me përpjekje organizative. Atje në katundin Tearcë u krye edhe një aksion në stacionin e policisë që vepronte aty. Këto ngjarje reflektonin shpejt në mërgatën tonë. Pastaj, kur filloi lufta në Kala të Tetovës, që në fakt ia dridhi themelet shtetit artificial maqedonas, kjo nuk i la të gjithë të qetë. Më pastaj, nuk

kishte të pa interesuar. Kjo i vuri në lëvizje të gjithë. Ne zakonisht mblidheshim te një klub privat pasi klubi shoqëror "Besa" u privatizua. Prandaj takimet i bënim te klubi "Bashkimi". Aty të gjitha mbrëmjet kalonin me debate.

Of of of, sa keq! Sa fjalë të kota dhe sa turpe llomotitnin aty?! Ç`debate bëheshin dhe sa sharje kishte! "Kush janë këta që luftojnë me djemtë tanë" thoshin shokët e grupit të Ali Ahmetit! "Djemtë tanë shkojnë ushtarë në atë ushtri, shqiptarët janë në koalicion" - bërtiste Remzi Loku. Herë-herë ia mbante ison Havzi Sulejmani kur thoshte me ironi dhe indinjatë: "Kush janë këta farë komandantë: Zoga, Pula, Laraska" e të tjera marrëzira, që këtu s´po zgjatem më tej.

Abrashi kishte rënë në hall me këta provokatorë të cilët përherë bënin plane që të sulmonin në ato momente kur ishte interesi i tyre dhe jo vetëm i tyre. Abrashit i them: "Ki kujdes, mos u dëshpëro se këta janë zagarë të A. Kasamit. Ai tani nuk del në skenë hapur, por dije mirë se ai i zien të gjitha këto "çorba", këto komplote dhe i planifikon këto trillime".

Pse nuk e njoh atë A. Kasamin, pse ai nuk del këtu me Shenazi Alitin?! "Mos ki dert - i thosha unë - ata dalin më vonë, si urithët. Në klub të shqiptarëve vijnë vetëm kur i harxhojnë lekët. Përndryshe, si të sëmurë që janë, ata rinë nëpër "kazinotë" e automateve të tyre. Me sinqeritet m´u drejtua dhe më pyeti: "Ç´të bëjmë, duhet të ndihmojmë dhe duhet t'i thërrasim shokët në Zvicër. Kujtoj se ata nuk flasin me A. Kasamin. Si duket i kanë hetuar pisllëqet e tij" .

Mërgimtarët i bënë disa mbledhje, por nuk kishin mundësi të bënin një organizim të mirëfilltë për faktin se propaganda anti-luftë çlirimtare, ishte e madhe. Për të dalë nga kjo anarki apo amulli e krijuar, mërgimtarët atdhetarë vendosën që të bëjnë një kërkesë te Shtabi i UÇK-së që gjërat të sqarohen dhe të dalim hapur me qëndrimet tona. Kishte propozime gjithashtu që të bëhet një demonstratë kundër shtypjes dhe aparteidit shtetëror maqedonas ndaj shqiptarëve.

Nga ky "Këshill i katundeve" që kishte dalë atje, kësaj radhe më kërkuan mua dhe më pyetën nëse do të kem mundësi t'u ndihmoj për të bërë një demonstratë në Kopenhagë. Gjatë bisedës i pyeta: "A ka gisht këtu, A. Kasami"? Ata më thanë – jo! Mirëpo, Remzi Loku dhe Shenazi Aliti – po!

Pastaj u fola se nëse ju doni të kalojë mirë demonstrata, mos i dëgjoni këta të dy sepse me këta po tallet dhe po intrigon A. Kasami. Unë i marr përsipër të gjitha anët organizative, por duhet të keni kujdes të mos turpërohemi para miqve danezë, sepse në demonstratë do të vijnë njerëz me peshë të madhe, si në politikën daneze, ashtu edhe në atë evropiane. Aty do të ketë pjesëmarrës edhe nga fusha e kulturës dhe e mediumeve daneze. Prandaj po ju them, nëse këtu do jenë këto dy vegla qorre të A. Kasamit, unë nuk i hyj kësaj pune, sepse nuk dua që të kompromet ohem, sepse jam i sigurt që ata do të gjejnë shkaqe që ta ndryshojnë datën e demonstratës apo do të bëjnë ndonjë pengesë tjetër, e pastaj do të dështojnë përpjekjet tona dhe unë do pësoj fiasko para danezëve.

Jo, jo! – thoshin – "Ne kemi vendosur të bëjmë demonstratë"!

Mirë pra! Do të fillojmë.

Dhe pa humbur kohë, e fillova aktivitetin, bisedova me njerëz që kishin peshë në politikën daneze dhe më premtuan se do të ishin me ne, do të solidarizohen me demonstratën, si nga radhët e pozitës, ashtu edhe nga opozita. Më premtuan se do të mbajnë fjalime përfaqësuesi i Lidhjes së shkrimtarëve, i PEN qendrës daneze, redaktori i "Politikës" do të paraqitet me një fjalë rasti dhe ato do t´i botojë një ditë më pas. Më premtuan pastaj se do bëjnë një shkrim dhe një peticion që do ta paraqesin para demonstruesve dhe atë peticionin do ta botojnë në gazetë.

Isha i kënaqur për aktivitetin tim dhe kisha bindjen, bazuar në përpjekjet tona, se miqtë danezë tani e tutje edhe më shumë do të na ndihmojnë.

U morëm vesh me Dalifin dhe Abazin për këtë aktivitet. Do të vijë edhe TV e Danimarkës, por kujdes, se po mori vesh A. Kasami

për këtë, do bëjë ndonjë intrigë që ta anulojë demonstratën. Ata këmbëngulnin: "Jo, jo, ato truqe të tij kanë marrë fund, ai turk nuk ka lidhje me ne"!

Dhe si për ironi dhe fatkeqësi, parashikimi im doli. Papritmas, vetëm dy ditë kur do të duhej të mbahej demonstrata, më thonë në telefon se Shtabi i UÇK-së nuk po lejon të bëhet demonstratë, për faktin se kanë vendosur të bëhen demonstrata të njëjta në tërë Evropën për një ditë. Për datën do të vendosë shtabi!

Of, of, of! Çfarë idiotizmi, çfarë mashtrimi! Qëllimi është që ta anulojnë demonstratën! Çfarë të bëja unë i mjeri?! Si ta hiqja nga përgjegjësia dhe si ta shtyja për më tutje gjithë atë aktivitet që pata bërë bashkë me shokët?! Si t´i anuloja gjithë ato ftesa (komunikata) për demonstratën?! U shkrova gazetave. E ftova në telefon në Zvicër, Musa Xhaferin, por nuk e mori telefonin, sepse kohë më parë isha grindur me të. Ashtu i revoltuar i them Dalifit: "Po mirë more vëlla, a të thashë se ai qen do ta gjejë mënyrën sesi të na pengojë"!

Dalifi m´u drejtua dhe më tha: "Beso Xhemil, unë s´dua të kem punë me këta njerëz dhe kurrë nuk bëhem përkrah me këta idiotë"!

Pasi ishte anuluar demonstrata, nuk kaloi një javë dhe nga organizatorë "të shquar" u mbajt shpejt një demonstratë. Mirëpo, në këtë demonstratë kishte pak shqiptarë dhe nuk pati asnjë pjesëmarrës, përfaqësues danezë, që të fliste. Megjithatë, demonstrata u mbajt në praninë e Musa Xhaferit i cili e mbajti një fjalim. Në fakt, kjo ishte një tallje dhe u kuptua fort mirë nga masa se pas këtyre qëndron A. Kasami.

Pas kësaj demonstrate, me dy shokët Ismet Mustafën dhe Qani Jakupin shkuam në "Shoqatën 97". Aty ishte vetëm Abazi. Morëm vesh se Musa po mbante "konferencë me gazetarë" në "Blogords plate Z". I nervozuar tej mase, i them Abazit: "Po ku je ti, përse nuk je ti në atë konferencë. Ti je kryetar i Fondit dhe jo A. Kasami"?! E uli kokën si i marrë. Thotë se A. Kasami është atje. "A ua thashë ty dhe Dalifit se ai i ngatërron të gjitha këto gjëra në Danimarkë". Iu them të shkojmë. Ishin Abrashi, Ismeti dhe Qaniu. Abazi u kthye

nga unë dhe më tha: "Ai është i madhi dhe unë nuk kam se ç`të bëjë atje". Dihet se ky ishte me Dalifin që dikur më luteshin t´u ndihmoja për demonstratën. Në atë kohë Dalifi u tërhoq, ndërsa ky pranoi të bëhet zagar i A. Kasamit në Danimarkë qe sa kohë. Së bashku, me këta tre shokë shkova në sallë ku e kishin organizuar "konferencën për shtyp". Futemi brenda, ç´të shohim! Si gjithmonë, A. Kasami me disa ithtarë të tij të bixhozit, si zakonisht po e luanin lojën *"fluturoi, fluturoi huti"*. Këta e shikojnë në sy A. Kasamin. E pashë që Musa dukej i humbur në atë mes ku ishin 5-6 vetë. Asnjë gazetar apo ndonjë danez. I revoltuar, u them: "Çfarë bëni këtu more të poshtër?! Përse po talleni me ata poshtë (me luftëtarët e lirisë) që po presin diçka, ndihma prej nesh"?! Pastaj iu drejtova Musës. *"O ti shok! A nuk e sheh se ky turkofil po tallet me ty dhe me kërkesat tona popullore. Po ti a e mban mend se kur ishe në vitin 1989 t´i solla në konferencë për shtyp njëzet gazetarë. Bile erdhi edhe Milaim Zeka nga "Ditari i Radio Stokolmit", atëbotë kur nuk kishte kaq aktivitete, siç po ndodh sot në Maqedoni, kur të gjithë janë të interesuar të marrin informacione se ç'po ngjan atje. Ndërsa A. Kasami këtu po i sjell 5 - 6 kumarxhinj të organizosh me ata njëfarë konference për gazetarë. Dhe jeni fshehur në këtë sallë. Por dijeni se gazetarët danezë nuk janë budallenj të vijnë më këtu, sepse ata i kanë sallat speciale për konferenca shtypi. Këto gjëra kur s´i kanë interesuar A. Kasamit që të kryhen si duhet dhe të kemi suksese. Këtij i intereson që juve t´u imponohet, që ky me kompaninë e tij të jenë përgjegjës. Bile kanë filluar të thonë në popull se kanë të dhëna dhe autorizime"*

Në atë çast u nxinë gjakrat. A. Kasami nuk kishte çfarë të thoshte. "Po të dëgjoj" – tha. Atij as që ia vara veshin, ndërsa Musa më tha: "Mos më provoko!

"Jo, nuk po të provokoj. Duke ta thënë të vërtetën në sy se po emëron njerëz që janë shumë të dyshimtë, ti M. Xhaferi ke një përgjegjësi të madhe për këtë. E anuluat demonstratën e cila ishte shumë e mirëpritur edhe nga miqtë danezë dhe po e përkrah këtë turkofilin e mjerë A. Kasamin dhe po bie pre e intrigave të tij duke

mashtruar masën, kinse Shtabi paska vendosur të bëhen demonstrata në gjithë Evropën"!

Musës në atë kohë i pata thënë shkurt e shqip: “Ti mbanë përgjegjësi të madhe sepse me kohë të kam treguar hollësisht se kush është ky turkofI”. Pastaj si mistrec kërceu Eshtref Eshtrefi, të cilin më vonë A. Kasami do ta emëronte si koordinator të UÇK-së për Skandinavi.

Mirë shumë, u emërua një ballist i keq, në bashkëpunim të ngrohtë me titistin. Siç po shihet, e kishte gjetur luga veshin”. Ndërsa pas luftës, ky i fundit, Eshtref Eshterfi, do të kapej me dhjetë kg heroinë dhe, o sa keq, gazetat daneze cituan: “U kap banda shqiptaro-serbe”, për faktin se në bandën e tij kishte edhe pjesëmarrës serbë. Pastaj filloi të më sulmonte pa asnjë argument: “Ti je spiun, enverist etj, etj.”

Pasi që Musa Xhaferi e emëroi A. Kasamin zëdhënës politik të UÇK-së, ky pastaj Abazin e emëroi kryetar të Fondit, që në fakt ishte Remzi Loku. Meqë këtë dai populli e kundërshtonte, atëherë popullit iu tha se kryetar i Fondit është Abazi, ndërsa Eshterf Eshterfin do ta emëronin si koordinator të UÇK-së për Skandinavi.

Pra, t´ua kujtojmë lexuesve se A. Kasamin dhe Eshtref Eshterfin i lidhte një miqësi e tyre, i lidhte në veçanti “sëmurja e bixhozit”, përpëlitjet e tyre nëpër automatet e lojërave të pista të fatit. Ishin të sëmurë dhe kishin bërë operacione të zemrës që të dy. Ishin pensionistë invalidorë dhe po ashtu, që të dy ishin futur në borxhe deri në fyt. Pas përfundimit të luftës, u pa se A. Kasami e kishte sabotuar UÇK-në ,duke mos ia dhënë lekët sot e kësaj dite. Flitet për miliona koronë të grabitur prej tij, kur e kishte në dorë gjithë fondin e UÇK-së për Evropën. Filloi ta sabotonte UÇK-në dhe pas luftës. Ai e shantazhonte BDI-në me lekët, e dirigjonte politikën dhe ekonominë e këtij sekti, kinse si parti politike. A. Kasami i pati premtuar kryetarit të Fondit - Remzi Lokut se do t’ia jepte postin e drejtorit të doganës së Maqedonisë, por ky plan u dështoi, siç u dështoi edhe plani për kryetar të degës së BDI-së në Tetovë. U përpoqën mjaft t´i japin poste siç ishin: drejtor i

aeroportit të Shkupit, kryeshef policie në Tetovë, drejtor i stadiumit në Tetovë etj.

Në Danimarkë, bashkatdhetarët e në veçanti punëtorët, i njohin me siguri më mirë se unë dhe dinë më shumë gjëra për këta elementë reaksionarë dhe për ato ngjarje që i theksova më lart, mirëpo këto kujtime të hidhura, por shumë të vërteta, janë nga ditari im, nga ato përpjekje të mia për t'i mbajtur kujtimet për aktivitet në Danimarkë. Fatmirësisht, me kohë kam mbajtur shënime.

Është shumë interesant dhe tejet për t'u habitur fakti, përse mërgatës shqiptare këtu, kurrë nuk i është dhenë të paktën një shpjegim për ato rrethana të asaj kohe, apo për më keq, nuk i është dhënë asnjë falënderim publik për aktivitetin dhe ndihmën që e kanë dhënë atdhetarët dhe atdhetaret tona.

Disa ditë para vitit të ri, papritmas mora lajmin se në udhëtim e sipër nga Norvegjia, një delegacion i sektit të prapë politik që u emëruar BDI, marrin mundimin dhe vijnë edhe në Danimarkë. Në atë delegacion thanë se do të ishin z. Ali Ahmeti, Xhevat Ademi dhe Hysni Shaqiri. Në prani të 200 vetëve sa morën pjesë, aty nuk ishte "udhëheqësi dhe organizatori kryesor" i UÇK-së - A. Kasami, edhe pse ato ditë ndodhej në Danimarkë.

Unë shkova me qëllim sepse kisha dëshirë dhe shpresa se do të ishte aty edhe ai. Desha që në prani të të gjithë pjesëmarrësve t´i thosha në sy të gjitha të palarat e tij "politike", t´i thosha të gjitha, pasi Aliut dhe Xhevatit ua kam treguar këto turpe dhe krime të tij. Them, krime të tij, sepse konsideroj se janë krime të rënda ato, të sabotosh luftën çlirimtare të kombit tënd.

Më kujtohet fort mirë kur Xhevati e quante "Hale Kasami". Pikërisht në atë mbrëmje ai e mbrojti aq shumë A. Kasamin, sa që u habita tepër.

Korrupsioni dhe tradhtia i lidhi bashkë apo çfarë ngjau, nuk munda të kuptoj dhe prej atëherë i ndërpreva të gjitha marrëdhëniet me Xhevatin. Ai mori drejtim të kundërt, madje edhe me vetveten e tij.

Koha ka dëshmuar dhe po dëshmon se kujtimet e tilla që veprimtarët atdhetarë i kanë shkruar për vite të tëra jashtë vendit të shqiponjave, ishin, janë dhe do të jenë pa dyshim pjesë e historisë sonë të ndritur, që nga koha rilindësve e gjer në ditët tona. Fatkeqësisht, çështja shqiptare nuk është zgjidhur drejt deri sot, as në raportet e jashtme me fqinjët, as në raportet e brendshme me faktorin ndërkombëtar ***unmik-eulex***-*in*, të cilët, duke u instaluar në Kosovë si institucione ndihmëse të demokracisë, janë këto pikërisht ata që po e shkelin me të dyja këmbët këtë demokraci të proklamuar. Gjendja nuk është aspak e kënaqshme me faktorët politikë shqiptarë në pushtet, me devijuesit e të gjitha ngjyrave. Në këtë kohë kur kaq shumë bëhet zhurmë e çohet pluhur se "Shqipërinë demokratike e kemi radhitur në radhën e shteteve të demokracisë së vërtetë perëndimore", duke u anëtarësuar në NATO dhe duke pretenduar të integrohet në BE.

Një punë shumë të mirë kanë bërë dhe po bëjnë në këtë drejtim, pra me të shkruarit e kujtimeve, veprimtarët e dëshmuar dhe ish-të burgosurit politikë, në radhë të parë Shoqata e të burgosurve politikë e Kosovës me Hydajet Hysenin si udhëheqës. Për punën e madhe dhe për kontributin e veprimtarëve të të gjitha organizatave, propozoj që sa më parë të krijohet një fond për t´i ndihmuar ish-të burgosurit politikë dhe atdhetarët e ilegales që t'i botojnë librat e tyre të këtij zhanri.

Meriton të theksohet se një punë të madhe në ndihmë të veprimtarëve të të gjitha organizatave po e bëjnë Faik Smajli në ueb-faqen albaniapress dhe Sheradin Berisha me ueb-faqen "Pashtriku", si dhe të tjera agjenci informative. Më këtë rast, dua të theksojë gjithashtu, se, një punë të madhe në këtë drejtim, pra, në evokimin e kujtimeve për organizimin e qëndresës çlirimtare, kanë bërë, Nysret Pllana , Ahmet Qiriçi, me "Radio-Kosovën e Lirë"; Fehmi Berisha, Ramadan Pllana, " Dëshmi Kohe", (ende e pabotuar libër), si dhe veprimtarët Faredin Tafallari, Ibrahim Kelmendi, e të tjerë.

Por, kujtoj që ende nga ky aspekt tepër peshë për të ardhmen e breznive tona, që ta njohin historikun e ilegales çlirimtare, për gati

gjysmë shekulli, në këtë kohë krizash të mëdha, nuk është bërë sa do të duhej të bëhej.

Pse, fjala vjen, nuk dalin hapur, por ngurrojnë të flasin e t´i shkruajnë kujtimet të këtij zhanri tejet demaskues dhe me vërtetësi e paanshmëri - siç ka dalë në shumë shkrime i madhi atdhetar, simboli i rezistencës shqiptare, Adem Demçi , në librin me rrënjë të thella të historikut , "Dosja e Demaçi"e shkruar nga historiani ynë i madh Hakif Bajrami.?!

Në këtë aspekt, punë të mirë kanë bërë edhe atdhetarët, ish- i burgosurit politik Et´hem Çeku, në librin,"Kosova ne sfondin e diplomacisë se Jugosllavisë dhe te Shqipërisë ne vitet 1945-1981", Autori ka bërë objekt të studimit të vet shkencor Kosovën dhe përpjekjet e vazhdueshme te shqiptarëve për te ndryshuar skemat e fiksuara prej të mëdhenjve në fillim të shekullit XX e për ta shndërruar Kosovën në shtetin më të ri të botës dhe qytetarët e saj si pjesëtarë të lire të Evropës moderne.

Por, me këtë rast, bëj pyetjen, vallë, a është duke i shkruar kujtimet e tij të burgut dhe të luftës edhe Nasim Haradinaj, -sa shumë do të kishin vlerë të madhe gjithashtu, për breznitë e reja edhe kujtimet e veteranëve (tani të ndjerë), Smajl Haradinaj (babait të Nasim Haradinajt), Metush Krasniqit, Ramadan Shalës, Ahmet Haxhisë, Ali Aliut –Preshevës e të tjerë.

Lexuesit janë të njohur me shkrimet e Hydajet Hysenit, si poet i mrekullueshëm, me poezi të fuqishme epiko-lirike , e ka pasqyruar jetën e rëndë dhe krenare të burgut, por, kujtoj që, ende nuk i ka shkruar kujtimet e tij dhe të shokëve ilegalë; përveç disa paraqitjeve publike në rtv. Kujtoj, që do të ishte tepër me interes kombëtar t´i shkruante kujtimet e tyre madhështore dhe me të vërtetat e hidhura edhe veprimtarët Sejdi Veseli, Emrush Xhamajli, Afrim Morina, Emin Krasniqi,Bajram Kosumi, Ahmet Isufi, Xhevat Bislimi, Berat Luzha, Ismet Sopi, Hilmi Muzaqi, Hazir Xhafolli, Jakup Shyti, Halil Kuliqi, Hajdin Abazi e shumë të tjerë.

Nuk kanë ngelur prapa në këtë drejtim, atdhetarët; Rasim Selmani, Rexhep Ahmeti, Jakup Krasniqi; të cilët për këtë punë të devotshme i përgëzoj.

Pa dyshim se lexuesve, në mos për asgjë tjetër, bile për një fakt: jam i bindur që, ua ka bërë me dije se, rrugët e mërgimit janë njëra anë e medaljes së zezë- për çdo mërgimtar, të cilit i mungojnë të afërmit e tij, -aq të dashur, -pastaj,i mungojnë uji, buka dhe natyra me klimën aq të bukur dhe të qëndrueshme, të trojeve shqiptare. Mirëpo, si vet zhvillimet e larmisë jetësore ku, madje edhe në këtë fatkeqësi gjendet një dritë në tunelet e jetës.

E kjo dritë të cilën duhet ta gjakojnë të gjithë shqiptarët dhe shqiptaret, është veprimtaria e pandërprerë e palodhshme dhe mbi të gjitha e guximshme, deri në sakrificat më sublime, për lirinë, përparimin, ribashkimin dhe barazinë e kombit tonë të lashtë dhe të ri. Personalisht jam munduar që të bëj të pamundurën dhe me veprimtarinë time të pandërprerë atdhetare, këtij qëllimi madhor i jam përkushtuar me të gjitha forcat e mendjes, të zemrës, të gjakut dhe të djersës.

Nga këto kujtime lexuesit kanë mësuar për shumë ngjarje, të heshtura gjer më tani, që kanë ndodhur në vendin skandinav, do të thosha në qytetin e një kulture të lashtë, me tradita shekullore në shkencë, art, kulturë, politikë e të tjera sfera të jetës, në një metropol të botës siç është Kopenhaga, një kërthizë e rrugëve tokësore, detare dhe ajrore, një kërthizë e udhëkryqeve të marrëdhënieve politike dhe diplomatike të sotme ndërkombëtare.

"Vendosmëria, përkushtimi dhe guximi për të arritur objektivat madhorë për çlirim, e bëjnë edhe të pamundshmen, të mundshëm.

Sikur të bëhej kjo vetëm përkohësisht para tri luftërave që i bëmë ne shqiptarët, megjithatë kohën robëri, pa le ta hante djalli! Mirëpo, fatkeqësia dhe tragjedia më e madhe qëndron aty se bëhen shkelje flagrante mbi ***flamurin, gjuhën, identitetin.*** Kujtoj këtu

mohimin e vlerës së ndritur të kombit, emblemës së LSHP. Më tragjikja e të gjithave është se u bënë e po bëhen shkelje flagrante mbi territorin shqiptar, që po ricopëtohet përditë. U bë kjo maskaradë e tejskajshme politike, pas atyre tri luftërave çlirimtare, pas gjithë atyre ndjekjeve të gati gjysmës së kombit jashtë vendit, dhunimeve, persekutimeve, vrasjeve e të tjera mynxyra që na i bënë sllavët okupatorë, që zor se do t´i shkruanin malet me lapsa dhe një det me ngjyra.

Ata nuk kishin as nuk po kanë aspak mëshirë ta pengojnë lirinë e shqiptarisë, ndërsa ne për "modesti personale" dhe "ruajtje të unitetit kombëtar", nuk kemi kurajë të duhur t´i godasim pamëshirë me të vërtetat e hidhura që ata i kanë bërë dhe po i bëjnë! **Pra tani e tutje, edhe më fort, edhe nga kjo fushëbetejë t´i shërbejmë lirisë!**

Duke i analizuar këto kujtime, medoemos më shkojnë mendime ***si rrufe*** për të gjitha këto turpe. Faji nuk qëndron vetëm tek ajo pjesa e sëmurë e kombit, e infektuar me tradhti, por ky faj herë-herë qëndron edhe te disa "krerë tarafë" e "matufë bajraktarë" të lëvizjeve dhe të organizatave çlirimtare. Jo të ngritur sa duhet politikisht, nuk kanë ditur as kanë mundur të ecin vertikalisht në rrugën e rrëpirët të ilegales.

Them kështu sepse jo rrallë ata lejuan që, herë për arsye meskine, herë për shkaqe mendjemadhësie, herë marrëzie politike, herë të mashtruar nga interesat personalë, të binin e të bëjnë "pazare" me tyxharët politikë antikombëtarë, të cilët në radhët e ilegales kishin hyrë për punë joserioze. Mirëpo, të gjithë këta xhelatë bukëshkalë i bashkonte një qëllim – ta sabotonin dhe ta shkatërronin nga brenda kalanë shqiptare, lokomotivën kryesore të shkatërrimit të shteteve armike. Mbase për këtë edhe paguheshin me dollarë, marka e dinarë. Duke u bazuar në këtë pikë të dobët dhe "neuralgjike", kujtoj se jo rrallë ilegalja ka marrë goditje të forta dhe kishte humbje të mëdha të kuadrove kyç të saj. Kjo pastaj kishte pasoja të mëdha organizative për ecjen përpara. Kujtoj këtu vëllezërit Gërvalla dhe Kadri Zekën, Rexhep Malën, Nuhi Berishën,

Bajram Bahtirin, Zija Shemsiun, Fadil Vatën, Afrim Zhitinë, Fahri Fazliun etj., të cilët me të drejtë konsiderohen dhe ishin udhëheqës dhe luftëtarë të paepur të çështjes shqiptare.

Disa të paditur politikë dhe jopolitikë që do t´i konsideroja naivë dhe cinikë thonë se ngritja e kësaj çështjeje dhe të shkruarit e kujtimeve nga ata që e kanë bërë historinë tonë të lavdishme, është një punë me të cilën ”nuk duhet të merremi” sepse **“kohët e liga kanë kaluar”**. Kështu mendojnë këta shkretanë, por këtu mendoj se fshihet, jo vetëm një padituri, por dhe një qëllim i prapë që të mos dihet shumë për veprimtarinë tradhtare ose të mos demaskohen disa “krerë” të ilegales për veprimtarinë e tyre të dështuar, të mos demaskohen as elementët reaksionarë që në ato vite, kur po ziente si vullkani revolucioni popullor, kishin marrë detyra nga UDB-ja dhe KOS-i si dhe nga agjentura të tjera të jashtme, që t´ua vrisnin lirinë shqiptarëve. Por fatmirësisht, llogaritë e veta i kishin bërë gabim, sepse revolucioni shpërtheu si vullkan dhe çështja shqiptare nuk mbeti përjetësisht nën hirin e historisë sonë të re.

Uroj që kjo punë e devotshme të arrihet me sukses, që historia jonë e lavdishme të lartësohet akoma më shumë, që ardhmëria jonë të bazohet mbi të vërtetat e mëdha dhe të pathyeshme dhe të marrë kah të ndritur dhe më të sigurt.

Fund

Danimarkë, 15 qershor 2010

Pjesa e katërt

LETRA, PETICIONE DHE TELEGRAME

LETËR E HAPUR QEVERIS DHE KUVENDIT DANEZE!

Kopenhagë, 05.10.2005

Kush duhet të vendosë për të ardhmen e Kosovës?

Këto ditë pritet të publikohet raporti për situatën në Kosovë, raport ky i përpunuar për sekretarin gjeneral nga Kai Aide. Raporti do të përmbajë njoftimin se sa shqiptarët i kanë plotësuar kërkesat e ashtuquajtura standarde të demokracisë dhe të drejtave të njeriut, të cilat OKB-ja i ka vendosur që t`i ndërlidhë drejtpërsëdrejti me çështjen e së ardhmes së Kosovës.

Para 6 vitesh u nënshkrua Marrëveshje e Rambujesë, në emër të popullit shqiptar pa u paraqitur fare një debat i gjerë popullor. Përfaqësuesit shqiptarë u detyruan ta nënshkruajnë këtë marrëveshje dhe pastaj t`i proklamojnë popullit se çështja e statusit të ardhshëm të Kosovës u zgjidh! I premtuan atij se kjo do të zgjidhet sipas vullnetit të popullit!

Por, në vend të zgjidhjes së çështjes kaq madhore, pasoi persekutimi i një milion shqiptarëve dhe luftërat në Kosovë: 120.000 shtëpi u dogjën nga militarët serbë, 20.000 gra u dhunuan, 12.000 persona u vranë. Pas luftës, zot i pushtetit real u bë UNMIK-u. Asnjë nga premtimet për shqiptarët nuk u realizuan, 3000 persona të zhdukur ende nuk janë gjetur. Kosova vazhdon të jetë nën kontroll të UNMIK-ut. Sot papunësia në Kosovë ka arritur në 70%, shumë më lartë se në ndonjë vend tjetër në Evropë.Sipas Bankës Botërore, Kosova është i vetmi vend në Evropë që nuk ka zhvillim ekonomik (rritje ekonomike). Sistemi arsimor po bie.Edhe pse numri i të rinjve është në rritje, numri i studentëve në vitin shkollor 2004/2005 ishte shumë më i vogël se në vitin shkollor 1998/1999, kur studentët dhe mësimdhënësit shqiptarë ishin në kacafytje të përditshme me policinë serbe. Krahas kolapsit ekonomik kriminaliteti ekonomik zgjerohet para syve të UNMIK-ut.

Zhvillimi në Kosovë vazhdon krejtësisht në rrugë të gabuar.Unë kam një njohuri solide për Kosovën por nuk mund të përmend asnjë lëmë ku shqiptarët kanë një gjendje të mirë.

Frustracionet po shtohen dhe gjendja mund të ndryshojë shumë shpejt me eskalimin e demonstratave të mëdha si në vitin 2004 kur shumë persona humbën jetën.

Më lejoni të kujtoj se pas konfliktit të përgjakshëm, ish-udhëheqësi i UNMIK-ut Hari Holker pat premtuar se do t`i shqyrtojë ankesat e popullit (qytetarëve) kundër policisë dhe ushtarëve për reagimet e tyre brutale ndaj demonstratave paqësore. As edhe ky premtim i UNMIK-ut nuk u realizua. Në një varg rastesh UNMIK-u është sjellë shumë ashpër ndaj aksioneve paqësore të shqiptarëve.Shumë persona, vetëm se kanë organizuar demonstrata, për shprehjen e mendimit të lirë, janë arrestuar nga UNMIKU-u. Këto që janë të mbrojtura me ligj në Danimarkë.

Por, kush i mbron shqiptarët në Kosovë?

Ne mendojmë se habia më e madhe është kur ju mendoni se për çështjen e Kosovës do të vendosë OKB-ja apo komuniteti ndërkombëtar dhe jo populli i saj. Ne mendojmë se kjo është antidemokratike.

Për ardhmërinë e Kosovës duhet të vendosë populli i saj!

Dihet historikisht deri sot që çdo herë kufijtë në Ballkan janë ndryshuar dhe kurrë s´janë pyetur shqiptarët. Popujt tjerë në ish-Jugosllavi kishin të drejtë që të vendosin për fatin e tyre me anë të referendumit. Edhe shqiptarët, unanimisht kërkuan lirinë e tyre përmes një referendumi në Kosovë por fuqitë e mëdha refuzuan të njohin rezultatin. Dhe që atëherë zhvillimet morën kahjen e gabuar dhe gjendja në Kosovë vazhdoi të keqësohet.

Pse Danimarka nuk e përkrahë idenë që shqiptarët të dëgjohen dhe vetë të vendosin për fatin e tyre përmes një referendumi, të vendosin vetë për të ardhmen e Kosovës?!

Në zgjedhjet e fundit në Kosovë ku kanë marrë pjesë më pak se 50%, nga shumë qytetarë të Kosovës ka pasur ankesa dhe janë cilësuar si jodemokratike për faktin se nuk kanë pasur mundësi të votojnë për kandidatin e dëshiruar pasiqë është dashur të votohet vetëm për partinë, me lista të mbyllura. Një gjë e tillë s´do të ishte e mundur në Danimarkë.

Si rezultat i kësaj situate kritike në Kosovë është themeluar Lëvizja për Vetëvendosje, nën udhëheqjen e Albin Kurtit – ish-lider i Lëvizjes studentore të vitit 1997/1998, i cili ishte burgosur nga policia serbe gjatë bombardimeve të NATO-s dhe u lirua vetëm pas përfundimit të luftës.

Albin Kurti dhe kjo lëvizje që e udhëheq ai, shpreh pa dyshim dëshirën për VETËVENDOSJE të shumicës së popullit shqiptar në Kosovë.

Mendojmë se është ide antidemokratike që të organizohen negociata në qarqe të ngushta nga politikanë të zgjedhur, ndaj kërkojmë të dëgjohet vullneti i populli të Kosovës për herë të parë në histori, si dëshiron të deklarohet, të përcaktohet për ardhmërinë e vet.

Me nderime!

Në emër të Lëvizjes Vetëvendosje!

Xhemil ZEQIRI, Kopenhagë

LETËR E HAPUR KRYEADMINISTRATORIT TË KOSOVËS SOREN J. PETERSEN

Nuk e di a je i informuar z. Petersen se ditëve të fundit, zëvendës-protektori Lori Rosi e nënshkroi rregulloren (ligjin) e UNMIK-ut, Nr.2005/16, sipas së cilës nga 1 maji 2005 do të fillojë aplikimi i vizave për shqiptarët dhe vetëm për shqiptarët që i keni ndarë në pesë shtete.

Nga këto viza vazhdojnë të privilegjohen vetëm serbo-malazezët.

Me këtë akt juridik, ju zotëri edhe njëherë po e tregoni hapur vasalitetin që e keni ndaj qeverisë së Beogradit, e cila prej kohësh e ka kërkuar këtë.

Qeveria e Beogradit e ka vënë në lojë të rrezikshme UNMIK-un me shqiptarët, që nga Marrëveshja e Rambujesë, ajo e Kumanovës e deri te Marrëveshja Hekerup-Çoviq.

Te këto marrëveshje e kanë burimin të gjitha fatkeqësitë e shqiptarëve. Nga këto, burimin e kanë Rezoluta famëkeqe 1244, Korniza kushtetuese, loja politike për standardet, ndjekja dhe burgosja e çlirimtarëve. Pra në vend që OKB-ja t´i përkrahte çlirimtarët, ajo me ndihmën e institucioneve të veta dhe me ndihmën e kolaboracionistëve shqiptarë që fatkeqësisht i morën edhe votat e popullit, po bën gjithçka që t´i eliminojë nga skena politike ata që nuk e pranuan shtypjen nën regjimin e S. Millosheviqit dhe që i rrokën armët për t´ia sjellë Kosovës lirinë.

Përse luftuan shqiptarët, unë s´po marr mundimin t´ju përgjigjem, sepse këtë më së miri e ka paraqitur intelektuali Beqir Berisha në letrën e hapur diplomacisë ndërkombëtare, me titull *„Përse luftuan shqiptarët“?!*

Por tani unë do të shtoja se që nga viti 1913 deri më sot, nën arsyetimin e ruajtjes së paqes në rajon, trojet shqiptare u copëtuan në vazhdimësi. Si pasojë e politikës së dhunës dhe të gjenocidit,

burgjet e Serbisë dhe të ish-Jugosllavisë, kurdoherë ishin plot shqiptarë.

Prej atëherë s´ka pasur dhe s´do të ketë paqe në rajon pa u zgjidhur çështja shqiptare.

Fatkeqësisht, kjo po ngjan edhe sot. Kësaj politike okupuese serbe po i shërbeni edhe ju, sepse edhe sot burgjet e UNMIK-ut dhe të Hagës janë plot shqiptarë për „faje“ politike.

Koncepti i diskriminimit po vazhdon. Nga kjo konstatoj se kjo është shumë e rrezikshme për të sotmen dhe për të ardhmen e Kosovës dhe jo vetëm të saj, por edhe të rajonit.

Derisa ju ditë e natë po flisni me plot gojën për integrime në Ballkan dhe në Evropë si dhe për heqjen e kufijve midis shteteve, papritur, te këmbët e shqiptarëve bie si bombë vendimi dhe ujdia midis UNMIK-ut dhe Serbisë për ngritjen e vizave në kufijtë shqiptaro-shqiptarë!

Duke bërë këtë ju po shkelni me të dy këmbët të drejtat njerëzore dhe kombëtare të shqiptarëve, po i diskriminoni ata si njerëz të klasit të dytë, në raport me popullin serbë dhe popujt tjerë në Ballkan.

Nëse ju zotëri dëshironi ta shihni Kosovën duke ecur me hapa të sigurt drejt Evropës, sikundër shpreheni me diplomacinë tuaj dredhake, mos mendoni se kjo do të arrihet ndonjëherë, duke vënë barriera të tipit serb.

Ju po kalkuloni me alternativa të ndryshme jashtë standardeve demokratike me Grupin e kontaktit, që Kosovës t´ia përcaktoni apriori dhe nga lartë, ardhmërinë e saj.

Duke bërë këtë, ju sharroni më thellë në batakun e historisë së re të demokracisë botërore, sepse po e shkelni të drejtën e një kombi të lashtë, për VETËVENDOSJE.

Ju po paraqisni alternativa të llojeve të ndryshme: herë pavarësi pa sovranitet (se sovranitetin ia keni falur dhuratë Serbisë), herë autonomi të zgjeruar, herë pavarësi të kushtëzuar. Këto

makinacione diplomatike e kanë lodhur së tepërmi popullin e Kosovës, të dalë nga lufta.

Populli i Kosovës ka duruar për vite. Në vitet ’90 të shekullit XX, nën regjimet e egra serbe, me shpresë që një ditë bota demokratike do ta kuptojë. Por kjo fatkeqësisht nuk ndodhi, ndaj u detyrua t´i rrokë armët. Po tani, deri kur t´i durojë këto makinacione tuaja, ma thoni zotëri?!

Nëse keni durim zotëri Petersen, shpalosni arkivat ballkanike dhe evropiane. Në to, në vitin 1904 shkruan se shqiptarët etnikë jetojnë në një hapësirë prej 114.000 km katrorë.

Sot në Ballkan jetojnë përafërsisht tetë milionë shqiptarë dhe tetë milionë të tjerë nëpër botë. Kjo tregon se tragjedia shqiptare ishte dhe është tepër e tmerrshme.

Por, në Shqipërinë të njohur ndërkombëtarisht si shtet, i kemi vetëm 28.000 km katrorë. Më thoni zotëri, ku janë ato qindra e mijëra kilometra katrorë të trojeve shqiptare? Ato territore janë grabitur gjatë shekujve e deri sot, nga shtetet fqinje ballkanike.

Po të them edhe diçka për të cilën ndofta ti s´ke njohuri. Ne, vërtet patëm fat tragjik në histori, por kurrë s´jemi pajtuar me këtë fat, me ato padrejtësi që na i serviri Evropa prej kohës së Bizmarkut deri më sot.

Me rezistenca paqësore dhe me luftëra çlirimtare, me djersë e gjak e kemi mbrojtur dhe do ta mbrojmë identitetin tonë kombëtar.

Kopenhagë 26-04-2005

LETËR E HAPUR PARTIVE, PARLAMENTIT DHE QEVERISË SË DANIMARKËS

E ardhmja e Kosovës duhet të sqarohet tani.

I lejoj vetes sime t´ju tërheq vëmendjen Tuaj në lidhje me negociatat për të ardhmen e Kosovës, që për momentin zhvillohen në Vjenë. Deri tani nuk është arritur në ndonjë marrëveshje të rëndësishme, por duke u bazuar në ato informata që kanë dalë nga takimet, duket sikur edhe një herë janë duke u marrë vendime për të ardhmen e Kosovës, pa e dëgjuar popullsinë.

Që nga luftërat në Ballkan dhe nga ndarja tragjike e Jugosllavisë, Kosova është kthyer në një pjesë të harruar të Evropës. Vite me radhë, zgjidhja e problemeve të Kosovës është shtyrë për në një të ardhme akoma më të pasigurt. Duke i vulosur me justifikimin ”mosmarrëveshje etnike”, Fuqitë e Mëdha i kanë hequr popullit të Kosovës edhe një herë të drejtën për të vendosur për të ardhmen e saj. Një e drejtë e cila ishte e siguruar nga Kushtetuta e mëparshme e ish-Jugosllavisë dhe që duhej të ishte garantuar nga konventat ndërkombëtare.

Fati i Kosovës ka qenë vendosur për së tepërmi nga fakti që një pjesë dërrmuese e popullsisë ishin shqiptarë. Në ish-Jugosllavi shqiptarët ishin grupi i tretë i popullatës nga madhësia, megjithatë kishin më pak të drejta se popujt e tjerë të Jugosllavisë. Sot nuk ka stacione të huaja televizive që raportojnë nga Kosova dhe nuk ka gazetarë të huaj që provojnë të zbulojnë nën sipërfaqe dhe të përshkruajnë pafuqinë dhe zemërimin. Kjo do të rritet dita-ditës derisa të vërshojë mbi sipërfaqe. Në Kosovë kanë të drejtën e votës. Kjo e drejtë ekzistonte edhe në ish-Jugosllavi. Por, kur papunësia është mbi 60 %, kur më shumë se 15% jetojnë në varfëri të thellë dhe skamja e varfëria karakterizojnë mënyrën e jetesës për më shumë se gjysmën e popullsisë, atëherë është vetë lufta për mbijetesë e cila karakterizon jetën e përditshme. Administrata e UNMIK-ut në Kosovë e ka lënë të gjithë shoqërinë në vendnumëro.

Në vitin 2004 Kosova eksportoi mallra me një vlerë 45.1 milionë euro, por importoi 25 herë më shumë. Përpos në bazën e madhe amerikane në zonë, tjetër kund nuk ndërtohet as investohet. Të vetmet rritje në Kosovë janë varfëria dhe papunësia. UNMIK-u e ka administruar Kosovën tashmë 7 vjet. Filloi si një fazë kalimtare, por sot prania e UNMIK-ut gjithnjë e më tepër, nga popullsia në Kosovë konsiderohet si një pushtim dhe si një morsetë që i është kyçur shoqërisë, e komanduar nga një administratë që s´ka as dëshirë të veprojë dhe as vizione për zhvillimin e shoqërisë.

Administrata e UNMIK-ut është totalisht jodemokratike, sepse popullsia është e penguar që në mënyrë reale të vendosë në lidhje me fatin e saj. UNMIK-u është kthyer në një mjet për pengimin e realizimit të dëshirës për liri. Shqiptarët thjesht, të lihen në fazën e dëshirës.

Gjatë negociatave, Fuqitë e Mëdha janë fokusuar në vendosjen e të ashtuquajturave standarde në një sërë fushash në Kosovë, përfshirë këtu demokracinë dhe të drejtat e njeriut. Por, përgjegjësia për nxitjen e zhvillimit demokratik, sot është e njëanshme dhe ndodhet në duart e UNMIK-ut. Popullsia nuk vendos në lidhje me pasuritë natyrore dhe politikanët e zgjedhur nga populli nuk kanë autoritet të hapin madje edhe një stacion autobusësh. Në këtë mënyrë është krijuar situata absurde ku UNMIK-u fokusohet te çështja e zhvillimit të të ashtuquajturave standarde demokratike, ndërsa shumicës së popullsisë i mungon liria, puna dhe demokracia e vërtetë.

Konfliktet dhe problemet sociale gjithnjë e më të ashpra kanë krijuar klimën më të keqe në marrëdhëniet midis grupeve etnike. Një kusht vendimtar për të mbyllur plagët e shumë viteve të përgjakura, është që e gjithë zona të nxirret nga varfëria. Mungesa e aftësisë së UNMIK-ut për të krijuar një zhvillim të tillë ka ndikuar faktikisht në zgjatjen e konfliktit midis shqiptarëve dhe serbëve dhe ka ruajtur arsyen e ndarjes etnike të shoqërisë, në kundërshtim me deklaratat e bukura nga konferencat e shumta, të cilat janë mbajtur gjatë këtyre viteve në Kosovë.

Faktikisht në Kosovë kanë shkuar shuma jo të vogla parash - 2.5 miliardë euro në më pak se 7 vjet. Në një shoqëri ku ende pjesë të mëdha të ekonomisë kontrollohen nga banda të organizuara kriminale, rrjedhimisht një pjesë e donacioneve të huaja kanë përfunduar në xhepat e pak personave, por rrallëherë në dobi të popullsisë. Gjatë kohës që UNMIK-u ka pasur përgjegjësinë në Kosovë, jeta politike është bërë më burokratike dhe e korruptuar. Kjo natyrisht ndërthuret edhe me mungesën e ndikimit të vërtetë të shoqërisë dhe me rritjen e varfërisë në shoqëri. Kjo nuk është diçka që i godet vetëm shqiptarët. Edhe serbët e zakonshëm paguajnë një çmim të lartë. Askush nuk përfiton nga miliardat e shumta që dërgohen në Kosovë. Paratë zhduken si uji në shkretëtirë dhe përdoren për mbajtjen e konferencave të shtrenjta, për rrogat e larta të të huajve që janë kthyer në zotërues të rinj në Kosovë dhe për të zgjatur jetën e korrupsionit politik. Kjo është pasojë e drejtpërdrejtë e mungesës së demokracisë në jetën politike.

Ajo që ndodh në Kosovë duhet parë nga një këndvështrim historik, përndryshe nuk mund të dihet sesi do të gjendet arsyeja e një zgjidhjeje permanente. Natyrisht, nuk është një proces i thjeshtë, por ecuria duhet bazuar në disa parime bazë dhe në të drejtën ndërkombëtare.

Shqiptarët nuk i kanë njohur kurrë kufijtë në Ballkan. Janë shumë që pohojnë diçka tjetër. Midis tyre edhe shefi i mëparshëm i UNMIK-ut, Hans Hakkerup. Por këto janë deklarata të pabaza. Shteti shqiptar u formua me do kufij që ishin tragjikë për shqiptarët. Më shumë se gjysma e popullsisë dhe e trojeve shqiptare, sot e kësaj dite ngelën jashtë Shqipërisë. Ky është një padrejtësi e padëgjuar, pa shembuj të mëparshëm në historinë e re të Evropës. Kufijtë iu imponuan Shqipërisë, pa i dhënë popullsisë së saj ndonjë mundësi për të shprehur qëndrimin e saj. Kjo ndodhi për herë të parë në Konferencën e Fuqive të Mëdha në Londër më 1912-1913.

Padrejtësia vazhdoi pas Luftës së Dytë Botërore, ku çështja kombëtare e shqiptarëve ngeli e pazgjidhur sepse pjesa dërrmuese e shqiptarëve banonte në territoret në vazhdim. në shtetet fqinje me

shtetin e ri shqiptar. Kur ish-Jugosllavia u shpërbë, të gjitha grupet etnike zhvilluan referendumet e tyre popullore, si bazë për krijimin e shteteve të reja të cilat më pas u njohën nga bashkësia ndërkombëtare. Gjithashtu edhe në Kosovë u zhvillua një referendum i tillë. Por pavarësisht nga rezultati gati i njëzëshëm, nuk ishte asnjë që e njohu të drejtën e Kosovës për shkëputje nga federata jugosllave. Nëse kjo do të ishte bërë atëherë, ndoshta do të ishte anashkaluar spastrimi brutal etnik i shqiptarëve dhe konflikti pasues i përgjakshëm. Por, Fuqitë e Mëdha ishin më të zëna me sigurimin e zonave të tyre të influencës në Ballkan, sesa me sigurimin e drejtësisë.

Situata në Kosovë është kaq e rëndë saqë në mënyrë urgjente duhet të zgjidhet statusi i saj për të ardhmen. Në thelb, nuk ekzistojnë mundësi të mëdha, nëse statusi i Kosovës mbetet i pasqaruar. Pyetje e një referendumi mund të ishte p.sh. nëse banorët e Kosovës dëshirojnë të ngelin nën Serbi apo dëshirojnë ribashkim me Shqipërinë. Kjo pyetje bazë nuk duhet të mbetet për t'u vendosur përsëri nga Fuqitë e Mëdha, pas dyerve të mbyllura. Vendimi duhet të merret nga ata njerëz të cilët lindin, jetojnë dhe vdesin në Kosovë. Është vendimtare që popullsia të vendosë në lidhje me të ardhmen e saj. E ardhmja e Kosovës duhet të vendoset nga popullsia nëpërmjet një referendumi popullor.

Përshëndetje shoqërore!

Xhemil Zeqiri

Kopenhagë, më 6.4.2006

STOP PËRNDJEKJES SË POPULLIT SHQIPTAR NË MAQEDONI!

PETICION

VËLLEZËR E MOTRA MËRGIMTARË SHQIPTARË!
TË NDERUAR MIQ TË SHQIPTARËVE!

Një konflikt i kamotshëm në Maqedoni, përsëri është rishfaqur në mënyrë tejet të dhunshme, para ca javësh. Në njërën anë është popullata e madhe shqiptare, e cila përbënë shumicën e banorëve të Maqedonisë, në anën tjetër janë zyrtarët maqedonas dhe bashkëpunëtorët e tyre ndërkombëtarë.

Shqiptarët për vite të tëra kanë luftuar për një Kushtetutë, e cila do t´i siguronte të drejtat e tyre kombëtare dhe të drejtat e tyre sociale , në të njëjtën linjë ashtu si edhe popujt tjerë në Maqedoni i kanë.

Në vend që t´i ofrojnë ato të drejta dhe mundësi, zyrtarët maqedonas radhazi i kanë ngulfatur protestat e shqiptarëve me gjak.

Zyrtarët maqedonas tani, përsëri po ua mohojnë shqiptarëve disa të drejta që shqiptarët i fituan me luftën çlirimtare, pas shkatërrimit të Jugosllavisë.

Si rast më i freskët është kur Gjyqi Kushtetues i Maqedonisë, e ndaloi përdorimin e Flamurit të tyre kombëtar.

Shumë pak danezë e njohin të vërtetën në Maqedoni!

Mbi 80% e shqiptarëve atje, janë të papunë.

Sistemi social atje, realisht është i shkatërruar.

Pesimizmi dhe revoltat, asnjëherë nuk kanë qenë më të mëdha se tani.

Tani, ushtria maqedonase përsëri po i sulmon fshatrat e banuara me shqiptarë mu në zemër të Evropës.

Opinioni është bërë shurdh- memec – përkundër se numri i të rinjve shqiptarë të vrarë është në rritje.

Kohëve të fundit janë vrarë 6 shqiptarë, pas bombardimeve masive të fshatit Brodec.

Maqedonia u krijua si shtet i pavarur, atëherë kur Jugosllavia u shkatërrua, pra më 1990.

Në Maqedoni dhe në Kosovë, çështja shqiptare nuk u zgjidh.

Shqiptarët në Jugosllavi përbënin numrin e tretë për nga popullsia, por ata asnjëherë nuk u pyetën se si donin të krijonin të ardhmen e tyre.

Mbi këta 3 milionë shqiptarë u përdorë dhunë e paparë për t´i mbajtur të ndarë, përkundër dëshirave të tyre për bashkim kombëtar.

Nënshtrimi i tyre u theksua kurdoherë nga të gjitha aspektet: në aspektin politik, social, moral, kombëtar etj.

Shqiptarët, aspak nuk e rregulluan të ardhmen e tyre, por mbetën keq, si në kohën e ish-Jugosllavisë titiste.

Në Danimarkë jetojnë më shumë se 10.000 shqiptarë – shumica e tyre kanë ardhur nga Maqedonia.

Përkundër rritjes së shqetësimeve në vazhdimësi në shtetin e Maqedonisë; e cila e bënë pandalshëm shkeljen e të drejtave njerëzore dhe kombëtare të shqiptarëve, habit fakti që: si NATO po ashtu edhe BE vazhdojnë të bisedojnë për me zyrtarët e Maqedonisë për pranim në këto organizata. Kjo është një politikë e gabuar ndaj një situate krejtësisht absurde.

Rekcioni ndërkombëtar nuk mungoj krejtësisht.

Edhe njëherë shqiptarët ngelën lecka të lojërave të fuqive të mëdha, për fuqi dhe ndikim në Ballkan.

Ne kërkojmë:

- Një stop të menjëhershëm të terrorit ndaj popullatës civile shqiptare

- Lirim të menjëhershëm të të rinjve civilë që janë burgosur, për të nënshtruar lëvizjen demokratike të popullatës shqiptare

- Marrëveshjet për pranimin e Maqedonisë në BE dhe NATO, të ndërpriten menjëherë

- Një milion shqiptarë në Maqedoni thërrasin, mjaft!

- Ne, nuk duam të jetojmë si qytetarë të rendit të dytë!

- Ne, kërkojmë të drejtën madhore që vet të vendosim për të ardhmen tonë.

Demonstratën e organizon , Emigracioni Shqiptar në Danimarkë.

Kopenhagë, 11 dhjetor, 2007

LETËR TË HAPUR
Drejtuar z. Bedri Islami

"Vdekjen e mendova se më vjen kurdo,
se më leni vetëm nuk mendova jo!"
Ndre Mjeda

I nderuari, zotni Bedri Islami!

Ju, me të vërtetë, nuk mundem dot me ju kuptue! Prej Jush kam lexuar e dëgjuar dhe jam frymëzuar atdhetarisht, por këtë që po bëni me Ali Ahmetin nuk po mund të të kuptoj, mbase jo vetëm unë, por edhe shumë shokë e shoqe të tjerë atdhetarë.

Personalisht e kam një veprimtari (CV) të bollshme si aktivist i LPK-së, në Danimarkë. Këto që po Ju shkruaj, jam në gjendje t'Jua argumentoj. Aktivitetin tim politik e di mirë edhe z.Ibrahim Kelmendi dhe shumë të tjerë, ish-shokë të LPK-së.

Përveç të nderuarit Muhamet Kelmendi, i cili për mendimin tim qëndroi si burrë, i pathyeshëm, qëndroi vertikal, mjerisht, të tjerët u shkërmoqën të gjithë. Eh! Kjo "malaria demokratike" ra si murtajë në shpirtrat e tyre, pasi ranë në rehatinë e kolltukëve të Sllavisë.

Gjatë luftës, më 2001, unë i shkrova një letër Shtabit të atëhershëm të Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare, se kush është Abdulahim Kasami, i cili, si matrapaz e spiun i UDB-ës që ishte, u zgjodh si zëdhënës politik, kinse ka qenë anëtar i LPK-së. Por harrohet fakti që disa vite më parë, Këshilli i LPK-së në Danimarkë u shkri nga Ibrahim Kelmendi, sepse i vetmi isha unë që kisha paguar anëtarësinë në LPK. E kisha parapaguar dhe "Zërin e Kosovës", pastaj kam dhënë shumë herë ndihma vullnetare për aktivitetet e LPK-së.

Dhe, në pikën II të mbledhjes, Ibrahimi e ndërpreu atë dhe tha: "Në Danimarkë nuk ka Këshill të LPK-së!" Ibrahim Xhemajli, ky

renegat si i pafytyrë që është, donte ta vazhdonte mbledhjen, duke thënë se kemi edhe dy pika..... Por mbledhja u ndërpre, dhe prej atëherë, unë kam vazhduar të veproj për LPK, vetëm dhe i pathyeshëm. Dhe fort mirë dihen të gjitha aktivitete e mia.

Dy ***konferenca ballkanike***, disa ***debate publike*** etj. Pastaj, nuk ka TV apo Radio e gazeta të përditshme në Danimarkë, ku nuk kam pasur ***letra të hapura*** drejtuar politikanëve dhe intelektualëve danezë, ***intervista*** e të tjera. Disa nga këto i kam botuar në katër librat e mia, por pikërisht për këtë, se kam qenë veprimtar i pandalshëm, Ali Ahmeti dhe qeveria sllave në pushtet po më ndalojnë në kufi dhe po më provokojnë sa herë që tentoj të shkoj në Atdheun tem. Prandaj, po e përsëris, nuk mund ta kuptoj qëndrimin tuaj, kur edhe librin e titulloni: "Ky është i vërteti, Ali Ahmeti"! Por, megjithatë, keni një farë të drejtë. Është "i vërteti", sepse në burgje janë shumë ish-ushtarë të UÇK-së dhe, siç të njoftova, edhe mua më ndalojnë si aktivist dhe më provokojnë në kufi. Ç´është halli, apo mos jam naiv dhe nuk e kuptoj dot çfarë të drejtash fituan shqiptarët?!

Është shumë interesante të duhen se ç'ka thuhen në bisedat informative që më marrin në kufi kur dua me shku në fshatin tem. Më kujtohet që herën e fundit, në vitin 2009, inspektorëte Sigurimit të Fshehtë (DBK-së), më thanë: "Tani është demokraci, me 300 vetë mund të formosh parti, bile të dalësh edhe në zgjedhje dhe po të votuan, të marrësh edhe pushtetin, por vetëm në politikë mos u përziej"!

Nuk mund të kuptoj sesi ka mundësi partitë shqiptare të mos përzihen në politikë. Vallë, për shkuljen e patateve janë ato?! Pra, e ritheksoj me bindje të plotë, i bazuar në fakte, se i ashtuquajturi prej teje: "I vërteti Ali Ahmeti", së bashku me Musa Xhaferin, emëruan zëdhënës të UÇK-së spiunin e Serbisë, A. Kasamin.

Është "ky, i vërteti Ali Ahmeti" & Co, që u treguan katërcipërisht të dështuar politikisht nga aspekti i zgjidhjes me diplomaci të çështjes shqiptare në Maqedoni. Dihet tani botërisht se rahmetliu titist Arbën Xhaferin dhe politikani tjetër "largpamës"

Ymer Ymeri, nënshkruan Marrëveshjen e Ohrit, përkrah partive pacifiste-titiste, duke u autorizuar nga "I vërteti", ku statusin e shqiptarëve të Iliridës e katandisën si mos më keq, siç thotë edhe fjala e urtë popullore: "E lanë as mish, as peshk"!

Dihet, kjo është vërtetuar nga shkrimet e mia të botuara në 4 librat, pasi asnjëherë nuk jam pajtuar me mashtrimet e politikanëve të brendshëm dhe të atyre ndërkombëtarë, për atë përmbajtje të aaj Marrëveshjeje, që përballë nesh po hiqen si miq, ndërsa prapa krahëve tanë po veprojnë për interesat e okupatorëve sllavo-maqedonas e të tjerë.

Marrëveshja e Ohrit jo vetëm që është e cunguar, por nuk u realizua as ajo e nënshkruar nga të autorizuarit e "Të vërtetit" tuaj. Kjo nga atdhetarët e vërtetë atëbotë, dihej se ishte një lojë djalli dhe vetëm një mashtrim. Por, edhe sikur të realizohej kjo, shqiptarët nuk do të kishin fituar aq sa e meritojnë. Fjala vjen, që me të drejtë të jenë faktorë shtetformues në trojet e tyre etnike, ku jetuan gjatë shekujve, e gjer më sot, që në Maqedoni të kenë të drejtën për ***vetëvendosje*** e të tjera...

I nderuari zotni Bedri Islami,

Do të doja të shtoja dhe një pyetje. Nuk e di a je në dijeni për këtë dukuri, ("marifet të pasardhësve titistë"). Si ka mundësi që prej Luftës Çlirimtare 2001 e këndej, në ambasadën e Danimarkës na sjellin vetëm shqiptarë, nga shteti i Maqedonisë?! Nuk ka dyshim se në Danimarkë, në mediume dhe në politikën e diplomacinë daneze, çështja shqiptare ka dominuar dhe dominon më së shumti si temë që është trajtuar dhe trajtohet me seriozitet të madh, siç është çështja jonë e pazgjidhur shqiptare. Kjo çështje ngrihet më shumë se kudo në shtetet e tjera të Evropës. Dhe kjo ka ndodhur, sepse si veprimtar besnik i LPK-së, me kohë e pa ndërprerje, për vite të tëra e kam informuar mirë dhe drejt opinionin danez. U vunë në aksion edhe forcat nacionaliste sllave, serbo-maqedonase. Më datë 23 qershor 2001, reagon në gazetën daneze

”Politiken”, mjekja Meri Trajkovska, duke dezinformuar opinionin danez se nuk është e vërtetë kur Xhemil Zeqiri thotë: ”Në Maqedoni, ka aparteid ndaj shqiptarëve”!

A e di z, Xhemil Zeqiri se në Maqedoni shqiptarët kanë partitë e tyre politike, deputetëdhe ambasadorë dhe vijon më tej.“Si duket, z. Xhemili nuk e di që, madje në Danimarkë, ambasadori i Maqedonisë është shqiptar”?!

Kur ajo e hodhi lart këtë ”tullumbace politike”, mua menjëherë m´u pat kujtuar paaftësia e politikanëve shqiptarë në Maqedoni dhe cinizmi dhe dinakëria e pjellës politike titiste, kur në ish-Jugosllavinë e Titos, për dekorim-mashtrimesh politike, në kohërat më të rënda kur shkeleshin të drejtat e vëllezërve shqiptarë në Kosovë, titistët e vunë në krye, si kryetar të radhës, një agjent të tyre, kriminelin e popullit shqiptar, Sinan Hasanin. Me këtë kartelë-afishe politike, ata dëshironin t´i thonë botës së tyre të tretë, kinse paqësore: ”Ja, shiheni se çfarë të drejtash kanë shqiptarët në Jugosllavi, ndërsa Enver Hoxha ngre shqetësime brenda dhe jashtë Shqipërisë, kinse për shkeljen e të drejtave të tyre, duke provokuar trazira të mëdha në Kosovë dhe në viset e tjera shqiptare”.

Kësaj meseleje i thonë: ”Sikur ajo kurva që i thotë gruas së sinqertë:Mambaj pak fëmijën në dorë”,pastaj ikën, duke ia lënë kopilin në prehër!

Zotni Islami, të njoftoj me përgjegjësi të plotë morale dhe penale që polemika të tilla, mëse njëherë, kam pasur edhe pas luftës, pra në vitin 2002. Të gjitha i kam thënë përballë tij, siç thoni ju andej nga Shkodra, ia kam thënë troç z. Ali Ahmetit, por tani edhe ju disa nga shokët tanë të LPK-së, kujtuat ”ma mbyllët gojën”! Them kështu, sepse ”i vërteti Ali Ahmeti”, me klithmat tua të pa fre, me aroma “dehëse” propaganduese, së tepërmi ka marrë revanin! Por kjo nuk është e tëra. Mua po më habit së tepërmi me heshtjen e tij, miku im shumë i respektuar, Ibrahim Kelmendi, duke përfituar nga këto. Si duket, ”i vërteti Ali Ahmeti”, e kaloi ylberin! E kaloi si një lakuriq nate, duke u kthyer në një renegat e sllavo-fil i mjerë. Ish-shefi i tij, tanimë i vdekur, por shi sa e

”habitshme” kjo, edhe pas vdekjes, sikur po e imponon-detyron politikën shqiptare në BDI. Njëherë, në kohërat e arta të tij, e solli ambasador dhëndrin (burrin e vajzës), ndërsa djalin e motrës e bëri shef në zyrën e servilit të tij, Musa Xhaferit. Tani, e përsëris Abdulhalim Kasami, ”i pavdekshëm”, pra idoli i Aliut edhe pas vdekjes, me amanetet e tij po vazhdon të luajë politikën pro-sllave në BDI, kur djalin e motrës së vet ia sjellin ambasador në Kopenhagë, që pastaj t´i mbyllet goja Xhemil Zeqirit nga gazetarucë e gazetaruce pro-sllave si kjo Meri Trajkovska se ja, unë po e dezinformoj opinionin se shqiptarët kanë aparteid në Maqedoni!
Pra, nga të gjitha sa shkrova po shihet qartë: Lumë për shqiptarët me në krye këtë ”Të vërtetin, Ali Ahmetin”, i cili i rehabilitoi dhe i bëri bashkëpunëtorë UDB-shët dhe pjellën e tyre gjakatare, duke ua mohuar dhe ndaluar rrugën drejt atdheut të të parëve gjithë atyre shqiptarëve e mërgimtarëve, duke i torturuar fizikisht e psikikisht dhe duke i marrë në pyetje informative në kufirin shqiptaro-shqiptar Kosovë-Maqedoni e gjetiu, atyre që nuk po i përkulen padrejtësisë.

Ngelem me shpresë se kjo letër e imja do të ketë së paku një ndikim modest, që ju shokë të nderuar të LPK-së, të reflektoni pozitivisht duke i vlerësuar drejt disa nga ish-shokët tanë të cilët mjerisht, për fat të keq, e devijuan rrugën e nderit dhe të lirisë drejt së cilës ishim nisur me betimin para ***flamurit kuqezi***. Për asnjë çmim nuk do të heqim dorë nga idealet tona të ribashkimit, të përparimit, të barazisë. Për të drejtat gjithëkombëtare, të veprojmë sa të jemi gjallë, kudo qofshim dhe kurdoherë!

Xhemil ZEQIRI

Danimarkë, më 5 nëntor 2013

LETER E HAPUR PREZIDENTIT SHQIPTAR z.BUJAR NISHANI

Mjerisht, që nga viti famëkeq 1990, për shqiptarët në Ballkan filluanmbrapshtitë politike, ekonomike, sociale etj.Ky vit, qe vit i krizave të mëdha që përjetoi populli dhe shteti shqiptar,Shqipëria socialiste.Bllokadat dhe represionet e shteteve imperialiste ishin prej kohësh tëpamëshirshme ndaj shtetit shqiptar, pasi që shteti socialist kishte mbrojtur me një fanatizëm të pakompromis identitetin dhe sovranitetin kombëtar.Shqipëria u ballafaqua, jo vetëm me sanksione ekonomike, por edhe mendërhyrje të pamëshirshme nga fuqitë e mëdha dhe agjenturat antishqiptare,siç ishte CIA dhe UDB-ja etj.Faktikisht, presionet ekonomike nuk iu hoqën kurrë shtetit shqiptar, bazuarsipas një artikulli të një publicisti shqiptar Anton Kote, që i referohetnjë gjenerali të CIA-s (tani s´më kujtohet emri i atij gjenerali), i ciliishte ndër më të suksesshmit e kësaj agjenture më të fortë në botë. Kyishte i vendosur në Frankfurt të Gjermanisë me 300 oficerë që kishin pasurobjektiv të bëjnë ndërhyrjen në ish-shtetet socialiste.

Pra, i nderuari Anton Kote i përshkruan fort mirë ndërhyrjet e tyre, mirëpounë këtu do të potencoj vetëm disa fjalë nga ky artikull i cili e citongjeneralin amerikan që në fakt kishte qenë një bir shqiptari, ku midistjerash ai thekson:"Në Shqipëri nuk kemi dalë ashtu siç kemi paramenduar, ne kemi dërguar 380grupe, ne nuk kishim mundësi të kuptonim si kanë rrjedhur aksionet, pasiata kishin një politikë diktatoriale dhe nuk tregonin se grupet tona janëkapur ose kanë kryer ndonjë aksion, e kjo na bënte tepër nervoz, pra nuklajmëronin nëpërmjet mjeteve të informimit, por hiqeshin sikurse nuk na kandodhë gjë".Artikulli i plotë është i botuar në gazetën "Zëri i Kosovës" që botohej nëZvicër.

Në pyetjen e Anton Kotes se cila agjenturë u ndihmonte më shumë dhe ngaishin rekrutuar diversantët, gjenerali përgjigjet:"Ndihmën më të madhe e kemi pasur nga UDB-ja

jugosllave, ndërsa kemi pasurshumë veprimtarë nga Kosova që janë hedhur në aksione”!

Gjithashtu, është edhe deklarata e kryeministrit anglez, Tonny Blair:"Vetëm në Shqipërinë e Enver Hoxhës, kanë dështuar ndërhyrjetanglo-amerikane"!

Kjo flet mjaft për luftën heroike të popullit shqiptar për ta mbrojturShqipërinë socialiste nga agjenturat e huaja kriminale.Këto fakte që theksuam janë të vërteta e jo trillime, gjithashtu janë shumëtë hidhura. Pikërisht për këtë, liderët "demokratë" është dashur tëreflektojnë realisht dhe të mendojnë kthjellët.

Por, tani shtrohet pyetja: Përse vepruan kështu pa kurrfarë kriteri askushtëzimi politik as kombëtar, në raport me të huajt?!

Por, ata kësaj pyetjeje nuk i përgjigjen dot, ata nuk e thonë kurrë të vërtetën,sepse kanë hyrë verbërisht në batak të ndyrë antikombëtar. Fatkeqësisht,turpet dhe krimet e tyre ekonomike, politike, sociale etj, koha po uanxjerr në shesh çdo ditë. Nga udhëheqja e tyre e çoroditur, popullishqiptar jo vetëm që u varfërua tmerrshëm, por edhe u përgjak dhembshëm nëvitin e hidhur 1997 dhe ende plagë të hapura qëndrojnë mbi trupin e Shqipërisë Etnike.

Politika plotësisht antikombëtare dhe disfatiste e I.Rugovës dhe S. Berishësi kanë sjellë aq shumë dëme kombit shqiptar, sa që edhe sikur ta drejtonteShqipërinë Etnike dikush nga çetnikët më të egër të Beogradit, nuk do tëmund ta dëmtonin aq shumë.

Prandaj, në Shqipërinë londineze, politikën fashiste të S.Berishës populli errëzoi në vitin 1997, me pushkë në dorë, me humbje të mëdha njerëzore dhemateriale,pas atij revolucioni të madh, që matrapazët politikë e marrin me hipokrizi dheme tallje.

Ishte Partia Socialiste ajoqë e qetësoi situatën dhe e riktheu zhvilliminnormal të jetës shtetërore të shqiptarëve, të shkatërruar nga themelet, ngaS.Berisha me kompani dhe të tradhtuar nga Perëndimi.Kjo fatkeqësi, nën maskën "demokratike", me politikën nihiliste të I.Rugovës, e "gëlltiti" popullin shqiptar në Kosovë dhe në viset e tjerashqiptare të okupuara nga shovinistët sllavë.

Trojet shqiptare të udhëhequra nga titistët Rugova, Xhaferi, Halimi, ushkelën egërsisht nga armiqtë sllavë pa kurrfarë rezistence, as pacifiste asradikale. Popullin shqiptar e mbështeti me shpatulla për muri medurim-turpin e proklamuar prej tyre, prandaj populli, duke e parë që kjo poe shpie drejt humnerave të mëdha historike, u detyrua të rreshtohet pasdjemve e vashave që i rrokën armët e luftuan për liri dhe dinjitet kombëtar.Pra, nën udhëheqjen e UÇK-së.Pas këtij zgjimi kombëtar, komuniteti ndërkombëtar i erdhi në ndihmë UÇK-sëdhe popullit shqiptar.Duke e bërë këtë akt human, sikur u hapën shpresat për perspektiva tëndritura për ne shqiptarët e Kosovës dhe viseve tjera.

Por, diplomacia e europiane dhe botërore, në planet e tyre afatgjatestrategjike, nuk kishte ndryshuar, por në kokat e tyre kishte mbetur si njëmyk i keq ideja antishqiptare edhe pas gjithë atyre premtimeve nga "demokratëtmodernë", se pas shkatërrimit të sistemit socialist të Enver Hoxhës, do tëarrihet edhe ribashkimi kombëtar.Shqipëria do të ndihmohej me "çeka të bardhë" nga Amerika, ekonomia e sajdo të lulëzonte etj, etj.

Këto ishin lojëra të rrezikshme, ishin premtime boshe që mund t´i hanin sibonbone vetëm "kalamajtë politikë" të tipit Berisha-Rugova dhe kompanitë etyre servile.Dhe tani, "shkencëtarë" të dalë nga brumi i tyre, të zhytur pas interesavepersonalë, po dalin me xhevahire "të reja", që me paçavure shkrimeshpublicistike po orvaten ta bindin popullin e shumëvuajtur shqiptar, seshqiptarëvetë pjesës tjetër të Shqipërisë, pra shqiptarëve të Kosovës, kinsepopullit të saj, i duhet komb dhe identitet i veçantë, pra kombi kosovar,sipas identitetit kosovar!

Këta kalemxhinj shkojnë më tej me marrëzitë e tyre. Ata duan që gjuhënshqipe ta ndajnë, pra ta thellojnë ndarjen e saj. Këta shkrimtarë "me famë",këta gazetarë bulevardesh brenda e jashtë atdheut, shkruajnë dhe flasinvetëm në gegërishte, ndërsa e urrejnë dialektin toskë, sikur ky dialekt tëmos ishte fare yni!Ndarja që po tenton të bëhet nga aspekti gjuhësor dhe në identitet u çon ujënë mulli, vetëm armiqve tanë të përbetuar sllavë.

Nëse vlerësojmë nga aspekti gjuhësor, këtu del fakti se emri Kosovë është term i huaj: "Një toponim që ka tërhequr që moti vëmendjen tonë është emër vendi ifshatit Trudë, i cili, me sa duket, ka qenë bazë motivuese e kalkimit nëgjuhët sllave të toponimit Kosovë.Të gjitha këto rrënjë latine dhe neolatine na shtyjnë të përfundojmë setoponimi Kosovë është në të vërtetë një kalk i toponimeve të shumta të krijuarme apelativa latinë dhe neolatinë. Në traditën toponime shqiptare ekziston edhe emër vendi Zogaj, që sipasmendimit tim duhet të ketë dalë nga togfjalëshi Zog i Zi 'turdus merula'(krahaso anglisht *blackbird– "zog i zi"*, *turdus merua*)(A. Konushevci).

Ndërsa nga aspekti politik, dihet mirëfilli që në "pushtetin paralel", ngaMarkagjoni i Mirditës qe shpallur si një pykë e zezë, e ashtuquajturaRepublika e Mirditës, e cila jo pak favore u krijoi trupave serbe gjatëtërheqjes së tyre, bile këto ditë kryeministri serb Koshtunica, e bërinjë falënderim për mikun e tyre Esat Pashën, me fjalët: "Serbët i harrojnë shpejt armiqësitë, por jo miqësitë".

Siç po shihet qartazi, politika e favoreve politike dhe ushtarake ndajSerbisë, i bashkon si dy pika uji, bajraktarin Markaghoni dhe kryeparinRugova!Prandaj, nuk është aspak çudi që në të ardhmen e afërt do të dalë njëkryeministër serb që do ta falënderoj Rugovën për shërbimet e tij ndajSerbisë, që ia bëri me vite e vite.

Unë dua të paraqes këtu pikëpamjen time senjë Republikë e tillë e Kosovës, e ndarë nga trungu amë, me gjuhë, identitetetj, do të ishte fillimi i një përçarjeje të madhe brendakombëtare, që zorse do t´i shihej fundi. Nëse shqiptarët bënë kompromise politike dje, duke pranuar një Republikë tëpavarur të Kosovës, me gjuhë, identitet dhe flamurin shqiptar që valoi meshekuj në trojet tona, kjo nuk i jep aspak të drejt askujt të vërë dorë mbi këtoelemente të shenjta që s´na ndajnë, por na bashkojnë kombëtarisht, pra as I.Rugovës, as tellallëve të tij politikë.

Për faktin se realitetet politike kanë ndryshuar në Ballkan dhe Europë, edhene shqiptarët tani,kompromiseve të pas viteve '80, duhet t´u japim fund.Tani është koha për VETËVENDOSJE të

kombit shqiptar në Ballkan.Shikuar nga të gjitha faktet, konkludoj se përpjekjet e tyre janë fund e krye një shërbim i mjerë ndaj pacifistëve dhefashistëve të huaj, të të gjitha ngjyrave!Pra, synimi i tyre qëndron aty se po tentohet t´i hedhet hi syve popullit.Këta faktikisht janë vënë në shërbim të politikës antishqiptare titiste tëzhvilluar para viteve ‘90.

Vlen të theksohet fakti setani s´ka ndërhyrje nga jashtë që imperialistët të fusin banda kriminale nëtrojet shqiptare, që të na çonin në vëllavrasje midis nesh, por tani zënkat e shqiptarëve nga pluralizmi politik i frymës përçarëse Berisha-Rugova, po nasjellin përçarje kaq të mëdha brenda kombëtare.

Sot, bota demokratike jeton me pluralizëm, por jo me grindje aq të egrandërpartiake, siç jetojmë ne shqiptarët. Serbia rrinte e qetë kur Shqipëria Etnike ishte nën udhëheqjen eBerishës dhe Rugovës, derisa UÇK-ja i mori armët. Derisa profashisti Berisha dhe "gandisti mbret" Rugova rrinin të qetë nëTiranë dhe në Prishtinë, poaq i qetë vepronte lirshëm qeveria fashiste S.Millosheviqit në Kosovë dhe bandat paramilitare të Sheshelit dhe të Arkanitgjakatar.

Janë këta politikanë "largpamës" që i ndoqën,i dënuan me burg, i fyenheronjtë kombëtarë, Adem Jasharin, Zahir Pasjazitin, Luan Haradinajn etj.Është regjimi i S.Berishës ai që i vrau tradhtisht ideologët e parë tëUÇK-së, Remzi Hoxhën dhe Ali Ukën.Për më keq, as sot e kësaj dite, kriminelët që i vranë ata pishtarë lirie, nuku zbuluan as u dënuan ndonjëherë!

Këta paramilitarë, "intelektualë puthadorë", në shkrimet e tyre trumbetojnëse në Kosovë ka zgjedhje të lira!Këto zgjedhje deri tani bëhen me lista të mbyllura, që faktikisht kjo është antidemokratike dhe nuk janë zgjedhje të drejta shqiptare, por tëdirigjuara, pra janë zgjedhje të UNMIKISTANIT.

Nuk besoj se këta "analistë", të regjur me vaj e uthull të huaj, nuk ikuptojnë intrigat e rrezikshme.E kemi parë këtë se edhe gjatë kohës së "pushtetit paralel" të I. Rugovës, nën drejtimin e regjimit të S.Millosheviqit, kishte "zgjedhje të lira", prame lista të mbyllura!

Dihet nga të gjithë se edhe kur krisnin armët e lirisë në malet e Kosovës,I. Rugova mbante "zgjedhje të lira", pastaj edhe kur digjej Fieri në flakë(1997), Sali Berisha me parlamentin e tij njëpartiak, vetëzgjidhejkryetar!

Tani shtrohet pyetja: Çka fitoi populli nga këto zgjedhje. Për këtë letë reflektojë vetë çdo shqiptar. Këta puthadorë mjeranë, këta "analistë e gjuhëtarë" me prejardhje tëdyshimta, sot po e dezinformojnë popullin, këta janë bërë zëdhënës të sëkeqes shqiptare, duke e përkrahur politikën pacifiste të nxitur ngaBeogradi, indirekt përmes Grupit të Kontaktit, që sot mundohet ta imponojsërish dominimin e politikës serbomadhe mbi shqiptarët, atë politikëgjenocidale që na kushtoi me një lum gjaku në shekuj.

Tani Serbia trumbeton parullën e saj dinake "më shumë autonomi e më pakpavarësi".Regjimi serb, natyrisht pajtohet me institucionet e Kosovës të cilatdinakërisht e kanë pranuar një status të tillë qe 7 vite. Druaj se zor që dotë ketë ndryshime, shikuar sipas parametrave të sotëm politikë.

Beogradi pajtohet me politikanët "demokratë" të Prishtinës, kërkon dialogçdo ditë sepse janë këta që e kanë pranuar Marrëveshjen e Rambujesë, e cilasipas rezolutës famëkeqe 1244, haptas ia njeh sovranitetin e Serbisë mbiKosovën.Bile, si për ironi të fatit, asnjëherë deri sot nuk e kemi dëgjuar tëmohohet njëherë nga politikanët pacifistë.

Pra shkurt, Kosova dhe trojet shqiptare janë duke u udhëhequr ngapolitikanët e marrëveshjeve antishqiptare që nga Parisi, Ohri dhe Konçuli.Dhe,nëse hyjmë të analizojmë kombëtarisht, që nga ajo Konferenca famëkeqe eRambujesë, çështja shqiptare ka marrë tatëpjetën.Politika shqiptare është vënë në shërbim të qarqeve ndërkombëtare, oseshkurt e shqip, në shërbim të borgjezisë reaksionare, e cila në shekuj kaqenë dhe ka mbetur deri sot, esencialisht antishqiptare.Tani politikanët shqiptarë s´janë në gjendje t´i mbrojnë për asnjë momentinteresat kombëtarë. Duke vepruar kështu, janë bërë "kukulla" në duar tëhuaja.Pa çka se politikanët "modernë" i fitojnë zgjedhjet me ndihmën e "miqve",kur

nënat shqiptare sot, janë veshur në të zeza nga politika e tyrekonfliktuoze dhe antihistorike.Këta janë të pangopur për pasuri e pushtet, këta s'e kanë hiç hallin përshtet!Këta nuk duan që kombi shqiptar të dalë me VETËVENDOSJE, sepse kështungjarjet do të merrnin kahun e duhur, kombi ynë do të shkonte drejtfitoreve të reja, drejt ribashkimit kombëtar dhe përparimit.

Xhemil Zeqiri

Kopenhagë, 24 korrik 2011

SIMBOLIT TË REZISTENCËS SONË KOMBËTARE, Z. ADEM DEMAÇI, PISHTARIT TË RIBASHKIMIT KOMBËTAR

- Simbolit të qëndresës, të zhvillimit të artit dhe të kulturës shqiptare dhe ideologut të ribashkimit kombëtar, Rexhep Qosjes;
- veprimtarëve të devotshëm të çështjes kombëtare, Sejdi Veselit dhe Afrim Morinës;
- profesorëve të nderuar, Sadri Fetiut dhe Agim Vincës; dhe
- të gjithë intelektualëve atdhetarë të cilët kanë pikëpamje përparimtare, të të gjitha viseve shqiptare, u drejtohemi me këtë:

KËRKESË

Duke i parë e dëgjuar zhvillimet dramatike në Atmëdheun tonë, të vaditur me djersë e gjak si para dhe pas tri luftërave çlirimtare kudo në viset tona, kujtojmë që politika dhe diplomacia shqiptare nuk ishte as nuk është në nivel të kënaqshëm e as të duhur për t´i arritur objektivat tonë historikë dhe objektivat kryesorë për të cilët luftuam si komb: të drejtat sociale, kulturore dhe shkencore, tëgjitha këto të drejta kombëtare që e garantojnë lirinë dhe barazinë e vërtetë të një populli dhe ribashkimin e një kombi,

Duke e parë e dëgjuar që partia në pushtet PDK-ja, AKR-ja dhe qeveria ”Thaçi 2” po edhe Parlamenti i Kosovës me partitë në opozitë,të cilat janë kthyer në servilë dhe zëdhënës aprovues të partisë në pushtet dhe partizate tjera satelite të tyre, për realizimin e pushtetit servil përballë faktorëve të huaj, jo gjithnjë të sinqertë, jo

gjithnjë të drejtë përballë kërkesave të drejta të popullit shqiptar, ato shtete evropiane ”aleate”, të cilat e penguan, si para ashtu dhe pas luftës, lirinë dhe ribashkimin e kombit shqiptar, konsiderojmë dhe kemi bindje të fuqishme që prej kësaj rruge pakrye ku e kanë futur Kosovën dhe viset e tjera shqiptare, mund ta shpëtojnë vetëm kërkesat dhe rezistenca këmbëngulëse e fuqishme e Lëvizjes Vetëvendosje (VV).

Prandaj vendosëm që t´ua bëjmë këtë kërkesë, që ju të nderuar /a atdhetarë t’i lëni mënjanë ca mospajtime formale, duke i kujtuar ato pika elementare qëju bashkojnë me idealet e VV.

O prijatarë të devotshëm, o besnikë shumë të dëshmuar të popullit, ju o të dëshmuar me djersëe gjak kombëtarisht, T’I BASHKOHENI pa hezitim kësaj Lëvizjeje e cila u bë simbol qëndrese sesi duhet bërë politikë dhe veprimtari opozitare përballë një aparati shtypës ndaj popullit të tij dhe servil ndaj faktorëve të jashtëm, të cilët nën maskat e ndihmave dhe të aleancave me politikën shqiptare, po qesin pandalshëm gur nën rrotate historisë, duke u kthyer realisht në aleatë të Serbisë dhe të shteteve të tjera ballkanike, okupatore njëshekullore e më tej, të trojeve tona.

Ngelim me shpresë që kjo kërkesë jona të merret në konsideratë prej jush!

Atdheu në rrezik!

Të bashkohemi si një trup i vetëm pranë Flamurit Kuqezi, për ta bërë Kosovën shtet me sovranitet të plotë, me polici, me ushtri, me ekonomi të zhvilluar e të tjera përparime shoqërore e kulturore, sepse nuk arrihen këto duke bërë vetëm deklarata të drejta, duke u bërë vetëm kritika qeveritarëve paradite dhe opozitarëve të vërtetë pasdite. Nuk arrihen fitoret tona kështu kur jemi të përçarë, kur jemi aq komodë sa të bëjmë sehire, duke qëndruar mënjanë, duke i shikuar me apo pa gjakftohtësi situatat dhe ”gladiatorët” e politikës së prapakthimeve historike, duke u ndeshur pa mbarim në beteja, dikush për pushtet, e dikush për të bërë shtet me sovranitet dhe të

ribashkuar në Ballkanin e trazuar të Evropës demokratike, e cila, jo deri në fund, po u qëndron besnike idealeve të lirisë dhe të barazisë së shteteve e të popujve.

Atdheu na thërret të bashkohemi!

Dëshmorët nuk na duan kështu të përçarë, me një Atmëmëdhe të ndarë në 6 shtete dhe në kundërshtime, me prapakthime ndërvete!

Prandaj, të bashkohemi sot, nesër do të jetë vonë, tepër vonë!

Qëndro Shqipëri!

Zgjohu shqiptar!

Me respekt atdhetar!

Stafi i redaksisë së ueb-faqes elektronike shqiptare: diplomacia.dk

Shënim: Kjo kërkesë u bë edhe me insistimin këmbëngulës të shumë atdhetarëve, pra të lexuesve të saj.

Xhemil Zeqiri

Më 6 gusht 2013

TELEGRAM URIMI BACË ADEM DEMAÇIT, ME RASTIN E 70-VJETORIT TË LINDJES

Vëllezër dhe motra, atdhetarë dhe atdhetare!

Janë të varfra fjalët për ta përshkruar personalitetin aq të madh dhe aq rrezatues të Bacës sonë ADEM DEMAÇIT.

Është e pamundur gjithashtu të thuhet e tëra për veprimtarinë e tij atdhetare e njerëzore edhe sikur të shkruhen me qindra libra.

Është vështirë gjithashtu të përqendrohesh për të shkruar pak rreshta modestë për Bacën si në këtë rast, sepse çdoherë dëshiron të thuash më shumë dhe s'e ndal dot veten dhe nuk ke dëshirë të vësh pikë.

Baca Adem nuk jetoi dhe nuk jeton për vete! Baca jetoi dhe jeton për tokën e vet, për popullin e vet. Jetoi dhe do të jetojë përgjithmonë për brezat që do të vijnë.

Kur toka e tij po digjej e po gllabërohej pothuajse në pakthim, kur populli i tij mjerohej e po humbiste çdo shpresë, doli një burrë i vogël por me zemër të madhe dhe u ngrit si Prometheu. Me forcën që na e dhuronte vepra dhe emri i tij, na e ngjalli shpresën, na dha forcë e krenari dhe na udhëhoqi ndër beteja për ***liri, barazi dhe dinjitet***. Barbarët sllavë, pasi nuk mundën ta blinin me privilegje e para, e futën në burg dhe menduan se mbaroi kjo punë. Bacën e burgosën, por nuk e burgosën dot shpirtin dhe zemrën e tij të madhe. Edhe nga burgu, ***ai*** ishte midis nesh, ishte kudo me ne. Sheshet dhe rrugët e përgjakura të Kosovës buçisnin deri në qiell me emrin e Bacës, se përfundimisht me Bacën në zemrat tona dhe me forcën që na dhuronte, e kishim mundur frikën, e kishim ngjallur shpresën dhe pakthyeshëm u nisëm drejt rrugës së lirisë.

Kur e filloi veprimtarinë atdhetare Baca Adem, ishte kohë pa kohë. Pas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore për idenë tonë të madhe për ribashkimin e trojeve shqiptare, luftohej me zjarr e hekur, Guximtari i madh ua tha hapur në gjykatë xhelatëve serbë:

"Jam për bashkimin e trojeve shqiptare. Nëse jo me hatër, këtë ne shqiptarët do ta bëjmë edhe me luftë"!

Prandaj e dënuan aq kohë sa do t´i mjaftonte një djaloshi të burrërohej fuqishëm për ta çuar luftën e tij më tej. I mbijetoi 29 vite burg të rëndë, derisa Kosova e tij me viset e tjera shqiptare po forcohej për ta sfiduar dhe për ta luftuar lubinë me emrin ish-Jugosllavi! Armiqtë nuk po e kuptonin dot gjuhën e dialogut, prandaj ***qëndresa*** do të merrte përmasa të luftës çlirimtare, Bacë Ademi do të dilte në ballë të UÇK-së, do ta drejtonte procesin diplomatik, pa iu dridhur qerpiku. Kurrë nuk u nënshtrua, sepse këtë ves të keq ua kishte falur armikut dhe horrave shqipfolës që aq shumë e urrenin dhe e urrejnë.

Mjerisht, edhe sot po jetojmë në përmasat e një kohe të pakohë, kur nuk po vlerësohen drejt vlerat kombëtare, por kundërvlerat dhe hienat e zeza të tradhtisë. Prandaj Bacë Ademi ende nuk po respektohet meritueshëm, ende injorohet mjerueshëm nga mjeranët politikë të shumë ngjyrimeve partiake, të cilët as sot nuk po i shërbejnë me devotshmëri çështjes kombëtare. E mohojnë vetëvendosjen e kombit tonë dhe të tjera virtyte të mëdha si këto. Të drejta shumë legjitime të njerëzimit.

Titistët dhe argatët e tyre të mjerë shqipfolës, e luftuan kudo me të gjitha mënyrat, por nuk arritën dot ta thyejnë Bacën me zemër të madhe. Ai nuk u thye as dje, as sot dhe nuk do të thyhet kurrë. Ata kanë qenë dhe janë shumë të vegjël përballë tij. Ky pra është ADEM SHQIPËRIA!Që pas i shkon Historia!

Bacit Adem, me rastin e 70-vjetorit të lindjes, ne mërgimtarët i urojmë nga zemra, prej së largu nga afër - edhe njëqind vjet të tjera!

I urojmë shëndet e suksese në veprimtarinë e tij të shenjtë!

Për ne është privilegj dhe krenari që jetojmë në kohën e Bacës Adem!

Xhemil Zeqiri

Danimarkë, më 26 tetor 2006

Pjesa e pestë

RRETH FIGURËS SË ENVER HOXHËS

ENVER HOXHA, I VETMI SHQIPTAR NË ENCIKLOPEDINË BOTËRORE

Enver Hoxha është i vetmi personalitet shqiptar i përfshirë në Enciklopedinë Botërore të vitit 2005.

Në vëllimin me 1050 faqe, politikani komunist është i vetmi shqiptar për të cilin shpjegohet me pak rreshta se kush ka qenë dhe se çfarë kontributi ka dhënë gjatë udhëheqjes së tij. Emri i tij shënohet në faqen 430, aty ku sipas rendit alfabetik vjen shkronja **H**.

"The Collins Ëorld Encyclopedia" është një vëllim i ilustruar i ngjarjeve të botës, historisë, artit, shkencës, mjekësisë dhe jep informacione për teknologjinë, për shtëpinë, për shkollën dhe për fjalët.

Qëllimi i tij është për të siguruar fjalë, duke përdorur gjuhë të qartë dhe jo teknike.

Hoxha në enciklopedi.

I kushtohen 53 fjalë në anglisht. Me to prezantohet figura e Enver Hoxhës, duke filluar që nga vitet e lindjes dhe të vdekjes së tij.

Në enciklopedi Hoxha nuk cilësohet si diktator, por si *"politikan komunist"* dhe si *"stalinist",**por i pavarur nga komunizmi sovjetik dhe ai kinez***. Në vëllimin që këtë vit ka 1300 fjalë të reja, Enver Hoxha përshkruhet si udhëheqës i Shqipërisë që nga viti 1954. *"Nga viti 1954, ishte Sekretari i parë i Partisë së Punës të Shqipërisë"* - thuhet në enciklopedi. Ndërkohë, në të

shpjegohet shkurtimisht edhe veprimtaria e Hoxhës që nga viti 1939.

Enciklopedia *"The Collins Ëorld Encyclopedia"* është botuar për herë të parë në vitin 1995 dhe në shqip përkthehet *"Enciklopedia Botërore Collins"*. Në të mbulohen ngjarjet aktuale botërore në fushën e shkencës, të historisë, të teknologjisë, të sportit, të artit etj. Në të përmenden personalitete nga të gjitha vendet e botës. Gjithashtu, në enciklopedi ka mbi 300 harta, diagrame dhe sajte interneti, në të cilat ka informacion të dobishëm për çdo përdorues.

Shqipëria në enciklopedi.

Në enciklopedi përshkruhet një historiat i Shqipërisë që fillon me vitin 168 para Krishtit e deri në ditët e sotme.

Në të shpjegohet pozita gjeografike e vendit, popullsia, të ardhurat për frymë, monedha që përdoret. Një vend të gjerë zë edhe politika. Në enciklopedi pasqyrohet një kronologji e qeverisjes shqiptare që pas shpalljes së pavarësisë.

Enver Hoxha (1908-1985). Politikan komunist shqiptar, udhëheqës i vendit që nga viti 1954.

Ai e themeloi Partinë Komuniste në vitin 1941 dhe e udhëhoqi ***lëvizjen partizane*** nga viti 1939-1944. Ishte kryeministër i Shqipërisë nga viti 1944 deri në vitin 1954. Gjithashtu, ai ishte edhe ministër i Jashtëm nga viti 1944-1953. Nga viti 1954, ishte Sekretari i parë i Partisë së Punës të Shqipërisë. Në politikë ai ishte stalinist dhe i pavarur nga komunizmi kinez dhe sovjetik.

Lavdi dëshmorëve të atdheut!

Lavdi Enver Hoxhës!

29 janar 2016

ENVER HOXHA PUNOI PËR TË MBROJTUR POPULLIN NGA RREZIQET QË I KANOSESHIN PREJ FQINJËVE OKUPATORË.

Reagim ndaj Radio-Televizionit të Kosovës

Kushtuar 100-vjetorit të kolosit Enver Hoxha

Duke e përcjellë mediumin tuaj, vendosa të reagoj fuqishëm ndaj emisionit të datës 23. 10. 2008 në Radio-televizionin e Kosovës (RTK) nga ora 20.30.

Mënyra tejet e pakontrolluar e atij debati, të ashtuquajtur ”Jeta në Kosovë“, sipas „taktikës“ „Pro e kontra“, më detyroi të reagoj ndaj RTK-së të udhëhequr nga një staf i dyshuar i kësaj redaksie.

Nuk është hera e parë që redaktorët e këtij mediumi informativ elektronik po bëjnë budallallëqe me “analistë” të tipit të Halil Matoshit.

Përse titistët si Agim Zatriqi dhe zatriqër e hiqër të tjerë të RTK-së ishin dhe do të jenë të interesuar që të dalin me “argumente“ kundër shqiptarit më të madh që ka lindur nëna shqiptare, këtë e dinë më mirë vetë ata. Këtë u përpoqën ta bëjnë në emisionin në fjalë.

Gjatë emisionit u pa qartë se popullit i servireshin shpifje dhe trillime nga më të ndryshmet dhe nuk i jepej mundësi palës tjetër të shpjegonte shtruar kundër-argumentet e tyre.

Pastaj, aty nuk ftohen njerëz që do të debatonin shtruar dhe do të shpjegonin shkencërisht luftën dhe përpjekjet e Enver Hoxhës për të çliruar dhe për të përparuar Kosovën dhe viset e tjera shqiptare të cilat kishin mbetur padrejtësisht nën robërinë e ish-Jugosllavisë titiste.

Në fillim të programit vetëm me dy fjalë u paraqit veprimtari besnik i çështjes kombëtare, Hydajet Hyseni, e pastaj iu dha rasti

atyre „analistëve“ të përrallave titiste dhe berishiste - hijenës me syze , Halil Matoshit dhe një puthadori „gazetaruc“ nga Tirana.

Ky i fundit krekosej para kamerës dhe doli me “argumente“ se Enver Hoxha ka qenë komunist dhe diktator dhe se ka vrarë kaq e aq. Kishin dhembje për ata që i shërbenin nënës së tyre UDB-së famëkeqe, të cilët bashkë me agjenturat evropiane dërgonin diversantë për të bërë përmbysjen e pushtetit popullor në Shqipëri, që u fitua me 28.000 dëshmorë e dëshmore të atdheut, gjatë luftës çlirimtare.

Bile grindaveci fjalaman H. Matoshi e sulmoi bashkëbiseduesin historian, me akuzën se Enver Hoxha paska qenë kundër NATO-s.

Sa harrestar i madh u tregua „analisti“ titist kur harroi se i madhi Enver Hoxha ishte trim. Ai s´kishte frikë as nga zoti e lëre më nga blloqet imperialiste, që kishin si qëllim themelor shtypjen e popujve.

Harrestari mjeran harroi gjithashtu, apo më saktë, nuk e dinte fare se në vitin 1961 Traktati i Varshavës ishte shumë më i fortë se NATO-ja, por Enver Hoxha ia tregoi vendin te thana, me nder lexuesve, e çoi në rr... të së ëmës. E bëri këtë në momentin e duhur, kur e pa qartë se ky traktat, i drejtuar nga Rusia hrushçoviane, kishte qëndrime kundër-shqiptare.

Enver Hoxha punoi për të mbrojtur popullin nga rreziqet që i kanoseshin prej fqinjëve okupatorë.

Ai dha urdhër të prodhohen miliona tonelata armatime, të fortifikohej vendi, me qëllim që në momentin e caktuar të mundë dhe të dijë si të veprojë. Tani ndërkaq, ato armë po shiten në Serbi e deri në Afganistan, nga trafikantë armësh të tipave Delijorgji dhe nga tipa injorantë si ti o H. Matoshi.

Natyrisht, duke e marrë bekimin nga i pari juaj Sali Berisha.

E sa për NATO-n, s´keni pse të krenoheni aq shumë o të marrë. Edhe pse kaluan 10 vjet ngalufta, ende nuk u zgjidh çështja e Kosovës, por as kauza shqiptare në përgjithësi!

Sot po shihet qartë se qarqe reaksionare, brenda dhe jashtë Shqipërisë, ende po bëjnë plane për tragjedi të reja për kombin shqiptar në Ballkan, sepse tani nuk është Enver Hoxha në ballë të popullit që t´u thotë të huajve dhe puthadorëve të tyre: stop pazareve me popullin shqiptar, se ky popull ka zot!

Ashtu siç u tha në Beograd më 1946 se ***Kosova është e Shqipërisë dhe duhet t´i kthehet asaj!***

Ashtu siç u tha në Paris më 1947 se ***Shqipëria ishte aleate e koalicionit antifashist dhe u çlirua me forcat e veta, prandaj kujdes me Shqipërinë!***

Ashtu siç u tha në Moskë më 1961 se ***Nikita Hrushçovi me klikën e tij, mund t´u fusin m... xhepave, por kurrë Shqipërinë nuk do të mundë ta bëjnë koloni!***

Ashtu siç u tha në Tiranë më 1981 se ***Kërkesa për Republikën e Kosovës është kërkesë e drejtë!***

Atëherë kur titistët shqipfolës dridheshin në Prishtinë, ndërsa kërkesën për Republikën e Kosovës e dënonin si djallin vetë.

Ishte Enveri ynë, Ai që aq shumë e mbrojti rininë heroike shqiptare e cila po përfytej e po përgjakej shesheve të qyteteve shqiptare, për të drejtat tona, me në krye atdhetarin vizionar - Hydajet Hysenin.

Tani ndërkaq, Shqipëria e ka një palo kryeministër si Sali Berisha i cili nëpër vite po prodhon vetëm fatkeqësi për Shqipërinë, duke u përlyer në korrupsion, duke pjellë afera me tipat e delijorgëve dhe të fazlliqve.

Ty dhe titistëve të tjerë të mjerë, që me idetë tuaja po u shërbeni klikave të huaja, kam edhe shumë për t´u thënë o H. Matoshi, por kjo nuk është e mundur me një shkrim. Madje nuk dua ta bjerri aq shumë kohën që të merrem me ty. E di se ju i parapëlqeni kuriozitetet, ndaj për kuriozitetin tuaj dua t´ua bëj me dije - ty dhe klanit tënd reaksionar - se 100-vjetorin lindjes së Enver Hoxhës e festuan në mënyrë madhështore edhe revolucionarët danezë në Kopenhagë.

Nuk do të harroj t´ju tregoj që se edhe enciklopedia botërore këta muajt e fundit e ka shpallur Enver Hoxhën si njeriun më të aftë shqiptar. Për këtë lajm, kujdes zotërinj, mos po merrni infarkt në zemrat tuaja fanatike.

Dhe për fund, grupit të „Ekspresit“, me kokën në Beograd e bishtin në Prishtinë, po i them: Mjaft me këto trillime e shpifje të paskrupullta. Mos harroni se nënat shqiptare, për kohëra të vështira, do të lindin kurdoherë Avni Rustemët e Shqipërisë.

Mos e harroni fatin e të parëve tuaj ideologjikë - Ahmet Zogollit dhe Esat Pashës, të cilët ishin paraardhësit tuaj të mjerë.

Danimarkë, më 25 tetor 2008

ENVER HOXHA BURËSHTETASI QË EDHE KUR FIENË I TMERRON TRADHËTARËT

Reagim, lidhur me "debatin" të zhvilluar midis Sabri Novosellës, Nexhmedin Spahiut dhe Erald Selcës në rubrikën Antipod të emisionit televiziv,me temën "Shqipëria 1945-2015"

Do të përpiqem të theksoj përmbajtjen më thelbësore të asaj që debatuan debatuesit, duke dhënë njëkohësisht këtu edhe opinionin tim për çështje të caktuara, po ashtu thelbësore.

1. Që në fillim, ish-veprimtari dinak dhe devijuesi nga idealet e lëvizjes ilegale në Kosovë - Sabri Novosella, konstaton me keqardhje se partitë profashiste, si "Balli Kombëtar, "Legaliteti" e të tjera, u shkatërruan, siç thotë ai, nga sllavët okupatorë.

2. Ndërkaq, e quan fatkeqësi të madhe faktin se më 28 nëntor 1944 në pushtet erdhën komunistët, Enver Hoxha dhe PKSH-ja.

Pastaj, ky kukum i mjerë, gjithnjë në cilësinë e mashtruesit të paskrupullt, vajton për faktin se Shqipëria socialiste paskësh rënë nën sistemin serbo-sllav.

Pas tij, fjalën e merr veprimtari atdhetar Erald Selca, i cili e kundërshton dhe e mbron pikëpamjen se Shqipëria është çliruar, jo më 28 nëntor 1944, por më 29 nëntor 1944, kur forcat fashiste, të detyruar nga forcat çlirimtare partizane, kanë ikur me ushtarin e fundit. Kjo fitore, thekson ai, pas LANÇ të popullit shqiptar, përkatësisht të ushtrisë çlirimtare me në krye gjeneral Enver Hoxhën, e bëri realitet çlirimin e Shqipërisë. Shqipëria po të mos rreshtohej në bllokun antifashist, nuk do të kishte ekzistuar fare.

Enver Hoxha është njeriu më i merituar që Shqipëria u çlirua në Luftën e Dytë Botërore dhe e fitoi simpatinë e Çurçillit, të Ruzvelltit dhe të Stalinit, si dhe të gjeneralit të famshëm francez Sharl De Golit, i cili madje edhe u takua me Enver Hoxhën - yllin e Luftës së Dytë Botërore. Toka shqiptare, nga veriu në Tropojë, e

deri në jug të Shqipërisë, është vaditur me gjakun e 28 mijë dëshmorëve. Pra, po qe se vendi nuk do të hidhej në këtë luftë, nuk do të kishte ekzistuar fare as Shqipëria administrative. Pas luftës, Enver Hoxha e gjeti Shqipërinë, jo të varfër por të mjerë. Ishte vend i bujkrobërve, i feudalëve dhe i agallarëve. Këto forca ndërkaq, (partitë e shkatërruara) që i përmendi Sabriu, të gjitha kanë qenë forca renegate dhe tradhtare. Ato kryekëput kanë vepruar kundër interesave kombëtare dhe nuk janë rreshtuar me bllokun antifashist. Në Kosovë ka qenë ca më ndryshe dhe këtë nuk e them vetëm unë, por edhe historianë të njohur shqiptarë. Ndërsa forcat e Ballit e të tjera si ato në Shqipëri, kanë marrë pjesë përkrah armiqve italo-gjermanë. Për shembull, në masakrën e Borovës kanë marrë pjesë edhe forcat kuislinge të Ballit.

Pas vitit 1944, Enveri e ka bërë të pamundurën për ta rimëkëmbur Shqipërinë. Pra, Shqipëria qe, jo e varfër por e mjerë - pa infrastrukturë, pa arsim, pa shëndetësi, pa teatër, pa operë, pa kurrgjë. Kanë munguar koniuktura e shtetit. Ato i ka vendosur Enver Hoxha. Enveri, përveç që u angazhua për shtetin shqiptar, u angazhua edhe për shqiptarët nën pushtimin jugosllav. I ka sponsoruar dhe i ka mbështetur të gjitha lëvizjet ilegale në Kosovë. Kjo mund të dëshmohet me të gjitha provat. Unë mendoj se pas vitit 1944 Enveri e ka bërë të pamundurën për ta rimëkëmbur Shqipërinë, për ta vitalizuar, për ta bërë shtet funksional. Në kohën e Zogut njerëzit kanë vdekur urie. Për këtë i kemi dëshmi veprat e Migjenit dhe ato nuk i ka shkruar ai për qëllime dhe arsye ideologjike. Pastaj, për të dhe për qeverinë e tij, të cilën e quante qeveri analfabetësh, ka shkruar edhe Noli.

Enver Hoxha ka bërë maksimumin që Shqipëria dhe shqiptarët të jenë komb i barabartë në mesin e kombeve të barabarta. Në Konferencën ndërkombëtare të Parisit, nuk kanë dashur ta pranojnë Shqipërinë si shtet antifashist, por duke qenë se ajo kishte merita në luftën antifashiste, nën trysninë ndërkombëtare, s'kishte sesi të mos njihej kontributi i saj.

Për dallim nga shtetet e tjera, Shqipëria u çlirua me forcat e veta, me përjashtim të ndonjë oficeri këshilltar gjatë luftës.

Është e turpshme - theksoi Eraldi, që sot kemi divergjenca rreth çlirimit të vendit. Partia e Sali Berishës e injoron ditën e çlirimit të vendit dhe çlirimin e feston më 28 nëntor, pra në Ditën e Flamurit. Kjo nuk është në rregull, është një tallje me këto data kaq të rëndësishme kur është derdhur edhe gjaku i dëshmorëve. Ne duhet ta respektojmë gjakun e derdhur, që atëherë e deri më sot.

Pastaj, me kërkesën e moderatorit, fjalën e merr Nexhmedin Spahiu, i cili nuk pajtohet me mendimin Eraldit se sikur Shqipëria të mos luftonte si antifashiste, nuk do të ekzistonte. T'i marrim shembull - thotë ai - shqiptarët e Kosovës. Në luftën e parë u radhitën me Gjermaninë etj… Shqipërinë në luftën e parë e përfaqësonte Toptani, mirëpo Esat Pasha u vra dhe Shqipëria mbeti ajo e vitit 1913. Sipas tij, situata qe e ngjashme me Luftën e Dytë Botërore, për shkak se shqiptarët morën pjesë në luftë me gjermanët, për kontributin që ka dhënë Gjermania për përparimin apo... (nuk dëgjohej mirë se ç'thoshte) të popullit shqiptar. Por një pjesë e shqiptarëve, duke pasur frikë se po përsëritet epilogu i luftës së parë, u radhitën me forcat gjermane.

Arsyetim krejt i pabazë, mendoj unë.

Dhe, përpiqet mjerueshëm ta rehabilitojë Ahmet Zogun, kur thotë: "Zogu e mori letrën e Hitlerit i cili ia ofronte bashkimin e Kosovës dhe të Çamërisë me Shqipërinë, por ky duke pasur frikë se Gjermania do të humbë dhe Anglia do të fitojë, shkoi në Londër dhe atje pati disa takime, duke pasur parasysh faktin se edhe elementë anglezë si Kipër Fild, Smajli e të tjerë, janë pro frontit të Lindjes. Po sikur këta i ka dërguar shërbimi i fshehtë në Shqipëri të punojnë edhe për ballistët dhe për përkrahësit e tyre në terren. Sipas përshkrimeve të Dejvid Smajlit, Piter Kipërtit e të tjerëve, këta ishin pranë ballistëve, pro Anglisë, kundër gjermanëve, e njëjta gjë (po them unë), e po thonë këta, kemi shkuar të ndihmojmë luftën kundër gjermanëve, t´i ndihmojmë partizanët por edhe ballistët.

Por, Nexhmedin Spahiu qëllimisht e anashkalon faktin se aleatët, e në veçanti misioni anglez në Shqipëri, e thonë pa dorashka se ballistët e Mit´hat Frashërit dhe legalistët e Abaz Kupit, nuk luftonin kundër forcave italo-gjermane, por luftonin vetëm komunistët, partizanët e Enver Hoxhës. Këto konstatime reale i kemi në kujtimet e tyre, kur ishin gjatë luftës në Shqipëri. Lexo: *"Fitorja e hidhur - Lufta Nacionalçlirimtare në Shqipëri "* nga Reeginald Hibbert dhe *"Shqiptari dinak"nga* Jon Halliday.

Por, a ka më të mjeruar në pikëpamje mendore se këta "analistë", që hiqen madje edhe si atdhetarë, "kombëtarë kosovarë" që deklarojnë se në Shqipëri nuk kishte luftë çlirimtare, por kishte vetëm luftë civile? Ndërsa ***historianët dhe analistët e huaj e thonë të vërtetën se në Shqipëri kishte luftë nacionalçlirimtare dhe se atë e bënë partizanët e Enver Hoxhës, deri në fitoren mbi fashizmin***.

Por, sipas N. Spahiut, ku ishin dallimet midis komunistëve dhe ballistëve? Ballistët nuk dëshironin ta shkatërrojnë vendin. Dëshironin që Anglia ta fitojë luftën dhe njëherazi të fitojnë edhe këta. Pra ta marrin pushtetin, për dallim prej atyre (këtu autori bën një digresion jo pa qëllim). Pastaj këta lidhen me Xhafer Devën, Rexhep Mitrovicën etj…

Shiheni të nderuar lexues, sesa "të hollë" paskan qenë "të uruarit", gjentëlmenët e paqes me fashizmin, ballistët dhe legalistët.

"Nuk e donin shkatërrimin e Shqipërisë", konstaton pasardhësi i tyre politik, Nexhmedin Spahiu. Kjo, për besë më bëri të qeshem dhe më kujtoi idenë e përrallës pacifisto-titiste të durimit të turpshëm të LDK-së, kur Ibrahim Rugova vite me radhë deklaronte dhe kërkonte me vendosmëri: "Mos e provokoni situatën"!

Madje edhe në vitin 1997, kur populli dhe rinia studentore përpiqeshin të rezistonin dhe të bënin luftën çlirimtare kundër fashizmit serbomadh.

Ballistët, si të vjetrit ashtu dhe të sotmit, gjithmonë mendjen e kanë pasur qyl, kanë dashur dhe duan që "Edhe mishi të piqet, edhe

helli të mos digjet”! Hahaha!Këtu dua t´ju përkujtoj vetëm ca vargje mbresëlënëse të romancierit, përkatësisht të poetit Shefqet Musaraj:

Ngordhi kali, i ranë thonjtë,
Po vrapon Balli t´i heqë patkonjtë;
“Ishin dhe janë të zgjuar për besë,
Nuk kanë bërë asgjë,
Dhe thonë - duam pjesë”?!

Kështu do të këndonte edhe sot poeti i njohur, sipas motivit të poemës satirike *“Epopeja e Ballit Kombëtar”.*

Tani dua këtu të shpreh ca dyshime të bazuara në fakte, rreth veprimtarisë subversive dhe pasurisë materiale - ngase dihet se pasuria shpirtërore i mungon plotësisht – të Sabri Novosellës.

Sabriu thotë se ka qenë në organizatën e Metush Krasniqit? Por a ka mundësi që ky zotëri të përmendë të paktën ndonjë aksion apo ndonjë veprimtari që ta ketë zhvilluar atëbotë, me ndonjë një person që është gjallë, që të dimë se me kë paska bashkëpunuar?!

Duhet sqaruar diçka lidhur me “ikjen” e tij në Shqipëri. Thuhet se pasi që policia jugosllave e ka dërguar në kufi të Shqipërisë, paska ikur. Si ka mundësi të ketë ikur?! Kur "iku"?! Ndërsa fill pas kësaj “ikjeje spektakulare”, me një operacion të bashkërenduar me të, policia jugosllave e ka kontrolluar shtëpinë e tij, madje duke bërë zhurmë të madhe, që të dëgjonte lagjja dhe populli, kinse andej kah novosellët paskan zbuluar një armik të rrezikshëm?!

Nuk kam asnjë interes, as nuk do të merrja mundimin të shkruaja lidhur me këto zhurma që i bën borgjezi i pasur - Sabriu, i cili u pasurua me paratë e shtetit shqiptar. Në krizën më të madhe, qeveria e RPSSH, me direktivën e Enver Hoxhës për çështjen tonë kombëtare, sipas fakteve të dokumentuara, i ndau dy milionë dollarë amerikanë për mërgatën dhe për përfaqësuesit e saj në

Evropë, atëbotë kur heroi i kombit ***Jusuf Gërvalla***, po i shkruante letër Enver Hoxhës.

Madje, thuhet se i kanë marrë afër 11 mijë dollarë. Reagova sepse u habita kur në atë debat Sabriu filloi të shpifte edhe ndaj Vetëvendosjes, kinse kjo Lëvizje, Albin Kurti dhe Emrush Xhemaili qenkan proserbë e marrëzira të tjera, bla bla bla! Për fat të keq, Sabriu u kompromettua keq atë natë, së bashku me atë "pejgamberin e kombit kosovar", Nexhmedin Spahiun.

Më pas, debatuesit Sabriu dhe Nexhmedini, në mënyrë paskrupullt u fokusuan edhe te personaliteti i Enver Hoxhës, duke shpifur në mënyrë histerike. Sidoqoftë, s´prish punë. S'ke çka u bën axhaminjve. Aq dinë, aq thonë.

Dua t´ua përkujtoj debatuesve shkretanë si dhe lexuesve të nderuar se për Enver Hoxhën, me respekt të madh, kanë folur dhe kanë shkruar atdhetarët dhe dëshmorët e lirisë së atdheut si: ***Jusuf Gërvalla, Ukshin Hoti, poetët kombëtarë, Hysni Milloshi, Mustafë Shyti, Kadri Kadriu***. Flasin dhe shkruajnë edhe sot, atdhetarë dhe atdhetare të devotshme që janë në rrugën e nderit dhe të lirisë - ***Zeqir Gërvalla, Avdi Ibrahimi, Sejdi Veseli, Ramadan Pllana, Afrim Morina, Gjon Bruçi, Ndoc Logu, Iliriana Koleka, Valentina Mici, Hajrije Berisha*** e shumë e shumë të tjerë.

Ndërsa, burra shteti si: Stalini, Çerçili, Ruzvelti, Gjergj Dimitrovi, Dë Goli, Mao Ce Duni, Toni Bleri, e shumë të tjerë, disa prej tyre, ndonëse nga pozita jo gjithmonë miqësore ndaj tij - e kanë vlerësuar lart luftën dhe punën e tij gjatë viteve kur ishte në krye të PPSH-së, e në veçanti, daljen e Shqipërisë nga Traktati i Varshavës, kur iu kundërvu PK të BRSS dhe Nikita Hrushçovit për ambiciet pushtuese të tij, kur erdhi në pushtet pas vdekjes së Stalinit.

Për klikat reaksionare të historianëve matufë që nuk e pranojnë realitetin, qoftë edhe të hidhur, e kam një mesazh: *"KUSH TENTON TË PËSHTYJË DIELLIN, PËSHTYMA I BIE NË FYTYRË"!*

Dua t'ua bëj me dije edhe një njoftim, që neve të cilët jemi besnikë dhe besnike ndaj personalitetit të Enver Hoxhës dhe veprës së tij, brenda dhe jashtë atdheut, na bën krenarë dhe krenare.

Kopenhagë 29 01 2016

ENVER HOXHA ËSHTË I GJALLË PËR ÇDO SHQIPTAR, QË E NDIEN VETEN SHQIPTAR, NDËRSA TI DHE GRUPI YT NEOFASHIST JENI TË GJALLËT E VDEKUR, O BUJAR NISHANI!

Kopenhagë, 18 tetor 2006

Sipas të përditshmes së Shkupit ” Fakti” të datës 19 shtator 2006 (faqe 8) e botoi një kumtesë – reagim të zëdhënësit të grupit parlamentar së Partisë Demokratike, Bujar Nishani. Përkitazi me manifestimin e Partisë Socialiste me rastin e përvjetorit të Konferencës së Pezës heroike, ku qytetarët shqiptarë dalën në atë vend të shenjtë, atje ku ishte bërë betimi për çlirimin e Shqipërisë! Me atë rast historiani guximtar, kryetari i partisë Sociademokrate, e bëri një ftesë të arsyeshme dhe të kthjelluar që : “të nderohen organizatorët kryesorë të asaj Konference nga Myslim Peza deri te Enver Hoxha”!

Kërkesa e tij e drejtë u prit me eufori sulmesh foshnjore, në veçanti në parlamentin e zhurmshëm shqiptar!

Zotërinjtë deputetë harruan se: nga ajo Konferencë u dhanë direktiva të mëdha lufte, që pastaj ajo luftë e lavdishme e solli lirinë dhe Shqipërinë e radhiti me fitimtarët-aleatët sovjetikë-dhe anglo-amerikanë, kundër bishave të egra të nazizmit dhe fashizmit.

Me dashje ose pa te edhe nga partitë që quhen socialiste në Shqipëri por që nuk e dëshirojnë përmendin emrin e strategut të asaj lufte antifashiste, harruan se merita kryesore i takon të madhit e të pavdekshmit përjetë, Enver Hoxha.

Ne, si veprimtarë shqiptarë që përpiqemi ta ndijojmë kombin tonë nga Skandinavia çështjen shqiptare dhe kauzën e saj. Ne, nuk reaguam kur ju e manifestuat përvjetorin e heroit tuaj që vet e keni vrarë, Azem Hajdarin për t´i mbuluar turpet dhe krimet tuaja, e

shpallët ”hero i shekullit”, po as opozita nuk pati deklaratë të tillë kundër jush!!!

Ne, nuk habitemi hiq se ju i bëni këto komplimente atij heroit tuaj të “demokracisë”, sepse ishte po ky Azem Hajdari ia i cili në kohën kur po digjej Kosova në shtatorin e vitit 1998, doli atje në veri e jepte kushtrimin famëkeq me armë në dorë: “ja vdekje ja liri o burra të nisemi drejt Tiranës”! Pra, të niseshin nga veriu grupet e armatosura drejt Tiranës që ta rrëzonin me armë, qeverinë Nanos!!!

Tani, ju të nderuar lexues, paramendojeni vetëm për një çast: a do të kishte shpërblim më i madh për Serbinë dhe goditje më e madhe për shqiptarinë se të përsëritej gjëma e madhe që ju ia sollët Shqipërisë në vitin 1997?!!!

Ju, jeni ata që pas “demokracisë suaj të ndritur” po i përkujtoni dhe nderoni profashistët dhe neonazistët më të urryer, ju po e përkujtoni dhe dështakun e historisë shqiptare, ikanakun mbretin Zogolli i cili kur u okupua Shqipëria më 7 prill 1939 , bashkë me suitën e tij iku nga sytë këmbët për më keq e mori me vete arin e shtetit duke e bërë atje në perëndim lesh e li...

Ndërsa, ju tani në vend se ta kërkoni pasurinë e humbur të kombit, familjen e tij e shpërbleni me prona të mëdha në qendër të Tiranës!!!

Ju jeni të prirë për konflikte brenda kombëtare, ashtu si gjyshërit tuaj që luftuan përkrahë fashistëve të huaj, pas ferrave në frontet e tyre të ulëta, kundër partizanëve çlirimtarë.

Ju, sërësh po i fryni zjarrit! E kjo është shumë e rrezikshme për ardhmërinë e Shqipërisë! Atëherë, zotëri oficer pse reaguat kur mbahej manifestimi i epopesë së madhe kombëtare. Me sa dimë ne, ti je kuadër ushtarak i përgatitur në shkollën e lartë të oficerëve “Skënderbeu”, në Tiranë, dhe dihet që betimi që keni dhënë si ushtarak; por, ti paturpësisht shkele mbi betimin tënd dhe më 1991 u radhite me grupin e huliganëve që ishte i ndihmuar nga titistët shqipfolës me “strategun” kundër shqiptarin e mjerë Ibrahim Rugova; natyrisht, ju të ndihmuar edhe nga lobistët serbë siç ishte

ish-ambasadori i amerikan Lorenc Igelbereger dhe një ministër anglez, Lordi Karikton ata të cilët më vonë do jenë edhe iniciuesit "strategët" e mbledhjes së dytë te Londrës më 1992, që dy presidentëve "shqiptarë" Sali Berisha ai kërkuesi i azilit politik tek S. Millosheviqi, Ibrahim Rugova, që kënaqeshin me konferenca shtypi dhe klithnin si papagajtë pas çdo takimi me ndërkombëtarët se ramë dakord që me dialog do ta zgjidhim çështjen shqiptare në ish-Jugosllavi dhe atë të Kosovës në veçanti,dhe natyrisht kjo ishte dhe politika nacional-shoviniste e udhëhequr nga kasapi serb i Ballkanit, S.Millosheviqi të cilit ju i keni bërë një shërbim të madh. Por, ju prapë po e vazhdoni avazin e vjetër: herë direkt herë nëpërmjet miqve të vet ndërkombëtar e imponontе politikën serbe në instuticionet shqiptare.

Këtë politikë ua prishi i madhi Adem Jashari i cili pasi e kishte menduar mirë se me lutjet e së premtes së Rugovës së ndjerë titist, nuk zgjidhen hallet shqiptare me shokët e tij i krijoi celulat ushtarake prej së cilës erdhi e lavdishmja Ushtri Çlirimtare e Kosovës dhe pikërisht këtë hero kombëtar së bashku me shokët të tjerë ju e burgosët me direktivat e titistëve nga Prishtina dhe Beogradi,

Ju, or Bujar Nishani kur ishit në pushtet nuk kemi dëgjuar të reagosh për këto burgosje të heronjve të gjallë në atë kohë. Por, as tani kur shefi i juaj ishte në Prishtinë dhe Drenicë para varrit të legjendarit, Adem Jashari tha; se shtëpia ime ka qenë shtab i UÇK, pse ti nuk reagove se ajo ishte e pavërtetë, kur dihet se e gjithë banda juaj "demokratike", e mbështetnin FARK-un, e qeverisë toptaniste alias (bukoshiste) që e mashtronte popullin në perëndim dhe mblidhte ndihma në emër të luftës, dhe e sabotonte me të gjitha mjetet atë.

Ti, or oficer Nishani, i nishangjinjve të këqij, tani mundoheni të merrni mundimin që me bandën tuaj të dënoni pushtetin popullor, të diktaturës së proletariatit, kinse ajo paska qenë diktatura më e egër por, këtu ju e keni ndihmën e dhe nga shumë puthadorë të mjerë që për interesat e tyre personale po hedhin baltë mbi të

kaluarën, njëri nga ata që tani po çirret në perëndim se kjo paska qenë diktatura më e egër në botë është edhe Ismail Kadare, i cili kur e thotë këtë qëllimisht e harron faktin se ishte kjo "diktaturë" me në krye "diktatorin" e saj Enver Hoxha që këtij shkrimtari vërtetë të madh dhe njëkohësisht këtij njeriu vërtetë me karakter shumë të vogël; i dha shumë përkrahje, për më tepër si mund të ishte i rrezikuar ky "martir" i imagjinatave të tij larg Shqipërisë, kur atëbotë ishte edhe Nënkryetar i Frontit Demokratik?!

Krejtësisht është e pavërtetë se në Shqipëri, ishte diktatura më e egër në botë!

Kujtojmë këtu krimet e Tito-Rankoviqit ndaj shqiptarëve në ish-Jugosllavi; vrasjet internimet, burgosjet e ndjekjet policore të UDB-s. A e di apo nuk donë ta dijë Ismail Kadare dhe kompania zhurmëmadhe kundër enveriste se : Titoja pas luftës së dytë botërore sipas gjurmimeve historike të historianit, Hakif Bajrami i ka vrarë më shumë se 4900.500 shqiptarë?!

Pastaj, ende nuk dihet numri i saktë sa të internuar, sa të burgosur, sa të ndjekur politikisht kanë qenë në ato vite të errëta?!

Po, a nuk u zhvilluan në Jugosllavinë titiste, me dhjetëra e dhjetëra gjyqe politike edhe kundër popujve të tjerë liridashës të ish-federatës së imponuar me dhunë, kundër çlirimtarëve që kërkonin pavarësi për vendet e tyre si: boshnjakë, kroatë, sllovenë e të tjerë, proceset politike i kanë kapur jo rrallë edhe majat e larta në ushtrinë jugosllave...

Po, pastaj pse ky zotëri puthador i francezëve i "harron" krimet e mëdha që janë bërë në shtetet tjera të Ballkanit dhe të Evropës, pikërisht gjatë këtyre viteve, kur sundonte despotizmi, më i egër mbi popujt, kur Gjermania ishte e ndarë padrejtësisht, kur Çekosllovakia, Hungaria e të tjera shtete sovrane po sulmoheshin nga kolonialistët, revizionistët sovjetikë, - siç i quante me të drejtë i madhi Enver Hoxha; ishte koha kur Rusia po sundohej dhe po i sulmonte vendet sovrane me në krye kundër njerëzorin dhe kundër shqiptarin më të madh rus, Nikita Hrushqovi. Fatkeqësisht, kjo valle e djallit mbi popujt liridashës, luhej edhe në perëndim; lufta e ftohtë

kishte marrë përmasa të egra; kujtojmë këtu sulmet amerikane mbi shtetet sovrane si: Vietnami, Koreja, Kamboxhia, Laosi, Nikaragua e të tjera shtete të cilat nuk e përfillnin "demokracinë" e atëhershme amerikane.

Tani, shtrohet pyetja: sa gjak i njerëzve të pafajshëm u derdh në këto vende?!

Sa të drejta elementare njerëzore u shkelën në ato vite kur sundonte ""socializmi" në lindje dhe "demokracia" në perëndim kur përhapej zjarri dhe përdridhej litari mbi popujt liridashës?!

Jo, zotëri të verbuar nga epshet për pushtet dhe për interesa personale; nuk ishte Shqipëria Socialiste as populli shqiptar, populli më i persekutuar nga regjimi i Enver Hoxhës!

Pastaj, shtrojmë logjikisht a ka kuptim kjo histeri sulmesh mbi udhëheqësin e lavdishëm , Enver Hoxha kur dihet historikisht se kurrë gjatë "sundimit të egër", Enver Hoxha, nuk i përkrahu por, kurdoherë me guxim i dënoi këto sulme, apo më saktë këto luftëra reaksionare mbi shtetet sovrane.

Mbase, pikërisht për këtë Shqipëria për popujt liridashës, ishte fanar i ndritur në Ballkanin e trazuar dhe populli shqiptar kishte respekt të padiskutueshëm në botë.

Ne, që jetojmë jashtë atdheut, jo rrallë na ka ngjarë të takojmë njerëz nga vende të ndryshme që flasin hapur me respekt të madh për Shqipërinë Socialiste dhe për strategun e madh, Enver Hoxha. Ngjanë kjo sepse popujt nuk mashtrohen nga gënjeshtrat tuaja shterpe politike e jo politike që i hidhni si pluhur e hi në erë...

Ju, kujtojeni vetëm një fakt: për 50 vjet populli shqiptar nuk e pati asnjë konflikt të llojit të vitit 1997, ku me sa dihet: së paku 3000 veta u vranë, qindra të tjerë u plagosën, shumë prej tyre përfunduan në çmendinë, sipas të dhënave statistikore, thuhet ky numër ka arritur deri në 400 veta, ata fatzinj si përballuan dot psiqikisht tmerret e fillim luftës civile.

Ju, me politikën e përçarjes të hurit e të litarit: e shumëfishuat tragjedinë kur dhe mbi 1 milion shqiptar i detyruat të largohen nga

sytë këmbët duke marrë rreziqe të rënda mbi shpatulla: deti shqiptar u kthye nga një det freskues, u bë një det i përvëlues – vdekjeprurës për shqiptarët, duke ikur me drejt vendit "mik" Italisë e cila vetëm në një aksion famëkeq me anijen luftarake "Sibila" i vrau më shumë se 80-të shqiptarë. Ne, ende nuk e dimë a është dënuar dikush nga ata kriminelë, që e shkaktuan atë tragjedi të rëndë, në detin Jon, në brigjet e Vlorës sonë heroike.

Fatkeqësisht, sot Shqipëria ka një emër të keq në botë, sepse po lëngon nga plagë të rënda që ju ia keni shkaktuar me drejtimin tuaj të pa mend: prostitucioni dhe narkomania kanë marrë hov si mos më keq, krimi i organizuar edhe deri në kupolat e brishta të shtetit, ia ka vënë kulminacionin e së keqes; vëllavrasja po e sakatojë çdo ditë Shqipërinë; ju që ankoheni për burgjet e enveriste , tani ato kullat e krenarisë shqiptare i keni kthyer në burgje familjare në malësitë tona!!! Ata, qindra fëmijë të cilët sot i ka burgosur kanuni i maleve, nesër do t´ju akuzojnë ju e jo Enver Hoxhën i cili i varrosi ato kode të egra; ku kërkohej hapja e varreve të reja!...

Unë, Fadil Shyti dora vet kam qenë në vitin 1979 për 15 ditë në Shqipërinë Socialiste, gjatë atyre ditëve kam qenë shumë i lumtur se po e vizitoja shtetin Amë, dhe ju them me sinqeritet se për ato 15 ditë i kam vizituar shumë qytete e katunde të atdheut tonë të dashur, por asnjëherë s´më ka ngjarë të lexoj për ndonjë krim, vëllavrasje ndër shqiptarët, pastaj asnjëherë nuk më ka ngjarë që të shoh ndonjë nënë shamizezë se djali apo e bija ju ka vrarë në det apo në prostitucion, në konflikt me grupet mafioze e gjetiu, në hajni apo raste të tilla të panjerëzishme. Ndërsa, pas viteve "të ndritura" të udhëheqjes suaj kam qenë 3 herë tjera ju them me sinqeritet për ato ditë sa qëndroja në Shqipëri me përjashtim se kënaqesha në vendin tim, për ato sa i theksova më lart, jam tronditur si mos më keq!!!

Mua më dhimbset populli shqiptar që po heq të zitë e ullirit nën kthetrat konfliktuoze të "demo(n) kroatëve si ju!

Populli shqiptar duhet të ndërgjegjësohet, që t´ju shporrë sa më parë nga pushteti juaj i hurit dhe i litarit!

Përndryshe, do të vuan pambarimisht deri në ferrin e Dante Aligerit, sepse po e duron shpatën e Domekleut mbi kokë!

Pra, plagë të tilla e krime të tmerrshme që po ngjajnë sot, nuk kishte kriminelët e të gjitha ngjyrave as që guxonin t´i ëndërronin në epokën e ndritur të Enver Shqiptarit.

Ndërsa, sa i përket problemit të shtruar të çështjes shqiptare në kohën e të madhit Enver Hoxha, politika shqiptare në Ballkan dhe në botë, në atë kohë kishte zërin e vet dhe fliste shqip me miqtë dhe armiqtë qofshin këta të vegjël apo të mëdhenj. Shteti me sigurimin shqiptar, u bëri ballë atyre qindra grupeve diversante dhe jo më pak se 400 grupe gjakatare u futën nga brigjet detare, nga malet , disa zbritën nga qielli shqiptar por, ato u shpartalluan pamëshirë nga pushteti popullor që ju tani o mjeranë, e quani diktaturë e hitleriane!!!

Enver Hoxha e ka mbajtur gjallë dhe e ka forcuar gjenin shqiptar!

Në kohën e "diktaturës" së Enver Hoxhës, kjo Shqipëria londineze që e quani kështu ju politikanët modernistë, kishte dinjitet: nuk ishte koloni e askujt, sepse në ato vite kishte uzina, fabrika, hidrocentrale, të cilat i fuqizonte me forcat e veta, shteteve të huaja mike as armike nuk ua kishte asnjë lekë borxh, ushtrinë e kishte më të fortë se sot.

Enver Hoxha, e ka zhvilluar shkencën shqiptare për ato vite deri në atë masë sa që radhitej me vendet më të zhvilluara të botës, e zhduku analfabetizmin, e bëri Shqipërinë me art dhe kulturë të përparuar dhe vërtetë kombëtare.

Enver Hoxha, e dha nismën për mbajtjen e Kongresit të drejtshkrimit më 1972 në Tiranë, i cili e arriti njësimin e gjuhës shqipe, kurse sot disa mjeranë po hedhin baltë mbi ato përpjekje madhështore nga shkencëtarët tanë.

Enver Hoxha, i bëri shqiptarët ta duan Shqipërinë, sepse kishte shoqëri të shëndoshë me një moral të fortë kombëtar, kurse sot fatkeqësisht shumë shqipfolës mendjeshkurtër po e fyejnë

Shqipërinë, pikërisht nga dobësimi i këtij morali që ju ia keni sjellë NËNËLOKES sonë hallemadhe!

Këto janë fakte të pamohueshme, që s´mund t´i heq nga mendja populli ynë, sado që ju hidhni vrerë kundër këtij burri të madh të kombit i cili bëri që të gjitha përpjekjet e fuqive të mëdha për ta bërë koloni e lesharapi Shqipërinë, dështuan me turp!

Këtë e ka pranuar hapur edhe politikani anglez, Toni Bleri, kur deklaroi pa dorashka: "ne nuk kemi pasur sukses në përpjekjet tona, kundër Enver Hoxhës"! Kur ishte në vizitë Peres De Kuelari, qe mahnitur nga përparimi e Shqipërisë, me atë rast pati deklaruar: "Jam i mahnitur nga këto zhvillime në një shtet kaq të vogël, që e drejton ekonominë kombëtare vetëm me forcat e veta"!

Po kështu me pietet është shprehur edhe politikani gjerman, Shtrausi, me rastin e vizitës që ia bëri Shqipërisë, në vitet 80-ta.

Ju thoni se Shqipëria në kohën e Enver Hoxhës paska qenë e izoliuar nga diktatura komuniste kurse ne ju themi: kjo s´është hiq e vërtetë! Shqipëria, atëbotë kishte marrëdhënie reciproke me më tepër se 100 shtete kurse, tani bota dinakërisht po izolon Shqipërinë nga maskarallëqet tuaja , nga shumë plagë të shoqërisë që e keni katandisur ju Shqipërinë dhe në veçanti nga frika e rikthimit të neofashistëve në pushtet!

Ju, po çirreni deri në qiell se doni të bashkoheni me Evropën, kurse pikërisht kjo Evropë dinake me politikën e saj kundër shqiptare, ne shqiptarët po na katandisë si mos më keq!

Shul shqip: Shqipëria se ka më identitetin dhe krenarinë në botë, siç e kishte dikur!...

Ju po u çoni çdo ditë ujë në mulli armiqve tanë, kur çirreni se diktatura më egër paska qenë në Shqipëri, gjatë "sundimit të diktatorit", me politikën tuaj të tallavave...

Ju s´jeni në gjendje ta kuptoni apo nuk doni ta kuptoni se: kjo, më së shumti i shkon përshtati Serbisë!

Mos harroni ju z. të fantaksur, ju që aq shumë jeni alergjik kundër emrit të ndritur të Enver Shqiptarit; se si Enveri ka vepruar

për Shqipërinë po ua kujtojmë edhe këto raste: së pari gjatë Luftës Nacionalçlirimtare i dërgoi dy divizione në trojet etnike kundër fashizmit, së dyti, Letrën dërguar BS, Josif V.Stalinit më 12 shtator 1949, ku i kërkonte që Kosova duhet çliruar me pushkë dhe me gjak nga okupatorët titistë, së treti, detyrën që ia ka dhënë Shtabit të Përgjithshëm në vitet 1980-1981, për të bërë planin e ndërhyrjes në Kosovë, në kushte të favorshme të situatës politike dhe asaj ushtarake.

Enver Hoxha asnjëherë nuk i ka tradhtuar interesat e shqiptarëve që jetonin jashtë kufijve të padrejtë të vitit 1913.

Kurse ju pushtetarët e sotëm nuk keni bërë asgjë, përkundrazi ju me udhëzimet e Sali Berishës, keni qenë kundër UÇK-së, e keni përkrahur me të gjitha mjetet FARK-un e B. Bukoshit dhe të I. Rugovës.

Enver Hoxha, tërë jetën punoi dhe na mësoi për bashkimin kombëtar!

Ti z. Nishani e din mirë faktin e pamohueshëm se ky burrë i madh i kombit me shokë, bëri plane ushtarake për çlirimin e trojeve shqiptare të cilat u pushtuan nga titistët jugosllavë, dhe për tradhti historike të Titos me kompani, këtë Enver Hoxha nuk u pajtua kurrë!...

Por, ti nuk bëhesh i sinqertë, ta përkujtosh e ta pranosh këtë!

Por, ti ke rënë kurthet e partisë tënde -mafioze e kundër kombëtare.

Ne, fort mirë e dimë se ju me programin e partisë suaj po veproni për kaq vite kundër popullit shqiptar! Ju, e keni vërtetuar këtë me veprimtarinë tuaj kundër shqiptare që prej se keni ardhur në pushtet me zhurma dhe jo rrallë herë me krisma dhen me hunj në krah!

Lidhur me Kosovën qëndrimin tuaj e paraqitët pa dorashka dhe pa turp edhe gjatë vizitës së Sali Berishës në Kosovë, kur hapur ju premtoi serbëve: “kishat serbe do të rregullohen (harroi i shkreti se shumë nga ato kisha janë shqiptare), pra, do të rregullohen e dhe me

mjetet e Shqipërisë, dhe pastaj vijoi: “ ne, e përkrahim pavarësinë e Kosovës, nën dirigjimin e Brukselit e të Strasburgut...

Kjo, vlerësohet nga ne dhe jemi të bindur edhe nga të gjithë atdhetarët e vërtetë, hiq më pak se tradhti kombëtare!

Enver Hoxha thoshte me plot logjikë dhe guxim: “Populli i Kosovës është autokton në trojet e veta dhe është ndarë padrejtësisht nga fuqitë e mëdha”!

Tani, çdo ditë këto fuqi armike po tallen me shqiptarët “demokratë”, këto po ua bëjnë kulaçin e pastaj edhe po ua japin kërbaçin! Sot,

Shqipëria e ka humbur pavarësinë që e kishte para vitit 1991, ju e shkatërruat egërsisht nga këshillimet e lobit serb, sepse serbët e din se duke e destabilizuar Shqipërinë, në ketë mënyrë më lehtë mbahet e pushtuar Kosova me vise të tjera shqiptare dhe ashtu sipas tyre, stabilizohet Ballkani.

Enver Hoxha është i gjallë në zemrat e atdhetarëve, tek ata që e konsiderojnë veten shqiptar, ndërsa ju dhe banda e juaj, jeni të gjallët e vdekur: politikisht, ekonomikisht pastaj edhe nga të gjitha fushat jetësore të vdekjes morale dhe etike shqiptare. Ju, kënaqeni boll, për interesat e juaja personale, jetoni si sheikët, bile biologjikisht...

Prandaj, pushoni nga zhurmat dhe trillimet me fjalorin tuaj të kundër njerëzishëm që e shprehni hapur gjarprisht, lërini të qetë heronjtë kombëtarë, sepse atje nën varre ku pushojnë, ata janë më krenarë dhe më të ndershëm se ju!

Kujdes se:

Heronjtë janë si ajri,

Heronjtë janë si buka,

Mos i fyeni zotërinj,

Se mund të kërcet pushka!

(Këto vargje i kam shkruar në vitin 1991, F.SH).

Ju, mjerisht vargjet që japin mesazhe madhore nuk i lexoni, pastaj e pësuat në vitin 1997!

Kujdes: Sepse, zemërimi i popullit nuk mbytet pafundësisht; por, po të shpërthej sërish do jetë vullkan më i stuhishëm se ai i vitit 1997 pastaj, ju zor e keni të mos lageni...

Danimarkë, 26 shtator 2006

Pjesa e gjashtë

RECENCA

TË THËRRASËSH ZANËN E NDALUAR

Shqiptar Oseku

Recension për librin e fundit të z.Xhemil Zeqiri "Mbi çështjen shqiptare"

Në një tregim të vjetër shqiptar, një bari kishte humbur rrugën në Bjeshkët e Nemuna dhe papritur has në vallen e zanave. Zana më e bukur nga të gjitha bie në dashuri me bariun dhe e ndihmon atë që ta gjejë rrugën e kthimit. Ajo iu lut bariut që ta mbajnë të fshehur lidhjen e tyre në mënyrë që të mundë të takohen në kasollen e vallëzimit në çdo natë pa hënë. Por bariu mundi ta mbajë sekretin vetëm për një kohë të shkurtër dhe këtë ua tregoi fshatarëve që talleshin me të. Në takimin e radhës, zana nuk erdhi. Bariu i ri kuptoi se kasollja ishte zhdukur dhe për fatin e tij të keq, ai e kishte harruar rrugën për në shtëpi.

Ashtu siç thotë tregimi, erërat e bjeshkëve ende i bartin thirrjet e bariut, duke thirrur me dënesë emrin e zanës së tij.

Është një mit i zakonshëm në Ballkan, që bart një mesazh të vjetër, po aq antik, sa që është ende tematik. Ky njeri çdoherë e ka hetuar dhe është frikësuar nga rreziku për ta thënë të vërtetën. Megjithatë ky njeri, për të ruajtur dinjitetin e vet, synon ta thotë të vërtetën, pavarësisht nga pasojat e tmerrshme,.

Ndoshta kjo gjë është më evidente te popujt e vegjël të cilët është dashur të luftojnë për t'u bërë ballë dallgëve të fuqishme të historisë. Është dashur që ata të mbijetojnë nën tiraninë e të fortit ndaj dhe i kanë krijuar dhe i kanë treguar tregimet e tyre. Në të vërtetë, e gjithë ekzistenca e tyre ka qenë në pikëpyetje.

Prandaj, nuk është çudi përse kjo përvojë e ka ruajtur shenjtërinë e mitit te shqiptarët, vendas të persekutuar të Ballkanit. Në fakt, nuk ka popuj të tjerë në Evropë (përveç ndoshta popujve baltikë nën Bashkimin Sovjetik) që është dashur të paguajnë një

çmim aq të lartë për ta rrëfyer tregimin e tyre. Asnjë popull nuk ka pasur aq shumë rapsodë të vrarë për shkak se kanë kënduar këngë historike apo kreshnike; aq shumë intelektualë të burgosur, vetëm sepse kanë shkruar për ide të ndaluara; aq shumë studentë të rrahur dhe të torturuar me elektroshok, për shkak se i kanë lexuar shkrimet e tilla; dhe aq shumë shtëpi të bastisur prindërish që janë marrë në pyetje, për shkak të literaturave që kanë lexuar fëmijët e tyre.

Danimarka dikur i publikonte shpesh qëndrimet e z. Zeqirit lidhur me refugjatët. Sot i publikon edhe pikëpamjet e tij lidhur me politikat e tashme të deportimeve të ngutshme. Ai është mjaft i njohur në Danimarkë në rrethet e njohësve të Ballkanit, për qëndrimet e tij të zëshme, për dhjetëra artikuj të publikuar në shumë gazeta prestigjioze daneze si dhe për një libër intrigues ***mbi çështjen shqiptare***.

Në librin e tij të dytë, arrijmë të kuptojmë se çfarë ka ndodhur në Ballkan pas ndërhyrjes së NATO-s në vitin 1999. Në të vërtetë, ky është tregimi mbi atë se çfarë pasoi pas oficiales *"të lumtur përgjithmonë"*.

Z. Zeqiri ka një histori për të rrëfyer dhe atë e tregon në mënyrë të sinqertë. ***Kujtimi i tij për bariun është rrëfim i një humanisti i cili e ka parë dhe e ka përjetuar sesi humanizmi në Ballkan rrokulliset në hendek edhe pas ndërhyrjeve të NATO-s në rajon dhe i bie alarmit***.

Z. Zeqiri ka një të vërtetë të qartë për të na treguar - atë se shqiptarët e kolonizuar dhe të shtypur, janë duke u shpërfillur dhe duke u keqpërdorur përsëri. Këtë herë jo nga fajtorët lokalë, por nga vetë demokracitë, përfshi edhe Danimarkën, e cila u zotua se do të ndërmerrte hapa për t'i ndryshuar gjërat.

Artikujt, stenogramet e mbledhjeve dhe letrat e Z. Zeqirit, mes të tjerave edhe ato drejtuar ministrit të përtashëm të Punëve të Jashtme të Danimarkës dhe homologut të tij në BE, e plotësojnë njëri-tjetrin duke krijuar një vepër integrale dhe origjinale për zhvillimet politike kombëtare në botën shqiptare dhe në gadishullin e trazuar. Prej shkrimeve dhe analizave politike të z. Zeqirit

mësojmë njëherazi edhe për kushtet dhe rrethanat e vështira e të dhimbshme të këtij veprimtari të devotshëm dhe lobisti të palodhur, të përkushtuar fund e krye kauzës shqiptare. Shkrimet e tij janë dëshmi e një idealisti i cili kurrë s'e vuri në plan të parë interesin e vet personal.

Duke lobuar personalisht për shqiptarët në Suedinë fqinje me vite, nuk e kam gjithaq vështirë për të kuptuar mirëfilli dëshpërimin që vërehet në mes rreshtave në librin e z. Zeqiri.

Standardet dhe konventat ndërkombëtare si dhe të drejtat themelore të njeriut, si duket nuk zbatohen kur është fjala për çështjen shqiptare. Mbase nuk vlen asnjë shpjegim ilustrues dhe konkret.

Është pikërisht ky pozicion i vetëkuptueshëm dhe i pakontestueshëm kjo: "Unë jam Unë" i politikës së vërtetë në Ballkan, që e alarmon z. Zeqiri. Si duket, në të gjitha fazat historike shqiptarët kanë qenë të gjykuar nga një gjyq fantomik dhe nga një gjykatës i padukshëm, ***mu si në veprat kafkiane,*** për të qenë *"viktimë e parëndësishme"* e kontinentit të vjetër. Është një fjalë e zymtë që çdoherë dhe në mënyrë të saktë e ka theksuar *"tjetrin"* në rajon: çifutët në Gjermani, çeçenët në Rusi, kurdët në Lindjen e Mesme, tutsit në Afrikë dhe fatkeqësisht – edhe pas intervenimit të NATO-s – shqiptarët në Ballkan.

Z. Zeqiri i bën thirrje Danimarkës, si anëtare e BE-së dhe e NATO-s, që të marrë përgjegjësinë e vet dhe të veprojë brenda këtyre organizatave, të promovojë një perspektivë të re – humane dhe në fakt racionale ndaj shqiptarëve. Ai i bën thirrje BE-së dhe NATOS-s që të kuptojnë faktin e pamohueshëm se nuk mund të ndërtohet një arkitekturë jetëgjate e paqes në Ballkan, pa e plotësuar vullnetin e shqiptarëve për liri. Dihet mirëfilli se liria nuk është diçka që mund të ndahet në pjesë me maturi. Nuk mund të matet me peshore të barnatores, as është shishe bari nga e cila duhet të nxjerrim 4-5 pika.

Ajo është një kategori universale dhe absolute: ***ose je i lirë, ose nuk je!***

Me mënyrën sesi trajtohet sot vullneti i shqiptarëve për liri në Ballkan - paralajmëron z. Zeqiri – përcaktohen vlerat që do t'i trashëgojnë fëmijët tanë në Evropën e ardhshme.

Fushat e bukura të Danimarkës nuk përshkohen nga erërat malore. Megjithëkëtë, aty dëgjohet një britmë, zëri i fuqishëm i Xhemil Zeqiri, i cili thërret emrin e zanës së ndaluar. Të shpresojmë se dikush do ta dëgjojë, për hir të të gjithë neve, para se të jetë shumë vonë!

Stokholm, Suedi, 26.02.2008

TË JESH NË MIQËSI ME XHEMIL ZEQIRIN TË BËN TË JESH KRENAR PËR SHUMË ARSYE

Ragip Sallova

Njeriu që e ka dëshmuar veten në të kaluarën, të sotmen e ka të pastër si loti. I takonim një të kaluare të përbashkët, një lufte të drejtë dhe një rruge me plot peripeci. E them këtë sepse në çdo sekondë apo milimetër të bisedave tona na përputheshin qëndrimet rreth të kaluarës dhe zgjidhjes së çështjes sonë kombëtare në të tashmen.

Jeta dhe veprimtaritë tona na ishin të syrvejuara, sa nga UDB-ja serbe, aq edhe nga argatët e tyre. Prandaj e patëm jetën të rrezikuar, por kjo nuk na frikësoi nga të ligët. Përkundrazi, merrnim vullnet dhe kjo na shtynte më tepër të veprojmë dhe të merremi më shumë në të mirën e popullit tonë.

Populli duhet krenuar që në radhët e tij ka ende burra si Xhemil Zeqiri. Po mos të ishte fryma e tij kombëtare, historia do të na shkruhej më ndryshe nga njerëzit e ligë që mundohen të jenë më të mëdhenj se dëshmorët tanë. Madje e quajnë veten edhe baba të lirisë apo të pavarësisë. Por një ditë do të skuqen faqet e historisë. Një ditë do t'i dilte flaka për të keqe. Prandaj populli duhet të ketë kujdes kë e afron dhe kujt ia beson fatin e vet. Në intervistën në Radio Kosovë, shoku Xhemil demaskoi shumë gënjeshtra të krerëve të vetë-thirrur si veprimtarë të LPK-së. Ai i demaskoi gjithashtu edhe krerët qeveritarë që na shtynë të dyshojmë në pohimet e tyre se e gëzojnë verdiktin e popullit. Ata e kanë marrë besimin e votuesve, duke vjedhur vota apo duke bërë manipulime të errëta.

Njëherazi e falënderoj për librin e dhuruar, të shkruar nga autori S. Kristo, *Në Moskë në mes Hrushovit dhe Enverit*.

XHEMIL ZEQIRI - VEPRIMTAR I SHQUAR I KOMBIT NË DANIMARKË

Shkruan Erald Selca

Ka më tepër se 35 vjet aktivitet dhe bagazh kombëtar, veprimtari nga Tetova e Shqipërisë etnike, atdhetari dhe intelektuali i mirënjohur Xhemil Zeqiri, i cili jeton dhe vepron në Kopenhagë të Danimarkës.

Atdhetarët si Xhemili ishin halë në sy për titistët dhe Jugosllavinë. Duhet shtuar se UDB-ja i syrvejonte atdhetarët dhe ilegalët e Lëvizjes, duke tentuar madje edhe t'i eliminonte.

Meritat e Xhemilit janë të shumta. Ai në Danimarkë e afirmoi çështjen shqiptare. Foli për shtypjen dhe persekutimet. Me tradhtarët e kombit, polemizoi në mediumet elektronike, ndërsa në shtypin e shkruar ka publikuar qindra artikuj. Me intelektualin mendjemprehtë Fadil Shytin ka botuar edhe libra.

Xhemili në vitet '90 të shekullit XX denoncoi helmimet serbe, kundërshtoi Kiro Gligorovin, politikat servile të shqipfolësve, si Arbën Xhaferi etj. Zë kritik ka edhe sot kundër lidershipit aktual.

Xhemili kontribuoi për LPK-në, për KMDLNJ-në, me Adem Demaçin, me shtetin shqiptar, me ish ministrin e Jashtëm Paskal Milon, i cili ishte edhe avokat i luftës së drejtë të UÇK-së dhe të simotrave të saj.

Xhemili kishte polemika edhe me Hans Hakerupin. Është njeri meritor i cili për kombin ka harxhuar mijëra e mijëra dollarë. Nuk është ndalur kurrë dhe gjithmonë ka qëndruar stoik përballë ortekëve të kohës. I tillë mbetet edhe sot.

Xhemili çmohet nga Ibrahim Kelmendi, nga idealistët, nga atdhetarët, si brenda, ashtu edhe jashtë atdheut.

Xhemili është person i padëshiruar nga klikat e Gruevskit dhe sojit të tij. Përkundër sfidave të jetës, ai vazhdon të kontribuojë edhe në rrafshin diplomat.

BIOGRAFI

KUSH ËSHTË XHEMIL ZEQIRI?

Nga është, çfarë arsimimi ka të kryer dhe autori i sa librave është?

I lindur më 27.02.1958 në katundin Zhelinë, rrethi i Tetovës. Ka mbaruar shkollën e mesme teknike në Gostivar. Pastaj u regjistrua në Fakultetin e historisë në Universitetin e Prishtinës në vitin 1980, por pas një viti, siç dihet, ndodhën demonstratat e pranverës së madhe të vitit 1981. Në katund, aty ku jetonte, kishte provokime nga policia maqedonase: thirrje për "biseda informative", maltretime etj., nga një stacionin policor në fshatin Grupçin, i cili në atë kohë ishte një stacion terrorizues për shqiptarët në anën e Dervenit. Prandaj u detyrua të emigrojë, së pari në Zvicër, pastaj në Gjermani, prej nga, disa muaj më vonë në Danimarkë, ku u vendos me punë. Prej atëherë, pra që nga janari i vitit 1981, me një përkushtim të madh, është përpjekur të veprojë pandalshëm për çështjen e pazgjidhur kombëtare.

Dhe, siç thekson autori, *"Tani po bëhen afër 30 vjet, pra mbi gjysmën e jetës sime e kalova në Danimarkë. Ashtu si jeta e të madhit tonë, simbolit të rezistencës shqiptare, Adem Demaçit, i cili i kaloi 28 vjet nëpër kazamatet jugosllave, duke e mbrojtur çështjen shqiptare,e unë rropatem rrugëve të Perëndimit duke i përkrahur mendimet e ndritura të këtij kolosi të madh të shqiptarizmit".*

Pasie mori lejen qëndrimit në Danimarkë, në fillim punoi lloj-lloj punësh fizike, sepse diploma e tij nuk qe me aq vlerë në Danimarkë. Ishte pa praktikë pune,kurse në Perëndim më tepër u intereson puna praktike se ajo teorike. Pra, nuk ishte i kualifikuar për atje. Pastaj u bë ngasës i autobusit urban dhe me këtë punë e çonte mirë, por koha e pengonte shumë për aktivitetet që i pat filluar, sepse orari i punës nuk i përshtatej dot. Kur aktivitetet filluan të shtohen, i filloi edhe kontaktet me gazetarët, me partitë politike, me shoqatat që merreshin me çështjet

ndërkombëtare, me deputetë etj. Prandaj u detyrua ta ndërpresë këtë punë dhe filloi të punojë taksist. Nga kjo punë ishte më i lirë dhe kishte njëfarë pavarësie në punë. Mbante kontakte më të rregullta dhe prej atëherë e vazhdon punën si taksist.

Pastaj fillon të merret me shkrime, kryesisht me publicistikë dhe me debate. U drejtonte letra të hapura institucioneve daneze, evropiane dhe atyre të OKB-së. Herë-herë i dërgonte artikuj shtypit danez për problemet politike që ishin aktuale për kohën. Natyrisht, dëshironte të mos dilte me emër, por disa nga mërgimtarët, këto veprimtari ia merrnin së prapthi, duke thënë: "Ai na qenka, siç thoshin,"i madhi". Kur e pa se kjo metodë ishte shumë e rrezikshme dhe do t´i kishte pasojat e veta dhe dëshpërimin e disa shokëve që e dinin kush po vepronte, vendosi të dalë hapur me emrin e vërtetë, pra pa pseudonim. Më vonë, ato shkrime dhe intervista do t'i botonte, vetëm e vetëm sa të njoftohej opinioni qartë për autorësinë, sepse kishte matrapazë të tillë që përpiqeshin ta pengonin aktivitetin e tij. Kur e shihnin se nuk kanë mundësi, së paku të rreshtoheshin përkrah tij dhe mundësisht të jenë të parët, u detyrua të dalë hapur me shkrime dhe deri tani ka katër libra të botuara: *"Kosova jonë", Tiranë 2000; "Në mbrojtje (diplomatike) të çështjes shqiptare", Prishtinë 2003; "Polemika, intervista, debate dhe letra", Prishtinë 2005; "Drejt Vetëvendosjes!", Prishtinë 2008; "E vërteta bën armiq", 2017*.

Libri i fundit është libër tre autorësh: Xhemil Zeqiri, Mona Agrigoroaei, një vajzë me prejardhje shqiptare, nga Rumania dhe Fadil Shyti, nga rrethi i Vushtrrisë.

Me Fadil Shytin i kanë dhe disa shkrime të përbashkëtaqë i janë kushtuar çështjes së pazgjedhur shqiptare.Ato do t´i botojnë në një libër, ca më vonë. Pastaj ka mundësi reale që autori në fjalë të botojë edhe një libër tjetër me intervista pasi materialet i ka të gatshme.

Duhet të theksohet se në mediumet elektronike dhe të shkruara shqiptare, ka dhënë shumë intervista ku i ka shprehur haptas qëndrimet dhe vizionet e tij për të djeshmen, të sotmen dhe të ardhmen e historisë së Shqipërisë natyrale. Gjithashtu, ka dhënë shumë intervista, disa herë në mediumet elektronike dhe të shkruara shtetërore daneze, për proceset që zhvilloheshin këto 20 vitet e fundit në trojet shqiptare.

Kopenhagë, 07.12.2014

FAKSIMIL

osovas selvstændighed (Vetevendosje), Albin Kurti, fra et. Men stik imod forventningerne – Albin Kurtis ldigt til Sverige - så fik Albin faktisk mest ud af mø-

Albin Kurti, Holger K. Nielsen og Xhemil Zeqiri

d til læsere i Roskilde, men også til Dagbladet i Køge og Ringsted samt af de Sjællandske Medier i Kalundidet.

le ting, der også blev tid til i de to rioder Albin var i Danmark, var flere d albanere, og et møde med Holger fra SF, som stadig kunne træffes i t. Til et efterfølgende møde, der e fundet sted med et socialdemoedlem af EU-parlamentet, mødtes det med journalisten Poul Smidt.

sen bad Albin STS om at stå for at af en delegationsrejse for 6-7 personer, der kunne besøge Kosova i okto Vi talte om emner til en sådan delegat men fortsætter drøftelserne et stykke endnu.

Et billigt besøg

Ikke mindst takket være Xhemil Zeqiri besøget af Albin billigt at gennem Xhemil sørgede for overnatninger og men også for at Albin blev transpor rundt til diverse arrangementer. STS talte for Albins billet med flyet, mer nægtede at modtage de penge, som kerne havde taget i gebyr for overfø



Uroelig situation i Nordvest

UDENRIGSMINISTERIET

Kære Xhemil Zeqiri

Tak for dit brev med en opfordring om at undersøge situationen i Makedonien (FYROM) og fortholdene for landets store albanske mindretal.

Danmark og EU følger udviklingen på Balkan tæt, herunder også udviklingen i Makedonien (FYROM). Som du påpeger i dit brev, er der ingen tvivl om, at spørgsmålet om behandling af mindretal er et vigtigt anliggende i Makedonien (FYROM), hvor det albanske mindretal repræsenterer op mod 25% af befolkningen.

Danmark har gentagne gange – bilateralt såvel som i EU-sammenhæng - anført overfor Makedonien (FYROM), at netop behandlingen af etniske mindretal var et af de områder, der fortsat skulle prioriteres højt.

Det kan i den forbindelse nævnes, at den makedonske regering siden sammenstødene i 1997 mellem albanske og makedonske befolkningsgrupper har haft som et af sine mål at forbedre forholdene for landets etniske mindretal. Skridt i denne retning har været vedtagelsen af en amnestilov for de fængslede fra sammenstødene i 1997, samt skabelsen af et privat finansieret albansk-sproget universitet i Tetovo. Et yderligere tegn på den albanske mindretals øgede integration i det makedonske samfund er partier DPAs (Albanerens demokratiske parti) deltagelse i regeringen. Det er i den forbindelse lykkedes DPA at få virkeliggjort flere af de krav, som den albanske befolkning i Makedonien (FYROM) ønsker gennemført. På internationalt hold støtter denne demokratiske dialog og de politiske lettinger - bl.a. af statsborgerskabsspørgsmål - som den skaber mulighed for.

Xhemil Zeqiri
Rådet til forsvar af menneskerettigheder og frihed i Kosova,
dansk afdeling
Øster Farimagsgade 9 st. th.
2200 København N

N.6. 5.D.260.a.

1. marts 2001

N.6. 5.D.260.a.

5. april 2001

UDENRIGSMINISTERIET
UDENRIGSMINISTERIET
K.4. J.nr. 135.D.1.e
København, den 29. oktober 1994
3. marts 2004
26. januar 2005



N.6. j.nr. 135.D.1.a

København, den 20. oktober 1994

Xhemil Zeqiri
Formand for Rådet til forsvar
af menneskerettigheder og frihed i Kosova
Kære Xhemil Zeqiri, Ørholmsgade 9 st. th.
2200 København N

Tak for Deres brev af 5. oktober 1994. Danmark følger nøje udviklingen i situationen for de etniske albanere i det tidligere Jugoslavien.

EU og Danmark har gentagne gange fordømt overtrædelserne af menneskerettighederne i det tidligere Jugoslavien. Med henblik på at sikre en retsforfølgelse af de personer, der er ansvarlige for overtrædelse af menneskerettighederne, har EU bl.a. medvirket ved etableringen af den internationale krigsforbryderdomstol vedrørende det tidligere Jugoslavien i Haag.

EU og Danmark ser med den største alvor på de serbiske myndigheders overgreb mod den lokale befolkning i Kosova. De seneste rapporter fra Amnesty International om overtrædelser af menneskerettighederne i

Xhemil Zeqeri,
formand for Rådet for Mennesherettigheder i Kosova, dansk afdeling

Jeg har siden 1981 arbejdet i Danmark for menneskerettigheder i Kosova. Bomber løser intet. Krigen må stoppes øjeblikkeligt. Den har skabt nyt had, nyt sorg og menneskelig lidelse. Det er civilbefolkningen, der som altid betaler den største pris. I Kosova i dag er der skabt den største humanitære katastrofe siden en humanitær historie. Derfor appellerer jeg til alle krigshandlinger. Der må der findes en løsning ved forhandlingsbordet, som afviser nationalisme og etniske udrensninger, som respekterer og på lige rettigheder for alle uanset nationalitet.

Apartheid i Makedonien

Balkan er mange gange i historien blevet kaldt en kruttønde, fordi hele området er et kludeteppe af nationaliteter. Grænserne er blevet trukket af stormagterne, som har skabt store nationale mindretal i mange lande.

Af Xhemil Zeqiri

Det er en farlig kurs vi der stævner mod, siger Xhemil Zeqiri, der er formand for Rådet for Mennesherettigheder i Kosova, dansk afdeling. Han er selv albanerer med familie i Makedonien, hvis situation er et ikke mere end et tilfælde af manglende rettigheder og ringere for alle landets borgere. Men det er langt fra tilfældet.

Tre krigen i det tidligere Jugoslavien er blevet kaldt en kruttønde på Balkan, da der igen kastet benzin i det allerede meget brændende bål i Kosovo, en provinsen i Makedonien kan den blandt i 18 nationalitetsgrupper og mere end 7 forskellige dialekter. Det er en af albanerne i Makedonien, der er blevet fra Makedonien.

varig og acceptabel løsning

DEBAT • KOMMENTAR

Albanernes tragedie kræver hurtig løsning

Kommentar af Xhemil Zeqiri

Information torsdag 23. juli 2009 21

OPINION

Helvede

Helvede er at have tabt håbet.

Archibald Joseph Cronin

PÅTALE

Historien som læremester

Tilsvarende gælder det al-

Albansk protest

Af Henrik Kaufholz

Under krigen i Kroatien er Serbiens undertrykkelse af det store albanske flertal i Kosovo, hvor nu alle albanske medier er blevet lukket, overset af både medierne og vestlige politikere, der prøver at skabe fred i Jugoslavien.

Derfor har Den albanske demokratiske forening i Danmark indkaldt til demonstration i København fredag 15. november. Den starter på Rådhuspladsen kl. 15 og slutter ved Udenrigsministeriet, hvor albanerne vil aflevere en opfordring til udenrigsminister Uffe Ellemann-Jensen om 'ikke at glemme Kosovos skæbne'.

– Der er fuldstændig kaos i Kosovo nu, siger Xhamil Zeqeri fra den albanske forening. 27.000 forårs er blevet fyret fra skoler, gymnasier og universiteter. De albanske medlemmer af Kosovos parlament tør ikke vise sig offentligt af frygt for det serbiske politi. Vi mener, at en varig og fredfærdig løsning på Jugoslaviens problemer kun kan nås ved at give alle nationaliteter samme rettigheder.

Der bor cirka 3.000 albanere i Danmark.

Glem ikke Kosova

Kosova bløder – Hvorfor tier Europa? Det spørger herboende albanere fra Jugoslavien om i forbindelse med borgerkrigen i Jugoslavien.

Albanerne afholder på fredag demonstration i København:

– Vi opfordrer på det kraftigste den demokratiske opinion i Danmark til at protestere mod undertrykkelsen af den albanske nationalitet i Jugoslavien. Ligeledes opfordrer vi de danske medier til ikke at glemme Kosovas skæbne, siger de herboende albanere fra Jugoslavien.

Demonstrationen afholdes fredag den 15. november kl. 15 fra Rådhuspladsen i København til udenrigsministeriet.

Certifikatë

Xhemil S Zeqiri

Veteran Luftëtar
i Ushtrisë Çlirimtare e Kosovës

Nr. prot. 12/3235
Data: 30.04.2016

Në emisionin "Më afër" në RTK - radio, me Demir Reshitin

Me recensentin e librit, general Dilaver Goxhaj

PËRMBAJTJA

INTERVISTA **15**
NUK SHOH ÇLIRIM KUR NJË E TRETA E TERRITORIT TË KOSOVËS ËSHTË NËN OKUPIM TË DHUNSHËM DHE ME ENKLAVA SERBE 20
NË DANIMARKËN DEMOKRATIKE KEMI PASUR MUNDËSI TË MËDHA, POR ATO NUK I SHFRYTËZUAM 30
PROBLEMI KA ÇALUAR QË NGA KONFERENCA E RAMBUJESË, KUR DELEGACIONI I KOSOVËS E NËNSHKROI ATË MARRËVESHJE 47
MOSMIRËNJOHJA – VESI MË I ULËT NJERËZOR 76
PËR ÇËSHTJEN KOMBËTARE TË GJITHË DUHET TË PUNOJNË 95
DUHET TË PËRKRAHET PLATFORMA PËR SHQIPËRINË NATYRALE 120
SALI BERISHA DHËNDËR SERB, ARBËN XHAFERI FILOZOF "RADIKAL" 134
DIÇKA ËSHTË DUKE ZIER NË MAQEDONI 145
UNË DUHET TË BËJ PËR SHQIPËRINË DHE JO SHQIPËRIA TË BËJË PËR MUA! 149
Pjesa e dytë *167*
REAGIME **167**
UNË QUHEM XHEMIL ZEQIRI, E JO PETRIT VOKA APO XHEMIL ZHELINKA 169
ZOTËRI XHAFER LECI NA TREGOI SE VËRTET QENKA NAIV ME BRIRË TË NDYRË! 178
SQARIM RRETH REAGIMIT TË IBRAHIM XHEMAJLIT, LIDHUR ME INTERVISTËN TIME DHËNË SHOKUT TIM, FADIL SHYTIT! 188
ÇFARË KULTURE PREJ RRUGAÇI QË KENI, O BAKI YMERI (!!!) 197
RTK-ja NË SHËRBIM TË KOLABORACIONISTËVE PROFASHISTË! 205
DISKUTIME 210

LIBRI I XHEMIL ZEQIRIT DALLOHET NGA SHUMË LIBRA TË TJERË TË KËSAJ NATYRE NË LOGJIKËN SPECIFIKE AUTENTIKE 212
UNË DO TA KISHA TITULLUAR LIBRIN, DËSHMI PËR KOHËN TONË 218
ENVER HOXHA MERITON NJË PËRMENDORE 500 METRA 222
Pjesa e tretë *225*
SHKRIME TË NDRYSHME 225
A DO TË BËHEN PËRMIRËSIME NË POLITIKËN SHQIPTARE APO DO TË VAZHDOJË E NJËJTA DEMAGOGJI POLITIKE?! 227
PËRPJEKËJET PËR TA SHPIKUR NJË KOMB KOSOVAR-IDEOLOGJI THELLËSISHT ANTIKOMBËTARE 231
HISTORIA SI MËSUESE LIRIE PËR KOSOVEN 238
JA PSE DUHET TË KEMI NDRYSHIME RRËNJËSORE NË KOSOVË 241
PSE PO NDODH KËSHTU?! 244
MARSI I KRENARISË KOMBËTARE SHQIPTARE! 246
SI ARRITËM TA PRANOJMË ADEM DEMAÇIN ANËTAR NDERI NË PEN-in DANEZ DHE NË ATË SKANDINAV 249
KOSOVA - ZGJEDHJET TË LIRA NË SERBI PËR TË ARDHMEN E KOSOVËS! 252
SHPALLJA E “PAVARËSISË” Më 17.02.2008 DHE PROTESTAT SERBE 255
KUSH ËSHTË ANDERS FOGH RASSMUSENI, TANI SEKRETAR GJENERAL I NATO-s?! 257
VIZITË SKANDALOZE E PRESIDENTIT TOPI NË DANIMARKË! 260
PUSHTUESIT KURDOHERË MBETEN PUSHTUES, PAVARËSISHT GJUHËVE DHE FLAMUJVE QË I KANË! ... 262
ARBËN XHAFERI, ASHTU SI E NJOHA UNË 266
SI U FESTUA 25 VJETORI I THEMELIMIT TË RADIOS 'ZËRI I KOSOVËS' NË KOPENHAGË 275
LËVIZJA VETEVENDOSJE PO I DEMASKON FUQISHËM PLANET E SERBISË DHE TË TITSTËVE SHQIPFOLËS 281

JA PSE U VRA LUFTËTARI I LIRISË ENVER ADEMI! 286
SPEKULANTËT FETARË PO MANIPULOJNË ME ÇËSHTJEN SHQIPTARE!.....288
MAQEDONIA SHTYPUR PAKICËN SHQIPTARE.....291
VAZHDON APARTEIDI NDAJ SHQIPTARËVE NË MAQEDONI PJESËMARRËS SI KURDOHERË EDHE SHQIPFOLËSIT! 293
Pjesa e katërt 321
LETRA, PETICIONE DHE TELEGRAME 321
LETËR E HAPUR QEVERIS DHE KUVENDIT DANEZE!.....323
LETËR E HAPUR KRYEADMINISTRATORIT TË KOSOVËS SOREN J. PETERSEN.....326
LETËR E HAPUR PARTIVE, PARLAMENTIT DHE QEVERISË SË DANIMARKËS.....329
STOP PËRNDJEKJES SË POPULLIT SHQIPTAR NË MAQEDONI!.....333
LETËR TË HAPUR Drejtuar z. Bedri Islami 336
LETER E HAPUR PREZIDENTIT SHQIPTAR z.BUJAR NISHANI 341
SIMBOLIT TË REZISTENCËS SONË KOMBËTARE, Z. ADEM DEMAÇI, PISHTARIT TË RIBASHKIMIT KOMBËTAR 348
KËRKESË.....348
TELEGRAM URIMI BACË ADEM DEMAÇIT, ME RASTIN E 70-VJETORIT TË LINDJES 351
Pjesa e pestë 353
RRETH FIGURËS SË ENVER HOXHËS 353
ENVER HOXHA, I VETMI SHQIPTAR NË ENCIKLOPEDINË BOTËRORE.....353
ENVER HOXHA PUNOI PËR TË MBROJTUR POPULLIN NGA RREZIQET QË I KANOSESHIN PREJ FQINJËVE OKUPATORË.....355
ENVER HOXHA BURËSHTETASI QË EDHE KUR FIENË I TMERRON TRADHËTARËT 359
ENVER HOXHA ËSHTË I GJALLË PËR ÇDO SHQIPTAR, QË E NDIEN VETEN SHQIPTAR, NDËRSA TI DHE GRUPI YT

NEOFASHIST JENI TË GJALLËT E VDEKUR, O BUJAR NISHANI! 366
Pjesa e gjashtë *377*
RECENCA 377
TË THËRRASËSH ZANËN E NDALUAR 379
TË JESH NË MIQËSI ME XHEMIL ZEQIRIN TË BËN TË JESH KRENAR PËR SHUMË ARSYE 383
XHEMIL ZEQIRI - VEPRIMTAR I SHQUAR I KOMBIT NË DANIMARKË 384
FAKSIMIL 387
PËRMBAJTJA 397

Të dashur lexues,
Librin që keni në duar, fillimisht e dërgova për ta botuar në një shtëpi botuese në Tetovë ku qëndroi rreth një javë. Drejtuesit e shtypshkronjës pasi e kanë parë përmbajtjen e librit, nuk ishin në gjendje ta marrin përsipër botimin me arsyetimin se shteti maqedonas nuk po pranon ta bëjë katalozimin e librit nga se, sipas tyre, libri vë në thumb të kritikës qeveritarët maqedonas... Madje ata më konsideronin disident!!! ***(Autori)***